Xhafer Durmishi

SKENDER

VEPRA
20



VEPRA
E
JUSUF GËRVALLËS

SI ANËTAR DHE IDEOLOG
I LËVIZJES NACIONALÇLIRMTARE TË KOSOVËS DHE
VISEVE TË TJERA SHQIPTARE NËN JUGOSLLAVI
(Dhjetor 1979 - Janar 1982)

AI QË KISHTE HUMBUR DHE FITUESJA E MEDALJES

1. Ai për mua kishte humbur në Gjermani
2. Naku dhe Gjergji mund t'ju flasin çka vlen për veprën e tij
3. GAZETAT E REVISTAT E JUSUFIT JANË PRODUKT I FRIKËS PERSONALE
4. LETRAT E JUSUFIT JANË PRODUKT I FRIKËS PERSONALE
5. Pena e Redaksisë së Dukagjinit
6. Baskia e kullës së Dukagjinit
7. Kurrsesi kompromis me komunistët
8. Qëllimet majtiste janë të kthjellëta si loti
9. Dje në amfiteatrin e Bibliotekës Kombëtare
10. Teksti më analitik dhe më gjithëpërfshirës
11. Kam pretendime
12. Fituesja e Medaljes

*

* *

1. Disa faqe nga Ditari
2. Intervistë
3. Letër e hapur satrapit J. B. Tito - Njeriu ka një të metë: ai di të mendojë!
4. Dasma e barbarit mbi kufomën e të stërmunduarit
5. Letër lexuesve Të dashur lexues të "BASHKIMIT"
6. Uji vërshonte – UDBa burgoste patriote e patriotë
7. Politikë asimiluese ndaj shqiptarëve në Jugosllavi
8. ZËRI I POPULLIT - ZË I TË GJITHË SHQIPTARËVE
9. MIRËUPAFSHIM NË MARSHIN E ARDHSHËM SHUMËMILIONËSH
10. IK O NATË PO KËNDON AGIMI
11. Letër një shoqi intelektual
12. PSE PËR HEKUBËN?
13. Ç'thonë kronikat e vjetra dhe të rejat?
14. MANIPULIMET NË SHTYPIN E HUAJ
15. PROGRAMI DHE STATUTI I FRONTIT TE KUQ POPULLOR
16. "BASHKIMI" BËN FUQINË
17. NËNTORI SHQIPTAR NË VISET E ROBËRUARA
18. KORRESPONDENTI POPULLOR
19. LANGONJËT NË GJAH PËR ZOTËRINË
20. KREATORI I ROBËRISË
21. NJOFTIM
22. "BASHKJETESA" E XHELATIT ME VIKTIMËN

23. Perditio tua, Israel, ex te
24. Viktima që glorifikon xhelatin e vet
25. Konjugacionet e një pushteti "popullor"
26. REKUIEM PËR NJË MONARK
27. RENEGATI
28. KTHIMI I BIRIT PLANGPRISHËS
29. DY FJALË PËR NUMRIN E PARË TË "LAJMËTARIT TË LIRISË"

30. Jo ngushëllime po urime
31. ME SY E ZEMËR NGA NËNA SHQIPËRI
32. Gëzuar Nëntori
33. KOHËT NDËRROJNË FATLUMNISHT
34. Dokumenti i gatishmërisë
35. VDIQ VIGANI I DIJES SHQIPTARE
36. V. I. LENIN - Situata revolucionare
37. MASHTRIM I MADH I RAMZESIANËVE TË VEGJËL
38. Aferë hashashi në Istri
39. PASHIQI – HOTI (paralele)
40. LUGATI NË KËNDIN E PARË TË RRUGËS
41. KOPILI I EPOSIT
42. Ka disa shqiptarë

43. KESHTU NA "URON" UDB-ja VITIN E RI!
44. Danush Gegaj
45. MË TË FORTË SE KURDOHERË
46. Një provokim i lig i vullnetit të popullit
47. KURTHET DHE HENDEQET
48. NJË VARIANT LEXIMI
49. ARMIKUT - GURIN E GJAKUT
50. SHTOJCË E LAJMËTARIT
51. THIRRJA PËR DEMONSTRATËN E SHTUTGARTIT, 25 prill 1981

52. REGJISTRIMI I POPULLSISË NË KOSOVË U BË NËN HIJEN E TANKEVE
53. KOSOVË, SA HIJE TË KA XHAMADANI I TRIMËRISË!
54. TRADHTARËT E VJETËR DHE TRADHTARËT E RINJ
55. SHQIPJA BËN EDHE PA GJËMË, I MJAFTON LAVDIA
56. TË MBLIDHEMI RRETH FLAMURIT FITIMTAR TË POPULLIT TONË TË BASHKUAR

57. K O M U N I K A T E
58. Fjalë më 28 Nëntor 1981 në Shtutgart

59. Kosova gjëmëmadhe, trimëresha Kosovë
60. Tetë kërkesa të parevokueshme të popullit shqiptar në Jugosllavi
61. TË DASHUR LEXUES,
62. DËNIMET E RËNDA NUK E MPOSHTIN POPULLIN AS RININË TONË
63. S'e ka të gjatë robëria
64. Luftëtar deri në vdekje
65. Turpi i mizorit dhe lavdia e heronjve
66. Më shumë se fashistë
67. Letër e hapur popujve të Jugosllavisë
68. MASA PËR PARALIZIMIN E ARSIMIT NË KOSOVË
69. S'na frikësojnë inskenimet
70. Gjuha shqipe dhe flamuri shqiptar në shënjestër
71. T'I JAPIM SHTYTJE TË RE LUFTËS
72. Komiteti Qendror i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare - Abusus not tollit usum
73. TË DASHUR LEXUES

74. Vive le son du canon!
75. NË DIJENI VËLLEZËRVE QË NDODHEN NË SHËRBIMIN USHTARAK
76. Yje të pashuar në qiellin e Kosovës
NJËRI NGA ATA
77. HARAÇI PËR MILICINË SERBE
78. ARMIKUN TA GRISHIM NË LOGUN QË DUAM VET
79. NË VEND TË URIMIT
80. BOTA PROGNOZON TË VËRTETËN SE SHEH (THOTË)!
81. Lëvizja e organizuar dhe spontaniteti
82. MBROJTJA E KISHAVE DHE SHENJTORËVE SERBË NGA SHQIPTARËT NË SHEKUJ
83. ÇËSHTJE TË LUFTËS NACIONALÇLIRIMTARE DHE TË REVOLUCIONIT

Letrat

1. Letër për Ibrahim Kelmendin, nga pranvera 1980
2. Letër për Nazmi Selmanajn, prill 1980
3. Letër Enver Hoxhës, prill 1980
4. Letër Enver Hoxhës, 19 gusht 1980
5. Letër Nënës në Dubovik, shtator 1980
6. Letër për Ibrahim Kelmendin, nëntor 1980
7. Letër për Nuhi Sylejmanin, janar 1981
8. Letër për Nuhi Sylejmanin, kah fundi i janarit 1981
9. Letër për Nuhi Sylejmanin, 10 shkurt 1981
10. Letër për Nuhi Sylejmanin, mesi i marsit 1981
11. Letër e Bardhoshit për Nijazi Strajën, 4 prill 1981)
12. Letër për Sabri Novosellën, 14 prill 1981
13. Letër për Sabri Novosellën, 13 maj 1981
14. Letër për Faridin Tafallarin, verë 1981
15. Letër për Faridin Tafallarin, verë 1981
16. Letër për Faridin Tafallarin, verë 1981
17. Letër Sabri Novosellës, 16 qershor 1981
18. Letër për Sabri Novosellën, 21 korrik 1981
19. Letër për Sabri Novosellën, 31 korrik 1981
20. Raport për degën Hasan Prishtina, 31 korrik 1981
21. Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981
22. Letër për Sabri Novosellën, 5 nëntor 1981
23. Letër për Sabri Novosellën, 14 nëntor 1981
24. Letër për Sabri Novosellën, 16 nëntor 1981
25. Letër për Kadri Zekën, 7 dhjetor 1981
26. Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982
27. Letër Imer Baqajt në kampin Latina në Itali, 14 janar 1982
28. Letër për Ibrahim Kelmendin, 15 janar 1982
29. Letër Kadri Zekës, 15 janar 1982

* * *

BETOHEM SE DO TA THEM TË VËRTETËN, KREJT TË VËRTETËN DHE ASGJË POS TË VËRTETËS

1. U VRANË TRE EMIGRANTË
2. KOSOVËS PO I VRITEN DJEMTË NGA SERBOMËDHENJTË
3. BETOHEM SE DO TA THEM TË VËRTETËN, KREJT TË VËRTETËN DHE ASGJË POS TË VËRTETËS

Veprën e Jusuf Gërvallës, si anëtar dhe ideolog të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare nën Jugosllavi (Dhjetor 1979 - Janar 1982), të parashtruar më poshtë, nuk e konsideroj të kompletuar. Përmbledhja e mëposhtme përbëhet, në tërësi, nga materiale të publikuara, në forma e mediume të ndryshme.

Kam qenë i bindur dhe kam pritur se vepra e Jusuf Gërvallës, si anëtar dhe ideolog i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare nën Jugosllavi do të botohet e përmbledhur qe shumë vite, por një punë e tillë nuk është bërë deri më sot. Pse nuk është botuar deri më sot pjesa më e rëndësishme e veprës së Jusufit, për të cilën e ka dhënë jetën, është çështje jo aq e thjeshtë për disa, por edhe unë në këtë pikë nuk do të ndalem për të dhënë një përgjigje të zgjeruar.

Ata që mendojnë seriozisht se kanë përparësi për përkujdesjen dhe ruajtjen e veprës të Jusuf Gërvallës nga shtrembërimet, ç'vlerësimet, humbjet dhe falsifikimet, këtë punë timen mund të ta konsiderojnë si ndihmesë në përmbledhjen dhe ruajtjen e saj.

Të gjithë ata të cilët ndërgjegjja dhe vetëdija i ka detyrua me u marrë me veprimtari ilegale, kundër sundimit të huaj në trojet shqiptare nën Jugosllavi, duke marrë rreziqe e bërë sakrifica të shumta, dhe duke i kaluar vitet e tyre më të mira të jetës nëpër burgjet e egra e të errëta, vetëm pse i kanë shpërnda dhe lexuar revistat dhe shkrimet e Jusuf Gërvallës, këtë përmbledhje mund ta konsiderojnë si kontributin tim në shenjë respekti për luftën dhe historinë e tyre, gjeneratën e tyre, epokën e tyre, luftën e tyre të ligjshme, luftën e tyre legjitime, luftë e cila nga pushteti vrastar i Jugosllavisë u klasifikua si e paligjshme.

AI QË KISHTE HUMBUR DHE FITUESJA E MEDALJES

1. Ai për mua kishte humbur në Gjermani
2. Naku dhe Gjergji mund t'ju flasin çka vlen për veprën e tij
3. GAZETAT E REVISTAT E JUSUFIT JANË PRODUKT I FRIKËS PERSONALE
4. LETRAT E JUSUFIT JANË PRODUKT I FRIKËS PERSONALE
5. Pena e Redaksisë së Dukagjinit
6. Baskia e kullës së Dukagjinit
7. Kurrsesi kompromis me komunistët
8. Qëllimet majtiste janë të kthjellëta si loti
9. Dje në amfiteatrin e Bibliotekës Kombëtare
10. Teksti më analitik dhe më gjithëpërfshirës
11. Kam pretendime
12. Fituesja e Medaljes

1. Ai për mua kishte humbur në Gjermani

Sabri Hamiti: "DONA (Donika Gërvalla)

I njejti ambient. Gjysmerrësirë.

DONA, e vetmuar. - Kush janë ata t'u flas për babain tim. Asnjë fjalë. Babain e kam njohur vetëm në Prishtinë. Duhet të kthehem atje për ta rinjohur. Jashtë nuk ka qenë

i njëjti. Ajo mbyllje në dhomën e tij në mansardë. Ai ballë i rrudhur, ajo buzëqeshje e tretur. Interesi i humbur për gitarën e vetë, për flautën time. Atëherë s'kam ditur gjë, tash e di si ia hëngrën shpirtin paknapak përditë. Ai për mua kishte humbur në Gjermani. Bishat ia hëngrën zemrën. Tash duan të ngjallen si kufomat e gjalla rreth hijes së tij. Jo. Nuk lejoj, nuk dua. Çka kanë bërë për të, asgjë. E kanë veshur vdekjen e tij me një vel të mjegullës, me peshën e territ. Jo! Pushim. Ç'është ky vrap i mjerë i njerëzve që duan të gjejnë identitetin e vet te tjetri në vonesë kohe." (Misioni, Prishtinë 1997, faqe 88-89)

2. Ata mund t'ju flasin çka vlen për veprën e tij

Sabri Hamiti: "ZANA (Suzana Gërvalla shën i Xh. D.), pa përfillje. Nuk kam çka sugjeroj në mënyrë të veçantë. Sa për miqtë e Isës, ai i ka pasur dy miqë të mirë, Nakun e Gjergjin. **Ata mund t'ju flasin çka e vlen, për veprën e tij."** (Misioni, Prishtinë 1997, faqe 83-84)

3. GAZETAT E REVISTAT E JUSUFIT JANË PRODUKT I FRIKËS PERSONALE

Sabri Hamiti: "*GJERGJI – Kush qenkan këta?*

ISA – vijon me zë të ulët. Thonë se janë një Luli e një Keqa. Kurrë s'i kam parë. Kanë mbi kokë një tjetër që i thonë Sofo. Po të gjitha fjalët sillen rreth një I Padukshmi, të tjerët i thonë Jusi. Të tjerët i bartin fjalët e tyre...

GJERGJI – Që ti je tradhtar?

ISA – Edhe këtë, edhe atë. Por shërbime lypin. Donë gazeta e janë gjysmanalfabetë. Shihe çfarë shkruajnë! Ia nxjerrë parasysh një letër. Parulla, propagandë qesharake. Këngë për traktorin, vaje për Kosovën, himne për Shqipërinë, këngë për Të Madhin. Më duhet të ndreq diçka."

GJERGJI – Këto fjalë më sollën këtu si pakrye. Ata farë tipash duhet t'i takosh sa më shpejt, përndryshe shkove keq ti dhe më keq familja." (Misioni, Prishtinë 1997, f.23-24)

Jusuf Gërvalla: "*Ku zënë fill, nga shtegtojnë dhe ku ngrehin çerdhe lejlekët e anës së ndriçuar të vetëdijes së Planetit, është punë që nuk mund të hetohet jashtë ligjshmërisë dialektike; Dhe, kjo ligjshmëri, për të paditurin, shfaqet përplot pusi.*" (Lajmëtari, tetor 1980, faqe 6)

4. LETRAT E JUSUFIT JANË PRODUKT I FRIKËS PERSONALE

U promovua "Shtëpia në rrugë"

Ishin të pranishëm Hysen-, Avdyl-, Donika- dhe Ergon GËRVALLA

Rexhep RIFATI, Prishtinë, 16 gusht 2014

Vargut të autorëve shqiptarë në Zvicër, me një libër të promovuar në Prishtinë, iu bashkua edhe publicisti Avdyl Gërvalla – njëri nga vëllezërit Gërvalla.

Botuesi dhe shkrimtari Nazmi Rrahmani përkujtoi se autori librin e fillon me ngjarjet e vitit 1921, që i përjeton kjo shtëpi, e cila për shkak të pjesëmarrjes nëpër luftëra çlirimtare përjeton goditje të mëdha, deri në konfiskimin e pasurisë nga regjimi i atëhershëm.

Edhe e mbesa e Bardhoshit, e bija e Jusufit, Donika, e pati tregimin e saj në këtë promovim. Ajo tha se kishte dëgjuar edhe më herët për disa nga ato që përshkruhen në

librin «Shtëpia në rrugë», por ai që ka lënë mbresë të pashlyeshme tek ajo ka qenë xhaxhai, Bardhoshi: «Për mua, si mbesë e tij, Bardhosh Gërvalla është ndër njerëzit më mbresëlënës që kam takuar ndonjëherë në jetën time». Ai për të është një ndër figurat më jotipike shqiptare, ndaj e karakterizoi, sa shqiptar, aq edhe evropian.

Pos autorit, Avdylit, nga radhët e familjes Gërvalla i pranishëm në promovim ishte edhe Ergon Gërvalla, djali i Jusuf Gërvallës, cili e ka përgatitur disenjmin e kopertinës së librit të promovuar.

DIKUSH PO I KEQPËRDOR KËTO LETRA TË JUSUF GËRVALLËS

www.koha.net 16 gusht 2014

"*I dashur shoku Enver! Ne shqiptarët e shkëputur nga atdheu i lirë dhe të mbërthyer me dhunë brenda kufijve politikë të Jugosllavisë, ndjekim me krenari çdo hap të Shqipërisë mëmë me përforcimin dhe përparimit të atdheut*", shkruante Gërvalla.

E për çfarë tjetër do të mund ta çmonte Hoxhën, një njëri që tërë jetën e tij ia ka kushtuar lirisë nga shtypja. Një njohës i mirë i Gërvallës, mik i tij i afërt gjatë kohës që i ndjeri ka jetuar në Kosovë, Skënder Blakaj, thotë se *kjo letër u shkrua për shkaqe krejt tjera, nga ato që ne mendojmë sot.*

"Dikush po i keqpërdor këto letra të Jusuf Gërvallës. Por nuk po duan me kuptua në çfarë rrethana i ka shkruar ai ato", deklaron Blakaj.

Gjatë përurimit të librit "Shtëpia në rrugë", e autorit, vëllait më të vogël të Jusufit, Avdyl Gërvalla, Blakaj deklaron *se i ndjeri ka kërkuar disa herë që ta vizitoj Shqipërinë, por një gjë e tillë nuk i është pranuar. E kur i Gërvalla ka ikur në mërgim, nuk është pritur mirë nga shqiptarët, madje prej tyre ka pas edhe përfaqësues të Republikës Populllore të Shqipërisë që i kanë bërë presion të madh atij.*

"Jusuf Gërvalla i shkroi Enver Hoxhës, sepse problemi kryesor ishte ndërmjet enveristëve të djegur në perëndim nga të cilët ishte i kërcënuar dhe në fund ne nuk e dimë sa është e madhe pjesëmarrja e Tiranës në likuidimin e atyre djemve. Ka sinjale për këtë. Prandaj e bëri që të mbrohej nga këta vërsulës. Unë njoh dy dëshmitar në një grindje të jashtëzakonshme, përfaqësuesi i Shqipërisë në ambasadën e Vjenës dhe një tjetër i njohur si patriot, me grindje të tillë e presion të jashtëzakonshëm ndaj Jusuf Gërvallës. E kush mund të ishte ai që do ta mbronte Jusufin nga këta, pos Enver Hoxhës. Ai nuk mund t'i thoshte Hoxhës se demokracia është sistemi më i mirë. Ai shkroi atë letër si kërkesë për strehimin e tij", ka shtuar Blakaj. (Jusuf Gërvalla kishte kërkuar strehim në Shqipëri, www.koha.net, 16 gusht 2014)

Jusuf Gërvalla: "*Ku zënë fill, nga shtegtojnë dhe ku ngrehin çerdhe lejlekët e anës së ndriçuar të vetëdijes së Planetit, është punë që nuk mund të hetohet jashtë ligjshmërisë dialektike; Dhe, kjo ligjshmëri, për të padituri, shfaqet përplot pusi.*" (Lajmëtari, tetor 1980, faqe 6)

5. Pena e Redaksisë së Dukagjinit

Zejnullah Rrahmani: "Atëherë arriti përgjegjja, sa e çuditshme aq edhe e mrekullueshme, nga Faraoni, i mbyllur atje në Kështjellën e tij të pathyeshme, rrethuar prej armiqëve të socializmit, prej armiqëve të proleteriatit ndërkombëtar, pra rrethuar prej imperializmit dhe klyshve të tij, i vetëm midis botës së kalbur, i ndriçuar përjetësisht nga ideologjia marksiste-leniniste e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, i adhuruar nga populli i tij socialist, ai, Faraoni, pishtar i marksizëm-leninizmit, shpresa e përjetshme e

grupeve marksiste-leniniste të Evropës e të Botës, udhërrëfyesi i pagabueshëm, biri i madh i Partisë, shkroi në gjuhën e unjisuar shqipe, ose gjuhën letrare shqipe, siç i thoshin disa, ose thjeshtë ashtu siç ishte lakuriq, në toskërishte:

-Vriteni qenin dhe hudheni ne plehëra!

Dhe, oh mrekulli! në referimin e orës pesë që bëri ai. Prapashtimësi, ushtari i Putifarit, në shqipserbishten e tij, mori një përgjigje tepër të palënshteg: një revolver me mbytës të zërit dhe biletën në një drejtim: Gjermani." (Jusufi, Dukagjini, Pejë, 2000, faqe 31-32)

Redaktor i librit *Jusufi* të Zejnullah Rrahmanit është Eqrem Basha.

Anëtarë të Redaksisë së Shtëpisë Botuese "DUKAGJINI" në Pejë, (Bibliotekës ROZAFA, që ka bërë botimin e librit *Jusufi*) emrat e të cilëve janë dhënë në fillim të librit *Jusufi* të Zejnullah Rrahmanit janë: Eqrem Basha, Rexhep Ismajli, Shkëlzen Maliqi dhe Skënder Blakaj.

Shkëlzen Maliqi: *"Në të vërtetë, edhe babai im ishte një ushtar i spikatur i revolucionit dhe shef i policisë kosovare në vitet pesëdhjetë, kur edhe në Kosovë zhvillohej lufta klasore kundër "reaksionit borgjez" dhe të tjerëve, çka nënkuptonte burgosje dhe tortura për kundërshtarët e regjimit, dhe pastaj për të dytën herë, që nga viti 1981 gjer më 1984, kur u burgosën në masë dhe iu nënshtruan torturave me mijëra "kundërrevolucionarë" kosovarë, "irredentistë" dhe "nacionalisë" shqiptarë."*

(http://shkelzenmaliqi.wordpress.com/2000/07/23/mbi-normalitetin)

6. Baskia e kullës së Dukagjinit

""BOTA SOT": Një e përditshme e Prishtinës, e quajtur "Zëri", para sa ditësh botoi një bisedë të gjatë në shumë e shumë vazhdime me Jusuf Karakushin. A mund të quhet ky tentim për rehabilitim të një ish-kryepolici të Kosovës?

Hysen GËRVALLA: Le të thonë Karakushat dhe kurrkushat e tyre sa të duan, le të bërtasin sa të mundën se "forcat progresive" "kanë bërë shumë ", por mos të harrojnë se opinioni i Kosovës e di mirë se ato "forca progresive" kanë krijuar hapësirë sot për t'i ladruar kuajt e vet, fatkeqësisht edhe të një Shkëlzen Maliqi, i cili, po të ishte normal, nuk do ta dhunonte që plot 13 vjet opinionin e gjorë me paraqitjet e tij të rezervuara në RTK-në e mjerë të Agim Zatriqit. Këta pinjoj të etërve gjakatarë do të duhej të skuqeshin para popullit të vet. Për ata që shohin me dy sy, Shteti i Pavarur i Kosovës, i inicuar para me se një dekade nga dr. Ibrahim Rugova, është i pashmangshëm. Ne emër të Zotit, nga varret do të ngriten të vrarët nga dora tradhtare dhe do të kërkojnë drejtësi. Vrasësit dhe shtisit e tyre i pret Ligji i drejtësisë se Shtetit të Kosovës, i pret edhe ligji i Kanunit, edhe përkundër vullnetit të Shkëizen Maliqit, bir i një satrapi të njohur. Sepse, ligji më i rëndë se të gjitha kodet është lënia e trashëgimtarëve ne bela të panevojë.

"BOTA SOT": Populli thotë: «Për pa gjak më vret kollaj, priti burrat masandej»!

Hysen GËRVALLA: Ne Gërvallajve nuk na ngutet. Vëllezërit tanë nuk u vranë për vadë uji, as për gur mexhe. Ata u vranë si bij të çështjes kombëtare. Ne presim ligjin e drejtësisë se shtetit të Kosovës. Sepse çështjen tonë nuk e vjetrojnë as dekadat as shekujt. Shumë herë gjatë shekujve jemi vrarë tinëzisht nga dora e tharë, por askush nuk na ka mbetur borxh. Po e them, për hatër të Shkëlzen Maliqit, se vrasja tradhtare që i përbiu djemtë tanë të paharrueshëm, nuk vjetrohet kurrë. Ajo mbetet amanet i varur në baski të kullës sonë në Dukagjin." (Intervistë e Hysen Gërvallës dhënë Jusuf Ferizit për 'Bota Sot' nga 10-16 mars 2003)

7. Kurrsesi kompromis me komunistët

Sabri Novosella: *"Porsi shteti amë, prapëseprapë njëra nga këto organizata bënte njëfarë dallimi. Kjo ishte LNÇKVSHJ, e cila udhëhiqej nga Metush Krasniqi, i cili ishte demokrat i vërtetë dhe mbi të* ***gjitha ideologjinë komuniste*** *e konsideronte si* ***ideologji ruse*** *dhe si të tillë edhe antishqiptare, ashtu siç i konsideronte antishqiptarë sllavogrekobizantinët në përgjithësi." (Zëri, 28 mars-4prill 1992)*

Sabri Novosella: "*E arsyeja ime, e cila në fakt ishte edhe qëndrimi i prerë i organizatës të cilës i takoja, e në veçanti i Metush Krasniqit, ishte se gjithsesi duhej krijuar një organizatë gjithëkombëtare në të cilën mund të militonin të gjithë shqiptarët atdhedashës e jo ndonjë parti Komuniste marksiste-leniniste."* (Intervistë dhënë Haqif Mulliqit e Emine Berishës për gazetën Zëri, e ribotuar në Drita, Trelleborg, Suedi më 1997.)

Sabri Novosella: *"Metush Krasniqi kishte një shpirt përbashkues. Ai bënte çmos për të krijuar unitet, bile mundohej që t'i afronte edhe komunistët që kishin rënë në konflikt me politikën e Titos për shkak të Stalinit. Posaçërisht ishte shumë i kujdesshëm me të rinjtë që binin viktimë të propagandës komuniste, që vinte nga regjimi i Enver Hoxhës.*

Mirëpo, ***kurrsesi*** *nuk gjente fuqi për të bërë* ***çfarëdo kompromisi me komunistët****, të cilët ishin në shërbim të okupatorëve serbo-komunistë. Në këtë pikëpamje, Metushi ishte tejet parimor dhe i palëkundur.*

Nga komunistët stalinisto–enveristë, të keqen kryesore e shihte se ata do të ndikonin në çorientimin e djalërisë kosovare, duke e keqpërdorur autoritetin e shtetit amë. Ndaj komunistëve stalinisto–enveristë të brezit të ri ndjente dhembshuri të madhe. Këta i konsideronte thjesht viktima të regjimit komunist të Enver Hoxhës." (Rezistenca kosovare mes dy zjarresh, Prishtinë 2010, f.68-69)

Sabri Novosella (Për diplomatët shqiptarë): "*Këta mua, personalisht, në mënyrë kontinuitive, më sillnin libra të Enver Hoxhës, që unë të gjeja mënyrë për t´i dërguar në Kosovë. Ata, thjeshtë e loznin lojën e tyre, por më duhet t´a pranojë se edhe unë e lozja lojën time. Unë të gjitha ato libra që m´i dhanë i futa në stufë dhe i dogja, që të mos u binin në duar të rinjve kosovarë, ngase prej tyre nuk fitohej asgjë e mirë, sepse atyre që u gjendeshin ato libra, dënoheshin me burg të rëndë dhe të gjatë, e madje edhe akuzoheshin si marksist-leninistë, kështu që, në vend që t´i shërbehej çështjes së Atdheut dhe kombit, në fakt krijoheshin kundërefekte."* (Intervistë në Zëri e ribotuar në Drita nr. 10/1997)

8. Qëllimet majtiste janë të kthjellëta si loti

"Bota sot: *Ju e thatë edhe më lart se pas vrasjes së Jusufit, Bardhoshit e Kadriut ka patur interpretime për personalitetin e Jusufit, është folur se ka qenë "marksist, komunist..." etj. Sa ju kanë lënduar juve si familje këto etiketime?*

Hysen Gërvalla*: Sigurisht se na kanë prekur. Jusufi kurrë nuk ka qenë në Lëvizje Popullore, kurrë nuk ka qenë komunist. Jusufin e ka edukuar nëna, familja, rrethi i tij në frymën kombëtare e jo ideologjike.*" (Bota Sot, 1dhjetor 2006)

Hysen Gërvalla: *"Dhe kur e panë se pak kush ishte i gatshëm të kacafytet me përbindëshat (Shqipëri e Enverit e Jugosllavi e Rankoviqit) që natën bashkëpunonin e ditën shaheshin, i përvolën mangët dhe u futen të gjallë në zjarrin që përvëlonte.*

Pasi dolën në Perëndim bënë përpjekjet e para për dialog kombëtar e njerëzor me "krerët" e OMLK-së dhe të grupimeve tjera që u përngjanin tufave të deleve, duke u përpjekur t'i ofrojnë mërgimtarët, t'i largojnë nga kursi ideologjik, në mënyrë që të viheshin të gjithë në binarë kombëtarë. Fatkeqësisht, gjithë këto përpjekje dështuan, sepse tufat e deleve që i kishte organizuar Enver Hoxha nëpër kruzhoqet partiake, ishin me tru të shpërlarë. Megjithatë, Jusufi e Bardhoshi nuk u ndalen. Dhe, deri në ditën kur u vranë nuk pushuan së insistuari për një pajtim të arsyeshëm e të qytetëruar....

...Gjatë takimeve të LNÇKVSHJ-së (Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës dhe Viseve Shqiptare në Jugosllavi, e udhëhequr nga Jusuf Gërvalla) me përfaqësues zyrtarë të Tiranës, doli hapur se diktatori Enver Hoxha nuk ishte i interesuar për forcimin e Lëvizjes Kombëtare, por për formimin dhe zgjerimin e organizatave komuniste në diasporë. Për këtë shkak dështojnë edhe bisedimet për bashkim në mes të Lëvizjes Kombëtare të Jusufit dhe OMLK-së se Hydajet Hysenit, që u mbajtën në Stamboll në tetor të vitit 1981." (Intervistë dhënë Jusuf Ferizit, Bota Sot, 10 mars 2003)

Hysen GËRVALLA: "*Qëllimet majtiste tani janë të kthjellëta si loti: ose do të ketë shtet siç mendon tradhtia, ose mos të formohet fare shteti i Kosovës."* (Bota Sot, 12 mars 2003)

9. Dje në amfiteatrin e Bibliotekës Kombëtare

Bota Sot: "Në amfiteatrin e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, dje u bë promovimi i veprës letrare dhe publicistike e Jusuf Gërvallës në katër vëllime. Ndërsa përveç bashkëshortes së poetit znj. Suzana Gërvallës, të pranishëm në poltronë e këtij takimi ishin edhe Nazmi Rrahmani, i cili bëri hapjen e promovimit, Sali Bashota, Rexhep Munishi dhe Kujtim Shala, të cilët ndanë me auditorin momente dhe analiza nga veprimtaria krijuese dhe jeta e dëshmorit Gërvalla. (wwww.botasot.info, 19 janar 2011)

* * *

(www.yllpress.com, 19 janar 2011)

Studiues, miq e bashkëpunëtorë të Jusuf Gërvallës janë bërë bashkë të martën në Bibliotekën Kombëtare Universitare të Kosovës në përurimin e kompletit të veprave të patriotit e poetit të shquar, i vrarë në janarin e 1982-s.

Një sërë aktivitetesh për nder të tij po organizohen në Kosovë, ndërkaq kompleti është botuar nga shtëpia botuese "Faik Konica" e mbështetur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Në këtë aktivitet promovues fjalët hyrëse i paraqitën shkrimtari dhe botuesi Nazmi Rrahmani, studiuesi i letërsisë Sali Bashota, etnomuzikologu Rexhep Munishi, studiuesi Kujtim Shala dhe krejt në fund, bashkëshortja e Jusufit Gërvallës, Suzana.

Në fjalën e tij, drejtuesi i shtëpisë botuese "Faik Konica", Nazmi Rrahmani, e paraqiti biobibliografinë e Jusuf Gërvallës, me theks të veçantë rëndësinë e botimit të këtij kompleti katërvëllimësh, ku janë përfshirë veprat e tij në poezi, prozë, dramë dhe publicistikë. ...

Suzana Gërvalla, bashkëshortja e veprimtarit dhe intelektualit Jusuf Gërvalla, e vlerësoi kontributin e shtëpisë botuese "Faik Konica" në botimin e kompletit të veprave. Gjithashtu, në fjalën e saj përmbyllëse theksoi se "në të ardhmen pritet botimi i shkrimeve nga studiues dhe kritikë letrarë për jetën dhe veprën e Jusuf Gërvallës ". (www.yllpress.com, 19 janar 2011)

10. Teksti më analitik dhe më gjithëpërfshirës

Shtëpia Botuese FAIK KONICA: "Tekstin e Sabri Hamitit *Vepra letrare e Jusuf Gërvallës*, botuar si parathënie e botimit *Vepra letrare*, Ora, Prishtinë 1992, e zgjodhëm ta vejmë në ballë të këtij botimi të Shtëpisë Botese Faik Konica – Prishtinë 2010, për shkak se është teksti më gjithëpërfshirës dhe më analitik i veprës letrare të Jusuf Gërvallës. Ai i përgjigjet më së miri kërkesës së botuesit, për t'i prirë me një tekst analizues dhe vlerësues këtij botimi, i cili është mbështetur, në radhë të parë, në botimin e përmendur, duke e plotësuar edhe me shkrimet e botuara ose edhe të pabotuara të Jusuf Gërvallës." (Jusuf Gërvalla, VEPRA, vëll. 1, Prishtinë 2010, faqe 30)

11. Kam pretendime

Donika Gërvalla: "Babai nuk ka **heshtur**. **Kam atë pretendim** që në Kosovë ka ardhur koha të mos **heshtet**. Të gjithë e dimë realitetin, të gjithë e dimë që për një deklaratë ose për 500 euro që dikush nuk i paguan haraç dikujt që vjen t'ia kërkoj mund të vritesh vet, mund të vriten pjesëtarët e familjes, mund të kidnapohen fëmijët. Prandaj për një realitet që ne e njofim mjaft mirë, kë presim që të vij dhe të na e ndryshoj?" (Kohavision, 18 maj 2012)

Donika Gërvalla: "Në anën tjetër ka mjaft persona që nga atentati i 17 janarit 1982 përpiqen të fitojnë kapital politik." (17 janar 2010, http://gervallablog.com)

12. Fituesja e Medaljes

"Presidenti i Republikës, Bujar Nishani i akordoi zonjës Donika Gërvalla-Schwarz "Medaljen e Mirënjohjes" me motivacionin: *"Për vetëmohimin e treguar në pjesëmarrjen në grevën heroike të urisë në Qytetin Studenti në shkurt 1991, vendimtare në përmbysjen e sistemit diktatorial komunist"."* (Presidenti Nishani dekoron zonjën Donika Gërvalla-Schwarz me "Medaljen e Mirënjohjes", http://president.al, 20 shkurt 2013)

*

* *

1. DISA FAQE NGA DITARI

E diel, 30 dhjetor, 1979
ora 00.45 Ludwigsburg

Pardje dy javë, më 14 dhjetor, natën vonë e braktisa Prishtinën dhe Kosovën.

Aty nga ora 16, erdhën në "Rilindje" Suzana me Kadri Rexhën dhe më prunë lajme të hidhura.

Atë ditë heret në mëngjes, e paskëshin burgosur Hysenin; i kishin gjetur materiale të shtypura të Lëvizjes. Dina, i cili e kishte sjellë lajmin për Hysenin, i gjen punëtorët e SPB-së duke ma bastisur banesën.

Unë, me Suzanën e me Kadriun, hymë në bufe të "Rilindjes" sa për të pirë nga një kafe, që ta merrja pak veten nga pesha e hidhur e lajmeve, kur në bufe hynë dy nga punëtorët e SPB-së, që kishin bërë tek unë bastisjen (me dy të tjerë). Kërkonin prej meje makinën tjetër të shkrimit, atë të punës (makinën ilegale e kishin gjetur). Atë makinë e kisha në banesë të Muhamet Tërnavës, e Muhameti ishte zyrtarisht në Gjermani. Pasi nuk

e gjetëm të vëllain, që të na e çelte derën e banesës, inspektorët e SPB-së shkuan dhe e morën një mjeshtër, e çelën derën me dhunë, e morën çantën, dhe ata i vunë derës dry të ri, e çelësat m'i dhanë mua.

Pastaj më çuan deri në banesë, ku i gjeta Bacën Mujë, Idrizin, Ferizin e Ramizin. Këta ndenjën sa ndenjën, e u çuan.

Unë e ndala dritën dhe ndenjëm ashtu në terr me Suzanën për ndonja një orë, duke u shtirë se po flemë (për ata që do të kenë përgjuar eventualisht përjashta). Më vonë u përshëndeta me Suzanën, duke i treguar se ndoshta shokët do të më këshillojnë të arratisem.

Ajo u pajtua, pa fjalë, dhe unë ika, duke i lënë fëmijët në gjumë.

Shoku i Lëvizjes, Bashkim Prishtina, qe i mendimit se është shumë më mirë të arratisem, se sa të bie në burg: edhe dënimi do të kish qenë i rëndë, edhe do të rrezikohej eventualisht organizata.

Kah ora dy pas mesnate, tashmë ditë e shtunë, i trokita në derë Skënder Blakajt. Me veturën e tij shkuam në Pejë, e morëm Salih Kastratin, dhe u nisëm për Jesenice, në kufirin jugosllavo-austriak. Rrugës kaluam mirë. Ata më lanë në oborr të Bacit Haxhi, kështu ishim marrë vesh dhe shkuan.

Unë isha pa pasaportë me pak të holla të xhep. Qëllimi ish që nga Jesenica të kontaktoja me Bardhin, që të vinte e të më merrte me vete. Por bllokun me numra telefonash e me adresa ia kisha lënë Suzanës, që ta bënte Bardhin me dije që të mos vinte në Jugosllavi, se ishte rrezik edhe për te, e kur pata dalë shtëpie s'më kishte shkuar mendja që do të ikja për në Gjermani (mendoja se do të ketë mundësi për Shqipëri).

Në Jesenicë më ra të qëndroj prej të shtunes mbrëma deri të enjten në mëngjes. Bacit Haxhi ia tregova çështjen të marten dhe atë të martë dola prej banesës së tij dhe zura vend në një bujtinë, në Zhirovnicë.

Bardhi s'kishte sjellë me vete ndonjë dokument të vyer për mua, mirëpo, me ardhjen e tij, unë u çlirova shumë. Para dreke bëmë ca plane, më në fund vendosëm që bërë Austri të ikja më këmbë, nëpër tunelin që shpie nga Hrushica (4-5 km larg Jesenice) deri në Rozenbah të Austrisë.

Në orën 17,30 u ndalëm me veturë në rrugën automobilistike të Hrushicës, 30-40 km nga tuneli. U nisa. Bardhin e porosita që po s'iu ktheva për 10 minuta, të nisej edhe ai me veturë për në Austri, nëpër kalesën kufitare në Podkoren të Kranjska Gorës. Afër hyrjes në tunel, pasi përgjova mirë e s'diktova njeri ndër oborret e ndër shtëpitë pranë, m'u ndërsye një qen. Ia lëshova dritën e baterisë së dorës dhe hyra me vrap në tunel.

Tunelin, 8100 m, e kalova, së paku 70% të gjatësisë, me vrap. Ishte aksioni im i parë në jetë në të cilin kisha hyrë me rrezik 100% që ose të shpëtoj, ose të bie në burg, ose, madje, edhe të vritem.

Pas guximit nistar, me të cilin i hyra rrezikut, zemra m'u bë zog dhe një frikë e papërjetuar kurrë ma kaploi të tërë qenien. Kurrë s'e kam marrë me mend që mund të jem aq i lig. Po ja që rrugën e kalova (sa isha unë duke ikur, nëpër tunel kaluan tre trena - elektrikë, për fat) dhe ia dola qëllimit.

Bardhin, sipas marrëveshjes, e prita te ura e parë e hekurudhës që pritej me rrugën automobilistike, 20-30 km nga dalja e tunelit. Fshati i parë që shihej nga ai vend në mal, ishte nja 500 m më poshtë. Prita afro një, një orë e gjysmë, kot. Atëherë iu drejtova me frengjishten time të mjerë të zotit të veturës së parë që kaloi atypari në një si depo-uzinë. Ai s'e dinte frengjishten, por për fat fliste sllovenisht gati më mirë se unë. Ai me çoi me veturë deri në Rosenbach (tetë km) ku u takuam me Bardhin, që ishte nisur kah vendi tek e prisja unë.

Gëzimi ynë s'pati kufi.

Bardhi ishte frikësuar shumë. Sa kish qenë duke ndenjur te vetura, matan kufirit në Hrushicë, pos të lehurave të qenit, kishte dëgjuar edhe një të shtënë dhe kishte parë të qarkullonte po në atë çast me shpejtësi automobilin e policisë jugosllave.

Doganierëve në kufirin austro-gjerman, Bardhi ua tregoi pasaportin e vet dhe një pasaportë të vjetër të një turku, ndërsa unë shtiresha se po fle në selinë e mbrame të automobilit.

Në Ludwigsburg, në banesë të Bardhit, arritëm nga ora katër e mëngjesit, ditën e premte, më 21 dhjetor, plot një javë pas arratisjes sime.

P.S. Në ç'gjendje të shthurur shpirtërore jam tërë kohën, mund të shihet edhe nga përmbajtja dhe kaligrafia e këtij shkrimi.

Po arsyetohem, duke thënë se nuk është çudi. Jam shkëputur nga toka që më lindi e më ushqeu më se 34 vjet. Kurrë s'i kam pasur në hatër largimet nga vendlindja, as për shëtitje të shkurtra, madje, se si po më vjen sikur jam shkëputur nga pjesa më e fuqishme e vetvetes. Pas shpine lash qindra e qindra të burgosur politikë, që po bien sakrificë për çështjen e atdheut, në mes tyre Hysenin dhe Ekremin; lash gruan me tre fëmijë dhe gruan e Hysenit me shtatë fëmijë. Një shthurje e madhe e vendlindjes dhe e familjes njëherazi. Edhe për Bardhin morëm vesh që në konsullatin jugosllav qenka në sy si armik i Jugosllavisë, prandaj në këtë çast po e zë të arratisur edhe atë.

Por me gjithë ndjenjën e zbraztësisë së madhe si pasojë e kësaj shthurjeje të madhe, shpresa për shpëtimin e atdheut po më mban gjallë. Pas të gjitha gjasëve, Kosova ime po hy në një rrezik të madh, por pikërisht duke hyrë në këtë rrezik do ta gjej edhe shpëtimin**. Jetën po e jetoj falas, deri sa të më jepet rasti (nderi) që ta jap për Kosovën, për Shqipërinë, për Shqiptarizmën.**

Po Shqipëria nënë, ç'thotë ajo vallë sot?

A e ka ndër mend dhe a ka kushte për t'i hyrë kryerjes së detyrës, e cila po e pret qëmoti?

Armiku ynë e humbi torruan, u nevrikos, e hoqi maskën! Kështu, me nervozizëm, do t'ia haj një ditë kokën vetes, në rrugën e degjenerimit të vet. Së paku do të mbetet pa Kosovën dhe pa shqiptarët!

E diel, 13 janar, 1980
Ludwigsburg
ora 21,00

Rrudhat në ballin tim, mënyra si përpiqen ato, sa kam qenë në vendlindje kanë pasur domethënie. Për gruan time, ato kanë qenë shenja të njeriut të stërmunduar po të paepur, i cili e meriton dashurinë e saj. Për fëmijët, ato rrudha kanë qenë udhëkryqe, tek ka ndenjur pezull gjithë enigma e dashurisë dhe ashpërsisë, që kanë pasur peshë të caktuar në jetën e tyre, në edukatën e tyre.

Rrudhat mbi ballin tim, për mikun e vendlindjes, për aq sa kam pasur indikacione 34 vjet të jetës sime, kanë shprehur qartë pamundësinë për të fshehur ndjenjën e fuqishme të brengës për fatin e atdheut të robëruar; ato kanë treguar se janë dyer kurdoherë të hapura kah shpirti, për të gjithë ata që kanë halle të ngjashme.

Këtu në dhe të huaj, pushon së ekzistuari çdo domethënie e rrudhave të mia, e pulseve të mia të brendshme; në rrugë, në gazetë; në TV, ato "konsumohen" këtu siç "konsumohet" një langë automobili, një mbishkrim, një reklamë e margarinës, e sodës së teshave.

Megjithatë, sado që në fytyrën time nuk reflektohen më ato impulset e fuqishme të dashurisë e të urrejtjes, nganjëherë më ka rënë të kap vetëtimthi nga një dritë gati-gati identike me atë të dikurshmen, të njeriut në shtëpinë e vet; prapëseprapë, vazhdimisht ndjenjat e mia, gjithë qenia ime sikur janë kyçur fortë; gjithë damarët sikur janë vënë me shtresa të forta e të ftohta lëndësh të panjohura, që po ua zënë frymën gjithë ndjesive të mia, duke i vënë fre vitalitetit në mua.

Më bëhet dendur se nga jeta njëdimensionale e të kolonizuarit në vendlindje, kam kaluar rrëmbimthi në një jetë më pak se një dimensionale të të arratisurit, që nganjëherë nuk do të donte më shumë se perspektivën e vdekjes në vendlindje së paku.

E hënë, 14 janar, ora 00,45 (Ludwigsburg)

Sot do të paraqitem me kërkesë për azil politik në policinë e Ludwigsburgut.

Qëkur erdha këtu, në saje të gjeturisë së Bardhit dhe të gjermanishtes së tij të shkathët, arritëm të kryejmë disa punë:

1) Për burgosjet masive politike të shqiptarëve nga ana e Jugosllavisë, e bëmë me dije organizatën e Amnistisë Internacionale, e cila premton se do të angazhohet, pas mundësive të veta, për lirimin e atdhedashësve tanë, eventualisht për pakësimin e torturave që ushtron përmbi ta policia fashiste jugosllave;

2) Sipas porosisë së revistës gjermane "Shpigël", prapë në saje të Bardhit, shkrova një material 13 faqesh, që ka pikënisje burgosjet aktuale në Kosovë, por shtrihet më thellë në historinë e shqiptarëve. Materiali mban titullin: "Përpjekje për të korrur edhe një brez intelektualësh", apo përafërsisht kështu. Presim që ky material, ose ndonjë tjetër i hartuar në bazë të lëndës që ofron ai, të botohet në numrin e ri të "Shpiglit", i cili del sot.

Gjatë kësaj kohe Suzana më bëri telefon 3-4 herë nga Prishtina. Ajo thotë se Hysenin, sipas fjalëve të Hedijes, e cila e ka parë në burg, nuk e paskan torturuar.

Suzana paska vështirësi në rregullimin e dokumenteve për udhëtim, me të cilat do të vinte këtu bashkë me fëmijët. Para disa ditësh e paskan ftuar në polici, në Prishtinë, i paskan thënë të mos shpresoj se e lëshojnë të vijë tek unë, dhe e paskan këshilluar të më bindë të kthehem edhe unë atje, me "garancë" se gjoja s'paskan për të më dënuar më shumë se dy vjet. Natyrisht, kjo është punë që s'bëhet.

Lajmet e fundit nga Kosova, përmes njerëzve që po vijnë së andejmi, thonë që burgosjet po vazhdojnë ende dhe se numri i të burgosurve ka arritur deri në 2000 vetë.

Kah fundi i kësaj jave pres të vij këtu nga Londra përfaqësuesja e Amnistisë Internacionale, me kërkesën e saj, bërë me telefon. Me mua dhe me disa shqiptarë të tjerë do që të bisedojë më për së afërmi lidhur me burgosjet politike në Kosovë.

Duhet shqyrtuar mundësia që gruan me fëmijë t'i sjellë këtu ilegalisht nga Prishtina.

2. INTERVISTË - REGJIMI TITIST EKSPERIMENTONTE DISKRIMINIMIN NË KOSOVË

Më 1946 Jugosllavia e ndaloi përdorimin e flamurit shqiptar në emër të "internacionalizmit proletar". Më 1968 në Kosovë pati trazira studentore të cilat vërtetë kanë arritur ca suksese

Gazeta alternativa politike e Berlinit "Tagishe Cajtung" më 20 janar 1982 në gjithë faqen e saj të shtatë botonte lajmin për vrasjen e Jusuf e Bardhosh Gërvallës e Kadri Zekës dhe një intervistë me Jusuf Gërvallën që kjo gazetë e kishte bërë dy vjet më parë, por që nuk e kishte botuar deri më këtë datë. Në tekstin hyrës të intervistës redaktori i gazetës "Tagishe Cajtung" ndër të tjera shkruan:

Regjimi me dorë të gjatë...

"Jusuf Gërvalla bashkë me të vëllan ishin anëtar të Lëvizjes Çlirimtare të Kosovës. Ai erdhi në fillim të vitit 1980 në redaksinë e gazetës sonë në Shtutgart me qëllim që të na informonte për Lëvizjen Shqiptare për Pavarësi në Kosovë. Jusuf Gërvalla ishte arratisur nga mesi i dhjetorit 1979 nga Kosova. Vëllai i tij, Bardhoshi, jetonte në Republikën Federale Gjermane qysh nga viti 1974. Ai punonte si punëtor social në Arbeiter Wohlfart në Ludvigsburg. Pasi Jusufi nuk e dinte fare gjermanishten përktheu vëllai i tij. Ne bëmë një intervistë prej katër orësh ku ata me durim na e shpjeguan gjendjen në Kosovë. Ata e dinin se regjimi jugosllav ka dorë të gjatë, prandaj pyetën nëse "Tagishe Cajtung" është gazetë e pavarur që nuk ia varë asaj dore të zgjatur. Pastaj, Jusuf Gërvalla na foli për biografinë e tij. Ai e paraqiti veten si letrar, i cili ka qenë i punësuar në një gazetë shqipe në Jugosllavi. Ai ka botuar tri vëllime me poezi dhe ka bërë përkthime të shumta nga gjuha serbokroate në gjuhën shqipe. Sipas të dhënave të tij ai ka qenë i aktivizuar që prej pesë vjetësh në Lëvizjen Çlirimtare në Kosovë. Ai qe arratisur gjatë një fushate të burgosjeve në këtë rajon. Vëllai i tij ishte arrestuar në Pejë më 15 dhjetor 1979 për shkak të "veprimtarisë kundërpopullore". Banesa e Jusufit në Prishtinë në të njejtën kohë u bastis në mungesë të tij.

Ai thoshte se shërbimi sekret jugosllav gjatë viteve të kaluara e kishte marrë disa herë në pyetje duke provuar ta detyronte për bashkëpunim. Jusuf Gërvalla arratiset në Gjermani dhe paraqet kërkesën për azil. Ndërkohë janë shpeshtuar arrestimet në Kosovë. Jusufi fliste për një shifër prej 2000 të burgosurish që ne na dukej atëherë e pabesueshme për çka ndërkohë është vërtetuar. Në këta dy vjet gjendja në Kosovë është ashpërsuar shumë. Janë bërë burgosje masive, është vendosur gjendja e jashtëzakonshme. Gjatë kësaj kohe Bardhosh Gërvalla kishte shkuar në qendrën sociale në Shtutgart për ta lutur atë që të lajmërojnë për një demonstratë solidarizuese pranë Entit për Rendin Publik. Bardhosh Gërvalla e ndjente veten gjithnjë të përndjekur nga Shërbimi sekret jugosllav. Gjatë demonstratës, sidomos kah dritaret e konsullatës jugosllave u bënë me zell fotografi. Por edhe në rrugë nga shumë janë parë shumë fotograf duke fotografuar. Kur demonstruesit provuan t'ua nxirrnin filmat nga aparatet fotografëve, ndodhën zënka dhe arrestime nga ana e policisë. Edhe Bardhosh Gërvalla ishte njëri nga të arrestuarit. Jusuf Gërvalla dhe vëllai i tij e vlerësonin gjendjen e popullsisë shqiptare në Jugosllavi si gjendjen e një popullit të mjeruar i cili lufton për liri si popujt e tjerë të botës. Ai donte ta njoftonte opinionin në Republikën Federale Gjermane për këtë luftë. Ai bashkë me të vëllanë dhe të njohurin e tij janë vrarë. Çdo gjë flet se këtë vrasje do ta ketë bërë Shërbimi Sekret Jugosllav, thuhej në këtë hyrje të këtij artikulli, të emituar mbrëmë në radion "Dojçe Vele", ku në vazhdim të tij jepet edhe një intervistë e gjatë e botuar më 20 janar 1982 në gazetën alternative politike "D. Cajtung".

** Ju keni bashkëpunuar me një organizatë ilegale të "minoritetit shqiptar" në Jugosllavi, në Lëvizjen Çlirimtare. Si paraqitet puna e kësaj organizate përgjithësisht?*

Jusuf Gërvalla: - Lufta ka disa faza. Fillimisht kemi të bëjmë me njohjen e historisë sonë dhe me njohjen e së vërtetës. Hapi tjetër është që këto njohuri t'i përhapim në popull. Kjo është faza e iluminizmit përmes trakteve, gazetave, parullave e në mënyra të tjera. Në fazën e dytë. shumëçka mvaret nga relacionet në botë, në Evropë dhe në vend. Faza e dytë përmban luftën e armatosur. Siç duket kalimi në te po përshpejtohet për shkak të terrorit të sforcuar jugosllav mbi popullin shqiptar. Por në këtë moment ende nuk jemi të përgatitur për këtë.

** Çfarë mbështetje ka kjo lëvizje tek "pakica shqiptare"?*

Jusuf Gërvalla: Është shumë vështirë të jepen shifra konkrete. Por, mund të thuhet se shumica e popullit shqiptar qëndron pas qëllimeve të kësaj lëvizjeje por askush nuk deklarohet hapur pasi ka frikë nga pasojat.

** Si është e ndërtuar kjo lëvizje në aspektin organizativ?*

Jusuf Gërvalla: - Kjo lëvizje ka bazat e veta kudo ku jetojnë shqiptarët brenda kufijve politik të Jugosllavisë. Ajo përbëhet nga një Komitet Qendror prej pesë vetësh. Pastaj janë komitetet e rretheve të cilat dërgojnë përfaqësuesit në Komitetin Qendror. Bazat janë celulat që përbëhen nga tra anëtarë dhe që punojnë në mënyrë konspirative.

Kosova vend i pasur që e eksploaton Serbia

** Si paraqitet politika e Beogradit, përkatësisht në hapësirën e rajonit autonom të Kosovës dhe çfarë ndikimi ka ajo në politikën gjyqësore e kulturore?*

Jusuf Gërvalla: Diskriminimi kombëtar bëhet në shumë aspekte. Më 1946 Jugosllavia e ndaloi përdorimin e flamurit shqiptar në emër të "internacionalizmit proletar". Një vit më vonë, përkatësisht në vitin 1947 u mor vendimi për dorëzimin e tepricës së drithërave në emër të njëfarë solidariteti. Kështu që vetë shqiptarët e detyruan të jetojnë edhe pa bukë gjatë atij viti. Disa vjet më vonë u bë kolektivizimi bujqësor, eksperiment ky që është bërë vetëm në Kosovë. Qëllimi ishte që tokat e shqiptarëve të përzihen me ato të serbëve. Në vitin 1956 derisa Rankoviqi ishte akoma në pushtet, vetëm në Kosovë u bë një aksion për mbledhjen e armëve. Me këtë rast shumë burra shqiptarë u burgosën dhe u torturuan. Kjo ka ndodhur atëherë gjatë dimrit. Thuajse gjithë natën i kanë detyruar të qëndrojnë në kanale me ujë ose të lidhur lakuriq pas trungjeve të pemëve. Për sa i përket politikës ekonomike, Kosova është një vend shumë i pasur, përsa i përket bujqësisë edhe pasurisë me xehe. Në popull flitet për një Kaliforni të dytë. Kosova përmban 64 për qind të të gjitha rezervave të nikelit e kromit, 65 për qind të rezervave të zinkut dhe plumbit, 28 për qind të rezervave të magnezit. Të gjitha këto të dhëna janë publikuar në gazetat jugosllave. Përkundër kësaj në Kosovë nuk ekziston industria përpunuese. Të gjitha produktet nga këto përsëri i shiten Kosovës më përfitime të shumëfishta.

Dy emigracione të Kosovës

** Kjo do të thotë se Kosova është më e prapambetura në krahasim me mesataren e Jugosllavisë?*

Jusuf Gërvalla: Po. Kjo mund të dëshmohet edhe me të ardhurat mesatare bruto për frymë. Të ardhurat e një banori të Kosovës në vitin 1953 kanë qenë 43 për qind më të vogla se sa të një banori të Sllovenisë, republikës më të zhvilluar në Jugosllavi. Njëzet vjet më vonë, në vitin 1977, ato ranë në 37 për qind. Edhe pse Kosova është furnizuese kryesore me energji elektrike, 250 fshatra nga 1300 sa ka gjithsej Kosova, janë ende të

paelektrifikuara. Që, thënë shkurtimisht, zhvillimi dhe funksionimi i Kosovës është i orientuar për furnizimin e Jugosllavisë. Ky diskriminim i madh ekonomik ka për pasojë papunësinë e madhe. Sipas të dhënave të pranuara zyrtarisht, papunësia në Kosovë është mbi 20 për qind. Kjo ka për rrjedhojë emigrimin e brendshëm dhe emigrimin e jashtëm. Emigracioni i brendshëm do të thotë brenda Jugosllavisë, kurse ai i jashtëm në shtetet evropiane. Midis viteve 1968-1978, p.sh. gjysma e popullsisë fshatare u detyrua të emigrojë.

** Po në planin gjuhësor dhe kulturor si duket politika e Beogradit?*

Jusuf Gërvalla: Fillimisht ka pasur diskriminim përmes injorimit të historisë kombëtare. Shqiptarët janë pasardhës të ilirëve dhe janë populli më i vjetër i Ballkanit. Deri në vitin 1968 shqiptarët kanë qenë të detyruar ta mësojnë historinë sllave, gjë që do të thotë historinë e dinastive të ndryshme serbe. Historinë tonë nuk guxonim ta mësonim. Pas Luftës së Dytë Botërore, aty-këtu u formuan shkollat ku mund të mësohej gjuha shqipe. Përmes presionit të intelektualëve dhe politikanëve shqiptarë numri i atyre shkollave u shtua, kështuq u bë shkollimi masiv në gjuhën shqipe. Por, ata njerëz më vonë u dënuan me shumë vjet burg. Fillimisht u formuan vetëm shkollat fillore, më vonë edhe shkollat e mesme. Në vitin 1965 pranë Universitetit të Beogradit u hap Fakulteti i Albanologjisë. Ndërsa më 1968 në Kosovë pati trazira studentore të cilat vërtetë kanë arritur ca suksese. Kështu që atëherë gjuha shqipe u njoh si gjuhë zyrtare në Prishtinë dhe u themelua Universiteti në gjuhën shqipe. Përdorimi i gjuhës amtare nuk ka qenë i lejuar dhe aty kanë qenë të punësuar kryesisht serbët. Tani rajoni zyrtarisht është dy gjuhësh: serbisht dhe shqip. Madje është përcaktuar me ligj që ndokush që nuk e di gjuhën shqipe nuk mund të punësohej fare, por në praktikë thuajse askush nuk i përmbahet këtij ligji.

MASAKRI ME QËLLIM TË ASIMILIMIT

** Por cili është qëllimi i Lëvizjes Çlirimtare?*

Jusuf Gërvalla: Qëllimi jo vetëm i Lëvizjes Çlirimtare por edhe i të gjitha forcave përparimtare është shkëputje nga Jugosllavia dhe bashkimi me Shqipërinë amë.

** A arsyetohet kjo vetëm me përkatësi nacionale apo ka edhe aspekte shoqërore e politike. A do të kërkonit ju bashkimin pavarësisht se në Shqipëri mbretëron sistemi radikal komunist, radikal demokratik ose një sistem i së drejtës?*

Jusuf Gërvalla: Pamvarësisht nga çfarëdo sistemi.

** Një bashkim i tillë i këtyre hapësirave Shqipërisë natyrisht se mund të vlerësohet hegjemonizëm shqiptar. Të paktën në disa pjesë të kësaj hapësire, shqiptarët janë pakicë dhe ta zëmë në Greqinë Veriore nuk ka lëvizje nacionaliste si në Jugosllavi?*

Jusuf Gërvalla: Në këtë supozim fshihet një thelb i vërtetë. Në Greqi p. sh. u arrit të asimilohet një shumicë e madhe e shqiptarëve. Në Maqedoninë Perëndimore popullsia e fshatrave është krejtësisht shqiptare, kurse qytetet kanë arritur t'i sllavizojnë. Edhe në Serbinë Jugore brenda 100 vjetëve serbët kanë arritur përmes terrorit dhe masakrave të dëbojnë shqiptarët drejt Jugut. Ndonëse pjesa më e madhe në ato hapësira janë shqiptarë, brenda popullsisë shqiptare një numër i vogël i shqiptarëve është asimiluar.

** Lëvizja Çlirimtare po lufton për bashkim me Shqipërinë. A ka lidhje ajo me Shqipërinë?*

Jusuf Gërvalla: Një përgjigje e kësaj pyetjeje do të ishte e dëmshme për interesat e Lëvizjes.

** E çfarë dallimi ka bashkimi me Shqipërinë me një statut autonomie i cili ua mundëson lirinë e plotë në aspektin ekonomik, kulturor e gjuhësor?*

Jusuf Gërvalla: Një statut autonomie për ne është në dobi vetëm përderisa të forcohemi për të imponuar bashkimin. Ndonjë alternativë përveç bashkimit nuk ekziston.

** Si po reagon shteti jugosllav ndaj rezistencës përbrenda pakicës shqiptare?*

Jusuf Gërvalla: Nga viti 1945 janë ndaluar 47 organizata shqiptare. Pjesëtarët e tyre kanë përfunduar në burgje. Këtu nuk janë bashkënumëruar burgosjet e fundit masive. Këto burgosje të fundit tregojnë nervozizmin e Jugosllavisë ndaj një sulmi të mundshëm të Bashkimit Sovjetik. Burgosje kaq të mëdha nuk ka pasur ndonjëherë. Këto janë duke u bërë vetëm në hapësirat shqiptare dhe tregojnë gjithashtu se Jugosllavia në këtë situatë kritike po vetëdijësohet për fundin e erës së Titos dhe se problemi shqiptar akoma nuk është zgjidhur.

** Atëherë këto burgosje masive me sa duket duhet të kuptohen si rrjedhojë e arsyeve të politikës së jashtme dhe jo për shkak të forcimit të lëvizjes për rezistencë të "pakicës shqiptare" kohëve të fundit?*

Të dy komponentët janë të përzier. Ju përkujtoj 47 organizata të ndaluara. Një lëvizje e rezistencës çdoherë ka qenë e pranishme. Por, në situatën e tashme është e menduar se aktivitetet e saj dhe ndjeshmëria shtetërore ndaj tyre janë rritur. Por, aktivitetet gjithsesi nuk i kanë ato përmasa sa Jugosllavia do të detyrohet të ndërmarrë këto masa.

** Qysh dhe ku janë duke u bërë burgosje masive dhe sa njerëz janë të goditur nga këto?*

Jusuf Gërvalla: Nga pranvera e vitit 1978 kur unë u arratisa në mes të dhjetorit të vitit 1979 kisha një të dhënë të saktë për 750 të burgosur në mes të të cilëve ishin edhe 73 femra. Tani po kthehen punëtorët emigrantë dhe po na sjellin informata të reja sipas të cilave numri i të burgosurve ka arritur në 2000 vetë.

** Cilat shtresa të popullsisë janë më shumë të goditura dhe çfarë akuzash konkrete u bëhen atyre?*

Jusuf Gërvalla: Kryesisht të rinjtë. Ndër ta kryesisht studentët e intelektualët, por edhe punëtorë e fshatarë. Fajësimi përmban veprimtari politike "kundër qeverisë" dhe "veprimtari armiqësore kundër popullit".

** A keni përshtypjen se burgosjet po bëhen sipas parimit të rastësisë apo në bazë të të dhënave e informatave konkrete?*

Jusuf Gërvalla: Pjesa më e madhe nuk kanë të bëjnë aspak me këto fajësime. Po bëhen përpjekje për ta zbuluar Lëvizjen e Rezistencës. Por, kësaj nuk ia kanë arritur akoma. Përvoja nga shumë organizata të ndaluara ia mundësoj Lëvizjes Çlirimtare të veproj në mënyrë konspirative dhe me sukses. Organet jugosllave të sigurimit po gjuajnë në errësirë dhe shpesh po kapin kuturu pjesëtarë të shqiptarëve, patë thënë atëherë në këtë intervistë patrioti i paepur dhe intelektuali i shquar shqiptar, Jusuf Gërvalla, e cila intervistë u botua në gazetën e lartpërmendur gjermane, të cilën mbrëmë e emetoi emisioni shqip i radios "Dojçe Vele".

(Përgatiti: Shefki Ukaj; Rilindja, 17 janar 1997)

3. Letër e hapur satrapit J. B. Tito
Njeriu ka një të metë: ai di të mendojë!
(dordolecët dhe udbashët)

Në të kaluarën tonë historike, para çdo vizite të sulltanëve në Shqipëri, thonë se nga Kryeqendra e Perandorisë çonin dofarë dordolecësh që e neverisnin dhe e shqetësonin popullin me të panjohurën që sillnin me vete. Pas tyre, bashkë me sulltanët, vinin edhe poetë kopukë, që kishin për detyrë ta madhëronin me këngë lavdinë e perandorëve. Në fund arrinte lartmadhëria e tij, sulltani, "fuqia e allahut në tokë", i cili, duke pasur "mall të madh për shqiptarët", s'e bënte as gjumin gjumë.

Nga ata që dilnin për ta pritur disa përuleshin sa më poshtë, se atje, në uljen dhe poshtërimin sa më të madh, gjendej thesari që u duhej atyre në këtë botë; të tjerë, si të shpëlarë trush, bënin sehir duke u hamendur në është ati I sulltanit kalë apo pelë; të tretët, duke pasur punë shumë më të urta në rrethanat e jetës skëterrë në robëri, mezi prisnin të kryhej formaliteti i pritjes dhe pa e vrarë fare mendjen pse ishte kështu kjo e ashtu ajo punë, ktheheshin tek fëmijët, tek gratë e veta, tek plangjet e veta, te puna e vet e krahut. Ishte ndërmjet tyre një palë njerëz kokëturrjelë, të cilëve, thonë, hija e sulltanit mbi tokat e tyre ua shëmtonte ditën, se ia dinin gjithë marifetet atij, sulltanit, hijes së pejgamerit në tokë dhe kopukëve të tij që e prisnin me lepe-peqe, ia dinin të gjitha, edhe avazin këngës së poetëve kopukë. Prandaj, sa herë që vinte sulltani në trojet e tyre, ata seç bluanin plane të turbullta, sikundër ishin mësuar të mendonin edhe kur sulltani gjendej në selinë e vet të shenjtë, se ndryshe nuk dinin të mendonin kurrë.

Kish ilaç sulltani edhe për këta: litarin, burgun ose arratinë. Se ishin rebelë dhe rebelët i kishte rëndë toka e Perandorisë.

Në të sotmen e pjesës së robëruar të Shqipërisë, në Kosovë, vizitave të sulltanit Tito u prijnë agjentët dhe xhandarët e UDB-së, dukja e të cilëve është diçka më konkrete se ajo e dordolecëve, si në kohë kolendrash apo në kohë bajrami. Xhandarët hyjnë me rrëmbim shtëpi më shtëpi të shqiptarit, tym për tym marrin nga një mashkull (mundësisht më të mirët) dhe i bëjnë tok krye për krye në burgjet e Kosovës; e kur në këto burgje nuk mbetet vend, atëherë i mbyllin edhe nëpër bodrume të përshtatshme, duke ua lënë rojen përmbi kokë. Por, nëqoftëse as kjo nuk ka bërë punë për shuarjen e rebelimit të shqiptarëve, atëherë Titoja, si munxadhënësit e dikurshëm të perandorisë turke, nga Beogradi (selia e shenjtë e perandorisë jugosllave) kthehet me fytyrë nga Kosova, i drejton andej duart dhe ua përcjell shqiptarëve munxën: frikë sa më shumë për shqiptarët, mallkim të tmerrshëm për ta, o Zot! (O Karter! O Brezhnjev!) Atëherë, sa çel e mëshel sytë, burgjet jugosllave mbushen me vajza e djem të popullit, të cilët s'e kanë fort për lale t'i shtrohen robërisë pa e qitur së paku atë fuqi që kanë.

Ky rit mistik, ky maskenball i pashembullt u përsërit edhe në nëntorin e vitit të kaluar në Kosovë.

Pa paralajmërimet e zakonshme pas të cilave Kosova përgatitet gjatë e gjatë, duke bërë mure dërrasash që ta fshehin realitetin për festën e pritjes së sulltanit Tito, ky bajloz i zi kësaj rradhe doli papritmas nga errësira dhe u sul mbi këtë pjesë të robëruar të Shqipërisë që revizionizmi jugosllav e ka dërmuar tej mase në planin ekonomik, social, kulturor...

Kumbuan daullet, që bien në Beograd e të shurdhojnë në Kosovë. Në faqet e "Rilindjes", Radio Prishtinës dhe të Televizionit të Prishtinës, ato sillnin breshër: "Rrofsh sa malet shoku Tito - e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja jonë"!

Dhe nuk na lëshoi toka nga kjo hata. (E kaluara jonë sikur filloka në vitet dyzet të këtij shekulli, e jo më se para tremijë vjetësh!) Është bërë imune Kosova ndaj kësaj fatkeqësie, që po tërbohet me dekada si një rrebesh i fëlliqur, por s'po na shfaros dot.

U turrën dordolecët e UDB-së shtëpi për shtëpi dhe morën me vete (së paku) nga një mashkull, për t'ua kthyer sigurinë dhe rehatinë rrugëve nga duhej të parakalonte sulltani.

Populli shqiptar i Kosovës: fëmijë të rritur (bërrr, të ngjethet lëkura), nxënës, studentë, nëpunës, punëtorë, fshatarë, me një inercion e neveri të papërshkrueshme, lejuan kësaj radhe t'i organizojnë me dhunë për pritjen që u desh t'i bëhet satrapit Tito.

E atje, në rrugë, në "festën e pritjes", në "pritjen madhështore", ç'të shohësh:

Ndërmjet rreshtave të pafundmë të njerëzisë së nxjerr me dhunë në rrugë, ku për çdo njeri UDB-ja kishte siguruar nga një polic, kolona e automobilave të zez korb kaloi me një shpejtësi afro 80 km në orë. Sulltani i turpshëm i kishte lëshuar perdet në veturën e tij të zezë me gjashtë dyer!

(njeriu i vdekur dhe jonjeriu)

E para "Rilindja", Radioja dhe Televizioni u ranë me të madhe kambanave se kësaj radhe, ti, i dashuri i pejgamberit dhe fuqia e allahut në tokë, sulltani Tito, kishte ardhur jo vetëm "të çmalleshe me shqiptarët e tu të dashur", po edhe të ndërmerrje diçka konkretisht për zbatimin rigoroz "të ndihmave" të Federatës për "zhvillimin e shpejtuar" të Kosovës. Megjithë robërinë, sikur këto qëllime të kishin qenë të vërteta, janë punë që nuk mund të quhen apriori të këqija, të dënueshme. Prandaj, ç'të frikësoi te kosovarët? Ata nuk ia duan të keqen vetes dhe dinë ta dallojnë mikun nga anmiku. Prandaj, s'ka si të mendohet se ata nuk duan zhvillimin e vet dhe se nuk dinë kish është ai që ua do të mirën dhe që i ndihmon! Pastaj, edhe nëse qëllimin e keq në ty e keni ditur vetëm ti dhe klika jote dhe kështu jeni frikësuar nga ndërgjegja e juaj e ligur tej mase, ju për këtë s'kishit nevojë se njerëzit e "këqij", "rebelët", "rrugaçët" ishin "të siguruar" nëpër burgje e nëpër bodrume!

Ç'kishte që frikësoheshe aq shumë, "baba mbret"?! Pse të shqetësoj aq shumë UDB-ja?

Rrugën ta shtruan me dafine, me lule nëntori; rrugën ta ngjeshën me valle, me zërat e brishtë të fëmijëve të posadalë nga mëndelat (bërrr, sa ftohtë bënte atë nëntor!), dhe poetët kopukë ia thanë në gazeta e revista, në Radio e në Televizion, me himnizimet e tyre emfatiko-euforike-muziko-kopuke, duke madhëruar lavdinë tënde. Renegatët që i ke krijuar ti vetë, e jo njerëzit nga gjiri i popullit tonë, t'i shtruan rreth sofre dhe ata të raportuan me përunjësinë më të madhe (sado që nuk dinin të lexonin as si fëmijët e brishtë në rrugë) edhe për të "mbërrimet e mëdha", edhe për "lojalitetin e pashembulltë" të kosovarëve edhe për disa "irredentistë, nacionalistë, njerëz të krisur, bukëpërmbysës", të cilët po kërkojnë diçka më shumë, "pa ditur as vetë ç'është ajo që kërkojnë, dhe po e sakatojnë mirëqenien në bashkësinë socialiste" të jetës në një "paqe e harmoni të bekuar"!

As kështu s'ta dëshmuam dot "dashurinë tonë të madhe"?!

Përveç hijes sate, s'të ndiqte kush, Tito, ty as renegatët shqiptarë, që kanë hyrë në shërbim të përjetshëm tek ti, as policinë që kish mugulluar si bari i keq.

Apo, mos ishte kjo, hija e ndërgjegjes, që nuk ju lente të qetë, megjithë të mirat që kishit përpara? Ç'ju dëftehet, vallë, në ëndërr, ty dhe klikës sate? Mos është fytyra jote, fytyra e dhunës, e kolonizimit të viseve shqiptare, fytyra e shfarosësit të shqiptarëve, që tani të del nga thellësitë e paqenësisë dhe të vjen përballë, duke të tmerruar edhe ty?

Ishe ti, Tito, me klikën tënde, që tradhtove idealet e shqiptarëve; ishe ti që ua shkele flamurin shqiptarëve, pasi ua ripushtove me tradhti një pjesë të tokave, se kështu të ndihmoi momenti i poshtër historik; ishte ti vetë që më 1947 ua rrëmbeve shqiptarëve të Kosovës edhe kokrrën e fundit të drithit dhe i le ata të ushqehen me barishte për më se një vit; ishte ti që patriotët shqiptarë, të cilët e kuptuan tradhtinë tënde, i hodhe në burgje, në kampet e tua të përqëndrimit, kurse me idenë e tyre të shenjtë luajte kapuç nëpër këmbë, duke i quajtur ata "informbyroistë", "tradhtarë të socializmit", "rrugaçë të thjeshtë"; ishe ti, e jo vetëm Rankoviqi - siç të pëlqen ty të mendoj bota - që poshtërove deri në shkallën më të ulët dinjitetin e shqiptarit, duke e zbruhur dru në të ashtuquajturin aksion të armëve, më 1956 dhe me një të goditur vrave dy lepuj: edhe dërmove shqiptarin edhe hoqe qafe rivalin e fronit tënd, Rankoviqin; ishe ti që qindra mijëra shqiptarëve ua dhe rrugën e mjerë të arratisë e të mërgimit në Turqi; ti, Tito studentët e Beogradit me demagogji, i përkdhele si "gjeneratë vigjilente" për ardhmërinë e vendit tënd, kur ata qenë ngritur në demonstrata, kurse ata të Prishtinës të cilët kërkonin të drejtat elementare njerëzore e kombëtare, i quajte "disa qindra qindra rrugaçë, që egërsohen rrugëve, për modë, si në vendet e perëndimit"! Më në fund, ti me klikën tënde jeni ata që milni begatinë e pashterrshme të Kosovës, kurse shqiptarit që jeton në vend të vet e nën robërinë tënde, ia ke vënë këmbën në fyt dhe i kërcënohesh se do t'ia zesh frymën.

"Dhe kush nga ne pati uri, ai në betejë ra.
Dhe kush na vdiq ndër duar, ai nga dorë e tyre u vra.
Ai që e morën me policë, urinë (lexo: robërinë) nuk e pat pranuar.
Ai që ia thyen nofullat, veç bukë pat kërkuar.
Atij që bukë i premtuan, tani i hidhen mu në grykë.
Ai që e rrasin brenda, të vërtetën e thosh pa frikë.
Dhe ai që u besoi se qenkan miq me ne,
ai paskësh pritur kot që shiu nga toka të derdhej në re."

Ç'pate lum "dashamiri", që u drodhe me kaq frikë në Kosovë kësaj radhe? Ç'hetove ashtu, në ajri, që mund ta rrezikojë shëndetin tënd, shëndetin e "vetadministrimit" tënd specifik, të cilin e ke mbërthyer aq fort me demagogji, me fuqinë e mungesës së argumentit; "unitetin" e mbretërisë sate të shtrenjtë dyzetvjeçare?

Që nga viti 1947 e këtej, siç të ka treguar para tri vjetësh (në "Rilindje") bashkëkombësi yt sllav, Milija Kovaçeviqi, për çdo dinarë të investuar në Kosovë, ke marrë prej Kosove dy dinarë e gjysmë. Prandaj, së paku njëherë për njëherë, s'ka frikë se kosovarët do të forcoheshin ekonomikisht deri në ndonjë shkallë që do ta rrezikonin ty vendin. Duke menduar se mund të paguash me kokë një hap të vetëm naiv, ti Krahinën e "shkarkove" nga përgjegjësia e saj si qendër ushtarake, dhe atë përgjegjësi ia "ngarkove" Nishit, ku rekrutohen tash shqiptarët; dhe s'të erdhi turp, as s'të ngau kush të arsyetoje këtë hap. Kurseve Kosovën nga brengat e tepërta! Prandaj, s'ke frikë se shqiptarët e robëruar mund të bëjnë ndonjë ditë edhe "komplot" ushtarak. Ti krerëve kosovarë, sikur t´u kishe dhënë të pinë hashash, ua mbushe gushën, dhe po i tërhek për hunde e po i sjell për kërpeshi si gjënë e gjallë në mazgjah, pasi ua ke topitur mirë ndjesitë me forcën e metodave të hartuara e të studiuara në Institutin për Shfarosjen e Shqiptarëve, në Beograd, dhe tash s´ke si të frikësohesh se të dalin dore vasalët. Ti e "kurseve" qiellin kosovar nga tymi i industrisë: për nënshtetasit e tu shqiptarë ti ke dashuri të posaçme - nuk do që ata të sëmuren nga tymi i fabrikave e as të lodhen duke punuar në ndonjë fabrikë; më mirë e kanë të shëtisin rrugëve të lirë, me duar në xhepa, të thithin në lirinë e pafundme ajrin përmbi kokë, e në daçin, kur të mos kenë bukë, le të "hanë" ajër! Edhe për historianin

shqiptar do të kish qenë ngarkesë e madhe sikur ai të zbriste më thellë kah rrënjët e historisë së vet. Edhe këtu ke bërë lehtësime: historiani apo nxënësi, apo studenti, përgjithësisht shqiptari, le ta mësojë historinë e Nemanjiqëve, ose së paku atë të LNÇ të Jugosllavisë, mjafton. Lidhur me LNÇ-në le të zgjedhin tema disertacionesh dhe ty le të thurin ditirambe. Çdo ngritje e vetëdijes kombëtare, që lindet nga përtrirja e kujtesës kombëtare me të mësuar të historisë së vërtetë, do të shkaktonte kokëçarje - do t'i bënte shqiptarët të kërkonin të dalin më vete, të bashkohen me shqiptarët tjerë, që i kanë vëllezër gjaku. Çdo bëje ti pastaj pa shqiptarët "e tu të dashur", alias, pa pasurinë që ka atdheu i tyre dhe që ty po ta ndërton sot Serbinë, Malin e Zi etj?

"Gjeneral, njeriu është shumë i dobishëm. Ai mund të fluturojë dhe të vrasë njerëz. Por e ka një të metë: Ai di edhe të mendojë." Dhe, kur merr të mendoj shqiptari, çkado që ti thuash ti, ai e di se po i thua kështu:

Ti je shqiptar, pasardhës i popullit më të vjetër në Ballkan, me një civilizim të lashtë. Kot ke luftuar kundër Romakut, bizantit dhe turkut, që deshën të ta japin emrin e vet dhe të ta shkelin tokën. Historia jote aq e gjallë dhe qëndresa jote e paepur ndaj përpjekjeve të vazhdueshme të të huajit që ta zhdukë nga faqja e dheut emrin, gjuhën, kulturën dhe qenësinë tënde fizike kombëtare shqiptare duhet të ndalen, të hynë në një fazë ngurosjeje, e cila është e domosdoshme - jo pse është i tillë çasti yt historik e kombëtar, po pse kështu e do logjika ime pushtuese. Ti duhet të mburresh që po ta jap emrin tim - jugosllav (sllav i jugut), hymnin tim gjithësllav "Ej slaveni"; duhet të jesh i kënaqur nëse mëson të marrësh frymë si sllav, si pjesëtarë i një race më të lartë, ta ndërrosh bioritmin tënd kombëtar, duke shkelur vetveten, historinë dhe atdheun tënd.

Këtë erdhe t'ia thuash edhe njëherë shqiptarit të Kosovës?

A s'e dite se s'ia duron midja?!

Gojët e këqija po flasin sikur të paska rënë diçka në vesh, atje, në selinë tënde të shtrenjtë, në Beograd. Të thanë kushedi se çka lugetërit hegjemonistë, të etshëm për të mbajtur ende nën thundër koloninë parajsore, Kosovën, dhe ti, në çastet e fundme të jetës prej matufi, në ankthin e halucinacioneve, që janë pasojë e poshtërsisë sate historike e cila tash të del para sysh me përmasa të shumëfishuara e me lëvizje të rrëmbyeshme, si lugati, si lubi, ke bërë dallash hesap: Shkova t'ua ndreq edhe njëherë samarin "shqiptarëve të mi" të pabindur! Për të arsyetuar para botës gjestin tënd, ti gjete pretekstin: “Kosova ka ngecur shumë prapa, ajo ka nevojë për zhvillim të shpejtuar, prandaj po shkoj... po u hedh atje poshtë, në koloni, pak hi syve, le të mendojnë se nuk kam tjetër punë pos halleve të shqiptarëve.”

Ç’thonë pastaj gojëkëqinjtë?

Aha, po! Po flitet se ke ardhur t’ua shtrëngosh edhe njëherë frerin vasalëve të tu, Fadilit (Hoxhës), Xhavitit (Nimani) me kompani, pse disa shqiptarë po marrin guxim të mendojnë ndryshe e jo si jugosllavë. Ç’të bëjnë edhe ata të shkretët, Fadili e Xhaviti! Ata e kanë punën edhe më ngushtë: ti kërkon prej tyre të të binden vetë dhe t’i detyrojnë edhe të tjerët të të binden ty. Kurse shqiptarëve s’po u bëhet vonë t’u shtrohen as Firmës Fadil & Co e as ty që të kanë “xhan”, por ja që s’po mbërrijnë, nga telashet e veta. S’po duan që s’po duan shqiptarët të mendojnë si ju; kanë marrë një avaz të ri, po duan të dalin më vete, të bashkohen me vendin e tyre amë, me Nënën Shqipëri, siç e quajnë me afsh atdheun e tyre, e kjo bën ta flakin robërinë jugosllave.

Kjo gjë të habit. Pos të tjerash, pos që me ekonomi në tokat shqiptare ke lejuar lojën “Laje, lyeje, kape maco, shkërryeje!”, ti ke marrë masa edhe për përçarjen e tyre: le të vriten sa më shumë vëllau me vëlla! Këtë fjalë e këtë ide i ka përfillur besnikërisht

gjithë aparati yt i fëlliqur shtetëror. Dhe shqiptarët kanë zënë qëmoti dhe po vazhdojnë edhe sot të vriten, të gjakosen si armiqtë më të mëdhenj ndërmjet veti.

Ky fenomen, me të cilin krenohesh pse ka mbirë brenda kufijve të shtetit tënd, ngërtheu me vete dy momente të rëndësishme. I pari: "Më mirë ia lan shteti tatimin kriminelit që e lind vetë, sesa populli që i lan tatimin shtetit. " Duke u nisur nga shkalla e kriminalitetit të madh në Jugosllavi del se sistemi yt revizionist është nga më të tmerrshmet xheheneme të kësaj bote. Dhe e dyta: kur të ketë marrë vëllau të vritet me vëlla në kolonitë e botës, - po thotë një njeri i mençur, - vëllau e vret të vëllanë duke dashur ta vrasë në të gjithë poshtërimin e përbashkët të të kolonizuarit. Dhe siç ka dashur historia, siç po dëshmon kudo epoka e dekolonizimit në botë, nuk shkon gjatë dhe në vend të vëllait i kolonizuari do ta kthejë pushkën kah armiku i vërtetë, kolonizatori.

Ky proces është ngjizur moti te shqiptarët, a s'të duket edhe ty? Fol drejt, a të ka shkuar ndonjëherë mendja se vjen edhe dita që shqiptari, I detyruar me dhunë për ta pritur "si miku" gjakësorin e vet më të madh, të dalë në shesh sikur pranë varreve të "shkjeve", pa dashuri, pa ndjenjë egërsimi, pa gaz në buzë, po edhe pa pezmatim. A s'të duket se kjo është një ftohje e rrezikshme gjaku? Mendoje se dashuria pushon në themele të gënjeshtrës, të dhunës?! Apo s'çaje kokë si do të vente puna me shqiptarët. Metodat e tua të shfarosjes, të ka shkuar mendja, do të arrinin shpejt e shpejt efektin që s'e arritën dot me shekuj metodat romake, bizante, turke: asimilimin apo shfarosjen e shqiptarëve. (Kush kanë qenë romaku, bizanti, turku në krahasim me fuqinë tënde!).
Ti klithje që nga Beogradi: "Barazi për të gjithë kombet dhe kombësitë!", se kjo të lypsej për demagogjinë tënde. Kurse në mbrëmje kokën e fusje, sa ishe më i ri e më i fortë, nën cepin e jastëkut me hingirizje, duke u gëzuar që ja, me rrena po kalon edhe një ditë në lumturi!

Dhe pati që të besuan dhe asish që mbetën duke bërë sehir, pa u përzier kurrë. Për të parët do të vijë dita t`ua këndojmë këngën:

"Turpin e madh si e durove
Dhe me ç`ilaç zemrën e mpive,
Kur me kasapët u pajtove
Dhe për ata në llum u shtrive…
Mjerë ata që duart i kanë ndyrë
Me krime që as gurët nuk t`i falin"

Të dytët e dinë se "prej atyre që rrinë e bëjnë sehir presim që, të paktën t`u vijë turp"

A e do edhe një nga lajtmotivet e tua më të preferuara, i cili po zvarritet që më se tridhjetë vjet përmbi Kosovën, si zahalli që të shpon veshët? "…në vjetin e ardhshme, duhet të kemi parasysh që Krahinën tuaj (kuptohet Kosovën) të ndërtojmë deri në maksimumin e mundësive tona…"! A e di kur i ke thënë këto fjalë? Me 18 mars 1951! Ku? Në "Rilindje". Po e vërteta, ku qëndron ajo? Gjashtë vjet më vonë, më 1957, të ardhurat për krye të një banori në Kosovë arritën në 49 për qind të mesatares në Jugosllavi. Ani mirë. Nga ky vit e tutje, puna ka ecur më tej. Por –së prapthi. Si gaforrja: me 1977, të ardhurat për krye të një banori në Kosovë ranë në shkallën 33 për qind të mesatares jugosllave! Sa do që nuk duam të të shqetësojmë (pasi edhe atëherë kur ti je në shtrat dhe asnjë fuqi fizike nuk ke, don të jesh mbret!),dhe ta bëjmë me dije se s`ke pasur as do të kesh lojalitet te shqiptarët që bukës i thonë bukë, duhet të ta themi se kopallat e tua s`do t`ia hedhësh më askujt. Se, në shtëpinë tënde vetëm gënjeshtra çirret fort…përreth të lavdërojnë shtypësit, kurse të shtypurit të fajësojnë. "Në mos më besofsh mua, pyete B. Brehtin. Ose cilin do njeri që ka një lugë tru në kokë.

Ja ç`thotë me një rast një dijetar, ta zëmë, duke folur për të kolonizuarit në botë (e ç`vlen për këta, vlen edhe për shqiptarët, të pushtuar nga Jugosllavia, apo jo?). Luftëtari i lirisë ka parë tek ia heqin zvarrë, tek ia vrasin të jatin në mënyrë brutale…,dhe ka mbajtur mend. Dalëngadalë është rritur, është martuar dhe është bërë babë. Historia është përsëritur: atë e kanë marrë nga shtrati I gruas, e kanë rrahur ndër sy të saj e të fëmijëve, dhe pastaj e kanë rrasur në burg. Familja ka mbetur e tmerruar, pa bukë. Ai vetë ka „shkalluar“. Kur të dalë në liri, historia mund të përsëritet prapë edhe më, edhe më…Prandaj as që i shkon mendja se urtia, dashuria, lumturia e kësaj bote mund të kërkohet këndej guximit, këndej vdekjes, këndej robërisë: dhe ai i bije shkelm “gjithë të mirave” të kësaj bote këndej dhe takimin me çdo gjë të mirë e cakton përtej kufirit të guximit, matanë vdekjes. Rrugë tjetër nuk ka. Në qoftë se merr guxim dhe s`ia ndan luftës kundër armikut të tërbuar, një ditë do të vritet, do të bëhet njeri i vdekur. Në qoftë se dorëzohet, shtrëngohet të përulet deri në baltë, dhe nuk do të jetë më njeri fare.

Ti i di këto. Nuk je armik për t`u përbuzur. Demagogjia jote me dekada po pi ujë edhe në Jugosllavi edhe gjetkë. Se mos nuk e ditka bota që gjithë „fillozofia” jote s`është tjetër veçse një demagogji, mbi të cilën pushon një rend i kalbur shoqëror? Merita jote: dite ta shfrytëzosh situatën që ha kopalla si të tuat! Prandaj s`je i pa mençur. Duke qenë i tillë, ti e di domosdo një gjë. Kur njeriu pajtohet me një fat, pra me luftën dhe me vdekjen, s`ka më vend për shqetësim, për nervozizëm.

Këtë dinë shqiptarët në Kosovë dhe në tokat tjera të tyre të pushtuara nga Jugosllavia. Sikur të mos e dinin ata do dëshpëroheshin dhe do të humbnin torruan për shkak të burgosjeve masive politike, që bëre ti në Kosovë dhe përgjithësisht ndër shqiptarët brenda shtetit jugosllav. Përkundrazi, për revolucionarët shqiptarë, këto burgime të papara janë shenjë e qartë se nervoza e gjandarmërisë jugosllave do të thotë se ky vend është buzë gremine dhe që po afron dita e luftës së hapur dhëmb për dhëmb e shqiptarëve të kolonizuar kundër armikut të tyre shekullor- Jugosllavisë.

Mjerë ti dhe klika jote kur të shpërthejë ithati ynë, i cili nuk e do të shtrydhet pak nga pak, se e ka kohën të shërohet përfundimisht.

“Duke marrë parasysh se çfarëdo që të na thotë,
ne qeverisë (sate) kurrë s`do t`i besojmë,
kemi vendosur që, nën drejtimin tonë e me besim të plotë,
një jetë më të mirë për vete të ndërtojmë.
Duke marrë parasysh se ju me siguri
përveç gjuhës së topave tjetër nuk kuptoni,
kemi vendosur që grykat e tyre tani
nga ju t`i drejtojmë që t´i shijoni!”

(Bertolt Brehti)

Në pastë qenë kjo frika jote gjatë vizitës së fundit ndër shqiptarë, atëhere je njëmend njeri i arsyeshëm: frikësohu edhe më shumë!

Janar, 1980 (Bashkimi, Organ i Frontit të Kuq, shkurt 1980, faqe 1)

4. Dasma e barbarit mbi kufomën e të stërmunduarit

(Tërmeti i 15 prillit 1979 dhe kurbeti i shqiptarëve nga viset e tyre brenda kufirit politik të Malit të Zi)

Tërmeti i 15 prillit 1979 dhe vërshimet që pësuan disa muaj më vonë, lanë pasoja katastrofike në viset shqiptare brenda kufijve shtetërorë të Jugosllavisë. Pjesa dërmuese e banorëve shqiptarë të Krajës, Anamalit, Shestanit, Ulqinit, Tivarit etj., mbetën pa kulm mbi kokë. Përkundër ndihmave të mëdha që arritën për popullsinë e dëmtuar nga të gjitha anët dhe përkundër zotimeve të qeverisë jugosllave se do të veprojë energjikisht për evitimin e pasojave të rënda nga tërmeti, në këto vise nuk është bërë gati asgjë.

Ja se ç'shkruan "Rilindja" nëntë muaj të plotë pas katastrofës, më 10 janar 1980, në kulmin e dimrit:

"... në këtë Komunë (Ulqin) 41 familje janë të strehuara nën tenda... numri më i madh i tyre... në Bashkësinë Lokale të Vlladimirit (kupto Anamalit)... U vendos që të gjitha familjet brenda kësaj jave të vendosen në rimorkio, ndërsa personave të rrezikuar nga aspekti social nga mjetet e solidaritetit t'u ndërtohen baraka... në shtëpi të tilla (shtëpi të shënuara me ngjyrë të kuqe, ku është rrezik të banohet), në Komunën e Ulqinit, jetojnë sot 25 familje... 200 familje jetojnë në shtëpitë e sanuara, 743 te miqtë dhe farefisi, 406 në hotele, 74 në pushimoret e punëtorëve etj... Me 1 prill të gjitha hotelet e kampet (pushimoret) duhet të lirohen për sezonin turistik... Ku do të strehohen familjet që sot jetojnë në hotele?"

Ky tërmet i pat goditur edhe disa vise bregdetare të Malit të Zi: Kotorin, Budvën, Hercegnovin etj. Në këto vise gjendja është sanuar gati qind për qind, me ndihmat që revizionistët jugosllavë morën nga bota. Këto ndihma patën arritur njëlloj për viset shqiptare që u dëmtuan edhe më shumë nga tërmeti. Por, këtu nuk u bë asgjë.

Ndonëse një gjendje e tillë pritej nga njerëzit që janë të informuar për kushtet ekonomike, sociale e politike të shqiptarëve në territorin e përfshirë brenda kufijve të Malit të Zi, megjithatë, kish edhe ndonjë mendim se qeveria revizioniste jugosllave e sidomos ajo e Malit të Zi, do ta mbulonte sadopak turpin e vet, nuk do të dilte aq haptazi me qëndrime aq diskriminuese ndaj shqiptarëve.

Shifrat e lartpërmendura, të cituara nga "Rilindja", siç mund ta dimë, janë provizore, të dhëna paushall, dhe prapa esencës së tyre zyrtare me siguri fshehet esenca jozyrtare, vërtetësia, e cila është shumë më e hidhur për banorët e tokave shqiptare nën Mal të Zi. Sido që të jetë, ta kundrojmë më për së afërmi shprehjen "743 te miqtë dhe farefisi". Ne edhe më herët kemi ditur për "prirjen" e banorëve të këtyre anëve për emigrim: ulqinakët, tivarasit, anamalasit etj., kanë marrë dendur udhët e mërgimit qëkur gjenden nën pushtimin barbar të Malit të Zi, i cili ka interese t'i popullsojë me malazezë këto vise që i patë pushtuar me ndihmën e Evropës (shtrigë), më 1881, dhe që i ripushtoi pas Luftës I Botërore, e së treti pas Luftës II Botërore. "Miqtë dhe farefisi" i 743 familjeve vetëm nga Komuna e Ulqinit (a do të jenë vetëm 743?!) gjenden në Belgjikë, në Amerikë, në Australi, me perspektivë kthimi në Vendlindje edhe më të pakët se perspektiva e atyre shqiptarëve që me dekada ndodhen në mërgim!

Në një emision dokumentar të TV Titogradit (Podgoricës) lidhur me problemet pas tërmetit të prillit, përmendej ndihma e madhe nga bota e jashtme dhe një problem, jo fort i rëndësishëm në dukje, po shumë esencial për "administrimin" revizionist jugosllav: me të holla që arritën nga vendi dhe nga bota e jashtme, duhej filluar ndërtimi i shtëpive në mënyrë sa më urgjente, që të dëmtuarit të mos i zinte dimri në tenda. Kishte një

cikërrim, për të cilin Federata nuk mundi të bjerë në ujdi me trustet kapitaliste jugosllave! Ndërmarrjet ndërtimore shfrytëzonin rastin e fatkeqësisë që të përfitojnë për vete. Ato nuk pranuar, as me intervenimet e Federatës, të ndërtojnë banesa për të dëmtuarit nga tërmeti me çmim më të ulët se një milion dinarë për një metër katror banimi! Deri në çastin e fatkeqësisë, ky çmim ende nuk kish arritur në këtë shkallë në tregun jugosllav të ndërtimtarisë. Një milion dinarë për metër katror, madje për baraka!!

Meqë jeta duhej vazhduar, e pushteti nuk ndërmerrte kurrfarë aksioni të organizuar, banorët e këtyre anëve u desh të orientoheshin kah ndërtuesit privatë. Dhe, ç'ngjau në këtë rast.

"Një murator, shkruante "Rilindja", – duke shfrytëzuar tërmetin dhe kohërat e ftohta që janë duke ardhur e që do t'i zënë ulqinakët pa pullaz mbi kokë, u pagua 2400 dinarë në ditë"! Ne dimë se 2400 dinarë bëjnë një rrogë mujore të punëtorit të inkuadruar në Kosovë!

Ç'të bëjë shqiptari në këto kushte? Ndihmat nuk bien në dorën e tij po të "përgjegjësve". Ekonomikisht edhe më parë kanë qenë fare të dërmuar, konkurrenca e tregut jugosllav i le pa kulm mbi kokë dhe pa bukën e gojës për fëmijë. Zor që mbetet tjetër rrugë, pos asaj të mërgimit e ajo është rruga e hidhur e shqiptarit, i cili duhet t'ia lëshojë vendin malazezit, se kështu i ka rregulluar dhe po përpiqet t'i rregullojë hesapet qeveria jugosllave, vazhduese e qeverive që nuk rreshtën së planifikuari se si t'i shfarosin shqiptarët.

Mëkot Shoku Enver Hoxha – (ditën kur u dha në përdorim lagjja "Bashçallëk" e Shkodrës, me shtëpi të ndërtuara në afat jashtëzakonisht të shkurtër, me mjetet e Shtetit Shqiptar dhe pa asnjë ndihmë nga miqtë as nga armiqtë, me shtëpi që të dëmtuarve iu dhanë në pronë personale – falas, pa taksa dhe pa qira – e pra tërmeti te vëllezërit tanë në Shqipëri po ai që na goditi ne këtej) – i porositi ulqinakët të bëjnë çmos e të mos e marrin rrugën e kurbetit. Me fatosat shqiptar, sikur të kishte lejen e Qeverisë Jugosllave, ai do të ngritte në këmbë për një muaj, jo vetëm një Ulqin. Po Qeveria Jugosllave nuk e la as Kosovën t'u dalë në ndihmë vëllezërve ulqinakë me të holla dhe me fuqi punëtore që do të punonte vetëm në viset shqiptare të dëmtuara nga tërmeti.

Gjithë kjo është edhe një dëshmi e vrazhdë se pushteti antipopullor jugosllav jo vetëm që s'qanë kokë për mirëvajtjen e popujve të Jugosllavisë, por ai vepron me plane të caktuara për shfarosjen sa më parë sidomos të njërës nga kombësitë që jetojnë brenda kufijve të saj politikë: për shfarosjen e shqiptarëve, që janë vendësit e vërtetë të këtyre trojeve.

Por, megjithatë, populli shqiptar është mësuar me vështirësi ndër shekuj, ndër shekuj u ka bërë ballë përpjekjeve barbare për shfarosjen e sojit të tij. Mbetet mundësia për një pyetje të vetme: Kush mund ta quaj të njerëzishme dasmën e barbarit përmbi kufomën e njeriut të stërmunduar dhe, kur një shoqëri, më mirë një sistem si ai jugosllav, e bazon zhvillimin e vetë në dinakërinë dhe në qyqarinë më të poshtër për të cilën mund të dëgjoj njeriu, a duhet të brengosemi ne për vete që po heqim kaq keq por duke pritur ditë të lumtura, apo vetë Jugosllavia e cila ia ka mihur vetvetes themelet me pushtetin e vet të egër dhe të cilën po e pret varri i sigurt?
(Bashkimi, Organ i Frontit të Kuq, shkurt 1980, faqe 2)

5. Letër lexuesve
Të dashur lexues të "BASHKIMIT"

Duke lexuar gazetën tuaj, shpesh siç na ka rënë të dëgjojmë, keni pasur rast t'i dëgjoni njerëzit përreth jush duke thënë: "me siguri duhet të jetë punë e reaksionit serb e malazez apo maqedon, punë e UDB-së, për t'i nxitur shqiptarët e etshëm për luftë çlirimtare, për t'i "organizuar" ata në mënyrë që pastaj t'i zenë të gatshëm në kurth". Kështu është folur edhe për afishet e për traktet që shpërndajnë grupet dhe organizatat revolucionare të shqiptarëve të robëruar në Jugosllavi.

Ishte vërtetë një kohë kur të pangritur në pikëpamje intelektuale dhe me ndërgjegje kombëtare të zgjuar po të dërmuar nga aksionet shfarosëse të Jugosllavisë titiste, ne "lejonim" që armiku të infiltrohet në mënyrat më të ndryshme provokative, për të na shkatërruar më lehtë. Por, ajo kohë perëndoi shumë shpejt, sepse UDB-ja e pa që nuk kishte llogari, se po "mësheshim" prej tyre të kujtonim ato që na lypsen. Prandaj, një praktikë të tillë e harroi shpejt, e detyruar të vepronte kështu nga presioni i grupeve dhe organizatave të shqiptarëve, të cilët, ndonëse në ilegalitet të thellë, ia dolën të popullarizojnë në masat popullore programe të tëra politike, që do ta shpien në udhën e çlirimit social e nacional nga Jugosllavia për formimin e shtetit unik të të gjithë shqiptarëve (pos atyre që kanë shitur interesat e tyre kombëtare te të huajt), që arrihet me bashkimin me Vendin Amë, Shqipërinë Socialiste.

Kjo nuk do të thotë aspak se provokimet dhe infiltrimet në radhët tona nga ana e agjentëve të UDB-së kanë pushuar. Përkundrazi, në këto çaste të veprimtarisë së sforcuar ilegale revolucionare, ne po ballafaqohemi përditë e më shumë me agjentë, e kjo është gjë fare e natyrshme kur kemi parasysh se edhe radhët tona po bëhen përditë e më të dendura, më masive.

I pakti prej nesh nuk është bindur ende për ekzistimin e Institutit për Shfarosjen e Shqiptarëve në Beograd, i cili ka themele të forta - gjithë pushtetin e revizionizmit titist. Prandaj është e natyrshme vështirësia e madhe në të konsoliduar të të gjitha forcave revolucionare të shqiptarëve në Jugosllavi.

Për të parë këtë vështirësi, duhet domosdo t´ia bëjmë një analizë, qoftë edhe të supozuar, Institutit në fjalë. Ja në pika të shkurtra, një analizë e tillë, duke u mbështetur në imagjinatën kreative të një shkrimtari, shkrimtar, i cili në veprat e veta ka grumbulluar artistikisht edhe vërtetësi të madhe dialektike e historike, të shkoqur nga përvoja e popullit tonë.

1. Zhdukja fizike e rebelimit. - Sipas fjalëve të shkrimtarit tonë, ideja e rebelimit thyhet me anë të luftës. E ne e dimë: gjatë luftës së fundit, ndonëse populli shqiptar luftoi krah për krah me popujt e Jugosllavisë për dëbimin e armikut të përbashkët, fashizmit, dredhia sllave ua hëngri kokën bijve më të mirë shqiptarë, si Emin Duraku, Hajdar Dushi e sidomos Shaban Polluzha, që ia kishte ndier erën tradhtisë së madhe ndaj shqiptarëve.

2. Zhdukja e idesë së rebelimit. - Masa e dytë, të cilën e ka gjithmonë ndërmend çdo institut i pushtuesit që merret me planet e shfarosjes së popullit të pushtuar, është masa për zhdukjen e idesë së rebelimit. E ne dimë: gjithë ç'mund t´i jepte shenjë shqiptarit për rebelim, duke u nisur nga grupet dhe organizatat më të vogla politike në Kosovë, u shua, ose u bënë përpjekje të shuhet, nga ana e Sigurimit Shtetëror Jugosllav, që nga lufta e këtej.

3. Zhdukja ose gjymtimi i gjuhës, artit, zakoneve. - A e dimë ne luftën tonë të vështirë, në fillim për ta ruajtur gjallë gjuhën tonë (së pari na thoshin se gegërishtja s´paska lidhje me toskërishten), e pastaj për t´i siguruar asaj edhe jetën në shkolla, fakultete, dhe më në fund edhe në administratën e Krahinës sonë, në të cilën popullsia

shqiptare përbën tetëdhjetë për qind (ndërsa të tjerët erdhën si kolonistë), kurse gjithë të tjerët së bashku njëzet për qind të popullsisë. Po arti, kultura? A s´duhet domosdo, t´i nënshtrohen edhe këto, me dhunë, një fryme dhe një vije rigoroze jugosllave, megjithëqë me artin dhe me kulturën e sllavëve të jugut nuk kanë asgjë, ama asgjë të përbashkët?

4. Zhdukja dhe dobësimi i kujtesës kombëtare. - Flamurin kombëtar, Jugosllavia na e ndaloi -në emër të internacionalizmit proletar (!) më 1946. Vjershat dhe përgjithësisht veprat e shkrimtarëve shqiptarë na i ndaloi, e në to ishte e mbledhur e gjithë e kaluara jonë kombëtare: pra duhej të harronim gjithë c´kishte të bënte me shqiptarët, se ne ishim bërë "jugosllavë" (sllav të jugut?). Na u ndalua kujtimi i fytyrave më të ndritshme të historisë sonë kombëtare. Por ngulëm këmbë dhe diçka nga këto nxorëm me dhunë. Por, doli vjet një tradhtar (e të tillë si ky ka edhe ca), me emrin Fadil Hoxha, dhe ky tradhtar e pa historikisht të nevojshme të mbante disa mitingje, nga Gjakova deri në Istog, duke predikuar pa pikë turpi: Kush është Mic Sokoli, që më janë kapur për Të, të rinjtë kosovarë; kush ishin Shota dhe Azem Galica? Ata ishin komita dhe asgjë tjetër (mos qoftë thënë me gojën tonë!). Më heret ai ka pas thënë: `Adem Dema-Demaçi është një hejn që nuk e njeh as mahalla e vetë"! Pra vetëm Fadili me kompani (Fadil&Co), që tradhtuan popullin e vet dhe po i shërbejnë qe dyzet vjet gjakpirësit më të poshtër sllav, po na delkan "hero". Trimat legjendarë shqiptarë, që luftuan për bashkimin e tokave shqiptare, madje duke ia vënë gjoksin grykës së topit, ata nuk qenkan gjë. Kështu do të thotë renegati Fadil. Dhe shton: Kush është Eqrem Çabej, kush është Ismail Kadare? Dhe ua vë përballë Idriz Ajetin dhe Azem Shkrelin, thua se rinia, pse dashka shumë dy të parët, që janë figura të shquara në gjithë historinë e kulturës shqiptare, nuk i dashka edhe Idrizin e Azemin. Ose thotë Fadili: ç‘kanë të rinjtë që dalin në koncerte të veshur me tirq, me xhamadana, me plisa të bardhë?
Të gjitha këto, sipas mendjes së Fadilit, të cilën ia kanë injektuar në kokë si hashashin atje në Institutin për Shfarosjen e Shqiptarëve në Beograd, u dashka të harrohen!

5. Përçaj e sundo. -Kjo është formula më e dashur e pushtuesve të të gjitha kohëve, që u kursen mund dhe u jep shumë rezultat në vendet e pushtuara. A e dimë se në çfarë shkalle të tmerrshme ka arritur në viset shqiptare të robëruara nga Jugosllavia gjaksimi i vëllaut me vëlla? E dimë. Por, kemi në këtë mes edhe një manifestim të ri të kësaj formule: sa më shumë pasiguri e mosbesim politik ndërmjet shqiptarëve përparimtarë, në mënyrë që të mos arrijnë të konsolidohen!

Dhe pikërisht kjo pjesë e kësaj formule sot është shumë aktuale për forcat revolucionare të shqiptarëve brenda kufijve politikë jugosllavë. Ekzistojnë shumë grupe e organizata, që të gjitha me një qëllim të vetëm, madje me një ide të vetme edhe për mënyrën e sendërtimit të këtij qëllimi (jo zogistë, ballistë… po vetëm komunist, marksist-leninistë që pranojnë vetëm pikëpamjet e një vendi të vërtetë socialist, siç është Shqipëria), por gjithë këto grupe e organizata e patën vështirë t´i shplohen shoqja-shoqes dhe t´i bashkojnë armët, sepse armiku pat infiltruar në radhët e tyre një armatë agjentësh.

Është një gjë tjetër me rëndësi: llojllojshmëria e strukturave shoqërore në shkallë të ndryshme arsimimi, që e kushtëzon në masë të madhe gjithë mënyrën e shkrimit tonë në "Bashkimi". Në saj të "kujdesit" të revizionizmit jugosllav, një pjesë e madhe e popullsisë kanë mbetur analfabetë, një pjesë tjetër gjysmë analfabeta, të tjerët me shkollime të mesme e të larta. Në mes këtyre shtresave dhe shtresës kuaziintelektuale, që është pjellë e ideve të revizionizmit jugosllav, ekziston një pus i madh, një moskuptim që të brengos. Për këtë arsye, ne jemi detyruar t'u drejtohemi intelektualëve të vërtetë dhe pjesës më të shëndosh të popullsisë të viseve tona të robëruara, e cila pret me padurim jo vetëm të mësoj ndonjë fakt, se shumicën i di mirë, për arsye se i ndien mbi lëkurë të vetë,

po edhe t'i jepet ndonjë shenjë për rrjedhën e luftës së mundimshme revolucionare apo për afrimin e betejës përfundimtare me armikun - Jugosllavinë revizioniste dhe renegatët shqiptarë në shërbim të saj.

Në këtë drejtim, ndihmesë e çmuar nga çdo lexuese e lexues i sinqertë do të kish qenë që: me sugjerime, të shprehura me shkrim apo me gojë, të na e bëni me dije në ndonjë mënyrë se cilat probleme duhet të trajtohen në gazetën tonë ilegale dhe në ç'mënyrë të rrahen ato më së miri, në mënyrë që gazeta ta bëjë efektin e vet. Natyrisht jemi të vetëdijshëm se është vështirë, për shkak të punës në ilegalitet të thellë, sugjerimet tuaja të na arrijnë drejtpërdrejtë. Por, si në çdo punë, me shokun e bankës, me mikun, kusheririn, me një fjalë me njerëzit më të besueshëm të çështjes sonë jetike, diskutoni lidhur me fizionominë e "BASHKIMIT" dhe jepni mendimet tuaja të çmuara. Nuk është çudi që shoku juaj i punës, shoqja e shoku i bankës, motra e vëllau, miku e kusheriri të jetë pikërisht ai që mund të na i përcjellë mendimet dhe sugjerimet tuaja.

Identifikimi i plotë i anëtarëve të redaksisë së "BASHKIMIT", sikundër i të gjitha forcave revolucionare shqiptare nën regjimin revizionist jugosllav, do të bëhet vetëm pasi të shpërthejë Beteja përfundimtare me armikun e kombit tonë.

-Përpara! Ja vdekje ja Liri!

Redaksia e "BASHKIMIT", Organ i Frontit të Kuq

(Bashkimi, Organ i Frontit të Kuq, shkurt 1980, faqe 2)

6. Uji vërshonte – UDBa burgoste patriote e patriotë

Vërshime që nuk mbahen mend, thanë të gjithë. Uji i tërbuar s'la shtëpi pa hyrë në të, anembanë Kosovës.

Por, edhe më e tërbuar u tregua UDB-ja vjeshtën që shkoi. Mu në valën më të madhe të stihisë, gjandarët dolën në një gjah të madh. Rezultati: mija e mija shtëpi shqiptarësh të bastisura, mija e mija fëmijë të tmerruar, qindra e qindra (gjegjësisht mijëra, pasi gjer në këtë moment dëgjojmë për më se 2500 të burgosur shqiptare e shqiptarë) patriote e patriotë të burgosur!

Shkroi edhe "Rilindja" e 21 nëntorit për një vëlla tonin, i cili, në çastin që doli gazeta (e mallkuar) ishte i burgosur dhe nuk arriti të lexojë gjë për aktin e madh njerëzor që kish bërë vetë, duke e ndihmuar me të madhe edhe Ndihmën e Shpejtë për t'u dalë përballë kërkesave të popullsisë, që po përjetonte çaste nga më të vështirat. Këtë e bëri ai, Shoku Bilall Osmani, punëtor në "INA". Ai duke luftuar me armë të thjeshtë, kofë, ia arriti që ujin e tërbuar mos ta lenë të futet në fuqinë nën tokë, ku do të përzihej me benzinë. Kështu, ishte e vetmja pompë në rrethin e Prizrenit që funksiononte. Kur në mëngjes shkuam të mësojmë diç më shumë për sakrificat që i kishte bërë gjatë tërë natës, Shokun Bilall e kishin arrestuar kusarët e UDB-së! Edhe një pjesë e madhe e shqiptarëve të vetëmohueshëm, që s'ua trembë syrin stihia, e që mikrofoni dhe kamera e gazetarëve ua lavdoi guximin e gatishmërinë, s'pati rast t'i dëgjojë t'i shikojë emisionet në radio e televizion, të cilat flisnin për heroizmat e tyre. S'patën rast, se UDB-së, që kish dalë në gjahun e madh mbi shqiptarët pikërisht ato ditë, duke përfituar ligësht nga një fatkeqësi elementare, i duhej preja sa më e majmur.

Përpara botës dhe përpara nesh, qoftë edhe formalisht, Jugosllavia, pasi na mbanë mbërthyer brenda kufijve të vet politikë, është e detyruar të mbaj ndaj nesh qëndrim të njëjtë me popujt e tjerë të Jugosllavisë. Kështu e detyron Kushtetuta e saj "vetadministruese" revizioniste, kështu e detyron propaganda e saj e flakët "socialiste e paqashtëse", kështu e detyron, më në fund, njerëzia.

Mirëpo, për sa po e shohim e po bindemi, edhe Kushtetuta, edhe propaganda, edhe njerëzia janë vetëm emra kuptimi. Zjarri shuhet me zjarr, helmi liget me helm, dhuna kthehet me dhunë, poshtërsia... me çka mund t'ia kthejmë poshtërsinë shumëvjeçare ndaj shqiptarëve Jugosllavisë? Do të na duheshin shekuj, sikur t'i kushtoheshim kësaj pune. Diçka, megjithatë, mund t'i kthejmë asaj me qëndresën tonë dhe me përforcimin e radhëve të luftëtarëve të lirisë, të cilët po bëhen gati për çastin kur në viset shqiptare të robëruara do të jepet KUSHTRIMI.

Forcat përparimtare të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në Serbi, në Maqedoni dhe në Mal të Zi, duke jetuar në gji të popullit të vet, tani e dinë edhe si rrah pulsi i këtij populli. Me popullin tonë, dihet mirë, nuk është puna si me njerëzit e hutuar, të cilët "merren" me hamendje të kota, për të gjetur se kush ... ndolli... (të keqen) për herë të parë prej shkretëtirave... dhe askush nuk mendon se ç'duhet bërë për të ndaluar vërshimin e ... (së keqes)". Përkundrazi, të keqes ia dimë dhe ia kemi ditur burimin. Dhe jemi përpjekur t'ia ndalim hovin. Që nga Lufta e Dytë Botërore e këndej, burgjet jugosllave nuk kanë mbetur pa të burgosur politikë shqiptarë të organizuar në grupe e organizata të shumta, që kishin një qëllim të vetëm: flakjen e robërisë jugosllave dhe bashkimin me Vendin Amë SHQIPËRINË, siç e donë të gjitha ligjet njerëzore, pos atyre të pushtuesve. Kështu i shohim edhe burgimet e tanishme masive, më masivet në luftën tonë të ashpër me revizionizmin jugosllav. Veçse, Jugosllavia po e humb përgjithmonë davanë! (Bashkimi, shkurt 1980, f.2)

7. Politikë asimiluese ndaj shqiptarëve në Jugosllavi

Kur viset e banuara, me shqiptarë u ripushtuan, atëherë filloi politika asimiluese (zhdukëse) ndaj shqiptarëve. Këtë më së miri e vërteton emërtimi i ministrave të Jugosllavisë së paraluftës e në "Jugosllavinë e Titos". Për shqiptarët është për t'u përmendur shovinisti i tërbuar, ministri Vasa Qubrilloviq.

Vasa Qubrilloviqit para Luftës i qe besuar detyra e asimilimit të shqiptarëve, pasi në këtë fushë sikur kishte eksperiencë të madhe, prandaj edhe ishte ministër agrar. Po ky ministër shevenist serbomadh u zgjodh edhe pas Luftës në të njejtën detyrë: duhej ta vazhdonte detyrën e vjetër të "shenjtë" – asimilimin sa më të shpejtë dhe sa më të suksesshëm. Ata donin ta pastronin "Stara Serbinë", si serbomëdhenjtë e quajnë Kosovën, nga "egërsirat", siç na quante Vladan Gjorgjeviqi, kryeministër i dikurshëm.

Politika e shpërnguljes me dhunë të shqiptarëve nga Atdheu i tyre u maskua më vonë, për të pasur sukses sa më të madh, me të ashtuquajturin "Aksion i armëve" (1956). Në këtë kohë titistët organizuan terror të papërshkrueshëm. Siç dihet "terziu" i këtij terrori ishte Aleksandër Rankoviqi, i cili vepronte në mënyrë krejt legale. Mendimi që Tito nuk ka qenë i njoftuar për një terror të tillë të egër, është gënjeshtër; ata e planifikonin bashkarisht këtë aksion. Por kur filloi lufta për prestigj, Tito e fitoi, duke e larguar Rankoviqin. Kjo ishte arsyeja pse Rankoviqi u shkarkua, e jo pse ushtronte terror mbi shqiptarët. Ky terror i egër kishte një qëllim që t'i frikësoj shqiptarët për të mos pritur i pari të mbramin, por që sa më shpejt ta lëshojnë "Stara Serbinë". Një terror i tillë la pasoja prapa, prandaj edhe po sjellim ca shifra të mangëta zyrtare për ilustrim.

Deri në Luftën e Dytë Botërore janë shpërngulur më se 500 mijë shqiptarë. (Kjo do të thotë sa t'i shpërngulësh sot 5 Prishtina), kurse pas Luftës, në të ashtuquajturën "Jugosllavi të re", vetëm në vitet 1953-1957, janë shpërngulur më se 195 mijë banorë. Deri në "Plenumin e Brioneve" janë detyruar ta lëshojnë Atdheun 230 mijë shqiptarë. (Të

gjitha këto shifra janë nxjerrë nga revista "Studime Albanologjike" të Universitetit të Prishtinës).

Sa u përket kolonizatorëve, nuk kemi ndonjë statistikë të enteve të Kosovës (pasi Kosova as që guxon të bëjë statistika të tilla.). Kështu jemi të detyruar të thirremi në statistikat e Drejtoratit për Reforma në Shkup: Deri në vitin 1940 në Kosovë u janë marrë shqiptarëve të varfër 381 245 ha. tokë pune dhe u janë dhënë çetnikëve, gjandarëve dhe oficerëve serbo-malazez, që kanë qenë në shërbim të Qeverisë. Në këtë kohë në Kosovë erdhën si kolonistë 17 679 familje serbo-malazeze, për të cilat janë ngritur 15 943 shtëpi të reja; kolonistët nuk pranonin të banonin në shtëpitë e vjetra të shqiptarëve, sepse i çmonin shtëpi ku kanë banuar "egërsirat"!

Sa u përket trojeve të ripushtuara nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia, gjegjësisht nga Jugosllavia, por që u copëtuan në mes këtyre republikave, nuk disponojmë fakte të shumta: jo pse nuk është ushtruar politikë asimiluese e diskriminuese, pasi në këto vise asimilimi dhe diskriminimi ka qenë edhe më drastik, që vazhdon edhe sot e kësaj dite me të madhe, por pse nuk i bëjnë duke i çmuar ato si territor plotësisht të tyre.

NË MAL TË ZI...

Edhe sot e kësaj dite në Mal të Zi shqiptarët në trojet e tyre, të pushtuara nga shovenistët malazez, nuk gëzojnë as të drejtat elementare, si shkollimin fillor në gjuhën amtare, etj. Përpos në Ulqin e Tuz, ku me sakrifica të mëdha fituan shkollë të mesme, në asnjë rreth tjetër nuk ka shkolla të tilla.

Një politikë e tillë diskriminuese, të cilës shqiptarët trima të këtyre trevave, që derdhën aq shumë gjak që t'i mbrojnë trojet e trashëguara nga baballarët, nuk arriti aspiratën përfundimtare: spastrimin e plotë.

Një politike të tillë diskriminuese që ushtrojnë shevenistët e tërbuar malazes, shqiptarët nuk i nënshtrohen. Ata ishin trima në mbrojtjen e Vatanit. Por, pas shevenistëve qëndronte dikur Rusia Cariste, ndërsa para, gjatë e pas Luftës Dytë Botërore Revizionizmi Titist, i mbështetur nga imperialistët anglo-amerikanë. Sigurisht, edhe tradhtia e ka rolin e vet. Megjithëqë populli shqiptar i këtyre trevave përjetoi e përjeton terror dhe diskriminim të paparë, ai i qëndroi, i qëndron dhe do i qëndroi kurdoherë presionit dhe nuk i lëshon tokat e veta. Shqiptarët nesër do të jenë edhe më trima dhe tokës së vet do t'i kthehen të gjithë të mërguarit, të cilët qenë detyruar të lëshojnë Vendlindjen për shkak të skamjes e terrorit politik nga shovenistët sllav.

Sigurisht një politikë e tillë diskriminuese e asimiluese ka lënë gjurmët e veta të vrazhda... Sidomos çpikja e kombit "musliman" (!) nga revizionistët titistë, të cilët, duke pasur aspirata shoveniste, bëjnë atë çfarë se bëjnë as mbretërit arabë. Dhe të tillë komunistë na qenkan komunistë se!!

Rrjedhimet shihen në atë se shumica e shqiptarëve të rretheve të Plavës, Gucisë (treva dikur të njohura, kur shqiptarët të organizuar në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, i bënin sfidë edhe Evropës për të mbrojtur tokat e tyre nga copëtimi), poashtu edhe rrethet e Podgoricës u "deklaruan" "musliman" gjatë regjistrimeve të vitit 1971. Dhe jo vetëm kaq, por në familjet e tyre ka depërtuar edhe gjuha serbe me të madhe, pasi nuk mund t'i përballojnë shkollimit në gjuhën joamtare. Edhe gjuha zyrtare ka ndikuar që popullsia të filloi të përdor gjuhën e pushtuesve. Shqiptarët, kudo që silleshin, torturoheshin, nëse nuk përdornin gjuhën serbe. P. sh. edhe pasardhësit e farefisi i patriotit Ali Pashë Gucia e Jakup Ferrit, të cilët Presidiumi i Kuvendit Popullor të Shqipërisë i dekori me tituj të lartë për trimërinë e treguar në mbrojtjen e Atdheut nga copëtimi, pasi që të dy ishin prijës të

kryengritjeve për mbrojtjen, të cilat Kongresi i Berlinit (1878) ia kishte dhënë dhuratë Knjaz Nikollës, tani e ndiejnë veten "musliman". Bile në shtëpi flasin gjuhën serbe.

Ja, edhe një gjendje të tillë demagogët e shovinistët e quajnë liri!!

Emigrimi nga këto vise e ka bërë të veten. Shumë nga të mërguarit kanë shkuar në Amerikë. Vetëm nga rrethi i Ulqinit kanë emigruar më se 4000 shqiptarë. Edhe më shumë kanë emigruar nga rrethet e Tuzit, Plavë e Gucisë. Ky emigrim u bë pasi në viset e banuara me shqiptarë, në Jugosllavinë e "Re" nuk u ndërtua asnjë objekt industrial. Poashtu shqiptarët nuk gëzojnë (dhe ndryshe as që bën) të drejtë në pension luftarak, siç i gëzojnë çetnikët malazesë. Kjo është e kuptueshme pasi shqiptarët kanë humbur luftën dhe janë ripushtuar, ndërsa çetnikët e kanë fituar, por edhe në këtë drejtim donim t'u tregonim shovenistëve sllav e reaksionarëve shqiptarë se me çfarë "lirie" kemi të bëjmë.

NË MAQEDONI...

Sa i përket politikës diskriminuese te shqiptarët në Maqedoni, janë kapërcyer të gjithë kufijtë. Atyre edhe sot e kësaj dite ndiqet një politikë e ashpër shoveniste, që bën të mendohemi thellë. Shqiptarët në Maqedoni detyrohen t'i nënshtrohen diskriminimit brutal si në fushën e kulturës, ashtu edhe në atë ekonomiko-sociale. Të drejtat elementare për të rrojtur si shqiptar, janë të cënuara.

Sa u përket statistikave të pasluftës, kur këto troje u ripushtuan, nuk disponojmë ndonjë shënim. Por dihet se i njejti fat, bile edhe më i keq se në Kosovë, i ndoqi edhe ata të Maqedonisë. Rëndësi të madhe shovenistët maqedon i kanë dhënë fesë, e cila në këto vite ka lënë gjurmë të thella, pasi klerikët, si edhe kudo e çdo herë, ishin e janë në shërbim që ta ndihmojnë reaksionin, në rastin tonë Klikën shoveniste të Shkupit. Këta hoxhallarë, pra i shërbejnë politikës shoveniste sllave, që ushtrohet ndaj shqiptarëve, e jo popullit e fesë. (Të ndahen në mes populli e feja, pasi të dyjave nuk u shërbehet në të njejtën kohë.).

Qeveria maqedone (ne nuk do të diskutojmë se a janë apo nuk janë maqedon të vërtetë, kjo është puna e tyre, si ta quajnë ata "zyrtarisht" veten edhe ne do t'i quajmë, edhe pse historikisht gjërat janë diç më të ngatërruara) vazhdon me politikën e saj shoveniste diskriminuese dhe asimiluese. Diskriminimi bëhet në fushën social-kulturore, duke cënuar të drejtat elementare të njeriut. Por shqiptarët e këtyre trojeve i përballuan kësaj politike të egër, edhe pse patën humbje të mëdha.

Politika e inkuadrimit, si kudo që rrojnë shqiptarët, e edhe në Maqedoni i ka goditur thellë bashkatdhetarët tanë. Në ndonjë fabrikë që është ndërtuar në këto treva, janë sjellë maqedon nga viset tjera dhe janë punësuar në to, ndërsa shqiptarët e këtyre viseve janë dënuar me papunësi dhe emigracion në mënyrë masive. Vetëm nga komunat e Gostivarit, Tetovës, Strugës, Kumanovës kanë emigruar më se 16000 shqiptarë. Për komunat e Kërçovës, Ohrit dhe Dibrës nuk disponojmë statistika momentalisht, por dihet se edhe nga këto vise kanë emigruar masivisht dhe janë të papunësuar mijëra të tjerë. Komuna e Tetovës dallohet për nga numri i shqiptarëve të papunë. Numri zyrtar është 4500 veta që janë regjistruar në Ent për inkuadrim. Edhe në Gostivar, në vitin 1978 ishin mbi 2000 veta që kërkonin punë. Dihet se këto janë statistika të mangëta zyrtare, pasi që revizionistët tentojnë që shifrat e tilla t'i minimalizojnë. Në anën tjetër mijëra shqiptarë pa folur tani për femra, as që lajmërohen fare nëpër entet përkatëse, kur dinë se ashtu-ashtu janë formalitete, atëherë për çfarë t'ua shohin syrin burokratëve.

Duke u bazuar në këtë gjendje të mjeruar, mërgimtarët që gjenden në botën e jashtme për të fituar bukën për familje, janë të detyruar që me krahët e tyre të mbajnë shumë anëtarë të familjes. Ata sikur dakordohen që kur jetojnë në mënyrë parazitore nga të afërmit e tyre, prandaj sikur s'u prish punë, pse për të fituar në gyrbet duhet të vuash si "gjarpëri nën gur". Kjo rëndon shumë në jetën e "gastarbajterëve", si ka filluar t'i quan edhe "Rilindja".

Ka edhe shumë të tillë që shkojnë në mënyrë ilegale, e që quhen "turistë". Të tillët shkojnë sidomos sezonit veror dhe shfrytëzohen në mënyrë të egër. Numri i sakët e tyre nuk dihet, por dihet se janë shumë. Për këtë vërtetohemi po t'i vizitojmë tregjet ilegale të Perëndimit të egër. (Bashkimi, shkurt 1980, faqe 4)

8. *ZËRI I POPULLIT* - ZË I TË GJITHË SHQIPTARËVE

Kërcënimi Sovjetik për intervenimin ushtarak në Jugosllavi, kumboi në Shqipërinë Socialiste si kushtrim për t'u ardhur në ndihmë proletariatit dhe popujve të Jugosllavisë. Për shqiptarët që ndjekin me admirim politikën e vendit të tyre amë, RPS të Shqipërisë, kjo është rruga e vetme që shpie kah lufta e pritur për çlirimin social e nacional nga revizionizmi titist dhe kah bashkimi kombëtar me vendim amë.

Fill pas pushtimit të Afganistanit në dhjetorin e kaluar, në botë piku fjala se Bashkimi Sovjetik (BS) s'e ka fort larg t'i shtrijë kthetrat edhe përmbi Jugosllavinë. Dhe bota, si një masë amorfe, e rënduar nga përgjumja kapitaliste, kolonialiste dhe revizioniste, ka zënë të merret me shkaqet dhe me arsyet e BS për një intervenim ushtarak në Jugosllavi, në vend që ta shtrydh mendjen se si të pengohet ky rrezik i prapët për popujt e Jugosllavisë.

Vetëm një vend i vogël krenar, Shqipëria Socialiste, në vend që të merret si të tjerët me dokrra, e shpalli botërisht me anën e Organit "ZËRI I POPULLIT" gatishmërinë e Qeverisë dhe të popullit shqiptar për t'u ardhur në ndihmë popujve të Jugosllavisë në rast intervenimi ushtarak nga ana e BS. Mendja e urtë mund të nxjerrë menjëherë përfundimin se Shqipëria Socialiste, që kultivon një vigjilencë të pashembullt lidhur me ngjarjet në botë, i ka të qarta arsyet e kërcënimit sovjetik dhe është e vetëdijshme se cilën anë do ta marrë për vete.

Kohë më parë, prijësi i madh i popullit shqiptar, Shoku ENVER HOXHA ftonte jo vetëm popujt tjerë, por edhe vet proletariatin sovjetik: "...ta shkatërroni regjimin diktatorial fashist, që fshihet me sllogane mashtruese. Ju duhet ta dini se ata që ju drejtojnë janë fashistë, shovenistë dhe imperialistë. Ata ju përgatisin si mish për top, për një luftë të ashpër imperialiste, për të vrarë popujt dhe për të djegur e shkatërruar vende, që shpresonin shumë tek atdheu i Leninit dhe Stalinit.... Armatimet dhe ushtria në BS s'janë më në duart e popujve sovjetikë dhe nuk shërbejnë për çlirimin e proletariatit botërorë, por përkundrazi, ato janë destinuar për të shtypur popujt sovjetikë e popujt tjerë." (E. Hoxha: Me Stalinin, Tiranë 1979, f. 41-42)

Në ngushticën e madhe të një intervenimi ushtarak sovjetik, për popujt e Jugosllavisë do të qeleshin disa fronte: mposhtja e dominimit të kapitalit perëndimor (me 35 miliardë dollarët që i ka borxh Perëndimit, Jugosllavia, në bazë të numrit të banorëve, është vendi me më së shumti borxhe në botë); shembja e regjimit të klikës hegjemoniste e social-shoveniste të Beogradit, e cila popujt e Jugosllavisë i ka futur në një rrugë të pakrye; dhe lufta e vështirë me armë kundër kuçedrës evro-aziatike ruse. Dhe gjithë këto fronte popujt e Jugosllavisë janë të shtrënguar t'i përballojnë vetëm me forcat e veta, të

cilat në këtë çast janë të dërmuara fare nga mjetet e egra të pushtetit anti-popullor revizionist në Jugosllavi qe tridhjetë e pesë vjet.

Për qeverinë dhe popullin shqiptar, të mbledhur grusht rreth Partisë së Punës të Shqipërisë (PPSH), ky rrezik i popujve fqinjë u bë kushtrim i hapur për t'i ardhur në ndihmë proletariatit të Jugosllavisë dhe për të treguar edhe një herë, si vazhdimisht brenda këtyre 35 vjetë jete në socializëm të mirëfilltë, konsekuencën e pashembullt ndaj idealeve të larta proletare, marksiste-leniniste.

Historikisht, në rrethana të caktuara, "bashkimi i armëve (shqiptare) me aleatët ballkanikë ishte vetëvrasje" (A. Puto: Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912-1914, Tiranë).

Dhe "ZËRI I POPULLIT", që i dha zë aktit fisnik të mbrojtjes së të drejtave të popujve në emër të internacionalizmit proletar, pa shikuar rrezikun me të cilin e ngarkon veten ka pasur parasysh këtë fakt. Shqipëria s`i harron masakrat që kanë bërë mbi popullin shqiptar ushtritë dhe gjandarmëria serbe, para njëqind vjetësh, kur shqiptarët u përzunë me mënyrat më barbare nga tokat e veta poshtë Nishit; masakrat e pa para të ushtrive serbe në Prizrenin e posaçliruar nga forcat e Lidhjes Shqiptare, kur serbët gjetën shesh për të bërë kërdinë mbi pleq, gra e fëmijë, mbi të plagosurit shqiptarë të strehuar në konsulatën Austro-Hungareze në Prizren (Pierre Loti: "Tourquie ago nisante",Paris, Calman-Revy); egërsimin sllavë të serbeve e malazezëve (të shtyrë nga Rusia, e cila sot po kanoset t`i pushtojë vetë po këta serbe e malazezë) mbi popullsinë shqiptare tamam në kohën që këta, e kishin çliruar pëllëmbë për pëllëmbë vendin e tyre nga Turqia, më 1912, dhe kur Pashiqi i Serbisë dhe Nikolla i Malit të Zi, që e gjetën Shqipërinë të dërmuar nga lufta me turqë, hynë dhe shkretuan të thuash gjithë tokat shqiptare dhe, më në fund, me dredhitë e veta e me anën e dredhisë së madhe ruse, atdheut tonë ia shkëputën Kosovën, viset shqiptare në Maqedoni, në Mal të Zi e në Serbi; mizorit e pastajme të mbretërisë Jugosllave, e cila i kishte dhënë vetes për detyrë të zhdukte nga faqja e dheut popullin shqiptar…

Akti i sotëm i vendit tonë amë, në sytë e të gjithë shqiptarëve dhe botës bëhet edhe më madhështor kur dihet fare mirë se gjatë këtyre 35 viteve të pushtetit popullor shqiptar, Partia e Punës ndoqi me interesim jetësor sidomos mizorit e mëvonshme jugosllave, ato të PKJ, e cila "ndaj popullsisë së Kosovës ndoqi një politikë nacional-shoveniste, që ishte e njëjtë me politikën e Mihajlloviqit dhe Nediqit"(Që në fund të vitit 1945,-thotë Sh. Ballvora", Tiranë 1968,-kur Jugosllavia kishte ende vise të pushtuara nga forcat e fashizmit gjerman, grupe udhëheqës i PKJ dërgoi brigada dhe divizione të tëra për të masakruar popullin e Kosovës dhe ushtroi një terror që ia kalonte atë që kishin përdorur ushtarët e monarkiste serbe në periudhën e më parëme") Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë, e cila ka shënuar me interesim të gjallë dhe me indinjatë të thellë çdo akt të diskriminimit nacional social e politikë të shqiptarëve në Jugosllave nga ana e revizionizmit jugosllav (dëbimin e programuar shtetëror të shqiptarëve nga tokat e tyre dhe popullzimin e atyre tokave me kolonistë serbë, malazezë e maqedonas; përpjekjet këmbëngulëse të Jugosllavisë për të bërë një diferencim artificial gjuhësor, historik e kulturor ndërmjet shqiptarëve në RPS të Shqipërisë dhe atyre në viset shqiptarëve në Jugosllavi, me qëllim që këtyre viseve t`u ndërrohet fizionomia etnike, sidomos me ndihmën e presioneve të vazhdueshme nacional-shoveniste për shpërnguljen, zhdukjen fizike ose asimilimin e shqiptarëve; vjeljen e begative të mëdha e natyrore të Kosovës në dobi të Serbisë e të tjerave republika të Jugosllavisë, e në dëm të zhvillimit të mbarë ekonomik të popullit shqiptar në Kosovë…), pra, RPS e Shqipërisë i ka pasur parasysh të gjitha këto kur shfaqi gatishmëri t`u vinte në ndihmë popujve të Jugosllavisë kundër tërbimit rus. Është ideali i lartë proletar, solidariteti i pashembullt klasor e fqinjësor,

mungesa e ndjenjës së praptë të revanshizmit, dhe jo harresa e fakteve, që Shqipërinë Socialiste e bën të dallojë mirë pafajësinë e popujve të Jugosllavisë nga egërsimi sllavomadh dhe nga tradhtia e madhe e qeverisë revizioniste e nacional-shoveniste të Jugosllavisë.

Më në fund, vetëvrasja e vërtetë do kish qenë bashkimi i armëve me krerët revizionist jugosllavë, që po veprojnë me tërbim për t`ua ngrënë kokën shqiptarëve liridashës të Kosovës: nga lufta e këtej, organet fashiste të sigurimit jugosllavë kanë hedhur në burgje më se pesëdhjetë grupe e organizata liridashëse të patriotëve shqiptarë, që një mënyrë a në një tjetër u përpoqën të heqin qafe skllavërinë në Jugosllavinë titiste. Sot, po këto organe, me një tërbim më të madh se kurrë, i kanë një burgosjeje në masë të shqiptarëve, që pati rezultat mbi 2000 të burgosur, femra e meshkuj, mbi të cilët po ushtrohet një terror i egër me metoda policore që ua kalojnë metodave më çnjerëzore fashiste.

Partia Punës e Shqipërisë, kurrë nuk është kursyer me kritikat e veta ndaj regjimit antipopullor dhe antishqiptar të klikës titiste-rankoviqiste. " Për klikën e Beogradit, thotë vet shoku Enver Hoxha, Kosova është një pikë shumë e dobët, prandaj ajo ushtron në Kosovë një terror të madh…Elementi shqiptar goditet posaçërisht në Jugosllavin titiste, sepse udhëheqësit e tanishëm jugosllavë i njohin mirë tiparet revolucionare të popullsisë shqiptare të atjeshme, e dinë mirë se këtë popullsi problemi nacional gjithmonë ka qenë dhe mbetet në plagë e hapët që kërkon shërim." Por aq sa ishin të rrepta kritikat ndaj regjimit revizionist jugosllavë, aq ishte e madhe dashuria dhe keqardhja e shqiptarëve për popujt e Jugosllavisë.

Është pra e vetë kuptueshme se, sa për klikën titiste, nuk do çanin kokë Qeveria dhe populli shqiptar, për çfarëdo intervenimi që të jetë fjala. Vaftë në djall Titoja (nëse nuk ka vdekur) me këlyshët e tij, të cilët qe 35 vjet po përdhosin idenë e madhe komuniste e popujt e Jugosllavisë po i privojnë nga e drejta e tyre e pamohueshme për një zhvillim të mbarë e të vërtetë socialist, për të cilin ata patën dhënë gjakun e vet të shtrenjtë gjatë luftës së fundit!

Duke qenë të vetëdijshëm për të gjitha këto, krerët dinak jugosllavë i dhanë hov edhe më të madh veprimtarisë së tyre të errët, tamam në çastin që popujt e udhëhequr prej tyre u ndodhën për ballë rrezikut rus, në vend që ti gëzohen ndihmës së pa rezervë të fqinjit të parë. Në fillim, ata e trumbetuan me të madhe në shtyp, radio e televizion artikullin e "Zërit të popullit". Nuk harruan, porse të heqin si me thikë ato pjesë të artikullit, që lidheshin me interesimin vital të RPS të Shqipërisë për fatin e hidhur të shqiptarëve në Jugosllavi. Pos kësaj , si pas zakonit të dhelprës, ata edhe këtë rast e shfrytëzuan për të mbjell mjegull te popullsia shqiptare e këtushme. Nëpërmjet agjentëve të regjur në punë antishqiptare, krerët jugosllavë dhe renegatët kosovarë (të cilët e shkelën dinjitetin e tyre si shqiptar, që do ishin dhe u bënë sllavë të jugut) i dhanë krah parullës absurde sesi, me aktin e gatishmërisë për t`i dhënë ndihmë të pakursyer Jugosllavisë përballë rrezikut sovjetik. Qeveria shqiptare dhe Partia e Punës e Shqipërisë paskan ndërmend të rreshtohen krah për krah me revizionizmin jugosllav!

Kjo është edhe një shenj e qartë se tradhtia revizioniste jugosllave ndaj interesave të popujve brenda kufijve politik të saj dhe jashtë tyre, është e papërmirësueshme.

Kur u pa se shqiptarët e Kosovës dhe të viseve tjera shqiptare në Jugosllavi nuk e hanin dot këtë pemë helmuese, sepse vetëdija e ngritur kombëtare dhe klasore ata i bën të zgjedhin të vetmen rrugë të mbarë, atë të bashkimit me vendin amë Shqipërinë dhe të përkrahjes parezervë të rrugës së Partisë së Punës me Enver Hoxhën në krye, revizionizmi jugosllavë e hoqi maskën dhe i zbuloi këmbët e veta: A. Gërliçkovi, një funksionar i lartë

i revizionizmit jugosllavë dhe renegat maqedonas, deklaroi se Jugosllavia as e ka kërkuar dhe as e ka për gjë ndihmën që po i ofron një parti dhe një vend, që deri më tash e ka kritikuar ashpër politikën jugosllave!

Kjo nuk është ndonjë çudi e madhe. Regjimet antipopullore jugosllave ia kanë njohur turrin shqiptarit të armatosur, të cilit lufta e drejtë për trojet e veta ia dhjetëfishon fuqinë. Prandaj, ky regjim ende ushqehet me ëndrrën e moçme sesi, në rast të një lufte të re, përsëri shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptarët në Jugosllavi do t`i mobilizojnë e do t`i dërgojnë për luftime në Srem e në Slloveni, në mënyrë që çetnikëve serbë e malazez t`u hapë shesh për të ardhur e për të masakruar përfundimisht popullsinë shqiptare në viset e saj. Duke ditur për borxhet e mëdha ndaj shqiptarëve revizionizmi jugosllavë do të pranonte gjithçka tjetër më parë sesa kosovarët e mobilizuar dhe kalimin e Ushtrisë Shqiptare këndej kufirit, pa marrë parasysh se u vjen për ndihmë popujve të qeverisur prej tij.

Ndërkaq ne, luftëtarët e lirisë, duke njohur armikun dhe aspiratat e tij, duhet të përqëndrojmë vëmendjen edhe në pikat e tij të dobëta, në mënyrë që lufta e ardhshme, e pashmangshme, të na shkojë mbarë. Ky është për ne rasti më i volitshëm të heqim dorë nga çdo ndjenjë revanshizmi, të bëjmë edhe ne dallimin e domosdoshëm ndërmjet popujve jugosllavë, të pa fajshëm për krimet e ushtruara mbi ne, dhe qeverisë nacional-shoveniste të Beogradit; të armatosur vetë dhe të bashkuar me forcat e armatosura të Nënës Shqipëri, ne do të mund të realizojmë dy qëllime të larta-t`i ndihmojmë popujt e Jugosllavisë për të mposhtur regjimin e tyre tradhtar dhe për ta përballur sa më mirë egërsimin rus, e në anën tjetër, vetë t`i realizojmë aspiratat tona shekullore, çlirimin e tokave shqiptare nga zgjedha jugosllave dhe bashkimin e tyre me vendin tonë amë, Republikën Popullore të Shqipërisë.

Të mos presim, pra, të hutuar-se hutesa mund të na kushtojë shfarosje- por, duke ditur qëllimet e errëta të klikës titiste, të mblidhemi edhe ne, shqiptarët në Jugosllavi, dhe të ndjekim me besnikëri hapin e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të vëllezërve shqiptarë të ndjekim rrugën unike, e cila do të na shpjerë pa dyshim fitore! Shkurt, 1980 (Bashkimi, prill 1980)

9. MIRËUPAFSHIM NË MARSHIN E ARDHSHËM SHUMËMILIONËSH

Leonid Brezhnjevi s'mundi ta fsheh iritimin e tij kur kryetari i Ansamblesë Kombëtare Franceze, Zhak Shaban Delmasi, theksoi se intervenimi sovjetik në Afganistan ishte i "papranueshëm".

"Pse bën bota tërë këtë bujë për këtë punë të vogël? Dërguam atje pak ushtarë sa për të mbrojtur disa rrugë e ura."

Kështu na njofton "Rilindja" e 10 shkurtit 1980, në artikullin "Habia e Brezhnjevit", të huazuar nga "Harald Tribune".

Ndërkaq, në Afganistan, siç e di e gjithë bota, ushtria sovjetike që pushtoi këtë vend vitin e shkuar, po bën masakra të papara mbi popullsinë vendëse. Vetë Kabuli, kryeqyteti i Afganistanit, një kohë të gjatë qe bërë burg kolektiv për banorët që s'e pranonin aq lehtë pushtimin. Malet e Afganistanit janë veshur ndërkohë me luftëtar guerilë vendës, të cilët nuk kanë ndërmend të ndalen pa e çliruar vendin nga regjimi tradhtar i Kabulit dhe nga sovjetikët.

Do të thoshte njeriu se Brezhnjevi nuk ditka gjë për këto "cikërrime". Sepse kur Shaban Delmasi, gjithnjë sipas artikullit të cituar në fillim, i bëri atij vërejtje sesi "pesë divizione sovjetike (në Afganistan) nuk mund të jenë aksion i vogël policor", Brezhnjevi

iu kthye dora-dorës njërit prej këshilltarëve të vet ushtarak: "Vërtetë kemi pesë divizione atje?" Të mos i kenë treguar, vallë asgjë për këtë punë gjeneralët sovjetik carit të tyre?! Nga frika që kanë prej "ndërgjegjes" së tij "komuniste", apo për shkak se cari ka hyrë në moshë të thellë, vjen bukur si i matufosur, dhe prandaj duket gjë e logjikshme të përjashtohet heshturazi nga disa punë të rëndësishme shtetërore (kupto: pushtuese)?!?

Po më shumë se me mosdije, "habia" e Brezhnjevit ngjan me atë shprehjen cinike "naive-hyjnore" të një prifti, i cili tërë natën është mbuluar me të puthurat e bukuroshes anonime, kurse mëngjesi dhe besimtarët e gjejnë të përkulur thellë rrëzë bustit të Shën Mërisë Virgjër, si një të vdekshëm që kurrë s'ka qenë më afër kontaktit me shenjtërinë.

Edhe një shprehje e këtillë do t'i falet këtij cari. Ajo ngërthen më vete së pak përpjekjen për të fshehur një të vërtetë të fëlliqur. Po nëse është fjala për megallomaninë e udhëheqësit të një fuqie botërore, i cili, duke u përpjekur kinse të fshehë një të vërtetë që e dinë të gjithë, i bën sfidë gjithë botës dhe mburret para saj, dhe tregon më qartë se kurrë që gjithë bota s'ka çka i bën??? Do të thoshim se fjala është për vetëkënaqësinë idioteske të një vendi që historinë e vet e krijoi me aneksime dhe me uzurpimin e të drejtave të më se dyqind popujve jorusë.

Njëmbëdhjetë vjet më parë, më 1968, Bashkimi Sovjetik "u ftua" të dërgoj në Çekosllovaki "pak ushtarë për të mbrojtur disa rrugë dhe ura" (Sic!).

Edhe njëmbëdhjetë vjet të tjera më herët, më 1957, BRSS qe "ftuar" në Hungari, po me "pak ushtarë për të mbrojtur disa rrugë dhe ura"!

Edhe më herët akoma, carët rusë ia kishin shkëputur Rumanisë Molldavinë, Hungarisë Transilvaninë, Shqipërisë Kosovën me gjithë viset e tjera shqiptare në Maqedoni, Mal të Zi e në Serbi (këto të fundit për t'ua dhënë vëllezërve sllavë, serbëve e malazezëve. Poashtu edhe Bullgarisë, atëherë kur detyroi Turqinë të nënshkruaj Marrëveshjen e Shën Stefanit, në vitin 1878, ku përfshihej krijimi i "Bullgarisë së Madhe" ballkanike.).

Dalim kështu, kur është fjala për periudhën vetëm pas Luftës së fundit, te cikli i çuditshëm kohor 1957, 1968, 1979. Për çdo njëmbëdhjetë vjet, pra, Bashkimi Sovjetik ndien obligime "t'u vijë në ndihmë" popujve të ndryshëm!

Por, meqë fuqia ushtarake e BRSS po rritet gjithnjë më furishëm në dëm të mirëqenies së popujve brenda kufijve politikë rus dhe shumë popujve jashtë atyre kufijve, ka gjasa të qarta se cikli prej njëmbëdhjetë vjetësh do të bëhet i pamjaftueshëm kur e do puna të tregohet nami i armës sovjetike.

Sikur nuk mjaftoi trofeu i vjemë i kësaj arme (Afganistani), kuçedra e re evro-aziatike – se e vjetra qe Turqia – tash po kanoset me një intervenim ushtarak të ri, kësaj radhe në Jugosllavi.

Natyrisht, s'ka mënyrë më të sigurt se kjo për ta shkulur përgjithmonë nga pasuesit e idesë së madhe komuniste admirimin që kishin ata dikur për atdheun e Leninit dhe të Stalinit. Në e parë duket se nga agresiviteti pansllav i Rusisë e pësojnë keq vetëm vendet joruse që pretendon t'i shkelë Bashkimi Sovjetik. Ato që pësojnë jopak, siç e patën pësuar shumë popuj nga zgjedha e rëndë turke me qindra e qindra vjet. Mirëpo, siç e pësoi vetë Turqia në fillim të këtij shekulli, duke u katandisur në një nga vendet më të prapambetura në botë, siç e njohim sot, ashtu do ta pësoj një ditë edhe Bashkimi Sovjetik, më keq se kushdo, kur të shpërthej mullani i të drejtave të shkulura njerëzore e kombëtare të më se dyqind popujve të ndryshëm brenda kufijve rusë dhe jashtë atyre kufijve.

"Revizionistët hrushovianë, – ua përkujton shoku Enver Hoxha komunistëve të vërtetë dhe proletariatit të Bashkimit Sovjetik, të cilët mbyten nën thundrën e revizionizmit, – luftojnë që të ngjallin te ju ndjenjën e prepotencës dhe të zotërimit mbi të tjerët. Forcën tuaj të madhe ata pretendojnë se gjoja e përdorin për të luftuar imperializmin amerikan dhe kapitalizmin botëror, por ky pretendim është i rremë.

Sundimtarët tuaj janë në kontradikta dhe në aleancë me imperializmin amerikan dhe kapitalizmin botëror jo për interesat e revolucionit, por për shkak të ambicieve dhe lakmive imperialiste për ndarjen e sferave të influencës dhe për sundimin e popujve."

Logjika e çdo pushtuesi e do që të pushtoj sa më shumë toka dhe, me këtë rast, të ruaj patjetër ndjenjën se vetë është i përshtatshëm dhe i pacënueshëm. Dhe aplikimi i kësaj logjike nuk është gjë e ndaluar. Por, as e paparashikuar jo. "...Le të na hedhë lufta, ndoshta për njëfarë kohe në plan të fundit; le të na rrëmbejnë disa nga pozitat e fituara. Por, në qoftë se ju do t'u lëshoni frerin forcave, të cilat pastaj nuk do të jeni në gjendje të bëni zap, atëherë, sido që të jetë puna, në fund të tragjedisë ju do të jeni një gërmadhë, dhe fitorja e proletariatit ose do të jetë e arritur ose, sidoqoftë, do të jetë e pashmangshme." (F. Engels: Vepra, vëll. 21, faqe 36).

Kjo, mbase është një logjikë më e fortë e më reale. Sikurse edhe logjika sipas së cilës, një popull i madh, që në krye me Leninin e me Stalinin diti t'i hapë një rrugë të re e një perspektivë të ndritshme proletariatit botëror, do të dijë t'i mposhtë bastardët e vet të mëdhenj, si Hrushovi e Brezhnjevi dhe të vazhdoj rrugën atje ku e patën ndërprerë.

.... Dhe ndonëse Amerika tash po bën zhurmë për rrezikun e Jugosllavisë nga pushtuesit rus, ndonëse Amerika ka në Jugosllavinë titiste po aq të drejta sa Rusia – të drejta që revizionizmi jugosllav ua ka dhënë pa rezervë të dy palëve, duke bërë flirte herë me njërën e herë me tjetrën – ajo e ka mendjen te disa interesa personale të klikës, që nuk përkojnë dot as me interesat e vërteta të popujve të Jugosllavisë dhe as me ato të Ballkanit.

Nga ana tjetër Evropa, kjo "Kurvë e motit", po angazhohet për ruajtjen e Statu-kuosë në Jugosllavi, përkatësisht për ekzistimin e mëtejshëm të një rendi revizionist, të cilit i prinë hegjemonizmi dhe nacional-shovenizmi serb ndaj nacionaliteteve të tjera brenda kufijve politikë të Jugosllavisë, ku ka lulëzuar materiali perëndimor dhe shkelja flagrante e të drejtave sociale dhe nacionale të popujve të ndryshëm. Në mënyrë të ngjashme Evropa ishte angazhuar rreth Ballkanit edhe para njëqind vjetësh, në kohën që po tërhiqej me bisht nën shalë rrëshqanori i hershëm evro-aziatik, Turqia e mundur. Edhe atëherë Evropës i patën dalë kokëçarje, pasojat e të cilave ndihen edhe sot e kësaj dite, sidomos kur është fjala për padrejtësitë që iu bën popullit dhe trojeve shqiptare. Besojmë se edhe në të ardhmen "zonjës së moçme" do t'i dalin kokëçarje të reja deri sa ajo e sheh të arsyeshme për të ndërhyrë mbrapshtë në fatin e popujve dhe deri sa fati i popujve të Ballkanit të mos zgjidhet drejt, sipas parimeve ndërkombëtare, që përfillin momentin etnik të caktimit të kufijve shtetërorë.

Kurse, hutesës apo "habisë" së Brezhnjevit i doli boja shpejt. Vetëm trembëdhjetë ditë pas hutesës së parë, në "Rilindje" (datë 23 shkurt) ia lexuam një deklaratë të re: "Bashkimi Sovjetik do të jetë i gatshëm t'i tërheq forcat e veta ushtarake nga Afganistani vetëm atëherë kur të ndërpriten plotësisht të gjitha format e ndërhyrjes nga jashtë!?

A-ha! Pra, në Afganistan paska forca ushtarake dhe këtë e ditka edhe Brezhnjevi! Dhe, ai e paska ndërmend t'i tërheqë vetë ato forca, porsa të mos ndërhyjnë të tjerët, "nga jashtë".

Pse, kur ndërhyri ushtarakisht në Afganistan, nuk paska ndërhyrë "nga jashtë" Bashkimi Sovjetik?!? Ose ne nuk e kemi mendjen në vend, se Afganistani, ndonëse nuk i përket Rusisë, paska qenë dhuratë hyjnore e taksuar për carët e ri të Kremlinit!

Deri kur, ne, njerëzit e munduar, do të na shtrojnë për dhe me "fuqinë e tmerrshme të mungesës së faktit"?

E pra, faktet, argumentet dhe logjika më e fortë dhe më e shëndosh janë në anën tonë. Brezhnjevë janë disa, ne të munduarit jemi miliarda. Kur do t'i biem më fije kësaj meseleje kaq të shesht e kaq të thjeshtë!

Ngrehuni, o ju të munduar...

Më në fund, vetë rrethanat në botën e sotme kaq të shqetësuar, do t'ju bëjnë që ose të lejoni t'ju shfarosin kulçedrat brezhnjevë, ... shah, tito... ose të këndoni në marshin tuaj të ardhshëm shumëmilionësh e ngadhënjimtar kusurin e vargjeve të hedhura këtu të Internacionales! (Bashkimi, prill 1980, faqe 2-3)

10. IK O NATË PO KËNDON AGIMI

Me bukurinë tonë të virgjër, të virgjër
vdekjen po ushqejmë
se kjo tokë ka të ftohtë
(Fatos Arapi)

Dora e zezë e xhandarmërisë jugosllave derdh rrebeshe torturash barbare mbi kokat e më se 70 femrave shqiptare të mbyllura në burgun e Mitrovicës.

Ky lajm i praptë prek thellë në sedrën tonë kombëtare.

UDB-ja, e cila me dekada nuk u njoftua me dëmtimin e meshkujve të zgjedhur shqiptarë ndër kampet e veta të përqendrimit, sot u kujtua për të vënë dorë edhe përmbi femrën shqiptare.

Po në gjithë këtë ankth acari mbi Kosovën martire, ballin na e ndrit një sihariq: "Ohoo! Lindi bija, porosi e kohës për kombin, mësoi nga etnit liri e pushkë".

Shqiptarja kosovare, e cila deri më dje ishte në terrin e plotë të padijes, kurse sot ka zënë të ecë fare natyrshëm në tribunat më të larta shkencore e kulturore, e kuptoi përfundimisht se duhet të dalë kudo krah me të vëllanë, me të shoqin e të birin, në të gjitha frontet dhe me qëndrimin e patundshëm. Një komb unik shqiptar – në një shtet unik! Ky akt i burgosjes masive edhe të femrës shqiptare në Jugosllavi, tregon qartë se kanë rënë përfundimisht në ujë gjithë kombinacionet e fëlliqura jugosllave
(që nga viti 1912 e këtej), të cilat shkollimin e femrës shqiptare e shihnin si një nga mjetet e rëndësishme për çkombëtarizimin e shqiptarëve. E si të mos dështonin, pasi penat e mprehta, që pushteti i Jugosllavisë së vjetër dhe ky i Titos i kishin angazhuar të bënin hulumtime e projekte shkencore për asimilimin dhe për shfarosjen e shqiptarëve, nuk kishin parashikuar dot që do të vinte dita që femra shqiptare e Kosovës, e mbrujtur nga një brumë fisnik, në vend që ta përqafojë kuaziemancipimin jugosllav, shkollimin e vet e pa si një detyrë të shenjtë, të cilën duhet vënë në shërbim të popullit dhe të çlirimit social e nacional.

Pushtetmbajtësit e sotëm jugosllavë do të kishin qenë shumë më të kënaqur sikur projektet dhe masat e tyre shfarosëse të kishin qenë më pak drastike e të orientoheshin vetëm në neutralizimin e intelektualit shqiptar në Kosovë e kështu edhe të femrës sonë. Ndoshta në atë mënyrë do të korrnin suksese shumë më të mëdha. Por, barbari nuk mund të jetë kurdoherë i vetëdijshëm se dhuna sjell dhunë, gremina sjell greminë. Gjithë ç'përjetuan nga pushteti i Mbretërisë Serbe, Kroate dhe Sllovene, si dhe nga socialimperializmi titist, s'ishte pos dhunë e greminë.

Dëshmia më e mirë për shëndetin politik, social e nacional të shqiptares së Kosovës sot është inkuadrimi i saj i drejtpërdrejtë në lëvizjen e gjerë për çlirimin social e nacional të shqiptarëve nga Jugosllavia dhe bashkimi i tyre me vendin amë, Shqipërinë. Dhe ky akt i saj bëhet më madhështor kur dimë se gjithë përpjekjet nacional-shoviniste të pushtetit jugosllav ishin të përqendruara në degjenerimin, përkatësisht në apolitizmin e rinisë kosovare. Veçanërisht qëndrimi ndaj femrës sonë ishte i atillë që asaj i ofronte mundësi të shfrenuara për shfrime instinktesh të ulëta pa kurrfarë përgjegjësie

shoqërore, mundësi që krijonin një bazë të fortë për amoralitet total, për degjenerimin, që do t'u jepte dorë projekteve shtetërore jugosllave për asimilimin e shqiptarëve.

Kjo- siç është fare e natyrshme në kushtet e jetesës brenda kufijve politikë të Jugosllavisë, ku degjenerimi ka zënë të lulëzojë me të madhe – nuk do të thotë se krimbi i lig nuk ka zënë të brejë edhe një pjesë të rinisë sonë. Mirëpo, nuk kemi pse të brengosemi, sepse shkalla e degjenerimit te i riu dhe te femra jonë nuk përkon as për së afërmi me shpresat e mëdha që ushqen Jugosllavia në këtë drejtim.

Përkundrazi. Sado që terrenin e ka përgatitur me kujdes për një mekje të madhe dhe për një përgjumje kombëtare e shoqërore, pushteti titist te femra shqiptare me dhunën e ushtruar ka arritur një efekt krejt të kundërt me qëllimet dhe synimet e veta. Polici, agjent i shkon femrës sonë në shtëpi, "i kërcen nga muri, ia përmbys shtëpinë, ia vë koburen në gjoks dhe i kërkon burrin, djalin, vëllanë. Ajo mbase deri në atë çast nuk dinte akoma pse lufton djali, burri, vëllai. Ajo rrinte në shtëpi, në punën e vet…" Në shkollë, në zyrë, në institut. Njëherë kishte qenë e re, mendja i kishte thënë se duhet ta ndrydhë rininë e vet, sepse rrjedhë tjetër të ngjarjeve nuk mund të ketë, se shqiptari është qytetar i dorës së dytë, i dorës së dhjetë në Jugosllavi, se zyrat nuk e kuptojnë dhe nuk e durojnë shqip, se malli në shitore nuk ka si të kërkohet shqip, shqipja duhet të flitet me zë të ulët, shqipes duhet t'i vijë marre nga serbishtja, e cila qenka gjuhë qytetërimi. Pushteti jugosllav ishte kujdesur që shqiptari të mos mund ta shijojë cicërimin e bukur shqip të poetëve të Rilindjes, të atyre të Realizmit. Po pastaj kish qëlluar që femrës, i vëllai, shoku i shkollës, i kishin futur fshehur në çantë poezitë e Migjenit, Naimit, Qajupit, romanet e Xoxës, Kadaresë. Dhe ajo kuptoi menjëherë që "shiftari" dhe "albanci" flitkan krejt njësoj, prandaj u dashka të jenë një. Dhe, bashkë me të vëllanë, me shokun e bankës, kishte bërë presion, kish dalë në demonstrata: Në shkollë dua të mësoj për Naimin, Kadarenë, së paku aq sa për Duçiqin, Andriqin, Qosiqin. Fakti që ia fshehnin historinë, traditën, përkatësinë e përbashkët kombëtare me gjithë shqiptarët në botë, e në radhë të parë me vëllezërit në RPS të Shqipërisë, femrën shqiptare e bëri t'i hapë sytë mirë e mirë dhe të bindet se Jugosllavia paska siklet të madh, tuk se i kushton kujdes e mund aq të madh fshehjes se çdo gjëje që mban vulën shqiptare. Atëherë femra jonë zuri të mësojë dalëngadalë për historinë e ndritshme të popullit të saj, mbi të cilin kishin rënduar shekujt e robërisë, por s'e kishin përkulur kurrë, për historinë e popullit që ishte bërë theror për Ballkanin dhe Evropën, duke ia ndalur hovin kuçedrës anadollake pesëqind vjet me radhë, kurse në fund, kur i kish ardhur dita, pas shumë gjakderdhjesh, të formojë shtet më vete (më 1878, më 1912 dhe më 1944) fqinjët shovinistë – serbi, malazezi, bullgari e greku kishin gjetur ditën për t'i rënë në qafë për t'ia rrëmbyer si qentë e tërbuar nga një copë të madhe toke. Më vonë, duke parë qartë qëllimin pse i burgosnin të vëllanë, të shoqin, shokun e shkollës, ajo tha: "S'durohet më, duhet mbaruar me këto siklete. Qau hallet me fqinjën e saj, mikeshën dhe mori vesh se kudo kish lotë e zi, kudo urrejtje e mjerim- kish burrin të burgosur… shtëpinë të grabitur. I mungonte edhe fqinjës, mikes… buka e mirë, mishi, gjalpi, vaji dhe kripa, i mungonte çorapja dhe këpuca, rroba e shtresa…" Se Kosova ishte në zi. Dhe s'qe shumë zor për gruan shqiptare të njihte se kush qe shkaktari, e njohu, e urrejti dhe u betua…"Do ta ndiqte, në rast nevoje do ta vriste." Prandaj e ndjeu nevojën të radhitej në prapavijat e frontit të bijve të saj, të radhitej edhe në krahun e tyre… "Jo vetëm pse kështu bëhej me djemtë e vet, por pse ajo njohu Jugosllavinë "si armiken e betuar të popullit, mbi të gjitha, si armikun numër një të saj", të femrës shqiptare.

"Oficeri serb u dha urdhër ushtarëve të hyjnë me të fortë në Konsullatë… Familjet shqiptare që ishin brenda u vranë pa mëshirë. Edhe të plagosurit i vranë dhe i therën në shtrat. Gratë e fëmijët i vranë… Disa nga serbët edhe i ndynë kufomat!" Kështu kishin vepruar serbët tamam në kohën që kishin përfituar nga lufta e "Prometheut kundër të

gjithë perëndive", nga lufta pra e popullit shqiptar kundër turkut, në radhë të parë, e pastaj edhe kundër serbit, malazezit, bullgarit që i përkrahte me të madhe "majka Rusija" e që donin të shkelnin tokat shqiptare (më 1912) dhe tamam atëherë që i thoshin botës se shqiptarët nuk janë gjë tjetër pos disa fise barbare, që s'dinë ç'është civilizimi dhe s'meritojnë të kenë shtet të pavarur.

Dhe ky ishte vetëm prologu i tmerreve që do të shihte populli shqiptar i Kosovës, i cili hyri në robërinë e gjatë dhe të errët jugosllave pikërisht ditën që në Shqipëri u shpall pavarësia, më 1912. Kusuri i këtyre tmerreve është shënuar në kujtesën e gjyshërve dhe të etërve tanë, si dhe në rezistencën heroike të popullit në krye me Shotë dhe Azem Galicën etj. Në një anë, Shota u shtrëngua të dalë krah me burrin në mal, për të luftuar me dhjetëra vjet kundër armikut barbar – xhandarmërisë dhe ushtrisë jugosllave, për ta vazhduar bashkë me çetat e lirisë këtë luftë të rëndë heroike edhe pasi u vra i shoqi, heroi Azem Galica. Në anën tjetër, nëna shqiptare, e cila e di se "gjaku i trimave s'humb më kot, por tokës i jep jetë", ia këndoi të birit këngën e arratisë, këngën e fshatrave dhe qyteteve të djegura bashkë me pleq, gra e fëmijë nga xhandarmëria dhe nga ushtritë koloniste serbe e malazeze, këngën e vargut të pakëputur të barbarizmave sllave nga më të mëdhatë që ka përjetuar mbi kurrizin e vet rruzulli tokësor. Po vetë s'u dha që s'u dha: rrembat e tokës stërgjyshore ia ushqen nënës, gruas e vajzës shqiptare dashurinë e madhe për tokën, për gjuhën, për doket dhe zakonet e të parëve. Detyrë e saj kryesore ishte bërë që, në një kohë rremetesh në skllavërinë jugosllave, atë dashuri t'ia përcillte djalit dhe vajzës bashkë me gjirin që u jepte! S'deshi të dijë për vuajtje e masakra, ato iu bënë bukë e përditshme. Dhe , tha: "Të zhbirosh me sytë e zemrës, është më mirë se sa të fyesh nga kurrkushi" dhe qëndroi sypatrembur e kokëlartë. Aq bukur e aq natyrshëm i dilte asaj kënga e nënës që duhet për nderin e të birit:

S'di në luftë në ka rënë,
S'di me nder në ka luftuar,
Mos armiqve u është dhënë,
Mos gjëkundi është harruar?
Sa për nder të Shqipërisë
Në ra djali "falur qoftë"
Se nga zemra s'them të keqen
Shqipëria veçse rroftë!

Sëfundi shpresat e shqiptarit u tradhtuan pas Luftës II Botërore. Bashkë me vëllezërit nga Shqipëria, shqiptarët e Kosovës kishin luftuar për tokat e veta të begata dhe kishin pritur ta gëzonin jetën dhe shtetin e përbashkët shqiptar. Por, ndonëse tokën tonë e lamë me gjakun tonë të shtrenjtë, duke ndihmuar edhe për çlirimin e popujve të Jugosllavisë, sllavi e greku, me ndërmjetësimin e fuqive të mëdha… sërish i shtrinë kthetrat e tyre mbi tokat tona dhe na vunë kufirin me Nënën Shqipëri, stabiliteti dhe mbarësia shtetërore e së cilës jo vetëm që dëshmojnë se shqiptarët dinë të qeverisen dosido, por ata në këtë punë mund të mbajnë edhe flamurin e nderit.

Por, sikundër më herët, pushtuesi jugosllav ka bërë edhe kësaj radhe një llogari të gabueshme. Kur i pushtoi, me ndihmën e të tjerëve dhe duke u shërbyer me tradhti, tokat shqiptare të Kosovës, të cilat i la të ndara në banovina ndërmjet Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi, për t'i bërë sa më lehtë zap, ai harroi ç'kishte bërë ndër shekuj shqiptari kundër pushtuesve shumëfish më të zotët – romakë, bizantinë e turq dhe me logjikën e një fodulli,

pandehu dhe tha: “Gjatë një brezi të gjitha punët do të ndreqen”, “”Për dy vjet, në katundet e pushtuara, asnjë nuk do të guxonte të fliste shqipen”. Dy vjet???

Jemi dëshmitarë se nga ai kërcënim kanë kaluar plot 68 vjet presioni çnjerëzor për shfarosjen dhe asimilimin e shqiptarëve, kurse gjuha shqipe sot flitet më thekshëm se kurdoherë në trojet shqiptare të Kosovës! Dhe për të gjithë këtë vitalitet, në masë të madhe i detyrohemi nënës, motrës, gruas shqiptare. “Ato që vdisnin sikur s’kishin jetuar kurrë, kur gjaku, në cep të minderit, u ngrinte ndër dej” të këputura nga barra e shumëfishtë e shekujve, i thanë tmerrit të shtyhej tutje dhe tokës shqiptare i falën shumë fatosa me të cilët do të mund të mburreshin shumë kombe të mëdha.

“Shpirti në gjirize, ç’duan në tokat e shqiptarëve”? pat klithur gjyshja e Mic Sokolit për sllavët, nëna e Azem Galicës, vetë Azemi me të shoqen, heroinën Shotë dhe patën rrokur armët kundër serbit e malazezit, armët me të cilat i lanë nam Shqipërisë dhe i futën tmerrin armikut që po ia shkretonte tokat dhe njerëzinë.

Shpirti në gjirize, ç’duan në tokat e shqiptarëve – i ra hise të thotë po për këta sllavë shovinistë edhe gruas së sotme shqiptare, kosovares së re dhe të futet drejtpërdrejtë në frontin e sotëm të luftës politike, me perspektivë fare të afërt për t’u shndërruar në një konflikt të armatosur, në luftë nacionalçlirimtare.

Me indinjatën e thellë për torturat që i bëhen sot kosovares në burgjet jugosllave, po me zemër të gufuar për aktin e saj të ndritshëm historik të inkuadrimit direkt në çështjen e madhe të lirisë, i falenderohemi, nënës, motrës, gruas shqiptare që na e forconi krahun e luftës dhe jemi të bindur se qysh sot mund t’ia themi të gjithë së bashku këngës:

Ik, o natë, po këndon agimi…

(Bashkimi, prill 1980, faqe 3. Ky artikull është ribotuar edhe në numrin dy të Lajmëtarit të lirisë, tetor-nëntor 1980, faqe 13-14)

11. Letër një shoqi intelektual

Tashmë dihet se në krye të frontit për çlirimin social e nacional të shqiptarëve nga Jugosllavia borgjezo-revizioniste dhe për bashkim me vendin amë Shqipërinë Socialiste, po depërtojnë disa nga forcat më përparimtare të intelektualëve shqiptarë të Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë. Por, dihet gjithashtu se një pjesë e madhe e intelektualëve tanë përkunden në gjumin e "ëmbël" të oportunizmit, të konformizmit dhe "izmave" të tjera, që e ngadalësojnë me të madhe realizimin e çështjes sonë të madhe. Seriozitetin historik kombëtar këta intelektual e marrin si çështje së cilës mund t'i kushtohemi nga çasti dhe si çështje që gjithmonë tjetërkujt i përket më shumë se atyre. Ata vazhdimisht presin një ´kohë të përshtatshme´ dhe ´një njeri të denjë´ që t´i thërrasë e t´i bashkoj në luftën e pashmangshme për çlirimin e tokave tona të zaptuara e kështu për realizimin e aspiratave shekullore të shqiptarëve, dhe vazhdimisht harrojnë se pikërisht nga radhët e tyre mund të dalë njeriu, të cilit do t´i shkoj përdoresh "ta mbledhë e ta sistemoj rebelimin e shpërndarë të shqiptarëve" . Jo dyzet vjet thotë një shkrimtar yni, - por as dyzet ditë harresë nuk t´i falte Shqipëria (…) Jo çdo lloj dashurie i hynte në sy Shqipërisë. Dashurinë ajo e donte të veçantë, atë lloj dashurie kur harrohet vetvetja, me dhembje, me ngut, me alarm."

Para detyrave dhe të drejtave që kërkon dhe ofron atdheu, të gjithë jemi njësoj. Por, s'do mend që për atdhe shumë më tepër i takon të luftoj atij që ka më shumë mundësi. E mundësi, ndër kryesoret, në kushtet bashkëkohore, është vetëdija e lartë kombëtare e

historike, e vënë pa kursim në shërbim të çështjes së lirisë. Në këtë drejtim, shoku intelektual dhe shoqja intelektuale, neve na kanë dhënë mend njerëzit e thjeshtë. Ata nuk iu ndanë asnjëherë luftës së ngulmët me mundësitë që kishin. Kurse ne, të shumtën e herave, s'e prishëm që se prishëm "qetësinë" dhe "rehatinë" tonë. Kemi shembuj të disa shokëve që për çështje kombëtare kanë rënë në burgje që në bankat e shkollës së mesme. Sot, pasi kanë dal në "liri", me përvoja të shtuara jetësore e revolucionare, dhe pasi kanë kryer edhe fakultete dhe kanë nxjerrë edhe vepra artistike e shkencore, ata rrëmbehen nga ndjenja disfatiste ose nga preokupime (mondene) në krijimtarinë shkencore e artistike, duke lënë bazën e këtij fenomeni, atëherë dalim te një konkludim absurd: për çështjen e atdheut bënë të luftohet në atë shkallë të zhvillimit të personalitetit intelektual, të cilën e karakterizon vrulli rinor; në standin tjetër, më të lartë, të zhvillimit, kur rrëmbimit e entuziazmit ia zë vendin përvoja dhe vetëdija e lartë, u dashka të vijë koha e pasivitetit revolucionar! Në çoftë kështu, atëherë edhe motivi i theksuar njerëzor i lirisë na del motiv i një sfere më të ulët të shpirtit të njeriut!

Ç'kanë pra këta intelektualë që të çajnë kokën dhe t'i trazojnë të përbrendshmet duke dërdëllisur dhe duke mbajtur "ligjërata" ethshme sesi nuk po ia dalin dot në realizimin e të drejtave dhe të lirisë krijuese në kuadër të sistemit fashist jugosllav? Nuk po dinë, vallë, a nuk po duan të dinë se, kur s'ke si t'i gëzosh të drejtat elementare kombëtare, është puna më e kotë në botë të kërkosh të realizosh të drejtat për krijimtari shkencore, artistike e kulturore, që janë pararojë e lirisë së vërtetë kombëtare e shoqërore?

Kjo është një mënyrë e mirë për të bjerrë energjinë intelektuale vend e pa vend. Dhe kjo zhvendosje e punktit fundamental, ku do të duhej të shkarkohej energjia intelektuale e kosovarit, dhe vendosja e tij në terrene të parrezikshme, mund të quhet një fitore e social-borgjezëve jugosllavë, në radhë të parë e UDB-së, mbi intelektualin shqiptar.

Një pjesë e këtyre intelektualëve janë rrëmbyer nga obsesioni i ndjekjes. Ata vazhdimisht i përgjon dhe ndjek dikush. Ata vazhdimisht, duke qenë të përgjuar e të ndjekur, u shmangen atyre punëve, për të cilat konsiderojnë se mund t'i dënojë përgjuesi dhe ndjekësi i tyre. Dhe në atë log, ku do të duhej të dilnim ne - e nuk dalim, sepse na ka mbërthyer obsesioni se jemi të ndjekur e të përgjuar - atje del dhe e merr fjalën ai, armiku. Kemi këtë rezultat: ndjekësi, përgjuesi fashist jugosllav është i organizuar, i stimuluar nga pushteti, intelektuali shqiptar është i çorganizuar dhe frikësohet nga shokët, vëllau, nga hija e vet; përparësia e agjentit dhe policit jugosllav vjen duke u shtuar gjithnjë në dëm të aktivitetit të intelektualit kosovar. Dhe kjo ndodh gjithnjë me kontributin që i japim ne vullnetarisht armikut. Sepse, ne duhet të dimë se "atje ku s'jemi ne, i lëmë shteg të hapur armikut".

Një lloj tjetër i intelektualit tonë ka firuar në ujërat amullore të pacifizmit. Parimi jetësor i tyre është vëllazërim-bashkim me të gjithë botën, pa dallim se a është fjala për qeveritë apo për popujt e ndryshëm. Në krah të kësaj ideologjie falso-naive, ata bëhen zëdhënës të "vëllazërim-bashkimit" të xhelatëve me viktimat e tyre, armë e heshtur tinzare për zgjatjen e jetës së shfrytëzimit të klasave dhe të popujve të shumëvuajtur. UDB-ja jugosllave, që s'lë gjë pa bërë për ta shfarosur popullin shqiptar të Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe të Serbisë, dhe të çdo ndjenje revolucionare, te ky lloj intelektuali ka gjetur një nga përkrahësit e heshtur por më besnik. Ky bir bastard i kompromisit pa kurrfarë kushti të favorshëm për vete, që hiqet se gjithë botën e ka vëlla dhe që aprovon edhe mjetet më barbare të gjenocidit mbi popullin e vet, duke bërë veshin shurdh e syrin qorr para përdorimit të atyre mjeteve, s'e ka për asgjë t'ia nxjerrë sytë fqinjit të parë, që e heton se merret me ndonjë aktivitet të shëndosh intelektual e revolucionar.

Për intelektualin tonë përparimtarë, sot shtrohet çështja:

Mos ka ardhur koha të mendojmë pak më ndryshe nga ç'kemi menduar më herët!

Ne sikur mjaftohemi me rezistencën spontane ndaj armikut tonë të tërbuar. Indinjohemi thellë për shpërnguljet e dhunshme, të vjetra e të reja, sidomos për këto të sotmet, që po bëhen në mënyrën më perfide, duke i falur Evropës shfrytëzuese krahë të lirë pune të djelmoshave kosovarë dhe duke eliminuar pjesën më vitale të armës nga fronti i ardhshëm i luftës së pashmangshme në Kosovë; indinjohemi për poshtërimet masive të shqiptarëve me dajak, me pretekst të mbledhjes së armëve apo të aktivitetit politik kundër Jugosllavisë; ne qajmë me lot për torturat barbare të ushtruara mbi vëllezërit tanë të burgosur politikisht që nga lufta e këtej, sidomos për këta që u burgosën këta muajt e fundit.

Ne vazhdimisht indinjohemi thellë dhe sinqerisht, por për të lëvizur nuk lëvizim fare. Dhe kur do të bëhemi forcë rezervë dhe për kur po e ruajmë energjinë tonë të madhe?

Mos ka ardhur koha të mbushemi njëherë mend se ne dhe vetëm ne, si gjeneratë jemi ata që na pret fronti. Nesër, kur të marrim t'i peshojmë punët tona, patjetër do të konkludojmë se mundësitë e aktivitetit revolucionar patriotik kanë qenë shumë më të mëdha. Kurse veprimet tona fare të vogla; në mos minimale. Edhe ky relativizim, kjo zbutje e "minimales" në "të voglën", s'është gjë tjetër pos punë e edukatës sonë të mangët, e cila nuk ka ofruar kritere reale për vlerësimin e veprave tona. Ne jemi vazhdimisht më të mirë nga ç'jemi në realitet. Por, kjo pasqyrë e idealizuar e vetvetes sonë, ky ngushëllim impotent se jemi duke bërë aq sa i kemi mundësitë, kur të kenë zënë të perëndojnë forcat tona si gjeneratë do të na bëjë të konkludojmë si gjithë të dëshiruarit. Sa pak kemi bërë e sa shumë ka pasur mundësi të bëjmë! Dhe ndjenjën vrastare të disfatës ta marrim me vete në varrin e mjerë të gjeneratës; sepse, çfarë jemi ne, as atëherë nuk do të marrim guximin fisnik për ta shpallur haptazi faqe botës seriozitetin tonë të mangët (të reduktuar deri në minimum) në përpjekjet për realizimin e aspiratave shekullore të shqiptarit të robëruar.

Gati poaq larg rrugës së vërtetë revolucionare për realizimin e aspiratave tona është edhe një lloj tjetër i intelektualit tonë: ai që çështjen e fitores mbi social-borgjezët jugosllavë dhe të çlirimit social e nacional të shqiptarëve e merr si një punë që mund të kryhet. Te ky profil i intelektualit tonë mund të gjejmë mjaft virtyte. Ai e do drejtësinë, barazinë, e do popullin dhe vendin e vet. Po veprimet e tij i karakterizojnë më shumë dëshira e flaktë për punë intensive revolucionare, por në kushte që atij do t'i garantonin doemos ngadhënjim të plotë të çështjes. Ndryshe, thotë ai, nuk bënë të luhet me zjarr. Në saje të paragjykimeve të tyre, çështja e lirisë bëhet punë e koklavitur. Sepse, po të varej nga dëshirat tona, ne lirinë do ta kishim gëzuar para sa e sa shekujsh. Sepse, siç dihet, robërinë s'e kemi dashur kurrë më shumë se lirinë. Pos kësaj, ka pasur raste historike kur të parët tanë janë çuar në këmbë me të madh e me të vogël për liri, po prapë liria s'është fituar.

Po të jetë puna vetëm te dëshira, edhe funksionarët shqiptarë në Jugosllavi, këta agjentë të titizmit dhe vasalë të mjerë të Beogradit, nuk do të kishin pasur asgjë kundër sikur ta ndanin pushtetin "e tyre" nga ai i Jugosllavisë; qoftë për ndonjë leverdi më të madhe ekonomike, por më të pavarur politike, qoftë për ndonjë kolltuk më të madh e më të butë. (Por, me kusht që viset shqiptare të mos bashkohen me Shqipërinë Socialiste, se atëherë ka rrezik edhe për kokën e tyre!) Po nuk është puna sistematike dhe gatishmëria për flijim që e shoqëron dëshirën e tyre fiktive për ndarje me Beogradin. Sepse, as puna e palodhshme revolucionare, as gatishmëria për flijim, nuk janë artikuj që shiten në treg të lirë. Ndryshe, ata do ta blenin para nesh. Qoftë edhe me kreditë e huatë e botës

kapitaliste imperialiste, të cilave, sikurse revizionizmi jugosllav, ia kanë hapur edhe ata dyert e shfrytëzimit barbar.

Gjithë ky kaos paragjykimesh, mendimesh e orientimesh si në jetën dhe në punën e përditshme, ashtu edhe në punën shkencore, artistike dhe në veprimtarinë revolucionare, nuk është i rastit në Jugosllavi dhe as Kosovë. "... Kapitalizmi botëror jo rastësisht e mbështet kaq shumë politikisht dhe financiarisht 'vetadministrimin' jugosllav dhe i mban iso propagandës titiste për ta shitur këtë sistem si 'formë të re të sprovuar të ndërtimit të socializmit' për të gjitha vendet." E ti, shoku intelektual, e di, më mirë se të tjerët, që pasojat më shkatërrimtare të këtij 'vetadministrimi' thyhen mbi kurrizin e Kosovës dhe se kaosi më i madh mbretëron pikërisht në viset shqiptare në Jugosllavi.

Luftën për fitoren tonë të ardhshme nuk mund ta shohim qartë "nëse nuk shohim se në situatat aktuale dhe në të ardhmen ekzistojnë dhe do të ekzistojnë një sërë hallkash të dobëta të zingjirit kapitalist botëror, në të cilat revolucionarët dhe popujt duhet ta zhvillojnë një veprimtari të pandërprerë, një luftë të organizuar, të paepur e të guximshme, që këto hallka të çahen njëra pas tjetrës! Lufta jonë nuk mund të ndahet me kurrfarë muri kinez nga lufta e përgjithshme e proletariatit botëror dhe e popujve të shtypur kundër shtypësve. Kurse, s'do mend që kontributi ynë në këtë luftë të madhe do të jetë pikërisht i plotë, në qoftë se atë e lidhim drejtpërdrejt me luftën kundër skllavërisë së shumëfishtë jugosllave: ekonomike, sociale, nacionale e kulturore. Edhe pa nënçmuar aspak armikun, me një përkushtim të madh revolucionar dhe me një gatishmëri për bashkimin e forcave dhe për 'mbledhjen e pezmit të popullit' tonë, ne do të mund të dalim faqebardhë para ardhmërisë, duke thyer hallkat e dobëta të Jugosllavisë titiste. Sot, siç dihet përgjithësisht, Jugosllavia ka "një pavarësi dhe sovranitet të cunguar, pse, veç, të tjerave, nuk ka një potencial ekonomik krejt të vetin. Pjesën kryesore e ka të përbashkët me firma dhe me shtete të ndryshme, prandaj ajo nuk mund veçse ta provojë në kurrizin e saj efektet shkatërrimtare të krizës dhe shfrytëzimit të huaj."

Këtë gjë e kanë hetuar popujt e Jugosllavisë, që sikurse ne përjetojnë skllavërinë e egër të "vetadministrimit" jugosllav, pabarazinë e pashembullt nacionale e sociale: këtë gjë e di bota dhe nuk ka hije të mburremi nëse edhe ne s'kemi kuptuar ende. Por turp i vërtetë do të jetë për ne atëherë kur çështjen ta kuptojmë në të gjithë vërtetësinë e saj të thjeshtë, e megjithatë, si deri më sot, nuk do të lëvizim vendit si gjeneratë që e ka mbi supet e veta gjithë përgjegjësinë aktuale, klasore, kombëtare e historike, duke lënë mënjanë gjithë ato "izma" të largëta, që shformojnë, çorganizojnë dhe shpërndajnë energjinë dhe vrullin e pjekurisë tonë revolucionare.

(Bashkimi, prill 1980, faqe 2)

12. PSE PËR HEKUBËN?

"Do të hani në paqe bukën e skllavërisë, në qoftë se dorëzoni armët menjëherë. Urdhëroni: të zhvishni në çast rrobat me ngjyrë të shkëlqyeshme dhe të visheni vetëm me shajak të zi, ose ngjyrë hiri. Të mos i lini më flokët t´ju rriten dhe kokën ta mbuloni me festen prej lëkure bualli. Të mos hipni mbi kuaj, mbi pela e mbi mushka. Të mbyllni oxhaqet në mënyrë që të mos keni marrëdhënie të drejtpërdrejta me qiellin e allahut nëpërmjet tymit, por ai të dal fjolla-fjolla nga dritaret dhe nga dyert tuaja, pasi t´ju ketë kapënisur të gjithëve, me plaçkë e bagëti e fëmijët. Të gjitha këto tersllëqe do t´ju hiqen vetëm pasi t´i tregoni me vepra e jo me fjalë sulltanit të madh, se e keni dëbuar nga shpirti juaj idenë e rebelimit." (I. Kadare, "Ura me tri harqe", f. 200, Tiranë 78.)

Këtë mesazh përhapnin para qindra vjetësh telallët e perandorisë turke. E merrnin dhe ia përcjellnin shoku-shokut, lumenjtë, fushat dhe shtëpitë anëpërtej Shqipërisë. Po

këtë mesazh çnjerëzor përhapin sot shtypi, radioja dhe televizioni jugosllav, duke porositur shqiptarët të rrinë siç janë, të binden e të heqin dorë nga lufta për ta gëzuar me vëllezërit e vet, e jo me të huaj, pasurinë e madhe nëntokësore e mbitokësore të tokave të veta dhe jetën në liri e bashkësi me vëllezërit e vet prej gjakut!

Në një anë, Jugosllavia mban nën thundër gjysmën e tokave të mirëfillta shqiptare dhe shfrytëzon e shtyp në mënyrat më të egra afro dy milionë shqiptarë! Në anën tjetër, zëri i saj jehon kumbueshëm: "Jetën e japim, Trieshtën s'e japim!" (para disa dekadash), ose, me një timbër të ri "patriotizmi", ajo sot klith "me një indinjatë të thellë" për një grusht sllovenë (në krahasim me numrin tonë) e kroatë në Korushkë! Për botën e qytetëruar të mbash nën thundër dhe në mënyrat më barbare afro dy milionë shqiptarë, me përpjekje të ngulmëta e të vazhdueshme për shfarosjen dhe asimilimin e tyre, dhe nga ana tjetër të angazhohesh, megjithëkëtë, si paternalist i dorës së parë për gjendjen e disa dhjetëra mija sllovenësh e kroatësh në Korushkë, është një paradoks, së paku një hipokrizi, të cilën nuk e ha dot njeriu që ka një lugë tru në kokë.

Rezoni, me të cilin maskohet ky paradoks, u përgjigjet llogarive naivo-epileptike të Jugosllavisë borgjezo-revizioniste. Ajo ende, si në kllapi, mendon se opinioni botëror s'i ka rënë në fije marifetit të saj. Sa u përket shqiptarëve, me këtë paradoks Jugosllavia mendon ta llogarisë si punë të ndrequr konfliktin me shqiptarët e robëruar, madje lidhur me këtë punë dëshiron të krijojë përshtypjen sikur konflikti ndërmjet shtetit jugosllav dhe shqiptarëve të robëruar është punë e harruar qëmoti. Ç'thoshin tërthorazi serbi, malazezi, maqedonasi?!? Ti je vërtetë shqiptar, thoshin ata, pasardhës i popullit më të vjetër në Ballkan, me një civilizim shumë të hershëm. Por s'ka gjë. Ke luftuar kundër romakut, bizantit, turkut, që kanë dashur të ta japin emrin e vet, duke shkelur tokën tënde. Por, tash që ke të bësh me sllavë, ani me sllavë jugu, historia jote aq e gjallë dhe qëndresa jote aq e patundshme në një lëvizje të përhershme përpjekjesh të të huajit për të të skllavëruar dhe për të të zhdukur nga faqja e dheut emrin, gjuhën, kulturën dhe fizikusin tënd kombëtar, sot që ke rënë në dorë të sllavit, të gjitha këto duhet të hynë në një fazë ngurosjeje të domosdoshme! Jo pse është i tillë momenti yt historik e kombëtar (ne jemi të vetëdijshëm se populli shqiptar në RPS të Shqipërisë po tregon një aftësi të pashembullt për vetëqeverisje dhe për lulëzimin e madh të shoqërisë – thonë ata), po pse kështu e do logjika ime – pushtuese. Të bëjmë se kinse po mburresh që unë po ta jap emrin tim, jugosllav (sllav i jugut), hymnin tim "Ej, Slaveni". Ti duhet të jesh i kënaqur nëse mëson të marrësh frymë si sllav, ta ndërrosh bioritmin tënd kombëtar, ta shkelësh historinë tënde dhe atdheun tënd!

Po për se? pyet shqiptari. Për Hekubën, vallë?! E ç'e ka shqiptari Hekubën (lexo: sllavin, sllavin e jugut, të veriut, të veri-perëndimit, jug-lindjes!)? As gjaku, as gjuha, as kultura, as doke e zakone, as historia e përbashkët (pozitive) se lidhin shqiptarin me asnjë sllav! (Bashkimi, prill 1980, faqe 5)

13. Ç'thonë kronikat e vjetra dhe të rejat?

Dy "fatosa" kishte, ndër shumë të tjerë, Jugosllavia, përkatësisht hegjemonizmi serb: Vasa Çubrilloviqin, shkencëtar, edhe sot anëtar shumë i nderuar e i përkëdhelur i Akademisë Serbe të Shkencave; dhe Ivo Andriqin, diplomat i ish-mbretërisë jugosllave dhe shkrimtar, madje edhe nobelist. Të dy këta "fatosa", njëri më 1937 dhe tjetri dy vjet më vonë, patën hartuar nga një elaborat për nevojat e mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve. Elaboratet e tyre pasqyronin mundësitë më optimale dhe rrugët më

efektive për ndarjen e Shqipërisë në sfera të përbashkëta interesi me Italinë fashiste dhe për shfarosjen e shqiptarëve, që kishin mbetur nga viti 1912 nën robërinë jugosllave, në Kosovë dhe në tri banovinat e Serbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë. Puna e tyre "patriotike" në planifikimin shtetëror të gjenocidit mbi shqiptarët, paraqet një pikë të mesme me traditën e gjatë të paraluftës dhe të pasluftës nga ana e Serbisë dhe Malit të Zi.

Në një kronikë shumë më të vjetër se ajo e Çubrilloviqit, në atë të vitit 1878, shqiptarët i shohim në tymin e barotit dhe të zjarreve mbi shtëpitë e djegura me gjithë katandi. Me djepa në shpinë, me ndonjë gjë të gjallë për dore dhe me një kothere bukë për të mbajtur shpirtin gjallë, shqiptarët lanë pas shpine shtëpitë e djegura në tokat e veta poshtë Nishit, Prokuples, Vranjës. Tërbimi i egër i Serbisë qe derdhur atëherë si rrebesh mbi popullsinë e pafajshme shqiptare, me të vetmin qëllim që, me terror ushtarak e policor, ata t'i lënë vatrat e tyre veriore dhe të rrudhen në drejtim të Kosovës e të Maqedonisë.

Dhe kur kishte ngjarë kjo?

Në kohën që vëllezërit e tyre në Kosovë dhe në të gjitha viset tjera të Shqipërisë po bënin luftë të lavdishme pa kompromis kundër perandorisë evro-aziatike, Turqisë! Pikërisht atëherë fqinjtë serbë, në vend që ta ndihmonin fqinjen e tyre, Shqipërinë e shumëvuajtur, e gjetën rastin t'i japin shqiptarit një grusht të tmerrshëm, t'i grabisin një pjesë të madhe të tokave, të cilat i mbajnë edhe sot.

Atë kohë, 1878-ën, dhe disa kohë të vona, më 1912-ën, kur me ndihmën e Turqisë, Rusisë Cariste dhe të "koncertit evropian" Shqipërisë iu shkëputën tokat më të begatshme: Kosova, Rrafshi i Dukagjinit, viset shqiptare në Serbinë e sotme jugore, ato në Maqedoninë perëndimore, pastaj Plavë e Guci, Ulqin, Tivat, Anamal, Hot e Grudë etj., që iu ndanë Serbisë dhe Malit të Zi – pikërisht atë kohë dhe të ngjashme Vasa Çubrilloviqi e Ivo Andriqi e ndjellin të çohet lugat për të dërmuar përfundimisht popullin shqiptar.

Cili shqiptar sot nuk është i informuar mirë për mizoritë që ushtroi mbi popullin tonë Jugosllavia e Paraluftës (simbolike e kësaj të Pasluftës)? Për reformën agrare qëllimi i vetëm i së cilës ishte shpronësimi i shqiptarëve dhe kolonizimi i tokave tona me serbë e malazezë. Për ndërrimin e dhunshëm të fesë ndër kisha, që do të thotë për ndërrimin e kombësisë dhe të gjuhës; për internimin e dhunshëm të njerëzve tanë në shkretëtirat e Anadollit? Për rrahjen, burgosjet, vrasjet, djegiet e fshatrave dhe qyteteve pa asnjë arsye të vetme?

Të vetmet forca që çliruan gjithë tokat shqiptare gjatë Luftës II Botërore, siç dëshmohet historikisht – ishin forcat shqiptare, të ardhura nga Shqipëria dhe të formuara edhe në viset e tjera shqiptare. Madje, këto forca dhanë një ndihmë të madhe edhe për çlirimin e territoreve të shumta joshqiptare, deri në Srem e Slloveni. Jugosllavia, nga ana e saj, edhe pse propagonte me të madhe luftën e përbashkët shqiptaro-jugosllave, një pjesë të madhe të forcave të veta të atëhershme e ngarkoi me detyra speciale për shkretimin e viseve shqiptare në Mal të Zi, Serbi e Maqedoni. Me atë rast nga dora e "komunistëve partizanë" jugosllavë u likuiduan më se dyzet mijë shqiptarë. Kjo do të thoshte se Jugosllavia jo vetëm që nuk e kishte harruar politikën e egër antishqiptare të regjimeve të mëparshme, por kishte ndërmend ta kultivonte vetë dhe vetë ta shpinte përpara atë politikë shoveniste. Një kohë të gjatë, me ndikimin e tradhtarëve Koçi Xoxe etj., ajo u përpoq ta shtinte në dorë edhe vetë Shqipërinë Socialiste, me propozimet e ngulmëta që Shqipëria të bëhej republikë e shtatë e Jugosllavisë.

Për fat të mirë, ky plan ra në ujë, pa kurrfarë perspektive, në saje të vigjilencës së popullit shqiptar të bashkuar rreth Partisë së Punës të Shqipërisë.

Por, me grabitjen e Kosovës dhe viseve tjera shqiptare që mban sot brenda kufijve të vet, Jugosllavisë i mbeti një mundësi tjetër për të shfryrë instinktet e veta fashiste-

shoveniste: i mbetën shqiptarët e robëruar të Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi e jugut të Serbisë. Kështu, më 1946, "në emër të internacionalizmit proletar! (!) shqiptarëve në Jugosllavi iu mohua e drejta për të mbajtur flamurin e vet kombëtar, me të cilin kishin luftuar dhe kishin derdhur gjakun e vet të shtrenjtë për çlirimin e tokave të veta, madje edhe të një pjese të mirë të Jugosllavisë; më 1947, tash në emër të "solidaritetit", nga drithnikët e shqiptarëve u mblodh edhe kokrra e fundit e drithit dhe iu shpërnda Jugosllavisë, ndërsa shqiptarët u detyruan, ad literam, të ushqehen me barishte për më se një vit.

Paralelisht, mund të realizoheshin edhe planet e mëdha të gjenocidit, të trashëguara nga e largëta dhe ajo e afërmja. Vetëm gjatë viteve 50, Jugosllavia shpërnguli nga viset shqiptare afro 500 mijë shqiptarë, që i çoi në Turqi, duke u bërë vend po aq kolonistëve të prurë në viset shqiptare nga Serbia dhe Mali i Zi. Në këtë kohë, Shkupi (i cili deri në çerekun e parë të këtij shekulli pat qenë vatër e patriotizmit dhe e luftës së shqiptarëve kundër egërsimit aziatik të Turqisë), ishte bërë qendër për "eksportimin masiv të shqiptarëve në Turqi. Do theksuar se për shqiptarët që merrnin rrugën e shpërnguljes, organet jugosllave, siç kishte sygjeruar ministri agrar i Qeverisë, edhe të Jugosllavisë së "re", në referatin e mbajtur më 1937, para ekspertëve "patriotë" qeveritarë serb, shovenisti i tërbuar V. Çubrilloviqi, i cili kishte kërkuar dhe bërë lehtësime të mëdha administrative e të tjera.

Që fatkeqësia e shqiptarëve të kishte doemos kontinuitet, Sigurimi Shtetëror Jugosllav ishte kujdesur, prapë me sygjerimin e ideologëve të vjetër e të rinj, që burgjet jugosllave për çdo sezon të ri të mbusheshin me të burgosur politikë shqiptarë, të cilët e kundërshtonin diskriminimin. Kështu menjëherë pas lufte ranë në dorë të gjyqit jugosllav dhjetëra grupe e organizata patriotike të shqiptarëve, të cilat Jugosllavia jo vetëm që i dënoi me burgime të rënda e me mundime çnjerëzore, por edhe i kualifikoi si organizata prosovjetike (sipas stilit të klikës titiste), që ishte anomalia më e madhe që trilloi hegjemonizmi sllav.

Më 1956 UDB-ja, e cila po bëhej gjithnjë më nervoze ndaj stoicizmit të shqiptarëve, që nuk largoheshin dot nga trojet e veta dhe ua prishnin planet borgjezëve jugosllavë, e çori maskën dhe doli me një aksion barbar për mbledhjen e armëve nga radhët e popullit shqiptar. Meqë shqiptarëve u ishin rrëmbyer armët qysh gjatë luftës dhe menjëherë pas saj, ishte vetë UDB-ja që ua "lehtësonte" barrën: ndërmjet agjentëve të vet, ajo u shitte armë atyre. Kështu, ka ngjarë që e njejta pushkë të shitet deri në 200 herë nga UDB-ja dhe 200 t'i dorëzohet policisë nga 200 persona të ndryshëm, që kanë fitua "dajak"! Të gjithë shqiptarët që thirreshin për dorëzimin e armëve, torturoheshin rëndë fizikisht: duke ndenjur tërë natën lakuriq, lidhur për ndonjë dru, në ujin e akullt të ndonjë kanali etj. Një pjesë e madhe e tyre, që s'u bëri ballë mundimeve, mbetën invalid ose vdiqën a u zhdukën në mënyrë misterioze nga ana e UDB-së.

Më 1968, nxënësit, studentët dhe intelegjenca përparimtare shqiptare u çua në demonstrata masive, që shtronin kërkesa vitale për popullin shqiptar: Kushtetutën e Kosovës, hapjen e Universitetit, dygjuhësinë. Demonstrata u shua me gjak. Megjithatë, disa vjet më vonë, Jugosllavia u detyrua, sado formalisht, t'i plotësoj këto kërkesa: u dha Kushtetuta e Kosovës, u hap Universiteti i Prishtinës, u përligj dygjuhësia. Ishte e natyrshme që kërkesa më vitale e demonstrantëve, e drejta për vetëvendosje deri në shkëputje, e cila formalisht figuron në Kushtetutën e Jugosllavisë, të mbulohej me plaf të rëndë heshtjeje.

"Ç'bënte... që linte akoma përmbi dhe legjenda të tilla!"

Lidhur me karakterin e sllavëve të Jugut në raport me popujt tjerë, kanë folur edhe Marksi dhe Engelsi. Sipas mendimit të tyre, sllavët e jugut, kompleksin e nënshtrimit nga

të mëdhenjtë, e kompensojnë në mënyrë të shumëfishtë e brutale ndaj popujve të vegjël, mbi të cilët kanë ndonjë pushtet. Pas disa të dhënave, që do t'i japim këtu më poshtë, shihet qartë vërtetësia e këtij mendimi.

Fraza më e dashur e Jugosllavisë, e cila trumbetohet sa herë të shfaqet rasti i përshtatshëm në mjetet e informimit publik, është një frazë tipike e kolonizatorit: Jugosllavia do bëjë çmos që ta nxjerrë Kosovën nga prapambeturia ekonomike e sociale, Federata do të ndaj ndihma të jashtëzakonshme për zhvillimin e shpejtuar të Kosovës. Përshtypja e pjesës së painformuar të opinionit është se Jugosllavia është dërmuar duke ndihmuar Kosovën, por kjo, Kosova, si një pus i pafund, kurrsesi të ngopet!

Ndërkaq, Milija Kovaçeviqi, në cilësinë e kryetarit të Komisionit ekonomik që e përfaqëson Kosovën në Federatë, shkruante para disa vjetësh në gazetën e përditshme "Rilindja": "Që nga viti 1947 e deri më 1977, për çdo dinarë të investuar në Kosovë, ka marrë nga Kosova dy dinarë e gjysmë".

Si merren nga Kosova dy dinarë e gjysmë etj.?

Dihet se Kosova është një trevë e begatshme me pasuri natyrore, me minerale të shumta, toka pjellore shumë të përshtatshme për bujqësi. Rezervat e saj të qymyrit, të zbuluara deri më tash (shënimet që do të japim këtu telegrafisht, janë kryesisht nga statistikat kosovare e Jugosllave për vitin 1978, sipas shtypit) arrijnë në rreth 12 miliardë tonelata, apo 64% të rezervave të përgjithshme në Jugosllavi, 24% të rezervave të nikelit dhe të hekurit, 67% të rezervave të plumbit dhe zinkut, 28% të rezervave të magnezit etj. Kombinati "Trepça" është prodhuesi më i madh i plumbit në Jugosllavi e Evropë dhe zë vendin e tretë në botë; kombinati "Kosova", që përfshin minierat e qymyrit, termocentralet e Obiliqit, më 1978 prodhoi 8 milion tonelata qymyr, alias 3 miliardë e 485 milionë kilovatorë energji elektrike.

Me një trajtim normal të gjithë këtij potenciali, Kosova do të kish qenë një nga viset më të zhvilluara në Jugosllavi. Mirëpo, të gjitha minierat dhe objektet kyçe të ekonomisë kosovare mbahen nën kontrollin rigoroz të Beogradit, në institucionet e të cilit përqëndrohen të gjitha studimet dhe analizat lidhur me ngritjen dhe shfrytëzimin e tyre. Këto institucione vazhdimisht "kujdesen" që minierat dhe potencialet tjera të shfrytëzohen sa më intensivisht, si burim i pashterrshëm për lëndët e para, të cilat do të përpunohen në viset e tjera të zhvilluara në Jugosllavi, ndërkohë që në Kosovë nuk ngriten objekte industriale që do të absorbonin ndonjë numër optimal të fuqisë punëtore, që do ta përpunonin vet, në vend, lëndën e parë. Përkundrazi, Kosova vazhdimisht mbetet furnizuese e rëndësishme e Jugosllavisë me lëndët e para, të cilat pastaj, të përpunuara i blen me çmime njëzet fish më të shtrenjta.

Në të vërtetë, gjithë ekonomia e Kosovës ka marrë atë drejtim që në çdo hap t'i përgjigjet zhvillimit dhe nevojave të viseve të zhvilluara të Jugosllavisë, kurse zhvillimin e saj, për gjendjen e saj të mjeruar ekonomike, sociale as që çan kush kokë. Dy, nga shumë objekte të tjera, janë shumë simptomatike dhe flasin për raportin e varshmërisë totale të ekonomisë kosovare nga ajo jugosllave: Fabrika e autopjesëve "Zastava" në Pejë dhe fabrika e thashmeve në Skenderaj. Në të parën prodhohen sedilje për prodhimet e "Zastavës" së Kragujevcit.

Dhe kështu me dekada, ekonomia e Kosovës po ecën me sediljat "kosovare" të "Fiatit jugosllav" dhe po vritet me thashmet "kosovare" të dyfegut serb.

Një pylltar serb pat vrarë para 20 vjetësh një bari shqiptar. Shkaku: bariu nuk ia jepte pylltarit, ashtu kot së koti, dashin që po ngjitte në bjeshkë. Për këtë arsye qe në burg tre muaj pylltari. Para dy vjetësh, këtë pylltar, të maleve shqiptare, e vrau i vëllai i bariut të ndjerë dhe për këtë vrasje u pushkatue (me pretekst se cënonte vëllazërim-bashkimin).

Kohën e fundit në Kosovë pati raste të ngjashme, apo identike, të cilat përfunduan në mënyrë identike. Ndërkaq, vitin e kaluar, në hurdhat e peshqve, në Istog, një polic serb vrau një djalosh shqiptar, i cili ishte gjunjëzuar te hurdha dhe kishte zënë një peshk. Polici, natyrisht, siç e kishte ditur opinioni i gjer kosovar, nuk u dënua. Por as për opinionin shqiptar kosovar, të rysur me përvojë të madhe në këtë drejtim, nuk krisi kiameti, ndonëse indinjata qe e thellë. Vetëm një gjë u kuptua definitivisht: shqiptari, është vetëm i kolonizuar në gji të Jugosllavisë, përkundër demagogjisë dyzetvjeçare.

Dhe, në një heshtje të rëndë, populli ynë ka zënë të evokojë fuqishëm këngën e të shpëtuarit, i cili duhet ta marrë pashmangshëm gjithë çështjen e fatit të vet në duart e veta.

Dhe Beogradi, i çuditur për paaftësinë e Institutit të vet për Shfarosjen e Shqiptarëve, klithi:
Ç´bënte (ky Institut) që linte përmbi dhe akoma legjenda të tilla?

"Është e mundshme që shqiptarët të zmbrapsen vetëm me anë të kolonizimit gradual, – ankohej Dr. Çubrilloviqi, – ky është i vetmi popull që arriti jo vetëm të mbahet gjatë mijëvjeçarit të fundit në bërthamën e shtetit tonë... por edhe të na sjellë dëme, duke shtyrë kufijtë tanë etnik (kupto: Serbisë) në drejtim të veriut dhe të lindjes... E vetmja mënyrë dhe i vetmi mjet është forca brutale e një pushteti të organizuar shtetëror, e pushtetin mbi ta e kemi pasur gjithmonë. Më 1912 e këtej nuk kemi pasur sukses me ta. Faji është yni, meqë këtë pushtet nuk e kemi shfrytëzuar si duhet. Për ndonjë nacionalizëm të tyre në dobinë tonë as që mund të flitet. Përkundrazi, duke u mbështetur te Shqipëria, ndër shqiptarët do të zgjohet ndjenja kombëtare, e nëse nuk i qërojmë hesapet me ta, apo nëse këtë çështje ia lëmë kohës, pas 20-30 vjetëve do të kemi një irredentë të tmerrshme, gjurmët e së cilës kanë zënë të duken dhe e cila, në mënyrë të padukshme, do t'i vërë në pikëpyetje të gjitha posedimet tona në jug."

Dhe, kjo ndjenjë kombëtare e shqiptarëve u zgjua vërtetë shumë më herët nga ç'parashikonte ministri i Titos, Çubrilloviqi, e cila ishte zgjuar me të madhe edhe në kohën e këtij "shkencëtari".

Qëndrimet e tilla të Jugosllavisë ndaj shqiptarëve patën për pasojë të logjikshme e të pashmangshme, në një anë stoicizmin e pashembullt, që është karakteristik për të kolonizuarit, e në anën tjetër një rezistencë e vazhdueshme, spontane dhe të organizuar, nga ana e shqiptarëve, si para Luftës II Botërore, ashtu edhe pas saj, deri në ditët e sotme. Ky qëndrim është në rrugën më të mirë që Jugosllavisë gjithçka t'i kthehet me të njejtën masë: dredhia medoemos dredhi, perfiditeti me perfiditet: në kushtet e diskriminimit ekonomik dhe politik, e sidomos në kushtet e terrorit të sforcuar ndaj patriotëve shqiptarë, të cilët sot po bien masivisht në burgjet e tmerrshme jugosllave, ka rrezik që trevat shqiptare të robëruara nga Jugosllavia, të detyrohen së shpejti ta aplikojnë edhe terrorin, si përgjigje ndaj dhunës shoveniste sllave të Jugosllavisë.

Duke pasur leverdi të madhe ekonomike nga kjo koloni, Jugosllavia sot ka mbyllur sytë dhe shurdhua veshët dhe nuk po don t'ia dijë për një rrezik të ri. Natyrisht, shqiptarët e robëruar duan t'ia dinë edhe më pak: ata kanë përpara vetëm një qëllim – çlirimin, dhe nuk do të pyesin për çmimin e lirisë. Për Jugosllavinë, ka gjithmonë një mundësi rezervë: tërheqja kufijve të vet të vërtetë, kur zjarri të bëhet i padurueshëm; ndërkaq për revolucionarët dhe për popullin shqiptar ka vetëm një alternativë: të presin të asimilohen, t'i shtrohen gjenocidit dhe ta bjerrin qenien e vet kombëtare në mënyrën më mizore nga dora e sllavëve të jugut, ose luftën e vet ta shpien deri në fund, deri në fitore, e cila arrihet vetëm pas formimit të shtetit unik të të gjithë shqiptarëve. Për sakrifica, të thuash, nuk ka fare vend të mendohet.

Kjo do të jetë përgjegjja e popullit shqiptar të robëruar nga Jugosllavia për egërsimin e pushtetit jugosllav dhe për të gjitha përpjekjet e këtij shteti që t'a asimilojë një komb dhe ta keqpërdorë në mënyrat më barbare.

Nervozizmin e policisë fashiste jugosllave, shqiptarët nuk e presin me frikë e nervozizëm të vet, siç kishte ngjarë në disa kohë më të hershme. Shqiptarët, duke ndier nevojën e pashmangshme për ta hedhur definitivisht zgjedhën jugosllave dhe duke u pajisur përditë më shumë me përvojë revolucionare, sa më shumë që po shtohet dhuna e terrori nga ana e Jugosllavisë, gjithnjë janë në pritje të shpërthimit definitiv të ithatit të hidhur, i cili ka mbledhur me shekuj.

E "Popujt nuk presin kurrë kot, siç pret njeriu ëndërrimtar te pragu i portës. Kur një popull pret diçka, kjo do të thotë se në thellësi të tij ai e mbrun atë që e pret."

(Bashkimi, prill 1980, faqe 5)

14. MANIPULIMET NË SHTYPIN E HUAJ

Duke bërë fjalë për disa shkrime për Kosovën që u paraqitën këto ditë në disa gazeta tona dhe gazeta të huaja të Perëndimit, Mahmut Bakalli, në këshillim tha si vijon:

"Siç e dini në disa vende në Kosovë, pati ca aksione armiqësore të nacionalistëve shqiptarë nëpërmjet të shpërndarjes së afisheve e parullave me përmbajtje armiqësore kundër vlerave themelore të revolucionit tonë e vëllazërim bashkimit tonë. Organizatorët e aksioneve të tilla armiqësore synonin të mashtronin një numër të rinjsh për qëllimet e veta armiqësore. Për shkak të cënimit të fryteve të revolucionit tonë, vlerave të sistemit të vëllazërim-bashkimit tonë, ndaj të cilave natyrisht jemi të ndieshëm, masat më të gjëra të punonjësve dhe të rinisë shqiptare dhe të të gjitha kombeve e kombësive në Kosovë, dënuan rreptë veprimtarinë e tillë armiqësore.

Rreth kësaj çështjeje në disa mjete të huaja të informimit në Perëndim po bëhen spekulime të ndryshme, në të cilat manipulohet me një numër të pasaktë e çuditërisht të madh të gjoja personave të akuzua që do të gjenden para gjyqit. Me atë rast ata shfrytëzojnë edhe shkrimet e papërgjegjësi nga kuluaret të disa gazetave tona të këtyre ditëve. Janë këto gjëra të pasakta e të trilluara, që do të kenë jetë të shkurtër. Të gjitha këto po aktualizohen në këtë rast të situatës komplekse ndërkombëtare me qëllim që të krijojnë përshtypjen për ndonjë situatë të jashtëzakonshme jostabile, që në Kosovë nuk është e tillë, për çka mund të bindet çdo kalimtarë qëllim mirë.

Ne s'kemi nevojë ta bindim askënd se në ç'masë kombet dhe kombësitë e Kosovës: shqiptarët, serbët, malazezët, turqit, myslimanët e të tjerë bashkë me kombet e kombësitë e tjera të Jugosllavisë janë të vendosur t'i mbrojnë frytet e revolucionit tonë socialist vetëqeverisës." ("Rilindja", 4 prill 1980)

Qeveria fashiste e Beogradit, me paralelen e saj në Prishtinë, ose është matufosur fare, ose ka një siklet të madh. Kohëve të fundit, e xigluar nga dora e vet, ajo po bën përpjekje monstruoze për t'i mbledhur muskujt e vet në një buzëqeshje sa më të natyrshme. Veçse gazi, me gjasë rrënjët i ka në ndërgjegjen e pastër dhe në shëndetin e mbarë – dhe Jugosllavia po e ndjell më kot këtë gaz si një gjë që i ka dalë qëmoti doresh. Në vend të saj, një ngërdheshje e llahtarshme po shpërndahet me ngërçe mbi fytyrën kolektive të qeverisë së socialshovinistëve të Beogradit dhe të renegatëve të Prishtinës.

Me këtë ngërdheshje, ata përpiqen t'ia hedhin botës sesi shqiptarët e robëruar në Jugosllavi nuk kanë kurrfarë armiqësie dhe kurrfarë perspektive për ndonjë konflikt të ardhshëm, të madh a të vogël. Dhe ne u besojmë, në njëfarë mase dhe në disa rrethana të caktuara: ata s'do të kishin qenë armiq të shqiptarëve, sikur ata, shqiptarët, nga Jugosllavia

të pranonin ofertën "bujare" për nënshtrimin e plotë ndaj shkeljes, shfrytëzimit dhe asgjësimit të plotë të shqiptarëve me anën e gjenocidit!

Ka harruar vallë kjo Qeveri se ka mundur të na shtypë e të na plaçkitë, por se nuk na e merr dot të drejtën për të urryer e për ta luftuar kur të na vi dita (e cila si po duket, është në prag.). Këtë të drejtë, ajo e di fare mirë, nuk na e patën marrë dot romaku, bizanti as turku; duhet të jesh i marrë e të mendosh se një Serbi, një Mal i Zi, një Maqedoni mund ta bëjnë atë që s'e bënë me ne fuqitë më të mëdha të tri kohëve. Popullit tonë ata i shkaktuan humbje të mëdha, që "nxirrnin aty-këtu gropa të thella mbi gjirin e tij të gjerë, por humbjet e bënin disa herë më të madh një popull".

Me shoun e madh të propagandës kundër – siç i quan ajo – "nacionalistëve" shqiptarë, dhe me injorimin dhe shtypjen e çështjes së shqiptarëve brenda kufijve politikë të Jugosllavisë, Qeveria e Beogradit është rrëmbyer nga një vetëkënaqësi absurde. Bashkë me renegatët e Prishtinës, ajo ka idenë se është duke lozur pjesën e vet jetësore teatrale, kurse gjithë bota përreth, në fytyrën e këtij dueti të fëlliqur, shikon lojën e arixhiut të mjerë me arushën kaba, e cila kërcen sipas daireve që bien në Beograd. Fjalët e mësipërme të Mahmut-titist-pashës dhe gjithë kampanja jugosllave kundër patriotëve dhe revolucionarëve shqiptarë, numrin e të cilëve shtypi e zvogëlon së paku për njëzet herë, s'kanë si kuptohen ndryshe.

Në këtë mënyrë, Qeveria e Beogradit, me një ndjenjë të topitur ndërmjet vetëkënaqësisë së marrë dhe dëshpërimit të pandreqshëm, po përpëlitet ta bindë veten dhe të tjerët se si shqiptarët, që jetojnë në tokat e veta nën robërinë jugosllave, i kanë qëruar që moti hesapet: qysh më 1912, më 1919, më 1945 etj. Dhe këtë të drejtë, të drejtën për të menduar kësisoji, s'ia merr dot kush këtij robëruesi fashist. Të drejtën për të menduar si ia do qejfi e nevoja. Sa i afrohet objektivitetit gjithë ky marifet, kjo është një punë tjetër. Kryesorja, ajo që na bën të lumtur, është fakti se konfliktin e kemi te dera, të gjallë: tokat e grabitura shqiptare dhe populli i shumëvuajtur shqiptar po i bien vetes prapa. Ata mendojnë se e fitojnë këtë luftë. Ne poashtu. E dikush këtu mund të gabohet keq. Të shohim se në anën e kujt janë drejtësia dhe vendosmëria e guximi. (Bashkimi, prill 1980, faqe 6)

15. PROGRAMI DHE STATUTI I FRONTIT TE KUQ POPULLOR

Si anëtar i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare nën Jugosllavi (LNÇKVSHJ), të dhënat që përmenden në këtë hyrje i kam mësuar nga Jusuf Gërvalla, shoku dhe ideologu i LNÇKVSHJ, në fund të korrikut 1981. Ato ngjarje të aktivitetit të tij, si anëtarë i LNÇKVSHJ, që m'i ka treguar e shpjeguar me kujdes e vëmendje, e quaj të drejtë dhe të arsyeshme t'i tregoj. Ata që janë të interesuar për historinë e kësaj periudhe kanë mundësi me i kontrollua faktet.

Diku në verën e hershme të vitit 1979 del nga shtypi numri i parë i gazetës "Bashkimi". Ky numër del si Organ i Frontit të Kuq. Pas arratisjes së Jusufit në Gjermani, rrethanat sillen në atë mënyrë që Jusufi ia fillon ta ndihmoj gazetën Bashkimi. Në saje të punës së Jusuf Gërvallës bëhet e mundshme dalja e numrit të dytë të Bashkimit, diku në shkurt 1980. Kah fundi i prillit 1980 del numri i tretë i Bashkimit. Edhe këta dy numra ashtu sikurse i pari dalin si Organe të Frontit të Kuq (pa mbaresën Populloor). Në maj 1980, Jusuf Gërvalla autorizohet ta shkruaj këtë Program dhe Statut të Frontit të Kuq

Popullor. Ky dokument është i pari në të cilin e ndeshim mbaresën "Popullor", dokument i përgatitur tërësisht nga Jusufi.

Kur Hysen Gega niset për Kosovë, nga banesa e Nami Ramadanit, ai merr me vete numra të shumtë të Bashkimit dhe këtë Program. Ky është programi i Jusuf Gërvallës e i Hysen Gegës, i pafalsifikuar. I armatosur me idetë e me qartësinë e Jusuf Gërvallës, Hysen Gega bëhet një nga militantët më të fuqishëm që ka pasur Kosova. Është koha që pas 30 vitesh ta sjellim në dritë këtë Program të pafalsifikuar të asaj kohe të lavdishme.

Në historinë e lëvizjes punëtore ndërkombëtare janë të njohura programe si p.sh. ai i Eisenach-ut, më 1869 (August Bebel), Gotha-s, 1875 (Ferdinand Lassalle), apo ai i Erfurt-it, 1891 (Karl Kautsky).

Në historinë e luftës për çlirim nacional e social të shqiptarëve nën Jugosllavi, vend të veçantë zen ky Program që mund të quhet Programi i Esslingenit-Sallagrazhdës-Lumthatit të Hysen Gegës.

Merita për kopjen e siguruar të këtij Programi i takon Faridin Tafallarit.

Qëllimi i botimit të këtij Programi ka të bëjë vetëm me ndriçimin e fakteve historike. Por është edhe një e vërtetë tjetër, se fatin dhe efektin e vërtetë të fjalës së shkruar, fillimisht, askush nuk mund ta dijë.

Xhafer Durmishi, tetor 2010

Jusuf Gërvalla: "Më vjen një ditë, (vitin e kaluar), në derë me disa shkresurina që vetëm titullin e kishin të qartë: Programi dhe Statuti i Frontit të Kuq Popullor, dhe më lutet t'ia korrigjoj në pikëpamje drejtshkrimore. Më pastaj më autorizon që të preki, po e pashë unë të arsyeshme, „si njeri me përvojë", edhe në anën materiale të pikave të përfshira në program e statut. Mirë, them, dhe meqë përmbajtja e shkresurinave ishte pa kokë pa bisht, i hy unë punës me gjithë seriozitetin dhe ato pak njohuri që kisha. Gjithmonë kisha parasysh, pas punës sime, ai do t'ua kthente shokëve për diskutim Programin dhe Statutin e Organizatës së tyre. Por, doli ndryshe. Doli se I. K. i ishte tekur të bënte një natë pa gjumë dhe të hartonte këmbadoras një program dhe statut të një organizate revolucionare, të cilin e botoi dhe e shpërndau si „literaturë revolucionare" menjëherë pas „korrigjimeve" që i bëra unë. E puna që kisha bërë unë më atë rast, s'ishte punë korrigjimi." (Raport Komitetit të Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, 31 korrik 1981)

"Ka ardhur koha që komunistët të shtrojnë haptazi përpara gjithë botës pikëpamjet e veta, qëllimet e veta, aspiratat e veta dhe përrallave për fantazmën e komunizmit t'u vënë përball një manifest të vetë partisë." Marksi dhe Engelsi

"Pika qendrore e edukimit internacionalist të punëtorëve në vendet shtypëse duhet patjetër të jetë propaganda dhe mbrojtja nga ana e tyre e lirisë së shkëputjes së kombeve të shtypura. Pa këtë nuk ka internacionalizëm. Ne kemi të drejtë dhe duhet ta trajtojmë çdo socialdemokrat (kupto komunist) të një kombi shtypës, i cili nuk e bënë këtë propagandë si imperialist dhe maskara." Lenini

"Formimi i një fronti revolucionar të përbashkët është i pamundshëm, nëqoftëse proletariati i kombeve shtypëse nuk përkrah drejtpërdrejt dhe në mënyrë të vendosur

lëvizjen çlirimtare të popujve të shtypur kundër imperializmit të ”atdheut” të vet, sepse ’nuk mund të jetë i lirë një popull që shtyp popuj të tjerë’. Engelsi”

(...)

”Bota ndodhet në një fazë ku çështja e revolucionit dhe çlirimit kombëtar të popujve nuk është vetëm një aspiratë e një perspektivë, por edhe një problem i shtruar për zgjidhje.”
”PPSH mbështet dhe përkrah me të gjitha forcat luftërat e drejta të popujve liridashës...”
Enver Hoxha

PER NJE SHQIPËRI SOCIALISTE TE TE GJITHE SHQIPTAREVE!
ME PUSHKE DHE PENE PER LIRI E PAVARESI!

”MA MIRE NJE PUSHKE NE MAL SE NJE THES FJALE NE PARLAMENTIN E BELIGRADIT”. AZEM GALICA

PROGRAMI DHE STATUTI I FRONTIT TE KUQ POPULLOR

PROGRAMI DHE STATUTI I FRONTIT TE KUQ POPULLOR është hartuar nga një grup shokësh, të cilët qenë të autorizuar. Për shkak të pamundësive, që janë evidente gjatë ilegalitetit të plotë, nuk qe e mundur që PROGRAMI DHE STATUTI të aprovohen në një konferencë të rregullt, ku do të merrshin pjesë përfaqësuesit.

Si i tillë, është i plotfuqishëm gjer sa ta krijojmë mundësinë për ta thirrur tubimin përkatës, i cili do analizojë edhe materialet e grumbulluara, që kanë të bëjnë me analizat rreth PROGRAMIT DHE STATUTIT tonë, analiza të bëra këto nga çdo militantë i Organizatës!

PROGRAMI

Populli shqiptar, për të çarë me sukses frontin në luftë kundër pushtuesve të egër fashistë gjermanë e italianë, ishte bashkuar dendur rreth organizatës së vet masive, FRONTI NACIONAL ÇLIRIMTAR, Organizatë që qe formuar dhe udhëhiqej nga PARTIA KOMUNISTE SHQIPTARE, tani PARTIA E PUNES SE SHQIPERISE.

FRONTI NACIONAL ÇLIRIMTAR është formuar në prag të Luftës së Dytë Botërore. I formuar nga PKSH (Partia Komuniste Shqiptare) FRONTI NACIONAL ÇLIRIMTAR luftoi me heroizëm armikun.

FRONTI NACIONAL ÇLIRIMTAR dhe PKSH, të frymëzuara thellë nga internacionalizmi proletar dhe nga Revolucioni i Tetorit, bashkuan armët me forcat e Partisë ”Komuniste” të Jugosllavisë. Në bazë të luftës së përbashkët ishte marrëveshja që, pas ngadhënjimit mbi fashizmin, gjithkush të bëhej zot në shtëpinë e vet.

Parimi i Luftës Nacional Çlirimtare dhe antifashiste, pas së cilës do të fillonte një etapë e re e jetës dhe ndërtimi i socializmit, në njërën anë, si dhe mendimi se do të gjenin zgjedhje të drejt gabimet e pafalshme që ishin bërë ndaj shqiptarëve gjer atëherë, në anën tjetër, i shtynë shqiptarët të bëjnë sfidë në luftën e pakompromis kundër fashizmit. Në bazë të parimeve të tilla, populli shqiptar, që deri më atëherë jetonte në tokat e veta në Kosovë, në Mal të Zi, në Maqedoni dhe në Serbi, i jepej mundësia e ligjshme për dalje nga robëria e rëndë jugosllave, e paraluftës, dhe për bashkim me vendin amë,

SHQIPËRINË. Prandaj populli ynë nuk e kurseu gjakun e vet të shtrenjtë. Në ndjekje të fashistëve të egër ai vajti heroikisht deri në viset më të largëta të Jugosllavisë.

Por, në çastin e ngadhënjimit mbi fashizmin, kur populli ynë po bëhej gati t'i gëzohej realizimit të aspiratave shekullore, bashkimit të përgjithshëm kombëtar e shtetëror të shqiptarëve, piku një nga tradhtitë më të mëdha. P"K"J, me dredhi të papara, manovroi fuqishëm nën rrogoz dhe ia doli me sukses të siguroj për vete në mënyrë arbitrare kufijtë shtetërorë, brenda të cilëve sërish përfshihej më se gjysma e tokave dhe e popullit shqiptar. Kështu, robëria e vjetër e kralëve serbë u zëvendësua me robërinë e re serbomadhe, në krye me klikën revizioniste të Titos.

P"K"J, në bashkëpunim me çetnikët, të cilët ishin siguruar se në Jugosllavi nuk do të vendosej rendi shoqëror socialist, ripushtuan tradhtisht viset shqiptare dhe ia filluan këngës së vjetër – shfarosjes dhe asimilimit të popullit shqiptar. Madje, P"K"J nuk u mjaftua me kaq. Ajo duhej të çonte në vend edhe aspiratat e vjetra të borgjezisë serbomadhe për dalje të lirë në Adriatik. Prandaj me manovrime të reja, të ndihmuar nga disa tradhtarë shqiptarë, si Koçi Xoxe e Pandi Kristo, ia hyri edhe aksionit për pushtimin e Shqipërisë.

Vëllezërit tanë, në saje të vigjilencës së PPSH, e shpëtuan Shqipërinë nga ky rrezik i lig. Ata ishin tradhtuar njëherë nga P"K"J dhe nuk tradhtoheshin më. Por në kushtet konkrete që u krijuan pas Luftës së Dytë Botërore, kur në nivel të politikës ndërkombëtare, ne vend që të korrigjohej, u përforcua padrejtësia ndaj tokave dhe ndaj popullit shqiptar. RPS e Shqipërisë u gjend në aso situate që të mos mund të intervenojë për vëllezërit e vet të mbetur jashtë kufijve të shtetit shqiptar, sado që dihej se Jugosllavia i ripushtoi tokat shqiptare që i kishin pushtuar përpara kralët dhe tani po ushtronte terror të egër. Në këto kushte, çdo intervenim ushtarak i RPS të Shqipërisë në viset shqiptare në Jugosllavi konsiderohet përzierje në punët e brendshme të Jugosllavisë dhe tërheq me vete pasoja të rrezikshme, po të nivelit ndërkombëtar.

Megjithatë, mbetën mundësi tjera, me anën e të cilave RPS e Shqipërisë ndikoi shumë në qëndresën tonë. Duke fituar për vete (në saje të kultivimit të marksizëm-leninizmit të kulluar dhe të luftës së pakompromis kundër imperializmit, kapitalizmit, kolonializmit, neokolonializmit dhe revizionizmit modern) atributin e zërit më të fuqishëm në Evropë, Partia e Punës e Shqipërisë ndoqi me interes jetësor dhe me indinjatë të thellë edhe politikën diskriminuese jugosllave të gjenocidit mbi popullin shqiptar; e luftoi me ngulm këtë politikë, duke e denoncuar para forcave përparimtare të gjithë botës. Në këtë mënyrë për popullin shqiptar në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Serbi u bë e qartë se ai nuk është i vetmuar në luftën për çlirimin social e nacional nga revizionizmi i egër titist.

* * *

Bazuar në domosdoshmërinë e Luftës Nacional Çlirimtare, si të vetmen për sigurimin e pavarësisë së plotë kombëtare, bazuar në domosdoshmërinë e përgatitjes së masave për revolucion dhe vet revolucionit, i cili pos pavarësisë dhe bashkimit kombëtar, në pushtet sjell popullin, bazuar në diskriminimin klika revizioniste që po ushtron klika revizioniste e Beogradit, të cilit diskriminim duhet t'i ndajvehemi përkatësisht, bazuar në shfrytëzimin e paskrupullt që u bëhet viseve shqiptare në Jugosllavi nga ana e klikës në pushtet, bazuar në të drejtat elementare njerëzore, se edhe populli shqiptar (i tokave shqiptare të pushtuara nga Jugosllavia) ka të drejtë të gëzojë dhe rrojë i lirë, i pavarur, i lumtur dhe, duke përkrahur pa rezervë luftën e drejtë dhe politikën parimore, vigjilencën e PPSH dhe të Qeverisë Shqiptare, në krye me shokun Enver Hoxha, punëtorët, fshatarët,

mërgimtarët, të papunët, intelektualët revolucionar e patriot, e sidomos femra shqiptare, me një fjalë, të gjithë shqiptarët (e tokave të robëruara dhe në mërgim) e vetëdijshëm, që janë për çlirimin dhe bashkimin e të gjitha trojeve shqiptare të pushtuara, të cilët nuk dyshojnë në përkrahjen e motrave dhe vëllezërve të Shqipërisë , morën këtë

V E N D I M

Nga radhët e të lartpërmendurve, që dalin nga gjiri i popullit shqiptar, të robëruar nga Jugosllavia, të formohet Organizata FRONTI I KUQ POPULLOR e cila do të bashkojë punëtorët, mërgimtarët, komunistët, intelektualët dhe gjithë popullin patriot e revolucionar shqiptar të robëruar – në luftë për LIRI dhe PAVARESI, në luftë për BASHKIMIN e popullit shqiptar në një shtet të vetëm, SHQIPËRINË SOCIALISTE.

Kundër kujt do të luftojë FRONTI I KUQ POPULLOR?

Për FRONTIN e KP (Kuq Popullor) është i huaj çdo aksion jashtë tokave arbërore. Çdo akt i kundërt me këtë do të konsiderohet akt agresiv dhe do të dënohet nga vet FRONTI I KP.

Lufta kryesore dhe e vetme do të jetë lufta kundër robëruesit jugosllav, në krye me klikën titiste dhe shovinizmin sllavomadh (serb, malazez e maqedon) me qëllim të çlirimit social e nacional nga Jugosllavia dhe të bashkimit shoqëror e kombëtar me vendin amë, Shqipërinë Socialiste. Kjo është e drejtë legjitime e popullit shqiptar, i cili, megjithëse derdhi pa kursim gjakun e vet të shtrenjtë për tokat e veta të shenjta, u bë pre e apetiteve pushtuese jugosllave dhe e politikës diskriminuese të fuqive të mëdha.

Për viset tona derdhën gjakun gjyshërit dhe baballarët tanë, nga gjaku i të cilëve mbin pipat që sot arritën të formojnë FRONTIN E KUQ POPULLOR.

Nga FRONTI I KUQ POPULLOR do të jetë i luftuar çdo individ, grup a organizatë, që provon të bëhet pengesë në realizimin e vullnetit të popullit shqiptar. Do të luftohet hegjemonizmi, shovinizmi, borgjezia e burokracia e çdo lloji, pa marrë parasysh a gjenden në radhët e tyre serbi apo shqiptari. Do të luftohen të gjithë renegatët dhe tradhtarët shqiptarë, sahanlëpirësit e mashtruar nga klika titiste, që ushqehet tradhtisht me gjakun dhe djersën e popullit të robëruar shqiptar. Do të luftohet ”intelegjenca” që shiti idealet e veta, duke lidhur fatin e vet me pushtuesit apo me borgjezinë, dhe jo me popullin. Me një fjalë, lufta jonë do të ketë tiparet e një revolucioni të përgjithshëm socialist.

FRONTI I KUQ POPULLOR, duke studiuar kushtet aktuale dhe duke shfrytëzuar edhe mendimin e çmueshëm të PPSH lidhur me gjendjen e përgjithshme në Jugosllavi, ka nxjerrë përfundimin e drejtë se në Jugosllavi dominon një atmosferë e volitshme (pasi gjendja e vështirë ekonomike dhe politika pa principe e shfrytëzimi klasor kanë bërë të pakënaqur të gjithë popujt e Jugosllavisë) për shpërthimin e revolucionit. Të mbërthyer ndërmjet shfrytëzimit të egër të Perëndimit e Lindjes dhe politikës antipopullore të udhëheqjes titiste, e cila interesat e vendit i ka shitur fare lirë te imperializmi e socialimperializmi, popujt e Jugosllavisë ndodhen në prag të një revolucioni popullor. Duke përfituar nga kjo situatë, si dhe nga niveli i lartë i vetëdijes shoqërore e kombëtare të shqiptarëve që lëngojnë nën thundrën jugosllave, FRONTI I KUQ POPULLOR, duke u bërë pararojë e luftës për LIRINE E PAVARESINE e shqiptarëve dhe për bashkimin e tyre me vendin amë, do të luftojë pa kompromis për të vjelë frytet e revolucionit, të cilat janë në pjekjen përfundimtare.

Klika e Beogradit po i gërmon me të madhe varrin vetvetes. Por, po ajo nuk do të bjerë do në të, në qoftë se nuk e shtynë forcat revolucionare. Këtë detyrë i ka caktuar vetes FRONTI I KUQ POPULLOR.

Cilat janë metodat e luftës që bën FRONTI I KUQ POPULLOR?

Nën thundrën e klikës revizioniste të Beogradit, pos shqiptarëve, u merret fryma edhe popujve tjerë, të përfshirë brenda kufijve politik të Jugosllavisë, të cilët i shtrohen politikës në favor të borgjezisë titiste. Shfrytëzimi, burokracia, korrupsioni dhe dominimi i kapitalit të huaj, i kanë shtrirë përdhe interesat e këtyre popujve dhe sidomos të klasës punëtore e fshatarësisë. Në këtë kontekst, lufta do të ketë shumë pika të përbashkëta me luftën e ardhshme të punëtorëve dhe fshatarëve të të gjithë popujve që rrojnë në Jugosllavi. Solidariteti ynë në këtë drejtim nuk do të mungojë. Mirëpo nëqoftëse popujt e Jugosllavisë, kur të ketë shpërthyer revolucioni ynë në tokat shqiptare, i përgjigjen prapë ndërsimit të klikës titiste dhe borgjezisë shoviniste të atyre popujve për të na i ndaluar ne shqiptarëve të drejtat legjitime për çlirimin social e nacional, atëherë ne do të shtrëngohemi t'ua kthejmë grykat e armëve tona edhe këtyre popujve.

Meqë interesat tona klasore e kombëtare përputhen me interesat klasore e kombëtare të popujve të Jugosllavisë, ne nuk dëshirojmë luftë me këta popuj, pos me klikën revizioniste të Beogradit. Prandaj në kohë "paqeje", FRONTI I KUQ POPULLOR ka për detyrë që me propagandë të shëndosh patriotike dhe marksiste-leniniste, t'i çjerrë maskën përgjithësisht klikës së egër të Beogradit dhe të thërras në luftë kundër saj edhe forcat përparimtare të popujve tjerë të Jugosllavisë. Mbi të gjitha, forca e propagandës i drejtohet popullit shqiptar, në mënyrë që ai të përgatitet në baza sa më të shëndosha e më të forta për revolucionin e ardhshëm.

Kjo është etapa e parë, e përgatitjes së revolucionit tonë popullor. Nëpërmjet Organit të FRONTI I KUQ POPULLOR, gazetës "BASHKIMI", si dhe nëpërmjet literaturës marksiste-leniniste dhe literaturës tjetër revolucionare, që botohet me bollëk në RPS të Shqipërisë e që ne do ta shpërndajmë në mënyrë ilegale dhe ta popullarizojmë në radhët e popullit tonë (dhe të tjerëve, po që se ata shfaqin interesim), ne do ta shpiem përpara idenë e çlirimit social e nacional nga Jugosllavia dhe kështu do ta shtrojmë terrenin për revolucion. Popullit tonë do t'i bëhet me dije se lufta jonë është luftë e drejtë dhe se një luftë e tillë, kur të jenë bashkuar të gjitha forcat, nuk ka si të mos ngadhënjejë, pa marrë parasysh se me çfarë armiku kemi të bëjmë.

Detyrë e jonë e parë, pra, është që në kushtet e tashme të luftës jo të drejtpërdrejtë, të mësojmë si të sheshojmë dhe t'i mbrojmë interesat e revolucionit të ardhshëm dhe ta mbledhim rreth vetes popullin tonë të shumëvuajtur, në mënyrë sa më të shpejtë dhe sa më të organizuar.

Kjo punë nuk është aspak e lehtë. Ne kemi të bëjmë me një armik të majmur me gjakun dhe djersën e punëtorëve dhe të nxitur e të ndihmuar nga forcat e errëta imperialiste, kapitaliste, kolonialiste, neokolonialiste e revizioniste. Prandaj, në luftën tonë lypset mjeshtri e hollë dhe guxim shqiptar. E FRONTI I KUQ POPULLOR konsideron se mjeshtëria nuk do të mungojë, nëse lufta jonë bazohet në të drejtën e patjetërsueshme të shqiptarëve për të mbrojtur tërësinë e vet territoriale dhe kombëtare dhe në ndjekjen e rrugës përparimtare të klasës punëtore dhe të fshatarësisë, të vizatuar dhe zbatuar me konsekuencë të pashoqe nga PP e Shqipërisë. FRONTI I KUQ POPULLOR e di se nëpër këtë rrugë të pagabueshme mund të na udhëheq vetëm ideologjia e shëndosh marksiste-leniniste, prandaj shembulli i Partisë së Punës dhe i rezultateve të mëdha të ndërtimit socialist në Shqipëri, do të jenë për ne busulla e vetme.

Ai që mohon nevojën e pjesëmarrjes së femrës shqiptare në revolucion, e kështu në radhët e dendura të FRONTIT TE KUQ POPULLOR ai nuk është me FRONTIN... Gatishmëria e femrës shqiptare që, bashkë me forcat e përgjithshme revolucionare, të përforcojë radhët e luftës për liri, jo vetëm që konsiderohet e drejtë dhe detyrë e saj, por edhe do të çmohet lartë nga revolucioni. Kësaj detyre dhe këtij obligimi, femra shqiptare ka ditur t'i dalë zot edhe në periudha të tjera shumë më të errëta historike, duke dhënë kontributin e vet të pazëvendësueshëm. Ajo paraqet gjysmën aktive të popullit tonë dhe revolucioni ynë nuk mund të merret me mend pa pjesëmarrjen e saj, për cilëndo etapë që të jetë fjala.

Etapa e dytë, përfundimtare, e revolucionit tonë do të jetë lufta drejtpërdrejtë me armë; barrën kryesore të saj do ta ketë prapë FRONTI..., si Organizata më masive që grumbullon në radhët e veta të gjitha strukturat shoqërore të popullit tonë, të udhëhequra nga forcat komuniste (Partia Komuniste, po të qe e formuar.).

Pas bashkimit të tokave shqiptare dhe të popullit shqiptar me Shqipërinë edhe Organizata jonë do të shkrihet me FRONTIN DEMOKRATIK që sot vepron në RPS të Shqipërisë.

FRONTI I KUQ POPULLOR thërret të gjithë shqiptarët e robëruar në luftë për LIRI e PAVARESI, për shpartallimin e armikut shekullor, borgjezisë dhe pasardhësve e ithtarëve të saj, revizionistëve jugosllavë, në krye me klikën titiste.

STATUTI

FRONTI I KUQ POPULLOR është organizatë masive revolucionare, që tubon të gjithë luftëtarët e lirisë dhe të pavarësisë së popullit shqiptar në luftë kundër robëruesit jugosllav dhe kundër çdo armiku tjetër që do të bëhet prag për realizimin e të drejtave të patjetërsueshme të shqiptarëve për të jetuar në LIRI e PAVARESI.

FRONTI I KUQ POPULLOR tubon në radhët e veta të gjitha strukturat e tashme shoqërore në viset shqiptare të robëruara nga Jugosllavia titiste: punëtorët, fshatarët, komunistët, intelektualët revolucionarë, me një fjalë të gjithë popullin liridashës, që është i gatshëm për luftë çlirimtare kundër robërisë shekullore. Në gji të kësaj Organizate ushtrojnë veprimtarinë e tyre revolucionare të gjitha forcat e ndërgjegjshme, që s'e kursejnë as jetën kur këtë e kërkon liria kombëtare dhe klasore.

Detyrat dhe të drejtat e çdo anëtari të FRONTI I KUQ POPULLOR përcaktohen në përputhmëni me aksionet që shkojnë në interes të Lirisë Kombëtare dhe Klasore të popullit shqiptar. Prandaj lidhur me ato detyra dhe të drejta, çdo anëtarë i FRONTI I KUQ POPULLOR duhet të ndihet krenar dhe t'i qojë ato në vend, edhe kur realizimi i tyre bëhet në kushte të vështira që kërkojnë të flijohet edhe jeta.

Busullë e vetme për të gjithë anëtarët e FRONTI I KUQ POPULLOR do të jetë lufta analoge e FRONTIT NÇ, i krijuar nga PKSH në prag të Luftës së Dytë Botërore (prill 1942.) dhe historia e zhvillimit të PPSH, si pararojë. (FRONTI NÇ i udhëhequr nga PKSH, sot PPSH, luftuan për çlirimin e tokave shqiptare dhe për ndërtimin e Socializmit të vërtetë në atë pjesë të tokave që përfshinë brenda kufijtë e Shtetit Shqiptar të sotëm, të cilit Fuqitë e Mëdha ia shkëputën arbitrarisht më se gjysmën e tokave shqiptare.)

Te revolucionari i FRONTI I KUQ POPULLOR nuk duhet të ketë asnjë pikë dyshimi lidhur me ndihmën që do të na japin vëllezërit tanë në Shqipërinë e lirë, posa ne të kemi krijuar kushte të shëndosha për shpërthimin e revolucionit. Ata kanë detyrë dhe

nder ta bëjnë këtë punë. Historia e popullit shqiptar nuk i ka parë kurrë të shkëputura interesat e popullit në pikëpamje regjionale. Kështu do të bëhet edhe në të ardhmen.

Militantët e FRONTIT TE KUQ POPULLOR janë militantë të ngritjes së vetëdijes shoqërore e kombëtare të popullit të robëruar shqiptar; militantë të aksionit dhe të luftës së armatosur për LIRI dhe PAVARESI, posa të piqen kushtet për shpërthimin e revolucionit të përgjithshëm popullor.

Strategjia e punës dhe e luftës së FRONTIT TE KUQ POPULLOR do të jetë strategjia e PPSH, e cila e ka demaskuar dhe demaskon me ngulm revizionizmin dhe politikën e egër jugosllave të gjenocidit mbi shqiptarët në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi. Lufta e shokut Enver Hoxha kundër revizionizmit, strategjia e hollë dhe trimëria e pashembullt e Tij në mbrojtjen e interesave jetike të popullit dhe të Shtetit Shqiptar, do të jenë mësimet bazë për të gjithë anëtarët e FRONTIT TE KUQ POPULLOR dhe do të studiohen me kujdes në mënyrë kreative, duke iu përshtatur kushteve konkrete.

Për FRONTIN E KUQ POPULLOR, do të thotë për gjithë popullin shqiptar të robëruar nga Jugosllavia, armiku kryesor është socialshovinizmi serb, malazez, maqedonas, i ndërsyer nga shovinizmi sllavomadh i Kremlinit. Poashtu edhe shovinizmi grek është armiku ynë, pasi ai ushtroj një politikë diskriminuese dhe të egër e barbare mbi vëllezërit tanë në Qamëri. Meqë ky shovinizëm duhet të jetë i huaj edhe për popujt sllavë, sidomos për ata të Ballkanit, që janë gjithashtu të shtypur nga krerët e Moskës dhe të Beogradit, ne i ftojmë edhe këta popuj t'i bashkohen luftës sonë kundër revizionizmit dhe shovinizmit të egër.

Lufta jonë është e vështirë por e drejtë. Këtë e kanë kuptua edhe armiqtë tanë, revizionistët e Beogradit. Ata e dinë se fitorja do të jetë në anën tonë, prandaj përditë e më shumë po na shtrëngojnë me dhunë e me tortura. Për militantin e FRONTIT TE KUQ POPULLOR duhet të bëhet shembull qëndrimi i patundshëm dhe vetëmohues i revolucionarëve shqiptarë, me të cilët janë mbushur përplot burgjet anembanë Jugosllavisë. Ideali i këtyre revolucionarëve: Liria shoqërore dhe kombëtare, është njëherazi ideali i çdo anëtari të FRONTIT TE KUQ POPULLOR.

Pjesëmarrjen e vet aktive në FRONTIN E KUQ POPULLOR, militanti i kësaj Organizate duhet ta kuptoj si detyrë, të drejtë dhe nevojë për ngritjen e revolucionit. Revolucioni do t'i sjellë popullit LIRI dhe PAVARESI, do ta zhdukë shfrytëzimin e njeriut nga njeriu, shfrytëzimin e një kombi nga një komb tjetër. Për këtë arsye, çdo anëtar i FRONTIT TE KUQ POPULLOR brenda mundësive të veta, duhet t'i begatoj njohurit e veta sa më shumë për revolucionet dhe për luftërat çlirimtare.

Sjellja e çdo militanti do të jetë pasqyrë e FRONTIT TE KUQ POPULLOR, i cili është vepër kolektive e të gjithë militantëve të tij. Suksesi i FRONTIT TE KUQ POPULLOR, varet nga vetëdija, guximi dhe disiplina e militantit, dhe anasjelltas, suksesi i përgjithshëm i Frontit të KP e bënë më të vetëdijshëm, më të guximshëm dhe më të disiplinuar militantin e FRONTIT TE KUQ POPULLOR!

Meqë FRONTI i KP është organizatë ilegale, që punon në kushte shumë të vështira dhe rrezikohet vazhdimisht nga zbulimi dhe kapja e anëtarëve të tij nga ana e policisë fashiste jugosllave, militantët e Organizatës sonë masive, duhet të kenë kujdes edhe si marrin frymë. (Natyrisht, me kohë duke u pjekur kushtet, FRONTI i KP do ta legalizoj dalëngadalë punën e propagandën e vet, në mënyrë që i tërë populli të mund të përgatitet sa më fuqishëm për luftën e ardhshme Nacional Çlirimtare të armatosur.

Militanti duhet të ketë cilësi të caktuara.

- Në cilin do mes shoqëror që të gjendet, ai duhet të bëhet shembull për të tjerët me sjelljen e vet; kështu ai do të bëjë për vete një numër sa më të madh të njerëzve.

- Në çdo aksion ai duhet të hyj me bindje të fortë dhe me disiplinë të hekurt.

- Urdhëratë që merr nga baza, do t'i përfillë në tërësinë e tyre dhe pa vërejtje. Nuk do të bëjë asgjë në kokë të vetë dhe aksionin do ta kryej me përpikmërinë më të madhe.

- Lidhur me pakënaqësinë e vetë sa i përket ideologjisë, politikës, aksionit apo urdhrit të caktuar, ai do ta sqaroj FRONTIN E KUQ POPULLOR pasi ta ketë çuar në vend urdhrin dhe pasi ta ketë kryer aksionin.

- Këshillat, sugjerimet, urdhrat, militanti i merr nga baza. Por, edhe baza është e obliguar t'i përfillë këshillat, vërejtjet, sugjerimet dhe rekomandimet që vinë nga anëtarët e Organizatës.

- Militanti duhet të jetë kritik dhe autokritik. Kritika dhe autokritika duhet të jenë të shëndosha, joformale, dhe të sqarohen në varshmëri me gabimet, me natyrën dhe pasojat e gabimit të bërë. E drejta për kritikë ndjek rrugët lartë – poshtë (nga baza drejt lidhjeve më të largëta të militantëve.) dhe poshtë – lartë (nga anëtari i fundmë drejtë bazës.), natyrisht pas kryerjes së detyrës.

Vendimet bazë dalin nga komunistët, pasi të jenë analizuar në mënyrë kritike dhe pasi të jetë konstatuar se sjellin kontribut të padyshimtë për revolucionin. Me formimin e Partisë Komuniste Shqiptare (në viset e robëruara) FRONTI I KUQ POPULLOR do t'i organizojë masat rreth sajë, pasi PK do të jetë prezantuesja më e denjë e klasës punëtore.

Propaganda duhet të kryhet në çdo vend dhe në çdo rast e kohë; ajo duhet të jetë propagandë e shëndosh, që demanton dhe demaskon plotësisht realitetin revizionist jugosllav dhe sidomos politikën antishqiptare të Jugosllavisë.

Çdo rivalizim ndërmjet anëtarëve, duhet të jetë i huaj për FRONTIN E KUQ POPULLOR. Rivalizimi e shtynë "militantin" të punojë në kokë të vetë, gjë që ka për pasojë individualizmin dhe kështu humbjen e besimit te njëri – tjetri. Pasoja më e rënd e kësaj do të kish qenë krijimi i grupacioneve, që shpien në fraksion. Këto janë të dënuara nga FRONTI I KUQ POPULLOR.

Militanti duhet të dijë t'i dallojë armiqtë e ngjyrave të ndryshme dhe t'u jap atyre përgjegjen e duhur, atë përgjegje që do t'u jepte vetë populli, sikur të kishte një gojë dhe sikur ta lejonin të fliste.

Militanti duhet të jetë vigjilent; ta njoftoj organizatën për dyshimin më të vogël që ka hetuar në infiltrimin e armikut; të mësojë t'i dallojë sa më lehtë armiqtë dhe agjentët e UDB-së.

Çdo akt spiunazhi çmohet si tradhti ndaj popullit. Tradhtia e shokut dhe e çështjes është tradhti ndaj popullit dhe tërheq me vete dënimin e merituar.

Sabotimi i punëve të FRONTIT TE KUQ POPULLOR tërheq dënim të rëndë.

Renegatët shqiptarë, që janë lidhur pas qerres së revizionizmit jugosllav, konsiderohen tradhtarë dhe luftohen njësoj si vetë titistët.

Borgjezia shqiptare; kuaziintelektualët dhe të gjithë ata që nuk përcaktohen për rrugën e revolucionit, qoftë edhe pa dashur i çojnë ujë në mulli armikut, konsiderohen armiq dhe do të marrin dënimin e merituar kur të bëhet gjyqi i popullit.

Puna propagandistike dhe materialet e ndryshme që hyjnë në këtë punë, implikojnë shpenzime materiale, që duhet të përballohen nga të gjithë anëtarët e FRONTIT TE KUQ POPULLOR. Për këtë qëllim, çdo anëtar duhet të jap kontribute të rregullta, sipas mundësive. Shpenzimet implikohen edhe për ndihmën që duhet t'u jepet familjeve të të dënuarve në aksionet e FRONTIT TE KUQ POPULLOR, të cilët hyjnë drejtpërdrejt nën kujdesin e Organizatës sonë.

Çdo keqpërdorim i kontributeve materiale të mbledhura nga anëtarët e FRONTIT TE KUQ POPULLOR dhe nga ndonjë tjetër aksion më i gjerë, dënohet rreptë.

- TE RROJE POPULLI SHQIPTAR, I LIRE DHE I BASHKUAR!
- TE RROJE SHOKU ENVER HOXHA, QE PO NA NDRIQON RRUGEN E VEPRIMIT!

(...)

- RROFTE FRONTI I KUQ POPULLOR!

Jo – atyre që janë trima
me ngreh gishtin e krimit
por - atyre që janë trima
me shtri dorën e pajtimit!
Adem Dema-Demaçi
(romani: "Gjarpit e gjakut")

Luftë vëllavrasjes – Plagës së shëmtuar!

Qëndresa heroike dhe veprimtaria revolucionare e Shokut Adem Dema-Demaçi, duhet të jetë shembull veprimi i qëndrimi për të gjithë militantët shqiptarë!

FRONTI I KUQ POPULLOR

* * *

Nga fundi i dhjetorit 1922 në Junik u mbajt mbledhja e komandantëve më të njohur të çetave të Kosovës dhe të malësive, ku u vendos të përgatitej një sulm tjetër kundër forcave qeveritare në prefekturën e Kosovës (Kukësit) dhe, më vonë, të ngriheshin edhe krahinat tjera të Shqipërisë.

Përpara nisjes për veprim, tek vendi i quajtur "Verrat e Gjocës", Hasan Prishtina u mbajti një fjalim të zjarrtë 1200 kryengritësve, ku ndër të tjera tha:

"- Vllazën! Kërkojnë prej nesh që atdheun ta trajtojmë si mall tregu. Jo kurrë! Si dje, sot, nesër e përherë atdheu ka qenë dhe ashtu gjaja më e shejtë për ne. Të gjithë ta dinë se na nuk jena tue luftue kundër Shqipnisë e shqiptarëve, por për një Shqipni të lirë e të bashkueme. Nuk kemi dalë maleve me shpëtua vetëm një shtëpi, katund apo fis, po të tanë Kosovën, e cila mbështjell në gjinin e vet krejt vllaznit, qytetet e katundet tona. Ideja dhe parulla jonë ka qenë dhe asht: çlirimi e bashkimi i tanë Kosovës me atdheun tonë të përbashkët Shqipninë. Dhe për ta realizue këtë duhet veprim e jo fjalë, bashkim e jo përçamje, trimni e jo frikë.

Na kurrë s'kemi kujtue se lirinë ka me na e sjellë dikush së jashtmi. Jo, një mijë herë jo! Atë e kemi fitue dhe do ta fitojmë me gjakun tonë, sepse vetëm kështu ajo mund të jetë liri e vërtetë. Vetëm pushka jonë e jo dikush tjetër ka detyrua e do të detyroj armiqtë të lëshojnë nga duartë gërshanët, me të cilat duen të qethin copa të tjera nga trupi i atdheut tonë. E dijmë se anmiku është më i shumtë në numër, më i armatosur me armë dhe më i pasun me pare. Kështu ka qenë dje, kështu asht edhe sot. Por kjo as nuk na tremb, as nuk na përkul, përkundrazi kjo kërkon që na të jemi ma të fortë. Të peshojmë mundësit tona me guxim e mendje të kthjellët. Ne nuk e zvoglojmë rrezikun, në të kundërt ne u themi luftëtarëve se rreziku është i madh, prandaj bashkoni radhët, tregoni vendosmëni e guxim, flakni tutje burracakët, që mbjellin përçamje e frikë, përbuzni ata që çirren tue na këshillue të dorëzohemi sepse gjoja do të shuhemi.

Vllazën! Asht e vërtetë se një gabim taktik gjatë luftës mund të sjellë që kjo apo ajo çetë të thyhet përkohësisht, por kjo s'ka aq rëndësi për fundin e luftës. Politika e dorëzimit, e pritjes apo e kundërshtimit të aksionit kurrë nuk të çonë në fitore. Kush ka frikë ka me vete humbjen, kush qëndron i patundun ka me vete fitoren. Liri pa gjak nuk ka."

16. "BASHKIMI" BËN FUQINË

"Fronti Nacional Çlirimtar ishte Fronti unik i të gjithë popullit kundër armikut të jashtëm, që na kishte pushtuar vendin. Vija e Partisë në Front ishte për bashkim pa dallim klase, bindjeje politike, feje dhe krahine e të gjithë shqiptarëve të vërtetë, e të gjitha forcave patriotike e demokratike të vendit, e të gjithë atyre që ishin gati të luftonin kundër pushtuesve fashistë e tradhtarëve për një Shqipëri të lirë, të pavarur, demokratike e të popullit." Enver Hoxha

Liria nuk fitohet me vota. Dhe kurrë nuk ka ndodhur që pushtuesi të bëhet aq zemërgjerë sa t'ia kthejë një populli lirinë të cilën ia ka rrëmbyer njëherë. Vetëm lufta e vendosur dhe pa kursim e popullit të robëruar e heq qafe zgjedhën e huaj dhe botën e detyron t'ia njohë atij lirinë.

Në luftë kundër pushtuesit jugosllav dhe tradhtarëve shqiptarë, vasalë të qeverisë së Beogradit, ne nuk duhet të ushqejmë iluzione dhe t'i lejojmë vetes asi komoditeti që të ngelim jashtë rrymës së drejtpërdrejtë të stuhisë, qoftë në kuptimin e frazës reaksionare: " Ha përshesh, se ka kush i kqyr punët e fisit", qoftë në kuptimin e shmangies tonë për një kohë më të gjatë a më të shkurtër nga lufta, duke ndjekur vijën e rezistencës së ulët.

Dhe lufta jonë përballë një armiku të rrezikshëm, i cili gëzon edhe përkrahjen e forcave të shumta me afinitet të ngjashëm, do të jetë gjithsesi një luftë e vështirë. Faktori teknik, në kuadër të jetës nën një shfrytëzim të egër kolonial, është i pakët e edhe ai që është, është momentalisht në duart e armikut. Punonjësit dhe mbarë populli shqiptar në tokat tona të pushtuara jeton në skamje dhe mjerim dhe i ekspozohen jo vetëm shtypjes e grabitjes, por edhe një demagogjie e propagande të fuqishme revizioniste, e cila ka për qëllim ta përjetësojë pushtetin e huaj mbi popullin tonë.

Mirëpo, ne, po vepruam me përkushtim dhe energji patriotike e revolucionare, do të kemi në dorë një faktor tjetër vendimtar: faktorin POPULL. Kur të ketë hyrë i vendosur e i bashkuar në shërbim të luftës së drejtë çlirimtare, populli përbën një fuqi të jashtëzakonshme, e cila thyen çdo potencial teknik dhe numerik të armikut pushtues. Këtë e dëshmojnë luftërat çlirimtare dhe revolucionare në historinë e njerëzimit.

"Bashkimi" - gazetë e popullit

Organizata jonë masive, FRONTI I KUQ POPULLOR, dhe organi i saj "Bashkimi" kanë marrë përsipër detyrën e vështirë po të ndershme e të domosdoshme: grumbullimin dhe përgatitjen e forcave tona patriotike e revolucionare për luftën nacionalçlirimtare dhe bashkimin e tokave dhe të popullit shqiptar të viseve të robëruara me Atdheun e përbashkët, Shqipërinë socialiste.

Nuk ka kurrfarë leverdie dhe nuk është revolucionare të fryhen në mënyrë joobjektive rezultatet e arritura nga puna jonë. Do pranuar se këto rezultate, në kushte të vështira të ilegalitetit, kur për një fjalë goje dergjesh në burg, janë rezultate modeste. Mirëpo, nuk mund të mohohet as ndikimi i organizatës dhe gazetës sonë dhe depërtimi ynë gjithnjë më i madh në radhët e punonjësve dhe të masave popullore. Dhe, ç'është poashtu me rëndësi, tërbimi i armikut, si rrjedhim i punës sonë. Le të guxojë klika titiste ta lejoj shpërndarjen e lirë vetëm të një numri të "Bashkimit"! Le të dalë ai vetëm njëherë botërisht në fshatra e qytete, shkolla e fabrika - në trojet tona të robëruara! Natyrisht, ëndrra të tilla nuk shohim. Por, duke marrë me mend eventualitetin e tillë (absurd), do të shohim njëherazi efektin e fuqishëm të punës sonë, frikën e armikut për ekzistencën e vet dhe tërbimin e tij kundër së vërtetës, që ka për detyrë të sheshoj dhe që po e sheshon

"Bashkimi". Kjo frikë nuk do të ekzistonte, tërbim nuk do të kishte, nuk do të burgoseshin njerëzit vetëm e vetëm pse i është gjetur "Bashkimi" sikur armiku t'i kishte sendërtuar ëndrrat e veta të liga për degjenerimin dhe asimilimin e popullit shqiptar në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e në Serbi. Prandaj, në qoftë se ndonjëherë do të ligemi, të dëshpërohemi apo të bëhemi skeptikë, është një metodë e sigurtë për t'i njohur mundësitë dhe efektet tona: duke shikuar pasqyrimin e punës sonë në sy të armikut. Natyrisht, kjo u rekomandohet atyre individëve të vaktë, që vullnetin nuk ua cilëson çelikosja dhe rezultatet nuk ua jep puna sistematike dhe me gjithë qenien. Për pjesën e vetëdijshme të popullsisë sonë është e qartë njëherë e përgjithmonë se te ne kurrë nuk do të pinë ujë gënjeshtrat dhe demagogjitë që kanë për qëllim t'ia zgjatin jetën robërisë sonë. Prandaj, në këso kushtesh, leja për shpërndarje të lirë të një numri të gazetës sonë, do të kish qenë vetëvrasje për qeverinë revizioniste të Beogradit.

"Bashkimi" po fiton përditë e më shumë autoritetin e një gazete të popullit për popullin. Ne nuk do të gjunjëzohemi para torturave dhe terrorit që po ushtron armiku barbar mbi forcat tona patriotiko-revolucionare. Le të na burgosin, le të na torturojnë. Kjo është puna e tyre. Puna e mizorit që i ka të numëruara ditët. Puna jonë është të qëndrojmë ballëlartë e të paepur, ashtu si do t'ia shtiem edhe më shumë tmerrin pushtuesit. Dhe punës nuk do t´ia ndajmë deri në fitoren e plotë. Prandaj edhe ju mblidhni forcat, mos u bëni "amin" burgosjeve, ndjekjeve, frikësimeve e shantazheve. Kjo le të jetë përgjigja e popullit për terrorin e armikut. Ne, po na e dhatë të drejtën dhe mundësinë, jemi të gatshëm të vdesim në ballë të radhëve tuaja.

Përvetësimi i literaturës revolucionare

"Po deshëm që lufta jonë, nga një rezistencë spontane, të kalojë në luftë të organizuar për çlirimin kombëtar dhe klasor, atëherë para nesh shtrohet si domosdoshmëri studimi dhe përvetësimi i historisë kombëtare dhe i literaturës revolucionare marksiste-lenineiste. Zotërimi i kësaj literature nga avangarda jonë dhe popullarizimi i saj në masa ka qenë dhe mbetet detyrë primare për zgjimin e vetëdijes kombëtare e klasore të masave popullore dhe të punonjësve.

Nën kujdesin e Partisë së Punës të Shqipërisë, sot në Atdheun tonë socialist lulëzon një literaturë e begatshme revolucionare. Nga literatura e tillë, që duhet të përvetësohet në mënyrë të domosdoshme dhe të ngutshme, sidomos nga pararoja jonë revolucionare, donë veçuar këto pikëmbështetje kryesore: veprat e Marksit, Engelsit, Leninit, Stalinit e ato të marksist-leninistit dhe prijësit të madh shqiptar, shokut Enver Hoxha; historia kombëtare shqiptare, ajo e PPSH-së dhe dokumentet e PPSH-së; shtypi shqiptar, sidomos publikimet shkencore nga lëmi i historisë dhe ai i ndërtimit teorik dhe praktik të socializmit në Atdheun tonë.

Vetëm pasi të kemi përvetësuar këtë literaturë ne do të jemi të pajisur me një vetëdije të lartë kombëtare e klasore, e cila do ta bëjë më të sigurtë hapin tonë dhe depërtimin tonë në gji të popullit; me këtë vetëdije, forca jonë goditëse mbi armikun tonë shekullor, do të shumëfishohet.

Për një Shqipëri socialiste të të gjithë shqiptarëve

Lëvizja jonë, lufta jonë nacionalçlirimtare, revolucioni ynë, na shpien pikërisht te qëllimi ynë kryesor: te një Shqipëri socialiste e të gjithë shqiptarëve. Kjo aspiratë është vënë edhe në ballë të organit tonë "Bashkimi" në trajtë parulle.

Nëse lufta jonë nacionalçlirimtare synon çlirimin kombëtar të të gjitha trojeve tona të pushtuara nga Jugosllavia, atëherë jemi duke luftuar për një Shqipëri. Nëse pos çlirimit kombëtar synojmë edhe çlirimin klasor, atëherë jemi duke luftuar për një Shqipëri socialiste, e cila pas bashkimit të tokave që iu shkëputën padrejtësisht trungut shqiptar, do të jetë Shqipëria socialiste e të gjithë shqiptarëve.

Ai që bënë zhurmë duke na e mohuar një të drejtë të tillë, në thelb është reaksionar, sepse pikëpamjet e tilla janë kryekëput pikëpamje imperialiste, kolonialiste e revizioniste. T´i mohosh popullit tonë të drejtën e luftës nacionalçlirimtare, do të thotë të pajtohesh me robërimin e popujve, dhe kjo është antimarksiste e antilenininiste.

Bashkëpunimi internacionalist i forcave tona çlirimtare

Sa i përket bashkëpunimit internacionalist me forcat përparimtare në botë, Fronti i ka vënë vetes detyrë të përhershme afirmimin e luftës sonë të drejtë dhe ndihmën reciproke ndërmjet elementeve revolucionare. Më në fund, konsiderojmë se ngadhënjimi i luftës dhe i revolucionit tonë do të jetë njëherazi kontribut për fitoren e revolucionit socialist në botë. Në këtë drejtim rezultatet tash për tash janë modeste, por ato inkurajojnë për suksese të mira në të ardhmen.

Po kur është fjala për bashkëpunim me fqinjët e parë, çështje që parimisht duhet të ketë edhe vendin e parë, në këtë drejtim dalin pengesa të shumta. Në gjithë të kaluarën tonë fqinjësore, siç tregon përvoja shekullore, "Bashkimi i armëve(shqiptare) me fqinjët e Ballkanit ka qenë(për ne) vetëvrasje". Edhe më keq ka dalë puna në luftën e fundit. Në emër të internacionalizmit proletar dhe të frontit të përbashkët antifashist e nacionalçlirimtar shqiptari i pati bashkuar armët me serbin, malazezin dhe maqedonasin. Mirëpo udhëheqja e PKJ-së, pa mbaruar mirë lufta, e hodhi maskën dhe e tregoi qëllimin e vërtetë; ajo kishte bërë me shqiptarin marrëveshjen që mund të bëjë xhelati me viktimën me urdhrin e saj në Kosovë erdhën brigada e divizione partizane, që likuiduan mbi 40 000 shqiptarë të pafajshëm në emër të lëvizjes balliste. Pas lufte ishte e natyrshme që popull ynë, për gjakun e derdhur në Srem e Slloveni, të gëzonte një simpati sado të vogël së paku nga ana e popujve fqinjë sllavë, atë që nuk e gëzonin nga qeveria revizioniste. Po gjithë argumentet që mund të mblidhen nga fërkimet e popullsisë sonë me serbët, malazezët e maqedonasit bien më shumë erë shovinizmi të papërmirësueshëm nga ana e tyre, sado që ata kanë hyrë në borxh te ne e jo ne te ata.

Kështu çështja e bashkëpunimit në baza të internacionalizmit proletar me serbët, malazezët dhe maqedonasit për ne është gjë shumë e vështirë, ndoshta edhe e pamundshme. Megjithate, kur te këto popuj të kemi hetuar disponim të mirë për bashkëpunim mbi bazat e përmendura, ne nuk do ta refuzojmë.

Kolonët serb, malazez e maqedonas, që janë sjellë nga kralët e hershëm dhe të sotëm me qëllim që të popullzojnë tokat e pushtuara shqiptare dhe t'ua ndërrojnë atyre fizionominë etnike, me pretendim që të fitojnë të drejta "historike" mbi tokat tona, duhet të vendosin me kohë për qëndrimin që do të mbajnë karshi luftës sonë nacional-çlirimtare. Ata duhet të jenë të vetëdijshëm se, duke qenë të ngulitur këtu nga kralët, apo duke ardhur pas lufte në tokat shqiptare, ndërkohë që pjesa më vitale e shqiptarëve është e detyruar të emigrojë - për shkak të politikës diskriminuese të pushtetit beogradas ndaj shqiptarëve,

janë duke u bërë vegël e verbër në dorën e aspiratave shoviniste beogradase. Ne, shqiptarët, s'kemi si ta kuptojmë politikën e maqedonasve me diasporën e tyre të Egjeut, të cilën po e vendosin me favore të shumta në viset shqiptare, dhe të ashtuquajturit "egejci" po i bëjnë pykë për shtyrjen e shqiptarëve nga vatrat e veta.

Detyra të ngutshme

Jugosllavia është duke përjetuar krizën më të madhe në historinë e saj. Si bishë e plagosur për vdekje, ajo po e kompenson agoninë e vet me diktaturë e terror mbi popujt që ka mbërthyer ne kthetrat e veta të përgjakshme. Si gjithmonë, egërsia e saj po shprehet më së shumti mbi popullin e robëruar shqiptar. Kohëve të fundit po dalin gjithnjë më haptazi edhe aksione çetnike, të nxitura e të përgatitura nga pushteti. Këto, se dhe tejmbushja e kupës së quajtur robëri, na detyrojnë të marrim qëndrim përkatës e të prerë për t'iu ndajvënë sa më me sukses veprimeve të armikut dhe për t'i shërbyer sa më mirë çështjes sonë të shenjtë: çlirimit dhe bashkimit të trojeve dhe të popullit shqiptar në një shtet kombëtar me pushtet popullor.

"Detyrat e njerëzve revolucionarë, përparimtarë, patriotë në vendet me zhvillim të ulët ekonomiko-shoqëror dhe të varura prej fuqive imperialiste e socialimperialiste, është t'i bëjnë të ndërgjegjshëm popujt për këtë shtypje e shfrytëzim, t'i edukojnë, t'i mobilizojnë, t'i organizojnë, t'i hedhin në luftë çlirimtare, duke mbajtur parasysh kurdoherë se revolucionin e bëjnë masat e gjëra, popujt." (Enver Hoxha, Imperializmi dhe revolucioni).

Dhe pakënaqësia ekzistuese e popullit si dhe situata e përgjithshme na bëjnë optimistë kur e do puna të hymë në radhët e popullit për t'i çuar në vend detyrat tona. Klika në pushtet nuk është më në gjendje t'i shtyp popujt si më parë, me mashtrime e demagogji, dhe mbase as me diktaturë. Përditë po bëhet më e qartë se mbarësia a prapësia e Jugosllavisë nuk varet nga mbarësia a prapësia e ndonjë individi (a grupi) në krye të saj. Puna është te rendi i kalbëzuar antipopullor, i cili s'ka shërim. Sa më shpejtë që të fillojë përfundimtare, aq më shpejtë do t'u kthehet liria dhe lumturia e grabitur popujve të kësaj pjese të Ballkanit.

Mirëpo kjo pakënaqësi, që vetvetiu përbën një nga forcat kryesore të luftës së ardhme, implikon para së gjithash edhe nevojën e përdorimit të saj me kohë e me vend. Sepse, si forcë goditëse, ajo ka një cilësi të atillë, që nuk i shfaqet kujtdo. Ajo do t'i shfaqet vetëm atij që është i denjë për luftën e vendosur dhe serioze, deri në fitore, pa marrë parasysh vështirësitë dhe sakrificat. Prandaj, si bij revolucionarë të popullit tonë, ne, në radhë të parë, duhet ta kemi parasysh pakënaqësinë e madhe të popullit dhe të hyjmë në esencën e saj e t'i përgatisim asaj terren të vërtetë për grushtin e saj të fuqishëm. Skënderbeu s´bëri gjë tjetër, veçse e mblodhi atë, rebelimin e shpërndarë dhe e sistemoi." (Ismail Kadare, Ura me tri harqe).

Një nga detyrat e ngutshme të patriotëve dhe të revolucionarëve shqiptarë në kushtet aktuale, është që t´u bashkangjiten radhëve tona të organizuara, Frontit të Kuq Popullor dhe organizatave e grupeve të tjera revolucionare. Ne nuk e nënçmojmë as legale e gjysmëlegale të disa njerëzve të ndershëm. Por s'ka asnjë dyshim se revolucionari, sado i përgatitur dhe i gatshëm që të jetë deri sa të mos u bashkohet radhëve të organizuara, do të jetë një ishull i vetmuar dhe i brishtë.

Ndërkaq për organizatat dhe grupet revolucionare, sot më shumë se kurrë shtrohet nevoja e njohjes reciproke dhe e bashkimit të shpejt. Siç mund ta dimë, në viset shqiptare nën Jugosllavi ekzistojnë një numër i konsiderueshëm grupesh e organizatash patriotiko-

revolucionare, me karakter regjional e mbiregjional. Kjo është e natyrshme për një periudhë të caktuar në përgatitjen e luftës çlirimtare dhe revolucionit, sepse e kushtëzojnë rrethanat e vështira të punës në ilegalitet të thellë - për shkak të presioneve të mëdha të armikut për shuarjen e çdo shkëndijëze revolucionare. Por duke u nisur nga kushtet konkrete, nga kriza që po pëson sidomos kohëve të fundit armiku ynë, nga zhvillimi i këtillë i ngjarjeve që flet për procesin e shembjes gjithnjë më të shpejtuar të tij, si dhe nga qëllimet, strategjia e taktika e njejtë e grupeve dhe organizatave tona revolucionare, sot ekzistojnë shumë mundësi për bashkimin e tyre në një organizatë të vetme e të fortë. Dikur, kur ngjarjet të kenë marrë përmasa të tjera, do të mund të bëhet vonë për bashkim të suksesshëm. Sepse si thoshte Lenini, në "çastet e shpërthimeve e plasjeve, është vonë për krijimin e organizatës; ajo duhet të jetë e gatshme që të mund të zhvillojë menjëherë veprimtarinë e vet."

Çështje organizative - strategjia dhe taktika

Vetëdija për procesin e shthurjes dhe të shembjes së shpejtë të socialshovinizmit jugosllav në krye me hegjemonizmin serb, nuk na jep të drejtë të nënçmojmë forcën armike. Përkundrazi, Jugosllavia, duke qenë e mbështetur fort në forcat e errëta reaksionare dhe antipopullore nga brenda dhe jashtë, përkundër plagës së rëndë që ka marrë nga kriza ku është katandisur me të katër këmbët, mund të zvarritet edhe për një kohë të gjatë, po s'ia dhanë të shtyrën forcat përparimtare nga gjiri i popullit tonë dhe i popujve të tjerë që vuajnë nën klikën e Beogradit. Prandaj, është e qartë se për t'ia arritur qëllimit, duhet një organizim i fuqishëm e serioz, që do të jetë në gjendje ta godasë atë për vdekje.

Para nesh tani shtrohet një çështje e rëndësishme, ajo e raportit dhe programit revolucionar dhe veprimit revolucionar. "Çdo gjë që bënë lëvizja e vërtetë, - shkruante Marksi, - ka më tepër rëndësi se një duzinë programesh." Kurse Lenini shton se "pa teori revolucionare nuk ka revolucion." Prandaj, pasi ne nuk kemi pse të frikësohemi për "teorizime", do të thoshim se na duhet një program i denjë për një lëvizje të denjë. Me këtë rast duhet të vëmë në dukje se ne ende nuk kemi qenë në gjendje ta formojmë partinë tonë komuniste marksiste-leniniste, pa të cilën gati do të jetë e pamundshme hyrja konkrete në luftën e ardhshme nacionalçlirimtare dhe në revolucionin tonë. Kjo na nxjerr te një çështje tjetër që kërkon sqarim. Ishte Partia Komuniste Shqiptare (sot Partia e Punës e Shqipërisë) ajo që e pat themeluar Frontin Nacional Çlirimtar (sot Fronti Demokratik). Dhe kjo ishte rruga e drejtë. Te ne ka ngjarë e kundërta. Fronti i Kuq Popullor, i themeluar prej forcash patriotike, pret themelimin e partisë sonë komuniste marksiste-leniniste e cila do të vihet në ballë të luftës dhe të revolucionit. Sipas vlerësimeve të Frontit, arsyeja për këtë inverzion qëndron në kushtet konkrete, të cilat kanë ndikuar që forcat patriotike të masave të gjëra të ecin një hap përpara organizimit të komunistëve tanë. Në kësi konteksti e shohim aktivitetin e Lëvizjes Nacional Çlirimtare të Kosovës dhe të Viseve të tjera Shqiptare nën Jugosllavi - një organizatë e hershme, që ka mbledhur dhe mban rreth vetes njerëz me eksperiencë patriotike e revolucionare dhe me të cilën jemi duke bërë përpjekje për njohje reciproke dhe për bashkim. Në kësi konteksti jemi duke përcjellë gjithashtu edhe aktivitetin e Marksist-leninistëve të Kosovës, që po shfaqen këto kohët e fundit me organin e tyre "Liria". Duke u nisur nga kryeartikulli në numrin e parë të këtij organi, si dhe nga përmbajtja e tij përgjithësisht e nga trajtimi marksist-leninist i problemeve nga ana e krijuesve të "Lirisë", ne e vlerësojmë shumë të drejtë punën e Marksist-leninistëve kosovarë. Kjo na jep shpresë që së shpejti, ndoshta pikërisht nga radhët e tyre, do të realizohet edhe kërkesa e domosdoshme për themelimin e vetë partisë komuniste marksiste-leniniste.

Për sa i përket strategjisë së ndjekur gjer më tash në luftë kundër socialshovinizmit jugosllav, ne kemi vlerësuar se pjesa më e madhe e grupeve dhe organizatave patriotiko-revolucionare shqiptare janë puqur në një pikë: në etapën e deritashme të luftës e të revolucionit tonë, ato i kanë dhënë armikut një grusht nga aspekti politik, duke bërë me veprimtarinë e tyre të ngritet vetëdija kombëtare e masave tona popullore. Vitet e fundit bashkë me vetëdijen kombëtare janë arritur rezultate të shënueshme edhe në ngritjen e vetëdijes klasore, që është një hap i madh cilësor drejt revolucionit. Këtë ua dimë për nder patriotëve e revolucionarëve tanë, që ditën ta përqafojnë e ta përhapin në masa literaturën revolucionare marksiste-leniniste, sidomos atë që po botohet në Tiranë dhe është bërë fener ndriçues edhe për forcat revolucionare në të gjithë botën.

Mirëpo, vlerësojmë ne gjithashtu, tani ka ardhur koha që të kalohet në një etapë tjetër të luftës: në aksione të sinkronizuara për dëmtimin e armikut edhe në pikëpamje ekonomike e luftarake. Kështu sikurse strategjia, edhe taktika e deritashme, në rast të tillë, duhet t´ia lëshoj vendin taktikës së re. Në këso kushtesh bëhet edhe më i nevojshëm bashkimi i shpejt i organizatave tona patriotiko-revolucionare, të cilat, deri më tash, megjithë strategjinë e njejtë apo të ngjashme, kanë aplikuar taktika të ndryshme."

Qëndrimi ndaj burgosjeve politike

"Do të ketë gjithmonë koka që ngrihen, sepse, s´do të ishte as fjala kryengritje, që, në fund të fundit s´do të thotë gjë tjetër, veçse "kokëngritje". Pra do të ketë gjithmonë koka që do të ngrihen e pastaj, si rrjedhim, do të priten, dhe ata që do t´i shikojnë ato… do të thonë me vete: jo, unë s´do ta bëjë kurrë një gjë të tillë. Kështu do të thonë, mirëpo sikur t´i ketë shtyrë djalli, fill pas kësaj s´do mendojnë veçse të bëjnë pikërisht atë që s´duhet të bëjnë."

Shtimi gjithnjë më i madh, dhe jo zvogëlimi i aktivitetit të organeve ndjekëse jugosllave ndaj forcave patriotike, e dëshmon në mënyrë të gjallë këtë mendim të Kadaresë. Klika titiste, me bajraktar hegjemonizmin serbomadh dhe përcjellës të parë shovinizmin maqedonas dhe malazez, "me forcën brutale po përpiqen të skllavërojnë racën tonë e të përjetësojnë qeverimin tiranik të tyre". Po bëhen katër dekada (vetëm nga Lufta e këtej) që ata nuk po zgjedhin mjete për ushtrimin e gjenocidit mbi popullin shqiptar. Një nga këto mjete, shumë e preferuar ishte dhe mbeti burgosja e çdo filize shqiptare, posa ta ketë dhënë shenjën e parë se nuk do ta pranojë verbërisht robërinë. Populli ynë është në dijeni për bijtë e tij të zgjedhur, që dergjen në burgjet e Jugosllavisë. Ai po i përcjell e dhembje edhe burgosjet e paradokohshme, që edhe sot po rrëmbejnë valë-valë shumë patriotë shqiptarë. E di mirë populli pse Klika titiste nuk po ka guxim të na denjësojë as me të drejtën tonë elementare: që të informohemi publikisht se kush janë të burgosurit, sa u dënuan dhe pse. Prandaj, më shumë se kurrë po e çjerrë marimangën e harresës, me të cilën ka qëllim ta mbulojë e ta hedhë në harresë UDB-ja fashiste.

Karshi këtyre akteve të egra, ne duhet të kemi qëndrimin tonë përkatës. Edhe ky qëndrim, vlerëson Fronti i Kuq, duhet të ndërroj nga i deritashmi. Mendojmë se duhet t'i kthehemi pak historisë. Xhandarët e Stojadinoviqit, ta zëmë, e vranë komunistin Zef Lush Marku, në fillim të këtij shekulli; por ata s'patën si t'i përballojnë kërkesës së opinionit që kërkonte informim të hollësishëm për vrasjen e tij mizore. Ata nuk ia dolën ta ndalin as shoqërinë e ngushtë dhe familjen e tij që kufomën e komunistit e nxorri nga varri dhe e varrosi atje ku përkiste. Në Jugosllavinë e sotme, UDB-ja e PKJ-ja e vrasin mizorisht Fazli Grajqevcin në burg (më 1964) dhe djaloshin Murat Mehmeti (në demonstratat e vitit 1968); dhe as na informojnë pse e si i vranë dhe nuk na lejojnë t'ua bëjmë gjëmën si ka hija as t'i varrosim ku duhet e si duhet! Prandaj, në qoftë se terrori i sotëm ia kalon terrorit

të kralëve të vjetër jugosllavë, të cilit Kamer Loshi, Shotë e Azem Galica iu përgjigjën me zjarr, pse atëherë ne të mos i lejojmë vetes t'ia kthejmë njëherë e mirë dhe me të njejtën masë armikut tonë të tërbuar.

Lidhur me atë që do të duhej të ndryshonte te ne në këtë qëndrim, ne propozojmë sa vijon:

1. Ata po na burgosin pa të drejtë. Dhe ne, me të drejtë, të mos u dorëzohemi. Kur ta rrethojnë shtëpinë, nga e cila s'ke ku shkon më tej, nëse je i përgatitur shtjer mbi ta dhe ua mbush barkun barot! "Udbashi" është një terrorist, që e çon në vend terrorin e planifikuar shtetëror jugosllav. Po s'pate kushte për mbrojtje me armë, ruaje gjakftohtësinë, mblidhe urrejtjen, në qëndrimin tënd të palëkundshëm, jepi grusht armikut gjatë hetimeve dhe në burg. Mos jeto në iluzione për dobinë nga qëndrimi më i butë. Ti je dënuar në Beograd, dënimin tënd e përtyp gjyqtari në Prishtinë si shiriti i magnetofonit fjalët e inçizuara kushedi se kur.

2. Ta kanë arrestuar djalin, vajzën, vëllaun, motrën, burrin, babanë apo shokun. Më së miri do t'ia nxjerrësh hakun nëse menjëherë i kërkon radhët e organizuara dhe hidhesh në luftë të organizuar revolucionare.

3. Ta kanë arrestuar kushëririn, fqinjin apo mikun e shtëpisë, bashkëqytetarin a bashkëfshatarin. Ata do të bëjnë mbi ty presione të ndryshme që të mos mbash kontakte me familjen e të burgosurit. A do ta dëgjosh armikun dhe t'ia kthesh shpinën njeriut tënd në çastet më të nevojshme?! "Miku i mirë në ditë të vështirë!" Sa herë e ke përdorur vetë këtë frazë?! Zbatoje, pra, në jetë! Kështu, edhe s'ia çon armikut amanetin në vend edhe solidarizohesh me tëndin dhe i jep krah atij. Sepse, mos harro, qysh nesër mund të të burgosin edhe ty, apo të të burgosin djalin e dëshirit, vajzën, vëllaun. Ç'do të ngjajë atëherë me familjen tënde, nëse rrethi e izolon fare?!

4. Burgosjet masive që po i bënë armiku në viset shqiptare, kurrsesi, nuk duhet të na ligin. Mos u dëshpëro dhe, mbi të gjitha, mos u frikëso. Ti je duke përcjellë në burg një pjesë të djalërisë shqiptare, por nesër do ta shoqërosh, në luftën çlirimtare, të cilën po e përgatisin bashkëluftëtarët. A s'ke dëgjuar kurrë se burgosjet, kur bëhen kaq masive, janë shenjë e dobësimit të armikut dhe përparimit të shpejtë të lëvizjes çlirimtare. Kështu burgoseshin para disa vjetësh edhe revolucionarët e Nikaraguas, por, e fituan lirinë. **Dhe, liria s´ka çmim**.

Ngritja e forcave organizative që do të zëvendësojnë organizatorët e arrestuar

Me burgosjet masive, që bëri me valë gjithnjë më të mëdha për më se një vit e gjysmë, UDB-ja nuk e realizoi dot qëllimin e vet. Ajo kishte ndier praninë e fuqishme të një dore të organizuar patriotiko-revolucionare, që ushtronte ndikim thuaja në të gjitha viset shqiptare të pushtuara nga Jugosllavia. Por, megjithë rrjetin e fortë të spiunëve dhe provokatorëve të regjur, ajo nuk ia doli të siguroj kurrfarë të dhënash konkrete për bazën e aktiviteteve revolucionare. Dhe, meqenëse aktiviteti po shtohej dita më ditë, duke shtrirë një ndikim gjithnjë më efektiv në masat popullore dhe në punonjësit shqiptarë, UDB-ja u detyrua të ndërmerrte më në fund diçka konkrete për të penguar zhvillimin e hovshëm të luftës dhe të revolucionit tonë. E vetmja mundësi, që i kish mbetur asaj në këtë drejtim, ishte asgjë tjetër përveç se një gjah nëpër mjegull.

Kështu, në kulmin e dëshpërimit, të mospërfilljes së ligjeve kushtetuese e ndërkombëtare, dhe në kulmin e papërgjegjësisë ndaj popullit dhe masave punonjëse, UDB-ja burgosi në mënyrë energjike disa qindra e mijëra djelmosha e vajza shqiptare, pa siguruar as argumentet më elementare kundër tyre (pos nëse merret si argument një libër,

vetëm pse është botuar në Tiranë, një shkrim me përmbajtje revolucionare, eventualisht një gazetë ilegale, siç është ta zëmë "Bashkimi"). Nga ky numër jashtëzakonisht i madh të arrestuarish, UDB-ja shpresonte se do t'i bjerë në fije lëmshit: qoftë duke gjetur në mesin e të arrestuarve pahiri ndonjë revolucionar të organizuar, qoftë duke nxjerrë me terror prej tyre ndonjë emër të rëndësishëm organizatorësh.

U arrestuan, u torturuan njerëzit tanë nëpër burgje, disa edhe dolën para gjyqit, të tjerë u lëshuan të shkonin në shtëpi, por nën përcjelljen e kujdesshme të agjentëve të fëlliqur. U çua një pluhur i madh në shtyp, Mahmut Bakalli iu kërcënua edhe një herë popullit të vet, e për hir të armikut shekullor, dhe mbi të gjitha u kujdes të fshihte sa më me kujdes përmasat e aktivitetit policor të sforcuar deri në shkallë fashiste në tokat shqiptare të robëruara. Por grupet dhe organizatat tona revolucionare mbetën thuaja të paprekura. UDB-ja nuk ia doli të shtjerë në dorë asnjë organ udhëheqës të këtyre grupeve dhe organizatave.

Dhe gjithë ky proces i tmerrshëm u përsërit disa herë dhe po vazhdon edhe sot. Më në fund, edhe nëse pohimi ynë është i gabueshëm, d.m.th. edhe nëse UDB-ja e ka zënë pikërisht zemrën e forcave tona të organizuara, kjo s'i bënë asaj kurrfarë dobie. Përkundrazi, pozita e saj bëhet edhe më e pashpresë. Sepse, është fakt se që nga fillimi i arrestimeve të nëntorit 1979, aktiviteti revolucionar në trojet shqiptare jo vetëm që nuk u rrudh as u shua, por vazhdoi me ritëm më të shpejtë dhe me përmasa më të mëdha. Pra, edhe nëse gjendja faktike flet për zënien e forcave tona të organizuara, ajo flet njëherazi edhe për lindjen dhe aktivitetin e sforcuar të forcave të reja, që vazhduan aty ku e kanë lënë të tjerët.

Me këtë kapitull për UDB-në dhe revolucionarët tanë, kësaj radhe patëm për qëllim të dalim te një kërkesë e rëndësishme që shtrohet para luftën dhe revolucionit tonë: te ngritja e forcave organizative, të cilat do të zëvendësojnë në mënyrë sa më të plotë e më energjike radhët e organizatorëve të dëmtuar nga armiku. Në situatën konkrete, ne vlerësojmë se është bërë një punë e shëndoshë, për aq sa është fryt i punës së forcave të organizuara aktivizimi i forcave të reja për dëmtimin e radhëve të armikut. Por, në qoftë se e vërteta qëndron ndryshe, atëherë, kjo gjë duhet të bëhet preokupim për punën revolucionare në të ardhmen. Sepse, pa rezervat e revolucionit, vihet në dyshim edhe vetë ngadhënjimi i revolucionit.

Një nga mënyrat e përshtatshme në përgatitjen e forcave të reja organizative, thotë Lenini, është ndarja e drejtë e punës revolucionare, e cila nuk guxon të koncentrohet në duar individësh apo grupesh të kufizuara. Gjithë puna revolucionare, sidomos ana e saj organizative, duhet të përvetësohet në shkallë sa më të gjerë dhe në të gjitha punktet ku ushtron ndikim grupi apo organizata e caktuar revolucionare. Po s'u veprua kështu, do të krijohen patjetër marrëdhënie personale e lokaliste brenda organizatave. Do të lihen pas dore anëtarët "periferikë" të tyre. Ata nuk do të mund të ushtrohen dhe përvetësojnë aftësinë e organizimit, sidomos në kushte të ndryshuara objektive; ata nuk do ta përvetësojnë e lëre më ta përsosin, as teknikën e konspiracionit, e do të mbesin të mangët edhe në zotërimin e literaturës revolucionare, duke e përhapur atë, e jo edhe duke e studiuar për vete. E keqja më e vogël që mund të dalë nga një qëndrim i tillë, është paaftësia e anëtarëve "periferikë" për propagandë e agjitacion të shëndoshë në mesin ku veprojnë ata. Kur punës revolucionare t'ia marrësh edhe momentin e propagandës dhe të agjitacionit të vërtetë, atëherë ia ke marrë edhe dimensionin e saj primar dhe e ke shndërruar në punë antirevolucionare.

Më në fund, marrëdhëniet demokratike revolucionare, që janë synim i parë dhe i përhershëm i revolucionit tonë, patjetër shprehen qysh në hapat e parë të organizimit të forcave revolucionare.

Rinia përparimtare - rezervë e pashtershme

22-vjeçari i sotëm ende nuk ka qenë i lindur, kur UDB-ja e pat burgosur herën e parë për veprimtari patriotike shokun Adem Dema-Demaçi, në vitin 1958. Sot këtë 22-vjeçar e kemi burrë të rritur e të pajisur me vetëdije të lartë kombëtare e klasore dhe me një gatishmëri e guxim të pashoq për t'u futur si e kërkon nevoja në zjarrin e luftës e të revolucionit. Në qoftë se ai është aftësuar edhe në pikëpamje organizative, atëherë, për kauzën tonë kanë ardhur kohë të mbara.

Si ka mundur ai të aftësohet në pikëpamje organizative, pasi me moshë është shumë i ri dhe është rritur në kushte të atilla, në të cilat njeriu e ka vështirë të shtjerë në dorë literaturë përkatëse; pastaj kushtet e ilegalitetit dhe të rrezikut të madh nga agjentët e regjur, kanë qenë në fuqi edhe për të, madje veçanërisht për të, si njeri i ri dhe pa përvojë.

As historinë e mirëfilltë kombëtare, as teorinë marksiste-leniniste të mirëfilltë, ai nuk ka pasur mundësi t'i mësoj në shkollë dhe as në kushte të hapëta publike. Cilat paskan qenë, pra, burimet e frymëzimit të tij dhe si u stërvit ai në punë organizative?

Natyrisht, momentet që ndikojnë në edukimin e përgjithshëm të njeriut dhe në formimin e plotë të personalitetit të tij, pra edhe të personalitetit të tij revolucionar - janë të shumta dhe të pallogaritshme. Kështu ka ngjarë edhe me 22-vjeçarin tonë në shqyrtim. Por, këtu e do puna që, pa hyrë në ndonjë analizë tjetër, ta veçojmë ndikimin që ka mundur ta ushtrojë ndonjë grup apo organizatë revolucionare e llojit të atillë që kanë vepruar ndër ne, duke u hapur edhe ndaj të rinjve, që do të thotë, duke analizuar edhe këtë premisë të propagandës së shëndoshë revolucionare.

Po e ndoqëm edhe më tutje këtë fill, do të dalim te një dimension i domosdoshëm i revolucionit - te çështja e vazhdimësisë së tij.

Rinia është rezervë e pashtershme e revolucionit. Konkretisht, rinia jonë, si për shkallën e arsimit, të vetëdijes kombëtare e klasore, ashtu edhe për vitalitetin e saj, paraqet një kërcim të madh përpara, në pikëpamje të sasisë dhe të cilësisë. Gjasat e armikut tonë, revizionistëve jugosllavë dhe renegatëve shqiptarë, për shtrirjen e ndikimit në rininë tonë po bëhen përditë më të vogla. Rinia jonë i shmanget si lisë së zezë këtij armiku të egër. Kështu, heshturazi dhe haptazi, ajo po tregohet e gatshme të pranojë një ndikim tjetër - ndikimin e forcave tona përparimtare patriotike e revolucionare. Prandaj, në këto kushte, edhe ne e kemi detyrë t'i kushtojmë vëmendjen e duhur punës organizative me rininë tonë përparimtare, shkollore e studenteske, fshatare e punëtore etj., duke e aftësuar atë për propagandimin e idesë revolucionare në mesin e vet e në popull, por edhe për t'u organizuar në shkallën më të lartë.

Këtë detyrë duhet ta kuptojmë aq më seriozisht, sa më seriozisht të kemi kuptuar se revolucioni nuk është problem që zgjidhet për një ditë, por një proces i gjatë e i mundimshëm, me sakrifica të mëdha.

Dy fjalë për konspiracionin

Shtrohet çështja: si mund të zhvillohet aktiviteti i hapur organizativ në kushtet e sotme, kur armiku ka stërvitur agjentë të regjur, të ngarkuar për zbulimin e radhëve tona dhe për shkatërrimin definitiv të idesë e të aksionit luftarak e revolucionarë? Pastaj: ç'qenka, pra, gjithë ai theksim i domosdoshmërisë për zotërimin e teknikës së konspiracionit më të thellë?!

Konspiracioni, ose teknika e ruajtjes rigoroze të fshehtësisë, është një nga faktorët kryesorë të veprimtarisë revolucionare të organizuar. Konspiracioni i jep revolucionarit mundësi për punë sa më të fuqishme ilegale, kurse armikut të popullit dhe të klasës aspak

mundësi për ta zbuluar atë punë revolucionare të organizuar. Proporcionalisht, çdo dobësim i konspiracionit, aq sa merr nga mbarësia e punës revolucionare, aq i shton gjasët për prapësinë e punës së armikut në zbulimin e veprimtarisë revolucionare, e kështu edhe në dëmtimin e revolucionit përgjithësisht.

Në një shkallë të caktuar të organizimit revolucionar, ka ngjarë edhe të keqkuptohet e të simulohet konspiracioni: si rrudhje e tepërt, mendimi i tillë ekziston në radhë të parë tek ato forca, që në fakt janë pozitive dhe të pastra, por jo edhe të stërvitura për luftë të gjatë, te ato forca që janë të orientuara kah efektet e rrëmbyeshme të luftës, pa durim për të pritur aksionet me ndikim afatgjatë. Konspiracioni, siç vë në dukje Lenini, udhëheqësi i madh i revolucionit socialist, është i domosdoshëm për punën revolucionare, pasi ajo zhvillohet në kushte të vështira të ilegalitetit më të thellë. Bile, pa përsosjen e konspiracionit, shton Lenini, nuk ka as aktivitet të mirëfilltë revolucionar.

Kësaj radhe, sa për udhëzimet praktike se çka duhet ruajtur sekret e çka duhet shpallur me daulle, po ndalemi në pika të shkurta. Konspiracioni më i thellë, që nuk guxon të cënohet në asnjë mënyrë, përbëhet nga ruajtje e fshehtësisë lidhur me dokumentet interne të organizatës revolucionare. Këtu bëjnë pjesë statuti i organizatës, bazat e organeve udhëheqëse, shtypshkronja, depoja e armëve. Po kështu, kurrë nuk duhet të përmendet asnjë emër konkret i cilitdo person të inkuadruar në radhët e organizatës revolucionare. Këto gjëra e kanë peshën e sekreteve ushtarake dhe zbulimi i tyre, te organizatat me përvojë, konsiderohet tradhti e dorës së parë dhe dënohet rëndë.

Nuk duhet të ruhet në fshehtësi, po, përkundrazi, të shpallen, masivisht pikëpamjet e organizatës lidhur me situatën në botë e në vend sidomos për strategjinë dhe taktikën e armikut dhe mjetet me të cilat ka mundësi të dëmtohen ajo strategji e ajo taktikë. Me këtë rast, gjithmonë duket të kesh parasysh se nuk të lejohet në asnjë mënyrë të tregosh se di diçka për ekzistimin e ndonjë organizate patriotiko-revolucionare.

Statuskuoja, ngrirje e të drejtave të popujve e të punonjësve

Për të mbrojtur pozitat e veta: sundimin mbi popujt e shtypur, mbi pasuritë e veta e të huaja, mbi rezultatet e punës së punonjësve në botë, kapitalizmi, socialshovinizmi dhe revizionizmi kanë siguruar edhe mekanizma përkatëse në shkallë shtetërore e ndërshtetërore. Kryerojë e "trashëgimisë" imperialiste e revizioniste janë ushtritë dhe policitë e tyre antipopullore, që ruajnë shtypjen dhe shfrytëzimin e përligjur me dhunën ndërkombëtare. Po një nga armët më dinake të gjakpirësve të popujve e të punonjësve në botë, është përpjekja që te masa të krijohet e të forcohet ideja dhe ndjenja e përjetësisë së kësaj gjendjeje, dhe të avullohet çdo iniciativë për ndryshimin e saj.

Një nga mjetet kryesore, që i shërbejnë në shkallë ndërkombëtare këtij qëllimi, është edhe popullarizimi me çdo kusht i idesë imperialisto-revizioniste për mbajtjen e të ashtuquajturës statuskuo, qoftë kur është fjala për "pandryshueshmërinë" e kufijve të tashëm shtetërorë në botë, qoftë për raportin në mes klasave ekzistuese në vendet e ndryshme, e në kurriz të klasës punëtore dhe të fshatarësisë.

Viktimë e dorës së parë të statuskuosë kemi qenë dhe kemi mbetur kurdoherë, ne shqiptarët. Për të kënaqur apetitet pansllave dhe apetite të tjera ekspansioniste, fuqitë e mëdha i kanë shkëputur trungut të përbashkët shqiptar më se gjysmën e tokave dhe gati gjysmën e popullsisë, duke i lënë ato në mëshirën e shteteve të huaja me regjime të egra antipopullore, hegjemoniste e shoviniste. Kështu ngjau para dhe pas Luftës I Botërore, kështu edhe pas Luftës II.

Me daljen në dritë të përpjekjeve tona të mundimshme për luftë nacionalçlirimtare, për vetëvendosje dhe shkëputje nga Jugosllavia, e bashkim me vendin amë, RPS të Shqipërisë, është e natyrshme që dalin forca të errëta - te ne dhe në botë - të cilat përpiqen të na frikësojnë e të bëjnë presione të ndryshme, pikërisht duke pasur parasysh statukuonë e përmendur. Dhe kjo gjë ne s´na habit aspak, sepse propaganda dhe agjitacioni imperialisto-revizionist nuk mund të kalojnë pa bërë ndonjë efekt. Mirëpo na habit qëndrimi i pacipë i disa forcave, të cilat ndjekin rrugën revolucionare, siç janë ta zëmë disa parti marksiste-leniniste. Pa informata të sakta mbi historinë e popullit shqiptar dhe mbi gjendjen e mjeruar të shqiptarëve me banim në Jugosllavi, ato sikur duan të na e mohojnë gjithashtu të drejtën për luftë nacionalçlirimtare. Duke përdorur disa klishe prej arrivistësh të revolucionit, ata pëshpërisin: Ju duhet të veproni vetëm për ngadhënjimin e revolucionit proletar në Jugosllavi, jo ju duhet patjetër të zhvilloni një bashkëpunim internacionalist me serbët e malazezët, jo duhet të hiqni dorë nga vetëvendosja gjer në shkëputje dhe bashkimi me vendin amë, sepse vendi amë nuk e potencon kështu si ju çështjen tuaj, ju nuk keni të drejtë, e të tjera, e të tjera. Nga ana tjetër, kudo që u shfaqet rasti, ata nuk lënë pa propaganduar përkrahjen e tyre ndaj luftërave nacionalçlirimtare dhe revolucioneve. Dhe ne, duke pasur megjithatë konsiderata për punën e tyre përgjithësisht revolucionare, në vend që t'u hidhërohemi atyre, kemi parapëlqyer që t'i njoftojmë me çështjen tonë ashtu siç është ajo në të vërtetë.

Sa për zëdhënësit e imperializmit e të revizionizmit, që në emër të statuskuosë së tyre "shpëtimtare" na e mohojnë të drejtën elementare të ekzistencës kombëtare dhe të luftës klasore, ne, siç ua kemi vënë grushtin përpjekjeve të armikut jugosllav për të na shfarosur ose për të na mbajtur nën thundrën e egër, do t'ua vëmë edhe atyre. Sepse, sikur me statuskuonë të pajtoheshim në cilëndo shkallë, atëherë as që do të flitnim për luftë e revolucion. Në instancën e fundit, revolucion do të thotë më së shumti mospajtim me gjendjen ekzistuese dhe luftë për ndërrimin e saj cilësor.
("BASHKIMI“ Nr.1, Janar 1981, faqe 1-2)

17. NËNTORI SHQIPTAR NË VISET E ROBËRUARA

Deri sa vëllezërit tanë në Shqipërinë Nënë kremtojnë të lirë festat binjake të nëntorit, ne, shqiptarët në viset tona të robëruara nga Jugosllavia, kremtojmë gjithashtu, megjithëse në skamje, mjerim e tortura mizore.

28 Nëntori 1912 është për të gjithë shqiptarët dita kur populli ynë, pas shekuj e shekuj robërie, realizoi disa nga aspiratat e vete shekullore: krijimin e shtetit të pavarur kombëtar dhe bashkimin e një pjese të madhe të tokave shqiptare brenda kufijve të këtij vendi. Për këtë e kishin dhënë pa kursim gjakun të parët tanë dhe gjaku nuk u shkoi kot. Në sytë e Evropës mospërfillëse dhe të shteteve shoviniste ballkanike, iu vunë themelet një shteti të ri që doli në shesh, sado i gjymtuar, vullneti i ndrydhur i një populli martir, që e lau pëllëmbë e gjak tokën e vet, i shtypur, i mohuar dhe i braktisur nga të gjithë. Dhe ky shtet, të cilit iu shkëputën thuaja viset më vitale, që i banojmë ne sot, sado që pas pavarësisë u robtua nga qeveritë tradhtare të vendosura në fron nga të huajt, u bë edhe për ne njëfarë mbështetjeje dhe mbrojtje nga shfarosja e asimilimi i plotë, që na hakërrohej si kërcënim i madh mbi kokë prej sllavomëdhenjve. Nëqoftëse nuk na përkrahte Zogolli, që ishte ngjitur tradhtisht në pushtet me ndihmën e serbit gjakpirës, Pashiq, përkrahjen për luftë na e dha kurdoherë populli vëlla, sidomos ai në Malësi, edhe kundër dëshirës e urdhrave të mbretit satrap. Me shpinën sado pak të siguruar nga kufiri i shtetit amë, ne, deri në mbarimin e turpshëm të Jugosllavisë së vjetër, s'i lëshuam dore armët për

mbrojtjen e popullsisë së pafajshme nga terrori serbo-malazez dhe për bashkimin e të gjitha tokave shqiptare brenda një shteti unik kombëtar.

Në gjendje të tillë na zuri lufta antifashiste nacionalçlirimtare. Baballarët tanë derdhën gjakun e tyre të shtrenjtë për një të nesërme të ndritshme, me ëndrrën e përjetshme se do ta gëzonin jetën në shtetin e ligjshëm kombëtar të të gjitha tokave dhe të të gjithë popullit shqiptar të bashkuar. Po dhuna edhe kësaj radhe e mundi drejtësinë, dhe 29 Nëntori i vitit 1944, ne, shqiptarët përtej kufirit, na mbërtheu sërish në robëri. Megjithatë, edhe 29 Nëntorin e kremton populli ynë kudo që të jetë, si festën më të rëndësishme të fitores mbi fashizmin, të çlirimit të vërtetë të Nënës Shqipëri dhe të ndërtimit të socializmit të mirëfilltë.

Edhe sot, në trojet e pushtuara shqiptare, pas aq përpjekjesh të social-shovinistëve jugosllavë për të na zhbirë nga faqja e dheut, ne po qëndrojmë në këmbë, më të fortë se kurdoherë. Në një anë kemi Nënën Shqipëri, të fuqishme e të kujdesshme, e cila na mbron nga rrebeshet dhe na ndjell për bashkim; në anën tjetër vetëdijen tonë të ngritur klasore e kombëtare, e cila po na shpie në drejtim të luftës së pashmangshme nacionalçlirimtare dhe të bashkimit me vendin amë.

Edhe sot, më shumë se kurdo, nëna shqiptare po e demoralizon armikun, duke lindur vajzën, duke lindur djalin, që po kërkojnë llogari nga ia që na e dha rrugën e shpërnguljes së madhe për në Turqi; llogari nga ai që na torturoi babanë e po ia torturon sot motrën e vëllain, apo djalin e vajzën; llogari nga kolonizatori, që na e dha rrugën e mërgimit nëpër republikat e Jugosllavisë dhe në botë. Rinia shqiptare po ia kallë datën armikut me luftën për çlirim nga pushtuesi, me admirimin e Shqipërisë Mëmë. Rinia jonë vigjilente, që u ka rënë në erë planeve të kahmotshme të social-shovinistëve jugosllavë për aneksimin edhe të Shqipërisë, si republikë e shtatë jugosllave, është bërë mur i pakapërcyeshëm edhe për këto apetite të liga të armikut të egër të shqiptarëve.

Kështu do ta ruajmë edhe në të ardhmen njëri-tjetrin: Shqipëria e PPSH dhe e shokut Enver ne nga rreziku i çkombëtarizimit dhe i shfarosjes, dhe ne atë nga apetitet pansllave të Jugosllavisë; deri sa të vijë edhe Nëntori i tretë – ai i bashkimit të plotë kombëtar dhe i jetës në liri e socializëm. (Bashkimi, janar 1981, faqe 3)

18. KORRESPONDENTI POPULLOR

Në kushtet e sotme, "para çdo gjëje, neve na duhet një gazetë. 'Pa atë, siç ka thënë në kohën e vetë Lenini, është i pamundur zhvillimi sistematik i një propagande dhe agjitacioni parimor dhe të gjithanshëm.'

Gazeta jonë, "Bashkimi", e cila do të zëvendësojë agjitacionin e shkëputur që bëhet me trakte e organe grupesh lokale, tash e tutje do të dalë rregullisht. Daljen e rregullt të "Bashkimit", do ta mundësoj Fronti i Kuq Popullor, i cili po përpiqet me të gjitha forcat për konsolidimin e radhëve të veta. Shumë detyra dalin para një organizate, e cila duhet ta udhëheqë popullin në luftën e tij për çlirim kombëtar e klasor dhe për bashkim me shtetin amë; dhe shumë vështirësi, që duhet të kapërcehen doemos. Një nga këto detyra, pra, është nxjerrja e gazetës "Bashkimi".

Që kjo gazetë të mund të kryej detyrën e vet, politizimin e masave dhe mobilizimin e tyre për luftën e vështirë çlirimtare, është e domosdoshme të shkruajnë për të korrespondentë nga gjiri i popullit. Këta korrespondentë popullorë duhet të jenë specialistë të profesioneve të tyre dhe ta zotërojnë mjeshtërinë e zejes fisnike të shkrimit.

Tash për tash, këta njerëz, pa kontributin e të cilëve është vështirë të shkojë mbarë puna jonë, janë të lidhur me rroga në vendet e punës të hapura nga pushteti dhe plotësojnë

nevojat e pushtetit, me vetëdije dhe pa të. Pra, ata i gjejmë në shumë pore të aparatit shtetëror, e kështu edhe në disa burime të rëndësishme informatash, të cilat mbahen fshehtë nga opinioni. Burime të rëndësishme informatash për ne janë statistikat e ndryshme për ecuritë në politikë dhe ekonomi, për popullsinë etj., e sidomos informatat për veprimtarinë e ushtrisë dhe të sigurimit shtetëror. Ne do të duhej ta aktivizonim një krah vital, i cili mund të sigurojë në çdo kohë shënime lidhur me arrestimet e bijve të popullit, me torturat që ushtrohen mbi ta, në mënyrë që ta njoftojmë popullin dhe të mund të ndërmarrim aksione, që parashikohen edhe me programin tonë. Deri më tash, në organet fashiste të sigurimit jugosllav ia kemi dalë të infiltrojmë një numër të mirë patriotësh revolucionarë, të cilët do ta tregojnë veten në çastin e duhur. Por, ne apelojmë që edhe ato forca, që nuk kanë qenë të lidhura drejtpërdrejt me ndonjë grup a organizatë revolucionare, të kërkojnë rrugë për ta dhënë kontributin e tyre në shërbim të popullit. Një nga rrugët e tilla është edhe bashkëpunimi me gazetën tonë, duke dërguar materiale e shkrime, që e shpien përpara çështjen e përgjithshme të çlirimit.

E mira është se në të gjitha poret e aparatit shtetëror revizionist, siç e ka treguar praktika e deritashme, ka shumë intelektualë popullorë dhe përgjithësisht forca të atilla pozitive, që janë të gatshëm të vënë gjithë çka kanë në shërbim të luftës sonë të drejtë për çlirim kombëtar e klasor.

Mirëpo, nga ana tjetër, është mjaft i madh numri i intelektualëve pasivë, që nuk mund t'i quash revolucionarë, po as armiqë të mirëfilltë të popullit, pasi pushtetit nuk i shërbejnë me vullnet e me zell. Gjithmonë, në periudhën kritike, për llojin e tillë të intelektualëve janë mbyllur rrugët e shumta dhe ata janë detyruar, në çaste vendimtare, të zgjedhin një nga dy rrugët kryesore: përparimtaren, ose armiqësoren. Ky çast ka ardhur sot edhe te ne për këtë tip të intelektualit: o me popullin – për ardhmërinë, o me klikën titiste – për vdekjen! Rrugë të mesme nuk ka.

Nuk ka mbetur kohë as për disa taktizime, që u flenë në hatër disa intelektualëve të një tipi tjetër – evolucionistëve. Në qoftë se pushteti fashist jugosllav po i përtërin haptazi metodat e kralëve të moçëm, duke organizuar aksione me individë e banda çetnike, atëherë armiku ynë gjen tek evolucionisti shqiptar një ndihmës të pashoq. Sepse përballë punës së ethshme praktike të armikut, evolucionisti ynë s'ka armë tjetër pos iluzionit; pritjen e zhvillimit të vetvetishëm të ngjarjeve në kahjen që e ëndërron evolucionisti. Ky tip i intelektualit tonë, po t'ia heqësh ëndrrat e bukura e moshyrjen e drejtpërdrejtë qëllimore në shërbim të armikut, është vëllai i pacifistit, një tip shumë i rrezikshëm i intelektualit, i cili, duke "përvetësuar" disa teori të vijës së rezistencës së ulët, që e mohojnë kombëtaren në emër të një internacionalizmi të paqartë edhe për ata vetë, i bëjnë armikut tonë agresiv shovinist shërbim të dorës së parë. Intelektualët e tillë, bashkë me ata që përfaqësojnë indiferentizmin e rrezikshëm, po mbetën më tutje në pozitat e tyre, do të luftohen si armiq.

Në Kosovë, si dhe në viset e tjera shqiptare të robëruara nga revizionistët jugosllavë, intelektuali është ngritur me thonj të duarve dhe me djersën e ballit. Këtë nuk e mohon askush. Bile, sakrificat kanë qenë për të shumë të mëdha. (Ai gjithmonë i është ekspozuar diskriminimit social e nacional dhe gjithmonë ka qenë i stërngarkuar me probleme, që ta nxijnë jetën me themel.) Por, kjo nuk i jep atij të drejtë ta bëjë syrin qorr e veshin shurdh, duke iu shmangur frontit të vështirë të qëndresës aktive ndaj armikut të egër. Përkundrazi, kjo atë e obligon edhe më shumë që përvojën e hidhur ta mbartë tek të tjerët dhe vetë të bëhet një militant i pakompromis i çështjes së madhe klasore e kombëtare.

Ne tani kemi nevojë për një armatë të tërë intelektualësh të profileve nga më të ndryshmet. Të gjithë ata, me një përkushtim më të madh dhe syçeltësi që të mos bëjnë as

sa të zitë e thoit për armikun, do të mund të jepnin kontribut të pamatur në luftën tonë. Më në fund, intelektuali përparimtar, kurdoherë ka qenë në shërbim të dijes pozitive, por patjetër edhe faktor aktiv në orientimin e mbarë të zhvillimit historik të shoqërisë aktuale. Kur marrim të flasim për ushtrinë e gazetarëve, shkrimtarëve e historianëve kosovarë, ne nuk na duket aspak e lehtë pozita e tyre dhe mundësia për veprimtari pozitive në degët ku janë përfshirë ata. Duhet një koncentrim dhe mundim i jashtëzakonshëm për të gjetur rrugë që ta duash të vërtetën objektive në rrethanat e robërisë dhe të jetës publike në një shtet të cilin e dëmton rëndë çdo xixë e së vërtetës. Sidomos gazetari dhe historiani, përveç preokupimeve të tyre jetike, të cilat nganjëherë rrallë kanë sukses edhe t'i publikojnë, janë të ngarkuar që, për rrogën mizore që marrin nga shteti, të kryejnë edhe punën që kërkon prej tyre armiku. Dhe kjo punë implikon gënjeshtrën e demagogjinë titiste dhe, jo rrallë, edhe gjykimin e vëllaut tënd, i cili ka luftuar pa kompromis. Me këto probleme ballafaqohet edhe shkrimtari ynë, i cili nuk ka më se si t'i shprehë haptazi bindjet e veta, kur ato prekin në sfera kombëtare e shoqërore, sepse këtë gjë nuk e lejon armiku. Prandaj, ai detyrohet të përdorë një gjuhë simbolike, e cila, siç na del nga praktika e deritashme, kuptohet të shpeshtën vetëm në qarqe të ngushta krijuesish dhe nga ndonjë shërbëtor i rryer i pushtuesit, që raporton vazhdimisht për ecurinë në krijimtarinë tonë.

Mirëpo, në qoftë se një gazetar, deri sa është duke marrë rrogë nga pushteti dhe deri sa të mos jetë i gatshëm për të dalë haptazi kundër padronit të vet, shpesh detyrohet të shkruaj edhe për tema që nuk e interesojnë apo që shkojnë në dëm të pikëpamjeve të tij (ta zëmë, duke shkruar me urdhër për numrin e vizitorëve të varrit të xhelatit), shkrimtari, në këtë pikëpamje, është në pozitë më të mirë. Ai shkruan vetëm për ato tema që i flenë në hatër dhe për to nuk e detyron askush me dhunë. Prandaj s'ka si arsyetohet, po përkundrazi do të dënohet rëndë gjesti i ndonjë kuazishkrimtari, i cili guxon të tradhtojë kaq haptazi, si qelbanikja Zade Gashi, qoftë edhe me një vjershë të vetme:

Zulmin na e ngriti
zërin na e rriti –
sinonim
i emrit të Tij
jemi ne.

(Mos qoftë thënë nga goja jonë!)
Po i përgjigjemi me një strofë të Brehtit:

Turpin e madh si e durove
Dhe me ç´ilaç zemrën e mpive,
Kur me kasapët u pajtove
Dhe për ata në llum u shtrive…
Mjerë ata që duart i kanë ndyrë
Me krime që as gurët nuk t´i falin!

Nuk do të çuditemi aspak në qoftë se nesër po kjo metresë e djallit, Zadja, ne del në shtyp edhe me ndonjë varg kushtuar Mic Sokolit, të shkruar me lapsin me të cilin ka shkruar për xhelatin Tito. Kjo s'do të jetë e para herë që një poet apo shkrimtarë kosovar vepron kësisoji. Ç'është më e keqja, poetët e tillë nxitojnë të dalin para njerëzve edhe me disa arsyetime e "teori" të gjoja taktikës së madhe intelektuale, në stilin: unë mendjen e kam gjithmonë te fatkeqësia dhe te robëria, por, për ta hedhur një temë të mirë në shtyp, më duhet të luaj lojën e lojalistit, në mënyrë që të fitoj kredi për ta thënë edhe mendimin tim të kamufluar kohë pas kohe!

Po të bëhej "tuxharet" me këso punësh, ndoshta ka vend edhe për arsyetime. Por, çfarë të vërtete ke shpallur ti para popullit tënd me temat e tua vërtetë të mira, por të përvjedhura njëherë në vit në mesin e gënjeshtrave dhe demagogjive që kanë dalë në shtyp nga dora jote për çdo ditë! Si është e mundur të duhen në të njëjtën kohë nga i njëjti njeri Marksi dhe Hitleri, ta zëmë, ose Ivo Andriqi dhe Ismail Kadareja, Rankoviqi dhe Ismail Qemali, xhelati Tito dhe shoku Enver…? Si bën të duhen njësoj Shqipëria dhe konglomerati jugosllav, dhe në fund të ngulësh këmbë se je, megjithatë, patriot e digjesh për bashkimin e tokave shqiptare si ideal shekullor për popullin tonë?!

A e vlen më në fund barra qiranë?

Të lëshosh dhjetëra gënjeshtra të kurdisura nga armiku, në mënyrë që të fitosh kredi për ta thënë një të vërtetë gjysmake – ky qenka taktizim? Më në fund, kush do t'i besojë edhe të vërtetës sate? Populli mund të thotë se, për ta ngrënë një pite, paske pranuar të hash dhjetë bajga. Populli jo që nuk është në gjendje të kuptojë këmbënguljen tënde për "taktizim", ai nuk do ta falë këtë gjë. Ai don që bijtë e tij t'i takojnë gjithmonë, të pacënuar vetëm popullit. Asnjëherë armikut! Nëna shqiptare, më shumë të do të torturuar nëpër burgje, apo edhe të vdekur, sesa të shitur te armiku, ose të ligur para armikut. Ty të lig lavdata e armikut dhe përulja jote para tij.

Populli ka shumë sy. Ke gabuar nëse mendon se ata sy nuk të shohin e nuk të përcjellin. Populli gjykon dhe gjykimi i tij është i pagabueshëm. A s'dëgjon si ka zënë të pëshpërisë populli: "Këta nëpunësit sapo janë studentë, po janë tanët, kur po ulen në kolltuk, po e harrojnë baltën tonë!"

Është koha e fundit, çasti vendimtar, shansa e mbrame të braktiset "taktika" dhe të bëhet ajo që nuk është bërë deri më tash: të kalohet nga radhët e armikut, atje ku është vendi i vërtetë i intelektualit tonë – në radhët e popullit. Intelektuali ynë duhet të veprojë kështu sa më parë, në mos për gjë tjetër, atëherë për arsye shëndetësore. Sot për sot ai çon një jetë të dyzuar; publikisht shtiret projugosllav, në brendësi patriot shqiptar. Ky regjim i dobët dhe jashtëzakonisht i rrezikshëm jetësor, duhet ndryshuar nga themeli, nëse nuk duam të pajtohemi me katastrofën. Dhjetë artikuj të mirë që do t'i shkruash për shtypin revolucionar, pa u rrezikuar së paku për një kohë as veprimtaria jote publike, janë ilaçi më i mirë për bigëzimin e rrezikshëm të personalitetit tënd, lëre pastaj shpërblimet që vijnë më vonë nga populli.

Të shkruash për shtypin ilegal, nuk do të thotë se je devalvuar. Situata aktuale i detyron intelektualët e "taktikës" dhe "evolucionistët" të tërhiqen nga jeta në iluzione. Ata janë të preokupuar me një jetë abstrakte, në kohën që armikun zhvillon aktivitet të gjallë, i cili në jetën e popullit tonë sjellë shkatërrime e shëmti. Ndërsa ujku u ka rënë ndërmjet shpatullave dhe copëton mishin e tyre, ata urojnë të jenë në ëndërr. Dhe, më e çuditshmja është se atyre, e kundërta e përgjumjes dhe e zhgrehjes në një jetë të sëmurë, u duket edhe njëfarë devalvimi. Veprimtaria patriotike e revolucionare, që ushtrohet në ilegalitet, atyre u duket se ua merr një kënaqësi të madhe, përmasën e afirmimit të shpejtë, ditor, në kushtet e jetës në robëri. Dhe pastaj vetë kthehen e të qahen se sa lehtë po afirmohet antivlera, kur kapet krah për krah me politikën e ditës! Megjithatë, ata ushqejnë iluzione se kanë shkruar diçka të vlefshme vetëm nëse këtë punë e kanë bërë në Pallatin e shtypit!

Çfarë të mire mund të kesh nëse ëndërron përjetësinë, e këndej nuk shkapesh se nuk shkapesh nga gjërat më banale të ditës. Të gjitha figurat e shquara të njerëzimit, kanë qenë shembull njerëzish të sakrificave. Kujto Sokratin, që u nxor në gjyq dhe u dënua nga injoranca, por nuk e shiti dot të drejtën për ta mbrojtur deri në fund të vërtetën. Kujto Xhordano Brunon, që inkuizicioni e kalli në turrë të druve, për shkak të ideve të tij përparimtare, për të cilat e dha edhe jetën pa hezitim. Haki Stërmilli ynë shpëtoi përpak nga varja e sigurt prej "inkuizicionit" zogollian, e shpëtuan protestat dhe përçapjet energjike të Albert Ajnshtajnit, H. Barbysë, S. Katajamas, Lesingut… Kujto sidomos

shokun Adem Dema-Demaçi, i cili e ka më të shtrenjtë të vërtetën dhe të drejtën e popullit të vet sesa rininë dhe jetën në robëri.

Nga çasti që do ta braktisni ´taktikën´ tuaj e të kaloni në punë intensive revolucionare, ilegale, do t´ju kaplojë një ndjenjë e fuqishme turpi për gjumin e gjatë që keni bërë si ariu në shpellë. Por populli ka zemër të madhe dhe do t´jua falë gabimet, nëse ktheheni me seriozitet kah populli për t´i shërbyer drejtpërdrejt në çështjen e madhe të çlirimit. Prandaj, shfrytëzoni sa më parë këtë shansë!

Mund të filloni menjëherë. Ju e dini konkretisht se nga mund t'ia nisni. Në radhë të parë shikoni si venë punët në vendin tuaj të punës dhe në rrethin tuaj. Bëni edhe një rishqyrtim të problemeve dhe shikojini ato në kuadër të robërisë dhe të diskriminimit të popullit tonë nga ana armikut jugosllav. Pastaj, si intelektualë që jeni, nëse e zotëroni sado pak shkrimin, do të dini t'i lidhni faktet ashtu si e implikon logjika e objektivitetit dhe jo demagogjia revizioniste. Nëse nuk keni prirje vetë për shkrim, gjejeni shokun dhe "furnizojeni" me informata.

Tema ka mjaft. Ato duhet të lidhen me krimet e padrejtësitë, me diskriminimin social, nacional, ekonomik, shoqëror e kulturor që po pëson populli ynë nga armiku mizor.

Duke i përcjellë dorë pas dore, me njerëz të besueshëm, punimet tuaja do të arrijnë te ne dhe, pasi të botohen, do të hyjnë në shërbim të drejtpërdrejtë të masave popullore.

Ju presim, pra, me krahët të hapur, korrespondentë popullorë, dhe ju urojmë që tani punë të mbarë revolucionare e patriotike në shërbim të çështjes së madhe të çlirimit. (Bashkimi, janar 1981, faqe 3)

19. LANGONJËT NË GJAH PËR ZOTËRINË

Prej goje në gojë, prej veshi në vesh – kjo ishte rruga e sihariqit: "Luma nuk po e paguen vergjinë, ka dalë në mal kundër turkut". Rruga e haberit të zi: "Xhandarët e rrethuan shtëpinë e Demë Ahmetit, kur nuk gjetën mashkull brenda, e banë rrafsh me tokë; plakat e fëmijët i ngulën në syngji, nuset e vajzat e reja desh i çnjerëzuen."

Gojë më gojë e vesh më vesh qitej edhe fjala e kushtrimit: "O bini burra se na ra shkjau; kush a trim, le të dalë në luftë, e t'ia përcëllojmë thembrat këtij gjakësori të egër.!"

Televizori e radioja nuk ishin, as në mendjen e njerëzisë nuk ishin lindur akoma, lëre më nëpër shtëpitë e tyre. Dikur vonë delte edhe ndonjë gazetë. Po lexuesit ishin të paktë. Errësirë kishte këndi ynë i brishtë i këtij planeti. Kishte ndonjë shkollë, po ato i kishte armiku për vete, jo për shqiptarin.

Po edhe lajmet e gazetave sikur e ndienin veten keq në letër, braktisnin rrugën e shkronjave dhe përhapeshin rrugës së rrahur prej motesh: gojë më gojë e vesh më vesh. Kështu u krijua rruga dredhake e informimit gojor.

Po në stomin tjetër të kësaj rruge përgjonte armiku.

Armiku e kishte shkollën. Dhe, megjithëqë shkolla është për ndriçimin e mendjen së një populli, natyrisht në kushte normale, dhe jo për shfarosjen e popullit tjetër, armiku ynë ka hequr më shumë keq se si ta shfarosë shqiptarin se sa për ta përparuar popullin e vet.

Edhe kralët e moçëm jugosllavë, edhe këta të sotmit; revizionistët e Beogradit, kanë hapur shumë institucione "shkencore" si Ozna, UDB-ja etj., që kanë për qëllim të mbledhin informata lidhur me shqiptarët, për të gjetur pikat më të dobëta në qëndresën e

tyre ndaj asimilimit dhe gjenocidit. Në këto institute kanë shërbyer e shërbejnë edhe njerëz të shquar nga jeta politike dhe shoqërore e Jugosllavisë, si shkrimtari nobelist Ivo Andriq, historianët Vasa Qubriloviq, Atanasije Urosheviq* etj. "Merita" e tyre konsiston në hartimin e elaborateve të ndryshme dhe të studimeve të errëta lidhur me mjetet, metodat dhe mundësitë për ndarjen e Shqipërisë ndërmjet Serbisë e Italisë, ndërmjet Serbisë e Greqisë, ndërmjet dreqit e të birit, dhe për shfarosjen e shqiptarëve të Kosovës me viset e tjera shqiptare përkëndej kufirit kombëtar shqiptar.

Duke mësuar pak nga pak disa zakone të shqiptarëve, UDB-ja ngriti disa sektorë të posaçëm për rekrutimin e agjentëve. Ata stimuluan te shqiptarët përhapjen e informatave "gojë më gojë e vesh më vesh". Qëllimi i fundit: në një anë prekja e pulsit të shqiptarëve dhe ngritja e kurtheve për patriotët dhe revolucionarët tanë, në anën tjetër infiltrimi i informatave të rrejshme, të cilat, duke u përhapur nga goja e vet popullit, do të ushtronin efekt më të madh sesa shtypi, radioja e televizioni. (Nga vetë logjika e aksioneve të tilla të UDB-së del që shqiptari nuk i konsideron të vetat këto institucione publike, ndryshe do t'u besonte më shumë se fjalës në vesh. Vërtet, pjesa më e madhe e popullit tonë konsideron se gazeta e radiotelevizioni ose janë krejtësisht kopalla ose gjëra që bluajnë në vete sherre të mëdha për shqiptarin.)

Një nga pykat që rrehin me këmbëngulje agjentët e UDB-së qe afro dyzet vjet, është zbehja ose shuarja e dashurisë së shqiptarit me banim në Jugosllavi ndaj Atdheut të tij, Shqipërisë. Agjentë të tillë lehin në hënë: "Na shiti Shqipëria", "Shqipëria nuk interesohet për ne", "Shqipëria nuk tha gjë për dëbimin e shqiptarëve nga tokat e tyre dhe për mërgimin e tyre në Turqi", "Shqipëria po i kthen Jugosllavisë patriotët që kërkojnë strehim në Shqipëri", "Shqipëria nuk po reagon për terrorin e madh që ushtrohet mbi patriotët dhe revolucionarët tanë që dergjen nëpër burgjet e Jugosllavisë"**, e shpifje të tjera. Kështu llomotisin kudo langojtë e UDB-së: në kafene, në shitore fshatrash, në dasma, në varrime, në shkolla e gjetkë. Kudo ku bëjnë kuvend të madh a të vogël shqiptarët. Ata flasin me "diskrecion": "Ta them në besë, si vëllaut, shih se po të na dëgjojë kush, vaj halli!"

Po a mashtrohet një popull?!

Shqiptarët, kudo që të jenë, e dinë mirë në të kujt shërbim ishte tradhtari Koçi Xoxe. E dinë se, për parat dhe postin e premtuar nga revizionistët jugosllavë, ky tradhtar tradhtarësh desh ta shiste Shqipërinë, për t'ia futur në grusht Jugosllavisë, si republikë të saj të shtatë. Populli ynë e di kish ishin vëllezërit prej tradhtie të Koçi Xoxes, të vënë në shërbim të Rankoviqit e të Titos, ata që delnin në Shqipëri gjoja si patriotë të arratisur nga UDB-ja, po me qëllimin e vetëm që atje të mblidhnin të dhëna e të kryenin diverzione, për ta shembur Shqipërinë socialiste dhe për ta minuar qëndresën shqiptare të kosovarëve ndaj asimilimit dhe gjenocidit. Po partia syshqiponjë me prijësin e madh Enver Hoxha në krye, i zbuloi një për një dredhitë e komplotet dhe agjenturës jugosllave ia ktheu prapa këlyshët tradhtarë, vëllezërit e Fadilëve, Xhavitëve, Mahmutëve, Sinan-hasanëve, Shaban-kajtazëve etj. (me numër – afro 4500 të tillë vetëm nga lufta e këtej). Ose i shpërbleu në vend, me plumb kokës, siç do të shpërblehen nga populli të gjithë tradhtarët dhe spiunët.

Shpifjet dhe dredhitë e rrezikshme të qeverisë së Beogradit, të përpunuara në UDB-në famëkeqe, po demaskohen ditë për ditë, popullorçe, "gojë më gojë e vesh më vesh", po edhe nga shtypi ynë revolucionar. Kështu po ia kthejmë armikut prapa grushtin e tij të drejtuat prej nesh, deri sa një ditë të mos na mbledhë të gjithë bashkë kushtrimi i luftës nacionalçlirimtare dhe fitorja jonë e plotë mbi pushtuesin e egër.

---

* Konkretisht për këtë shiko në elaboratin e Ivan Vukotiqit, të hartuar më 3 shkurt 1939, për nevojat e qeverisë së Stojadinoviqit; një pjesë të këtij elaborati po e botojmë në këtë numër.

* Se sa na ka "harruar" Shqipëria mëmë, mund të shihet qoftë edhe vetëm nga artikulli "Kush përgjigjet për krimet e gjenocidit në Kosovë", që po e botojmë gjithashtu në këtë numër. (Bashkimi, janar 1981, faqe 5)

20. KREATORI I ROBËRISË

(Pjesë nga elaborati i Ivan Vukotiqit për ndarjen e Shqipërisë dhe shpartallimin e rezistencës së kosovarëve)

(Trojet shqiptare në të kaluarën qenë bërë objekt preokupimi jo vetëm për Fuqitë e Mëdha. Në radhë të parë fqinjët e Shqipërisë, në Ballkan po edhe përtej Adriatikut, bënin kombinime se kush do të merrte më shumë nga tokat shqiptare. Për këtë atyre u jepte dorë atmosfera militariste e kapitalizmit dhe e imperializmit, me fashizmin gjerman e italian, i cili po bëhej gati për ta shpërthyer Luftën e Dytë Botërore. Në koniukturat e kohës kurrë nuk la pa u përzier as Jugosllavia, kur ishte fjala për grabitjen e tokave shqiptare dhe për shfarosjen e popullit shqiptar, qoftë në shtetin tonë kombëtar, qoftë jashtë kufijve të tij. Këtu po sjellim një pjesë të elaboratit të Ivan Vukotiqit lidhur me Shqipërinë dhe shqiptarët e për nevojat e qeverisë jugosllave të Stojadinoviqit, hartuar më 1939.)

Sipas marrëveshjes së arritur në mbledhjen e Venedikut ndërmjet Stojadinoviqit dhe ministrit italian të punëve të jashtme, kontit Galezzo Ciano (18 qershor 1938), Cianoja erdhi sërish në Jugosllavi në janar të vitit 1939 dhe, në Belje e në Beograd, bëri biseda të gjata e konspirative me Stojadinoviqin.* Duke folur përgjithësisht për pozitën e jashtme politike të Jugosllavisë, Stojadinoviqi ia përsëriti shefit të diplomacisë italiane faktin se për Jugosllavinë është më se e nevojshme t'i ruaj marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe të bashkëpunimit me Gjermaninë; nga ana tjetër Jugosllavia është e gatshme t'i përmirësojë marrëdhëniet me Hungarinë. Orientimet parimore të politikës së jashtme jugosllave në të ardhmen e afërme, ai i formuloi kësisoji: afrim gjithnjë më i theksuar me Romën, dhe sipas kësaj, me Boshtin; dalje faktike nga Lidhja e Kombeve me tërheqjen e delegacionit nga Gjeneva, në maj të vitit 1939; shqyrtimi në frymë të përshtatshme, i hyrjes eventuale të Jugosllavisë në paktin kundër Kominternit, veçmas po që se nga ana gjermane arrin për Jugosllavinë aviza sesi kjo gjë do të pritej mirë në Berlin. Por, në këto biseda, vëmendjen më të madhe ata ia kushtuan Shqipërisë, dhe me atë rast Stojadinoviqi ia tërhoqi vërejtjen Cianos për dy zgjidhje të mundshme: 1) që mbretin Zog ta zëvendësojnë me ndonjë personalitet më të denjë për fronin shqiptar, por as ai (Stojadinoviqi – shën. i J.G.) nuk e di kush mund të jetë ai personalitet; 2) që Shqipërinë ta ndajnë mes vete Italia e Jugosllavia. Me atë rast ai shtoi se, lidhur me këtë çështje nuk mund të bisedojë hëpërhë, sepse nuk e ka studiuar hollësisht. Mirëpo, ndërsa Stojadinoviqi fliste për ndarjen e Shqipërisë, Cianoja gjithmonë fliste për korrektura kufitare ndaj Jugosllavisë!

Pas largimit të Cianos, Stojadinoviqi kërkoi nga ministria hartimin e elaborateve përkatëse për Shqipërinë dhe për çështjen e ndarjes së territorit shqiptar. Janë ruajtur dy

elaborate interne lidhur me këtë çështje: njëri i nëpunësit të lartë të ministrisë, Ivan Vukotiq, i hartuar më 3 shkurt 1939; tjetri i ndihmësit të tij të atëhershëm, Ivo Andriq, më 10 janar 1939.

Vukotiqi niset nga kjo: "Që në fillim do të them se bashkimi i Shqipërisë veriore dhe i disa pjesëve të Shqipërisë së mesme me vendin tonë, është një nga interesat jetësore të popullit tonë. Ky do të kishte qenë realizimi i aspiratave tona të natyrshme dhe sendërtim i dëshirave tona shekullore." Vukotiqi përmend këto arsye: 1) Populli shqiptar, gjatë historisë së vet, ka qenë vegël e politikës dhe e qëllimeve të të huajve, vegël e Turqisë, Austrisë, e kohën e fundit – e Italisë. Shqiptarët kurrë nuk kanë qenë solidarë me popujt e tjerë të Ballkanit. Nga ana tjetër as ne nuk kemi pasur kurrë simpati ndaj tyre. "Në kombinacionet tona politike e diplomatike dhe në politikën tonë ballkanike, gjithmonë kemi synuar t'i thyejmë të gjitha kërkesat shqiptare për formimin e shtetit të pavarur, nga shkaku i thjeshtë se ai shtet ka mundur të formohet vetëm kundër nesh dhe kundër aspiratave tona nacionale." Me atë rast Vukotiqi e përmend edhe këtë: "Derisa Konferenca e Ambasadorëve në Paris përcaktonte kufijtë e Shqipërisë, Pashiqi, në qershor të vitit 1921, zhvillonte bisedime me italianët dhe kishte pranuar që Shqipëria të ndahej ndërmjet nesh dhe Italisë, me kusht që ne të fitonim një zgjidhje më të mirë se sa ajo që parashikohej me marrëveshjen e Londrës të vitit 1915. Me këtë propozim nuk qe pajtuar qeveria jonë e atëhershme, kështu që propozimi nuk qe realizuar. Me rastin e negociatave tona me Italinë, më 1924, nënsekretari shtetëror italian i punëve të jashtme, Kontarini, la të kuptohej mundësia e ndarjes së Shqipërisë, ose së paku ndarja e sferave të interesit mes vendit tonë e Italisë. Kontarini pat deklaruar atëherë sesi Shqipëria është pika më e ndjeshme në marrëdhëniet italo-jugosllave, prandaj, po të zgjidhej në mënyrë të favorshme kjo çështje, do të mund të krijohej epoka e paqes dhe e miqësisë ndërmjet Jugosllavisë dhe Italisë. Më 1926 qenë bërë të fundmet përpjekje serioze për rregullimin e marrëdhënieve tona me Italinë sa i përket problemit shqiptar. Dhe atëherë çështja pat dështuar për arsye të shumta." "Bëhet fjalë për çështjen – vazhdon Vukotiqi – pse qarqet tona zyrtare pritonin t'i hynin ndarjes së Shqipërisë me Italinë. Nga arsyet është përmendur edhe ajo se Italisë, si fuqi e madhe e shtet joballkanik, nuk duhet t'i lejohet të vërë këmbë në Ballkan. Është cekur parimi i vjetër 'Ballkani popujve të Ballkanit'. Nuk është parashikuar forcimi kaq i papritur i Italisë dhe i rëndësisë së saj ndërkombëtare. Besohej se Shqipëria nuk do të konsolidohej për shumë vjet dhe se ne do t'ia dalim ta përforcojmë pozitën tonë në Shqipëri, duke e shmangur plotësisht Italinë. Asnjë nga këto parashikime, në të cilat është mbështetur politika jonë lidhur me pavarësinë e Shqipërisë, nuk është realizuar. Përkundrazi, gjithçka ngjau ndryshe. Shqipëria po konsolidohet dhe po bëhet qendër e irredentës (sic) për arnautët tanë.** Italia ka shkelur në Ballkan dhe e ka në dorë jo vetëm Sazanin, e përmes tij kanalin e Otrantit, por edhe kontrollin e gjithë administratës shqiptare, ushtarake e civile. Ky është një fakt që s'kapërcehet dhe s'mohohet dot. Kur është puna kështu, është gjë e thjeshtë dhe e qartë se në interesin tonë është që Italia të mbaj vetëm një pjesë të saj, jo tërë Shqipërinë. Sikur për ndarjen e Shqipërisë të mos ekzistonin fare arsye të tjera, do të mjaftonte edhe vetëm e vetëm kjo arsye." 2) Me pozitën e saj gjeografike, Shqipëria – sipas Vukotiqit – është pengesë për zhvillimin ekonomik të shtetit jugosllav, kurse, me ndarjen e Shqipërisë, kufiri ynë në hinterland do të shkurtohej për ndonja 300 kilometra. 3) Shteti dhe monarkia shqiptare janë qendër tërheqëse për një pjesë të madhe të shqiptarëve, që jetojnë buzë kufirit. Me pushtimin dhe aneksimin e Shqipërisë veriore do të mbytej irredenta shqiptare, e rrezikshme për krahinat tona në jug. Elementi luftarak shqiptar në territorin tonë do të përfshihej nga lindja e perëndimi dhe do të dënohej me një asimilim më të shpejt. 4) Kurdo që është bërë fjalë për ndarjen e Shqipërisë, kërkesat tona maksimale kanë shkuar deri te lugina e Shkumbinit. Gjithashtu, linja Strugë-Librazhd-Elbasan-Durrës do t'i

kënaqte plotësisht kërkesat tona… "Ndarja e Shqipërisë dhe bashkimi i krahinave të saj veriore dhe qendrore me Mbretërinë tonë, do të kish qenë për ne sukses i madh kombëtar dhe sendërtim i aspiratave tona të natyrshme. Do të përmirësohej pozita jonë strategjike në këtë pjesë të kufirit. Do të arriheshin leverdi të paçmuara ekonomike e, me lidhje natyrore, do të bashkoheshin dy krahina të rëndësishme, e Zetës dhe e Vardarit. Do të likuidohej irredenta shqiptare (!), dhe shteti shqiptar, i menduar dhe i krijuar nga armiqtë tanë." Prandaj Vukotiqi përfundon se duhet të shfrytëzohet situata e volitshme që, me ndarjen e Shqipërisë, të kryhet një vepër e madhe popullore.

---

* Interpretimin e elaboratit të Vukotiqit e ka bërë historiani kroat Bogdan Krizman, duke e botuar në revistën "Casopis za suvremenu povijest", tok me në elaborat të ngjashëm të shkrimtarit Ivo Andriq.

** Për Shqipëri, Vukotiqi përdor termin Arbanija, shqiptarët i quan herë Arbanasi e herë Arnauti. Këtu e ka fjalën konkretisht për shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera nën Jugosllavi. (Bashkimi, janar 1981, faqe 5)

21. NJOFTIM

"Lexuesit e ndershëm të "Bashkimit" i njoftojmë se, duke filluar nga ky numër, gazeta jonë do të dalë rregullisht, për ndryshim nga praktika jonë e deritashme që "Bashkimin" ta nxjerrim vetëm kohë pas kohe. Kjo gjë është bërë në saje të konsolidimit të dukshëm të forcave të Frontit të Kuq Popullor dhe të forcave krijuese të mbledhura rreth kësaj organizate.

I ftojmë gjithë ata lexues, që mund të kontribuojnë në krijimin e kësaj gazete të popullit, të paraqiten me artikujt e tyre, pasi ta kenë gjetur mënyrën, sipas këshillave që dalin nga disa artikuj të botuar në këtë numër.

Po kështu shpresojmë se në të ardhmen do të jemi edhe më efektivë në shpërndarjen dhe propagandimin në popull të gazetës 'Bashkimi'." (Bashkimi, janar 1981, f.8)

22. "BASHKJETESA" E XHELATIT ME VIKTIMËN

Revista "NIN" e Beogradit, nëpërmjet intervistash me funksionarë të lartë shtetërorë, nga numri në numër po e shtron çështjen e bashkëjetesës së popujve të Jugosllavisë në federatën jugosllave. Natyrisht, ndonëse ky paraqet një hap të çuditshëm të kësaj reviste, pas të cilit mund të supozohet se qëndron kryekëput qeveria dhe i cili sigurisht fsheh ndonjë qëllim tinëzar, s'ka kurrfarë "rreziku" se mund të pyeten popujt e Jugosllavisë sa e duan dhe a e duan fare ata "bashkëjetesën". Sa për popullin shqiptar, e sidomos për pararojën e tij patriotike dhe revolucionare, nuk shtrohet fare çështja e bashkëjetesës me popujt e tjerë në kuadër të kufijve administrativë të Jugosllavisë. Kjo "bashkëjetese" është e dhunshme dhe e paligjshme, sepse viset shqiptare në Kosovë, Dukagjin, Maqedoni, Mal të Zi e në Serbi janë vise shqiptare, që trungut të përbashkët shqiptar iu shkëputën në mënyrë të paligjshme, në kushte të errëta historike dhe kundër vullnetit të popullsisë vendëse shqiptare. Që nga fillimi i këtij akti barbar, të kryer në fillim të shekullit tonë dhe të përsëritur edhe njëherë pas Luftës II botërore nga fuqitë e mëdha e nga forcat më të errëta jugosllave, mbi popullsinë tonë u ushtrua politika e asimilimit dhe e gjenocidit. Dhe që atëherë, politikës së tillë barbare, populli ynë iu përgjegj me një rezistencë të pandërprerë. Aktualisht, rezistenca e fuqishme po spontane e popullit tonë, përditë e më shumë po merr përmasa të një

lëvizjeje të organizuar, e cila nesër do të na çojë në luftën e përgjithshme çlirimtare - kombëtare e klasore dhe në bashkimin me vendin amë të shqiptarëve, Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë. Por, për t'iu treguar renegatëve dhe tradhtarëve të mëdhenj e të vegjël shqiptarë të të gjitha ngjyrave, që interesat jetike dhe aspiratat shekullore të popullit të vet i kanë shitur për një kockë të hedhur apo për një pozitë të mjerë në administratën revizioniste jugosllave, këtu poshtë po nxjerrim disa të dhëna nga premisat e jetës ekonomike, politike e shoqërore, që janë rrjedhim i kësaj "bashkëjetese", e cila s'është gjë tjetër pos bashkëjetesë e xhelatit me viktimën.

KALIFORNIA E VOGËL BANGLADESH I MADH

Po të nisemi nga rezervat natyrore të Kosovës, nga toka e saj cilësore dhe kushtet e favorshme klimatike e gjeografike, Kosova, me një trajtim të barabartë ekonomik, do të kish qenë ndër viset më të zhvilluara në gjithë territorin administrativo-politik të Jugosllavisë. Kosova plotëson 64 % të të gjitha rezervave jugosllave të thëngjill-linjitit, 57 % të rezervave të plumbit dhe zinkut, 24% të rezervave të hekur-nikelit, 30% të të gjithë energjisë elektrike etj. Në Kosovë gjenden gati të gjitha rezervat "jugosllave" të argjendit e të kromit dhe pjesa më e madhe e rezervave të arit.

Për konfiguracionin e saj, raportin shumë të favorshëm të sipërfaqeve të punueshme të tokës ndaj atyre të papunueshme, me një bimësi të dendur etj., Kosova është bërë që moti me një emër të dytë të popullarizuar - Kalifornia e Ballkanit.

Edhe popullsia e Krahinës sonë është jo thjeshtë një popullsi punëdashëse, po njëherit një popullsi, që siç i thonë fjalës, e ka pasur mall punën në plang e shtëpi të vet. Sot vullnetit të madh të kësaj popullsie i është shtuar edhe një potencial i madh i krahut të punës, me një strukturë gjithnjë më të volitshme arsimore, madje me ekspertë gati për të gjithë lëmenjtë e jetës.

Po gjendja e tashme e saj, megjithatë është jashtëzakonisht e mjerueshme. Në saje të politikës diskriminuese e kolonialiste të Jugosllavisë, Krahina jonë ka mbetur regjioni më i pazhvilluar jo vetëm në Jugosllavi, po edhe ndër më të pazhvilluarit në botë. Rezervat natyrore të saj grabiten nga federata jugosllave në trajtë lëndësh të para dhe, pasi të jenë përpunuar në republikat industrialisht më të zhvilluara jugosllave, i shiten Kosovës me çmime të shumëfishuara. Përveç kësaj një rol minues për ekonominë kosovare luan politika diskriminuese e çmimeve. Lëndët e para të Kosovës, në tregun e brendshëm jugosllav shiten me çmime shumë më të ulëta se ato në tregun botëror. Vetë Kosova, prodhimet finale, të përpunuara në republikat e zhvilluara, i blen me çmime deri 124% më të larta se çmimet e tregut botëror.

Në saje të kësaj politike diskriminuese bujqësia e Kosovës, me të cilën është e zënë pjesa më e madhe e popullsisë sonë aktive, ka mbetur në nivelin e një bujqësie ekstensive e me produktivitet jashtëzakonisht të ulët. Toka e punueshme, për shkak të masave të hershme e të vona administrativo-politike që ka marrë Jugosllavia për të bërë presion mbi popullsinë vendëse, është e copëtuar në ngastra shumë të vogla. Në qoftë se në një të kaluar bujqësia siguronte për popullsinë kosovare punëdashëse një ekzistencë solide, ajo sot nuk ka si ta siguroj as kafshatën e gojës për pronarët e saj të imtë.

Ndërkaq, puna në të ashtuquajturin sektor shoqëror, paraqitet edhe më ligsht për shqiptarin e Kosovës. Ky sektor ka një aftësi fare të vogël absorbuese të fuqisë punëtore, gjithsej 6400 punëtorë të inkuadruar në vit (këto 3-4 vitet e fundit). Përballë ritmit të

shpejtë në shtimin e krahut të ri të punës, shkalla e punësimit te ne kufizohet me papunësinë totale.

Gjithë kjo ka pasur për pasojë një lëvizje të atillë të popullsisë së aftë për punë, e cila nuk mbahet mend për asnjë periudhë tjetër historike të Kosovës, madje emigrimet e popullsisë sonë thuaja se nuk kanë qenë më masive as në periudhat e shpërnguljeve të mëdha e të dhunshme për në Turqi.

A IA BËJMË KINSE PO BASHKJETOJMË

Për të parë se sa është e arsyeshme, e leverdishme dhe e domosdoshme bashkëjetesa e shqiptarëve me popujt tjerë të mbërthyer brenda kufijve administrativo-politikë të Jugosllavisë revizioniste, po e bëjmë një krahasim të ndarjes së të ardhurave personale të punëtorëve në Republikën e Sllovenisë dhe në Kosovë. Tabela që po e botojmë këtu, është bërë sipas të dhënave të Entit Federativ Statistikor dhe paraqet gjendjen në muajin mars 1979.

Në kohën në shqyrtim, Sllovenia kishte 1 milion e 826 mijë banorë, Kosova po aq, 1 milionë e 600 mijë. Por, në këtë kohë, numri i të inkuadruarëve në Slloveni, 780 mijë, ishte gati 5 herë më i madh se ai në Kosovë (167 mijë - fjala është për sektorin shoqëror). Punëtorët e Sllovenisë realizonin së bashku 5 miliardë e 38 milion e 878 mijë dinarë të rinj kurse ata të Kosovës vetëm 909 milion e 649 mijë dinarë, ose më se 6 herë më pak.

Punëtorët sipas lartësisë së të ardhurave personale (mars 1979)

	SLLOVENIA	KOSOVA
Të ardhurat personale	PUNËTORË	PUNËTORË
Deri në 3 000 dinarë	2 340 ose 0,3%	25 217 ose 15,1%
3 001 - 4 500	111 540 ose 14,3%	72 144 ose 43,2%
4 501 - 6 000	244 140 ose 31,3%	39 579 ose 23,7%
6 001 - 8 000	241 020 ose 30,9%	18 704 ose 11,2%
8 001 - 10 000	104 520 ose 13,45	7 014 ose 4,2%
Mbi 10 000 dinarë	76 440 ose 9,8 %	4 342 ose 2,6%

Është jashtëzakonisht të shohim se në përqindjeje paraqiten përkatësisht punëtorët e Sllovenisë dhe ata të Kosovës në ndarjen e të ardhurave të ulëta dhe rrogave të larta. Siç shihet edhe nga tabela, sa më e ulët të jetë shkalla e të ardhurave aq më e lartë është përqindja e punëtorëve kosovarë që marrin pjesë në ndarjen e tyre; dhe anasjelltas, sa më shumë të ngjitet shkalla e të ardhurave, aq më i vogël bëhet numri i punëtorëve që marrin pjesë në ndarjen e tyre (në Kosovë) dhe aq më i madh numri i punëtorëve të Sllovenisë, që i gëzojnë ato të ardhura të larta. Konkretisht, paga me lartësi deri në 3000 dinarë marrin vetëm 2340 punëtor sllovenë, ose 0,3% e të të gjithë të inkuadruarëve të kësaj republike, dhe 25217 punëtorë kosovarë, ose 15,1% e të të gjithë të inkuadruarëve të Krahinës sonë. Nga 3000-4500 dinarë marrin 14,3% punëtorë sllovenë dhe 43,2% punëtorë kosovarë; nga 4500-6000 dinarë marrin 31,3% punëtorë sllovenë dhe 23,7% kosovarë; nga 6001-8000 dinarë marrin 30,9% sllovenë dhe 11,2% kosovarë; nga 8001-10000 dinarë 13,4% sllovenë dhe 4,2% kosovarë, dhe, mbi 10000 dinarë 9,8% sllovenë dhe vetëm 2,5% kosovarë.

Kur kësaj t'ia shtojmë edhe faktin se papunësia në Kosovë është 20 herë më e madhe se në Slloveni dhe absolutisht më e madhja në gjithë Jugosllavinë, atëherë bëhet e qartë se bashkëjetesa 68-vjeçare me popujt e Jugosllavisë ka qenë për ne, shqiptarët me banim në Jugosllavi, një nga periudhat tona më të vështira e më të rrezikshme për shfarosje të plotë.

TELALLI THOTË:
BESOMË EDHE NË GËNJEFSHA

Revizionistët jugosllavë, këta telallë absurd të "socializmit specifik", "mosangazhimit", "vëllazërim-bashkimit", "barazisë" së kombeve e kombësive, i shtrembërojnë në mënyrë drastike disa fakte vitale karshi opinionit të vendit dhe atij botëror. Ndër të tjera, atyre ua do puna të mos flasin kurrsesi me të dhëna reale kur është fjala për papunësinë në disa vise të caktuara, sidomos në Kosovë.

Sipas kritereve, me të cilat vlerësohet problemi i papunësisë në shkallë jugosllave, del se numri më i madh i të papunëve është në Maqedoni, po edhe atje vetëm 5,7 për qind. Vendin e dytë e zë Serbia me 4,7 për qind të papunë, ndërkohë që në Kosovë, sipas këtyre kritereve, as qe ekziston problemi i papunësisë! Në Krahinën tonë, gjithnjë sipas këtyre kritereve, që as "Rilindja" revizioniste nuk durohet pa i quajtur "sa mashtruese, aq edhe joreale", të papunë qenkan vetëm 3,7 për qind.

Ku është nxjerrë vallë ky 3,7 përqindësh famoz?! Ose, edhe përqindja e të papunëve në regjione tjera! Pasi, siç e pranon edhe vetë Enti Federativ i Statistikave, Jugosllavia zë një nga vendet e para në botë përnga shkalla e papunësisë.

Këto "fakte" i kundërshton edhe vetë "Rilindja", duke u mbështetur, siç thotë, "në disa mjete tjera të informimit në Jugosllavi". "Po të vlerësohet papunësia me kritere reale, shkruan ajo, sipas një analize, del se papunësia në vend është 12 për qind, ndërsa në Kosovë 27 për qind; në Bosnjë e Hercegovinë 13,5 për qind, në Maqedoni 21,3 për qind, në Serbi 11,9 për qind, e të tjera. Papunësia në Slloveni, 1,4 për qind, është njëzet herë më e vogël se ajo në Kosovë".

"Rilindjes" do t'ia dinim për nder sikur pas botimit të kësaj informate të qëndronte edhe më në të njejtën pozitë, atleti i mirë që nuk bien nën rekordin që e ka hedhur një herë. Mirëpo, sado që të dëshirojmë ne, kështu nuk ngjan. Madje, artikulli në fjalë na duket më shumë t'iu ketë përvjedhë redaktorëve, sesa të jetë botuar esëll. Megjithatë, autori i informatës në fjalë, e meriton një përkrahje prej nesh, sado që edhe ai ha ngapak në peshojë.

Ja, pra, disa nga të dhënat për vitin 1978 që na ofron Enti Federativ i Statistikave dhe që na ndihmojnë t'i dalim krah gazetarit të "Rilindjes" dhe të vërtetën që e ka sheshuar ai.

Më 1978, Kosova kishte përafërsisht 1 milion e 525 mijë banorë. 799 mijë, ose 52,4 për qind e popullsisë së përgjithshme ishin banorë të aftë për punë. 167 mijë veta, ose 11 për qind e popullsisë së përgjithshme ishin të inkuadruar në sektorin e ashtuquajtur shoqëror, kurse aktiv në të gjithë sektorët gjithë krahina kishte vetëm 387 mijë vetë, ose 25,4% të popullsisë së përgjithshme. Po t'u besohet këtyre shifrave (më vonë do të shohim kundërthëniet e shumta që dalin prej tyre) atëherë del se më 1978 412 mijë banorë të aftë për punë kanë mbetur të papërfshirë në asnjë sektor të veprimtarisë. Dhe numri 412000 paraqet 27 për qind të popullsisë sonë të përgjithshme (1 milion e 525 mijë), e jo 3,7 për qind!

Përveç kësaj, siç vë në dukje edhe vetë "Rilindja", te ne afro "140 000 vetë për çdo vjet bëhen krah i ri pune". Kurse ekonomia, me aftësinë e mjerë absorbuese të fuqisë punëtore, mund të çelë vende pune vetëm për 6400 vetë në vit (që nga viti 1977 e këtej). Del që, prej katër vjetësh e këtej, ushtrisë së të papunëve në Kosovë i janë shtuar deri më tash edhe nja katër njësite të mëdha me nga 133 600 banorë, që, bashkë me të papunët e vitit 1978, bëjnë jo më pak se 946 400 veta.

Pra në vitin 1981, ne kosovarët po hyjmë me afro 1 milion të papunë!

Në qoftë shtuar më 1980 popullsia e Kosovës sipas parashikimeve të Entit Federativ (se me çfarë saktësie i bënë si parashikimet, mund të shihet edhe nga ky fakt. Në të njejtin publikim, "Kalendari Statistikor i RSFJ 1980", numri real i popullsisë së Sllovenisë figuron 1 626 000 banorë në vitin 1979, kurse i parashikuar i popullsisë së kësaj republike për vitin 1980, në vend që të jetë më i madh, figuron për 1000 banorë më i vogël, do të thotë - 1 625 000!), pra, në qoftë për t'u besuar këtyre "parashikimeve", atëherë fillimi i 81-shit e zë Kosovën me afro 1 592 000 banorë dhe vetëm me 179 000 të zënë në punë në të ashtuquajturin sektor shoqëror, ose me 11,3% e popullsisë. Një kosovar i zënë me punë në këtë sektor, do të ketë në kurriz mesatarisht 9 banorë (slloveni vetëm 1,7)!

3,7 përqindëshi që paraqitka sipas revizionistëve titistë, shkallën e papunësisë në Kosovë, duke "zëvendësuar" si me shkop magjik 30 përqindëshin, është nxjerrë nga 61000 të papunët që kërkojnë punë nëpërmjet enteve të inkuadrimit. Dhe për këtë numër kapen, si i mbyturi për kashtë, revizionistët, kur duan të na e hedhin syve, neve dhe botës. Mëkot do të ngulë këmbë edhe një pjesë e shtypit revizionist sesi "një numër i madh i kosovarëve të papunë, për shkaqe subjektive e dobësi të ndryshme (ne do të themi për shkak të pritjes së gjatë e të pa shpresë - "Bashkimi"), nuk paraqiten fare në BVI-të gjegjëse". Kjo për ata nuk ka asnjë domethënie. Ata duan që ky numër të përmendet, numrin e saktë e dinë më mirë se ne vetë dhe kënaqen. Por, po vjen dita që kjo kënaqësi t'u mbetet në fyt dhe t'ua zërë frymën.

SHPËRBLIMI I TË KOLONIZUARIT PËR KOLONIZATORIN

Kosovës i kërcënohet rreziku nga një lëvizje e atillë e popullsisë, që pjesa e saj e aftë për punë - strukturalisht më e reja dhe biologjikisht më e shëndosha - të braktisë vendlindjen dhe të marrë masivisht rrugën e hidhur të kurbetit për në republikat e zhvilluara jugosllave, në Evropë e më larg. Në pozitë më të vështirë në këtë pikëpamje janë vetëm edhe viset shqiptare në Maqedoni, Mal të Zi dhe në Serbi, për shkak të kompaktësisë më të vogël etnike të shqiptarëve në strukturën e përgjithshme të popullsive të këtyre republikave si dhe për shkak të masave edhe më të vështira administrativo-politike, të cilave u ekspozohen vlerat e përmendura shqiptare.

Po t'u drejtohesh statistikave jugosllave lidhur me emigrimet e popullsisë sonë në cilëndo periudhë brenda këtyre 68 vjetëve robëri ato i fshehin faktet si gjarpri këmbët. Ç'është e vërteta, numri 12000 kosovarë të inkuadruar në republikat e Jugosllavisë e në botën e jashtme, nuk ka mundur të fshehet në asnjë mënyrë. Dhe ky numër, edhe po të jetë vetëm kaq, paraqet një shkallë shumë të lartë e të rrezikshme të emigrimit karshi numrit të përgjithshëm të popullsisë së Kosovës, afro 10 për qind të popullsisë së aftë për punë. Por kjo shifër as që i afrohet numrit të vërtetë të kurbetçinjve "modernë" shqiptarë.

"Bashkësia krahinore për inkuadrim përmes enteve të saj të inkuadrimit e mban njëfarë evidence për këta punëtorë, por vetëm për ata që më parë janë paraqitur në këto

ente... Mirëpo një numër i madh i fuqisë punëtore punësohet në territoret e tjera të vendit përmes kanaleve të tjera, e sidomos me vetiniciativën e tyre. Prandaj, ky numër i punëtorëve të tillë gjithnjë është më i madh nga ai që evidentohet në entet përkatëse." (Dr. Hivzi Islami, "Popullsia e Kosovës", Prishtinë 1980, f. 123) Një shembull simptomatik lidhur me "objektivitetin" e të dhënave statistikore të këtyre enteve, na e ka dhënë po Dr. H. Islami në veprën e përmendur: "Derisa në vitin 1966 në tërë Slloveninë, sipas evidencës së shërbimeve krahinore të punësimit, ishin 217 punëtorë nga Kosova, vetëm në Lubjanë në atë vit ishin të inkuadruar 676 punëtorë nga kjo Krahinë."

Një shtrembërim i tillë i fakteve, me skandalozitetin që përmban në vete, nuk flet për lëshime të rastit, që nganjëherë mund të ndodhin edhe në statistikat më pedante. Përkundrazi, ai na shpie te një mjet sa perfid, aq edhe i preferuar i administratës jugosllave në drejtim të fshehjes së numrit të përgjithshëm të shqiptarëve me banim në Jugosllavi dhe të gjitha të dhënave që e tregojnë në mënyrë reale gjendjen e mjeruar të popullsisë sonë të përfshirë me dhunë brenda kufijve administrativo-politik të këtij armiku të përbetuar të farës sonë.

Këtë shtrembërim faktesh, revizionistët e realizojnë me mjeshtëri edhe në saje të përvojës më të hershme jugosllave në këtë drejtim. Edhe qëllimi kryesor mbetet po ai që ishte para 68 vjetësh; me plane të ngritura në shkallë shtetërore, viseve shqiptare nën pushtetin, viseve shqiptare nën pushtetin administrativo-politik të Jugosllavisë t'u ndërrohet në rrënjë struktura kombëtare. Për këtë qëllim u ndoqën mes dy luftërave botërore dhe pas Luftës II botërore më se 600 mijë shqiptarë dhe në vend të tyre u sollën në këto vise shumë e shumë kolonë të kombësive serbe e malazeze, e tani së fundi po sillen edhe maqedon nga Greqia. Dhe pikërisht për këtë qëllim po u jepet edhe sot rruga e mërgimit "ekonomik" shqiptarëve të robëruar. Ata i mban shpresa se edhe me trojet tjera shqiptare do të ngjajë ashtu siç ka ngjarë me Prespën dhe Ulqinin, banorët e të cilëve, për shkak të presionit ekonomik dhe politik, i kanë braktisur gati përgjithmonë vatrat e veta dhe kanë marrë në sy Amerikën e Australinë.

Natyrisht, është e tepërt dhe gati banale t'u thuhet revizionistëve gjakpirës jugosllav se këto shpresa të tyre nuk janë gjë tjetër pos qep me ujë.

Mbi të gjitha, ndërsa është arritur që ata të pranojnë cilësimin e shpërnguljeve të mëdha për në Turqi si migrime politike, përkatësisht të terrorit dhe të dhunës, ata i propagandojnë migrimet e sotme të shqiptarëve thjeshtë si një dukuri të rëndomtë ekonomike, të parrezikshme, madje edhe të dobishme, duke i lidhur këto migrime me gjoja inkuadrimin e Jugosllavisë në "ndarjen ndërkombëtare të punës". Po dokrrat e tilla nuk pinë ujë te populli ynë i shumëvuajtur. Pararoja patriotiko-revolucionare e Kosovës dhe e viseve të tjera shqiptare e di mirë se ne, për aq sa është çështje politike - bile e një politike diskriminuese që kufizohet me fashizmin e racizmin - niveli jashtëzakonisht i ulët i zhvillimit ekonomik të viseve shqiptare, aq është politike edhe çështja e emigrimeve të sotme, që janë pasojë e drejtpërdrejtë dhe e domosdoshme e diskriminimit të tillë. Dhe, e gjithë kjo s'është gjë tjetër përveç aplikim i mjeteve të reja "bashkëkohore" për sendërtimin e qëllimeve të vjetra kolonialiste e asimiluese.

Dhe ne, ja ku u premtojmë se do t'i shpërblejmë pikërisht ashtu si i ka hije të kolonizuarit ta shpërblej kolonizatorin: me zjarrin e fuqishëm të dekolonizimit dhe të çlirimit kombëtar. Dhe le ta shqyrtojnë ata vetmevete jerm çështjen se ç'të mira mund të dalin nga "bashkëjetesa" që na e ofrojnë në këmbim të lirisë së rrëmbyer.

(Bashkimi, janar 1981, faqe 9)

23. Perditio tua, Israel, ex te

Kosova, pas daljes nga robëria pesëshekullore turke, e cila u zëvendësua me një robëri edhe më të rëndë – atë sllave, në kohën që Shqipëria e sotme fitoi pavarësinë, më 1912, u nda në katër të ashtuquajtura banovina. Kjo ndarje kishte qëllime kryekëput politike dhe shërbente për t'i mbajtur sa më lehtë në zotërim shqiptarët e papërkulshëm, kurse katër banovinat u përgjigjen katër regjioneve, brenda të cilave është mbërthyer edhe sot populli shqiptar në viset e robëruara nga Jugosllavia e Titos: Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi dhe Serbi.

Dhuna, terrori, shpërnguljet në masë, djegia e fshatrave dhe e qyteteve shqiptare kishin për qëllim realizimin e planit shtetëror jugosllav për shfarosjen apo asimilimin e plotë të shqiptarëve, të cilët atëbotë qenë bërë prag i pakapërcyeshëm për daljen e Serbisë në Detin Adriatik dhe përgjithësisht për apetitet pansllave të monarkive të Serbisë dhe të Malit të Zi, më vonë Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve.

Megjithatë, që nga viti 1912 e këtej, megjithë zhdukjen e madhe fizike të shqiptarëve, nëpërmjet masakrave, vrasjeve dhe shpërnguljeve, në viset e robëruara shqiptare kurrë nuk ndërroi dukshëm fizionomia e tyre etnike: numri i shqiptarëve në këto vise mbeti gjithmonë numër dominant i popullsisë së përgjithshme në të gjitha regjistrimet e popullsisë që janë bërë deri më tash në Jugosllavi. (Në punimet historiografike dhe demografike, që po dalin kohëve të fundit ndër ne, vërehet vazhdimisht mekanizmi jugosllav për fshehjen e numrit të vërtetë të shqiptarëve që jetojnë në trojet e veta, me qëllim që fizionomia etnike e tokave tona të ndërrojë rrënjësisht me kalimin e kohës.) Edhe sot, shqiptarët paraqesin shumicën dërrmuese të popullsisë, deri në 80 e 98 për qind, në pjesën më të madhe të tokave shqiptare në Jugosllavi.

As Mbretëria e SKS dhe as Jugosllavia e Titos nuk hoqën dorë asnjëherë prej aspiratave shoviniste ndaj popullit shqiptar. Si njëra si tjetra merrnin përsipër kultivimin e kombeve dhe të kombësive që jetojnë brenda kufijve të tyre politikë. Se kjo gjë lypsej, së paku formalisht, me raportet e rregulluara në shkallë ndërkombëtare. Në këtë drejtim, Jugosllavia, qe 68 vjet, u shtrëngua që, në trajtë kompensimi për shkeljen brutale të të drejtave legjitime të shqiptarëve, të zhvillojë në mënyrë permanente dhe me mundim të konsiderueshëm një mekanizëm të gjallë të propagandës së konsumit të brendshëm, jugosllav dhe të konsumit ndërkombëtar. Siç është fare e natyrshme, Jugosllavia e sotme, duke ruajtur dhe dukje çuar një hap më tej aspiratat shoviniste ndaj shqiptarëve të Kosovës dhe duke qenë në anën tjetër e shtrënguar t'i thellojë e t'i arsyetojë më shumë se e djeshmja këto aspirata, mjetet për shfarosjen dhe për asimilimin e shqiptarëve i ka përsosur dukshëm, në përputhmëni me situatën në vend dhe në botë.

Aktualisht, për opinionin mesatar jugosllav dhe botëror, që manipulon me informatat elementare dhe fare të cekta lidhur me Jugosllavinë, në këtë pjesë të Ballkanit, përkatësisht në këtë shtet, ose nuk ka fare shqiptarë, ose ata përbëjnë një pakicë të parëndësishme, që nuk meriton kushedi se çfarë kujdesi. Në rastet më fatlume, një pjesë e opinionit të tillë e di përafërsisht numrin e shqiptarëve që jetojnë brenda kufijve politikë jugosllavë, por nuk e di se këta shqiptarë jetojnë në tokat e veta të pushtuara nga Jugosllavia dhe mendon se Jugosllavia ka bërë shumë për realizimin e të drejtave të tyre nacionale, sociale dhe ekonomike.

Deri në këtë shkallë, mund të thuhet, uji ka shkuar në mullirin e madh të demagogjisë jugosllave, në krye me klikën titiste. Qëllimi i saj ka qenë dhe mbetet maskimi i numri të shqiptarëve, i begative të jashtëzakonshme natyrore të tokave shqiptare, maskimi i kompaktësisë etnike të shqiptarëve në të gjitha viset e tyre, me qëllim

që, duke ndjellë pos kësaj edhe lugetërit pansllavë për t'u zgjuar e për ta kujtuar "Kosovën serbe" , ta bëjnë sa më të largët e më të pakapshme të drejtën historike e kombëtare të shqiptarëve të Kosovës për vetëvendosje dhe për jetesë në kuadër të shtetit unik shqiptar.

Po ka një pjesë të opinionit (të brendshëm e të jashtëm), që e di me themel çështjen e shqiptarëve dhe të tokave të tyre të përfshira brenda kufijve politikë jugosllavë. Këtë opinion e përbëjnë në një anë qarqet politike shqiptare, jugosllave dhe ndërkombëtare, në anën tjetër inteligjenca dhe forcat revolucionare te e dhe në botë. Kjo pjesë e opinionit e di se "Në kundërshtim të hapët me parimin e kombësisë dhe të vullnetit të popullsive vendëse, nga trungu i Shqipërisë u shkëputën (më 1912 – shën. Red.) krahina të tëra si Rrafshi i Dukagjinit, Kosova dhe tokat shqiptare në Maqedoni. Më tepër se gjysma e popullsisë së vendit dënohej të ndërronte zgjedhën e vjetër turke me një zgjedhë të re, atë të Serbisë dhe të Malit të Zi."2 Një problem të tillë, çdo palë e akcepton në mënyrën e vet. Opinioni i ngritur shqiptar kërkon rrugë dhe mënyrë për të dalë nga kjo gjendje, që do të thotë për të dalë nga zgjedha serbo-malazezo-maqedonase dhe për t'u bashkuar me vendin amë Shqipërinë socialiste, për t'i ndarë me të të mirën dhe të ligën që atyre ua ka caktuar rruga e përbashkët historike e një kombi të njëjtë me fate të njëjta; pala tjetër, opinioni i qeverisë jugosllave, që viset shqiptare i shfrytëzon në mënyrën klasike dhe me mjetet klasike me të cilat shfrytëzohet një koloni, e di edhe ai hesapin e vet: deri sa t'i shkojë përdoresh, Jugosllavia e Titos nuk do të heqë dorë vullnetarisht nga tokat tona, prej të cilave nxjerr leverdi të mëdha, po përkundrazi do të përpiqet t'i ngulë kthetrat e veta fashiste sa më thellë në lëkurën e popullit shqiptar dhe në thellësitë e begatshme të tokave shqiptare. Ndërkaq, opinioni politik evropian siç e di se ka vendosur pa të drejtë në kohën e Luftërave Ballkanike dhe pas Luftës I dhe II Botërore në dëm të shqiptarëve e në të mirë të ruajtjes së interesave të veta në Ballkan duke anuar vazhdimisht nga popujt sllavë, e di po ashtu se çështja e shqiptarëve të robëruar nga Jugosllavia mund të mbulohet e të heshtet përkohësisht, por të shëruar as ka pasur në të kaluarën dhe as do të ketë në të ardhmen. Populli shqiptar jo një herë në historinë e vet është treguar i gatshëm më parë të shfaroset sesa të mbajë me pëlqimin e vet këmbën e të huajit në fyt. Aq më parë sot që ekziston një territor i pavarur shqiptar, me një shtet dhe një ushtri të vetën, që fundi i fundit është e thirrur të mbrojë territoret shqiptare, qoftë ato brenda kufijve të vet shtetërorë, qoftë ato që kanë mbetur jashtë atyre kufijve me dhunë dhe për bashkimin e të cilave është derdhur gjaku deri në gju gjatë historisë.

Duke i vënë sendet secilin në vend të vet, inteligjenca jonë dhe e huaj, revolucionarët tanë e të huaj, ndjekin me indinjatë të thellë gjendjen e vështirë të popullit shqiptar në Kosovë, i cili ka rënë viktimë e orekseve të pashtershme pansllave dhe e qëndrimit të disfavorshëm të Evropës. Dhe, një opinion i tillë, të cilit pa dyshim i takon e nesërmja e shëndoshë e njerëzimit, është me ne pa rezervë.

Duke u nisur nga lufta jonë e drejtë, sepse ndryshe s'ka si cilësohet lufta për mbrojtjen e tokave të tua dhe të interesave jetike të popullit tënd; si dhe nga pjesëmarrja aktive e përhershme e shqiptarëve të Kosovës në vlimet e përgjithshme të historisë së Shqipërisë për ruajtjen e tokave dhe të popullit nga copëtimet e ndryshme barbare; pastaj, me vetëdije të lartë se qeveria titiste e Beogradit, mashë e imperializmit dhe e revizionizmit botëror meriton tek e fundit edhe urrejtjen e popujve jugosllavë, që lëngojnë si mos më keq nën këmbën e shovinizmit serb, është e natyrshme që ne, revolucionarët kosovarë të ndahemi diametralisht me mendime nga kjo qeveri dhe nga ky shtet. Ç'ka quan Jugosllavia mik, për ne do të jetë (dhe ka qenë) armik. Dhe anasjelltas, kur ajo quan armiq djalërinë më përparimtare shqiptare, që s'i ka lënë vend harresës kombëtare dhe që s'e ka hequr mendjeje rrezikun nga zhdukja prej dorës jugosllave as dashurinë dhe

respektin ndaj detyrave dhe nderit historik e kombëtar, atëherë ne atë djalëri do ta quajmë djalëri e vërtetë shqiptare.

Në të tillë kontekst e shohim edhe aktivitetin revolucionar të të pesëdhjetë organizatave tona patriotike e revolucionare, që UDB-ja jugosllave i ka terrorizuar dhe i ka masakruar që nga Lufta II Botërore e deri më sot. Në të tillë kontekst do ta shohim patjetër edhe aktivitetin e patriotëve shqiptarë, që para disa muajsh i mbushën ding të gjitha burgjet dhe bodrumet e policisë jugosllave në Kosovë.

Nëse gjyqi, shtypi, radioja dhe televizioni jugosllav e shohin të arsyeshme t'i dënojnë "Për vepër penale të propagandës dhe të bashkimit me qëllim të veprimtarisë armiqësore kundër popullit dhe shtetit" patriotët dhe revolucionarët Shefqet Jashari, Ramadan Pllana, Avdi Kelmendi, Abdyl Lahu, Isa Demaj, Sylejman Qyqalla, Skënder Jashari, Hysen Gërvalla, Ibrahim Shala, Asllan Loshi, Ruzhdi Saramati dhe gjithë kusurin që tepron nga dy mijë e më shumë të burgosur politikë shqiptarë brenda disa muajsh (që mund të supozojmë pse nuk shpallen botërisht emrat e tyre), ç'na mbetet neve tjetër pos t'i nderojmë këta revolucionarë dhe të mburremi siç mburret çdo popull me bijtë e vet më të mirë.

Se anija jonë ka erë të mbarë, e cila do ta nxjerrë nga dallgët e stuhishme, dëshmon fakti se të gjitha organizatat patriotike shqiptare, që i janë vënë përballë deri më tash qeverisë fashiste të Beogradit, duke lëshuar përherë e më shumë rrënjë në popull dhe vetëm në popull, kanë pasur një drejtim dhe një platformë të vetme: çlirimin nga robëria jugosllave dhe bashkimin me vendin amë, Shqipërinë, të tillë çfarë është ajo, me Partinë e Punës në krye. Kështu, lëvizja jonë, mbi të gjitha, na del edhe largpamëse: ajo ka zgjedhur një platformë politike dhe një ideologji, e cila do të jetë ideologjia e së nesërmes së njerëzimit.

Ne jemi krenar që, në një anë, populli ynë vëlla në RPS të Shqipërisë, nën udhëheqjen e ndritur të Partisë së Punës në krye me shokun Enver, po arrin rezultate të shkëlqyeshme në kultivimin e socializmit të kulluar dhe në avancimin e idesë së madhe marksiste-leniniste, kurse në anën tjetër, Kosovës gjithnjë më shumë po i shtohen forcat për t'i thënë një herë vendosmërisht armikut të tërbuar shovinist: Jo! Jo, sepse, duke pasur vëllaun tim, nuk bëhem me xhelatin tim dhe me xhelatin e vëllaut tim, se ky do të kish qenë një absurd. Jo, gjithsesi, sepse, edhe po të mos kish qenë absurd, atëherë, të del e të tepron kusuri: që në fillim është parë se Jugosllavia qe 68 vjet s'bën gjë tjetër pos që përsërit: "Per me si va nella cita dolente"!3

Meqë rruga e mjerimit, rruga e ferrit shpien vetëm kah ferri, atëherë ne do t'i përgjigjemi ngjashëm shovinizmit serb, malazez dhe maqedonas:

"perditio tua, Israel, ex te"! (Lajmëtari i lirisë, gusht 1980, faqe 1-2)

24. Viktima që glorifikon xhelatin e vet

Besoj se e lexon "Rilindjen". E ke të vetmen gazetë të përditshme në gjuhën tënde, në pjesën e robëruar të Shqipërisë. Është e vërtetë se "Rilindja" të ka bërë vazhdimisht të klithësh në kulm të hidhërimit. Si durojnë kaq poshtërsi faqet e saj! Sa herë, duke qenë i ndershëm dhe njeri që e do të vërtetën objektive, je ulur madje për t'u dhënë përgjigje, po në faqet e "Rilindjes", të pavërtetave, të cilat jo vetëm që e dëmtojnë rëndë mirëqenien tonë politike, shoqërore dhe ekonomike, por prekin thellë edhe në sedrën tonë kombëtare?

Natyrisht, përpjekjet e tilla të kanë shkuar huq. Edhe mua! "Rilindja" u bën vështirë vend gjërave që shkojnë në të mirën e popullit tonë të shumëvuajtur!

Pse?

Ti e ke ditur që "Rilindja" është organ i LSPP të Kosovës, LSPP e Kosovës degë e LSPP të Jugosllavisë; LSPP e Jugosllavisë shpikje e pakripë e klikës titiste, klika titiste mashë e shovinizmit dhe e hegjemonizmit të lig serb…. e kështu me radhë, deri te Kau i Zi, përkatësisht deri te pansllavizmi i mykur?

Prandaj, duke ia bërë me kohë vendin në mesin e "të drejtave" më formale që "gëzon" populli ynë nën skëterrën jugosllave, ti i ke dhënë vetes të drejtë morale të mos e lexosh fare "Rilindjen". A çohet jeta me rrena bajate dhe me poshtërsitë, të cilave më së paku u besojnë ata që pjellin vetë?!

Ja, për shembull. Ty të pezmaton fakti se "Rilindja" jonë, qe 35 vjet, ta ka nxjerrë me përunjësinë më të skllavëruar e më poshtëruese së paku 12 775 herë në faqen e parë fotografinë e xhelatit më të madh të popullit shqiptar J.B.Tito, dhe gati po aq herë atë e ka quajtur ndërsy teje: "Tito, e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja jonë e vetme". (Mos qoftë thënë prej gojës së shqiptarit kjo hata!)

Hajde që xhelati paska mundësi të jetë e kaluara dhe e tashmja e viktimës që bie nga dora e tij, ke thënë me vete e me zë. Por, si bën që ai të jetë edhe e ardhmja e viktimës?! E ardhmja e viktimës është vdekja, paqenësia.

Dhe ti, në vend që të pezmatohesh, duke dhënë edhe paratë e fituara me djersën e skllavit, që vuan në tokën e vet dhe me aprovimin e renegatëve nga gjiu i popullit të vet, je betuar që s'do ta lexosh më "Rilindjen", qoftë ajo edhe e vetmja gazetë që del në gjuhën tënde, në pjesën e robëruar të atdheut tënd. Për këtë unë të jap të drejtë, në qoftë se është puna për t'i ruajtur nervat. Mirëpo, nëmë ndjeksh edhe pak me durim në këta pak rreshta, do të shohësh se ç'ka ke lejuar të të dalë dore, nëse je betuar të mos e lexosh kurrë "Rilindjen".

Ta shfletojmë gazetën e 27 prillit 1980, artikullin me titull "Urdhëroni parmenda!"

"U shitën parmendat? – e pyetëm Zeqir Krasniqin nga Llodrovoqi.

Posi! Ende kam myshterinj të mirë… në disa fshatra ende punohet me parmendë", gazeta jonë të ther mu në zemër. Por, në shekullin e satelitëve dhe të kompjuterëve, shqiptari i Kosovës lavron ende me parmendë!

Si bën pastaj ta lexoj "Rilindjen", - do të më qortosh, - për të lexuar "kënaqësinë" e parmendës shqiptare në fund të shekullit të njëzetë?!

Por, lejomë të të përgjigjem. Gazetën nuk po ta rekomandoj për kënaqësi, për romantikë. Megjithëqë të dromcuar dhe në frymën e liberalizmit socialo-borgjez jugosllav, në faqet e saj do ta gjesh një pjesë të shkapërderdhur të realitetit të popullit tënd. Si bën, pra, të mos e lexosh "Rilindjen", aq më parë nëse je vigjilent dhe di që t'i lidhësh faktet?!

Vazhdojmë me lexim. 10 janar 1980. Nëntë muaj pas tërmetit katastrofik në Ulqin, "Rilindja" shkruan:

"… në këtë komunë 41 familje janë të strehuara nën tenda… U vendos që të gjitha familjet brenda kësaj jave të vendosen në rimorkio, ndërsa personave të rrezikuar nga aspekti social, nga mjetet e solidaritetit t'u ndërtohen baraka (…) Në shtëpi të tilla (shtëpi të shënuara me ngjyrë të kuqe, ku është rrezik të banohet- vër. e red.) në Komunën e Ulqinit, jetojnë sot 254 familje.. 200 familje jetojnë në shtëpitë e sanuara, 743 te miqtë dhe farefisi (nënvizimi i red.), 406 në hotele, 74 në pushimoret e punëtorëve etj. Më 1 prill të gjitha hotelet e kampet duhet të lirohen për sezonin turistik… Ku do të strehohen familjet që sot jetojnë në hotele?"

Autori brengoset, ku do të strehohen familjet që "sot jetojnë në hotele". Ka mundur të brengoset edhe për 743 "te miqtë dhe farefisi", sepse, miqtë dhe farefisi i ulqinakëve jetojnë në Zagreb, në Boston, në Sidnei! Atje, ulqinakët e sotëm, ka mundësi të bëhen "miq dhe farefis" për ulqinakët që do të goditen nesër nga tërmeti apo nga ndonjë

fatkeqësi tjetër. Kurse në Ulqin do të zbresin ngadalë barinjtë e kral Nikollës së Malit të Zi!

Ta di unë dhembjen, vëllaçko, e di se gazeta "jone" të ther mu në zemër. Por, të ngulim këmbë e ta lexojmë, pa e humbur torruan!

Të shohim ku na shpie "Rilindja" e 10 shkurtit 1980? Më duket se në Ulqin.

"Në kolonínë turistike "Ada" të Ulqinit po bëhen përgatitje të mëdha për fillimin e sezonit të sivjetshëm turistik. Është e sigurt se deri në qershor kapaciteti do të shtohet edhe për 100 shtretër. Deri në fund të këtij viti parashikohet që kjo koloni nudistike të ndërtojë edhe 450 shtretër të rinj. Ndërtimi i këtyre vilave do të kushtojë rreth 85 milionë, ndërsa pajimet rreth 40 milionë dinarë.

Për kolonínë nudistike në deltën e lumit Buna do të zgjidhet me sukses edhe çështja e ujësjellësit dhe e kanalizimit dhe për këto do të shpenzohen 3 milionë dinarë. Në këtë pushimore asnjëherë nuk ka pasur vështirësi të shiten kapacitetet. Edhe për sivjet ato janë shitur në shtatorin e kaluar. Kjo dëshmon se nudizmi po rritet prej dite në ditë, qoftë në radhët e turistëve të jashtëm, apo të atyre vendas. Ndërkaq, sivjet pritet të arrijnë më shumë mysafirë vendas, edhe atë nga Sllovenia, Zagrebi dhe Beogradi.

Më duket se poshtërsitë e tilla s'donë koment. Por, ta (b) analizojmë pak çështjen, për hir të qartësisë. Sepse, nuk jemi duke biseduar në të vetëm, ka mundësi të na dëgjojnë edhe të tjerë.

Ndërsa banorët e këtij qyteti shqiptar përfyten me pasojat e rënda nga tërmeti (në një kohë që vendi ynë amë, Shqipëria socialiste, të njëjtin problem, po aq të rëndë, e ka zgjidhur në shkallë shtetërore dhe në një afat jashtëzakonisht të shkurtër), Jugosllavia titiste, në sytë e të uriturve dhe të të ngrirëve shqiptarë, ndërton dhe meremeton plazhe nudistike, për ta sjellë këtu Evropën, Sllovenínë, (sic!), Zagrebin dhe Beogradin e lakuriquar! (Po të dëgjoj duke klithur: "Ky është një sadizëm i pashoq!" Dhe pajtohem me ty. Por s'e kam këtu fjalën).

Të lakuriquar e sheh sot shqiptari përparimtar edhe shpirtin dhe luftën imperialisto-revizioniste të Evropës, të Sllovenisë, Zagrebit dhe Beogradit – në kurriz të punëtorisë dhe të fshatarësisë së shfrytëzuar.

Një pjesë të kësaj vigjilence, tërthorazi, ia detyrojmë "Rilindjes". Prandaj, më pëlqen kur të shoh me të në dorë. Ti s'je më fëmijë që t'u shmangesh problemeve të tua jetësore, duke ua lënë ato të tjerëve apo duke i shtyrë për më vonë. Është puna e bindjes sate të drejtë historike e kombëtare që të indinjohesh kur "Rilindja", megjithë problemet e mëdha në të përballuar të gjenocidit që ushtron klika titiste mbi shqiptarët, ta mban te hunda xhelatin Tito si të vetmin njeri, mbi të cilin peshokan e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja jonë!

Njëherazi, kjo është punë e qëndresës sonë të përgjithshme përballë armikut shekullor jugosllav.

Prandaj, mos më thuaj që "Rilindja" nuk duhet të lexohet, të zbërthehet dhe informatat e tërthorta që marrim prej saj lidhur me realitetin tonë të hidhur të mos i përcillen edhe shokut, të afërmit, dashamirit! (Lajmëtari i lirisë, gusht 1980, faqe 2-3)

25. Konjugacionet e një pushteti "popullor"

Mbrëmjen e 4 majit, te konviktet e studentëve, në Prishtinë, u dëgjua një këngë. Vetë mbrëmja ishte e bukur dhe e ngrohtë, kurse e shoqëruar me këngën rinore, ajo u duk sikur solli çmpirje të përgjithshme pas një dimërimi të gjatë e të sert jashtë zakoni.

Mirëpo nuk vonoi, e konviktet u rrethuan nga policia.

"S'e ditkeni që është ditë zie?!"

" Ne jemi shqiptar, e shqiptarët nuk mbajnë dot zi!"

Megjithatë, kënga e tyre u lidh me pranga. Kurse nata pranverore e 4 majit 1980 u shndërrua në natë ferri nën goditjet e rënda të grushteve e të kërbaçëve, në qelitë e ftohta të burgut të Prishtinës.

*

Qytetari N. nga Deçani kishte një ves të keq. Atij i pëlqente të mendojë me kokë të vet dhe sidomos përpiqej të gjente ca lidhje të logjikshme edhe nëpërmjet atyre fakteve, që të tjerët i ndanin me këmbëngulje si shfaqje të ndryshme të dukurive të ndryshme.

Një kohë të gjatë, qytetari N. nuk e kish ngopur dot kureshtjen e vet lidhur me një fytyrë të stërnjohur dhe të stërurryer, që nuk po e shikonte më në ekranin e vogël mbrëmjeve në shtëpinë e tij varfanjake. E pra, kish qenë një kohë më herët që atë fytyrë e kish shikuar së paku tri herë në ditë, krah për krah me të shoqin.

Ç'u bë me Jovankën, – kishte thënë atëherë, dhe e kish përpirë sakaq fjalën e vet, sepse kish diktuar që njerëzia e shikonin me frikë.

Papritmas, fytyrën e njohur të Jovankës e pa sërish qytetari N. në ekran të vogël ditën e shpalljes së vdekjes së Titos. Qante me ngashërim. Qytetarit N., që s'kishte mësuar ta shohë duke qarë, sesi iu duk e çuditshme. Një fantazmë e harruar, që po shfaqej në dritë tjetër.

Nga na doli tash Jovanka, – s'iu durua atij.

Pastaj e kafshoi buzën e vet, sepse iu kujtua që edhe kësaj radhe kishte bërë një marrëzi.

Por, kësaj radhe ishte kujtuar vonë...

Në qoftë se edhe ju keni vese të këqija si qytetari N. dhe në qoftë se, megjithatë, për të mos gabuar, dëshironi të këshilloheni me atë që e ka pësuar drejtpërsëdrejti nga veset e veta, atëherë shkoni e merruni vesh me qytetarin N. Ja ku e keni, në burgun e Pejës.

*

Për Zogën bashkëkohëse të "kufijve të Geget" kish qenë gjë e rëndomtë dhe një nga gëzimet e vetme varfanjake që, për çdo Shëngjergj, të delte me të ëmën mbi Marash.

Këtë rrugë kish marrë dhe në këtë vend kish arritur edhe kësi shëngjergji, më 9 maj 1980. Aty, bashkë me moshataret e veta të njoma, ia kishte thënë këngës së stinës.

Zoga bashkëkohëse kish qenë larg disa ngjarjeve të jetës rreth saj, me punë dhe me moshë. S'kish ditur, vallë, apo s'kish dashur të dinte mosha e saj për një vdekje, që kishte ndodhur disa ditë më parë?

Kur erdhi policia dhe ia hoqi me rrëmbim nga dora e njomë dairet, me të cilat po e shoqëronte ajo këngën e padjallëzuar, ajo u habit pa masë dhe sikur ra në marre. S'ishte mësuar të këndonte shpesh dhe aq më pak t'ia prenin me dhunë këngën.

Po habia e saj sakaq u kthye në një tmerr të papërshkrueshëm. Të ëmën po ia vënin me egërsi nën kërbaç!

*

Në sport mund t'ia mbash anën ekipit që e do.

Kjo është rregull.

Por, nga ana tjetër, kjo nuk do të kish qenë rregull po të mos i kishte edhe përjashtimet.

Këtë e di më së miri publiku i Prishtinës, i cili në fillim të korrikut mori guxim të anonte për ekipin e basketbollisteve nga Tirana, në pallatin e sporteve "25 Maj".

Me atë rast shkrepëtinë aparatet fotografike të policisë. Policia, e mësuar me manifestime të ngjashme të publikut prishtinas, po aplikonte kështu një metodë bashkëkohore të veprimit në kushte të jashtëzakonshme. Duke kapur në film personat që anojnë për ekipin shqiptar, do ta ruash sado pak rendin publik dhe do ta çosh deri në fund me sukses punën policore: marrjen në pyetje dhe dënimin e shqiptarëve që guxojnë ta shprehin haptazi animin nga ekipi shqiptar, që do të thotë apriori animin nga Shqipëria.

Në këtë pikë, policia, edhe me mjetet dhe metodat e vjetra, që do të thotë me qentë e dresuar dhe me kërbaçët e me armët e zjarrit, e ka përmbushur thuaja rregullisht qëllimin e vet: dashamirët e tillë "të sportit" i ka vënë nën dajak, që ta mbledhin mendjen për tjetër herë dhe t'u tregojnë edhe shokëve.

Por, doli që edhe në punën e policisë paska mundësi të ketë përjashtime nga rregullat, përkatësisht të mos ketë kurdoherë sukses.

Publiku, që anonte zëshëm, me këngë, për ekipin e dashur, të hetuarit policinë që po fotografonte, kundërshtoi me çka mundi. Kur mori fund loja, publiku kishte një rast ta çonte edhe më tej kundërshtimin e rezistencës së vet, sepse policia kishte zënë t'i veçonte disa persona, që i fuste në kombin mavi të policisë. Atëherë publiku, në vend që të shpërndahej sekush në punë të vet, bllokoi automobilin dhe nuk i lejoi dot policisë të merrte asnjë person.

Kjo qe një shfaqje që premton se do të mund të përsëritet, nga të dy palët.

*

Se në ç'pikë ka arritur "kënaqësia e përbashkët" e popullit dhe e pushtetit "popullor" të ushtruar mbi popullin tonë, dëshmon edhe kjo ngjarje, me fillim të thjeshtë fare po me një përfundim krejt të parëndomtë për kushtet e deritashme.

Në terracat e dy konvikteve të Prishtinës, dy grupe studentësh, fare spontanisht, kishin dalë dhe këndonin këngë shqiptare. Koha nuk ishte e papërshtatshme, kohë dite, pika e verës. Dhe ata nuk duhej t'i pengonin askujt. Pastaj, "zia" e përgjithshme për satrapin Tito, e mbajtur me dhunë një kohë të gjatë, kishte kaluar.

Po lidhjet telefonike funksionojnë mirë në kryeqendrën tonë, sidomos për lajme të prapta. Dikush ishte "kujtuar" ta informonte policinë për këngën e rinisë. Dhe policia, s'është përtace, sidomos për punë të prapta, e bllokoi menjëherë bulevardin "Ramiz Sadiku", përkatësisht pjesën e këtij bulevardi, ku prekin konviktet.

Kjo s'ishte hera e parë që pushteti i policisë "popullore" po rrekej të manifestohej në tërë "madhështinë" e vet mbi të rinjtë e pafajshëm, që s'duan t'ia dinë se qenka e ndaluar të këndohet shqip.

Mirëpo, durimi ka kufi. Dhe studentët, që kanë edhe ata "njëfarë" force, me të cilën i brumos ndjenja se do të bëhen bartës të të mirave dhe të ligave të jetës në një të ardhme të afërt, kishin ngulur këmbë që ta manifestonin edhe ata hovin e tyre të pandalshëm.

Kështu filloi një "lojë", e re për trojet tona.

Duke përdorur vinçin e madh të punishtes së afërme ndërtimore, ata ngjitnin gurë në terraca të të dy konvikteve, të femrave dhe meshkujve. Dhunës policore, ata iu vunë përballë me gurë.

Epilogun e kësaj ngjarjeje mund ta marrin me mend, po më së miri atë e dinë aktorët e saj, të cilët janë duke e ndier në lëkurën e vet. Po ka gjasa se policia fashiste jugosllave, e cila po hakmerret egërsisht për turpin që pësoi, tash e tutje do të mendohet pak më shumë kur të niset për t'ia shuar rinisë sonë këngën shqiptare në buzë. (Lajmëtari i lirisë, gusht 1980, faqe 3-4)

26. REKUIEM PËR NJË MONARK

Me rastin e vdekjes së monstrumit revizionist, J. B. Tito, këtij armiku të përbetuar të popullit shqiptar

I teket burrit të botës për të vdekur. Një e drejtë e amshueshme, e patjetërsueshme. As arsyet nuk mungojnë. Jeta – halle shumë. Dergja e gjatë e ka përpirë edhe pikën e fundme të durimit. Pastaj mosha, more vëlla. S'janë shaka 88 vjet!

Patjetër duhet të vdes, thotë ai.

Menjëherë!

Dhe, një ditë prej ditësh, ndërsa Konziliumi i mjekëve po i injektonte në trup pikën e fundme të gjakut të stërnipërve të tij dhe thërminë e fundme të truve të zogjve të Ballkanit, ai, pa një pa dy, ia dha në dorëzim djallit shpirtin e vet prej përbindëshi. Mbi mbeturinat e kurmit të tij të qelbur mbetën pezull raskapitja disamujore (disavjeçare?) e Konziliumit të mjekëve dhe hutesa e Familjes së Pikëlluar.

Po era e thatë e ditës së shënuar dimërore, 14 shkurt A.D. 1980 e humbi gjithë athëtimën e përparshme, dhe moti i zënë pisk deri më atë çast sikur u çmpi e mori frymë thellë.

Kish vdekur satrapi monstruoz, Josip Broz- Tito!

Kush ma zuri diellin…

Nga çmpirja e përgjithshme, që erdhi papritmas si dhunti hyjnore në këtë pjesë të Evropës, qielli sikur u kthye në elementin e vet: barkun do t'ia stolisnin sërish zogjtë e lirë të gadishullit Ilirik. Sikur u shkrinë gur e dru: nuk do t'i përdhoste më hapi i rëndë i përbindëshit. U gëzua shpirti i ri: nuk do t'i merrnin më gjak për të mbajtur gjallë fosilet e monstrumit. Fëmijët ia thanë këngës:

Kush ma zuri diellin,
Ia zëntë therra shpirtin!

Po Familja e Pikëlluar ra në hall.

I vdekuri kishte pasur hije të rëndë dhe kishte lënë prapa shumë ngatërresa.

Veç kësaj, gjatë dergjës së përbindëshit, në kufij ishte dukur një përbindësh tjetër, më i madh e më i tmerrshëm, me disa kambiale, që i tundte në erë si somnambul.

Dhe u mblodhën kokë më kokë anëtarët e Familjes së Pikëlluar. "Si guxoi të na linte kaq paturpshëm, në ditë kaq të ligë!"

Vërtet, si kishte guxuar ai të vdiste pa pyetur njeri, dhe ç'vdekje na qenka vdekja në pikë të dimrit?! A s'ka thënë mirë poeti: "Dua të vdes në pranverë!"

Po udhët e të madhërishmit janë shumë.

I vdekuri, me shkopin dhe me strajcën e lypës në dorë, kishte bërë për të gjallë të vet një arkë të madhe. Paraja ka pushtet. Mashën ta bën tangar. Pos parasë, ai kish lënë trashëgim edhe një mekanizëm të përsosur për shfrytëzimin maksimal të të mirave që sjell gënjeshtra dhe demagogjia.

Kështu, po në frymën e ish zotit të shtëpisë, Familja e Pikëlluar, me paratë e lypura dhe me arsenalin e pasur të gënjeshtrës, e ktheu në gjysmë të rrugës tellallin që ishte nisur të shpallte ngordhjen e përbindëshit.

Dy datëlindje – dy datëvdekje

Dhe vdekja, që s'kishte si të mos quhej vdekje, sepse kish vdekur trupi, kish tretur edhe shpirti (a kishte fare shpirt?), me emrin e zotit dhe të Xhebrailit, që e ngrënkan shumë ryshfetin, u bëj jo vdekje. U shty për tre muaj!

Më 4 maj A.D. 1980, tellalli doli dhe e pështyu fjalën e përpirë, të përtypur me mundim tre muaj rresht.

U shtrua ngeshëm sofra e zisë dhe erdhën sa çel e mbyll sytë edhe të ftuarit, që, për çudi, kishin qenë të gatshëm: të larë e të lyer, të veshur e të mbathur.

Në rekuiemin e monstrumit ia behën pothuaj të gjitha specimenet e kësaj bote. Thua se ky rekuiem ishte një Barkë e dytë e një Noe të dytë.. Me kucë e me mace. Zonja dhelpër e Brigjeve Britanike. Gjeldeti i larëm dhe i butë i Brigjeve të Azyrit; çakalli i Jermanisë; pumat, anakondat dhe kameleonët e Andeve. Nuk munguan as specimenet ngjyrë pjeshke të papjekur nga Dheu i Largët i Diellit në Lindje. Dhe, siç është fare e kuptueshme, Ariu Plak i Siberisë. Kish disa muaj që ata e kishin lënë takimin te kufoma e qelbur e përbindëshit të ngordhur.

Sa lotin e derdhi Krokodili i Nilit! Të mëshirohen gur e dru. Sa shlirshëm u derdhën inxhinjtë e sinqeritetit të Zonjës Dhelpër! Të të shkrihet shpirti. Besëlidhja ndërmjet maces dhe miut, që u bënë pikërisht në këtë sofër zie, premtonte se nuk do të thyhej përjetë fjala e dhënë një herë në kuvend… Kurse Ariu i Siberisë, i cili disa muaj më parë e kishte vënë shputën e madhe kaba në kufijtë e Familjes së Pikëlluar, betohej se as që i ka shkuar dhe as i shkon mendja për ndonjë prapti arinjsh!

Privilegjin për të pasur dy vdekje, më saktësisht, dy data të vdekjes, dy datëvdekje; një të hershme, orë e pa kohë- prandaj edhe të vërtetë. Dhe më vonë të dytën, datëvdekjen artistike- me mot të porositur (maj, pranverë, romantikë…) një privilegj të tillë nuk mund ta gëzojë kushdo.

Ta vdesësh një herë faktikisht trupin më 14 shkurt 1980, është dashur të kesh lindur faktikisht 88 vjet më parë, më 7 maj. Të të bëjnë me vdekje të dytë artistike, më 4 maj, është dashur të ta kenë kremtuar një ditëlindje të dytë, artistike, atëherë kur s'e ke pasur – do të thotë më 25 maj. (Maj, maj… vetëm maj. Ç'kërkon këtu shkurti kryengritës, si një bisht i këputur!) Pra, për të gëzuar dy datëvdekje, duhet të kesh gëzuar dy datëlindje.

Dy emra, shumë fytyra

Gjatë këtij shekulli, një nga kushtet për të vdekur dyfish ka qenë edhe ky: mos të të mjaftojë një emër i vetëm. Ta zëmë: Josip Broz. Një emër i tillë, ndoshta, ka mjaftuar për të hyrë së prapthi në një parti dhe në një luftë. Por ai nuk mjaftoi dot për t'u mbajtur në krye të një partie dhe në një luftë. Por ai nuk mjaftoi dot për t'u mbajtur në krye të një partie dhe të një shteti revizionit – siç doli puna pastaj. Për këtë duhej një emër i dytë, përkëdhelës, sugjestionues: Tito.

Kusht i posaçëm për ta gëzuar me popullaritet këtë emër, ka qenë që t'i shërbesh afro dyzet vjet, me përunjësi të pashembullt, imperializmit dhe kapitalizmit botëror, e në anën tjetër ta mbash ndezur dritën e drejtimit të socializmit. Dhe të mos mjaftohesh me kaq. Për maskë, të krijosh edhe një bllok, me emrin e çuditshëm: të painkuadruarit!

Me një fjalë, për ta gëzuar me jetë të gjatë emrin e dytë artistik – Tito, ishte e domosdoshme të kishe jo një po shumë fytyra, që të bëje pa pengesa flirte të pashoqe, të apasionuara, per amica silentia lunae, me atë që është çuar i pari! Për të mos vdekur kur ke vdekur, rëndësi të posaçme ka që, në kohën e sundimit tënd prej monarku fashist, të kesh çuar jetë sa më të shfrenuar. Të kesh pasur në pronën e madhe mbretërore ullishte e vreshta, pyje si Igallo dhe, mundësisht ndonjë ishull të tërë, si Brioni. Disa dhjetëra vila! Këto mund t'i ketë edhe një drejtor i thjeshtë. Por, bën të kesh pasur pallate me qindra e qindra dhoma. Secila dhomë një krua dhe secili krua një çep të artë!

Ndër të tjera, duhet të kesh qenë lahper. Të kesh futur nën kurorën mbretërore së paku pesë gra, të tjerat në harem, mundësisht sa më të reja, për salltanet, dhe rrallë e rrallë për – punët e natës!

Por, as këto nuk do të bëheshin kabull në çfarëdo kohe dhe në rrethana çfarëdo. Kusht i posaçëm është që vendin ta kesh futur deri në fyt në borxhe që arrijnë shifra astronomike. P.sh. 14.000.000.000 dollarë amerikanë! Që, sipas kursit të sotëm, bëjnë 36.400.000.000.000 dinarë të vjetër. Pra – 36 bilionë e 400 miliardë dinarë!

Trashëgimi madhështore për një rekuiem edhe më madhështor, që ia bëri monarkut Familja e Pikëlluar! (Pra, Kryesia e Federatës, se më në fund po i heqim dorëzat. S'ka lezet të flasim edhe më tutje me mesele).

Dy e dy bëjnë – 10 muaj me ajër të pastër!

Mendoj se ata që nuk bëjnë pjesë në Familjen e Pikëlluar – e të tillë jemi ne, shqiptarët e Kosovës, si dhe popujt e pafajshëm të Jugosllavisë – kanë edhe kohë për të bjerrë edhe deponime të sigurta për të mos u mërzitur. A s'jemi vallë duke jetuar në një regjim papunësie të shkallës më të lartë në Evropë, ndër më të lartat në botë?!10 Sidomos ne, shqiptarëve, koha na del e na tepron. Prandaj, mund të merremi edhe me "dokrra".

Për fillim, pakëz matematikë. Ndiqmëni me kujdes! Së paku me kujdesin, me të cilin e ndiqni një ndeshje futbolli.

Nëse Titua, me përkrahjen e zëshme të aparatit shtetëror revizionist të Jugosllavisë, për shtetin e vet 22-milionësh ka marrë hua te imperializmi dhe te kapitalizmi botëror 36 bilionë e 400 miliardë dinarë, atëherë ai çdo banor të Jugosllavisë, madje edhe Bali Katravellën tim kërthi, e ka ngarkuar me nga 1 654 550 dinarë borxh. Ju pyes: me se do ta lajë këtë borxh Bali Katravella im, të cilit e ëma ia lan tri herë në ditë mendelat e fëlliqura? Madje pa deterxhent!(Deterxhenti, siç e dimë, me vdekjen e parë faktike dhe me vdekjen ne dytë artistike të të përkëdhelurit Tito, humbi si shurra e pulës.)

Vazhdojmë!

Nëse gjendesh në ballë të një shteti me 22 milionë banorë, prej të cilëve ke inkuadruar vetëm 5 milionë e 612 mijë banorë, atëherë, me ç' banorë, prej të cilëve ke inkuadruar vetëm 5 milionë e 612 mijë banorë, atëherë, me çfarë shume të hollash e ke ngarkuar çdo të inkuadruar në larjen e borxheve prej 36 bilionë e 400 miliardë dinarësh? Përgjigja e saktë është: çdo i inkuadruar duhet të paguajë nga 6 milionë e 486 mijë e 100 dinarë. Po nëse këtij të inkuadruari nuk i ke dhënë të ardhura mujore më të larta se 607 300 dinarë (mesatarja jugosllave), atëherë, për sa kohë mund ta lajë ai pjesën e vet të borxhit?

Matematika, punë e rëndë prej së cilës mund të të dhembë koka.

Përgjigja e saktë për pyetjen e mësipërme është se të gjithë punëtorët jugosllavë së bashku, për ta larë borxhin, me të cilin i ka ngarkuar ata Titua me titistët e vet, duhet t'i japin gjithë të ardhurat e tyre mujore në një periudhë kohore prej dhjetë muajsh e gjysmë! Pa lënë asnjë metelik anash.

Supozojmë se prej kësaj matematike i dhemb koka edhe Kryesisë së Jugosllavisë.

Së paku sot. Jo edhe kur merrte hua.

Bile, ka indikacione se edhe atëherë edhe sot, që ajo po hy në borxhe të reja të imperializmit dhe të kapitalizmit botëror, ka harruar që "S'ka mbetë borxh pa u kthye, ja me pare ja me krye".

Nuk është qejf i vogël të kesh një mecenë të madh, i cili e hap kuletën posa ta kesh hapur ti gojën për t'i lypur gjësend për mëshirë. Dhe klika titiste kotet dhe ëndërron se Amerika është aq zemërgjerë sa mezi pret ta shpenzojë dollarin e vet për t'u blerë

sheqerka fëmijëve të llastuar. Ose cigare të trasha, të gjata – "tompus", për monarkun Tito, me të cilat ky pat fituar në botë popullaritetin e një kryepari të fisit, që e rreshk llullën e paqes pranë zjarrit indian, në një kohë që amerikani ia merr pëllëmbë-pëllëmbë gjithë tokën, kurse atë, indianin, e mbërthen në rezervate!

Po nëse një ditë mecena i madh kërkon t'i lahen me cenë borxhet?

Atëherë, sipas matematikës reale, dy e dy që bëjnë gjithmonë katër, do të na dalin diçka tjetër.

Ose duhet t'ia lëshosh shtëpinë, që e ke ngritur me të hollat e tij, ose t'ia thajsh paret në dërrasë. E, "për t'ia tharë paret në dërrasë", të gjithë të inkuadruarit në Jugosllavi, siç u tha më sipër, duhet të punojnë për mecenën dhjetë muaj e gjysmë! Pa ngrënë e pa pirë, pa u veshur e pa u mbathur. Ose duke ngrënë çka s'blehet me pare dhe duke veshur ç'ka s'blehet me pare…

Banorët e Jugosllavisë, pra, pasi ta kenë ngrënë gjithë gjënë e gjallë, gjithë barishtet, lëvoret e verrave dhe të kërpnajave; pasi të kenë veshur dhjetë muaj e gjysmë gjethe gështenjash, për të mbuluar pjesët e turpshme të trupit, si Adami e Eva; pasi të kenë kaluar me banim në shpellat e dashura të të parëve të vet – se banimi në kushtet moderne kërkon shpenzime, pasi t'i kenë ngrënë edhe milionat e produksioneve me portretin e përbindëshit Tito në teknikën bardh-e zi-kolor, madje megjithë korniza, do të mund të kthehen e të hanë kulumria!

Diçka, megjithatë, u mbetet badihava titistëve: Ajri! Dhe ajri nuk është artikull jetësor pa rëndësi.. Ai na e mban gjallë frymën. Pos kësaj, në mos i gjetshin vetes tjetër çare, titistët mund ta shfrytëzojnë ajrin edhe për ndonjë udhëtim në kozmos. Deri në Mars, bie fjala. E, për një udhëtim të tillë ata do të kenë nevojë të madhe.

Pse?

Pjesën dërmuese të firmave, Jugosllavia i ka ndërtuar me investime të përbashkëta me imperializmin. Mecena mund të mos lejojë t'i lahen borxhet duke shfrytëzuar objektet e tij industriale etj.

Por, s'ka gjë.

Siç e dimë, titistët janë shumë të shkathët në shpikjen e termave të ndryshme politike e legjislative. Ka mundësi që, kur të kenë arritur në Mars (prapë me fluturake amerikane), të shpikin edhe atje një vend, një Amerikë të Marsit ta zëmë, ku do të mund të marrin në të ardhmen hua për shpenzimet e mëdha që i duhen borgjezisë së këtushme!

Rrugë të mbarë, pra, titistë jugosllavë!

A mbahet shpirti me kulumria?

Nuk them që rruga e titistëve dhe e titizmit është njëherit edhe rruga e të gjithë qytetarëve të Jugosllavisë fashiste. Sidomos klasës punëtore dhe fshatarësisë së mashtruar, besoj, nuk do t'i shkonte aspak për lale një udhëtim i tillë në uri, në paqenësi. Udhëtim kah gjumi dimëror i arushës! Por, në rast të tillë, ata duhet të dinë se për çdo sëmundje ka ilaç. Mund të thonë shkurt: "Hiqe piten e ligë dhe sille të mirën!" Por, kjo gjë kërkon ca mundime. Ta zëmë, ndonjë kryengritje masive, eventualisht një revolucion të ri.

Apo mos edhe punëtorisë dhe fshatarësisë jugosllave titistët ua kanë prerë rrënjë, si me brisk, motivin e kryengritjes dhe të revolucionit?!

Kjo s'përputhet me asnjë ligj të shoqërisë, prandaj nuk do t'i besojë as Bali Katravella im.

Po ne, vëllezër shqiptarë. Do të udhëtojmë edhe ne tok me jugosllavët? Fadili, Mahmuti, Xhaviti, Xhevdeti… thonë se "rruga e Titos është rruga jonë". Dhe duhet t'u besojmë. Vërtet, nuk di a mund të ketë rrugë tjetër për këta renegatë me kompani, pos rrugës së titizmit? Rruga e kryengritjes dhe e revolucionit është rruga e vdekjes së tyre.

Prandaj, nuk e kam me ta po me ju: me punëtorinë, fshatarësinë, me inteligjencën, me popullin e robëruar shqiptar të Kosovës.

Na pyeti vallë Titua kur na e shkeli vendin? Kur hyri borxh te imperializmi? A na pyeti ai kur me pasuritë tona ngriti strofullin e çetnikëve – Beogradin, duke na e marrë kafshatën nga goja? U dashka tani që ne të marrim pjesë në larjen e borxheve të Jugosllavisë titiste?

Nuk di a na mësojnë kështu historia dhe tradita luftarake e popullit tonë, a na mësojnë kështu rrugët revolucionare të popullit tonë dhe të popujve të botës, që kanë hequr qafe përbindësh shumë më të mëdhenj se titizmin, i cili i ka të cekëta rrënjët.
Nuk di, më në fund, a kemi hesap – thjesht, të udhëtojmë bashkë me Jugosllavinë titiste, duke larë borxhe tërë jetën!

Ose, ndoshta, ende nuk na u mbush mendja se nuk mbahet shpirti me kulumria! (Lajmëtari i lirisë, gusht 1980, faqe 6-8)

27. RENEGATI

Prolegomenë për historiatin, zhvillimin dhe perspektivën e dështakut më të madh të fisit njerëzor

Prejardhja dhe shtrirja fizike e renegatit.

-Ndër fjalorë, renegatin e gjejmë te shkronja r me këtë shpjegim përkatës: renegati vjen nga lat. Renegate (re…+ negare – me mohue) dhe shenjon njeriun që ka ndërruar mendje, bindjen e përparshme dhe ka dalë në taborin kundërshtar, në taborin e armikut; ai është edhe i arratisur, dezertor, përçarës, tradhtar, pjellë e keqe, kopil….
Ndër vende e popuj, renegatin e gjejmë kryesisht në të gjitha paralelet dhe meridianet e planetit Tokë. Sidomos në gji vendesh dhe popujsh të pushtuar e të kolonizuar.

Ekologjia e renegatit.- Truall i përshtatshëm për lulëzimin e renegatëve quhet trualli ku ekziston konflikti i përhershëm mes gjakësorit dhe viktimës. Karakteristikë kryesore e truallit të tillë janë ato rrethanat e njohura, që e mbajnë gjallë ligjin ekologjik, sipas të cilit, për të gjalluar ujku, duhet të zhduket dhia, dhe për të gjalluar dhia , duhet të zhduket lakra. Këtu renegati futet si një pykë, që gjithmonë shërben për të çarë trupin e palës së dobët, të viktimës.

Edhe klima, që kushtëzon mugullim të dendur dhe rritje të suksesshme të renegatit, është klimë ters: qielli i ulët, i rëndë, i zymtë, me një minimum ditësh me diell gjatë vitit (apo gjatë dekadave, shekujve) dhe me maksimumin e të reshurave kalbëzuese. Kusht i domosdoshëm janë erërat e përhershme me kundërmim qelbanik, që duhet të fryjë gjithmonë nga një drejtim, nga qendra (kupto: nga institutet e pushtuesit për shtypjen dhe ç'kombëtarizimin e të pushtuarit) në drejtim të provincave të pushtuara e të kolonizuara. Këto erëra duhet të sjellin pështjellim, anarki, pacifizëm, altruizëm të inskenuar, terr injorance e analfabetizmi, tradhti, vëllavrasje, përçarje dhe sherre që mbillen, piqen e korren përngut, pa e pritur njëri-tjetrin.

Format e ekzistencës së renegatit.- Në përputhje me kushtet e tilla ekologjike, te familja e madhe e përbindëshave-renegatë është zhvilluar një mori formash të ekzistencës, nga më të ulëtat e deri te ato më të lartat; që nga renegati-morr, i cili nuk shikon si e si të sigurojë për të vegjlit e vet një lugë kos, po që ta bëjë të ngordhur lopën e të vëllait, për t'ia lënë atij pa kos carrokët, e deri te renegati-katalla, i cili ushqimin e vet e siguron duke ushqyer sa më majmë armikun me gjakun e vëllezërve të dikurshëm.

Përkufizimi i qenies së renegatit.- Më poshtë do të shohim sa e vështirë na del puna e përkufizimit të qenies së renegatit. Ja se pse. Thamë se ai është ndërmjetësues në shtypjen sa më të suksesshme të të pushtuarit nga ana e pushtuesit. Pra, renegati na del jo krijesë e mëvetësishme po gjymtyrë e këputur nga një praorganizëm (praatdhe, prapopull), që i ndajshtohet një organizmi të ri (të armikut), i cili për nga konstitucioni elementar dhe për nga bindjet s'ka asgjë të përbashkët me paraardhësin e renegatit.

Një dukuri e tillë nuk është hetuar në asnjë plan të ekzistencës së gjallesave të planetit tonë. Madje as te sendet dhe fenomenet natyrore. Në mungesë të mundësive për ndonjë përkufizim plotësisht të saktë të qenies së renegatit, do të mjaftohemi me evidentimin e ekzistencës së tij në disa plane fiziko-metafizike dhe në disa shkallë të ndryshme të qenies.

a)Plani metafiziko-mistik

Të gjitha doktrinat fetare e kanë evidentuar ekzistencës e shpirtit të lig, i cili bën çerdhe nën sjetullat e njerëzve të vdekshëm, për t'i larguar këta nga rruga e mbarë dhe për t'i joshur në udhën e djallit. Prandaj, në mësimet fetare renegati jo rastësisht krahasohet pikërisht me këtë qenie mitike, emërtohet "hafije" dhe i caktohet vendi më i keq në rrathët e ferrit. Po ndryshe nga fryma e ligë mistike, renegati e ha bukën dhe, si të tillë, edhe renegatin e ha plumbi. (Po të ketë kush ia jep)

b)Plani antropologjik

Sikundër në gjithë botën shtazore, forma më e lartë ekzistenciale e së cilës është njeriu, edhe te njeriu dominon instinkti i dashurisë ndaj më të afërmit të llojit dhe rezoni e kujdesi për zhvillim sa më të mbarë të llojit të cilit i përket (kjo e dyta vetëm te njeriu)

Përjashtim bën pasardhësi i Kainit, vëllavrasësi..

Po edhe në këtë pikë, qenia e renegatit sikur ikën nga mundësia e përkufizimit të saj të saktë. Vërtet, Kaini e vrau Abelin, që e kishte vëlla, por vrasja i bë për shkak të xhelozisë, do të thotë për të jetuar vetë në liri (patologjike) , e jo për t'ia dhënë armikut barbar lëkurën e të vëllait.

c)Plani zoologjik

Të themi: renegati është dosë, që e ha pjellën e vet! Por, deri më sot nuk kemi njoftime për ndonjë dosë që t'ia ketë shpënë për ëmbëlsirë ujkut derrkucët. Ose, mund të themi mace. Macja e ha pjellën e vet, këtë e dimë. Por, ajo vazhdimisht kujdeset që, duke eliminuar të vegjlit e vet, ta lërë gjallë më të shkathëtin, pasardhësin më të aftë për të gjuajtur minj dhe për t'u përleshur me qen. Renegati jo! Ai, bijtë e shkathët të popullit të vet i rjep dhe lëkurën e tyre ia jep falas armikut; ai i lë gjallë këlyshët që i përngjajnë atij, më të dobët.

ç)Plani botanik

A bën lulja pa lulen? "Me një lule nuk çel pranvera!" Por, edhe në këtë mes na paraqiten patologji madërgona, bie fjala. Mbin ku s'e ke pritur, rritet duke ua marrë ushqimin bimëve që japin fryte. Edhe kërpnaja, që u lidhet për trupi pemëve dhe ua ndan rriten. Por, t'i pyesësh, për hir të kujt bëjnë kështu, edhe madërgona edhe kërpnaja të tregojnë se e bëjnë vetëm për të jetuar vetë, dhe jo për hir të hithit agresiv, ta zëmë. Kurrsesi!

d)Plani i sendeve dhe objekteve

Në e parë duket se përfundimisht kemi dalë në fushën e kërkuar. Përfytyrimi i parë që lidhet me shembëlltyrën e renegatit, është një vegël e thjeshtë e praktikës më të thjeshtë: masha. Me mashë nxirren gështenjat nga zjarri, me mashë e ruajmë dorën nga

prushi. Ose biza. Me të i hapim rrugë gjilpërës për në lëkurë dhe kështu ruajmë gishtat. Por, edhe masha edhe biza janë aq indiferente, aq të marra e të ftohta, sa s'kanë lidhje ç'janë duke bërë. Më në fund, edhe sikur të mos kishin qenë indiferente e të marra, masha dhe biza mund ta ngrenë kokën me mburrje para renegatit, sepse as njëra as tjetra nuk përdoren kurrë për asgjësimin e llojit të vet.

Shumimi i renegatit. – Shkencërisht është vërtetuar se vetmia është gjendje vrastare edhe për krijesat më asociale, madje edhe për monstrumet, që pothuaj se i kanë mjaftuar gjithmonë vetvetes. Ndoshta edhe dështaku më i madh i fisit njerëzor, renegati, do të mund të bënte pa shoqëri dhe pa pasardhës. Por, meqenëse në lashtësinë e errët hyjnore mistike, kur janë ndarë shpirtrat dhe fatet jetësore, ai ka zgjedhur shpirtin, rrugën dhe fatin e Kainit, fatin e këpujës, bullungës, macallungës, bajllagës; fatin e ushujzës që thith gjak jo për vete po për të tjerë, pra të një ushujze patologjike, ai ka pranuar njëherazi fatin e veprimit sipas diktatit të të huajit. Kështu , edhe për shumimin e tij vendos tjetri. Ka çaste që renegati, ngjashëm me revolveristët me pagë të Perëndimit të egër, lodhet me punën e vet dhe dëshiron fuqishëm të kthehet në jetën e qetë: po ai që i rri mbi kokë dhe i dikton nuk e lejon kurrsesi një gjë të tillë. Atëherë renegati rrëmbehet nga ndjenja e vetëshkatërrimit dhe e iritimit ndaj shumimit. Por, edhe atëherë ai është i detyruar të shumohet sipas urdhrit të armikut, të cilin e ka bërë "vëlla".

Zakonisht, renegati shumohet duke mbjellë mjegull, me të cilën lypset të mbulohet e drejta, e vërteta historike dhe trashëgimia e mbarë kombëtare e vëllezërve të tij të përparshëm në atdheun e robëruar. Rekuizitat praktike: gënjeshtra e imtë, edhe atëherë kur të gjithë e dinë se je duke gënjyer; gënjeshtra e madhe historike, demagogjia. Pra, siç shohim, shumimi i renegatit bëhet të shumtën në mënyrë metafizike, pa kontakt fizik. (Ose me një kontakt oral!) Por, edhe kjo mënyrë e shumimit kërkon shpenzime sasish të mëdha energjie, e cila kompenzohet po me mjete patologjike: pas çdo komunikimi me qëllim të fundëm shumimin, renegati duhet të hajë pak palcë kurrizore të ish vëllezërve të vet dhe të lëpijë ndonjë asht të ish vëllezërve. Zakonisht, ashtin ia hedh pushtuesi dhe kolonizatori, pasi ta ketë konsumuar vetë intenzivisht.

Përfaqësuesi.- Qielli, toka dhe uji shqiptar, me një nga klimat më optimale për rritjen dhe shumimin e renegatit, e bëjnë me të madhe këtë kopil, këtë ushujzë. Kësaj radhe do të marrim shembull vetëm disa nga përfaqësuesit e renegatëve, ekzistenca e të cilëve manifestohet në planin dhe në shkallën më të lartë: Fadil Hoxha, Xhevdet Hamza, Xhavit Nimani, Mahmut Bakalli…

Perspektiva e renegatit për ekzistencë.- Regenati, përfaqësuesi më i denjë i llojit të vampirit, që është i thirrur për ta zhdukur lugatin, zhduket posa të bien mbi dhe shenjat e para të agimit, pra të luftës çlirimtare-çkolonizuese dhe të revolucionit. Duke iu referuar kapitullit me titull "Ekologjia e renegatit", po përfundojmë se perspektiva ekzistenciale e renegatit është si ajo e disa insekteve të caktuara, që jetojnë vetëm tre çerek ore: "ata lindin aty nga ora pesë dhe ngordhin aty nga ora gjashtë e mbrëmjes. Për këto insekte nuk ekzistojnë mëngjesi, mesdita, mbrëmja, për to nuk ekziston kohë tjetër veç muzgut, ku ato lindin dhe vdesin." (Lajmëtari i lirisë, gusht 1980, f. 8-9)

28. KTHIMI I BIRIT PLANGPRISHËS

(Ëndërr në tri pamje)
Pamja 1

Unë isha mbërthyer pranë radioaparatit dhe ia rrotulloja butonin prej vale në valë, prej intervali në interval. Kisha përshtypjen sikur mes intervalesh të caktuara dëgjoja një grahmë të kohëpaskohshme. Më ngjante me një kruarje të ngathët të shpatullave të Kontinentit të Vjetër. Evropa bënte gjumin e vet, tridhjetë e pesë vjeçar, në krahun e djathtë. Megjithatë, ca sinjale të mprehta hollake, si larva me bisht të zhdërvjelltë që preftojnë kohë pas kohe para syve të vëzhguesit bjerrakohës, sikur përmbanin mesazhe të mjegullta e të pakapshme për gjendjen e vërtetë të Kontinentit.

Papritur e pakujtuar m'u bë sikur mes atyre sinjaleve kapa një fërkim të rëndë e të mundimshëm. E rrotullova disa herë butonin e aparatit me dyshimin se mos më kishin bërë veshët për ato që më dukej se kisha dëgjuar fare qartë. Kudo e njëjta zhurmë, e njëjta grahmë, e njëjta përçartje; një si tërmet, me epiqendër në një skutë të parëndësishme të Kontinentit, në Ballkan bie fjala. Sinjalet thua se vinin nga një botë tjetër. Mes fjalëve jashtëzakonisht të gjata të një gjuhe të huaj, që po e kuptoja pa e pas ditur kurrë, si në ëndërr më, dhe që kërkonin angazhim thuaja mbinjerëzor për shqiptim të mbarë nga spikeri, më kishte zënë veshi edhe një emër të njohur, të urryer. E parëndomta qëndronte në tonin me të cilin u shqiptua ai emër dhe frazat që i prinë dhe e pasuan: ishte një timër senzacioni dhe aferash ndërkombëtare… Mos po e ndërronte krahun Evropa plakë?!

S'kishte asnjë dyshim, spikeri fliste qartë dhe radioja punonte për bukuri.

"Sot… Fadil Hoxhën e pritën më kot të dilte në foltoren e seancës së pasditës të Konferencës së partive komuniste të Evropës, ku ai duhej të fliste në cilësinë e përfaqësuesit të LKJ. Në këtë kohë Fadil Hoxha ishte paraqitur në Ambasadën e Kombeve të Bashkuara në Berlin, me një kërkesë të parevokueshme për azil politik. Me vete, në vend të arsyetimit formal që praktikohet në procedurën e strehimit politik, ai kishte sjellë një arsenal të tërë dokumentash dhe fotografish. Dokumentacioni në fjalë pretendon të pasqyrojë gjendjen e shqiptarëve në Jugosllavi, përkatësisht diskriminimin ekonomik, social e nacional që ushtrokan mbi ta shovinistët serbë, malazes e maqedonas dhe përgjithësisht qeveria e Beogradit.

Kërkesa e ish nënkryetarit të Kryesisë së RSFJ, si na njoftojnë në organizatën e Kombeve të Bashkuara, do të shqyrtohet pozitivisht, kurse dokumentacioni në fjalë do të studiohet në mënyrë urgjente dhe të shqyrtohet në njërën nga mbledhjet e para të KB. Pritet që pas këtij akti, në viset shqiptare të shpërthejnë turbullira, ndoshta dhe kryengritje masive.

A është fjala vetëm për një aventurë, që i kapërcen caqet shqiptare dhe jugosllave, apo për një hap serioz në lëvizjen revolucionare të popullit shqiptar drejt çlirimit dhe bashkimit me vendin amë, Shqipërinë socialiste, e për këtë problem qarkullojnë qëmoti informata, do të tregojë koha.

Sido që të jetë, nuk është hera e parë që Evropa ballafaqohet me çështjen shqiptare. Ndërsa Fadil Hoxha, të cilin shqiptarët nuk e dallonin deri më tash me asgjë nga armiku i tyre shekullor – shovinistët e Beogradit, tash ka mundësi të bëhet lider i vërtetë i revolucionit të tyre…"

Ja se cili paskësh qenë Fadil Hoxha? – thashë me vete.

Qe tridhjetë e pesë vjet e dinim se ai ishte sulur të hynte së prapthi në histori, si gaforrja në strofull. E kishim ditur për renegat që e ka nxjerrë në Pazar për pesë para tokën e shenjtë të të parëve dhe lirinë e popullit të shumëvuajtur shqiptar. Ta ketë mbledhur në vete gjithë këtë kohë vrerin e robërisë, që një ditë të shpërthejë si stuhi?! Apo ka dashur që, me një gjest, ta kthejë për së mbari gjithë punën e tij të deritashme, që s'mund të quhej me emër tjetër pos- tradhti?

Sido që të jetë, ka një thënie për prehrin e lënduar të nënës. Prehri i nënës e pranon herdokur birin plangprishës! Biri plangprishës, thashë me vete, po i kthehet gjirit të ngrohtë të atdheut! Bukur deri në llahtarë. Në çastin që atdheu po bëhej gati për ta flakur nën këmbë robërinë dhe, me valën e parë të marshit milionësh të lirisë, ta shkelte edhe birin e vet plangprishës me gjithë shokë.

Nëse nuk paskemi ditur ta vlerësojmë në mënyrë largpamëse personalitetin militant të Fadil Hoxhës, - thashë, pasi kisha nxjerrë kokën në dritare dhe kisha parë atje poshtë në qytet turmat e para të banorëve të Prishtinës, që kishin dalë të shënonin me brohoritje lajmin e posadëgjuar në radio- nëse jemi mashtruar, atëherë ky paska qenë një nga mashtrimet e ëmbla që ndodhin nganjëherë në jetë.

Pastaj, i entuziazmuar nga turma, bëra të dilja edhe vetë përjashta. Pse jo? Ishte një ngjarje gjithsesi e rrallë, prej së cilës mund të priteshin kthesa të tjera.. Shembullin e Fadilit mund ta ndjekin qysh sot Mahmuti, Xhevdeti, Xhaviti…Por, nuk dola. Më ndali radioja. Po emitohej një befasi edhe më e madhe, një fjalim i Fadilit drejtuar shqiptarëve të Kosovës.

"Vëllezër shqiptarë, - thoshte ai, - u deshën më se tridhjetë e pesë vjet që të dalë në dritë e drejta e patjetërsueshme që na u mohua me forcën e armës dhe të gënjeshtrës më të poshtër. Këto vjet, për veten time, i kam kaluar si gjarpri nën gur. Por, së paku u rashë në fije qëllimit të armikut dhe armëve të tij. Tash s'ka se ç'na ndal në rrugën tonë të shenjtë. Tridhjetë e pesë vjet nën robërinë e skëterrshme të shovinistëve të Beogradit, nuk janë pak. Ato e kanë dërrmuar dhe e kanë përdhosur tokën tonë të shenjtë dhe popullin tonë të shumëvuajtur. Por, nëse ne jepemi me gjithë mend dhe me gjithë fuqi për ta çuar në vend porosinë e shenjtë të të parëve, obligimin dhe nderin tonë më të madh, për ta parë të lirë dhe të bashkuar këtë tokë dhe këtë popull nën udhëheqjen e ndritshme të Partisë së Punës të Shqipërisë, atëherë gjithë vuajtjet e krajatat do të tretin sa çel e mbyll sytë. Para nesh do të shpaloset perspektiva e sigurt e një populli të mbarë e të fuqishëm, i cili e ka zgjedhur rrugën më të ndritshme të ardhmërisë, rrugën e socializmit të mirëfilltë, që është rruga e pashmangshme e gjithë njerëzimit në mëngjesin që po agon. Përpara, pra, drejt fitores!…"

Bukur deri në llahtarë! – përsërita dhe u dhashë i tëri pas zërit që vinte nga ana e anës së botës.

"Në mos Evropën, me vete do ta kemi pjesën e saj më përparimtare, marksistë-leninistët e rinj, që i kanë drejtuar sytë nga atdheu ynë i dashur, Shqipëria, të cilën e konsiderojnë atdhe të proletariatit. Do ta kemi me vete nënën Shqipëri… Shqipëri… Shqipëri…"

Ç'janë këto belbëzime?

Zëri papritmas kishte zënë e po humbiste timbrin e ëmbël dhe patosin e militantit të lirisë. Për një kohë tmerrësisht të gjatë u duk sikur dëgjoja një magnetofon të vjetër të prishur, me gjilpërën që ndalet vazhdimisht në një pikë të diskut të dëmtuar, me tingujt që dalin llahtarshëm si nga ndonjë zgërbonjë avdalle e natës. Kërkëllima e thellë, që

përsëritej me çdo fillim dhe mbarim të të njëjtës frazë të përsëritur, dalëngadalë u shndërrua në një kruarje planetare.

Ishte sërish ai fërkimi i moçëm i njohur i shpatullave të Evropës plakë, e cila nuk jepej. Nuk e ndërron aq lehtë ajo krahun, në të cilin flenë ngathtësisht qe tridhjetë e pesë vjet…

"Shqipëria…"

Pamja III

Po tash po zgjohesha nga gjumi. Te kryet e shtratit vërtet dërdëlliste radioja. Në kuadratin e ndriçuar të aparatit, që do ta kem lënë ndezur qyshse mbrëmë dhe ku kishin rënë fijet e para të një mëngjesi të bardhë, më dukej sikur u reflektua në trajtë fluidi tiparet trashamane të personit të Fadil Hoxhës, i cili seç belbëzonte në një shqipe të vjetër, të bërë blozhdë nga të menduarit e gjatë në serbokroatishte të atij që e fliste. Vetë zëri të përkujtonte një tellall të dobët, që flet si në jermi rrugëve të botës, duke shpërndarë mesazhin më absurd, që s'e pranon asnjë portë e njerëzisë.

"Shqypnia, shokë… Shqypnia po përzihet në pun't tona t'mrenshme. Ju, shokë, duhet m'e dit vet dhe m'u kallxu' edhe thmive t'tu, net m'sojnë qysh duhet ën shkoll, qysh duhet m'e punu' tokën; me i hek lopt e vogla, me bo lop të mdhaja, qi për me pjell viça të mdhaj.. Ju, shokë, duhet m'e dit kush na i ka dhon kto lop e kta viça, përveçse Tita, Jugosllavia e Tit's. Djemt le ta trusin bythën e ne t'rrinë rahat, i ka qit sefaja mëç… Eqrem Qabej, Eqrem Qabej! E kush koka Eqrem Qabej? E kemi na Idriz Ajetin, ma i mir s'na duhet! S'e hekin goje njifar Kada… Kadarin… Kadarenë. Thonë, koka shkrimtar i mirë. Pse, Azem Shkreli jon koka shkrimtar i keq a? A pak shkrimtar kemi na pa ata të Shqypnisë? Qe, për shemull, Ivo Andriqi, Dobrica Qosiqi… Vasa Qubriloviqi… (Jo, ky s'koka shkrimtar po shkenctar!) Punë e madhe!

E fika me rrëmbim. Deri kur do të na kuisë kaq kobshëm mbi portat e shtëpive kjo sorrë ndjellakeqe, kjo qyqe nate, kjo kukuvajkë, kjo shpendkeqe?!

Këtë "fjalim famoz" të analfabetit-renegat Fadil Hoxha e kisha dëgjuar me qindra herë, në të njëjtin edicion, të qëruar ndjenjash dhe mendimesh. E dija përmendsh çdo të thoshte më tej. A s'ishte ai vetë ai disku i dëmtuar i gramafonit, në të cilin Beogradi ka incizuar mbeturinat e demagogjisë dhe të propagandës më të poshtër e më të tejdukshme, që Fadili t'i shesë me pozat e tij karakteristike prej kreteni që i mban të përveshura buzët dhe me gjuhën e tij të ntrashur prej të çkombëtarizuarit atje ku i shiten më së paku, në Istog, Irzniq, në "zem-zadrugën" e Bishtazhinit. Thua se ka të bëjë me koka lakrash, e jo me pasardhësit e popullit më të lashtë të Gadishullit Ilirik, që ta marrin kokrrën në sy dhe s'u bëhet vonë për rrenat e pakripura, sepse kanë punë më të urta në shtëpi. Thua se ka të bëjë me "lopt dhe viçat" e këtyre "zem-zadrugave", të cilat s'i heq goje. Këtë detyrë i kanë dhënë "urtakët" e Beogradit ish nënkryetarit të Kryesisë së RSFJ, Fadil Hoxhës: që ky të bëjë agjitacion për zëvëndësimin e lopëve të vogla "tradicionale" me lopë të mëdha të Banatit, të Kragujevcit, të Danimarkës, që bëjnë viça të mëdhenj.

Pthu! – pështyva, duke menduar në ëndrrën absurde të natës së kaluar. Dhe, në çast, vendosa: bashkë me viçat e mëdhenj të lopëve si ajo që polli Fadilin, do ta shpall të pavlefshme në gazetë edhe ëndrrën time të marrë. Nuk do të blej më viça të mëdhenj, për t'i hyrë në qejf Fadilit, dhe nuk do të shoh kurrë më ëndrra kaq pa lidhje.

Për ata që besojnë me këmbëngulje se ëndrra ka patjetër një dimension të realitetit të përjetuar, kam një ide. Të lidhemi me kusht: a mund të bëjë Fadili zgjandërr qoftë edhe hijen e asaj që bëri në ëndrrën time absurde?

Unë them se jo. Kurrë !

Po ju, vëllezër, si thoni ju? (Lajmëtari i lirisë, gusht 1980, faqe 9-10)

29. DY FJALË PËR NUMRIN E PARË TË "LAJMËTARIT TË LIRISË"

Kemi nderin që, në kushte jashtëzakonisht të vështira të ilegalitetit, të dalim para lexuesit shqiptar me një revistë të dypërmuajshme revolucionare, që e kemi emërtuar "Lajmëtari i lirisë". Shpresojmë se nëpërmjet këtij organi do t'ia dalim me sukses të bëhemi zëdhënës të aspiratave revolucionare të djalërisë shqiptare të Kosovës, e cila nuk e ndal dot luftën për çlirim nga robëruesi i egër jugosllav dhe për bashkim me vendin amë Shqipërinë.

Kështu shpresojmë të plotësojmë edhe një detyrë, një dimension të luftës sonë të përgjithshme: të demaskojmë botërisht armikun tonë shekullor, qeverinë shoviniste të Beogradit, dhe t'u bëjmë jehonë ideve dhe veprimeve të lëvizjes së përgjithshme nacionalçlirimtare në pjesën e robëruar të atdheut tonë, në tokat shqiptare të robëruara nga Jugosllavia.

Krahas përvojës se begatshme revolucionare të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të ndërtimit socialist në vendin tonë amë, krahas pasqyrimit të gjendjes ekonomike, shoqërore e kombëtare të shqiptarëve, që lëngojnë nën zgjedhën e egër sllave, në revistën tonë do të bëjnë vend dhe do të priten me mirëseardhje të gjitha ato ide e veprime, që shpien kah realizimi i aspiratave tona shekullore. Me fjalë të tjera, për ne do të jenë të mbara të gjitha idetë dhe veprimet revolucionare që zhvillohen qoftë në planin ilegal, gjysmilegal apo në planin legal e që përputhen me platformën tonë revolucionare.

Cila qenka platforma jonë?

Përgjithësisht, ne përvetësojmë vijën ideopolitike të Partisë së Punës të Shqipërisë, me adaptime minimale, që implikohen aty-këtu nga gjendja jonë karakteristike. Përafërsisht këtë vijë ndoqën afro pesëdhjetë organizatat dhe grupet patriotike revolucionare të shqiptarëve të Kosovës, që armiku, fatkeqësisht, arriti t'i dëmtojë bukur shumë qe tridhjetë e pesë vjet.

Kemi njoftime se armiku ynë shekullor, qeveria e Beogradit, për të dëmtuar luftën tonë të drejtë, e cila mund të arrihet vetëm duke përfillur idenë e një revolucioni të përgjithshëm socialist, djem nga radha e shqiptarëve ushtron dhe organizon në një ushtri iluzioniste, në ushtrinë e treqind partive shqiptare, që hanë bukën e imperializmit dhe njëkohësisht ia zgjasin jetën qeverisë shoviniste të Beogradit. Lufta e emigracionit shqiptar, me rrënjë në imperializmin e kalbëzuar e me idenë e saj të përgjithshme shkatërrimin e Shqipërisë së sotme dhe të rezultateve të saj të shkëlqyera në avancimin e socializmit, jo vetëm që është luftë e huaj për ne, por ajo do të luftohet pa kompromis, sikundër që luftohet çdo fraksion armiqësor, që do të quhet dezertim nga e vetmja luftë e drejtë – revolucioni socialist."

Më në fund, me shpresë se do t'ia dalim me sukses punës së nisur dhe se do ta gëzojmë edhe lexuesin tonë të etshëm për vlimet revolucionare në tokat shqiptare, ne po ia lëmë me kaq "Lajmëtarit të lirisë" ta na flasë vetë për preokupimet, platformën dhe për idetë revolucionare që do të pasqyrohen në të. (Lajmëtari i lirisë, nr.1, gusht 1980, faqe 16)

30. Jo ngushëllime po urime

Studenti N. ra në burg – bashkë me dy mijë e sa shqiptarë të tjerë, që i burgosi vjet UDB-ja në mënyrë të palejueshme dhe në kundërshtim me ligjet ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar dhe po i shkelë vetë Jugosllavia. Po ja që studenti N. paskësh bërë "vepër penale të bashkimit dhe të propagandës kundër shtetit", prandaj "duhej" të dënohej dhe kështu i hëngri 8 vjet burg të rëndë!

Kush u dënua u dënua, dhe jetën s'ka q'e ndalon. Dhe erdhën kushërinj e miq dhe ia uruan babait të studentit N. burgosjen e djalit: Pastë faqen e bardhë! Nuk ka rëndë për çkado punë në burg…

Por, nuk kaluan as ca ditë të tjera dhe plakut, d.m.th. babait të studentit N. erdhi e i trokiti në derë – si me ndruajtje e ngurrim – një nga miqtë e kahmotshëm të familjes. "Traktorin që patëm bërë pazar", tha, "më duhet të ta kthej…" "Pse lumë miku", ia priti babai i studentit N. "Traktori është i ri dhe në gjendje të rregullt!" Atëherë ai miku i tregoi se nuk i gjente të metë traktorit, po ata të UDB-së ia paskëshin vënë këmbën: Ai është armik i shtetit dhe i popullit, – i paskëshin thënë, – dhe ku ke parë ti të blihet traktori nga armiku!…

Vitin e kaluar, përfaqësuesi numër një i opozitës jugosllave, M. Gjilasi, u kap vetë i treti duke botuar e duke shpërndarë gazetën ilegale antijugosllave "Casovnik". Dënimi: 1000 000 dinarë të vjetër (Gjilasi), një muaj burg (bashkëpunëtori i tij i parë).

"Rilindja" që e pat botuar këtë lajm senzacional, nuk e tha dot se 1000 000 të vjetër, që Gjilasi detyrohej të paguante gjobë, ishte cazë më i vogël se pensioni i rangut të parë, që merr ky ish funksionar i lartë. Pa llogaritur këtu të ardhurat e tjera të këtij ultrarevizionisti, të cilat ai i vjel nga honoraret për intervista, shkresurina e libra, të gjitha thellësisht antijugosllave, që kanë dalë dhe vazhdojnë të dalin nga pena dhe nga goja e tij në botën e jashtme.

Kishte në atë kohë disa njerëz "naivë", të cilët pritnin që "Rilindja" e "tyre" të angazhonte menjëherë pas këtij lajmi ndonjë penë "të shquar" si Fahredin Gungën bie fjala, për të dalë në gazetë, në radio e në televizion me ndonjë koment, siç ka qenë zakon së paku kur bëheshin burgosje politike të shqiptarëve. Kurse ne çuditemi sot për atëherë, si ka lejuar fare Serbia të dalë në gazetë edhe një lajm aq i vogël.

Që gjyqi jugosllav të kujtohej për ndonjë dënim më adapt për Gjilasin me kompani – siç ishte larg mendësh, ashtu doli. UDB-ja po e kafshon buzën me pendesë që "u nxitua", dhe "gabimin" e përparshëm po e përmirëson duke i bërë koncesione Gjilasit në një kohë edhe më të përshtatshme: tash "po i jep leje" që ky të botojë jo më gazeta, por libra të tërë!* Në rrëmujën e sotme jugosllave, kur për çdo çast mund të ndodhin edhe gjëra nga më të papriturat e më të pabesueshmet, edhe kalbësirat si Gjilasi duhet të ruhen me kujdes! Pse jo, ai po i vak në diell shpresat e tij të moçme për ta zënë vendin e ish xhelatit Tito. Pos kësaj, burgu nuk është për "zotërinj subtilë" si Gjilasi. Për plebej bëhen burgjet, me plebej mbahen ato…

Është një "plebej" shqiptar, i cili po dënohet qe tri herë me burg të rëndë. Një herë pesë, pastaj dy herë nga pesëmbëdhjetë vjet! Tamam aq sa të mos e shoh kurrë diellin me sy! Madje, pa nxjerrë kurrfarë gazete si "Casovniku" i Gjilasit.

Anomali? Jo. Logjikë qind për qind!

Dënimet e rënda një shtet i ka për njerëzit që paraqesin rrezikun më të madh për atë shtet.

Sipas kësaj logjike del, po ashtu qind për qind se M. Gjilasi është një qen me zgjebë, që çirret kot së koti. Një qen dhëmbërënë, që e kalon motin nën kosh të drithit, duke lehur pa rrezik (lexo: në banesën e tij të madhe në mes të Beogradit, dhuratë nga

Titua, me pensionin po të rangut më të lartë dhe pa pengesa për intervista e libra antijugosllave). Ndërkaq, akti i pashembullt revolucionar i Adem Demës-Demaçit është një rrezik i përhershëm që Serbia të mbetet pa tokat shqiptare (njëherë e përgjithmonë), mbi të cilat i mban ende kthetrat e veta të përgjakshme.

Pra, rreziku pikërisht nga plebenjtë vjen.

Por, të kthehemi edhe një herë te traktori.

A ka vend të habitemi pse në raste të caktuara edhe shitblerja më e rëndomë e një traktori edhe më të rëndomë paska mundësi të bëhet "çështje politike"?

Aspak!

UDB-ja i ka llogaritë e veta, shumë të qarta: dënimet sa më të rënda për patriotët shqiptarë, izolimin total të familjeve të këtyre patriotëve, presionin politik edhe mbi rrethin e ngushtë e të gjerë të tyre. Që, kur të marrë babai shqiptar guxim për të nxjerrë këtë botë jallane një fëmijë (mbase çdo lindje te ne është shumë më e rrezikshme se Casovniku i Gjilasit!), të kujtohet domosdo t'i thotë menjëherë foshnjës së porsalindur: "Larg çdo pune politike e revolucionare, se do të më mbetet traktori pa shitur!"

A ka fakte më të mira që të na e mbushin mendjen se, për Serbinë hegjemoniste, pika neuralgjike jemi pikërisht ne, shqiptarët. Dhe, a duhet të na dëshpërojë e të na trembë kjo gjë, apo të na bëjë çdo ditë më të lumtur e më të fortë, se kështu po i afrohemi realizimit të aspiratave tona shekullore.

Për babanë e studentit N. të burgosur, për etërit e të gjithë të burgosurve politikë shqiptarë, që s'e kanë kursyer veten për çështjen e shtrenjtë të atdheut, ne nuk kemi fjalë ngushëllimi, po vetëm urime. Këtë të drejtë na e jep gatishmëria që as ne të mos largohemi kurrë nga rruga patriotike e revolucionare, jo vetëm kur na kërcënohet burgu i rëndë sikurse ai ku lëngojnë shokët e vëllezërit tanë, po edhe atëherë kur do të na kërcënohet edhe vdekja. Sepse nuk kemi iluzione për liri të fituar pa sakrifica dhe pa gjak.

Gjyqi jugosllav e ka dënuar tri herë me burg të rëndë Adem Demën-Demaçin, luftëtarin më të paepur kosovar për idealin kombëtar dhe njerëzor në Kosovën e pasluftës: më 1958, me 5 vjet burg, nga të cilat i ka mbajtur 3; më 1964 me 15 vjet, nga të cilat i ka mbajtur 10; dhe më 1975 po me 15 vjet burg të rëndë, nga të cilat i kanë mbetur edhe 10 vjet. Pra, deri më tash, shëndetin dhe rininë e heroit tonë të gjallë, burgjet dhe UDB-ja fashiste kanë pasur rast ta thithin si shushunja, për tetëmbëdhjetë vjet të gjatë me radhë. (Ademi vetë sapo ka shkelur në moshën 45 vjeçe!) Të tri herët është dënuar për "vepër armiqësore kundër popullit dhe shtetit". Në gjykimin e fundit, në shtator 1975, patrioti ynë pat deklaruar haptazi, pa hezitime dhe me domethënie të thellë: "Megjithëqë… plotësisht i pafajshëm, unë gjithmonë kam qenë dhe kurdoherë kam për të qenë – deri në vdekje – për idealin kombëtar e njerëzor; dënimi që po më bëhet mua është dënim për bindje dhe mendime, e jo për vepër, dhe kjo gjë është, me sa di unë, kundër ligjit dhe në kundërshtim me të gjitha normat ndërkombëtare e njerëzore."

Më 10 qershor të këtij viti, "Rilindja" mori lejë të nxirrte emrat e një grupi prej 8 vetash: Shefqet Jashari, Ramadan Pllana, Avdi Kelmendi, Abdyl Lahu, Isa Demaj, Sylejman Qyqalla, Skënder Jashari dhe Hysen Gërvalla – që Gjykata e Qarkut të Prishtinës u dha dënime 3-8 vjet burg të rëndë për "vepër penale të propagandës dhe bashkimit me qëllim të veprimtarisë armiqësore". Një muaj më vonë po kjo gazetë solli edhe lajmin nga Gjyqi i Qarkut të Shkupit, i cili, për të njëjtën vepër, kishte dënuar 3-6 vjet burg të rëndë Gani Sylajn, Muharrem Shalanin dhe Haxhi Maliqin. As te grupi i parë as te i dyti (dhe as te afro 2000 të burgosurit e tjerë politikë shqiptarë, që i burgosi vjet UDB-ja), nuk janë kapur materiale armiqësore të dënueshme me ligjet ndërkombëtare, të

cilat i ka nënshkruar edhe vetë Jugosllavia në Helsinki, para disa vjetësh. Të burgosurit në fjalë janë privuar lirie vetëm për deklarata verbale ose shkresa unike apo të shumëzuara me dorë e makinë shkrimi – dhe kjo gjë është në kundërshtim me ligjet ndërkombëtare. (Por, kush do ta detyrojë Jugosllavinë të përgjigjet për këto krime, në mos e detyrofshim ne vetë. (Lajmëtari, tetor 1980, f. 2)

31. ME SY E ZEMËR NGA NËNA SHQIPËRI

Në qoftë se epoka e lavdishme e Skënderbeut nxori në pah një përmasë të rëndësishme të shpirtit të popullit tonë; gatishmërinë për flijim në shkallën më të lartë dhe frymëzimin e papërsëritshëm për mbrojtjen e atdheut, mund të thuhet se epoka e sotme shqiptare e Partisë së Punës dhe e Enver Hoxhës jo vetëm që konfirmoi të parën, por sheshoi edhe një përmasë tjetër, të ndryrë deri në tash në ndërdije nga shekujt e robërisë dhe historia njerkë, etjen e madhe të shqiptarit për punë dhe për ndriçimin e plotë të mendjes. Sot doli në shesh Njeriu i Ri, vërtet nga gjiri i një populli të vogël, por i pari që të bëhet shembull në botë.

Skena e dramës së sotme shqiptare është po ajo e para 500 vjetëve, kur Shqipëria bënte luftën e prometheut kundër të gjithë perëndive. Atëherë ishte bota e krishterë ajo që e pat nisur luftën kundër kuçedrës anadollake. Dhe, posa u duk se ajo botë po e bekonte titanin Skënderbe i cili më në fund i çonte në vend edhe interesat e Evropës, fuqitë e kohës ia kthyen shpinën heroit tonë në tradhti nga më mizoret dhe jepnin me të madhe edhe porosi e para për eliminimin e tij. (Sikur kishte diçka që nuk durohej te personaliteti i Gjergjit dhe i gjithë popullit shqiptar; ndoshta serioziteti dhe këmbëngulja mbinjerëzore që çështjen e shtrenjtë të lirisë e bënte të kuptohej në gjithë njërëndësinë e saj.

Kësisoji u sprapsën edhe forcat e djeshme komuniste, të cilat në vallen e madhe të komunizmit patën hyrë përpara Shqipërisë së “vogël”. Kjo Shqipëri e “vogël”, në njërëndësinë e saj të madhe në luftë për zhvillimin dhe pavarësinë e plotë të vendit si dhe për avancimin dhe mbrojtjen e çështjes së madhe komuniste, revizionistëve ua mori gjithë merakun – në kushte të luftës me një intensitet që ato s’e kishin parë e s’e kishin menduar.

Marrëveshjet paqësore dhe krushqitë e dikurshme të Venedikut e të Serbisë me vezirë e sulltanë, në një kohë që Shqipëria martire po e lante në gjak çdo pëllëmbë të tokës së vet në luftë kundër fuqisë më të madhe të epokës, nuk ndryshojnë aq shumë nga tradhtia jugosllave, sovjetike, kineze… që tradhtuan komunizmin, duke mos qenë të gatshme t’i bëjnë ballë frymëzimit të lartë marksist-leninist dhe duke parapëlqyer rrugën e rezistencës së ulët ndaj armikut të epokës- imperializmit dhe kapitalizmit.

Ne, shqiptarët e shkëputur me dhunë nga trungu i Atdheut tonë të shenjtë, që dhuna na mbërtheu brenda kufijve politikë të Jugosllavisë, ndjekin krenarë çdo hap të Shqipërisë nënë në formimin dhe përparimin e Atdheut dhe të çështjes së madhe komuniste. I gëzohemi çdo prove të suksesshme të unitetit të pathyeshëm të partisë me popullin, e kjo na bën edhe ne më të fortë. Mburrja e entuziasmi ynë s’kanë kufi kur kujtojmë që Shqipëria, nga një vend i varfër dhe i prapambetur feudo-borgjez, tash është kthyer në një vend të përparuar e të zhvilluar, pa analfabetizëm e papunësi, ku kultivohet socializmi i mirëfilltë, në një vend, që jo vetëm po ia del ta ruajë të paprekur kështjellën e marksizëm-leninizmit, po edhe të ndezë shkëndija revolucionare te pjesa më e madhe e popujve të botës. Pa frikë se biem në ndonjë eufori të palejueshme, ne jemi të bindur se nesër, kur këto shkëndija të kthehen në zjarre të vërteta revolucionare, bota do t’ia njohë një pjesë të madhe të meritave pikërisht Atdheut tonë, Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Do të jetë dashur një punë e mundimshme tej mase për të arritur në shkallën e sotme. Jemi në dijeni për një pjesë të konsiderueshme problemesh me të cilat janë ballafaquar PPSH dhe populli shqiptar në rrugën e tyre të ndritshme. Ajo që na krenon dhe na jep shpresë më së shumti, është fakti se, në gjithë këtë punë prej titani, PPSH dhe populli shqiptar i lirë, në udhëkryqin e njërës nga sprovat më të mëdha historike, ka zgjedhur rrugën e sinqeritetit dhe të guximit të pashoq, në të cilin është mësuar ndër shekuj populli ynë i shumëvuajtur, rrugën, e cila Atdheut tonë i jep dorë të bëhet tribunë e fuqishme e idesë përparimtare dhe e lirisë për të gjithë popujt e botës, duke ndarë si me thikë të mirën nga e liga.

Ne ndjekim me indinjatë të thellë bllokadën e ligë ndaj Shqipërisë, të nisur nga imperializmi e kapitalizmi dhe të vazhduar egërsisht nga revizionizmi modernë. Por, zemra na bëhet mal kur shohim që Atdheu ynë marshon sypatrembur, duke çarë një pas një rrethinat e bllokadat mizore dhe duke ndjekur me frymëzim e besnikëri të pashembullt rrugën e socializmit, që është e nesërmja e të gjithë njerëzimit.

Në sajë të ekzistimit të kësaj Shqipërie të mbarë, të fortë e vigjilente dhe në sajë të shpirtit të paepur luftarak të popullit tonë në përgjithësi, edhe ne – shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare brenda kufijve politikë të Jugosllavisë – ndonëse jemi dëmtuar në një farë mase nga shtrëngimi i darëve të social-shovinizmit serbo-malazezo-maqedonas, kemi qëndruar dhe ia kemi dalë të ruhemi nga ujërat e zeza ideologjike të revizionizmit titist-rankoviçist. Larg ndjenjës shoviniste a revanshiste, që ka mundur të bëhet pasojë e të zezave që kemi hequr me dekada nga armiku barbar, te ne është ndezur xixa e luftës së pashmangshme nacionalçlirimtare, konturet e së cilës po duken qartë në horizont.

Të nxirret pjesa e robëruar e tokave dhe e popullit shqiptar nga kthetrat e përgjakshme të social-shovinistëve titistë dhe të çohet në vend vullneti i nëpërkëmbur i popullit tonë të shumëvuajtur; bashkimi me vendin amë, është e drejtë historike që iu mohua – po pa iu çrrënjosur kurrë popullit tonë të vënë në shekuj përballë padrejtësive të mëdha historike.

Në dëshmi të përpjekjeve dhe të luftës sonë flasin, pos të tjerash, vetë kampet jugosllave të përqëndrimit me barkun e tyre të errët e të akullt, që s'po pushon së gëlltituri qe dyzet vjet me qindra e mijëra patriotë e revolucionarë shqiptarë. Flet vetëdija e zgjuar kombëtare dhe klasore e shqiptarëve me banim në Jugosllavi.

Na bën të fortë fakti se PPSH me shokun Enver në krye, jo vetëm që kanë ndjekur në hap të gjitha konjugacionet e gjenocidit sllavofil të ushtruar mbi ne, por kanë qenë edhe të vetmit denoncues të këtij gjenocidi në sy të botës.

Deri sa ne na kanë zhdukur masivisht si "ballistë" dhe deri sa kemi duruar urie, deri sa ne kemi shikuar me sedër të vrarë kombëtare si zbret dhe si na ndalohet flamuri shqiptar me të cilin i kishim çliruar tokat tona, deri sa nga vatrat tona të dashura na kanë dëbuar me tortura e shantazhe, me një fjalë, gjithë kohën që ne kemi shijuar mjetet më të egra të gjenocidit nga ana e social-shovinistëve titistë, i vetmi satisfaksion për ne ka qenë forcimi dhe zhvillimi i mbarë Shqipërisë nënë dhe denoncimi nga ana e saj i të zezave të zbrazura me rrebesh mbi kokën tonë. Dhe në vend të ndjenjës së braktisjes nga Shqipëria nënë (këtë ndjenjë provoi një kohë të gjatë ta injektonte në ne gënjeshtra e ligë titiste), qenien tonë e mbushi ndjenja e fuqishme se nuk jemi vetëm dhe ka kush na del zot, ka kush e davarit mjegullën, me të cilën titistët menduan ta mbështillnin historinë tonë të vërtetë dhe planet e tyre shtetërore për shfarosjen e shqiptarëve.

Si gjithmonë, edhe sot, pararoja jonë revolucionare dhe mbarë populli ynë, me sy e me zemër jemi të drejtuar nga nëna Shqipëri dhe presim çastin që fatin tonë do ta lidhë sërish me fatin e saj, si një pjesë e pandashme, për tërësinë e së cilës është derdhur gjaku i bijve martirë të Shqipërisë ndër shekuj. (Lajmëtari, tetor 1980, f. 3)

32. Gëzuar Nëntori

Erdhi edhe nëntori i 68-të i festave që shqiptarët i kremtojnë në dy gjendje të ndryshme. Ndërsa Atdheu ynë i lirë, Shqipëria socialiste, ia thotë për këto festa me zë të fuqishëm këngës së rezultateve të shkëlqyeshme në ndërtimit e vendit dhe në kultivimin e mbrojtjen e pashoqe të socializmit, ne të tjerët, shqiptarët e shkëputur nga trungu amë, shënojmë lavdinë e të parëve tanë, që tokën mëmë e ulën me gjakun e tyre të shtrenjtë po të pakursyer, dhe mjerimin e sotëm kush nën robërinë e egër të pushtuesve sllavë e grekë dhe kush në udhën e madhe të kurbetit në dhera të huaja.

Ne shqiptarët e Kosovës dhe të viseve tona të tjera brenda Jugosllavisë, këtë nëntor po e shënojmë në një skamje e mjerim të madh, ku jemi katandisur në saje të politikës kolonialiste të pushtuesve revizionistë jugosllavë, me lot ndër sy qajmë vuajtjet e motrave dhe të vëllezërve tanë, që lëngojnë në burgjet e armikut gjakësor, por dhembja jonë është dhembje krenare, sepse ata nuk e kursyen rininë e tyre, por u hodhën në luftë të guximshme për realizimin e aspiratave tona shekullore për bashkimin e tokave shqiptare dhe për shembjen e rendit antipopullor të Jugosllavisë revizioniste.

Lëvizja nacional-çlirimtare në Kosovë e në veset tona të tjera përkëtej kufirit, e cila pasqyrohet në një luftë me pushtuesin dhe tradhtarët që po i shërbejnë atij me besnikërinë e qenit, si dhe në vetëdijen tonë të ngritur në pikëpamje kombëtare dhe klasore, ne jep shpresë se nuk do të kalojë shumë kohë dhe festat e nëntorit do t'i kremtojmë së bashku me atdheun tonë të lirë.

Gëzuar festat e Nëntorit! (Lajmëtari, tetor 1980, f.3)

33. KOHËT NDËRROJNË FATLUMNISHT

Mbi idetë dhe lëvizjet përparimtare asnjë popull nuk mund të vërë dorë përgjithmonë, ashtu si e vë njeriu kësulën në kokën e vet të patjetërsueshme. Ku zënë fill, nga shtegtojnë dhe ku ngrehin çerdhe lejlekët e anës së ndriçuar të vetëdijes së Planetit, është punë që nuk mund të hetohet jashtë ligjshmërisë dialektike; Dhe, kjo ligjshmëri, për të paditurin, shfaqet përplot pusi.

Ideja e madhe komuniste mori krahë në Gjermani, me Marksin në ballë. U avancua dhe u materializua në Revolucionin e madh rus, të cilit i priu Lenini dhe të cilin e çoi përpara Stalini. Po pasi braktisi stepet e paskajshme, e pezmatuar në tradhtinë e akullt hrushoviane, ideja e madhe komuniste u strehua dhe nguliti në Shqipërinë e "vogël". Këtu gjeti prehje dhe truall të përshtatshëm për lulëzim të plotë. Së këndejmi fshikullon sot pa mëshirë imperializmin dhe social-imperializmin, "eurokomunizmin" fodull. Këtu u bë fener për proletariatin, të nënshtruarin, të kolonizuarin. Kudo në botë. Sepse, si thotë poeti, Shqipëria është një magje lirish, që formulën e lirisë nuk e mban sekret.

Në këto çaste, kur pjesa e robëruar e Atdheut tonë lëngon rëndë nën kthetrat e social-shovinistëve jugosllavë, kujtesës sonë kombëtare të fanitet një përbindësh më i hershëm-gjysmëhëna e sulltanëve turq. Pesë shekuj rresht u përpoq ajo ta përpinte flamurin shqiptar dhe u kërcënua të zhdukte nga faqja e dheut çdo shenjë të shqiptarizmit. Ç'paska ndërruar kështu te Shqipëria që sot, rinisë turke, në marshimet e saj revolucionare, t'i valojë shkaba dykrenare shqiptare mbi fushën e gjakut dhe poeti turk t'u çojë të fala dhe "nder… duarve (shqiptare – L.L) që, me të njëjtën mjeshtëri që

përdorin armën, përdorin penën, penelin, harkun e lahutën… duarve që krijuan njeriun e ri”?!

Në këto çaste na kujtohet edhe gulçimi i rinisë hitleriane për ta shtruar e për ta dërrmuar Shqipërinë. Por, këtij kujtimi i del përballë me gjallëri një pamje e këndshme: sot, komunistët marksistë-leninistë gjermanë, Atdheun tonë, Shqipërinë socialiste , e konsiderojnë pishtar të komunizmit dhe atdhe të të gjithë proletarëve në botë.

Ç’ndërrim fatlum i kohëve!

Vetëm i padituri dhe kopuku i dhënë pas dokrrave dhe pas ashtit, që mund t’ia hedhin në këmbim të lirisë së rrëmbyer social-shovinistët e Beogradit, nuk mund të kuptojë ende se ku kanë vajtur punët. Dhe vetëm ky i paditur dhe ky kopuk mund të mos mendojë ashtu si mendon bota. Ose kështu si shprehen shkrimtari bashkëkohës frëng Robert Eskarpit dhe poeti turk Tahsin Saraç, të cilëve po ua japim fjalën. (Lajmëtari, tetor 1980, faqe 6)

34. Dokumenti i gatishmërisë

Gjithë ata shqiptarë që - duke harruar demonstratat historike të vitit 1968 - ka harruar ç'është forca e masës së revoltuar, këto ditë pati rast të përkujtohet edhe njëherë, me demonstratat e futbolldashësve të Prishtinës, më 21 shtator.

Vendi dhe preteksti i tyre mund të jetë i pakuptim në dukje të parë: reagim për një padrejtësi sportive në fushën e futbollit. Por, duhet të jesh fare jashtë realitetit shoqëror kosovar, nëse çështjen e kufizon në këtë mënyrë. Edhe fizikisht, demonstratat kaluan jashtë fushës së sportit, u përhapën në rrugët e Prishtinës dhe zgjatën deri natën vonë. Vallë, një padrejtësi e thjeshtë sportive mund t'i shtynte qytetarët tanë që "tërbimin" e tyre ta derdhnin mbi çdo automjet, të madh a të vogël, që nuk kishte targë të Krahinës sonë?! A s'i përkujtojnë autobusët dhe veturat e përmbysura, demonstratat e 1968-ës?!

Ky dokument i gjallë i pakënaqësisë së masave, pos që i dha grusht qeverisë së Beogradit, duhet t'i bëjë të mendojnë pak më thellë edhe forcat tona revolucionare, sidomos pararojën e tyre: në qoftë se nuk evidentohet pakënaqësia e përgjithshme, në qoftë se ajo nuk shfrytëzohet në mënyrë të organizuar për qëllime revolucionare, atëherë s'do mend se pakënaqësia e tillë, si potencial që kërkon shkarkim të domosdoshëm, do të manifestohet patjetër në mënyrë spontane. Dhe dihet se në raste të, vendi dhe preteksti s'kanë si të jenë të qëlluar, domethënë në mënyrë vitale të nisin dhe të zhvillohen atje dhe ashtu si e do puna.

Ky shpërthim ndodhi në një kohë të përshtatshme, kur disa elemente të revolucionit tonë, të tërhequr nga ofensiva për shkak të presionit të madh policor e politik të pushtetit, kishin zënë të përqafonin aty-këtu edhe ide disfatiste e kapitulluese. Një pjesë e intelegjencës sonë donte të thoshte - natyrisht, jashtë ligjeve të dialektikës - sesi te populli ynë qenkan vërejtur edhe shenja përgjumjeje dhe mosgatishmërie për t'iu përgjigjur pararojës revolucionare. Ata e harrojnë traditën shekullore luftarake të popullit shqiptar dhe, nga hutesa e vet, bëjnë llogari të gabuara dhe veprime të rrezikshme: dyshojnë dhe përhapin dyshime lidhur me situatën reale te ne dhe me shpirtin luftarak të popullit tonë në këto çaste të vështira robërie e mjerimi.

Tani, jo me fjalë e me shtrydhje sterile të trurit që të shpie në udhë të pakrye, po me një vepër të shkëlqyer të manifestimit konkret të forcës së popullit, këto demonstrata na e tërheqin veshin qortueshëm dhe sikur na thonë fare qartë se kush ka të drejtë të dëshpërohet: inteligjenca me popullin, apo populli me inteligjencën? Pakënaqësia dhe revolti i shtresuar i masës në rrethana të caktuara historiko-shoqërore janë, pa dyshim, të barasvlershme me potencialin e pafrenuar të rrymës së rrëmbyeshme të lumit. A do të

derdhet kot ai potencial, apo do t'i lëvizë turbinat e revolucionit, varet nga djalëria pararojë, pjesë e pandashme e së cilës është inteligjenca popullore.

S'ka revolucion pa popullin dhe s'ka popull jorevolucionar. Gjithçka varet nga kushtet objektive, në të cilat do të shpërthej ose jo revolucioni. Kurse qielli ynë - siç e tregon realiteti objektiv dhe siç e thonë analizat e thella shkencore marksiste-leniniste të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të udhëheqësit të madh shqiptar Enver Hoxha - është i stërngarkuar me elektrizim të fuqishëm revolucionar.

Për revolucionarin e vërtetë është e qartë se shkarkimi i këtij elektrizimi do të bëhej më me vend e më me efekt po të kishte udhëheqës të denjë revolucionarë, që do të viheshin në ballë të masave të revoltuara për t'u prirë atyre kah fronti i shenjtë i çlirimit të tokave stërgjyshore dhe i bashkimit me Atdheun tonë të lirë, Shqipërinë socialiste. (Lajmëtari i lirisë, nr. 2, tetor-nëntor 1980, faqe 6)

35. VDIQ VIGANI I DIJES SHQIPTARE

Historia e gjuhëve është historia e popujve që i flasin a i kanë folur.

Në gusht të këtij viti, shkencat albanologjike dhe kultura kombëtare shqiptare në përgjithësi, pësuan një humbje të madhe. Lajmi i hidhur për vdekjen e profesor Eqrem Çabejt i tronditi thellë jo vetëm bashkëpunëtorët dhe miqtë e tij të shumtë, po edhe punonjësit e tjerë shkencorë, pedagogët, studentët, nxënësit dhe mbarë popullin shqiptar

Vdekja e këtij biri të shtrenjtë të kombit tonë u prit me pikëllim të madh edhe në Kosovë, si në të gjitha trevat shqiptare, Shumë punonjës të shkencës e të arsimit, studentë e të tjerë, e kanë pasur fatin e bardhë t'ia lexojnë e t'ia studiojnë veprën, po edhe të njihen personalisht me profesorin e nderuar, i cili vinte në mesin tonë që të përgatiste studentë për punë shkencore në fushën e studimeve albanologjike.

Po pikërisht në çastet më të vështira, kur u desh ta pranojë faktin e hidhur se pro. Qabej nuk jetonte më dhe kurrë më nuk do të vinte mes nesh, mendja na ka shkuar te vepra e tij madhore, e cila përbën kulmin e mbërrimeve shkencore në fushën e albanologjisë, i kapërcen kufijtë e dijes kombëtare dhe hyn në radhën e monumenteve të shkëlqyera të gjuhësisë ballkanike dhe indoevropiane në përgjithësi. Dhe pikëllimi ia ka lëshuar në ato çaste vendin mburrjes.

Eqrem Qabej u lind në Gjirokastër, më gusht të vitit 1908. Mësimet e para i mori në vendlindje, kurse shkollimin e mesëm dhe studimet e larta i vazhdoi në Austri. Në Grac e në Vjenë ai i dëgjoi ligjëratat e Paul Kreçmerit dhe të Norbert Joklit, dy nga gjuhëtarët më të shquar të asaj kohe. Së andejmi, i pajisur me dije të madhe, prof. Qabej u kthye në Atdhe. Në Shqipërinë feudalo-borgjeze, që përjetonte çaste të vështira mjerimi e prapambeturie nën këmbën e mbretit satrap zogollian, ai u strehua në vatrat e atëhershme të arsimit shqiptar – në Shkodër dhe Gjirokastër. Këtu ia filloi me zell të madh punës së tij shkencore, e cila do të vijë duke u rritur për një gjysmë shekulli rresht.

Në Shqipërinë e posaçliruar prof. Qabej e filloi punën në institutin pedagogjik dyvjeçar, ku përgatiti kuadro për nevojat e arsimit kombëtar. Një kohë të gjatë punoi në Institutin e Shkencave, e në 1957 në Universitetin e Tiranës. Disa vjet rresht dha kontribute të çmueshme në Institutin e Gjuhësisë dhe të Historisë. Kur Partia e Punës vendosi të themelohej Akademia e Shkencave dhe kështu të realizohej ideja e kahmotshme e Samiut, prof. Qabej u zgjodh anëtar i rregullt i saj. Ndërkaq, instituti më i lartë shkencor i vendit e zgjodhi anëtar të Presidiumit. Për rezultatet e jashtëzakonshme në fushën e shkencave albanologjike dhe për kontributin e çmueshëm në fushën e arsimit

kombëtar para e pas çlirimit, presidiumi i Kuvendit Popullor i RPS të Shqipërisë i dha prof. Qabejt titullin e lartë Mësues i Popullit.

Ky burrë i shtrenjtë i dijes shqiptare tërë jetën ia kushtoi shkencës dhe kulturës kombëtare dhe na la trashëgim një vepër monumentale me karakter enciklopedik. Përveç shkrimeve me interes për kritikën letrare, për historinë e letërsisë, folklorin, etnografinë, historinë etj. Eçrem Qabej trajtoi e zgjidhi çështje nga më të rëndësishmet në të gjitha fushat e gjuhësisë; ortografi e fonetikë, filologji e gramatikë, dialektologji e fjalëformim, leksikografi e leksikologji, onomastikë e etimologji, sidomos në historinë e gjuhës. Për t'u marrë me probleme kaq të larmishme e kaq të ndërlikuara, i dha dorë përgatitja e jashtëzakonshme teorike në fushën e gjuhësisë dhe njohja me themel e shqipes dhe e një morie gjuhësh të tjera indoevropiane.

Vetëm përshkrimi, qoftë edhe në vijat më të përgjithshme, i veprimtarisë së tij shkencore, kërkon faqe të tëra dhe paraqet vështirësi jo të vogla. Përveç punimit me titull "Studime italo-shqiptare", të cilin e shkroi gjermanisht e mbrojti për disertacion doktorate në 1933 para Paul Kreçmerit dhe Norbert Joklit në fazën e parë të krijimtarisë (periudhën gjysmëshekullore të veprimtarisë së E.Q, studiuesit e ndajnë në dy faza: e para në vitet 1929-1945 dhe e dyta 1945-1980) dijetari ynë botoi ndër të tjera edhe këto vepra e studime "Doke e zakone e adete të shqiptarëve" (gjermanisht), "Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe", "Marrëdhëniet e rumanishtes dhe shqipes", "Për gjenezën e literaturës shqipe", "Kulti dhe vijimi i hyjneshës Diana në Ballkan", "Greqishtja e re dhe shqipja", "Atlasi gjuhësor shqiptar" si dhe një varg artikujsh për probleme të ndryshme të letërsisë gojore dhe të shkruar (Bibliografi e veprave të prof. E. Qabejt, Studime gjuhësore V. Prishtinë). Kështu ai ngriti dhe trajtoi probleme jo vetëm gjuhësore por edhe asosh historiko-letrare e etnografike. Që më 1936, me veprën" Elemente të gjuhësisë" , Qabej filloi t'i dalë zot tezës se shqipja e ka prejardhjen nga ilirishtja dhe këtë tezë, me punë të pareshtur gjatë disa dhjetëvjetëshave, ai e përforcoi vazhdimisht, duke sjellë në dobi të saj argumente shkencore të pakundërshtueshme. Pikërisht profesorit tonë të nderuar duhet t'ia dimë për nder provën se populli ynë përbën një njësi etnike dhe kulturore historike në trevat e banuara sot prej tij, provë që, sikundër të gjitha rezultatet e tjera shkencore të Qabejt, nxirret prej burimesh të shumta shkencore dhe mbështetet fortë pas përgatitjes së jashtëzakonshme shkencore të autorit.

Origjinës së shqipes dhe problemit të autoktonisë së popullit tonë në viset e banuara sot prej tij, dijetari ynë u kushtoi kujdes të veçantë. Duke trajtuar këto dy çështje kapitale, të cilat – siç thoshte edhe vetë prof. Qabej – për ne shqiptarët, përveç interesit shkencor, kanë edhe rëndësi të madhe nacionale, ai dëshmoi se ishte atdhetar i rrallë. Por, duke përfillur në mënyrë të pashembullt ndershmërinë e domosdoshme për një shkencëtar të vërtetë, Eçrem Qabej kurrë nuk i lejoi vetes të rrëmbehet nga emocioni patriotik aq sa ta cënojë sado pak të vërtetën shkencore në dobi të historisë sonë, siç kanë vepruar shumë dijetarë në dëm të popullit tonë. Duke punuar me dekada në këtë fushë prof. Qabej konstatoi se populli shqiptar është autokton në viset ku jeton në ditët e sotme – që nga koha e lashtë greko-romake – dhe se shqipja është bija e ilirishtes.

Profesor E. Qabej e përtrollisi tezën se shqiptarët gjoja qenkan të ardhur në viset e tyre të sotme (madje në një kohë të vonë, për mendimin e ndonjë shkencëtari si Vajgandi) dhe vërtetoi shkencërisht se territori i sotëm shqiptar jo vetëm që nuk paraqet zgjerim të trojeve shqiptare po, përkundrazi, tokat e shqiptarëve vazhdimisht vetëm janë ngushtuar deri në minimizim gjatë shekujve. Kështu, me nëntekstin e fuqishëm të veprës së vet, prof. Eçrem Qabej e qortoi me domethënie të thellë Evropën imperialiste, e cila në shekullin e kaluar dhe në këtë shekull ka prurë vendime kriminale ndaj një populli të

lashtë heroik, duke ia copëtuar tokën për hir të orekseve të qarqeve shoviniste të shteteve fqinjë ballkanike. Duke e transformuar në lëmin e shkencës albanologjike këtë çështje të rëndësishme të historisë sonë kombëtare, prof. E. Qabej krahas mprehtësisë së jashtëzakonshme shkencore, dëshmoi edhe ndjenjën e tij të lartë patriotike.

Dijetari ynë i madh e studioj në mënyrë të thelluar e të gjithanshme edhe monumentin më të vjetër të shqipes së shkruar –"Mesharin" e Gjon Buzukut. Duke u mbështetur në gjuhën e kësaj vepre, ai arriti t'i ndriçojë me saktësi dhe invencion të rrallë shkencor fazat më të vjetra të historisë së shqipes. Nga ana tjetër, në bazë të veçorive të gjuhës së "Mesharit", prof. Qabej arriti në përfundim se – në kulturën kombëtare shqiptare – Buzuku duhet të ketë pasur medoemos paraardhës, meqë gjuha e tij është "prodhim edhe i një zhvillimi të mëparshëm të shkrimit dhe i përpunimit nga ana e këtij shkrimtari…" Kështu ai provoi se tradita e shkrimit të shqipes është së paku për dy shekuj më e vjetër sesa është e dokumentuar në shkallë të gjerë në veprën e Buzukut. Dhe ky rezultat i punës së ndritur të E. Qabejt konsiderohet me të drejtë një nga të mbërrimet më të mëdha te ne në fushën e gjuhësisë.

Më në fund vetë puna në këtë vepër të Buzukut, të cilën edhe e transkriboi e transliteroi, duke e përgatitur kështu botimin e saj kritik, profesor Qabejn e ngriti në sferat më të larta të dijes. Në këtë mënyrë, ai i dha filologjisë shqiptare një kryevepër, me të cilën hapet epoka e re e studimeve në këtë fushë.

Eçrem Qabej, duke e krahasuar gjuhën e teksteve të vjetra me të folmet e ngulimeve shqiptare jashtë atdheut, konstatoi se ndarja dialektore e shqipes nuk ka moshë të madhe dhe se në kohën e Buzukut dallimet mes toskërishtes e gegërishtes kanë qenë më të vogla e më të pakta sesa sot. Ky përfundim ka rëndësi shumë të madhe dhe jo vetëm për dialektologjinë historike të shqipes, por edhe për vetë historinë tonë kombëtare.

Njësimi i gjuhës letrare dhe drejtshkrimi i saj, çështje shumë të rëndësishme të kulturës sonë kombëtare, ia kanë tërhequr vazhdimisht vëmendjen Qabejt. Përveç kumtesave e diskutimeve të shumta rreth këtyre çështjeve, këtë e dëshmon edhe fakti se ai qe zgjedhur vazhdimisht pas çlirimit anëtar komisionesh për hartimin e drejtshkrimit të shqipes, duke përfshirë edhe Drejtshkrimin më të ri, i cili shënon një fazë të re në kristalizimin e gjuhës sonë letrare. Kontribut të madh dhe prof. Eçrem Qabej edhe në fushën e leksikografisë sonë. Ai hartoi bashkë me shokë ose redaktoi një varg fjalorë tipash të ndryshëm, që janë botuar prej vitit 1947 e këtej. Po vepër e tij monumentale mbetet "Studime etimologjike në fushë të shqipes", në të cilën ai punoi më se tridhjetë vjet. Më mirë se kudo, te kjo vepër shihet ç'njohuri të thella kishte Qabej nga fusha e gjuhësisë indoevropiane. Duke e korrigjuar Majerin dhe një varg studiuesish të tjerë, gjuhëtari ynë provoi se shqipja, ndryshe nga mendimi i disa studiuesve, ka një fond shumë më të gjerë fjalësh indoevropiane, d.m.th autoktone. Ai vërtetoi se një shumicë fjalësh, që në shkencën e gjuhësisë më herët konsideroheshin fjalë të gurrës latine, i përkasin edhe ato fondit autokton të shqipes. Nuk është vendi të radhiten këtu gjithë problemet e shtruara dhe gjithë rezultatet e arritura me "Studime etimologjike në fushë të shqipes". Thuaja se mjafton të vihet në dukje që një vepër e llojit të tillë u mungon shumë kombeve me tradita më të gjata kulturore. Dhe prandaj mund të thuhet pa ngurrim se "Studime etimologjike në fushë të shqipes" është një kryevepër jo vetëm në fushën e shkencave albanologjike por edhe një monument i rrallë në lëmin e gjuhësisë indoevropiane përgjithësisht.

Rezultatet shkencore nga rrafshet e gjuhësisë, profesor Qabej i kumtoi, përveçse në Universitetin Shtetëror në Tiranë, në atë të Prishtinës a në ndonjë universitet tjetër të Evropës – edhe në shumë kongrese të shkallës ndërkombëtare. Punimet e tij janë botuar

në një varg publikimesh shkencore të vendit dhe të botës së jashtme dhe ato janë përkthyer e janë aprovuar nga gjuhëtarë eminentë të mjediseve të ndryshme të Evropës.

Vdekja e prof. Eçrem Qabejt na la pa njërën nga kokat më të ndritura dhe figurat më të mëdha të shkencës sonë kombëtare. Dhe ne mbesim të pikëlluar për mungesën e tij. Por, përjetë do të përulemi me nderime e dashuri para trashëgimisë kolosale kulturore që na la ky vigan i dijes dhe para kujtimit të personalitetit të tij të ndritur. (Lajmëtari, tetor 1980, faqe 7-8)

36. V. I. LENIN
Situata revolucionare

Për marksistin s'ka dyshim se revolucioni është i pamundshëm pa situatën revolucionare, por jo çdo situatë revolucionare mund të çojë në revolucion. Cilat janë, në përgjithësi, shenjat e situatës revolucionare? Ne me siguri nuk do të gabohemi po të tregojmë këto tri shenja kryesore:

1) Pamundësia për klasat sunduese që ta ruajnë të pandryshuar sundimin e vet; një krizë ose një tjetër në "shtresat e larta", krizë e politikës së klasës sunduese që krijon një të çarë, nga e cila depërton pakënaqësia dhe zemërimi i klasave të shtypura. Për shpërthimin e revolucionit zakonisht nuk mjafton që "shtresat e ulëta të mos duan", por duhet gjithashtu që "shtresat e larta të mos kenë më mundësi" të rrojnë si më parë.

2) Acarimi përtej acarimit të zakonshëm, i varfërisë dhe i mjerimeve të klasave të shtypura.

3) Shtimi i madh, për shkak të arsyeve të mësipërme, i aktivitetit të masave, të cilat në kohë "paqeje" lejojnë që t'i grabisin me qetësi, por të cilat në kohë stuhie tërhiqen si nga gjithë atmosfera e krizës, ashtu edhe nga vetë "shtresat e larta", në veprime historike të pavarura.

Pa këto ndryshime objektive, që nuk mvaren jo vetëm nga vullneti i grupeve dhe i partive të veçanta, por as i klasave të veçanta, revolucioni – sipas rregullit të përgjithshëm – është i pamundshëm. Të gjitha këto ndryshime objektive së bashku quhen pikërisht situatë revolucionare. Një situatë e tillë ka ekzistuar më 1905 në Rusi dhe në të gjitha periudhat e revolucioneve në Perëndim, por ajo ka ekzistuar gjithashtu edhe në vjetër 1860-1870 në Gjermani, në vjetët 1850-1861, 1879-1880 në Rusi, megjithëse në këto raste nuk ka pasur revolucione. Pse? Sepse revolucioni nuk lind nga çdo situatë revolucionare, por lind vetëm nga një situatë e tillë kur ndryshimeve objektive, që përmendëm më sipër, u shtohet edhe ndryshimi subjektiv, pikërisht: aftësia e klasës revolucionare për veprime revolucionare në masë, aq të forta, saqë ta thyejnë (ose ta lodhin) qeverinë e vjetër, e cila kurrë, as në kohë krize, nuk do të "bjerë", po të mos e "përmbysin". (DËSHTIMI I INTERNACIONALES II) (Lajmëtari, tetor 1980, faqe 8)

37. MASHTRIM I MADH I RAMZESIANËVE TË VEGJËL

Në vitin 1296 para e.r. kremtoi faraoni egjiptian Ramzesi II fitoren mbi hititët dhe urdhëroi që beteja, e cila gjoja i paskësh sjellë nam atij, të përjetësohej me epe dhe monumente madhështore. Duke çarë rrugë me mburrje mes shekujsh e mijëvjeçarësh, kjo “fitore” përjetoi një moshë të thellë 3000 vjeçare. Po pastaj papandehur, në trajtë providence të mallkuar, në fillim të shekullit tonë u zbulua një marrëveshje modeste e

privuar nga çfarëdo nami “Mbi paqen dhe miqësinë e përjetshme të hititëve me egjiptianët”, marrëveshje e bërë menjëherë pas betejës së përmendur, nga e cila del se ajo betejë paskësh qenë, në realitet, disfata më e turpshme e Ramzesit të Dytë!

Kështu shekulli ynë XX i paskrupullt, në zhvillimin e vet blasfemoi shenjtërinë e fjetur të lashtësisë egjiptiane , duke i rrëmbyer asaj nga prehri një “fitore” të madhe. Po humbja, për egjiptianët dhe për njerëzimin në përgjithësi, mbase nuk është aq e madhe, meqë ky zhvillim na pasuroi me një kryevepër të falsifikimit të historisë.

Para së gjithash do të kish qenë larg çdo rezoni sikur shekulli ynë i dëshirit nga zbulimi që bëri të mos nxirrte për vete ndonjë leverdi. Dhe sot gjithçka të bën të mendosh se, në përgjithësi, falsifikimi i historisë është jo vetëm i mundshëm po edhe jashtëzakonisht i dobishëm, edhe nëse epoka jonë është e atillë që fshehtësia të mos mund të ruhet as tri ditë.

Është fat i madh që te rasti ynë konkret kryevepra miniaturale e falsifikimit të historisë mban vetëm disa dekada. Jugosllavia, kjo kreaturë politike e denjë për asgjë, mbi kurrizin e të cilës kryqëzohen të gjitha rrymat e mundshme politike dhe gjithfarë sferash të interesit, sot u shfry përfundimisht si një ballon i lirë. Edhe “jugosllavi” më kokëshkretë, edhe koka më e fjetur politike e ka të qartë se “jugosllavizmi” po mbahet gjallë vetëm në këtë koncept artificial, kurse vetë aparati shtetëror duhet t’ia dijë për nder inercionit, i cili këtë vend po e shpie dalëngadalë po fare sigurt te pika përfundimtare e ndalimit.

Po mbajte vesh pak më me kujdes, në Beograd, Kralevë, Titograd, Shkup… do të dëgjosh fragmente gjëmësh për Kosovën, e cila po i përballon heroikisht serbizmit dhe po kërcënohet me shkëputje dhe bashkim me vendin e vet amë, Shqipërinë. Do të dëgjosh Desanka Maksimoviçin, këtë perëndeshë-marionetë të konsumuar, tek qan me ngashërim “pse nëna serbe nuk po lind më 9 jugoviqë” që do ta serbizonin Kosovën. Klithja e saj e prridhur u ngjitet si bisht mendimeve “shkencore” të historianëve Cvijiq e Qubriloviq dhe atyre letraro-historikë të shkrimtarëve J. Duçiq, I. Andriq, I. Laliq, D. Qosiq… që hoqën të zitë e ullirit për ta argumentuar “serbizmin” e Kosovës dhe për të gjetur mjete efikase për çkombëtarizimin e shqiptarëve dhe për gjenocidin e ushtruar me këmbëngulje përmbi ta. Gjithë këto klithje nga errësira, nga paqenësia, lidhen së bashku me metodat e pashembullta të terrorizmit e të shfarosjes së shqiptarëve nga ana e Rankoviqit me përbindësh të ngjashëm në krye me xhelatin nga Kroacia- Titon, nga i cili as që ke mundur të presësh gjë tjetër, kur dihet se ai, që në fillim të ngjitjes së tij politike në gji të partisë e të shtetit jugosllav, ia ktheu shpinën popullit të vet kroat dhe nisi ta shpartallojë atë si disa që e ha gjellën e vet.

M’anë tjetër Koshava e Beogradit , e cila kurrë s’ka pasur lidhje me Prishtinën, tash po i kapërcen mundësitë e veta hapësinore dhe po i fryn në Prishtinë një ninulle të ëmbël për ta vënë në gjumë qeverinë e këtushme “shqiptare”, e cila, sipas urdhrit të Beogradit, duhet ta qetësojë situatën sikur jemi në parajsën e kësaj bote jallane, kurse kriza nacionale, shoqërore dhe ekonomike, sidomos kriza politike, janë vetëm fjalë të thata. Me një lëvizje të vetme, d.m.th. me një fjalim të Mahmut Bakallit, që për pesë para ia lëshoi në dorë serbizmit fatin e popullit të vet të shumëvuajtur, numri prej më se 2000 të burgosurish politikë zbriti në 50 sish, kurse luftëtarët e lëvizjes çlirimtare u bënë informbyroistë, ish të burgosur e çmos tjetër? Që skena e tillë të bëhet edhe më makbethiane, Bakalli nis edhe të krekoset sikur gjoja i kërcënohet “Politikës” së Beogradit pse kjo “boton fjalë nga çarshia”, me të cilat “do të shërbehet armiku i brendshëm dhe i jashtëm”! Kjo lojë në “makro” relacione Beograd-Prishtinë Prishtinë – Beograd, bie në kohë të duhur. Në sytë e fshatarësisë dhe të punëtorisë shqiptare, lufta e pararojës shqiptare të rezistencës kundër hegjemonizmit dhe shovinizmit serbomadh

duhej të paraqitej si pavor diuurmius i disa individëve të papjekur, të cilëve u ka mbetur në fyt buka e bardhë titiste dhe prandaj kërkojnë pogaçe! Si do të nxirreshin ndryshe me dhunë nga populli ynë i robëruar (që, si thotë poeti, është afër sofrës po i pangrënë dhe afër dijes po i panxënë) deklarata sesi gjoja vetë populli e gjykon pikërisht brezin e vet që ndodhet në ballë të luftës?! Kështu loja kapërcen në "mikro"-ambient, në gji të popullit. Dhe kjo paraqet një maskim mjeshtëror të qëllimit të vërtetë: nga lartësitë, papazjahninë e krijuar hudhe atje poshtë, në "radhët" e ulëta, atje le t'i thyejnë dhëmbët me të. Pa çka që çdo gjë ka filluar lart, që nga qepët e grira imë-imë, prej të cilave duket sikur perëndesha marionetë Maksimoviq lahet në lotë serbizmi, që nga llojet e shumta të mishit (të gjallë) të konsumuar me bollëk, prej të cilit gogësijnë Rankoviqi e Titua me kompani, e deri te salca e kripur dhe e mëlmuar mirë me dokrrat e "Politikës" , "Borbës", NIN"-it, "Rilindjes" etc. Kemi mbetur pa i marrë vesh vetëm edhe disa "vogëlsira": a i përkisnin ato 2000 (pardon vetëm 50!) të burgosur shqiptarë rinisë shkollore – sipas një pale, rinisë universitare në krye me profesorët – sipas palës tjetër, apo ishin fshatarë kopukë, bjerrakohës – sipas palës së tretë (të mjeteve "socialiste" të informimit në Jugosllavi)?! Mos kanë qenë prej të të gjithë këtyre nga pak? Por kështu do të kishim një spektër të tërë strukturash shoqërore! Me një spektër të tillë mund të fillojë dhe ka filluar, vetë revolucioni. 2000 të burgosur politikë nga gjiri i popullsisë shqiptare dymilionëshe (në Jugosllavi), nuk është numër modest. Po ti shtojmë kësaj edhe llojllojshmërinë e strukturave shoqërore, të cilave u përkasin të burgosurit, rreziku bëhet fare i qartë. Prandaj – krasit! Kush thotë se janë 2000 të burgosur?! Shumë-shumë 50, ju lutem? Bile, edhe ata nga radhët e fshatarësisë. Ose nga radhët e shkollarëve të mesëm, sepse në fakultete nuk kanë mundur të depërtojnë!(Sic!) Ose, rini universitare Dhe kurrsesi prej të gjithëve! Është tepër, vëllaçko! Këtë gjë e dinë mirë mjeshtërit jugosllavë të papazjahnisë. Prandaj do të donin t'i ndajnë në elemente të panjësueshme pjesët e të pandashmes.

Kështu u dha urdhri i parë: Burgos! I dyti: shkruaj! I treti: Shlyej dhe prapë shkruaj! Mbi të gjitha – krasit, në të majtë e në të djathtë!

Si mundën zotërinjtë udbashë, Rankoviqët, Bakalliqët, Hoxhiqët&Co, të harrojnë se me krasitje vetëm sa shpejtohet rritja, madje rrita e mbarë, e nëse më në fund puna është për madërgonë (sipas ekuacioneve jugosllave, bar i keq, jemi ne, shqiptarët), prej gjithë kësaj nuk del kurrfarë leverdie, sepse madërgona shkulet aq vështirë dhe gjithmonë tepron diçka prej saj.

Provuan ta shkulnin popullin tonë, para serbëve, malazezve e maqedonasve edhe pushtuesit e mëdhenj romakë, bizantinë, turq. Provuan dhe mbaruan vetë, kurse populli i vogël shqiptar mbeti "madërgonë", që po u bën ballë stuhive e thatësisë.

Nuk është aq e vështirë të merret me mend se ky popull do t'i përballojë në mënyrë të ngjashme edhe Koshavës së Beogradit.

Por, kësisoji, rrëfimi ynë zuri të marrë tone të pezmatuara. E qëllimi ynë nuk ishte i tillë. Se në fillim e kishim fjalën… fjalën e ëmbël të "vëllazërim-bashkimit" dhe të "barazisë", që duhej të zëvendësonin vullnetin e ndrydhur të popullit shqiptar për të jetuar në kuadër të shtetit të vet nacional, Shqipërisë, dhe të maskonin kolonizimin e tokës shqiptare, e kishim fjalën e ëmbël, që duhej ti ngushëllonte hungarezët, të cilët në kuadër të Jugosllavisë e kanë fatin e njëjtë me shqiptarët, t'i ngushëllonte kroatët që gjakojnë aq shumë për shtetit e pavarur kroat të popullit të bashkuar kroat!

Vlen të ndjekim me kujdes edhe sa mund të qëndrojë kjo papazjahni, kjo turli-tavë e jugo-razmesianëve të vegjël. Personalisht mendoj se të gjitha "epet" dhe të gjitha monumentet "madhështore" të federatës jugosllave do të shemben. Për të gjallë të brezit tim dhe për kënaqësinë e madhe të... (Lajmëtari, tetor 1980, f. 10)

38. Aferë hashashi në Istri

KANË "HARRUAR" TE NA INFORMOJNË PËR QENDRAT E BIXHOZIT NË BUDVË, OPATI E GJETKË

Shtypi jugosllav na njoftonte kohë më parë se në Istri qenkan zbuluar plantacione hashashi, gjoja pronë ilegale shtetasish të huaj. Edhe më herët kemi pasur rast të lexonim informata mbi sukseset e organeve të sigurimit në "luftë" me kontrabandistët që merren me shitjen dhe me transportimin e narkotikëve të rrezikshëm në territorin jugosllav. Madje edhe "suksesin" e fundit me këtë fatkeqësi bashkëkohëse, shtypi i këtushëm e trumbetoi si fitore mbi një sherr që as ka mbirë as ka lëshuar shtat në Jugosllavi.

Në Jugosllavi, siç e dimë pronësia e çdo ngastre të tokës brenda kufirit shtetëror, është nën kontroll administrativ rigoroz. (Se në ç'shkallë ka arritur tatimi, e di mirë çdo shqiptar që ka një copë tokë!) Prandaj është absurd të thuhet e të mendohet se shtetasve të huaj u paska shkuar për dorësh të mbjellin ilegalisht hashash në arat e Istrisë.

Dihet qëmoti se ky nuk është rasti i parë as i fundit që Jugosllavia të pranojë investime legale të perëndimit në truallin e saj, edhe të degjenerimit, pra, që vjen bashkë me to. Edhe sikur ta kuptonim (për çështje leverdie materiale) ndërtimin e "Fiat"-it italian të pagëzuar "Zastava" në Kragujevc, të "Citroën"-it francez në Kopër, të "Peugeot"-it në Prishtinë etj., nuk mund të kuptohet se si bën që shteti jugosllav të merret edhe me kultivimin e narkotikëve fitimprurës edhe në mënyrë ilegale, pa marrë parasysh sa të dëmshëm janë ata për shëndetin e popullsisë, veçmas të rinisë.

Në një kohë kur kriza ekonomike po e dërmon shtetin e sotëm jugosllav dhe kur ai po orvatet me të gjitha mënyrat, mjetet dhe mundësitë për t'i marrë në dorë frenat e qeverisjes (qoftë edhe duke kërkuar lëmoshë në lindje e në perëndim), sepse po i kanoset rreziku nga përmbysja e madhe, duhet të jemi të vetëdijshëm se, sa më e vështirë të jetë përgjithësisht gjendja, aq më i trullosur është edhe aparati shtetëror dhe se një pushtet si ky nuk ngurron as nga metodat më çnjerëzore, vetëm e vetëm për ta mbajtur veten.

Prandaj ai ka lejuar dhe ka nxitur që në sipërfaqe të caktuara toke të mbillet hashash, qoftë nga pronarë të huaj (aq më keq), qoftë nga të vendit.

Ndërkaq për qendrat e bixhozit "harron" të na informojë shtypi jugosllav. Po të mos ishte kjo "harresë" shpëtimtare, opinioni do të njoftohej edhe për qendra bixhozgjinjsh në Opati, Budvë etj. thuaja identike me ato në Las Vegas e në Monako, ku princër pa portofolë bëjnë qarkullime me miliarda dollarë dhe matrapazllëqe me gjithfarë narkotikësh. (Lajmëtari, tetor 1980, f.10)

39. PASHIQI – HOTI (paralele)

Pas burgosjeve të vjeme masive pat marrë dimër i fortë dhe kudo sundonte një atmosferë e tendosur. Populli, i prekur thellë në sedër pse po ia burgosnin bijat dhe bijtë e tij të shtrenjtë, me një heshtje të rëndë tuç po i tregonte pushtetit jugosllav se është fare i distancuar dhe se do t'ia shpërblejë një për një këto tortura posa t'i vijë dita. Edhe pushteti, nga ana e vet, tregoi qartë se është në gjendje të bëjë çmos, në qoftë nevoja edhe të kalojë përmbi kufomë, për ta ruajtur gjendjen ekzistuese. Nëpër ndërmarrje e shkolla, nëpër ente e kudo bënin rojë ditë e net agjentët e UDB-së dhe qytetarët e detyruar me

dhunë. Ata ruanin objektet shoqërore dhe njëherit mbanin nën kontroll shtëpitë e të burgosurve, për ta bërë izolimin total të familjeve të tyre nga rrethi.

Megjithatë, përkundër masave të tilla, rinia jonë përparimtare gjeti shteg për të shpërthyer disa aksione në shumë pika të trojeve shqiptare, madje pikërisht atje ku masat e pushtetit ishin përqendruar aq shumë. Bie fjala, në fshatrat në afërsi të Dubovikut dhe në Dubovik (katund në afërsi të Pejës, ku u burgos patrioti Hysen Gërvalla), traktet dhe afishet shpërndaheshin pa e pritur njëri tjetrin mu para hundëve të njerëzve të pushtetit.

Pak për shkak të pazotësisë e më shumë për shkak të prirjeve të veta, UDB-ja burgoste pa ndërprerë shumë të rinj të këtyre fshatrave dhe të qyteteve, edhe pasi kishte kaluar vala më e madhe e burgosjeve. I torturonte ata në mënyra të ndryshme dhe, pasi nuk e gjente dot "fajtorin" e vërtetë, (se aksionistët tanë nuk kryejnë aksione vetëm në lagjen apo në fshatin e vet), UDB-ja vuri në përdorim armën e vet të dytë të preferuar, rrenën me bisht: me gojën e bashkësive lokale dhe të aktiveve të LK, e qiti fjalën se traktet dhe afishet i paskan shpërndarë gjoja fëmijët!

Ditën që u shpall vdekja (e dytë) e kryeudbashit Tito, në Raushiq u grisën fotografitë e Titos e flamuri i urryer i okupatorit. Prapë policia u vu të kërkojë gjurmët e aksionistëve dhe prapë s'i gjeti dot. Atëherë vendosi ta përdorë armën rezervë. Kryetarin e Komitetit Komunal të LK të Pejës, renegatin Beqir Hoti, e ngarkoi që, me ndihmën e anëtarëve të LK, të shpallte në popull sesi aksionin në fjalë e kishin kryer serbët. Dhe nga aktivi i LK të Pejës, kjo rrenë mori dhenë. Tani, sa për të bërë muhabet me disa njerëz naivë nga radhët tona, po përpiqemi ta zbërthejmë këtu këtë gënjeshtër bajate.

Së pari, te ne ende nuk dihet që fëmijët të jenë marrë ndonjëherë me aksione të shpërndarjes së trakteve dhe të ngjitjes së afisheve kundër okupatorit jugosllav. Por, në qoftë se tash u morën atëherë UDB-ja, në vend që ta përhapë këtë gjë, është dashur ta kapte kokën në dorë dhe të mbytej në Bistricë. Sepse kur të vijë koha që në valën e luftës çlirimtare të kapen fëmijët qoftë të nxitur nga të rriturit, qoftë krye në vete atëherë okupatorit i ka mbetur vetëm hija.

E dyta, aktivi politik i Pejës ka në gji të vet shumë anëtarë të kombësisë serbe e malazeze. A do të lejonin ata të fajësohen pa faj serbët e malazezët, po të mos ishte fjala për një ndërmarrje dinake në fitim të tyre, pra, për një aksion që, në kuadër të një plani të përgjithshëm afatgjatë ka për qëllim t'ua zgjasë qëndrimin serbëve dhe malazezëve në vatrat tona.

Populli ynë i urtë ka pasur kohë dhe rast ta hetojë dhe ta vërtetojë një fakt të pakundërshtueshëm. Jugosllavia e vjetër kurdiste situata të ndërlikuara. Ndërsente bandat çetnike të digjnin lagje qytetesh dhe fshatra shqiptare, e në anën tjetër shpallte se ato djegie i kanë bërë shqiptarët. Pastaj organet e pushtetit gjoja ndërhynin në gjithë këtë marifet, dhe intervenimi i tyre kishte një rezultat: torturimin e shqiptarëve në mënyrat më të egra. Ashtu sot qeveria titiste e Beogradit e sheh të domosdoshme (njëherë përnjëherë) jo të flasë për aksione të shqiptarëve, se në atë mënyrë do të popullarizoheshin aksionet dhe lufta e rinisë përparimtare dhe e keqja do të merrte përmasa më të mëdha, po përkundrazi, ta fshehë çdo punë në drejtimin patriotik të shqiptarëve.

Por demagogjisë së tillë populli iu përgjegj me një aksion: për të dytën herë në Raushiq, i theu dhe i nxori në rrugë, nën rrotat e kamionit, fotografitë e xhelatit të vet dhe e bëri copë e grimë flamurin e urryer jugosllav.

Tani le të lehin në vazhdime këlyshët e Titos, Beqir Hoti e Mahmut Bakalli, të cilët (për t'u gjendur pranë vatrave të zjarrit dhe për të shtuar presionin) po bëjnë ve në Dubovik, gju më gju me tradhtarët e imtë Ramë Shala (rojë e arinjve në Grykën e Deçanit

dhe armëmbajtës i Mahmutit), Elez Shala e Ymer Shala, i pari korrier i gjyqit e i dyti delegat krahinor dhe kulak i madh në katundin e vet, Dubovik.

(Lajmëtari, tetor 1980, f. 11)

40. LUGATI NË KËNDIN E PARË TË RRUGËS

Sa vlen jeta e qytetarit në sytë e policisë fashiste Jugosllave

Alija Toskiqi, djalë 22 vjeç nga Priboji, as që do ta ketë marrë me mend sa lehtë është të t'i shëmtojnë ato pak stinë behari dhe të ta shuajnë fare jetën e njomë. Tragjikën e beftë të kësaj mundësie, që të kërcënohet në çdo kënd të rrugës ai e kuptoi vonë: kur po vdiste për gazep në grushtat, shkelmat dhe kërbaçët e tre policëve. Në pikë të ditës!

Tragjika e Alija Toskiqit në krahasim me fatin e shumë qytetarëve të tjerë që e kanë pësuar njësoj ose edhe më keq se ai, ka megjithatë një satisfaksion të vockël. Krimi i policëve mbi këtë jetë të njomë u shqyrtua në forume të larta dhe bëri njëfarë buje edhe në shtypin revizionist jugosllav.

Dolën në shesh edhe disa krime të tjera të policisë mbi qytetarët e pafajshëm. Në Beograd, policët rrahën dhe maltretuan keq gazetarin Bozho Filipoviq dhe një shofer, i cili kishte bërë një delikt të vogël komunikacioni. Dritën e shtypit e panë edhe katër vrasje të qytetarëve nga dora e policisë. Polici Bozho Filipoviq e vret Milenko Shliviqin. Polici Vasa Ekimoviq, duke u përleshur me qytetarin Zhivko Strashiçiq, e vret pahiri një shokun e vet pastaj i egërsuar kthehet e ia jep tetë plumba edhe Strashiçiqit, duke e lënë të vdekur në vend. Në Istog, polici Milan Petroviq e vrau djaloshin Muhamet Halili, pse po gjuante pa leje peshk në lumin e Istogut! (Le të na kujtohet se kjo vrasje ndodhi pak kohë pas pushkatimit të Selim Talit, i cili qe dënuar me vdekje pse vrau një pylltar të kombësisë tjetër dhe ia mori gjakun të vëllait, po kjo vrasje u trajtua si ata mbi "vëllazërim-bashkimin" Ne ngulim këmbë se vrasja e M. Halilit nga polici s'është gjë tjetër pos një hakmarrje e egër, e organizuar nga UDB-ja e Pejës).

Ja pra cili është çmimi i vërtetë i jetës së qytetarit në sytë e milicisë "popullore".

Po a shteren me kaq burimet e informatave që të çojnë në gjurmë krimesh të shumta mizore mbi popullsinë e pafajshme?

Shtypi jugosllav shkruan: "Informatat për milicët që e kanë shkelur ligjin ishin të varfra e të shkurtra". Dhe i thërret lexuesit, domethënë, qytetarët e rrezikuar nga policia, që të mos e humbin besimin: "Secili qytetar duhet ta ketë ndjenjën se milicia ia mbron të drejtat, e jo se ia cënon ato?!

Informatat, vërtet, qenë të varfra e të shkurtra. Jo për shkak të mungesës së krimeve, po për arsye të tjera, praktike. Gryka e hinkës nëpër të cilën duhet të rrjedhin ato informata, është ngushtuar, deri në një minimum qesharak, sa të lëshojë në opinion vetëm disa ngjarje të pakta kriminalistike, që kanë të bëjnë me një periudhë të shkurtër kohore. Nëpër këtë hinkë nuk kanë pasur si të rrjedhin krimet e kryera pak më herët. Policia e sotme, natyrisht, në shtyp trajtohet sikur nuk ka lidhje me policinë e hershme, me traditë të madhe krimesh mbi qytetarët e pafajshëm. Kështu ka porositur qeveria e Beogradit në mënyrë që shtetasve t'u hedhet edhe një herë pluhur syve.

Por, duket se policia gjithmonë mbron interesat e klasës në sundim. Policia pasqyron mirë frikën e pushtetit nga shtetasit dhe kujdesin që ka shteti ndaj shtetasve të vet.

Që nga viti 1945, qyshkur sundon në Jugosllavi klika titiste, policia jugosllave s'ka bërë gjë tjetër veçse ka mbrojtur me një lojalitet të jashtëzakonshëm interesat e kësaj klike. Me një egërsi, që ia kalon asaj të xhandarmërisë ish-jugosllave, policia e Titos dhe

asnjë tjetër ka zbatuar me dorën e fortë gjithë ligësitë që qeveria i ka caktuar me programe shtetërore. Klasikës së dhunës e të terrorit policor ish-jugosllav i është shtuar dhuna dhe terrori i perfeksionuar i policisë titiste, ndjekja e shqiptarëve dhe muslimanëve në Turqi, kurdisja e situatave praktike që policisë i kanë shërbyer për ta vënë nën dajak popullsinë e pafajshme shqiptare, mirëmbajtja e kampeve famëkeqe të përqëndrimit në Nish, Goli Otok, Pozharevc, Beograd, Lepogllavë, Idrizovë, etj., i ashtuquajturi aksion i armëve në Kosovë, që ishte pretekst për vënien kolektive të shqiptarëve nën tortura të papara…

Lëre pastaj që çdo shqiptar i moshës madhore ka për të treguar ndonjë rast që policia t'ia ketë "mbrojtur" të drejtat qytetare duke e kërcënuar, duke e rrahur dhe duke e poshtëruar deri në palcë, duke ia sharë madje edhe nënën e kombit.

Po fëmijët vallë, a kanë se çdo të rrëfejnë ata?

Në shumë lojna të fëmijëve polici është personazhi më i tmerrshëm. Polici, në imagjinatën dhe në përditshmërinë e tyre, i ka zëvendësuar shtrigat e përrallave dhe lugetërit e errësirës. Por, me një ndryshim në dobi të policisë. Ndërsa shtrigat dhe lugetërit kurrë nuk kanë dalë realisht nga paqenësia e tyre, policin jugosllav e ke në çdo kënd të rrugës; me kërbaç në dorë e revole në këllëf dhe, mbi të gjitha, me gatishmërinë e tij të tmerrshme që të ta marrë shpirtin kur t'i teket. (Lajmëtari, tetor 1980, f. 11)

41. KOPILI I EPOSIT

Mbi ballin e ulët i përvidhet një shkëlqim tinëzar. Nga buzëqeshja e tij e thartë po e pakursyer: me gojën hapekrah dhe me ata dy dhëmbët e sermët, të kap tmerri. E ke takuar rrëzë gardheve të botës: me këpucë të rripta, me rrobat e bardha të ngushta, me një palë flokë të zeza të mëlmuara me vaj ulliri dhe me sharki në dorë. Disi çuditshëm të ka dalë nga kuadri i peizazhit: kot je përpjekur të gjejsh diçka të përbashkët mes tij e kasolleve përreth, mes tij e rrugës së përbaltur, barit të vesuar erëmirë dhe rehatisë amullore, në gji të së cilës sikur përpëlitet një vorbull shqetësimesh të mëdha.

Është Bali Katravella. "Rapsodi" dukagjinas!

Sa herë je takuar me të, ke pasur përshtypjen se i ke dalë në prag në ndonjë punë të nisur, për të cilën ai nxitohet vazhdimisht. Që të tregoj se cila është ajo punë e tij, kjo nuk ndodh, edhe në plassh. Ai t'i tregon dhëmbët, por t'i fshehë këmbët. Vetëm këpuca e tij e rripët i di shtigjet e tij plot muzg. Kurrë s'ta ka shkelur pragun e derës, por ai e di më mirë se ti se sa grushta miell të kanë mbetur në magje!

Thonë se vaktile ka qenë mësues. Sot, nga zemani i mësuesisë i ka mbetur një shenjë emblemë e një ndriçimi të perënduar: lapsi në xhepin e majtë të xhaketës. Dhe - kravata.

Ndërkaq, thirrja e brendshme "artistike", siç duan të thonë "gojëkëqijtë", i paska ardhur disi papritmas, një natë dimri.

Përjashta borë, përjashta cegmë. Brenda bubullinë stufa prej llamarine, e ngarkuar me dru çarri. Nxehtësia, që lëshon ajo, e përzier me vlagën e odës, me kundërmimin e rëndë nga djersët e valltarëve të shfrenuar para defit të magjupes, ta zë frymën. Përjashta ulërima ujqish. Dhe suferinë. Ndonjë klithmë e mbytur e burrit, i cili në këmishë e të linjta rri lidhur për drurin e pemës, në borë gjithë natën e gjatë.

Ata pak burra që i kanë shpëtuar për ndonjë natë dorës së zezë të UDB-së, tashmë kanë ikur nga oda dhe janë shpërndarë nëpër koniqe. Prapa tyre ka mbetur hija e urtisë dhe e dufit të urrejtjes për... kohën. Në odë ka mbetur Bali Katravella e ca katravellë të tjerë. Dhe defatorja me çamparet dhe me zërin e saj të çjerrë. Dhe aty ku, disa orë janë rrahur hallet e njerëzve nga më të hequrit në këtë botë, tash defatorja nxjerrë goje gjithë

ndytësitë e xhambazëve dhe i mëlmon ato me shikime yshtëse e me të dredhura prej gjarpërushe të kërdhokullave.

Balisë i shkon lëng për goje. Do të donte t'i qasej defatores pranë-pranë. Ah, kofshët e saj! Po ajo ende i takon një bote të largët e si të huaj për mundësitë e tij. Dhe tundimi i tij bëhet gjithnjë më i madh. Ai duhet të bëjë doemos diçka, diçka që do t'i jepte shkas të qëndrojë sa më shpesh pranë asaj "bukurie".

Për fillim, ai e merr defin e saj dhe sillet nëpër odë duke mbledhur paratë e imta që hedhin në def valltarët. Pastaj, përsëri në natë shtrihet kënga e shëmtuar e defatores. Nga zëri i shthurur dhe nga kofshët e saj të vala, aq më të ngrohta sa më të largëta për Balinë, atij i ngjizet papritmas në mullë një thirrje e fuqishme së brendi: "Duhet të bëhesh këngëtar!"

Ideal madhështor mbi krahët e një frymëzimi edhe më madhështor! Po "gojëkëqinjt" duan t'ia mohojnë edhe këtë frymëzim të shkretit Bali. Flitet se idenë për t'u bërë këngëtar ia paskësh përsëritur në vesh komandiri i postkomandës në Bishtazhin. "Kështu do të mund të marrësh pjesë i papenguar në mexhliset e tyre.", i paskësh thënë ai, - "dhe të na tregosh, helbete, ç'flasin ata".

Sido që të ketë qenë, Bali Katravellën e ke atë ditë e sot këmbëkryq në dasmat e botës: ulur mbi jastëk të butë, me sharki në prehër, me raki e mishra përpara, atje ku s'pinë raki (se s'e kanë as qumështin) dhe ku s'dinë ç'është mezja; në dasmat e kursyera varfanjake të Dukagjinit.

- A s'na e merr një këngë, o Bali Katravella se, helbete, dasmë kemi!

- Boll ju shurdhova! Ju mirë e keni, ndiqeni llafin, ku e patët. Bota ka shumë halle dhe ju ia keni anën llafit, dini ta qani burrërisht.

Dhe, deshe s'deshe, burrat e vazhdojnë kuvendin. Balia hesht. Burrat flasin - shënon Balia (pa e nxjerrë lapsin nga xhepi i xhaketës!). Burrat flasin për skamje. Për njëfarë terrori, që s'po u hiqet qafe qëkur është vërë kufiri ndërmjet vëllaut me vëlla. (Kështu disi duan të thonë meselet e tyre të hedhura rrotull-rrotull.) Kënga e Balisë këndon për begati, për njëfarë rehatie parajsore. Ç'quan armik të përbetuar goja e burrave përreth, quan mik për kokë kënga e Balisë:

"Marshall Tita n'kali t'bardh'..."

ose

"Lum e lum për këtë Kosmet,
na ka ardhë Tita n'poset..."

përjarget ai.

Të nesërmen blloku i shënimeve i komandirit të postkomandës në Bishtazhin me fjalët e Balisë, që përpiqet të riprodhojnë meselet e atyre dhe me stërkalat e pështymës së tij, që i përvidhen begatshëm nëpër dhëmbët e sermët. Komandiri ia rreh krahët dhe ia shkel syrin. Tash shko, i thotë, se mua më duhet të kryej një punë por ti mos u bëj i përtueshëm, eja e gëzona edhe ndonjëherë...

Balia bishtin nën shalë e në shtëpi të vet!

A e di çka i ke ata, o Bali Katravella!

Ata i ke vëllezër të gjakut, mori farë e ndytë! Kurse komandiri i policisë t'ia ka ngrënë kokën edhe vëllait që ta ka bërë nëna. A s'ke kujt t'i këndosh pos xhelatit të farës sate?!

Këto fjalë ndoshta i meriton si për fund Balia. Por, a fajësohet koka e shkretë pranë kokës së urtë?

Mbase jo.

Dhe fjala e të diturit thotë:

"E keqja në botë nuk mbahet në krah të atyre që bëjnë keq, por në saje të atyre që e durojnë të keqen." (Lajmëtari i lirisë, numër 2, tetor-nëntor 1980, faqe 16)

42. Ka disa shqiptarë

Ka disa shqiptarë në dhe të huaj, me një jetë të dhembshur po edhe të errët. Baltën e atdheut ata e kanë ndërruar me shkëlqimin e huaj. Ata nuk e duan as shqipen e të gjithë shqiptarëve, po një gjuhë në vete – të ish bejlerëve e kriminelëve. Kanë edhe nga një gjuhë rezervë: anglishten, frengjishten. Shqipja, konsiderojnë ata, nuk meriton të jetojë amshueshëm ndër breza. Ata bëhen sikur luftojnë edhe për çlirimin e Kosovës, por gjithmonë e kanë ndër mend shembjen e Shqipërisë. Kujt duan vallë, t'ia lëshojnë në dorë peshqesh, kur t'ia marrin shqiptarit? Bosëve të tyre të Perëndimit? Si nuk e ndiejnë mallkimin e nënave e të motrave shqiptare! Por, ata s'kanë më as vesh për mallkime as për urime shqip. Për fat, në rrugën e tyre plangprishëse, ata janë vetëm. S'i ndjek dot Kosova kreshnike as shqiptari me një lugë tru në kokë. Se trojet shqiptare do të qelbeshin nga robëria e re në "botën" që do ta "krijonin" ata! (Lajmëtari, tetor 1980, faqe 16)

43. KESHTU NA "URON" UDB-ja VITIN E RI!

Si përvjet, edhe sivjet, shumë kurbetçarë u kthyen në vendlindje për t'u shlodhur nga hallet e mëdha të kurbetit dhe për t'u çmallur me njerëzit e tyre. Takimi i tyre me familjet ka për çdonjërin domethënie shumë të madhe, i ripërtërin dhe u jep forca të reja që pas disa javë pushimi, të kthehen sërish atje tek i pret puna e vështirë dhe barraka e ftohtë.

Hysen Gegaj nga Sallagrazhda e Suharekës, ishte punëtor i mirë e shumë i dashur për shokët e vet, gjithnjë i gatshëm t'i ndihmojë pa kursim të tjerët. Edhe ai, me një gëzim të madh u nis për në vendlindje, ku arriti natën e Vitit të Ri. Në shtëpi e pritnin me mallë babai i rrezbitur, nëna plakë, shoqja, vëllezërit, fëmijët e mitur. I harroi vuajtjet e përjetuara gjatë qëndrimit të tij në kurbet. Jeta po i dukej sërish e bukur. Tjetër dhe ish ky, tjetër erë binte këtu athëtima e dimrit, rruga e përbaltur dhe gjerdhet e ulëta.

Si u përshëndet me prindërit e me fëmijët, sa u çmall pakëz, Hyseni doli në fshat tek shokët e moçëm dhe ndenji me ta deri pak para mesnate.

Në shtëpi e pritnin me padurim. Druanin se do ta kalonin pa të edhe këtë Vit të Ri. E dinin se ai harrohej fare kur ishte me shokët. I tillë kish qenë qysh fëmijë, kur i ruante lopët e fshatit, për t'ia shtuar një kafshatë bukë familjes. I tillë kishte qenë edhe në kohën e rinisë së hershme, kur iu desh ta regjte shtatin e njomë me peshat e rënda të betonit e të tullave, në punishtet ndërtimore të Beogradit. Për shokë jepte gjithçka edhe tash. Veçse tash vinte pak më thatim e gjithnjë më hijerëndë. Dhe sikur kishte ca brenga të thella për moshën e tij.

Megjithatë, pak para mesnate, ai u kthye në shtëpi. Shtathedhur e hijerëndë. Mbase pak edhe në qejf. Nga pija. Por ç'ishte ajo brengë e re në rrudhat e hershme, që s'po ia kuptonin dot prindërit as e shoqja? Po burrërohet si shpejt, tha me vete, jo pa njëfarë mburrjeje të druajtur, i ati, Qazim Gegaj. Ndërsa vëllau i dytë i Hysenit, Danushi,

e shikonte me një admirim të fshehtë, sa herë që puqnin gotat apo ia krisnin këngës së festës.

Kulminacioni arriti në mëngjesin e 1 janarit. Aty nga ora tre, shtëpia e Qazim Gegajt, qe rrethuar nga një tog policësh të armatosur deri në dhëmbë. Pasi policia kishte zënë mirë e mirë pozitat, udhëheqësi i saj trokiti fuqishëm në derën e shtëpisë dhe u çor egërsisht. Ai kërkoi t'ua dorëzonin Hysenin.

Me gjasë, policisë nuk i pëlqekan njerëzit e mirë dhe të dashur. Njerëzit e tillë i quajkan me një emër absurd: "armiq të popullit"! Armiqtë e popullit të jenë vallë ata që s'i bëjnë gjë të keqe popullit, pos që mendojnë ditë e natë për hallet e tij dhe të vetat?! Armiq kishin qenë dikur gjermanët, italianët, çetnikët... Shqiptari, që dërmohet e robtohet për një kafshatë goje në rrugët e hidhura të kurbetit ky shqiptar të jetë armik i popullit shqiptar?!? Armiku i popullit shqiptar ka qenë gjithmonë dikush tjetër. Armik i popullit shqiptar është polici që çirret, sikur i ka pikur nga qielli e drejta për të burgosur njerëzit e pafajshëm, për hir të gjakpirësve të Beogradit!

- Jeni të rrethuar! Dorëzojeni Hysenin, - i bërtiti përsëri babait, dhe shoqes së Hysenit, kryepolici, duke ua vënë grykën e automatikut në gjoks.

Hyseni, në krye të shkallëve, bërtiti si i shastisur, nga tmerri që e kapi kur i pa babanë dhe gruan para grykës së armës.

- Hiqe atë hekuraqe, or fatzi, ç'ke që u bie më qafë pleqve e grave?!

- Hysen Gegaj! Në emër të popullit, jeni i arrestuar!

- Cilit popull?!? Unë jam bir i këtij plaku, bir i këtij populli dhe i kësaj toke. Për ty ka ankime e mallkime populli, jo për mua.

- Mbaje gojën, - çirrej kryepolici, kur ia lidhën duartë Hysenit. - Tash ec përpara, e kusurin do ta marrësh vesh në hetuesi...

- S'qe nevoja të më lidhni. Vij vetë.

Pa u ndarë mirë nata me ditë, Sallagrazhda u gjetë më këmbë. I zgjoi zëri i fuqishëm i loparit, argatit dhe gurbetçarit Hysen Gegaj, që ndonëse po ia shtonin goditjet me kundak, me grushte e shkelma, bërtiste me gjithë gjoksin e tij të bështëm:

- Poshtë titizmi, armiku i përbetuar i popullit shqiptar! Lavdi marksizëm-leninizmit! Poshtë klika tradhtare kosovare. Rroftë populli shqiptar, i lirë e i bashkuar! Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë në krye me prijësin e madh Enver Hoxha!

- Rroftë e qoftë, sa malet me dëborë, - iu përgjegj që nga oborri i vëllai, Danush Gegaj dhe nuk pushoi as ky, deri sa iu vunë prangat dhe deri sa u nis kampanjolla e milicisë.

Në pejzazhin e mjegullt dimëror, mbi rrugën e përbaltur dhe gjerdhet e ulëta të Sallagrazhdës mbeti vetëm zhurma e thekshme e kampanjollës së milicisë, që u nis me turr, trishtimi dhe mpirja e plakut Qazim Gegaj, i cili s'e kishte kuptuar gjysmën e fjalëve që thoshin të bijtë... Mbeti zemra e mpirë e nuses dhe vaji i fëmijëve...

- Rroftë populli shqiptar, i lirë e i bashkuar! - po të përgjigjemi edhe ne që këtej, o Hysen Gegaj dhe ty Danush, dhe atyre mijëra djemve të këtij populli, që UDB-ja po i dergj pa kursim në burgjet e fëlliqura e mizore. Dhe që këtej po jua përcjellim edhe sihariqin, se edhe populli po bëhet gati për t'jua marrë ju hakun!

Po bëhet gati populli për hakmarrjen e vet të madhe! (Lajmëtari, janar 1981, f.1)

44. Danush Gegaj

Tani mund të thuhet se është i rrallë ai fshat, ajo lagje qyteti, apo ajo shtëpi shqiptare ku UDB-a të mos ketë burgosur së paku nga një njeri, ose të mos ketë bastisur egërsisht. Me një tentim shtazarak, që i kalon edhe kufijtë e terrorit të aksionit famëkeq të armëve të vitit 1956, revizionistët jugosllavë po orvaten të zhbijnë çdo filiz të

rezistencës shqiptare ndaj shtypjes dhe shfrytëzimit të egër kapitalist e kolonialist nga ana e shovinistëve të Beogradit.

Me indinjatë të thellë i bëjmë me dije forcat tona revolucionare dhe mbarë popullin se, përveç vëllezërve Hysen dhe Danush Gegaj, kohëve të fundit u arrestuan për veprimtari "armiqësore kundër popullit e shtetit", do të thotë për veprimtari patriotike, edhe këta persona: Hasan Ukëhaxhaj, magjistër i gjuhës shqipe, profesor në gjimnazin e Deçanit, Musa Berisha nga Duboviku, student i letërsisë shqipe, momentalisht në shërbimin ushtarak në Ptuj, si dhe një milic, të cilit ende s'ia dimë emrin etj. (Lajmëtari i lirisë, nr.1, janar-shkurt 1981, faqe 1)

45. MË TË FORTË SE KURDOHERË

Pjesë nga dollia e ngritur me rastin e kremtimit të festave kombëtare shqiptare 28 e 29 Nëntorit nga një grup punëtorësh kosovarë në botën e jashtme

Vëllezër të dashur!

Gjithçka te ky dhe është e huaj për ne. Kjo sallë, sendet përreth, njerëzit, rrugët këtu, na shikojnë ftohtë. Në qoftë se ndonjëherë edhe ndodh të na hetojnë pranë, atëherë, praninë tonë e ndiejmë si praninë e një lecke të hedhur në rrugën e madhe.

Ky shekull, kjo botë, nuk deshën as të dinë se në një kënd të Ballkanit është një popull, që nuk e ka arritur, edhe sot e kësaj dite, as gjënë elementare jetike, të cilën të tjerët e gëzojnë me shekuj: lirinë e trojeve të veta, e cila është kusht i domosdoshëm për përparimin e për ndriçimin e mendjes dhe mbi të cilën mund të ngrihet godina e dashurisë së shëndoshë për vëllanë, fqiun e kështu edhe për gjithë botën.

Historia na la me gishta në gojë dhe në bisht popujsh të tjerë, që erdhën shumë vonë në trojet e stërgjyshërve tanë. E kush i ka shërbyer më mirë se ky popull historisë? Kush ia lau asaj më me rregull tatimin e gjakut e të sakrificës? Dhe kush kërkoi më pak prej saj: vetëm tërësinë e tokave tona deshëm dhe jetën në shtetin e përbashkët kombëtar, atë që gjithë të tjerët në Evropë e kishin prej motesh.

Por, në vend që të sendërtohej kjo aspiratë e drejtë, jeta na katandisi në robëri, në skamje e mjerim. Jeta na shpërndau rrugëve të kurbetit.

Një gjë nuk e arriti dot ky shekull: të na i prejë rrembat e gjakut stërgjyshor, të përtërirë brez pas brezi nga fatosat që, për vatan e troje të veta, “e kanë dekën si me le”. Dhe këta rremba gjaku na mblodhën sot këtu që të festojmë dy nga ditët më të shënueshme të historisë sonë: 28 Nëntorin 1912 – ditë kur në Vlorën heroike u ngrit flamuri me shkabën e zezë dykrenare mbi fushën e gjakut dhe u shpall Pavarësia e Shqipërisë, dhe 29 Nëntorin 1944, kur populli ynë vëlla në Shqipëri u çlirua nga prangat fashiste, mori plotësisht fatin në duart e veta dhe filloi me ndërtimin e socializmit të vërtetë.

Vëllezër!

Me djersën e krahut të shitur, pa strehë mbi kokë as për këtë natë të shënuar feste, ne u mblodhëm këtu që të shkëputemi për një çast nga hallet tona të mëdha të përditshmërisë, e t’i kthehemi historisë sonë të lavdishme dhe botës t’i përcjellim një mesazh të hidhur të çerekut të fundit të shekullit XX: Nuk ka paqe në botë, deri sa të ketë popuj e njerëz të shtypur prej popujsh e njerëzish të tjerë.!

Këtë mesazh kanë në gojë malet, fushat, lumenjtë e trojeve tona të robëruara në Kosovë, në Rrafsh të Dukagjinit, në Çamëri e Maqedoni, në Mal të Zi e në Serbi. Dhe atë do ta thonë pareshtur deri në ditën e çlirimit të plotë nga zgjedha e huaj dhe bashkimit të ligjshëm me Atdheun e lirë, Shqipërinë socialiste.

Vëllezër!

U mbushën 68 vjet nga dita kur plaku i thinjur, Ismail Qemali, i mbështetur fort në kushtet e pjekura historike, në shpatullat e fuqishme të popullit të vënë në luftë të pakursyeshme përballë armiqve të shumtë, në përkrahjen e guximshme të bijve fatosa të këtij populli, shpalli në 28 Nëntor 1912 Pavarësinë e Shqipërisë. U mbushën 68 vjet nga dita e realizimit të një pjese të aspiratave shekullore të popullit shqiptar- për krijimin e shtetit shqiptar dhe daljen e kombit shqiptar komb më vete dhe i pavarur.

Cilat qenë ato kushte historike, që dhanë dorë të shpallej Pavarësia dhe të formohej shteti i pavarur shqiptar. Ndoshta pikërisht këtu është vendi që të përpiqemi ta gjallërojmë në kujtesë atë kohë.

Kuçedra anadollake, pas një sundimi pesëshekullor në Ballkan, ngreu përpjetë thundrat, duke dhënë shenja të qarta se tash po gremisej për të mos u mëkëmbur më kurrë. Shenja më e qartë qe hyrja e Italisë në Libi, që deri më atëherë ishte një nga zotërimet e shumta të perandorisë otomane. Pos kësaj, disa dhjetëra vjet më herët, Turqinë e kishin dobësuar në masë edhe luftërat ruso-turke, kurse tash po fillonin me të madhe luftërat ballkanike. Sa më e afërt bëhej ngordhja e kuçedrës evro-aziatike, aq më shumë drejtoheshin kah trashëgimia e madhe territoriale e Turqisë sytë lakmues të fqinjëve tanë ballkanikë dhe ata të fuqive evropiane të kohës. Në kombinacionet e hapëta e të fshehta që u bënë me të madhe për ndarjen e tokave që po linte prapa Turqia, populli shqiptar jo vetëm që ngeli anash dhe i vetëm, po për më tepër pikërisht tokat e tij po bëheshin kulaçi që të tjerët mendonin ta ndanin mes vete si "trofe lufte".

Në një anë ishte Greqia, që synonte krahinat shqiptare të Jugut dhe nuk pritonte të qante me lot karshi botës për gjoja "të drejtat" që kishte ajo mbi këto krahina dhe bënte edhe marrëveshje ushtarake me shtete të tjera, si me Bullgarinë etj., për ndarjen e Shqipërisë.

Në anën tjetër ishte ëndrra sllave, me nxitje e përkrahje të fortë nga Rusia cariste, e cila mendonte se kishte ardhur dita t'ua zgjeronte oborret qesharake mbretërore vëllezërve të vegjël sllavë të jugut, kralëve të Serbisë e të Malit të Zi.

Në këto kombinime përzihej dendur edhe Bullgaria me kërkesat e saj për ringjalljen e Paqes së Shën Stefanit, e cila e kishte shpërblyer atë me disa krahina të rëndësishme thjesht shqiptare. E nuk ndjenjën anash sidomos fuqitë e mëdha të kohës si Italia e Austro-Hungaria. E para synonte të merrte nën drejtimin e plotë a të pjesshëm shtetëror pjesën më të madhe të Shqipërisë, sidomos krahinat në Vlorë e poshtë, e dyta përpiqej ta zgjeronte e ta forconte ndikimin e saj, përmes katolicizmit, në krahinat veriore të Shqipërisë.

Kur ta kemi parasysh këtë kuadër të tmerrshëm shkrumbi e tymi, na duket fare e qëlluar e pakundërshtueshme ajo thënia, sipas së cilës shqiptarët po bënin luftën e Prometheut kundër të gjithë perëndive. Dhe, siç thotë një historian shqiptar, populli ynë kurrë s'kishte qenë më afër realizimit të aspiratave shekullore, po kurrë edhe më në rrezik që fati i tij të nxihej përfundimisht, ashtu si nuk e kishin nxirë shekuj e shekuj robërie.

Po luftëtarët e lirisë, në krye me Ismail Qemalin, Isa Boletinin etj. nuk pyetën për rreziqe e viktima. Ata hetuan se ishte çasti i fundit që shqiptari i vuajtur të atdhesohej. Dhe menduan se do ta bënin popullin me atdhe të plotë, duke bashkuar në një tërësi të pandashme të gjitha tokat dhe mbarë popullin shqiptar.

Për këtë arsye, ndonëse me shpalljen e Pavarësisë mbeti pa u realizuar një nga kërkesat më vitale të aspiratave shekullore të shqiptarit, tërësia e tokave dhe e popullit – se trungu shqiptar u krasit me një padrejtësi të pa shembullt historike, duke iu këputur degë-degë më se gjysma e tokave dhe gati gjysma e popullit shqiptar, ndonëse shteti shqiptar i atëhershëm qe i brishtë, kurse qeveritë që e morën nën drejtim (pas qeverisë së

përkohshme të I. Qemalit) deri në Luftën e Dytë Botërore ishin qeveri të egra antipopullore, që vendin e gremisën në errësirë, kriminalitet e luftë të egër për pushtet, në prapambeturi e skamje nga më të mëdhatë, megjithatë, 28 Nëntori 1912 mbetet një nga datat më të shënueshme dhe më të lavdishme në historinë e shqiptarëve.

Përpjekjet e armiqve të shumta kanë dashur ta errësojnë dhe ta mohojnë fare lavdinë e atyre moteve që sollën shpalljen e Pavarësisë Shqiptare. Po mbetet fakt i pakundërshtueshëm se këtë akt madhështor e kushtëzoi, në radhë të parë dhe mbi të gjitha, lufta e pamposhtur e popullit shqiptar, i cili ishte ngritur në këmbë i tëri, i vetëdijshëm një për një se lirinë s'ta sjell njeri dhe se çmimin e lirisë nuk e paguajnë as luftërat e ashpra dhe as gjaku i derdhur pa kursim.

"Lëvizjet e vërteta popullore, na mëson historia, nuk mund të krijohen nga hiçi". Në qoftë se vendet fqinje ballkanike kërkuan t'u ndaheshin tokat shqiptare si shpërblim për fitoren e tyre mbi Turqinë dhe në qoftë se kërkesën e tillë ta përligjën fuqitë e mëdha të kohës, kjo nuk ngjau aspak për shkak se populli shqiptar nuk kishte luftuar. Përkundrazi njerëz përparimtarë nga gjiri shovinistëve të Ballkanit, siç është socialdemokrati serb D. Tucoviq, e thoshin me gojë të vet se populli shqiptar kishte qenë pararoja dhe shtylla e luftës shekullore kundër Turqisë. Fqinjtë mundën të kërkonin shpërblime të tilla për shkak se ishte koha kur sundonte arsyeja e të madhit që nuk i hynte në sy i vogli dhe që s'e kishte për gjë ta shkelte e ta dëmtonte fqinjin e largët apo të afërt.

Me shekuj, populli shqiptar kishte qëndruar në luftëra të pasosura kundër pushtuesit gjithfarësh. Katragjyshët tanë ilirë kundër romakut, stërgjyshët tanë kundër sundimit pesëshekullor turk. Për pesë shekuj luftimesh me anadollakët, në gjithë Evropën dhe në Ballkan, siç është pranuar gjerësisht nga shkenca e historisë, ndoshta vetëm epopeja e lavdishme hungareze e kohës së Huniadit, mund të krahasohet me epopenë shqiptare të Skënderbeut, që prej 25 vjet rresht, duke korrur fitore pas fitoreje, secila më e lavdishme se shoqja, s'ia ndau luftës së ashpër e këmbëngulëse kundër fuqisë më të madhe në botë të asaj kohe. Dhe kur? Në një kohë që Venediku, Raguza, Serbia e shtete të tjera, duke mos ia dalë të mateshin me turkun, ia puthnin dorën pushtuesit, duke bërë me sulltanët e vezirët turq krushqi pas krushqie, vetëm për të mbetur në rehat në mëshirën e tyre. Për Skënderbeun e madh, që ishte bërë mal për depërtimin e forcave në Ballkan, fqinjtë nuk patën ndihma e përkrahje, po vetëm kurthe e dredhi nga më të mëdhatë.

Kush tjetër, pos shqiptarët, e kishin bërë zakon edhe më vonë "mot për mot ka nji pashë me premun"!

Nga dokumentet turke rezulton se në shekujt XVI-XVIII shqiptarët e krahinave të shumta kishin bërë mesatarisht – dy kryengritje në vit. Edhe gjysma e parë e shekullit të kaluar, kur i kemi fillet e Rilindjes Kombëtare Shqiptare është e mbushur me kryengritje të njëpasnjëshme të shqiptarëve, që pak më vonë u kurorëzua me epopenë e lavdishme të Lidhjes së Prizrenit.

Ndonëse Lidhja Shqiptare e Prizrenit u shua me gjak- për lavdinë e shqiptarëve sypatrembur e të lidhur ngusht si një trup dhe për turpin e fqinjëve ballkanikë dhe të shteteve evropiane, që kaluan në anën e pushtuesit shekullor turk dhe të interesave shoviniste të Rusisë së largët – ajo la trashëgim një program serioz revolucionar, vetëdijen e zgjuar kombëtare dhe shpirtin e paepur luftarak të popullit shqiptar. Atë program ngulnin këmbë të zbatonin edhe në fillim të këtij shekulli luftëtarët tanë të lirisë dhe atë e realizuan pjesërisht me aktin e Shpalljes së Pavarësisë, më 1912.

Për shqiptarët e Çamërisë, të Kosovës e të viseve shqiptare në Maqedoni, Serbi e Mal të Zi, 28 Nëntori është dita e daljes nga robëria e vjetër turke dhe e hyrjes në një zgjedhë edhe më të rëndë, në zgjedhën sllave e greke.

Në kohën që Atdheu ynë, Shqipëria iu rrek konsolidimit të shtetit shqiptar, të rifituar me gjak pas afro pesë shekujsh, në viset shqiptare që mbetën jashtë shtetit filloi shfrytëzimi më i egër i pasurive dhe popullsisë nga pushtetet e huaja serbe, malazeze e greke. Dokumente të kohëve të shkuara e të sotme provojnë në mënyrë të pakundërshtueshme një shtypje barbare të shqiptarëve, e cila pasqyrohet në shfrytëzimin e pasurive tona natyrore, në shtypjen e traditës së popullit tonë deri në zhdukjen e saj, me qëllim të fundit, shfarosjen e plotë të shqiptarëve që mbetën në robëri nën pushtetet përkatëse.

Kjo, natyrisht, pati rezistencën e vet në të gjitha viset shqiptare. Edhe sot e kësaj dite patriotët dhe revolucionarët shqiptarë përulen me respekt para programeve patriotike çlirimtare të Hasan Prishtinës e të Bajram Currit me shokë, si dhe para armëve të lavdishme të Shotës e Azemit dhe të të gjithë atyre luftëtarëve të lirisë, që s'u pajtuan me robërinë jugosllave po ia kallën datën armikut kudo që u ndeshën me të.

Nga përfundimi i luftës kundër fashizmit, në të cilën populli shqiptar i çliroi me forca të veta të gjitha trojet shqiptare, priteshin ditë më të mira për popullin tonë.

Me thirrjen e Partisë Komuniste Shqiptare sot Partia e Punës e Shqipërisë, dhe në frymë të bashkëpunimit internacionalist proletar në frontin e përbashkët antifashist me popuj të tjerë ballkanas, kosovarët dhe shqiptarët e viseve të tjera me banim në Jugosllavi, derdhën pa kursim gjakun e tyre të shtrenjtë. Por, edhe kësaj radhe, fati i popullit tonë u mor nëpër këmbë nga forcat e errëta kapitaliste, që nxorën krye në fund të luftës dhe e futën nën sqetull edhe udhëheqësinë e PKJ. Kjo, ende pa qëruar mirë hesapet me fashizmin, e la frontin dhe u drodh e ushtroi masakra mizore mbi popullsinë shqiptare të Kosovës e të viseve të tjera. Me përkrahjen e fuqive të mëdha asaj i shkoi përdorësh t'i shtrijë sërish kthetrat mbi ato pjesë të tokave shqiptare që i kishin mbetur trashëgim nga kralët, e u rropat të vente dorë edhe mbi tërë Shqipërinë socialiste, me synim që ta bënte republikë të shtatë të Jugosllavisë dhe kështu t'ia delte sa më leht në krye të qëllimit të lashtë sllav për zhdukjen e plotë të popullit tonë.

Që atëherë, ndërsa në Shqipëri filloi lufta heroike për ndërtimin e socializmit, e cila sot e mban lart flamurin e revolucionit e të socializmit dhe Atdheun tonë e bën flamurtar të marksizëm-leninizmit e shembull për të gjitha forcat përparimtare e revolucionare në botë, ne, shqiptarët e Kosovës, u shtrënguam të ballafaqohemi me shfrytëzimin më të egër të pasurive dhe të popullit tonë nga ana e revizionistëve titistë, që po përpiqen ta çojnë përpara me mjete gjithnjë më perfide gjenocidin mbi shqiptarët.

Mbinë forca nga gjiri i popullit që u dolën përballë edhe këtyre përpjekjeve të kralëve të rinj jugosllavë. Burgjet e Jugosllavisë, që nga lufta e këtej, mbahen kryesisht me të burgosur politikë shqiptarë, që nuk stepen as para terrorit më të egër policor, që në disa pika ia kalon edhe atij fashist. Aktualisht, në burgjet jugosllave dergjen me mijëra patriotë e revolucionarë shqiptarë, e mes tyre një numër i madh femra. Me idealin e lartë të çlirimit kombëtar e klasor nga revizionizmi jugosllav dhe të bashkimit të shenjtë me vendin amë, Shqipërinë socialiste, ata, duke pasur edhe yllin komunist në zemër, janë bashkuar në frontin e luftës çlirimtare dhe të revolucionit, i cili do të ngadhënjejë patjetër, sepse frymëzimin dhe shtytjen e ka në vullnetin e vërtetë të popullit dhe në klasat më përparimtare e më të shëndosha të tij – në klasën punëtore dhe aleaten e saj më të ngushtë, fshatarësinë.

Ne ndihemi jashtëzakonisht të fortë që Atdheu ynë , RPS e Shqipërisë, në përvjetorin e 30-të të çlirimit, po del para popullit vëlla në Shqipëri me të mbërrime gjithnjë më të mëdha dhe më i fortë se kurdoherë. Na bën të lumtur fakti se pushteti popullor shqiptar kurrë nuk e la pas dore çështjen e fatit të shqiptarëve në Kosovë e në viset e tjera shqiptare të pushtuara nga Jugosllavia. Përkundrazi, jo vetëm ideologjia revizioniste jugosllave, po mbi të gjitha shtypja e saj e egër mbi popullsinë shqiptare, te Shqipëria gjetën denoncuesin e vetëm e më të fortë të barbarizmave dhe të gjenocidit.
Te kjo Shqipëri, pararoja patriotike e revolucionare e shqiptarëve me banim në Jugosllavi, gjeti jo vetëm Atdheun e vet të shenjtë, po edhe pishtarin më të denjë të ideve të luftës nacionalçlirimtare dhe të revolucionit.

Prandaj, përkundër robërisë e skamjes, torturave e kurbetit, që na i dha "peshqesh" titizmi, ne sot, më të fortë se asnjëherë në histori, po e ngrejmë së bashku këtë dolli, duke përgëzuar 28 Nëntorin 1912, ditën e Pavarësisë së parë, dhe 29 Nëntorin 1944, ditën e Pavarësisë së madhe të Atdheut tonë.

Lavdi marksizëm-leninizmit, idesë dhe realitetit të pamposhtur të pararojës së njerëzimit!

Rroftë PPSH me shokun Enver Hoxha në krye!

Rroftë populli shqiptar i lirë e i bashkuar! Vdekje titizmit, këtij armiku të përbetuar të popullit shqiptar! (Lajmëtari, janar 1981, f. 2-3)

46. Një provokim i lig i vullnetit të popullit

Në vigjilje të Vitit të Ri, "Rilindja", në rubrikën e saj "Në ditën e sotme", na shkruante: "Në Bunjaj (më 1943) filloi puna triditëshe e Konferencës së Parë Krahinore të Këshillave nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Metohisë. Në prezencën e 51 delegatëve nga të gjitha rrethet e Kosovës e të Metohisë, u zgjodh këshilli i parë nacionalçlirimtar, u caktuan detyrat e tij dhe iu bë proklamata popujve të K. dhe M. që ta intensifikojnë luftën kundër okupatorit fashist."

Natyrisht, lexuesi ynë nuk bëhet me dije për përmbajtjen e proklamatës, e cila përmbante edhe Rezolutën e Konferencës, ku thuhej: "Populli shqiptar, i cili me shekuj luftoi për çlirimin dhe krijimin e shtetit të vet kombëtar, si dhe pjesa e trojeve shqiptare dhe pjesa e popullit shqiptar që pat mbetur jashtë kufijve shtetëror shqiptarë, me çlirimin nga pushtuesit (fashistë), do t'i realizoj aspiratat e veta dhe do t'i bashkangjiten shtetit amë – Shqipërisë…"

Kjo proklamatë s'qe pos një provokim i lig i vullnetit të popullit tonë, i cili u çua në luftë ngadhënjimtare kundër fashizmit, i çliroi tokat e veta dhe u erdhi në ndihmë edhe popujve të Jugosllavisë. Sepse, fuqitë aleate në Luftën II Botërore dhe Jugosllavia, të cilat e kishin nënshkruar Rezolutën e përmendur të Konferencës së Bunjajt, madje në cilësinë e garantuesve për realizimin e saj, e shkelën atë si të ishte fjala për një marrëveshje të parëndësishme tregtare, e jo për vullnetin e një popullit të tërë, të shumëvuajtur.

47. KURTHET DHE HENDEQET

Kosova dhe dispozita kushtetuese jugosllave mbi statusin e territorit kombëtarisht të papërzier.

Herët a vonë, pushtuesit dhe klikat antipopullore do të gremisen atje ku ua kanë bërë vendin historia dhe popujt e shtypur. Këtij mallkimi nuk do të mund t'i bëjë bisht as Jugosllavia titiste. Ajo vërtet ka kurdisur shumë leqe dhe ka hapur shumë llagëme për punonjësit dhe popujt e shtypur, që të mbajtur me forcën e dhunës brenda kufijve

administrativo-politikë të këtij shteti socialshovinist, do të shtrëngohen t'i japin shumë e shumë zor për ta hequr qafën nga laku. Megjithatë, përditë po bëhet më e qartë se këta popuj do të mbesin edhe më tej ata që janë – të përjetshëm, kurse në kurthat e në hendeqet e kurdisura për ta do të bjerë vetë kreatura e regjimit antipopullor jugosllav, në krye me hegjemonizmin serb, e me shovinizmin malazes e maqedonas shokë të ngushtë.

Si çdo pushtues dhe si çdo klikë antipopullore, edhe regjimi i Beogradit është përpjekur e përpiqet ta përjetësojë pushtetin e vet. Pos të tjerash, edhe me dispozitat ligjore. Korrekte në dukje të parë, këto dispozita, në thelb, përmbajnë nene e klauzola të atilla, që kanë për qëllim realizimin e aspiratave më të errëta antipopullore, antikombëtare dhe antiklasore. Këto dispozita janë ato që përligjin diskriminimin social e racional të disa popullsive, varfërimin e shtypjen gjithnjë më të madhe të një pale dhe pasurimin e privilegjet gjithnjë më të mëdha të një pale tjetër, në kurriz të së parës.

Aktualisht, një dispozitë e tillë kushtetuta re u shkakton telashe të mëdha krerëve revizionistë të Beogradit: dispozita mbi statusin e të ashtuquajturit territor të papërzier në pikëpamje nacionale. Një status të tillë, sipas dispozitës në fjalë, e gëzojnë ato tërësi administrativo-politike të federatës (ato republika e krahina), në të cilat popullsia e një kombësie përbën mbi 80 për qind të popullsisë së përgjithshme.

Ku qëndron këtu shkaku për brengosjen e krerëve socialshovinistë të Beogradit?

Në kohën që kjo dispozitë u ngjit e bëri vend në Kushtetutë, nuk ekzistonte frika se statusin e territorit kombëtarisht të papërzier mund ta gëzonin një ditë edhe ato regjione ku kjo gjë ishte e padëshirueshme për shovinistët sllavë.

Sidomos kur ishte fjala për Kosovën, nuk ekzistonte as më e vogla frikë në këtë drejtim. Në frymën e paraardhësve të vjetër, kralët e rinj të Beogradit i kishin marrë masat e nevojshme preventive edhe kur është fjala për dezintegritetin territorial të viseve të pushtuara shqiptare edhe për dezintegrimin etnik të këtyre viseve. Kosovën ata e mbajtën të ndarë, ashtu si e kishin ndarë kralët – në katër banovina: një pjesë brenda krahinës së Kosovës dhe tri të tjera në republikat e Maqedonisë, Serbisë dhe Malit të Zi. Elementit autokton shqiptar të këtyre viseve ata, sikurse edhe paraardhësit e tyre, ia dhanë rrugën e kurbetit në shkretëtirat e Anadollit, në republikat e Jugosllavisë e gjetkë, kurse në viset shqiptare sollën kolonistë sllavë dhe i ngulitën aty me kushte shumë të favorshme për jetese. Në trojet shqiptare, veç kësaj, nuk ndërtohej ndonjë industri as nuk hapeshin çfarëdo vende pune, ku të mund të inkuadrohej shqiptari, e pak punë kishte për të edhe kur vendoste të shitej si argat i thjeshtë. Kishte punë vetëm në ato punishte të domosdoshme, ku nxirreshin lëndët e para dhe pasuritë e tjera të mëdha të shqiptarëve, që merrnin rrugën e Beogradit. Popullsia shqiptare shtypej në pikëpamje sociale e racionale, ekonomike e politike, mbi të ushtrohej terrori i egër politik dhe presioni i vazhdueshëm, që duhej ta detyronte shqiptarin ta braktiste patjetër vatrën e vet, ku të vinte pastaj kolonisti sllav. Edhe Kosova, pra, kjo si është tash, duhej të zbrazej fare nga elementi autokton shqiptar dhe, e mbushur me elementin ardhacak sllav, të ndërronte rrënjësisht fizionominë etnike dhe nga krahinë shqiptare, të bëhej një krahinë sllave.

Po llogaria e socialshovinistëve doli me disa të meta: trojet tona jo vetëm që nuk u zbrazën nga elementi i stërlashtë shqiptar, po përkundrazi, u ngjeshën edhe më shumë me këtë element. U shtuan aq shumë sa sot kërcënohemi ta fitojmë edhe statusin e territorit kombëtarisht të papërzier për krahinën tonë. E kjo do të kish qenë vdekje për qeverinë e Beogradit.

Sa e madhe është për ne rëndësia e statusit kombëtarisht të papërzier, mund të bëhet tjetër herë objekt shqyrtimi. Tash për tash po e përmendim vetëm faktin se, në rast të tillë, do të pushonin së vepruari në Kosovë ligjet e dy gjuhësisë dhe do të dominonte gjuha shqipe. Efektet e tjera, që dalin nga statusi i territorit kombëtarisht të papërzier, njëherë për një herë përfytyroni vetë, lexues të dashur. Dhe t'i kemi mirë parasysh kur

t'ju shkojë mendja te regjistrimi i popullsisë, te kujdesi që duhet ta kemi në propagandë e agjitacion të shëndoshë në të gjitha meset ku jetojnë shqiptarë, e sidomos në Kosovë. (Lajmëtari, janar 1981, f. 7)

48. NJË VARIANT LEXIMI

Të gjithë, pak a shumë, e kemi dëgjuar atë anekdotën për nëpunësin e pispillosur të bashkisë, i cili e nxjerr me maniret e një zotëriu të rëndë gazetën dhe fytyrës i jep pamje të atillë sikur është duke lexuar në të hatatë e kësaj bote. Po kur t'i afrohesh, she se gazetën e ka të kthyer mbrapsht, dhe maniret e "larta" e shprehjen e brengosur të fytyrës i ka për konsum, që të tjerët të shohin se si bën punë të madhe burri i votës – lexon gazetë. Por, koha e këtij "zotëriu" ka perënduar. Tash gazetën dinë ta lexojnë edhe fëmijët e moshës parashkollore, kurse opinioni lexues, në masë të madhe, është shumë më i ngritur se krijuesit e një gazete. Prandaj, anekdota për gazetën e kthyer mbrapsht tash mund të marrë kuptimin e mundësisë së vetme të leximit, nëse do ta marrësh vesh të vërtetën. Ne këtu po japim një variant të leximit "së prapthi" të gazetës "Rilindja" përkatësisht të artikullit "Mbi 1800 tonë xehe mbi plan". Tekstin e këtij artikulli po e botojmë në tërësi, me vërejtjet tona, të cilat i kemi nënvizuar dhe futur në kllapa.

Deri dje, në këtë muaj të kremtash të rëndësishme **(sepse ato shënojnë hyrjen e dytë të Kosovës nën zgjedhën e egër sllave),** duart e vyeshme të minatorëve (**argatë**) të Tërgut, nëntokës së kësaj miniere i shkëputën mbi 1800 tonelata xehe me shumë se ç'planifikohej **(për ndërtimin e sa më shumë bazeneve dimërore në Beograd dhe të qyteteve të bixhozit, në Budvë e Opati).** Rezultat i kësaj është mobilizimi në punë **(gazetari ka dashur të thotë të kundërtën: ky është rezultat i mobilizimit në punë, po kjo është logjikë e "lartë" për kokën e një punëtori publik, që burim të ngritjes së tij në pikëpamje intelektuale i ka në radhë të parë nga referatet e neveritshme të LSPP-së)** e këtë sidomos e ka mundësuar aplikimi i plotë i sistemit të ri katërbrigadësh të punës **(për eksploatim sa më të egër të nëntokës së begatshme shqiptare në mënyrë sa më të ngutshme, sa nuk është bërë vonë, se vjen lufta çlirimtare dhe Serbia mbetet pa ato pasuri).**

Përveç realizimit të planit fizik, metali në xehe ka përbërje më cilësore **(metali në xehe paska realizim të planit fizik dhe përbërje më cilësore; gazetari i famshëm i "Rilindjes" edhe më të famshme, ka problem për ta shtruar drejt në shqipe mendimin: xehja, pos që është nxjerrë me shumicë, ka edhe përbërje më cilësore, me ç'rast kjo "përbërje cilësore" mund të merret me mend se ekziston më shumë për hatër të gazetarit, i cili ngul këmbë të shkruajë temë me shtimung feste, pa përfillur të dhënat që ka në dorë).** Me një angazhim të tillë minatorët e "Trepçës" krahas realizimit të planit edhe më shumë po i kontribuojnë afarizmit **(menaxherizmit kolonialist)** edhe më të mirë të organizatës së tyre punonjëse, përkatësisht shtimit të të ardhurave dhe pasurimit të fondeve. **(Ne e dimë se ata shtojnë të ardhurat e shefave të Beogradit e të Prishtinës. Sepse, vetë minatorët, siç shkruante "Rilindja" e njëjtë, s'po e kalojnë dot mesataren e pagave mujore prej afro 2800 dinarësh, sa bëjnë sot vetëm dy rezevuarë benzinë, ose një dozë dymujore e deterxhentit "Dalli, dalli" etj.)**

Dihet se në njëmujorin e sivjetmë e përfunduan me 360 milionë dinarë fitim **(për arkat e borgjezisë social-shoviniste jugosllave).** Sipas të gjitha gjasave, dinamika e tillë e realizimit të planit dhe kushtet e volitshme të çmimeve në treg **(këtu e kemi pritur këtë idiotizëm me zile. Të mos ketë ditur vallë Çerkin Ibishi, autor i këtij artikulli, se**

"Trepça" është e detyruar t'i shesë prodhimet e veta vetëm në tregun e brendshëm – me çmime deri në 20 herë më të ulëta se në tregun botëror, ndërkohë që çmimet e hekurit, çelikut dhe të bakrit të prodhuar jashtë Kosove, po në tregun e brendshëm jugosllav, janë shumë të larta se ato në tregun botëror, përkatësisht 124, 72 dhe 27,5 për qind; vetëm për shkak të diskriminimit me anë të çmimeve të ulëta, gjatë vitit 1978 kjo minierë gjigande pati mbi 300 miliardë humbje, gazetari i Rilindjes do të mund të lexonte së paku në "kohë të lirë", deri sa shlodhet nga referatet e LSPP-së, edhe revistën "Economia"!), do të mundësoj afarizëm edhe më të mirë – sigurisht me fitim prej 400 milionë dinarësh **(nga të cilat, me siguri, nuk do të ndahet asnjë metelik për humbjet e industrisë kimike të "Trepçës" të cilat siç shkruante "Rilindja" e Çerkinit, ndoshta Çerkini vetë, parashikohen në 103 milionë e 800 mijë dinarë).** (Lajmëtari, janar 1981, f. 7)

49. ARMIKUT - GURIN E GJAKUT

Në prag të regjistrimit të popullsisë, që fillon në prill

Ekonomikisht, Jugosllavia ka interes të madh për viset e pushtuara shqiptare në Kosovë, Dukagjin, Maqedoni, Mal të Zi e në Serbi. Pasuritë natyrore në këto vise janë procentualisht nga më të mëdhatë në gjithë territorin administrativo-politik të Jugosllavisë. Ato sigurojnë një pjesë të madhe lëndësh të para dhe rezerva të begatshme natyrore, që ndikojnë dukshëm në potencialin e përgjithshëm të pasurive të këtij vendi revizionist. Ndërkaq, në pikëpamje politike, pushtimi i këtyre viseve – bashkë me përpjekjet e vazhdueshme për pushtimin e Shqipërisë Veriore deri te lumi Shkumbin (para lufte), ose për shndërrimin e gjithë Shqipërisë në republikë të shtatë (pas Luftës II Botërore – nga shovinistët serbë e malazezë është konsideruar në sendërtimin e ëndrrës pushtuese sllavo madhe, në gjurmët e përtëritjes së shtetit mesjetar serb të Nemanjiqëve.

Popullsia pengesë e pakapërcyeshme

Mirëpo, për vjeljen e rehatshme të pasurive natyrore të viseve shqiptare të pushtuara dhe për dehjen sllavomadhe të pushtuesve, përherë ka ekzistuar një pengesë e pakapërcyeshme: popullsia vendëse –shqiptare. Etnikisht, kjo popullsi ka qenë gjithmonë kompakte në viset e veta, kurse historikisht, ajo kishte një traditë të madhe luftarake e rezistuese ndaj pushtuesve të huaj edhe më të mëdhenj e më të fuqishëm. Prandaj, si për Mbretërinë Serbo-Kroato-sllovene, ashtu edhe për federatën titiste, ky problem implikonte një zgjidhje të domosdoshme. Zgjidhja më e mirë, siç kanë treguar përpjekjet e vazhdueshme jugosllave dhe siç është e natyrshme për shumë pushtues barbarë, do të kish qenë shfarosja e plotë e shqiptarëve. Por, meqë kjo është treguar e parealizueshme për shkaqe të ndryshme, në dispozicion ka mbetur përpjekja e vazhdueshme për dobësimin e rezistencës së shqiptarëve.

Gjenocidi mbi shqiptarët

Shfarosja e plotë e shqiptarëve me mjete të dhunës u tregua e parealizueshme që në krye të herës.1)Për shkak se shteti amë i shqiptarëve, pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë në 1912, - siç detyrohen të pranojnë me keqardhjen më të madhe kreatorët e shovinizmit serb- u konsolidua më shpejt nga ç'pritej dhe i topiti në njëfarë dore apetitet serbe për pushtimin e Shqipërisë.2) Ky konsolidim i Shqipërisë, për aq sa e dekompozoi në zhgandërr të hidhur ëndrrën e ëmbëlth jugosllave, edhe popullsisë shqiptare në viset e pushtuara i jepte impulse për një qëndresë sa më të madhe e më heroike përpara tërbimit shovinist të jugosllave.3) Sikundër që me ndihmën e fuqive të mëdha i kishte shtënë në dorë këto vise, Jugosllavia, po karshi fuqive të mëdha dhe karshi opinionit ndërkombëtar,

kishte disa obligime (sado formale) lidhur me qëndrimin ndaj popullsisë së pushtuar vendëse. Ja ç'lexojmë në nenin 2 të Traktatit të Pakicave (shtator 1919, në Saint-Germain-en-Laye), të cilin e pat nënshkruar Jugosllavia e vjetër: "Shteti Serbo-Kroato-Slloven merr përsipër t'u sigurojë të gjithë banorëve mbrojtje më të plotë të jetës e të lirisë, pa dallim klase, kombësie, gjuhe, race ose feje". Është tjetër çështje, a iu përmbajt ajo në praktikë Traktatit, apo filloi ushtrimin e egër të gjenocidit mbi shqiptarët. Lidhur me këtë, Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, i formuar në një institut evropian, në atë kohë raportonte: "Djegie shtëpish e fshatrash, vrasje masive e popullsisë së paarmatosur e të pafajshme, dhunë e ashpërsi e pashembullt, plaçkitje dhe akte mizore nga më të ndryshmet; këto janë mënyra që kanë përdorur dhe po përdorin ushtritë serbe e malazeze për t'ua ndryshuar kryekëput fizionominë etnike krahinave të banuara qind për qind me shqiptarë". Është çështje që dihet mirë (dhe që e pranojnë edhe jugosllavët e sotëm, për t'u dalluar gjoja nga ata të vjetrit) se praktika e tillë ka vazhduar që nga viti 1912 e deri në fillim të Luftës së Dytë Botërore. Këtë e dëshmojnë aksionet e kombinuara të ushtrisë e xhandarmërisë jugosllave bashkë me çetnikët e ndërsyer kundër popullit të paarmatosur shqiptar, e dëshmojnë kryengritjet e vazhdueshme shqiptare nën udhëheqjen e heronjve kombëtarë Isa Boletini, Bajram Curri, Hasan Prishtina, Shotë e Azem Galica etj.

Kapitullin e një "shpirtgjerësie" më të madhe formale-ligjore, po edhe të një shkeljeje më brutale të të drejtave të popullsisë shqiptare për jetë të lirë në tokën e vet, e hapi Jugosllavia titiste pas Luftës së Dytë Botërore. Formalisht, ajo ishte e detyruar që, në trajtimin e kombeve dhe kombësive, të merrte përsipër obligime më të mëdha se paraardhësja e saj, Mbretëria e SKS. Këto popullsi kishin derdhur gjakun në frontin e bashkuar antifashist nacionalçlirimtar, që më në fund e polli edhe shtetin-kreaturë të Jugosllavisë së re. Rrjedhimisht, përballë opinionit të vendit dhe atij botëror, e donte puna që të shformohej nga mendja e njerëzisë kujtimi i shtetit të serbëve, kroatëve e sllovenëve në krye me hegjemonizmin serb, e të krijohej përshtypja e një shteti socialist, që ka në themel bashkësinë e kombeve dhe të kombësive krejtësisht të barabarta. Me këtë parullë boshe, titizmi fitoi kredi në një pjesë të opinionit të vendit, me të e fitoi edhe "popullaritetin" në arenën ndërkombëtare. Në fakt, titizmi ishte betuar se nuk do ta lejonte ndërtimin e socializmit në Jugosllavi, kurse ndaj disa kombësive ndoqi një rrugë krejtësisht të kundërt me atë që trumbetonte.

"Lidhur me çështjen e popullsisë së Kosovës grupi udhëheqës i PKJ ndoqi një politikë nacionalshoviniste, që ishte e njëjta me politikën e Mihajloviqit e të Nediqit. Që në fund të vitit 1945, kur Jugosllavia kishte ende vise të pushtuara nga forcat e fashizmit gjerman, grupi udhëheqës i PKJ dërgoi brigada dhe divizione të tëra për të masakruar popullin e Kosovës dhe ushtroi një terror, që e kalonte atë që kishin përdorur ushtritë monarkiste serbe në periudhën e mëparme. Kështu, në praktikë, u shkelën me të dy këmbët parimet e mëdha të solidaritetit dhe të respektimit të të drejtave legjitime të popujve për të zgjedhur vetë fatin e tyre" (Sh. Ballvora, Studime historike, 4. Tiranë, 1966, f.85).

Por, edhe nëse udhëheqja shoviniste e PKJ mundi të likuidonte në përfundim të Luftës e menjëherë pastaj mbi 40 mijë shqiptarë, kjo gjë, me fashitjen e tingujve të fundit të luftës, u bë e pamundshme. Së paku në përmasa aq të mëdha.

Pranimi i fajit pas aktit të kryer

Megjithatë, në dispozicion mbeteshin metoda të tjera të shumta, që mund të viheshin mirë në shërbim të shovinizmit jugosllav: metodat e kombinuara me dhunë, terror, presion, me masa administrative e politike dhe me demagogji. Të gjitha këto së bashku duhej të siguronin likuidimin e plotë të rezistencës së popullit të robëruar shqiptar,

apo së paku dobësimin e kësaj rezistence deri në një shkallë të durueshme e të padëmshme për shovinistët sllavë.

Në këtë punim për hir të aktualitetit, ne do të përqendrohemi vetëm në njërën nga metodat e përdorura prej borgjezisë së vjetër e të re jugosllave: në falsifikimin e të dhënave statistikore mbi numrin e shqiptarëve dhe mbi lëvizjen demografike të popullsisë shqiptare. Në këtë të drejtë Jugosllavia ka investuar shumë, sepse fshehja e numrit të shqiptarëve në trollin e saj administrativo-politik si dhe fshehja e numrit të shqiptarëve të shpërngulur në Turqi e gjetkë, ka një ndikim me shtrirje të gjerë, e presupozon rezultate afatgjata në pretendimet pushtuese ndaj viseve shqiptare.

Fillimin e këtyre falsifikimeve, e gjejmë në fillim të pushtimeve jugosllave, menjëherë pas vitit 1912. Qysh Jovan Cvijiqi, gjeografi i njohur serb, kreatori i politikës antishqiptare, "ndonëse ka qenë i ngarkuar të kontribuojë në këtë drejtim, nuk ka mundur të mos pohojë, kur është fjala për numrin e popullsisë, se janë të pasigurta shënimet e agjentëve, priftërinjve, mësuesve dhe propaganduesve të tjerë". (Dr. Hivzi Islami, Popullsia e Kosovës, Prishtinë, 1980, f.221).

Pos numrit të popullsisë që vazhdonte të jetojë në tokat e veta apo të marrë rrugën e kurbetit në territoret e pushtuesit, të dhënat statistikore të të gjitha kohëve përpiqen të na e fshehin me këmbëngulje e perfiditet sidomos numrin e shqiptarëve të shpërngulur në Turqi, me plane shtetërore jugosllave për shpopullimin e trojeve shqiptare nga elementi autokton dhe popullzimin e tyre- me element kolonist sllav. S'ka asnjë dokument që të na flasë me gjuhën e saktë shkencore për këta të shpërngulur as për kolonistët serbë e malazezë, që janë sjellë këtu në vend të tyre. Punëtorët tanë shkencorë kanë probleme, jo vetëm për publikimin e shënimeve lidhur me këtë çështje (mund të na preket Beogradi, thonë recensorët e shitur), po veçanërisht në gjetjen dhe krahasimin e këtyre shënimeve. Qoftë kur është fjala për shpërnguljet para qoftë për ato pas Luftës.

Po t'i drejtohesh renegatit Fadil Hoxha, ai, në një "dokument" të botuar, të thotë se pas Lufte, nga i gjithë trualli jugosllav janë shpërngulur në Turqi vetëm nja 9000 shqiptarë (!) Atë e demanton Hajredin Hoxha. Ky paraqitet pak më "dorëlirë": numri i përgjithshëm i shqiptarëve të shpërngulur në Turqi nga gjithë territori administrativ jugosllav, sipas mendjes së tij, nuk i kalon 70.000 veta(!), në periudhën e pasluftës. Dhe, më tej, demantuesi tjetër, as më pak as më shumë se –LK e Serbisë, e tregon pa dashur mjerimin e dy të parëve. Në Plenumin e 14-të të LKS, - na bën të ditur dr. Hivzi Islami në veprën e përmendur, - "duke u diskutuar për disa çështje të shqiptarëve të Kosovës, u përmend edhe fakti se vetëm nga kjo Krahinë, në vitet e fundit të deformimeve të njohura e të presionit ndaj shqiptarëve, janë shpërngulur rreth 50.000 njerëz".

Ndërkaq, vetëm nga Maqedonia, - na njofton më tej dr. H. Islami, duke u mbështetur në burime autorësh jugosllavë, - vetëm brenda tri vjetësh (1955-1958) janë shpërngulur në Turqi 160.000 "turq", prej të cilëve pjesa dërmuese, konsideron autori, janë shqiptarë, po "vetëm të deklaruar kështu (turq-L.L) i pranonte qeveria turke". Kurse periudha e shpërnguljeve më të mëdha për në Turqi nuk është ajo e viteve 1955-1958, po pikërisht pas vitit 1958, që do të thotë se numri i të shpërngulurve është më i madh në masë të pakrahasueshme.

Përveç kësaj, vetë H. Hoxha thotë se, sipas të dhënave, sot në Turqi jetojnë mbi 1.000.000 shqiptarë. Ku arritën ata të shumohen nga 70.000 të shpërngulurit e "tij", bashkë me ata për të cilat flasin statistikat e paraluftës?!

Këtë epërsi në të publikuar të të dhënave, që shkon në favor të disa autorëve jugosllavë ndaj disa "autorëve" kosovarë, nuk mund ta vlerësojmë hëpërhë përparësi edhe sa i përket moralit të tyre. Ata e kanë pasur në dorë arrën edhe gurin, prandaj, kur ua ka dashur puna, s'kanë ngurruar edhe ta thyejnë arrën, duke publikuar të dhënat, që i kanë

ditur gjithmonë. Është e vërtetë se renegatët shqiptarë, duke pasur qëllim jetësor vetëm pozitën e fituar me tradhti, vrapojnë si mëzi para pelës, duke thënë me gojë e duke bërë me vepër, në dëm të shqiptarëve, edhe ato që nuk i kërkojnë prej tyre domosdo gospodarët sllavë në Beograd. Pos këtyre, ka edhe disa kuazidijetarë, që dinë po nuk thonë gjë prej gjëje nga frika e tyre. Mirëpo, në përgjithësi, lëvruesit tanë, kush më shumë e kush më pak, sidomos brezi i ri intelektual, po bëjnë punë të ndershme shkencore, madje edhe me sakrifica të mëdha.

Ndërkaq, kur është fjala për forumet dhe autorët jugosllavë, karakteristike nga kjo pikëpamje është një dukuri në periudha kalimtare e të krizave shoqërore-politike, që implikojnë përkrahjen e ndonjë popullsie, mbi të gjitha kur ka presion të madh nga populli, po jo edhe pasoja nga zbulimi i ndonjë sekreti, vjellin kurdoherë edhe gjëra të palejueshme nga e kaluara, në formë të "pranimit të fajit". Por, kurdo që janë "pranuar" fajet e tilla, kjo gjë është bërë pas aktit të kryer (nga autorë gjoja të tjerë) dhe gjithmonë i ka prirë kryerjes së ndonjë akti tjetër, më të errët e më barbar. Pastaj kanë ardhur të tjerë, që e kanë "pranuar fajin" e të parëve, e kështu me radhë.

Si të pacifizohen shqiptarët e kroatët e Bosnjës

Në të gjitha regjistrimet jugosllave të popullsisë, më 1921, 1948, 1953, 1961 dhe 1971, numri i shqiptarëve dhe i kroatëve të Bosnës është falsifikuar në mënyrat më të liga.. Për realizimin e këtij qëllimi, shovinistët serbomëdhenj kanë trilluar emërtime të çuditshme për kombësi të shpikura prej tyre dhe "teza" të shumta që s'kanë aspak të bëjnë me shkencën.

Në regjistrimet para lufte, shqiptarët nuk kanë pasur mundësi ta deklaronin kombësinë e tyre, se s'i pyeste kush, po vetëm të deklaroheshin lidhur me besimin e tyre fetar dhe me gjuhën amtare. Në pozitë të ngjashme ishin edhe kroatët e Bosnës të besimit fetar musliman. Mbi të dy palët bëhej presion dhe insistohej që këta të deklaroheshin turq. Në mënyrë që pastaj, me dhunë e presion, t'u jepet rruga e Anadollit.

Kur është fjala për shqiptarët, shovinistët serbë kishin trilluar edhe një "tezë", atë të ashtuquajturve "arnautashë" – serbë të shqiptarizuar. (Cvijiqi shënon ekzistimin e 140 familjeve "arnautashësh" në Kosovë. Atë e kundërshton me këmbëngulje socialdemokrati përparimtar serb i kohës, D. Tucoviqi, i cili thotë se kurrë historikisht nuk kanë ekzistuar rrethana që të kushtëzonin shqiptarizimin e serbëve.) Pjesa tjetër: ata të konfesionit musliman quheshin turq, ata të konfesionit ortodoks (si bie fjala në Rekë, Maqedoni) serbë apo maqedonë dhe ata të konfesionit katolik – një dreq e di se çka!

Pas lufte, për "boshnjakët" u hap dera që, vetëm për të mos e deklaruar përkatësinë kombëtare kroate (në një kohë që serbët e Bosnës nuk deklarohen ndryshe pos serbe), të deklaroheshin si "turq", "jugosllavë të pacaktuar" (më 1953) "muslimanë në kuptimin e përkatësisë etnike (më 1961) dhe "muslimanë në kuptimin kombëtar" (më 1971). Kështu në kohën e ekzistimit të më se 600 milionë muslimanëve në botë, të cilëve as u shkon mendja të jenë të kombësisë muslimane, sepse me kombësi janë arabë, turq, kinezë apo shqiptarë, jugosllavët e "shpikën" kombin e ri "mulsiman". Ndërkaq, për të treguar qartë se në trojet ballkanike mund ta durojnë më lehtë praninë kombëtare të ish pushtuesve të vet turq, shovinistët jugosllavë propagandojnë me sa munden që shqiptarët të regjistrohen "turq", ndonëse e kanë kombësinë e tyre të gatshme shqiptare, që s'i turpëron më asgjë, po përkundrazi i mburr si pasardhës të drejtpërdrejtë të popullit më të lashtë në Ballkan, tokat e të cilit shtriheshin pikërisht edhe atje ku jugosllavët sot e kanë atdheun.

Më 1971, në valën e regjistrimit të popullsisë, në Shkup u zunë pesë hoxhallarë, të cilët në masat shqiptare bënin agjitacion që këto të mos deklaroheshin shqiptarë. Sepse, siç i kishin porositur gospodarët maqedonas të thonë këta papagaj, të deklarohesh shqiptar

dashka të thotë se ke hequr dorë nga feja, meqë në Shqipëri nuk ka fe – dërdëllisnin ata. (Për ta pat shkruar edhe shtypi, qe folur edhe në radiotelevizion, po ata s'i gjeti gjë, se, dihej, ishin të paguar nga vetë organet maqedonase. Këtu është e tepërt të merremi me supozime se ç'do të ngjante sikur në Maqedoni në të mirë të çështjes shqiptare, ndonëse kjo është njëmijë herë më e drejtë).

Por, ironia më e madhe qenka rezervuar për këto ditë. Në kohën e krizës më të madhe në historinë e jugosllavëve, në kohën e lëvizjeve më të mëdha të disidentëve politikë, të përçarjeve edhe në vetë radhët më të larta të qeverisë jugosllave, në kohën e burgosjeve të papashme politike të shqiptarëve e të kroatëve dhe të lëvizjeve të mëdha të këtyre dy kombësive për çlirim definitiv nga Jugosllavia, pra, në kohën që "jugosllavizmi" është shndërruar në djallë me brirë më shumë se asnjëherë dhe për të gjithë popujt e këtushëm, sidomos për serbët, në këtë kohë, del një NIN i Beogradit me një apel anakronik e të rrezikshëm: që sa më shumë banorë të Jugosllavisë të deklarohen në pikëpamje kombëtare – "jugosllavë"! Pardon: jo "jugosllavë" në thonjëza, po jugosllavë, pa dorashka, - urdhëron lartmadhëria e tij NIN-i. Tri ditë pasi kaloi viti i mundimshëm 1980!.

Një përgjigje për thirrjen e tillë mund t'i jepet atij në këmbë e në dorë, siç ka bërë ai, pa na lënë të këndellemi nga "festa" e Vitit të Ri, kur, në vend që të gëzonim si të gjithë bota, ne qanim të afërmit dhe miqtë që dergjen në burgjet e atyre, për të cilët NIN-i na fton t'ua marrim edhe emrin.

Dezintegrimi i kompaktësisë etnike të shqiptarëve

Kush të ha këtë kokërr ulliri!

Thirrja e tillë e NIN-it u drejtohet pikërisht "muslimanëve" dhe shqiptarëve. Jugosllavët ende bëjnë llogari pa hanxhinë kur është fjala për nivelin arsimor dhe për vetëdijen kombëtare të shqiptarëve.

Mirëpo, edhe në regjistrimet e kaluara, të vitit 1971, shqiptarët e patën kuptuar se ka ardhur koha e fundit që të dalin në dritë të gjitha dredhitë e pabesitë jugosllave dhe pat vendosur që jugosllavëve, në vend që t'ua falë kombësinë e vet, do t'ua falë më me qejf gurin e gjakut. Ndonëse edhe atëherë u bënë manipulime me numrin e popullsisë, rezultatet e regjistrimeve qenë fatale për jugosllavët (sidomos për maqedonasit, të cilët i vonuan gjashtë muaj rezultatet nga republika e tyre, vetëm për të manipuluar disi numrin tejet të madh të shqiptarëve). Këto rezultate i dhanë impulse të reja popullit tonë të robëruar. U pa se, sa i përket shtimit natyror dhe moshës mesatare të popullsisë, shqiptarët janë kombësia më vitale jo vetëm në Jugosllavi, u pa se, megjithë përpjekjet më çnjerëzore të armikut për ta zhbirë farën e popullit tonë nga viset shqiptare, ajo kurrsesi nuk po rrallohet, përkundrazi përvjet po mugullon më e shëndoshë e më vitale.

Faktori njeri është faktori më i rëndësishëm për çdo shoqëri, në çfarëdo shkalle të zhvillimit dhe në çfarëdo kushtesh historike. Ky faktor e përcakton perspektivën e një shoqërie, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në lëvizjen e saj. Për ne, shqiptarët e robëruar nga Jugosllavia, njeriu është pasuria e vetme që kemi dhe arma e vetme që do të na nxjerrë nga kthetrat e pushtuesit. Prandaj, është i domosdoshëm kujdesi sa më i madh që të mos e bjerrim as në masën më të vogël njeriun tonë.

Cili është qëllimi i jugosllavëve sa i përket falsifikimit të të dhënave mbi popullsinë?

1)Në rastin më fatlum për pushtuesin, me zvogëlimin e numrit të shqiptarëve deri në një minimum dhe me shtimin proporcional të numrit të kolonistëve sllavë në tokat shqiptare, shovinistët jugosllavë pretendojnë të fitojnë "të drejta historike" mbi tokat tona; 2) Në një rast më pak fatlum për ta, kur nuk do të mund të sigurohej dezintegrimi i

dukshëm i kompaktësisë etnike shqiptare po një dezintegrim i pjesërishëm, atyre u mbetet në dorë mundësia që popullsisë sonë t'ia reduktojnë edhe ato të drejta formale, që i përgjigjen shkallës së caktuar të kompaktësisë më të madhe etnike të shqiptarëve.

Ne nuk mund ta shtojmë numrin e shqiptarëve në Jugosllavi. Por, duke u nisur nga rëndësia që ka për ne ky regjistrim i popullsisë, pararoja jonë revolucionare e patriotike e fton popullin tonë që syçeltësinë më të madhe në regjistrime ta kuptojë si një domosdoshmëri patriotike. Rinia përparimtare thirret të jetë sa më mobile me propagandën dhe agjitacionin e drejtë në popull, në mënyrë që armikut t'i japim një grusht të fortë edhe në këtë drejtim, duke mos ia "falur" asnjë njeri. Një aktivitet jashtëzakonisht i gjallë propagandistik në këtë pikëpamje në mesin e shqiptarëve të shpërndarë nëpër republikat e Jugosllavisë – për ne duhet të jetë detyrë e posaçme dhe domosdoshmëri. (Lajmëtari, janar 1981, f. 8-9)

50. SHTOJCË E LAJMËTARIT
Kush thumbit e kush potkoit

Revista jonë ishte në përfundim e sipër kur ne siguruam të dhënat për ngjarjet e mëposhtme. Ç'është e vërteta pjesën më të madhe e dinim edhe më parë. Por prisnim ndonjë listë konkrete, që do të paraqitte, në mënyrë më të afërme, sidomos gjendjen tonë sa u përket burgosjeve të egra, që UDB-ja po zbaton masivisht në viset shqiptare, gjithnjë më intensivisht prej më se dy vjetësh e këtej, duke u përpjekur të na trembë e të na qes pengesë pas pengese në rrugën e lëvizjes sonë patriotike e revolucionare. Kështu na shënimet relativisht të bollshme që mblodhëm tani, u detyruam ta zgjerojmë gjithë numrin e revistës sonë me këtë shtojcë, dy faqesh, që i kapërcen shpenzimet tona edhe ashtu të mëdha për shtypjen e revistës. Qëllimi kryesor ishte që të mos presim t'i botojmë ato në numrin e ardhshëm, nga i cili do të na ndaj shumë kohë, kurse nga materialet e përgatitura më parë për këtë numër nuk gjenim asnjë të tepërt, që të hiqnim dorë prej tij kësaj radhe. Prandaj, në qoftë se materialet e shtojcës nuk do të jenë të përpunuara në nivelin e shkrimeve tjera, nga lexuesi ynë i ndershëm kërkojmë ndjesë.

*Ja që u krye lista e një pjese shqiptarësh të ndershëm, që UDB-ja jugosllave i burgosi - me dorën e veglave të fëlliqura kosovare - vetëm në periudhën prej 21 nëntorit 1980 deri në të aguar të 1 janarit 1981:

1. Hasan Ukëhaxhaj, nga Carrabregu, magjistër i gjuhës shqipe, arsimtar në QAMO "Vëllezërit Frashëri" të Deçanit,
2. Ibish Neziri, nga Bardhaniqi, student i gjuhës shqipe, i burgosur më 21 nëntor 1980,
3. Bajram Gashi, nga Llapushniku, milic me shërbim në fshatin Cërmjan, student i gjuhës shqipe në SHL të Gjakovës,
4. Ali Mehmeti, nga Botusha, mësues në Mushtisht të Suharekës,
5. Sokol Mehmeti, gjithashtu nga Botusha, student,
6. Ramiz Zeqiri, nga Brovina, student i gjuhës shqipe,
7. Xhafer Sylejmani, nga Nivokazi, student
8. Musa Berisha, nga Duboviku, student i letërsisë shqipe, i arrestuar gjatë kohës që po bënte shërbimin ushtarak diku në Slloveni,
9. Ismet Ibërdemaj, nga Peja, student në Prishtinë,
10. Hysen Gegaj, nga Sallagrazhda, bujk, në kohën e arrestimit punëtor i inkuadruar në botën e jashtme, e
11. Danush Gegaj, nga Sallagrazhada, student në Prishtinë, që, bashkë me të vëllain,

Hysenin, u arrestuan mëngjesin e 1 janarit 1981, në shtëpinë e lindjes, në Sallagrazhdë.

Ndaj të gjithë këtyre njerëzve, tek të cilët, po përmendim kalimthi, nuk është gjetur kurrfarë materiali dëshmues, ndiqet procedura penale sipas nenit famëkeq 133 të Kodit penal të Jugosllavisë, për vepra që kualifikohen si vepra kundër popullit e shtetit, e që janë vërtet kundër shtetit, por për – popullin. Dhe të gjithë u shtrohen hetimeve që shoqërohen me tortura brutale.

Një aksion i vlefshëm në Prizren

* Në vigjilje të festës sonë kombëtare – 28 Nëntorit, rinia jonë revolucionare kreu një aksion të vlefshëm në Prizren dhe disa fshatra të rrethinës. Këta patriotë e revolucionarë shpërndanë, energjikisht dhe në shumë pika njëkohësisht dhe pa u diktuar, disa afishe të punuara bukur dhe me një përmbajtje të shkurtë e koncize, që vinte si përgjigje për burgosje masive politike që po bëhen te ne pa pushuar.

Redaksia e "Lajmëtarit të lirisë" vlerëson se aksionin e përmendur e bën të vlefshëm jo vetëm përmbajtja dhe shpërndarja e shkathët e afisheve, po para së gjithash momenti i përshtatshëm kur u krye aksioni: festa kombëtare e Pavarësisë, para dhe gjatë së cilës burgosja e forcave tona përparimtare jo vetëm që nuk pushoi po u intensifikua si rrallë ndonjëherë.

U lumtë djemave të vatanit!

Edhe në Gjimnazin e Deçanit

* Në vigjilje të festën sonë kombëtare nuk ndenji kot as një krah tjetër i rinisë përparimtare, por kreu me sukses një aksion tjetër – në QAMO "Vëllezërit Frashëri" të Deçanit. Gjashtë paralele të ish Gjimnazit eksperimental dhe muret e jashtme të sallës së fizkulturës, u stolisën me parulla, secila më e fuqishme se shoqja: "Rroftë 28 Nëntori", "Rroftë PPSH dhe Enver Hoxha", "Lavdi marksizëm-leninizmit" etj. Fotografitë e satrapit Tito, të varura si shëmtim që ndyen emrin e madh të patriotëve e të rilindasve shqiptarë Frashëri, emrin e të cilit e mban kjo qendër shkollore, rinia i mbuloi me një ngjyrë të fortë të yndyrshme.

Po me këso ngjyra të yndyrshme ishin shkruar edhe parullat mbi mure, me shkronja të mëdha. Kështu që, edhe kur u panë prej organeve të shkollës e pastaj të sigurimit dhe pas përpjekjeve të ethshme të këtyre për t'i fshirë ato, shenjat e tyre dukeshin qartë për një kohë të gjatë. Ishte kënaqësi e posaçme të shikoje, gjatë orës së mësimit, gjurmët e shkronjave të bukura, me fjalët e dashura "Rroftë PPSH", që UDB-ja kish dhënë urdhër të mbuloheshin me egërsi, sikurse çdo shenjë tjetër shqiptare dhe përgjithësisht përparimtare e revolucionare. Dhe një pushim i këndshëm shpirtëror, kur, në vend të fotografive të xhelatit të popullit tënd, shikoje rendin bosh mbi mure ku kish qenë fotografia e tij, e hequr për një kohë të gjatë. Derisa nuk u siguruan fotografi e korniza të reja, se të vjetrat i kishte mbuluar njëherë e përgjithmonë ngjyra e fortë, e yndyrshme. Katrorët boshe në mure, me një ngjyrë më të zbehtë në brendi, paraqitnin boshllëkun e tmerrshëm të qeverisë shoviniste të Beogradit, e cila po e përjeton agoninë e saj të sigurt.

200 milionë që t'i merret koka atij të gjalli që guxoi t'i hiqte kokën anonimit të vdekur në bust

* Me gjasë, anonimiteti ofendues e shëmtia e madhe e emrit Petar Përla, që mban Shkolla Fillore e Irzniqit, paskësh zgjuar neveri e mllef te banorët e këtij fshati, apo të ndonjë fshati tjetër përreth. Ose, ndoshta, edhe aksioni për të cilin do të bëjmë fjalë këtu, është vepër e rinisë së organizuar.

Sido që të jetë, aty në të aguar të 25 nëntorit të vitit që shkoi, busti i Petar Përlës, në oborrin e shkollës së Irzniqit, u gdhi për faqe të zezë: pa atë kokën e tij të shëmtuar e anonime.

Pas kësaj, UDB-ja e Deçanit dhe e Pejës maltretoi shumë njerëz, ndër ta edhe vëllain e kryetarit të Komunës së Deçanit, i cili kishte bërë rojë, vetë treti, natën që busti mbeti pa kokë. Tash, hetimet po bëhen edhe më të ethshme. Po gjurmët e aktorëve – as për ilaç! Sa më i madh po bëhet tërbimi i UDB-së, aq më shumë po i hipën vlera kokës anonime të Përlës dhe aq më e urryer po bëhet për armikun tonë koka e të riut tonë, që ia mori kokën e shëmtuar bustit. Nga burime të sigurta jemi informuar se UDB-ja e ka qitur fjalën në rrethin e besimtarëve të vet se ai që e zë aktorin e heqjes së kokës nga busti, do të shpërblehet me – 200 milionë dinarë!

Urdhëroni, turruni gjahtarë skalpesh të shqiptarëve! Për kokën e metaltë të një sllavi anonim, do të shpërbleheni me 200 milionë dinarë po të keni sukses t'ia merrni kokën nga krahët një shqiptari të gjallë. Me këto para mund të bleni, sa t'ju dojë shpirti, deterxhente, kripëra, vajra, sheqerëra e ashkla, që Jugosllavia titiste s'po mund t'ua sigurojë shtetasve as me shkopin dhe strajcën e lypës. Për ju është kujdesur UDB-ja, ajo ka para, sa të doni, vetëm ju punoni si ju porosit ajo, dhe do të shpërbleheni në kurriz të djersës e të gjakut të popullit.

Por, qëkur u hipi kështu vlera kokave të metalta?! Parvjet, kur u bë busti i heroit shqiptar, Sezai Surroi në një fshat të Opojës, autori i projektit pat marrë shpërblim vetëm 1 milion dinarë, kurse gjithë projekti pat kushtuar vetëm afro 3 milionë. Natyrisht, pa llogaritur ahengjet e pangopshme të renegatëve kosovarë, që erdhën në solemnitetin e zbulimit të bustit për t'i fryrë bulshinjtë dhe barkun si babëzinj të dorës së parë…

Por, si guxojmë të gabohemi! Atëherë ishte puna për një kokë hekuri të shqiptarit, tash për një kokë të tillë të sllavit. Dhe, këto s'e kanë çmimin e njëjtë as të shkrira në metal. Dhe kjo është gjëja më e rëndomtë në kushtet e jetës së sotme të shqiptarit në robërinë sllave.

Prapë Përla, prapë Kardeli… Deri kur – përrrr?

* Përgjithësisht, Deçani është një nga regjionet më të prapambetura të Kosovës si në pikëpamje të zhvillimit ekonomik, ashtu edhe të jetës politike e shoqërore. Përveç kësaj, me një strukturë jashtëzakonisht të mjerë arsimore e intelektuale, zyrtarët e kësaj komune përkasin ndër shërbëtorët më besnik të okupatorit jugosllav. Ata mbajnë në duar çelësat e Kuvendit të Komunës e të Komitetit Komunal të LK si edhe të një gjyqi të kohës së Ali Bungut. Por, një çetnik malazez, siç është inxhinieri Zoran Shaliq, e ka në dorë fatin e tyre dhe mendjen e veprimin e tyre. Ai i vë përfilli këta funksionarë të punëve të kota e të tradhtisë kombëtare dhe i bën të përkulen thellë para madhërisë së tij sllave.

Kështu, vjeshtën e shkuar u vendos të pagëzoheshin rrugët e qytezës që kish zënë të rritej, ndonëse me një rritë të fëmijës defekt. Me këtë rast edhe pse popullsia shqiptare në këtë komunë paraqet 94,2 % të popullsisë së përgjithshme (sipas regjistrimit të vitit 1971), s'u respektua as tradita as historia shqiptare, po rrugët u pagëzuan me emra krerësh

revizionistë sllavë, si Eduard Kardel e C°, dhe me emra çetnikësh sllavë, si Petar Përla & C°.

Në vargun e shfaqjeve të panumërta të diskriminimit mbi popullsinë vendëse shqiptare, banorët e Deçanit me rrethinë e morën si ofendim të rëndë këtë manifestim të shëmtuar e të egër të shovinizmit sllavomadh dhe përkuljen e pakurrizorëve renegatë shqiptarë. Prandaj dolën forca që, duke mos duruar më, kryen një aksion të organizuar: hoqën apo mbuluan me ngjyrë të yndyrshme të gjitha tabelat e rrugëve, që mbanin emra me të cilët ata nuk pajtoheshin.

Natyrisht, organet u vunë në gjah pas aktorëve të aksionit dhe s'bënë gjë prej gjëje. Njëkohësisht, ata vunë tabela të reja në vendet nga ishin hequr ato prej aksionistëve. Por, tani – me një vrragë në shpirt – e morën vesh se popullsia e këtushme, jo vetëm që nuk është e një mendimi me ta, por ajo di edhe ta shfaqë mospajtimin e vet. Sot me heqjen e tabelave, nesër kushedi…

UDB-ja dyshon në radhët e "veta"

* Qëmoti është thënë dhe është përcaktuar si domosdoshmëri se lëvizja jonë duhet të kujdeset patjetër të përvetësojë sa më shumë nga njerëzit tanë të ndershëm, që nevoja i ka shtyrë të punojnë në sekretariatin e punëve të brendshme. Këtu nuk është vendi të sqarohet dobia që del për ne nga kjo punë, veçse duam të bëjmë me dije se, edhe në këtë drejtim, po shënohen hapa të rëndësishëm. Do të cekim se është kjo arsyeja që na shtyri ta veçojmë nga lista e të burgosurve pikërisht një punëtor të sekretariatit që tash dergjet në burg me pretekst se është marrë me veprimtari revolucionare e patriotike.

Nuk jemi në gjendje të informojmë konkretisht për Bajram Gashin, milic me shërbim në Cërmjan: a ishte ai me të vërtetë anëtarë i ndonjë grupi a organizate patriotiko-revolucionare nga ato që veprojnë në viset shqiptare të pushtuara. Ne kemi gjurmuar dhe kemi konstatuar, se ai nuk përket së paku në asnjë nga tri organizata me të cilat ne zhvillojmë bashkëpunim. Prandaj, nuk është e ndershme ta përvetësojmë këtë njeri të vyer, duke e quajtur sekush si anëtar të vet, ndonëse konkretisht neve do të na bënte nder. Por, nga ana tjetër – ç'është shumë më me rëndësi, ne kemi informata thuaja të sigurta se Bajram Gashi nuk është i implikuar në ndonjë plan të errët të UDB-së, e cila, duke burgosur gjoja njerëz nga radhët e veta, shpeshherë ka ditur të ngreh kurthe për forcat tona përparimtare, duke i ngashënjyer ato me provokime nga më të ligat.

Milici Bajram Gashi, sipas të gjitha gjasëve, është vetëm një nga deti i tërë i njerëzve tanë të ndershëm, që, edhe pse kanë qenë në punë te okupatori, mendjen dhe zemrën i kanë pasur në rregull, do të thotë në anën e drejtësisë e të njerëzisë. Ai, me gjasë, nuk mundi t'i durojë më pa kundërshtim prapësitë e armikut kombëtar dhe klasor. E cekim edhe – klasor, sepse ai ishte lexues i zellshëm e i flaktë i literaturës marksiste-leniniste dhe rezononte me ndershmërinë e me mprehtësinë me të cilën e kishte pajisur ajo literaturë dhe ideja e pastër komuniste. Bir i një familjeje të këputur fshatare të Drenicës heroike, ai ishte shtrënguar të shfrytëzonte bursën e sekretariatit të punëve të brendshme dhe të kryente edhe shkollën e mesme në Vushtrri ku dalin kuadro të milicisë. Por, ai e kish pasur gjithmonë të qartë se nuk mund t'ia kthejë shpinën kombit të vet dhe ndershmërisë shqiptare e njerëzore. Si siguroi rrogën e parë, ai u regjstrua në SHLP të Gjakovës, ku ishte duke ndjekur me sukses ligjëratat në grupin e gjuhës dhe letërsisë shqipe, derisa e arrestuan. Kolegët e tij milicë, si marrim vesh, me kohë i paskëshin ngjitur atij edhe një nofkë tërheqëse, Bajram Kukësi, ngase ai e paskësh dëgjuar rregullisht radion shqiptare.

Një ditë, më 24 të nëntorit që shkoi, "marksistët" titistë, që kanë alergji të madhe ndaj marksizëm-leninizmit të vërtetë dhe ndaj shqiptarizmit, vendosën ta arrestojnë edhe

Bajramin dhe ta hedhin në edhe atë në qelitë e akullta ku i hedhin "armiqtë e popullit". Meqë poshtërsia e UDB-së nuk do të ishte e plotë po të kishte kufi, ata po i mbajnë në sirtar rrogat e tij, që vazhdojnë të vijnë ende nga qendra (ai ka të drejtë të marrë së paku gjashtë rroga pas arrestimit, për aq kohë sa mund të zgjasin hetimet). Kështu, familja e tij, e cila varet kryekëput prej rrogës së tij, tash ka mbetur në rrugën e madhe. Kjo është vetëm një nga mizoritë e shumta të armikut tonë, tërbimi i të cilit ka marrë hov të pandalshëm, deri në – vetëpërmbysjen e tij të plotë.

Tuna mos e ndaltë armikun mizor!

Kurse ne, që e kemi për detyrë e që po kujdesemi ta shtyjmë sa më shpejt kah varri i sigurt, mund të jemi të kënaqur që kësaj radhe konkretisht po bindemi se armikut po i hyn tmerri dhe koka iu ka mbushur mjegull, edhe kur është fjala për kuadrot e "veta", të cilat kujdeset t'i mbajë me presion në rrugën e errët të krimit, amoralitetit dhe të egërsisë fashiste.

Tani është e sigurt se Bajram Gashi, sido që të venë punët (thonë se ai është edhe i qëndrueshëm e i pamposhtur në qëndrimet), është një zog që i ka dalë dore përgjithmonë UDB-së. Na mban shpresa se shembullin e tij të ndritshëm do ta ndjekin kolegët e tij të tjerë të ndershëm!

Një akt barbar, i organizuar

* Është bërë punë e vështirë të merret vesh me saktësi çkado që ka të bëjë me kriminelin nga Lëvosha e Pejës dhe me krimet e tij, sepse atë e mori nën mbrojtje qendra çetnike e Beogradit, duke ua hequr duarsh organeve të Pejës. Megjithatë ia kemi dalë të shtiem në dorë disa të dhëna.

Nga të gjitha ato, që po fliten me të madhe në popull, e sigurt është sa vijon:

Më 19 tetor 1980 në Lëvoshë, fshat përmbi Pejë, një kriminel malazez shtiu mbi dy djelmosha shqiptarë, nga të cilët njëri mbeti vdekur e tjetri ia doli të ikë dhe ta informojë policinë për krimin e asaj dite. Viktimë e këtij gjahu çetnik në skalpe shqiptare qe 20 vjeçari Masar Hyseni nga fshati Sminë i Vitisë (i lindur më 1960), student i vitit të dytë në Shkollën e Lartë Komerciale në Pejë.

Ditën kontestuese, Masari dhe moshatari, bashkëshkollari e bashkëvendasi i tij Osmani nga Sadovina e Vitisë, kishin dalë për një shëti të zakonshme në pyllin afër Lëvoshës. Osmani ecën pak përpara shokut dhe i teket të bëjë një vrapim në ajër të pastër, se qenka edhe sportdashës. Kur iu afrua një grupi shtëpish, dolën në rrugë ca fëmijë që e ngacmuan. Më tepër në shaka, ai i jep një shpullë njërit prej tyre, e fëmija ia merr një vaji të djallëzuar dhe duke qarë, hyn në njërën prej shtëpive. Menjëherë pas kësaj, shfaqet njeriu me dyfek. Osmani mbetet i habitur dhe nuk nxehet, se s'i merr mendja që sherri mund të dalë kaq i madh. Po krimineli i afrohet me tërbim dhe nis t'ia vërë dyfekun në gjoks. Osmani ia largon me një shkathtësi të madhe dhe ata kapen fyta fyt. Ndërkohë arrin edhe Masari që përpiqet t'i ndajë. Mirëpo në përleshje e sipër dyfeku i kriminelit vjell zjarr dhe e lë paluar Masarin. Osmani i tmerruar duke mos parë mundësi t'i rrëmbejë armën çetnikut dhe duke parë në sytë e këtij një etje të madhe për gjak, arrin të ik dhe ta informojë policinë e Pejës për ngjarjen tragjike.

Duke kërkuar, sipas udhëzimeve të Osmanit, Masarin e vrarë, organet e sigurimit hasin në afërsi të vendit të ngjarjes në një kufomë tjetër të një djaloshi, të vrarë kohë më parë, për të cilin krimineli i Lëvoshës do të pranojë më vonë në burgun e Pejës se e ka vrarë me dorë të vet, sikurse edhe Masarin.

Gjatë hetimeve krimineli dha indikacione se është i porositur të heq sa më shumë koka shqiptarësh. Por, duke marrë një qëndrim mospërfillës ndaj organeve, ai nuk e

kallëzoi asnjë njeri nga ata që ia kishin bërë "porosinë". Pas një kohe të shkurtër, me intervenimin e instancave më të larta të UDB-së, krimineli dërgohet gjoja për kontroll mjekësor në Beograd, ku gjendet edhe sot, dhe shpallet i devijuar psikik.

Në popull ka zënë të flitet se si një çift bashkëshortor francez, turistë nëpër Krahinën tonë, paska kapur pahiri në kamerë filmike një nga krimet mizore të Çetnikut të Lëvoshës, pikërisht në vendin ku është zbuluar pahiri një kufomë, dhe atë film ua paska dërguar organeve të sigurimit. Pos kësaj, flitet dendur se krimineli ka marrë mbi vete jo më pak se shtatë të vrarë. Këtu mund të ketë edhe teprime, po përvoja e thellë e popullit tonë thotë se "pa ngrënë hudër s't'i vjen era gojës".

Sido që të jetë, tash çetniku kriminel është në të terur, larg nga dora e gjyqeve të Kosovës, apo nga dora hakmarrëse e shqiptarëve.

Tani ne do të donim ta pyesim renegatin e fëlliqur Beqir Hoti: ku është ai tash që të bëjë presion mbi popullsinë për dënimin me vdekje të këtij krimineli. A s'ia paska prishur Beqir Hotit ky kriminel i urryer "vëllazërim-bashkimin" e tij të bukur, siç ia pat prishur Selim Tali, i dënuar me vdekje dhe i ekzekutuar, pse e vrau një kriminel serb, duke marrë gjakun për të vëllanë që ia kishte vrarë ky kohë më parë?! Por, jo. Beqir Hoti është qengj i butë dhe "i njerëzishëm". Kur çetniku Rade Zvicer atij i jep flakareshë si ndonjë lluci (në kohën që Peja ishte përfshirë nga vërshimet), ky ia kthen faqen tjetër. Kështu, i "njerëzishëm" e i butë, ai konsideron se edhe për flakareshat që merr populli shqiptar nga shovinistët jugosllavë, ka të drejtë t'ua kthejë shovinistëve faqen tjetër (të popullit) për flakaresha të reja. Por, kush i ka faj Beqir Hotit dhe Beqir Hotëve tjerë, nëse janë mashtruar keq."
(Lajmëtari i lirisë, nr.1, janar-shkurt 1981).

51. THIRRJA PËR DEMONSTRATËN E SHTUTGARTIT, 25 prill 1981

VËLLEZËR TË DASHUR!

Sa herë jemi nisur të kërkojmë të drejtat tona të ligjshme nga armiku i egër jugosllav, ai gjithmonë na i ka ngërdheshur dhëmbët dhe ka treguar qartë se s'kemi pse t'i trokasim në derë për ndonjë të mirë. Por, fytyrën e vërtetë të armikut po e shohim këto ditë, që studentët, rinia jonë përparimtare dhe gjithë populli shqiptar i Kosovës u ngrit në këmbë për të kërkuar me zë të lartë realizimin e atyre të drejtave, të cilat na i mohuan qe 40 vjet socialshovinistët jugosllavë në krye me bandën gjakatare titistë të Beogradit. Demonstratave paqësore të studentëve tanë për përmirësimin e kushteve të jetesës, ata iu përgjigjën me kërbaç e me burg.

Dhe kur studentëve këmbëngulës iu bashkua edhe populli ynë heroik, duke i treguar botës se ka ardhur përfundimisht koha për realizimin e të drejtave të shqiptarëve në Jugosllavi, armiku barbar derdhi mbi atdheun tonë të dashur, mbi Kosovën e shumëvuajtur, më se gjysmën e ushtrisë e të milicisë serbe, malazeze e maqedone. Tanket rrethuan gjithë Kosovën, reparte të mëdha ushtarësh zunë grykat e Ibrit, Kaçanikut dhe të Rugovës, u rrethuan veç e veç shumë qytete, kurse aeroplanët dhe helikopterët lëshuan pa pushim parashutistë dhe gaze lotësjellëse. Njësitë speciale të milicisë bënë kërdinë mbi popullsinë tonë të paarmatosur. Këto njësi përdorën mbi rininë tonë armatime e mjete të atilla dhune, çfarë s'janë parë të përdoren gjetkë në botë.

Gjithë Kosovën e ka mbuluar jezeri. Sot në trojet tona sundon çizmja e xhandarit dhe bajoneta e ushtarit pushtues, kudo janë vënë patrulla policore e ushtarake dhe të gjitha rrugët e qyteteve dhe të fshatrave tona janë nën kontrollin e rreptë të patrullave ushtarake,

me armatime të rënda, me tanke, aeroplanë dhe helikopterë. Popullsia shqiptare po vritet, po gjymtohet, po rrahet e poshtërohet dhe po mbyllet nëpër kazerma e burgje fashiste.

Kështu me parullën e "vëllazërim-bashkimit" dhe të "barazisë së kombeve e kombësive" në një anë, dhe në anën tjetër me forcën e xhandarit dhe të policit, Jugosllavia fashiste u nisë për të kushedi të satën herë për të shkelur vatrat dhe nderin e shqiptarit, duke vrarë, çnjerëzuar e torturuar pa mëshirë qindra shqiptarë e shqiptare, pa kursyer pleqtë, gratë dhe fëmijët.

Në këto kushte ne nuk na mbetet rrugë tjetër shpëtmi pos të bashkohemi edhe më fort - të gjithë shqiptarët si një trup i vetëm - të lidhemi me besa-besë e, me guximin e njohur shqiptar, t'i mbrojmë me këmbëngulje të drejtat tona të ligjshme, ta shpëtojmë njëherë e përgjithmonë vendin nga kasaphana e përgjakshme, që po e pëgatit për ne armiku mizor; të shpëtojmë nderin e nënave të motrave tona, të shpëtojmë nderin e vatrave ku kemi lindur.

Të dashur vëllezër,

Sot, Kosova jonë e dashur, vëllezërit e motrat tona, që po shkelen nën zinxhirët e tankeve të ushtrisë fashiste jugosllave, na e kanë nevojën më shumë se kurrë. Prandaj është e domosdoshme që, si pjesë e pandashme e popullit tonë, edhe ne të ngrejmë lart zërin e protestës në mbrojtje të të drejtave tona të ligjshme, në mbrojtje të vëllezërve e të motrave tona, që s'e kursyen e s'po e kursejnë gjakun e tyre të shtrenjtë.

Për këtë qëllim, në vargun e manifetimeve të shumta të shqiptarëve anë e mbanë botës, kemi vendosur të thërresim një miting protestues në Shtutgart të RF Gjermane. Tubimi bëhet të shtunën, më 25 prill, në ora 10,30 para Stacionit Hekurudhor të Shtutgartit.

Gjendja e krijuar në Kosovë na obligon që në miting të dalim në numër sa më të madh.

POPULLI YNË ËSHTË I PAMPOSHTUR DHE DO TË FITOJË!

52. REGJISTRIMI I POPULLSISË NË KOSOVË U BË NËN HIJEN E TANKEVE

Lidhur me regjistrimin aktual të popullsisë, revizionistët jugosllavë kanë zhvilluar me kohë një fushatë sa të ethshme aq edhe perfide të propagandës dhe të agjitacionit në dëm të disa popullsive. Pas qerres së revizionistëve, me një paturpësi që shkon deri te tradhtia e hapët kombëtare, janë lidhur me zell të madh edhe renegatët shqiptarë në pushtet. Fushata është zhvilluar në dy drejtime kryesore. Drejtimi i parë ka qenë propaganda dhe agjitacioni i organizuar shtetëror në disa pjesë t'i quajmë skajore të popullsisë shqiptare, në të cilat socialshovinistët jugosllavë ia kanë dalë të ushtrojnë edhe më përpara njëfarë ndikimi çkombëtarizues e asimilues, siç janë të ashtuquajturit "torbeshë" apo "maqedonas muslimanë" në Maqedoninë perëndimore dhe të ashtuquajturit "muslimanë" të viseve shqiptare të Malit të Zi. Të mos flasim pastaj për popullsinë shqiptare të viseve të Sanxhakut, te e cila socialshovinistët e Beogradit kanë arritur ta shtypin pa mëshirë ndjenjën kombëtare dhe ta çrrënjosin në masë të madhe gjuhën amtare shqipe. Ndërkaq, drejtimi i dytë ishte ai i frenimit të ndjenjës kombëtare të shqiptarëve, kudo që të jenë ata, me presione të gjithanshme politike etj.

Ja disa nga aksionet e shumta në shkallë shtetërore, të realizuara me anën e mjeteve publike të informimit, siç janë shtypi e televizioni.

Thirrjet për vampirizëm
të "teorive" borgjeze shoviniste

Qysh para tri vjetësh, më 1978, një ekip i Televizionit të Beogradit, në krye me poetin dhe gazetarin serb Lubivoje Rshumoviq, realizoi në Maqedoninë perëndimore një serial televiziv "dokumentar", të përbërë prej dymbëdhjetë emisionesh njëorëshe. Duke vajtur nga fshati në fshat, si misionarët e dikurshëm të krishterimit, ky gazetar zhvilloi me atë rast biseda të pafundme me të ashtuquajtur "torbeshë" apo "maqedonas muslimanë". Bisedat, duke u sjellë gjoja në mënyrë spontane dhe duke u "përpunuar" pastaj në redaksi me mjete dhe metoda "shkencore", zhvilloheshin rreth adeteve e zakoneve, rreth të kaluarës "historike" të "torbeshëve", rreth emrave "karakteristikë" të personave e të vendeve, siç janë shtigjet e ndryshme, fushat e arat, burimet e krojet etj. Me një fjalë emisionet ngulnin këmbë që të nxirrej antroponimia dhe mikrotoponimia sllave e kësaj pjese të popullsisë shqiptare dhe të viseve thjesht shqiptare

Ky ishte një qëllim i tejdukshëm që, me anën e mjeteve dhe metodave të njohura shoviniste të "shkencëtarëve" të dikurshëm sllavë si Cvijiqi e Gjorgjeviqi, te kjo pjesë e popullsisë shqiptare të thellohet edhe më tej apolitizmi, pacifizmi dhe asimilimi, duke ia ngulitur asaj në kokë mendimin se më parë mund të jetë gjithçka tjetër sesa popullsi shqiptare.

Renegatët shqiptarë në pushtet, qoftë në Kosovë a në Maqedoni, siç është e natyrshme për ta, e bënë syrin qorr e veshin shurdh e nuk e panë të udhës ta thonin asnjë fjalë lidhur me atë fushatë të ndyrë shoviniste, e cila është në kundërshtim edhe me dispozitat kushtetutare të Jugosllavisë, që kanë të bëjnë me përcaktimin e lirë kombëtar dhe që gjoja para shikojnë dënime të rrepta për çdo agjitacion në këtë drejtim.

Por, egërsia dhe guximi karakteristik i socialshovinistëve jugosllavë në diskriminimin e një populli të tërë, shpërtheu haptasi vitin e kaluar në gazetën "Veçer" të Shkupit. Nga 25 shtatori deri më 21 tetor, kjo gazetë e shovinistëve maqedonas botoi në 23 vazhdime serinë e artikujve të Nijazi Limanovit me titull "Islamizimi i Maqedonisë". Duke u përpjekur gjoja për t'u dalë zot "torbeshëve" apo "maqedonasve muslimanë", siç quhet këtu me kohë një pjesë e popullsisë shqiptare pjesërisht e asimiluar, gazeta në fjalë doli me sulme të hapëta shoviniste, të padëgjuara deri më tash, kundër popullit shqiptar. Sipas të vjellave të Limanovit, një gazetar gjysmanalfabet dhe psikopat nga rrethi i Dibrës, populli shqiptar e paskësh pranuar në të kaluarën me gjithë dëshirë fenë muslimane, me qëllim që pastaj, me një "agresivitet" të paparë prej "pushtuesi" të egër, t'i islamizojë edhe popullsitë sllave përreth. Në marifetin e tij të bukur, morri Nijazi Limanov – edhe vetë një shqiptar i asimiluar - shkon aq larg sa jo vetëm i thërret të vampirizohen të gjitha forcat e errëta "shkencore" të borgjezisë sllavomadhe serbe, por atyre u siguron edhe "lëndë" të re lidhur me "agresivitetin", "dhunën" dhe përgjithësisht "egërsinë" e "pushtuesve" shqiptarë.

Përsëri renegatët shqiptarë bënë gjumin e tyre të ëmbël të tradhtisë dhe të moskokëçarjes për çkado që nuk e rrezikon pozitën e tyre të mjerë në aparatin revizionist jugosllav.

Doli dhe reagoi, vërtet pesë para dymbëdhjetëve por në mënyrë të thuktë shkencore, akademiku Dr. Ali Hadri.

Duhej që renegatët shqiptarë, siç u jepte mundësi Kushtetuta për të cilën ata kapen aq fortë kur ua do nevoja, t'ia ngjitnin për veshi Limanovit e "Veçerit" dhe ta ndërprenin që me artikullin e parë serinë e atyre shkrimeve me përmbajtje thellësisht antishqiptare. Ata, pra, janë aq energjikë e të papërtueshëm kur kanë të bëjnë, qoftë edhe me një fjalë të vetme të autorëve shqiptarë.

Tragjedia në popull – farsa në pushtet

Siç thamë në fillim, drejtimi i dytë nga do të dëmtohej popullsia shqiptare në regjistrimin aktual të popullsisë, ishte shtrëngimi dhe presioni i gjithanshëm politik mbi shqiptarët. Ky shtrëngim u realizua në radhë të parë me burgosjet masive të djalërisë përparimtare të Kosovës e të viseve të tjera shqiptare. Për një libër, një broshurë, gazetë apo trakt, madje për një fjalë goje të thënë në rrugë, qindra e mijëra shqiptarë u privuan lirie dhe i mbushën burgjet e Kosovës dhe të Jugosllavisë në një periudhë fare të shkurtër kohore. Sikur të mos u mjaftonte kjo, plangprishësit shqiptarë, këta tradhtarë të regjur, morën flamurin e turpit në dorë dhe u byritën para mikrofonave e kamerave, në faqet e shtypit revizionist, duke iu kërcënuar në një mijë mënyra popullit shqiptar dhe djalërisë së tij përparimtare, me aq pasion të egër, sa të ta mbushin mendjen se i ke hyrë deri në fyt borxh djallit po more guxim qoftë edhe të marrësh frymë shqip.

Që efekti të jetë sa më i madh, revizionistët dhe sahanlëpirësit shqiptarë, pasi bënë punën e tyre djallëzore, iu dhanë edhe më me pasion kërcënimeve për ata shqiptarë, që do të guxonin të bënin agjitacion lidhur me deklarimin e kombësisë.

Askujt s'ka mundur t'i shkojë as mendja se regjistrimi i popullsisë në Kosovë do të vazhdonte edhe në kushtet e tmerrshme që u krijuan pas demonstratave të fundit. Në një kohë kur rrugët, sheshet dhe vatrat tona binin erë gjaku, zhurmë tankesh e aeroplanësh dhe shkëlqim barbar të bajonetës së ngopur me gjakun e rinisë sonë ; në një shtrëngim të tillë hekuri, siç është rrethimi i plotë i qyteteve dhe fshatrave tona, ora policore e ndalimi i çdo grumbullimi të njerëzve; mbyllja e Universitetit dhe e të gjitha shkollave, mbyllja e ndërmarrjeve, fabrikave dhe uzinave – në një kohë të tillë, pra, një çështje siç është regjistrimi i popullsisë s'kishte gjë tjetër për qëllim, pos sadizmin e pamatë të shovinistëve revizionistë të Beogradit, që deshën ta provonin në praktikë se a rrëzohet deveja e stërngarkuar për një lëkurë lepuri më shumë.

Shtypi, radioja e televizioni revizionist zunë të krekoseshin si mburravecët e fundit të kësaj bote sesi, megjithë situatën e krijuar në Kosovë, ata gjoja s'e kanë humbur pushtetin dhe regjistrimin e parashikuar të popullsisë po e vazhdonin në kushtet dhe në mënyrën më "normale". Si vazhdimisht që 69 vjet e këtej, forcat e errëta borgjeze jugosllave deshën edhe kësaj radhe të përfitonin nga mjegulla dhe të mjegullonin statistikat e tyre të mjegullta dhe të zvogëlonin numrin e shqiptarëve që jetojnë brenda kufijve administrativo-politikë të Jugosllavisë.

Sa i dënueshëm është ky akt kaq barbar i atyre forcave të errëta jugosllave në pushtet, të cilave u ka krijuar klimë shumë të favorshme për manifestimin e fshehtë dhe të hapët të shovinizmit pikërisht revizionizmi në pushtet, do të shihet me kalimin e kohës atëherë kur do të shihet edhe dëmi që i është shkaktuar në këtë mënyrë evidentimit statistikor të popullsisë shqiptare në Jugosllavi.

Por, kjo nuk i bën nder qeverisë jugosllave. Dhe aq më pak do t'i sjellë dobi. Sepse populli ynë, ndonëse kësaj radhe ishte i zënë me punë më të ngutshme, me varrimin e bijave dhe bijve të vet, me mjekimin e plagëve që morën ata nga ushtria dhe milicia jugosllave, me burgimet e rënda, është absurd të mendohet që e ka harruar edhe rëndësinë e regjistrimeve të popullsisë. Populli ynë ka një shpirt të madh. Ai e përballoi burrërisht e heroikisht tragjedinë. Do ta përballojë edhe këtë regjistrim të popullsisë që u bë nën hijen e tankeve dhe nën zhurmën kërcënuese të aeroplanëve.

Për falsifikimet që borgjezia jugosllave ka bërë prej motesh lidhur me numrin e shqiptarëve, populli ynë gjithmonë e ka pasur të gatshme përgjigjen : Jemi shqiptarë, shqiptarë lindim dhe shqiptarë vdesim! Këtë përgjigje ka pasur kurdoherë në gojë populli ynë, edhe kur u është vënë zjarri shtëpive, fshatrave e lagjeve tona; kur xhandari serb na ka dërmuar pse i kemi thënë ose nuk i kemi thënë "mirëmëngjesi"; edhe kur na kanë

shkelur flamurin, na kanë plaçkitur kokrrën e fundit të misrit nga drithnikët...Edhe kur na e kanë zbritur deri në baltë dinjitetin kombëtar, duke na kërkuar armën që s'e kemi pasur; edhe kur na e kanë ndaluar gjuhën tonë të ëmbël.

Ç'është më e çuditshme, ne nuk ligemi nga punët dhe fjalët e armikut. Sepse e dimë se çdo fjalë e tij është vetëm një farsë. Por, as armiku të mos mendojë se e mashtron lehtë këtë popull, i cili po e përjeton tragjedinë e madhe ku e katandisi shovinizmi jugosllav, por i cili ka vendosur me të gjitha forcat e veta t'ia vërë atij pushkën në gjoks.

Kësaj të vërtete do t'i dalë zot shqiptari sidomos sot, që armiku hoqi maskën e tij të urryer dhe doli me fytyrën e tij të vërtetë dhe më të urryer, me fytyrën e kriminelit gjakpirës. (LIRIA"; nr.3; maj; 1981, f. 14)

53. KOSOVË, SA HIJE TË KA XHAMADANI I TRIMËRISË!

Këtu e njëqind vjet më parë kishte ndodhur një nga përleshjet më të pabesueshme në historinë e njerëzimit. Fshatari shqiptar me emrin Mic Sokoli ishte kapur fyt a fyt me topin bajloz turk. Kjo përleshje e madhërishme e njeriut me çelikun i kishte thyer të gjitha përmasat e deriatëhershme të përfytyrimit njerëzor mbi heroizmin. Në përleshje me Micin, topin e thau vera dhe u rrokullis thepinës tatëpjetë në një hon të Grykës së Carralevës. Nga shqiptari Mic mbeti xhamadani i trimërisë, i skuqur me gjak, i cili iu vesh trollit si farë e trimërisë së përjetësuar të shqiptarit. Dhe mbeti edhe kënga epike :

Mic Sokoli nji fjalë p'e flet,
I thotë nanës "Tymermeç!",
Pa u faru Malsia krejt.
K'tu nuk hyn as krajl as mret!

Atëhere nuk ishte Shqipëria. Në të vërtetë Shqipëri kishte, por atë e kishte kapur për fyti dhe ia kishte zënë diellin gjysmëhëna e verdhë turke. Fatosat pasardhës të Micit, duke vënë gjakun e tyre të shtrenjtë në themelet e tokës nënë, e bënë edhe Shqipërinë, duke ngulur në 1912 në Vlorën heroike flamurin e kuq me shkabën dykrenare, simbol i lirisë, shtetësisë dhe pavarësisë shqiptare.

Por, fuqitë imperialiste të kohës jo vetëm që trupin e Shqipërisë e shtrinë në sallën e operacionit të tyre të egër, duke ia hequr asaj, si me brisk pjesët gati më vitale, por dhanë edhe shenja të qarta se nuk do ta lenin as shqiptarin brenda kufijve kombëtarë ta gëzonte i qetë jetën në atdheun e lirë, të krijuar me mundime mbinjerëzore në luftë me shtatë krajlitë. Kurse fuqitë shoviniste të Ballkanit, si Serbia, nuk kënaqeshin vetëm me pushtimin e Kosovës, por përpiqeshin të hidhnin hapin deri në Shkumbin. U desh heroizmi i lumjanëve për t'i dhënë një mësim dhelprës plakë të Shumadisë. Dhe, mësimi i doli tepër i hidhur asaj, pasi iu desh të lente 12 mijë vojnikë në malet e Lumës.

Dhe më pas doli, kësaj radhe nga deti, një armik tjetër që mori në sy rrugën e robërimit të Shqipërisë, u desh që kundër këtij armiku të vishej edhe një herë xhamadani i Mic Sokolit. Doli dhe e veshi pa përtesë, në Vlorë më 1920, Selam Musai, duke iu hedhur edhe ai në grykë topit italian. I tmerruar nga trimëria shqiptare, edhe ky armik i ri, ndonëse kishte forca të pamata numerike e teknike, u detyrua të kthehej nga kish ardhur, matanë detit, duke lënë prapa lakminë e papërmbajtur për brigjet shqiptare dhe për pasuritë e mëdha të Atdheut tonë, si një mundësi të kthimit të sërishëm në to.

Erdhi viti 1939 dhe me të këmishëzinjtë e Duçes, Musolinit, e pastaj edhe ata të Hitlerit, që deshën ta shtronin përdhe Shqipërinë. Por, tashmë ishte bërë fare e qartë se në çdo rrebesh që egërsohej mbi tokat shqiptare, i delte i zoti edhe xhamadanit të trimërisë

shqiptare. Kësaj radhe, ai u vesh nga komunisti Vojo Kushi, në Kodër të Kuqe të Tiranës, duke iu hedhur në grykë tanksit gjerman, për ta bërë atë të belbëzojë dhe të mos t'i kthehet kurrë më goja e zjarrtë në Shqipërinë e përskuqur nga komunizmi.

Kjo është me pak fjalë historia e xhamadanit të trimërisë, historia e një populli të tërë, i cili, përballë armikut kurdoherë më të fuqishëm në numër dhe në përgatitjen teknike ushtarake, përballë lakmisë së armiqve zullumqarë të largët e të afërt, u detyrua të futet në luftëra të pareshtura, madje, me një armë të vetme; me gatishmërinë e flijimit për nderin e atdheut dhe me trimërinë e tij karakteristike që zëvendëson çdo armë të armikut.

Dhe vërtet shekujt, në ndërrimin e tyre, shkundën rrebeshe të mëdha mbi kokën e shqiptarit. Shpesh koha e zuri ngushtë shqiptarin për një kafshatë bukë, por jo edhe për sofrën bujare që i shtrohet me zemër mikut; koha e zuri shpesh ngushtë shqiptarin me robëri, skamje dhe mjerim, por asnjëherë të përkulur e të nënshtruar; gjithmonë shqiptari u tregua dorëlirë për të ta lënë në dorë pa të pyetur fare gjënë e vetme që kishte – jetën e tij, kurdo që këtë e kërkoi nderi i fisit dhe nevoja e atdheut.

Një histori e tillë ngjalli kurdoherë admirimin e miqve dhe tmerrin e armiqve. Kurse bota përreth, e ballafaquar me një trimëri kaq të materializuar, pa pasur mundësi ta shqyrtojë e ta definojë saktësisht, bënte seir dhe mbetej me gojë hapur, e çuditur nga një armë e tillë – gatishmëria mbinjerëzore për flijim dhe trimëria e pashembullt.

Bota, e cila dikur çuditej se ku e gjente shqipja gjithë atë forcë kur matej me shtatë krajlitë, sot po çuditet, ç'e gjeti kështu shqiptarin e Kosovës të rebelohet "brenda natës" dhe si po i bën ballë me muaj të tërë rrethimit të egër me tanke e bajoneta, ushtri e polici; si i bën ballë tërbimit të zhurmshëm kërcënues të aeroplanëve mbi kokat e popullsisë duarthatë e të paarmatosur.

Populli shqiptar i Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare të robëruara nga Jugosllavia nuk u rebeluan "brenda natës" . Rebelimi i tij u përgatit për afro dyzet vjet të vështira jete në kuadër të Jugosllavisë revizioniste titiste, e cila për popullsinë shqiptare, përballë propagandës lidhur me mirëqenien, barazinë ekonomike, politike e shoqërore me kombet dhe kombësitë e tjera, lidhur me gjoja vëllazërim bashkimin, s'pati gjë tjetër pos shtypjes kombëtare e shoqërore, pas diskriminimit social e kulturor, pos shfrytëzimit të egër të pasurive të tyre natyrore dhe zbatimit të mjeteve të gjenocidit.

I durueshëm sa s'bën më deri më sot, populli ynë, duke arritur në shkallën e një mjerimi të tillë që kufizohet me vdekjen nga uria, i ndodhur përballë një propagande të rënduar tuç nga demagogjia, e cila ka për qëllim të mbytë gjithë ç'ka shpëtuar ende nga skamja e mjerimi; i ndodhur edhe përballë qëndrimit diskriminues ndaj kombësisë sonë nga ana e regjimit antipopullor dhe sidomos antishqiptar të qeverisë së Beogradit, e pa të arsyeshme të ngrinte zërin e saj të fuqishëm dhe të kërkonte të drejta e liri në një rrugë paqësore, përveç demonstratave. Po kur në vend të të drejtave dhe lirive, mori përgjigjen me tanke, aeroplanë, me kërbaç, gazëra lotsjellëse e helmuese, dhe më në fund edhe me plumbin e shovinistëve, vendosi ta nxjerrë pallën sheshit dhe t'i dalë sypatrembur përballë armikut, me ato mjete që pati në dorë. Dhe mjetet e tij ishin më të fuqishme se tanku e aeroplani, më të fuqishme se plumbi i armikut. Në anën e tij ishin drejtësia dhe trimëria, përballë synimeve grabitqare e shoviniste të armikut, në anën e tij ishin detyra dhe nderi për mbrojtjen e pasurive dhe të jetës, përballë sulmeve të të huajit mbi këto pasuri dhe mbi jetën e njerëzve të robëruar e të skamnuar.

Në një situatë të tillë, tërbimi i armikut e shtyri edhe një herë shqiptarin ta veshë xhamadanin e trimërisë. Si dikur Mic Sokoli, Selam Labi e Vojo Kushi, djalëria patriotike e revolucionare, e mbrujtur edhe me idealet e larta marksiste-leniniste, doli sypatrembur para tankut të ushtrisë së revizionistëve jugosllavë.

Edhe kur shtrohet çështja e armëve, Kosova këto i ka me bollëk, dhe bile të gjitha llojet e tyre. Ato i sollën me vete armiqtë e shumtë për ta robëruar e plaçkitur, por, bashkë me kokën e tyre lanë në Kosovë edhe armët që kishin sjellë me vete. Kaluan mbi tokën tonë shumë pushtues: romaku, bizanti dhe turku, greku dhe bullgari, serbi e malazezi, austriaku e francezi, italiani e gjermani, bile shumë prej tyre nga dy e tri herë. Që të gjithë ata, me forcën e armëve të tyre, mendonin se do t'i përjetësonin stemat dhe flamujt e tyre mbi fushën e gjerë të Kosovës. Por, stemat dhe flamujt iu shkelën me këmbë, populli ynë mbeti kryelartë dhe e pasuroi arsenalin e armëve.

Petritat e Podujevës, me një çifte gjahu, çarmatosën dy autobusë me policë të specializuar që kishin ardhur nga Beogradi, ua kallën automjetet, dhe me armët e rrëmbyera formuan në qytetin e tyre të dytën "Arbëri të vogël". Në Prizren, motrat tona, me emrin e Shotë Galicës në gojë, sulmuan mbi hordhitë e urryera të xhandarmërisë serbe. Kurse në Prishtinë, studenti sypatrembur i doli përpara tankut, shpalosi gjoksin dhe bërtiti si sokol mali : "Shtjer, bishë fashiste, se s'e tremb dot komunistin shqiptar!"

Ata që kanë dyshuar në fjalët e marksist-leninistit të madh të ditëve tona dhe prijësit të lavdishëm shqiptar, shokut Enver Hoxha, kur thoshte se s'duhet zemëruar shqiptarin, sepse," kur zemërohet shqiptari, merr flakë e zjarr edhe stralli", e patën rastin të binden gjatë demonstratave të fundit në Kosovë, kur ngjau ajo që s'kish ngjarë gjetiu tjetërherë: kur fëmijët, të kapur dorë për dorë, u dolën përpara sypatrembur tankeve dhe armëve të shovinistëve jugosllavë.

Një çudi e madhe ndodhi para pak kohësh në Pejë: armiku titist, i cili kishte vënë re femrën kosovare me kësulë, tirq e xhamadanë shqiptarë, u tmerrua dhe ua vuri dryrin dyqaneve ku enden veshjet tona kombëtare. Po ai e kishte kuptuar në mënyrë banale çështjen e xhamadanit të trimërisë. Sepse, nuk është zhguni mbi gjokset shqiptare që atyre ua sjell trimërinë, por është zemra e tyre e brumosur me dashurinë e pamatë për tokën mëmë dhe kombin e drejtësisë.

Kosovë, hije të ka xhamadani i trimërisë! (Liria, maj 1981, faqe 15)

54. TRADHTARËT E VJETËR DHE TRADHTARËT E RINJ

Çdo pushtues, për të bërë zap popullsinë e pushtuar, rekruton në organet e pushtetit të vet një numër vendësish, të cilët bëhen përçues të politikës, të ideologjisë dhe të urdhrave të atij pushteti.

Nga viti 1912, kur tokat shqiptare në Kosovë e Rrafsh të Dukagjinit, në Maqedoni, Mal të Zi si dhe ato në Serbinë e sotme të ngushtë iu shkëputën padrejtësisht trungut shqiptar dhe hynë nën zgjedhën e egër serbomalazeze, në shërbim të pushtetit të huaj hynë edhe njerëz nga radhët e popullsisë vendëse shqiptare, që nga "poverenikët" më të thjeshtë e deri te deputetët në parlament.

Përfaqësues tipikë të indigjenëve të rekrutuar në aparatin shtetëror të pushtuesve jugosllavë ishin dikur Dragajt e Mitrovicës, Begollët e Pejës, Kryezitë e Gjakovës etj., dhe më pastaj, në aparatin revizionist titist- Fadilj Hodzët, Dzavid Nimanët, Mahmud Bakalët etj.

Në kohën e Jugosllavisë së vjetër kishte ndodhur që populli shqiptar, duke u nisur nga të drejtat formale që garantonte kushtetuta e atëhershme, bënte edhe përpjekje për të zgjedhur përfaqësuesit e vet në organet e pushtetit (rasti i Zef Lush Markut, Lufta e Baranit e 1937-ës) dhe, për ta realizuar këtë të drejtë, ishte përgjakur sa e sa herë me pushtetin shovinist. Ndërkaq, në Jugosllavinë e Titos, pushteti e ka kursyer popullin; ai është kujdesur vetë për njerëzit që do të zgjidhen në organet shtetërore. "Poverenikët"

dhe deputetët shqiptarë në "parlamentin" titist i gjejmë në një pozitë më të mirë se ata në Jugosllavinë mbretërore; këta s'kanë nevojë as të luajnë veshin për të bërë çka don për popullin në mënyrë që të fitojë simpatinë e tij. Mjafton që t'u përgjigjen kërkesave të pushtuesit dhe e kanë të siguruar kolltukun e butë. Vullneti i popullit përjashtohet fare, sepse, në vendet udhëheqëse (qoftë edhe për një drejtor të thjeshtë) funksionarët nuk zgjidhen , por emërohen nga forumet e larta lokale dhe qendrore. Pasi t'i ketë zgjedhur për qejfi, pushteti i quan këta njerëz – përfaqësues të popullit. Po edhe populli, logjikisht, ata i quan – tradhtarë të popullit. Sepse, sipas praktikës së deritanishme, është dashur të japësh provime të shumta të gatishmërisë për të bërë politikë antishqiptare, ani pastaj të të emërojë pushteti në ndonjë organ lokal apo qendror.

S'ka tjetër emër për këta sahanlëpirës që i shërbyen me besnikërinë e qenit, jo popullit, nga gjiri i të cilit kanë dalë, po regjimit të egër antipopullor e antishqiptar, te i cili janë shitur badihava. Ata u bënë thjeshtë një vegël e verbër në realizimin e politikës shoviniste dhe të gjenocidit mbi shqiptarët.

Me pajtimin e plotë të këtyre tradhtarëve u masakrua, më 1945, popullsia shqiptare në Drenicë e Gjilan, në Tetovë e gjetkë. Me heshtjen e tyre aprovuese u likuiduan dhjetëra mijëra partizanë shqiptarë në Tivar, në Srem e Slloveni, ku kishin vajtur për t'u dalë në ndihmë popujve fqinjë jugosllavë në dëbimin e çizmes fashiste. "Poverenikët" dhe funksionarët titistë ishin kokë e këmbë të pranishëm kur u shkel me të dy këmbët vullneti i popullit shqiptar në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare, i shprehur në Rezolutën e Konferencës së Bujanit, më 1943, e cila shqiptarëve u garantonte të drejtën për vetëvendosje deri në shkëputje dhe bashkimin me vendin amë, Shqipërinë, e që ishte aspiratë e natyrshme shekullore e popullit tonë të martirizuar. Në vend që të viheshin me guxim në ballë të popullit tonë të shkretë e të dërmuar luftërash, masakrimesh e skamjeje, t'i prinin atij në rrugën e mëtejshme të çlirimit kombëtar dhe klasor (kur Jugosllavia shkeli të drejtat e premtuara, për të cilat populli ynë pat derdhur pa kursim gjakun e bijve të vet të shtrenjtë), tradhtarët Fadilj Hodza e Dzavid Nimani me shokë, parapëlqyen qyqarinë dhe pajtimin në heshtje me të gjitha të zezat që kishte përgatitur për shqiptarët klika titiste. Ata ishin këtu edhe kur zbriti dhe u shkel për më se 20 vjet flamuri shqiptar. (të verbërit: Pse edhe ata nuk kërkuan të ndaloheshin flamujt e kombeve të tjera në Jugosllavi – në emër të "internacionalizmit proletar" – siç bënë jugosllavët me shkabën tonë dykrenare?!) Ata nuk paraqitën kundërshtimin më të vogël as më 1947, ku u zbrazën drithnikët e Kosovës dhe populli ynë i uritur u detyrua të ushqehej me barishte, se kopallat e demagogjitë revizioniste nuk jepnin bukë. Për më tepër, tradhtari Xhevdet Hamza u ndodh në krye të detyrës për realizimin e aksionit famëkeq të armëve, më 1956, kur populli shqiptar u masakrua, kur dinjiteti i popullit tonë u kërcënua të ulej deri në baltë nga zullumet e gjakpirësve titistë-rankoviçistë. Qyqarinë e tyre nuk e preku as vajtimi i djepeve shqiptare, loti i nënave as malli i burrave shqiptarë, që u dëbuan nga vatrat stërgjyshore dhe morën në sy shkretëtirat e Anadollit. Tradhtarët ishin gjithnjë këtu, të pranishëm kudo, si biberi në tavë dhe bënin jetën e tyre të rehatshme në kushtet e "vëllazërim-bashkimit" të xhelatit me viktimën. Dhe për këtë merrnin shpërblim racionin e turpshëm prej sahanlëpirësish; së pari në triska të majme për ushqim e veshmbathje, pastaj në shtëpi të mëdha e apartamente, e më pastaj në vila e vetura.

Kur krimet individuale e masive të ushtruara nga klika titiste mbi popullin tonë, s'e prekën dot atë lëkurë bualli-mamuth të renegatëve shqiptarë, marrëzia më e madhe është të pritësh prej tyre që të preken nga pabarazitë ekonomike, shoqërore e kulturore nën regjimin titist. Në qoftë se të ardhurat kombëtare në Kosovë janë gjashtë herë më të vogla se ato në Slloveni, kurse zhvillimi i Kosovës bëhet me një ritëm 106 për

qind në zotimet e jugosllavëve, në qoftë se papunësia te ne është njëzet herë më e madhe se ajo në Slloveni dhe krahu i lirë i punës derdhet varë-darë nga Kosova nëpër republikat e Jugosllavisë dhe në shtetet Perëndimore. Në qoftë se në Kosovë punohet në zhvillimin e një industrie nxjerrëse, që e pasuron Beogradin dhe jo të një industrie përpunuese – që do të pasuronte Kosovën, nëse fshatarësia kosovare është varfëruar deri në kufirin e zisë së bukës dhe rënkon në kushtet e një jete asociale, në qoftë se gruaja shqiptare ka mbetur edhe në fund të shekullit XX në errësirën mesjetare, e diskriminuar nga aspekti shoqëror dhe familjar, në qoftë se, më në fund, ky mjerim përjetohet në përmasa të shumëfishuara në viset shqiptare në Maqedoni, Serbi e Mal të Zi, ç'kanë të bëjnë të gjitha këto me renegatët shqiptarë!!! Ata e kanë kolltukun e tyre, kanë pallatet dhe veturat, kanë rrogat e tyre të majme, si gjithë funksionarët dhe borgjezia jugosllave. Dhe, mbi të gjitha – nëse popullit i ka ardhur shpirti në fyt dhe ngre zërin e tij të fuqishëm për të kërkuar bukë, të drejta e liri, kushte të njëjta a të përafërta me popujt e tjerë të mozaikut jugosllav, me të cilët e lidhin "vëllazërimi" e "bashkimi" – tradhtarët e kanë në dorë milicinë dhe ushtrinë. Natyrisht, jo për të për të përkrahur interesat e kërkesat e popullit, po për t'i shtypur në gjak ato. Dhe, kur të mos u mjaftojnë milicia e ushtria e stacionuar në tokat shqiptare të robëruara, ata mund ta thërrasin edhe milicinë dhe ushtrinë e Beogradit. E dinë se, për të bërë zap shqiptarët, Beogradi nuk kursen ushtri as milici. Tanke as avionë. Helikopterë as municion.

Kjo gjë, ç'është e vërteta, dihej mirëfilli. Ishte parë në ngjarjet e 1945-ës e në ato të 1968-ës. U pa edhe në tragjedinë më të re të Kosovës, në mars e prill.

Por, nuk dihej një gjë tjetër. Megjithë besnikërinë e tyre të pashoqe ndaj Beogradit, tradhtarët shqiptarë si Dzavid e Mahmudi, a e meritonin ata që Beogradi t'i nxirrte në rrugën e madhe? Dyzet vjet luftë antishqiptare të shkurtabiqit-bullafiq Dzavid Nimani nuk i siguruan atij as një pensionim të rehatshëm nga gospodari! Si qen i zgjebosur e i shogur i stanit, të cilit i janë rralluar të lehurat dhe i është dobësuar nuhatja, ai u detyrua të lërë stanin e kaçorren, të lërë koritën dhe qullin e përbashkët me qentë e tjerë të gospodarit. Ç'mund të bënte për Beogradin më shumë seç ka bërë, i shkreti Dzavid! Stazhi më se 10 vjeçar i shërbimit të Mahmudit qe vërtet më i shkurtër, po ky ishte një qen me dresurë dhe shërbimi i tij – shumë më intensiv e efektiv. Megjithatë, edhe Mahmudin e hodhi në shportë Beogradi si lëvoren e limonit të shtrydhur.

Po pse?

Edhe budalla e di se ajo që kërkon aktualisht prej tyre Beogradi, nuk është më fare në mundësinë e tyre. Populli i robëruar shqiptar kishte nevojë të madhe t'ia qanin hallet e t'ia mjekonin plagët e mëdha, që ishin pezmatuar sa s'bën më. Kurse Beogradi kërkon që renegatët shqiptarë t'i flasin këtij populli ashtu si i kanë folur qe 40 vjet, me demagogji, frikësime e shantazhe, Kërkon që ata të injektojnë edhe më në popullin shqiptar po ato mendime që kanë Beogradi, Mahmudi e Fadilji. Por, kjo është e kotë. Aq e kotë , sa do të kish qenë e kotë sikur shqiptarët të kërkonin nga Beogradi që ky t'ua japë falas ato të drejta e liri, të cilat s'fitohen veçse me luftë këmbëngulëse e me gjak.

Duhet të jesh i verbër fare nëse nuk sheh se s'qitet më në krye me shqiptarin. Ka ndodhur diçka e re me të. Ai gjithmonë e ka urryer regjimin antipopullor jugosllav, i cili mban nën thundrën e vet të përgjakshme edhe popujt e tjerë të këtij mozaiku artificial, por dëmton veçanërisht shqiptarin. Po sot kjo urrejtje ka dalë haptazi dhe është bërë mur i pakapërcyeshëm për pushtuesin dhe tradhtarët e vendit. Në ngjarjet e marsit e të prillit, populli ynë tha njëherë dhe përfundimisht: Jo! Kjo i kushtoi gjak. Ndërmjet nesh dhe qeverisë së Beogradit tani ka hyrë gjaku i bijve të shtrenjtë të popullit tonë. Dhe ky gjak është ai që i fshin të gjitha perspektivat e kthimit në gjendjen e mëparshme. Beogradi kërcënohet haptazi me gjakderdhje të re. Por s'i bën dobi. "Zemra jonë ka gjak sa gurra".

Dhe mbi gjakun e derdhur forcohen edhe më shumë themelet e vetëdijes kombëtare e klasore të shqiptarit të robëruar. Ndjenja e fuqishme e lirisë e ka bashkuar popullin tonë trim si një trup të vetëm. Me tanket e aeroplanët, me helikopterët e mitralozët, me ushtrinë e milicinë speciale, Beogradi s'bëri gjë tjetër pos që dogji etapat e luftës sonë të pashmangshme dhe na ndihmoi shumë në afrimin sa më të shpejtë kah dita e fitores së sigurt.

E di mirë Beogradi se nuk gjendet dot ilaç për ta shëruar te populli ynë kujtimin e vrasjeve e të plagosjeve, as akullin e burgjeve të kësaj pranvere.

Por, këtë sikur nuk po e dinë ca tradhtarë të rinj që pushteti i ka futur në lojë si kartën e fundit. Kryesia e Serbisë e pat thënë që në fillim të prillit se disa udhëheqës vasalë kosovarë si Fadilji, Dzavidi e Mahmudi "janë të pjekur për t'u larguar nga skena politike". Kjo i gjeti tashmë Dzavidin e Mahmudin, pritet të gjejë edhe Fadiljin. Nga ana tjetër, kur populli shqiptar shtroi çështjen e republikës së federuar të Kosovës, ishte e vetëkuptueshme që, kur të shpallej republika, nga postet e tyre duhej të binin dhe të merrnin nga populli dënimin e merituar të gjithë ata udhëheqës e kriminelë kosovarë e jugosllavë, që aprovuan apo urdhëruan gjakderdhjen në Kosovë. (Si mund të jetojë shqiptari nën shkopin dirigjues të atij që i vrau, i plagosi e i burgosi bijtë më të shtrenjtë?) Tani plaga po pezmatohet gjithnjë e më shumë, sepse Beogradi, i vetëdijshëm për krimet e deritanishme dhe për rrugën e krimeve më të mëdha që ka ndër mend, emëroi në vende kyçe të pushtetit krahinor renegatë të rinj shqiptarë me kondicion edhe më të madh për tradhti të reja. Garnitura e vjetër e tradhtarëve të urryer u zëvendësua këmbadoras me një garniturë findo të re tradhtarësh që çirren si të flamosur, duke pandehur se do ta frikësojnë e ta përulin një popull që kurrë s'është përulur, e përulet aq më pak sot që ka vendosur të luftojë pa u zmbrapsur për të drejtat dhe liritë e veta.

Tash që s'ka bukë, dhe shteti ka hartuar plane për një "otkup" të ri, këta renegatë të rinj thërresin: "Mirëqenia", "Begatia"! Kur populli kërkon me të drejtë, republikën që e kanë të gjithë popujt e tjerë të Jugosllavisë, ata thërresin: "E kemi republikën – Serbinë". Kur begatitë tona plaçkiten pa mëshirë dhe marrin rrugën e Beogradit, ata thërresin: "Vëllazërim-bashkim"!. Kur ushtria e milicia fashiste mbulojnë në gjak Kosovën, duke shkelur mbi popullsinë e pambrojtur, ata çirren: "Të distancohemi nga nacionalistët, shovinistët, reaksionarët e kundërrevolucionarët shqiptarë, që duan të rrezikojnë revolucionin dhe integritetin territorial të Jugosllavisë"! Me një fjalë, ata thërresin si qyqarët më të mëdhenj të kësaj bote për një nënshtrim akoma më të madh të popullit tonë, për t'u pajtuar me humbjen edhe atyre pak të drejtave formale që kishin deri më tash në Serbinë. Ata e thërresin kështu popullin shqiptar që ky, me sy në ballë, t'ia hapë vetvetes me duart e veta varrin e sigurt.

Ku e shohin vallë perspektivën këta renegatë të rinj? Ata s'e kanë as përvojën e paraardhësve të tyre, e kushtet kur u ngjitën në skenë janë pakrahasueshëm më të ndërlikuara se ato kur mbretëronin renegatët e vjetër. . Për pushtuesit jugosllavë, shërbime më të mëdha se Fadilji, Dzavidi e Mahmudi nuk mund që nuk mund të bëjnë. Kurse populli shqiptar jo vetëm nuk po frikësohet nga shantazhet e tyre, po përditë po i konsolidon më shumë radhët e veta, po e forcon frontin e luftës e të hakmarrjes së madhe popullore.

U mbetet një mundësi e vetme tradhtarëve të çirren e të përpëliten si peshku në zall, e kur t'i shtrydhë deri në fund pushtuesi e t'i hedhë në rrugë, atje t'i presë dora hakmarrëse e popullit.

Të mjerët tradhtarë, ç'po u përgatit populli! (Liria" nr.4-5 gusht 1981, faqe 12 dhe 17)

55. SHQIPJA BËN EDHE PA GJËMË, I MJAFTON LAVDIA

1.
Fshati ruante të kaluarën,
Fshati donte ardhmërinë,

Pa pranga ta shihte Kosovën,
Në liri t'ia ndiejë dashurinë,

Këngët për Azemin rriteshin,
Shtrëngoheshin armët në gji,
Në kulla historia shpalosej,
Në zemra gufonte liri!

Dhe bashkë me atë madhërim armësh,
Kumbonte ëmbël çiftelia,
Në kujtimin e gjallë të Shotës me trimat,
Rritej në Shpresë e tërë Drenica,

Këndej erdhën e thyen qafën panumër ushtri,
Turpin e tyre e namin tonë lanë pas,
Lindjet përherë më të dashura bëheshin,
E flamuri valonte në Prekaz,.

2.
Por në prag të një stuhie,
Në gardh të fshatit vuri putrat,
Ujku i vjetër prej Serbie,
Hallakati të gjitha kullat,

Në gjëmë u mblodh fshati atë natë,
Qeni serb në rrugë u shçir,.
Na rrethuan, babë Nebih!
Na rrethuan, bir Tahir!

Dhe hungroi zë' i tradhtarit
E i lëndoi trimat në zemër:
"Dorëzohi, se s'ka tjetër"
U tha, e i thirri vrazhdë në emër,

"Qërou, shpirt i shitur, ik!"
Që nga kulla plaku tha:
" Le të vijnë milicët serbë,
Kemi punë vetëm me ta."

"Me këto duar do t'ju lidh"
Po i nxehte fjalët tradhtari,

“Gjithmonë preja i takon,
Atij që e zë i pari.”

Shkrepi flakë pushk’ e Tahirit
Merr tradhtarin në lule të ballit
“ Vafsh në pleh, qen i mallkuar,
O qelb e plagë e shqiptarit!”

Sakaq dhe fshati me milicë,
Si korba të zeza, u resh i tëri,
Por, a tunden muret e kullës?
A dridhet në dorë të trimit, maliheri?

Një ditë e gjatë, pa fund, luftimesh,
U ngrys e kafshuar nga pabarazia.
Njëri tabor – dy pushkë te frengjia,
Tabori tjetër – me tanke ordia!

3.

Kot qëllonin tanket murin,
Kot murtaja rrahte çatinë,
Këndej qëndresa më e fortë bëhet,
Andej fashistët një pas një bien

Mbahu Prekaz, ti kullë graniti,
E tërë Serbia të ka marrë në thumb!
Është po ai serb prej shovinisti,
Që me ty lufta i shkoi në lumë.

“Të fortë e kemi kullën!”
Te frengjia i qeshi buza plakut
Të fortë e kemi Kosovën.
Ne po biem, po kush na e merr hakun.”

Në atë çast mbi kullë gjëmoi,
Një i paudhë helikopter,
Dhe plaku ra, po në dorë të Tahirit,
Këpuste breshërima njai maliher,

Prite Prekazin, o bishë e ndytë,
Në pancir e veshur e me tankun shok!
S’më le vend tjetër të të qëlloj, pos sytë,
Dhe më kapardisesh si një maçok

S’të thanë, kur u nise, në Beograd,
Se dhe njëherë këtu, në Drenicë,
Kur u vërsulën çetnikët e tu,
Mes vetullave i qëlloi Murseli sakicë?

Dhe vazhdoi lufta, e gjatë e rreptë.

Dhe u drodh trimi, pa të shtrirë plakun
“Duhet të tërhiqem, të çaj rrethimin,
Shumëfish t’ia marr Prekazit hakun.”

Po drit’e hënës e tradhëtoi,
Mbi maliherin kur i ra,
Nga mitrolozat në duar barbare
U shtri skaj prozhmit, Tahiri, u vra.

4.
Dhe s’lanë t’u bëhej as gjëma trimave,
Të vrarët e vet vajtonte Serbia.
Ndër mote, pra, atyre le t’u mbetet gjëma,
Shqipja bën edhe pa gjëmë, i mbetet lavdia

Këndej erdhën e thyen qafën panumër ushtri,
Turpin e tyre e namin tonë lanë pas,
Dhe lindjet përherë më të dashura na bëhen,
Dhe shqiponja e lirë në Prekaz.

(“LIRIA” , nr. 4-5; gusht 1981, faqe 23)

56. TË MBLIDHEMI RRETH FLAMURIT FITIMTAR TË POPULLIT TONË TË BASHKUAR

"KUSH NUK DERDH NJE PIKE GJAKU PER TOKE TE VET, KUSH NUK JEP ASNJE QINDAR PER TE, AI S'KA TE DREJTE AS TE VARROSET NE TE."
Sami Frashëri

Sot zbresin pa pushim në Kosovë ministra e funksionarë të lartë republikanë e federativë, japin udhëzime për shtypje e represalje dhe kthehen me ngut në Beograd, për të kurdisur plane të reja antishqiptare. Gjithë aparati propagandistik jugosllav, ai i Lidhjes Komuniste., i Lidhjes Socialiste, i Lidhjes së Rinisë, mjete të shumta informimi në Jugosllavi e Kosovë shpifin e bërtasin kundër shqiptaiëve, shajnë popullin e Kosovës dhe tokën e Kosovës si „tokë të mallkuar", shajnë nënën shqiptare pse lindi aq shumë trima...

Frenat e qeverisë e të luftës kundër shqiptarëve i kanë marrë në dorë shovinistët më të tërbuar jugosllavë, të cilët po përdorin pa kursim të gjitha mjetet e dhunës dhe terrorit për të gjunjëzuar popullin shqiptar, për të njollosur luftën e tij të drejtë dhe për të diskreditуar bijtë e tij të vërtetë marksistë-leninistët dhe revolucionarët e patriotët shqiptarë, që po qëndrojnë me heroizëm të rrallë përballë masave të egra ndëshkuese të gjakpirësve jugosllavë.

Populli ynë u ka dhënë një grusht vdekjeprurës forcave të errëta shoviniste të Jugosllavisë. Të bashkuar e të vendosur deri në fund për luftën e vet të drejtë, shqiptarët e Kosovës, me demonstrata e greva,me aksione të njëpasnjëshme, po edhe me rezistencë pasive, e kanë shtjerrë deri në pikë të fundit qetësinë dhe urtinë e qeverisë shoviniste të Beogradit. Asnjë aksion i serbomëdhenjve në pushtet, pa marrë parasysh kahjen e qëllimin, nuk po mun të realizohet, edhe rise organeve u janë vënë në dispozicion forca e mjete të shumta. Kjo ka bërë që tërbimi shovinist të rritet jo vetëm nga dita në ditë, por edhe nga çasti në çast.

Të hutuar përballë qëndresës së pashoqe shqiptare, shovinistët e kanë humbur fare kokën dhe gjithë punën e kanë çuar në një qorrsokak nga i cili e kanë vështirë të dalin. Çdo masë që po ndërmarrin ata kundër shqiptarëve të revoltuar, në vend që ta qetësojë e frikësojë, po e pezmaton dhe po e trimëron edhe më shumë popullin tonë të robëruar. Tani edhe vetë jugosllavët janë të bindur se, ose do të duhet t'ua plotësojnë të gjitha kërkesat shqiptarëve, ose do të detyrohen ta mbajnë vazhdimisht në Kosovë, në gjendje gatishmërie, milicinë dhe ushtrinë e shumtë jugosllave. Mirëpo tërbimi ua ka errur sytë dhe ata sot nuk po janë në gjendje të zbatojnë mjetet e urtisë e të gjakftohtësisë së domosdoshme, po vetëm forcën e armës dhe të demagogjisë.

Ndërkohë, duke hetuar shembjen e truallit nën këmbë, shovinistët serbomëdhenj kanë bërë përpjekje të ethshme për ta pushtuar kalanë për së brendi, për të thyer unitetin e shqiptarëve, duke aktivizuar në mënyrë të paparë rrjetin e gjerë të spiunëve dhe të agjentëve, me përpjekje për një zgjerim të mëtejshëm të tij me njerëz frikacakë, të pavetëdijshëm e të mashtruar.

Tani, me anën e këtij mjeti të stërnjohur të përçarjes, të cilin e kanë përdorur edhe më parë shovinistët serbomëdhenj po përpiqen mëkot të arrijnë ato rezultate në nënshtrimin dhe gjunjëzimin e shqiptarëve, të cilat nuk i arritën dot me tanke e aeroplan, me automatik e kërbaç; as me burgun e zi. 30 000 forca të reja ushtarake e policore kanë zbritur nga Beogradi në Kosovë për ta bërë zap popullsinë e këtushme, qëkur shpërthyen demonstratat e marsit.

Në prezencën e nën kërcënimin e këtyre forcave po përpiqet borgjezia serbomadhe të detyrojë popullin për t'u deklaruar kundër dembnstratave. Por për popullin tonë është bërë e qartë se demonstratat ishin zëri i të drejtave dhe lirive të shkelura, kurse demonstrantët bijtë e vërtetë të popullit, që vendosën të thyejnë prangat e robërisë e të mjerimit. Kështu rinia, punëtorët, fshatarët dhe inteligjencia popullore tashmë janë bërë mur i pakapërcyeshëm për pushtuesin dhe po e vrasin atë me heshtje shkëmbi, pikërisht kur ky klith i lebetitur: "Dëno demonstratat!" Profesorët e universitetit Kosova janë bërë bllok dhe armiku s'ua nxjerr dot një fjalë, minatorët, punëtorët në fabrika e ndërmarrje gjithashtu. Madje, armiku i tërbuar po detyrohet të -spërndajë organizata të të tëra të LK në fshatra, ndërmarrje e institucione të ndryshme që po tregohen të pabindura. Kaq thellë që ka depërtuar ndjenja e lirisë e kaq shumë që është brumosur bashkimi i popullit.

Një gjë që e krenon shumë situatën aktuale në Kosovën tonë kreshnike është ilaçi që i doli papritmas një dukurie shumë të dëmshme në jetën e shqiptarëve të robëruar nga Jugosllavia: hakmarrjes dhe vëllavrasjes. Ky ilaç u përfitua nga qëndresa e pashembullt e popullit tonë karshi zullumeve të padurueshme që po sheh ky pupull nga shovinistët serbomëdhenj që nuk ngurruan as të shkelin me tanke e të grijnë me mitraloza edhe fëmijët shtatë vjeç.

Siç e dimë, vëllavrasja mes shqiptarëve, e kushtëzuar nga rrethanat politko-shoqërore nën regjimin e egër titist dhe e stimuluar në shumë mënyra si mjet efikas për përçarjen e popullit tonë të shumëvuajtur, vazhdimisht rrinte varur si një kërcënim i madh mbi kokën e çdo shqiptari.

Por, shpërthyen demonstratat e marsit dhe të prillit. Studentët, rinia, inteligjencia popullore, punëtorët dhe fshatarët, me një fjalë mbarë populli ynë, u çuan në këmbë dhe kërkuan të drejtat e ligjshme, të mohuara nga regjimi jugosllav për më se 40 vjet. Mirëpo, kërkesave tona për bukë për më shumë të drejta e liri, qeveria e Bogradit u tregua shumë e gatshme t'u përgjigjet me gjuhën e çelikut dhe të barotit. Populli shqiptar e pa se me çfarë lehtësie e papërgjegjësie shkelte tanku serb mbi trupat e fëmijëve, pleqve dhe të të rinjve shqiptarë. Dhe, duke u gjendur përballë tërbimit të këtij përbindëshi, populli ynë

duarthatë e i pambrojtur, por në rrugën e drejtë të mbrojtjes së të drejtave dhe të lirisë, e kuptoi menjëherë se arma e tij e vetme po më e fuqishmja, është bashkimi. E kuptoi se vëllavrasjes dhe hakmarrjes duhet t'i shkelet menjëherë koka si gjarpërit.

Prandaj, si në kushtet karakteristike të luftës, kur pushojnë së vepruari shumë ligje e dukuri shoqërore që kanë vepruar dendur në kohë paqeje, ashtu te populli ynë pushuan së vepruari shumë ligje e dukuri shoqërore. Dje, të hasmuar, kishin kërkuar t'i pinin gjakun njëri-tjetrit, sot po merren ngrykë me njëri-tjetrin. „Hasmin" e deridjeshëm po e quajnë me emrin e vërtetë - vëlla. Ata falën gjaqet e kusuret dhe u lidhën vëllazërisht,sepse kuptuan që koha kërkonte tjetër luftë, luftë me armikun e vërtetë.

Kjo gjë i dha një dimension të ri, revolucionar e shumë human, luftës sonë nacionalçlirmtare.

Përveç kësaj, në rrethanat e egra kur pushteti kërkon nga fshatarët që të bojkotojnë e të leçitin familjet e pjesëmarrësve në demonstrata dhe në ngjarjet e tjera të kësaj pranvere, populli po ia kthen mbrapsht porositë, kërkesat dhe urdhërat armikut të tërbuar. Fshatarët tanë të ndershën, të pezmatuar sa s'ka më, në vend që të leçitin familjet e pjesëmarrësve në demonstrata, ashtu si kërkon prej tyre pushteti, po leçitin gjithë atë njeri dhe gjithë atë familje që provon ta çojë në vend urdhrin dhe porosinë e tillë të egër të UDB-së.

Këto dhe dkuri të tjera, të cilat janë pasqyrë e gjallë e unitetit të pathyeshëm që është arritur sot te masat tona punonjëse dhe te mbarë populli ynë flasin qartë se lufta jonë dita ditës po i afrohet me hapa të mëdhenj fitores së sigurt.

Duke parë se me popullin në Kosovë e ka humbur davanë, qeveria e Beogradit, nëpërmjet përfaqësive të saj diplomatike që janë çerdhe agjenturore të Jugosllavisë në botën e jashtme, po rropatet të fusë frikë, konfuzion e përçarje së paku në mesin e punetorëve kosovarë në mërgim. Këtë qëllim shovinistët serbomëdhenj po duan ta realizojnë me frikësime e shantazhe. Bie fjala, për të vazhduar pasaportin, punëtori kosovar i mërguar detyrohet të tregojë shokët që kanë marrë pjesë në deonstratat e punëtorëve të zhvilluara këto kohët e fundit në botën e jashtme. Përpjekje për t'i kërcënuar ata me marrjen e pasaportit ka bërë UDB-ja me punëtorët tanë të mërguar që kanë shkuar në shtëpi për pushime. Bile, një pjesë të tyre e ka hedhur edhe në burg, tok me ata dhjetëra mijëra shqiptarë të tjerë që përgjigjen pse kanë marrë guxim të kërkojnë me zë të lartë të drejtat më të ligjshme.

Përveç kësaj UDB-ja ka bërë përpjekje të etshme që, nga radhët e disa shqiptarëve të pavetëdijshëm, të ligj a të mashtruar, të rekrutojë spiunë e agjentë. Këta kishin për detyrë të bojkotonin e të provokonin demonstratat e punëtorëvë shqiptarë në mërgim marrjen e klubeve në duart e punëtorëve dhe dëbimin e përfaqësuesve diplomatikë jugosllavë nga këto klube.

Por, asgjë nuk i ndal më punëtorët tanë në rrugën e tyre të drejtë. Ata janë pjesë përbërëse e popullit shqiptar që po shtypet nga çizmja e ushtarit dhe nga kërbaçi i xhandarit fashist jugosllav. Ata ndjekin hap pas hapi zërin e popullit e të Atdheut dhe përditë e më shumë ata i gjen të gatshëm t'i dalin zot popullit qoftë me demonstrata, me marrjen e klubeve në duart e veta apo me mënyra të tjera që i lyp koha e nevoja.

Fatkeqësisht janë disa punëtor të mërguar që, duke pasur një vetëdije fare të ulët shoqërore e kombëtare duke qenë përveç kësaj edhe të lig kanë pranuar urdhrat e porositë e UDB-së fashiste dhe ia kanë kthye shpinën popullit e atdheut të vet. Por është gjithashtu e vërtetë se punëtorët tanë në mërgim kanë arritur t'i izolojnë e neutralizojnë në mënyra ndryshme këta spiunë e agjentë të fëlliqur. Ata i njeh mirë punëtori ynë dhe e di si do t'i qërojë hesapet me ta kur të vijë momenti i duhur.

Marksistë-leninist e Kosovës, të tubuar rreth organit "Liria", duke pasur parasysh interesat klasore e kombëtare të popullit shqiptar që vuan nën zgjedhën e rëndë fashiste jugosilave, duke pasur parasysh unitetin e pashembullt që është arritur te populli ynë në Kosovë, të gjithë ata njerëz të mashtruar e të frikësuar po që ende nuk janë zhytur në krime ndaj popullit, i fton të braktisin rrugën e tyre të pakrye, të kthejnë mbrapsht me trimërinë e njohur shqiptare urdhrat e UDB-së e të përfaqësive diplomatike jugosllave në Perëndim. Le t'i kthehen sa më parë nevojës së atdheut e të popullit që i lindi dhe i rriti me njëqind mundime.

Ndryshe, kur të fillojë me goditje dora hakmarrëse e popullit, do të jetë i humbur gjithë ai shqiptar që ka braktisur interesat e popullit, gjithë ai shqiptar që, për interesa të imta e të fëlliqura, vazhdon t'i shërbei armikut të egër shovinist edhe pas ngjarjeve tragjike të kësaj pranvere në Kosovë. Populli ynë do t'u marrë gjak në vetull. Atdheu do t'i lërë pa nam e nishan. Varret e tyre dot'i shpupurishin qentë nëpër varreza të huaja rrugëve të shkreta të botës. Sepse, siç thotë patrioti dhe dijetari ynë i madh, Sami Frashëri atdheu nuk duhet t'i japë as varr atij që nuk e ka dhënë për atdhe pikën e djersës apo të gjakut kur ka qenë nevoja.
Rroftë uniteti i popullit ne realizimin etë drejtave dhe aspiratave të tij shekullore!
Rroftë Republika Socialiste e Kosovës!
Poshtë politika dhe terrori i egër fashist i qeverisë nacionalsoviniste tt Beogradit!
Poshtë agjentët dhe spiunët që vënë në shërbim të gjaksorit!

57. K O M U N I K A T E
e Komitetit Qendror të LEVIZJES NACINALÇLIRIMTARE TE KOSOVËS

Për të fshehur shkakun e vërtetë të demonstratave dhe trazirave të sivjetme në Krahinën e Kosovës, skamjen e mjerimin, shtypjen nacionale, sociale e kulturore të popullsisë vendëse, qeveria shoviniste e Beogradit, me kryepolicin Herleviç në krye, u hodh në të katër anët për të kurdisur arsye të paqena, si ”romantizëm nacional” dhe ”nacionalizëm e shovinizëm shqiptar” si dhe për të gjetur ”organizatorin” e demonstratave, duke fajësuar herë një ”grup huliganësh”, herë ”ekstremistët” shqiptarë, (duke pasur në këtë rast parasysh Marksistë-Leninistët e Kosovës) herë organizatën Fronti i Kuq Popullor etj., në mënyrë që pastaj të kthehet e t’ia ngarkoj fajin kryesor Republikës popullore Socialiste të Shqipërisë.

Ndër ”organizatorët” e shumtë, kryepolici Herleviç, zuri ngoje edhe organizatën tonë patriotiko-revolucionare me emrin Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës, duke e fajësuar atë për shumë ”vepra” që nuk përkojnë aspak me veprimtarinë e saj.

E kemi parë të udhës që pasi, pasi në mjetet e informimit publik të Perëndimit u publikuan ”informatat” e përpunuara nga agjencitë gazetare jugosllave, t’ju drejtohemi me një kërkesë demokratike edhe ne: për dezinformimet e ndryshme rreth ngjarjeve tragjike të Kosovës; ne do të kishim pasur një satisfaksion, po që se do ta transmetoni në organet tuaja edhe këtë komunikatë nga ana e Komitetit Qendror të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës.

1. Demonstratat e Kosovës të këtij viti nuk i ka organizuar LNÇK. Ato kanë shpërthyer spontanisht, së pari në Universitetin e Kosovës, e pastaj janë përhapur në të gjitha viset e Kosovës. Shkaku dhe arsyeja e shpërthimit të tyre nuk mund të kërkohen askund tjetër, pos në revoltën e grumbulluar me dhjetëra vite te popullsia shqiptare për

shkak të skamjes, mjerimit dhe padrejtësive nacionale që i bëhen popullit tonë nga ana e qeverisë shoviniste të Beogradit.

2. Kërkesa për t'iu njohur Kosovës statusi i republikës së federuar jugosllave nuk është kërkesë e LNÇK. Organizata jonë lufton për çlirimin e tokave shqiptare të pushtuara nga Jugosllavia dhe bashkimin e tyre me vendin amë, Shqipërinë, dhe kështu për krijimin e shtetit unik shqiptar brenda kufijve kombëtarë. Kjo shihet nga Statuti dhe Programi, nga të gjitha dokumentet e LNÇK të botuara në organet "Zëri i Kosovës" dhe "Lajmëtari i lirisë", si dhe në të gjitha traktet tona.

Kërkesa për republikën e Kosovës është kërkesë e një pjese të inteligjencies së Kosovës. Çështja e saj është shtruar më herët, sidomos më 1968. Pasi ajo u refuzua nga ana e Titos dhe e qeverisë jugosllave, në Kosovë patën shpërthyer në nëntor të vitit 1968 demonstrata të fuqishme. Edhe atëherë edhe sot, kjo kërkesë u përkrah nga mbarë populli shqiptar në Jugosllavi. Por, LNÇK mbetet pranë kërkesës së saj të vetme – luftës për bashkimin e ligjshëm të të gjitha trojeve shqiptare të robëruara nga Jugosllavia dhe bashkangjitjen e tyre shtetit amë.

3. Nga Statuti, Programi dhe të gjitha dokumentet e LNÇK del qartë se ne nuk e aprovojmë dhe nuk e aplikojmë asnjë formë terrori dhe anarkie. As sot LNÇK nuk merr përsipër as përgjegjësinë më të vogël për aktet e "terrorit" e të "anarkisë", që i trumbeton me të madhe policia sekrete jugosllave, siç është djegia e ndonjë fabrike a ndërmarrjeje, përdhunimi i monumenteve kulturo-historike, i varrezave serbo-malazeze etj. Madje, sipas bindjes sonë, janë as më shumë e as më pak se aksione subversive të njerëzve të UDB-së. Qëllimi i tyre është justifikimi i vrasjeve, plagosjeve, arrestimeve, burgosjeve dhe terrorit të paparë mbi popullsinë tonë. Në këtë drejtim Jugosllavia, si para ashtu edhe pas Luftës së Dytë Botërore, ka pasur një traditë të gjatë. Lidhur me inskenimin e akteve të terrorit e të anarkisë nga ana e qeverive jugosllave, akte që pastaj i janë mveshur popullsisë shqiptare, mjafton të shikohet elaborati i serbomadhit Vasa Çubriloviç "Shpërngulja e shqiptarëve", i cili përmban një arsenal të pasur udhëzimesh për aplikimin e metodave më barbare, nga të cilat do të duhej të rezultonte çrrënjosja e shqiptarëve nga tokat e tyre brenda kufirit administrativo-politik të Jugosllavisë. S'ka dyshim se në kontekst të kësaj "vepre" duhet të shihen edhe brengosja e Jugosllavisë për shpërnguljen nga Kosova të elementit serbo-malazez, edhe zhurma e madhe rreth prishjes së varrezave dhe të përmendoreve kulturo-historike në Kosovë.

Këto metoda nuk janë në traditën dhe në mënyrën burrërore të luftës ballë për ballë që kanë bërë me shekuj shqiptarët edhe atëherë kur armiku ka qenë dhjetë fish më i përgatitur, numerikisht e teknikisht. Përkundrazi, për 500 vjet të sundimit turk, ishin pikërisht shqiptarët ata që mbrojtën tradicionalisht përmendoret kulturo-historike në territorin e tyre, pa marrë parasysh se cilit popull i takonin ato. Deri më dje serbët nuk kurseheshin në lavdatat e tyre për popullsinë shqiptare të Rrafshit të Dukagjinit, që mbrojtën Patrikanën e Pejës dhe Manastirin e Deçanit nga të gjitha stuhitë dhe luftërat e shumta të zhvilluara në këtë terren.

Shqiptarët e Jugosllavisë, kur ka qenë nevoja, e kanë mbrojtur edhe me armë elementin e këtushëm serbo-malazez. Por qeverisë shoviniste të Beogradit nuk i leverdisë ta pohoj këtë në momentin aktual, edhe pse me siguri, asgjë nga e kaluara nuk do të ketë harruar. (Neve na indinjon thellë fakti se as kryepolici Herleviç as ndonjë tjetër nga udhëheqja jugosllave, derisa hakërrohen mbi shqiptarët, nuk u kujtuan të përmendnin së paku një herë problemin e shpërnguljeve të mëdha të shqiptarëve nga Kosova dhe viset tjera shqiptare, por kanë marrë në dorë kamxhikun e kërcënimeve për shkaktarët e shpërnguljes së serbo-malazezëve; "çudi", si nuk e publikuan asnjë rast të prishjes së

varrezave të serbomalazezëve, kur hetimet treguan se këso veprash ishin kryer pikërisht nga bandat e aktivizuara çetnike dhe nga vetë njerëzit e porositur të UDB-së!)

Në fund ju njoftojmë se Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës është një organizatë patriotiko-revolucionare që lufton me mjetet më demokratike që janë përdorur ndonjëherë në Evropë. Terrori, anarkia e revanshizmi kanë qenë dhe mbeten metoda, jo vetëm të huaja por edhe të urryera e rreptësishtë të ndaluara për çdo anëtar dhe simpatizant të Lëvizjes sonë. /Korrik 1981, Untergruppenbach

Kjo komunikatë u përpilua nga Jusuf Gërvalla e Xhafer Durmishi dhe u nënshkrua
Komiteti Qendror i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës

58. Fjalë më 28 Nëntor 1981 në Shtutgart

Kemi dëgjuar të flitet, se si në një numër të "Zërit të Rinisë", i cili botohet në Kosovë, vite më parë diku nga viti 67, figuron një fotografi e Fadil Hoxhës, ku gjoja ai ka ngritur gishtin dhe nën fotografinë e tij qëndrojnë fjalët Republika e Kosovës. Qarkullojnë fjalë të themi të drejtën, se informata të sakta për ekzistimin e një fotografie të tillë, me fjalë të tilla nuk ekzistojnë. Mirëpo nga ana tjetër është përmendur fakti, se edhe udhëheqja kosovare, edhe populli kosovar, sidomos në vitin 68 dhe në vitin 1974, kanë paraqitur një kërkesë të tillë, për arsye, se një kërkesë e tillë ishte e logjikshme dhe e drejtë edhe para vitit 1981. Mirëpo po të nisemi nga angazhimi i Fadil Hoxhës, me kompani, me realizimin e të drejtave të ligjshme kushtetuese, për shqiptarët, që jetojnë në Jugosllavi, atëherë mund të themi, se edhe po të jetë bërë një kërkesë e tillë, që Kosovës t'i njihet statusi i Republikës nga Fadil Hoxha me kompani, ajo është shtruar në atë mënyrë, në mënyrën në të cilën shërbëtori shtron para zotriut një lutje dhe jo një kërkesë. Me këtë rast duhet të bëjmë një sqarim të qartë. Qeveria kuislinge e Kosovës, e cila ka tradhtuar me themel interesat e popullit shqiptar në Jugosllavi edhe po ta bëj kërkesën për një republikë apo çfarëdo të drejte tjetër kushtetuese e njerëzore, për shqiptarët në Jugosllavi, këtë kërkesë do ta bëj formalisht edhe do ta bëjë në formë lutje edhe posa të paraqitet problemi i parë, siç është paraqitur më 68, në se është e vërtetë ç'kërkesa, siç është paraqitur po ashtu në vitin 1974. Fadil Hoxha me shokët janë treguar të gatshëm, për t'u tërhequr sa më shpejt nga kërkesat e tilla.

Po ndryshon krejtësisht mënyra, ndryshon krejtësisht intensiteti, me të cilën rinia revolucionare dhe populli shqiptar në Jugosllavi e paraqiti kërkesën, që Kosovës t'i njihet statusi i Republikës, në pranverën e përgjakshme të këtij viti (mars 1981). Nuk është fare e vështirë, të thuhet se asnjë popull dhe kështu as populli ynë kurrë nuk ka mundësi të shtrojë kërkesa në rrugë të padrejtë. Prandaj mund të mendojmë dhe të jemi të kënaqur, të jemi shumë të gëzuar, që populli ynë diti ta bëjë kërkesën pikërisht në një kohë të tillë, kur edhe ekzistojnë kushtet më objektive për realizimin e saj, pa marrë parasysh viktimat, që u tregua e gatshme qeveria e Beogradit, të shkaktojë në radhët e popullsisë shqiptare, pa marrë parasysh reprezaljet, që ajo po merr kundër rinisë dhe popullit shqiptar, pa marrë parasysh këmbënguljen e saj, që me rrena, me demagogji, me shpifje e trillimet më të poshtra ta hedhë poshtë kërkesën, që Kosovës t'i njihet statusi i Republikës.

Dhe pyetje e tretë ishte, se deri kur do të presë populli, që të realizohet Kosova Republikë. Në pamundësi, që të zgjatemi, për arsye që nuk është e hijshme, që kjo tribunë këtu të shndërrohet në tribunë të dy-tre shokëve, po ne e kemi menduar si një tribunë të popullit, ku do të marrë pjesë ai që është i interesuar të bëjë një pyetje ose të parashtrojë një problem. Po të përpiqem t'i bie shkurt. Kjo pyetje, se deri kur do të presë populli, që të realizohet kërkesa Kosova Republikë, është çështje e objektivitetit. Populli në radhë të

parë nuk është duke pritur fare, për arsye se , këtu disa herë u tha sonte edhe mendojmë se, nuk do të mund ta mohojmë, që populli, me aksione të ndryshme, me parulla, me sabotimin e diferencimeve politike, me injorimin e tyre në çdo mënyrë, është duke marrë të gjitha masat që mos pajtohet me situatën të cilën ia imponon qeveria e Beogradit. Prandaj populli nuk është duke pritur, populli ka bërë një hap të drejtë, një hap të ligjshëm, ka bërë një hap, i cili tash i lejon atij që të kthehet edhe të presë përgjigjen përfundimtare të qeverisë shoviniste të Beogradit. Populli pa dyshim është ai, që e di më së miri deri kur duhet të presë që të realizohet kërkesa Kosova Republikë. Populli është i pagabueshëm!!! Unë, ti ai tjetri mund të gabojmë të gjithë me radhë, për arsye se jemi njerëz, jemi individ, kurse populli, i cili po tregohet kaq i durueshëm për realizimin e kërkesës, që Kosovës t'i njihet statusi i Republikës, pa kurrfarë dyshimi, do të dijë se deri ku shtrihen kufijtë e durimit, për fitimin e statusit të Republikës. Kosova Republikë!!!

Dhe ne, si bij të këtij populli, që jemi, kurrsesi nuk duhet ta vëmë mendjen në gjumë! Nuk duhet të kotemi, duhet të jemi sy qelë, ta masim pulsin e popullit dhe të presim prej tij, ato detyra, që na shtron ai! Të presim prej tij ato rrugë, që na përcakton ai dhe të jemi gjithmonë të gatshëm, që t'i përgjigjemi! S'ka kurrfarë dyshimi, se kur do të tregohet jo objektive pritja e mëtejshme, për kërkesën Kosova Republikë, populli do të dijë ta hedhë poshtë një kërkesë të tillë edhe të dal me kërkesë tjetër, me fjalë të tjera, me qëllimin e tij të fundit që është ka qenë dhe do të jetë bashkimi i gjithë shqiptarëve, bashkimi i ligjshëm i gjithë shqiptarëve në shtetin e tyre kombëtar!

(...) Se ç'ka do t'i sjell, çfarë të mira do t'i sjellë Kosovës statusi i Republikës, ne ose duhet të realizojmë (analizojmë) ta shtrydhim mendjen , të mendojmë ditë e natë. Kemi edhe disa pika të tjera si të mbështetemi edhe të logjikojmë pse një njeri i mençur thotë, se mendimi është e vetmja parajsë, prej së cilës nuk mund të na ndjekin. Ta zëmë se një pikë mbështetje prej të cilës mund të nisemi ne kur të analizojmë, se çfarë të mirash do të na sjellë statusi i Republikës për Kosovën, mund të drejtohemi konkretisht te armiku. Po të ishte kërkesa Kosova Republikë, një kërkesë boshe, një kërkesë në ajër, një kërkesë mendje lehtë, një kërkesë, të cilën e kanë bërë aventurierët, një kërkesë të cilën e kanë bërë, ata që ëndërrojnë pa baza, pa farë dyshimi se Beogradi, qysh më 11 mars të këtij viti, do të dilte me dokumentin për statusin e Republikës së Kosovës dhe do të na thoshte urdhëroni shqiptarë ja ku e keni Republikën! Por a është kështu, po e shohim që prej afër nëntë muajsh. Të gjitha forcat, gjithë plehun, gjithë vrerin shovinist të 74 vjetëve, qindra vjetëve më të përparshëm, Beogradi, tashmë e ka akumuluar, e ka grumbulluar, për ta shtypur kërkesën e Kosovës Republikë. Prandaj ne po duam ta vlerësojmë punën. Mund të nisemi edhe nga ky moment, po të ishte kjo kërkesë, një kërkesë me rëndësi të vogël, ose pa rëndësi, padyshim se Beogradi, do të shfrytëzonte rastin edhe do të na e bënte qejfin. Por është një kërkesë shumë vitale për popullin shqiptar dhe prandaj Beogradi, qeveria e Beogradit, si një qeveri shoviniste e tërbuar në kulm, na e mohon me aq këmbëngulje për arsye se , a do të mund të na mohojë apo jo do ta tregojë e nesërmja e shenjtë, se si do të mbarojë puna!

Po kështu kam edhe një përgjigje tjetër edhe një plotësim tjetër. Kur është fjala për saktësimin, se sa do të mund të na ndihmojnë forcat përparimtare, forcat internacionaliste në botë! Por sa do të mund të na ndihmojë vendi ynë amë Shqipëria Socialiste! Po ndalem te pika e parë, për forcat internacionaliste, nuk duhet të kemi iluzionin, se populli shqiptar, është populli më fisnik në botë, se populli shqiptar ka dallime të mëdha me popujt e tjerë në botë. Duhet të jemi realist dhe të themi se populli shqiptar është një prej popujve të botës, për të cilin vështirësitë, tragjeditë kombëtare, gjatë historisë e kanë prurë deri në këtë shkallë, sa ai sot të tregojë një afinitet për të qenë

një popull luftarak, për të qenë një popull fisnik, për të qenë një popull i cili respekton të drejtat e të tjerëve, i cili s'ka kurrfarë aspiratash për të shkelë të drejtat e të tjerëve, i cili shumë i donë dhe madje nuk mund të jetojë pa të drejtat e liritë e veta. Nëqoftëse populli shqiptar ishte në gjendje që në vitin 1936/37 të dërgonte njësitë të tëra me në krye heronjtë e popullit tonë, që ne sot i njohim, si Asim Vokshi, Xhemal Kada, Mehmet Shehu, Justina Shkupi e të tjerë në Front, në luftë për republikën e Spanjës, atëherë si mund të dyshojmë dhe nëqoftëse ne dyshojmë në forcat progresive të botës do të gabojmë për arsye se është një mori njerëzish progresivë njerëzish liridashës në botë, që lirinë e të tjerëve e respektojnë si lirinë e vet. Kurrsesi nuk duhet të dyshojmë në ndihmën që do të kemi nga forcat internacionaliste të gjithë botën, aq më tepër kur sot ekziston një pishtar, i cili është burim për energjitë e këtyre forcave përparimtare. E ky burim nuk është as më shumë e as më pak po pikërisht vendi amë i shqiptarëve pra i kosovarëve, ai që sot të gjitha forcave në botë, po jua tregon rrugën e drejtë të lirisë, të drejtësisë, njerëzisë, humanitetit, të demokracisë e socializmit.

Kur është fjala për pyetjen e tretë, që shtroi shoku natyrisht kjo është një çështje sa delikate aq edhe vitale, e rëndësishme për popullin tonë, jo vetëm për Kosovën, jo vetëm Maqedoni e Mal të Zi, por edhe për atë në Shqipëri, se siç tha më parë shoku emri Shqipëri, sot nuk është një emër të cilin nuk guxon ta prekë shqiptari, të cilin nuk guxon ta përmend shqiptari i Kosovës dhe përgjithësisht ai i Jugosllavisë.

Në një referat, në një punim, i cili u lexua sonte, u tha se një prej arsyeve të cilat Jugosllavinë e shtyjnë ta zhagisë kërkesën e kosovarëve për Republikë, është pikërisht përpjekja e Jugosllavisë, që edhe në momentin e ardhshëm, kur të shtrëngohet, të ja pranojë Kosovës statusin e Republikës, në atë moment të përpiqet, që Republikën e Kosovës, ta japë me kufij sa më të ngushtë! Mirëpo populli ynë, i cili derdhi gjakun në pranverë, që sot s'po pushon me aksione, që sot s'po pushon me parulla, i cili çdo ditë e më shumë po organizohet për ditë e më shumë, po del me veprime, që janë veprime karakteristike për një fazë të pjekur, ndoshta të kryengritjes popullore, jo të demonstratave të thjeshta, do të dijë të dalë përballë Beogradit, edhe kur është fjala për ngushtimin e kufijve të ardhshëm të Republikës.

Pa dyshim, thashë në fillim, se pyetja është delikate. Deri para pak kohësh kishte njerëz, që një atribut të tillë, do të thotë atributin e tradhtisë kundrejt kufijve të Kosovës, ja mveshin edhe Shqipërisë socialiste, duke thënë se ajo siguroi kufijtë e vetë dhe për vëllezërit e Kosovës, nuk deshi të dijë më tutje. Se sa ishte e vërtetë kjo parullë e përhapur aq më shumë e aq më pak përveçse nga Udbeja, u muar vesh sot. Sot e njëjta Jugosllavi, e cila deri më sot përhapte parulla se Shqipëria dhe PPSH-ja i kanë kthyer shpinën Kosovës, e njëjta Udbe sot përhap parulla , se si kërkesa për Kosova Republikë është kërkesë krye këput e Enver Hoxhës, i cili gjoja qenka përzier në disa punë të brendshme të Jugosllavisë.

Natyrisht se do të varet shumë edhe nga vëllezërit tanë në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Serbi, se sa do të ju afrohemi realizimit të kërkesave tona objektive plotësisht të ligjshme. Po të jetë puna te kosovarët, për ata që i kanë pjekur hesapet, ata që e kanë shtrydhur mendjen për luftën e kaluar në mars e në prill e për këtë që po vazhdon e sidomos për atë që do të vijë, këtu është shumë fjalë e rëndë, që flitet për ndonjë tradhti të tillë, që të flitet për ndonjë harresë kur është fjala për vëllezërit në Maqedoni edhe në Mal të Zi. Por natyrisht në drejtimin e asaj, që të realizohen të drejtat e ligjshme të të gjithë popullit Shqiptar në Jugosllavi, për përfshirjen e të gjithëve brenda kufijve të ardhshëm të Kosovës, kjo varet shumë siç thashë edhe më parë, nga vetë aktiviteti që do të zhvillojnë vëllezërit tanë në regjionet përkatëse. Por duhet ta kemi guximin e të flasim

objektivisht e të themi, se vetë kërkesa që Kosovës t'i njihet statusi i Republikës, siç e tha kohë më parë Zëri i Populllit, pikërisht Arbër Korabi, që kjo kërkesë para se të jetë një aspiratë, një qëllim të fundit të populllit shqiptar në Jugosllavi, paraqet më parë një protestë që do të thotë se vetë kërkesa që Kosovës t'i njihet statusi i Republikës është një kërkesë, e cila flet qartë se në këtë moment populllit shqiptar në Jugosllavi ka përqafuar idetë e luftës, për një autonomi të vërtetë të shqiptarëve në Jugosllavi.

A është e drejtë kjo, mund të kthehemi mbrapa në histori. Në kohën e Lidhjes së Prizrenit, apo në kohën e kryengritjeve të mëdha të Kosovës, më 1908/10/11 ku 12 kushtet objektive nuk lejonin, që populli në atë kohë të dilte menjëherë me kërkesën për pavarësinë e plotë të Shqipërisë. Por populli u detyrua të dalë për një autonomi në radhë të parë, që do të jetë themeli i shëndoshë edhe për luftën e mëtutjeshme edhe për fitoren e pavarësisë së plotë të populllit shqiptar.

Një rrugë e tillë, sa do që historia nuk përsëritet na imponohet sot edhe ne populllit shqiptar në Jugosllavi dhe gjithë kombit tonë kur është fjala për realizimin e të drejtave tona qoftë në kuadër të kufijve jugosllavë, qoftë me bashkimin e plotë që do të bëhet nesër patjetër në mes gjithë shqiptarëve që jetojnë kudo në tokat e tyre." (Këtë inçizim magnetofonik nga Faridin Tafallari, e botoi për herë të parë Faridin Tafallari në shkrimin: ÇFARË THA JUSUF GËRVALLA PËR KOSOVËN, SHQIPËRINË DHE TROJET SHQIPTARE, NË DITËN E FLAMURIT, 28 NËNTORIN E VITIT 1981; www.albaniapress.com, 22 nëntor 2008)

59. Kosova gjëmëmadhe, trimëresha Kosovë

Ditët, javët e muajt po kalojnë mbi tragjedinë tënde më të re, Kosovë, si mbi trupin e mpirë të një të njohuri të vjetër, të cilit s'iu nda në shekuj gjëma e madhe e robërisë, por as kënga e të pamposhturit s'iu shua mbi buzët e çara, të thara për lëngun e shëndetshëm të lirisë.

Në pragun e stinës së përtëritjes, Kosova jonë martire, ti u godite nga acari i egër, që po kanoset të t'i thaj rrembat e gjakut, të ta zërë frymën, të të ngurosë me gjithë çka ke.

Hordhi të shumta barbare serbe u dyndën me çelik e barot drejt teje në euforinë e tyre fashiste. Si thnegla u derdhën nëpër rrugët e qyteteve dhe fshatrave të tua. Qielli yt u err nga aeroplanët, helikopterët e gazet lotsjellëse. Toka jote, që sapo e kish shkrehur trupin e saj të bëshëm për t'iu dhënë farës së jetës, u drodh nën zinxhirët e tankeve, nën peshën e autoblindave. Mbi të u hodh fara e vdekjes. Plumbat e mitralozit shtrinë përdhe fëmijën, plakun, gruan shtatëzënë dhe djalin e vajzën shqiptare, lulekuqen tënde.

Për të tretën herë gjatë motit të egër titist, Kosova jonë me halle, për bukën dhe të drejtat që kërkove nga bishat shoviniste, more përgjigjen me plumb dhe u ule në gjakun e bijve të tu të pafajshëm duarthatë.

Dhe tash, Kosovë, ç'të qaj më parë, unë, biri yt revolucionar?

Të qaj të kaluarën tënde helm apo të tashmen tënde pelim? Netët që err apo ditët që gdhin me këmbën e të huajit brenda! Të të qaj bukën që s't'u dha. Ti gjithmonë pate sofër bujare për të tjerët edhe kur s'kishe bukë për vete. Tani ta kanë zënë derën, ta zbrazin magjen e t'i hedhin me përbuzje mysat e bukës, që ke gatuar me duart e tua. Bëjnë ligjin në shtëpinë tënde dhe presin prej teje që ti të përkulesh e të marrësh si lëmosh frytin e djersës dhe të pasurisë sate. Për bukë të të ankoj, pranë sofrës e pangrëna Kosovë?!

Të drejtat që t'u shkelën, ato të t'i qaj? Ti rrite me mundime djemtë, jetimat e tu, hoqe për ta kafshatën nga goja, teshën nga trupi. Ishte e drejtë që ata të shpërblenin një ditë. Dhe u çuan e dolën rrugëve e shesheve tua: "Duam bukë!, – thirrën me sa patën, – "Duam bukën tonë, jo mëshirën e huaj; drejtësi duam, se mjaft kemi mbetur rrugëve të botës të rreckosur e të dregëzuar, të dërmuar urie e skamjeje, poshtërimi e përbuzjeje. Duam ta gëzojmë emrin tonë të vërtetë, që na u mohua me dhunë!"

Apo varret e reja të t'i qaj, Kosova gjëmëmadhe? Të kërkosh bukë, bukën tënde, paska qenë "krim"! Në vend që ti të hapje magjen, hape brinjat e tokës sate dhe ua bëre varrin djemve të tu. Pikëllim i pamatë, duhet të jetë pikëllimi yt, Kosova jonë martire. Lëre që t'i shtrinë përdhé djemtë e dëshirit, bonjakët e tu, po as gjëmën s'të lanë t'ua bësh. Të të shkojnë djemtë pa nam e nishan?!

Ndoshta plagët në trupin e ri e të bështëm të djalësisë sate, Kosovë, ato duhet të t'i qaj? Ku i ke spitalet, ku i ke mjekët që i ngrite me thonjtë e duarve? Për kë ndërtove e për kë u mundove? Që, kur t'i duhen më së shumti djemve tu, për të mjekuar plagët që morën duke kërkuar për ty bukë e të drejta, ti të mos i shërosh në spitale, po ata të mjekohen shpellave me barishte, ose dyerve të botës, si harbutë?! Apo i ke për të mjekuar milicët dhe ushtarët e huaj, xhelatët e djemve të tu! Ata, moj nënëloke, erdhën të të hapin plagë dhe të t'i hedhin edhe një herë trupit pranga të reja.

Të të qaj burgun e zi? Ishte e drejtë që burgjet t'i mbaje për kriminelë e kopukë. Pse i mbushe me djemtë e tu më të mirë? Si s'pëlcasin të shkretat, gjithë ajo rini që dergjet në to!

Të të qaj Universitetin që mban emrin tënd? Na e mbyllën urtakun tonë të shtrenjtë, në moshë të mitur, dymbëdhjetë vjeçe më! Sa kishte nisur t'ua ndrinte mendjen bijve e bijave të tua, t'i nxirrte ata nga skëterra ku i kanë katandisur ata që sot harbohen me uniforma rrugëve të tua, me këllëfet e revoleve zhveshur, me automatikët në duar, me ngërdheshjen e shfrenuar në buzë, me vulën e krimit e të turpit në shpirt. Të të qaj shkollat, ku s'do të ketë më vend për filizat e tua! Çfarë bimësh të pafruta do të shartojnë tash mbi filizat tona, lokja jonë dritëpaka! Asosh që do të të nxjerrin sytë kur ty të duhet drita, që do të të gjuajnë me gurë kur ty të duhet buka, asosh që, duke u përjargur, me gjuhën e ntrashur të të çkombëtarizuarit, do ta këndojnë këngën e të huajit e cila t'i çon peshë plagët. Këngën që flet me epsh për shtratin tënd të shkrryer, për sofrën tënde të përmbysur, për shkelmat, plagët e poshtërimet që të dhanë.

Të të qaj Naimin, Çajupin, Asdrenin? Ligjërimi i tyre i lirisë u dashka t'ia lëshojë radhën një ligjërimi tjetër, atij të robërisë. U dashka që pjella jote e brishtë ta shplajë trurin me këngën kriminele, dalë nga dora e Duçiçëve, Laliçëve, Çoviçëve! Por ata i kemi qajtur njëherë, nënëloke. Kur u shkrinë si qiri, që ti të shihje pakëz dritë. Të të qaj flamurin, në Strugë e Tivar, ku banorët kërcënohen të mos e lënë më të valojë? Apo shkabën e zezë dykrenare në Prishtinë, që deshën t'ia hiqnin njërën kokë? Pse s'thanë të vinin një qyqe në vend të saj!

Ç'të qaj më parë, gjëmëmadhja Kosovë?

Bacë Bajrami e Boletini, Idriz Seferi e Sef Kosharja, Abdyl Frashëri e Ymer Prizreni, Shota e Azemi, Kosovë; Shota e Azemi s'paskan qenë për ty!!! Me emrin e tyre të ndritur shpëlan sot gojën e ndytë kriminele ai që po t'i vë prangat. Po kush të jetë për ty atëherë, Kosovë? Garashanini mos? Savë Batarja, Nikolla Pashiçi, Stojadinoviçi, Vasa Çubriloviçi e Ivo Andriçi? Ose ndoshta Rankoviçi, Nikeziçi, Stamboliçi, Miniçi apo bastardët e tu Fadili e Vllasi?!

Ndoshta pikëllimit tënd madhështor i shkon më shumë të t'i qaj rrugët e trotuaret e gërryera nga zinxhirët e tankeve serbe. Qiellin e shëmtuar nga aeroplanët dhe gazet lotsjellëse. Apo "otkupin" që po të pret te dera, ja s'ta përkujton pak motin e zisë së bukës, 1947-ën!

Të të qaj emrin e ndytë që serbomadhi – sipas shembëlltyrës së vet – po ia shpif birit dhe bijës sate: nacionalist, shovinist, reaksionar, kundërrevolucionar, shqiptaromadh? Apo "mëkatin" që bëkan bijtë e bijat e tua, se "nxitkan urrejtjen mes popujve", vetëm e vetëm pse kërkojnë për vete bukë dhe republikë, ato që popujt e tjerë i kanë qëmoti;

Të të qaj Prekazin? E dyta herë që po i vihet kazma Prekazit tënd të shumëvuajtur e heroik;

Të të qaj rininë, punëtorët e fshatarët, intelektualët, gjithë popullin tënd, që serbomëdhenjtë e kanë hedhur të tërin në gjyqin e tyre të turpshëm? Që, si dikur, kur e detyronin të hiqte plisin e të vinte "kapicën", tash e detyrojnë të thotë, kundër vullnetit dhe me shpirt të zhuritur: "Djemtë e vajzat e mia s'janë të mit, shtylla e shtëpisë – punëtorët që më mbajnë gjallë, as ata s'janë të mit, fshatarët e revoltuar s'janë të mit!" Por kush qenka i këtij vendi dhe i këtij populli, Kosovë? Gurët e sokakut apo xhelatët dhe kriminelët që s'reshtën së punuari për t'ia ngrënë kokën popullit tonë?!

Me kë do ta ndajnë sivjet këngën e shkollës nxënësit dhe studentët, ata që në pranverë u hodhën si petrita dhe ngritën lart zërin e fuqishëm pa iu trembur syri nga plumbi e çeliku? Ç'bar të keq do të mbjellin pranë rrënjëve të tyre të brishta? Ç'libra e ç'mësime do t'u japin sivjet, pasi po ua heqin ato që kishin dhe që u duheshin? Ç'do të bëjnë ata kur më të mos ketë t'u dalë përpara mësuesi i vjetër, me të cilin ishin mësuar dhe ai ish mësuar me ta? Si do ta ndrydhin ata në vete pezmin dhe pamundësinë për të bërë çkado për mësuesin e për shokun e vet?!

* *
*

Por jo, moj nënë, mos thuaj: Mbarova! "Djemtë e tu ende janë gjallë / N'kam asht çue rreptë Kosova / E ban luftën ballë për ballë"! A e dëgjon, Kosovë, si buçasin burgjet nga kënga e lirisë, që ia thonë bijtë e bijat tua? Nuk ka pranga në botë që mund ta lidhin atë këngë! Do të pëlcasin prangat, do të pëlcasin burgjet e zeza, në të do të hynë ata që e kanë vendin atje, gjakpirësit serbomëdhenj.

Prandaj, do të këndoj trimëresha Kosovë, se ty s'ta do gjëmën. Ti që i thua tramundanës "plaç" nuk do të lejosh më që djalëria jote të vijë në atë ditë që, e shkapërderdhur skutave të botës, bonjake e pa krah, ta shkojë motin si qyqja në rremb. Jepi, Kosovë, jepi se do të këndojmë! Pa çka se në rrugë na kanë dalë therra? Të stepemi para tyre e ta shmangim rrugën?! Se mos ke mbetur shkret dhe nuk ka kush të del zot? Se u derdh gjaku, se u hap plaga, se u mbush burgu, "nuk mbaroi Prekazi krejt". "S'ka mbarue kurrnji shpi / përveç shpirti i Ahmet Delisë /zbardhi f'tyrën krejt Shqipnisë..."

Atje ku ranë bijtë e bijat e tua, nga një mij u ngritën në vend të tyre. Ty s'të ka prekur dergja e qyqeve – shterpërimi. As trimërinë s'e ke shterpë e të rastit. Nëse barbari s'të la t'ua bësh gjëmën as t'ua mburrësh plagën djemve të tu, s'ka gjë. Nesër, në liri, varret e djalërisë trime kosovare do të përjetësohen me kurora lavdie të dëshmorëve të orëve të para, kurse plaga që mori kjo djalëri, do të ndriçojë si pishtar në rrugën e lumtur të ardhmërisë. Sot nuk qenka e thënë të shërohen në spitale plagët e trimave të tu. Barishtet e malit do t'i shërojnë edhe më mirë. Kurorat e lashta e të larta të bjeshkëve të tua, Kosovë, do të bëhen strehë e sigurtë për kokat heroike të bijve e bijave të tua. S'ke rritur djem në të linjta. Janë djem që s'ia varin plagës ata. Mjaft që ti t'ua tregosh shtegun e luftës. Do të marrin edhe nga tetë plagë të tjera, si Gjergj Elez Alija dikur. Buka që s'tu dha, Kosovë, ti e di se nuk jepet me lutje e përkulje. Ajo merret me gjak e me luftë. Trego rrugën, pak ke që të ndjekin? Ose, të drejtat që t'u shkelën, a i janë falur ndonjëherë kujt ato? Jo, se

liria, siç na ke mësuar ti vetë, trimëresha Kosovë, veç me gjak fitohet. Prandaj thirr, lësho zënë, të shohësh petritat si të dalin zot!

Pa Naimin e Asdrenin, Kosovë, s'e bëjmë të gjallë një hap. Më mirë vdesim e harrohemi.

Tani më thuaj Kosovë, cili flamur është fituar e mbrojtur pa gjak? Vetëm i bardhi fitohet me përunjësi e bindje, me kurrizin të kërrusur. Por, flamuri i bardhë është qefini i atdheut dhe i popullit. Vetëm turpi, ligështia e vdekja bëjnë strehë nën palën e tij të urryer. Kursena prej tij, Kosovë! Flamuri ynë ka qenë dhe mbetet i kuq, i përgjakur, njëri dhe tjetri: ai me shkabën dykrenare dhe ai me drapër e çekan! (Zëri i Kosovës, nëntor 1981, faqe 1-2)

60. Tetë kërkesa të parevokueshme të popullit shqiptar në Jugosllavi

I shtyrë nga shtypja e egër ekonomike, politike, shoqërore e kombëtare nën thundrën e pushtetit gjakatar titist, populli shqiptar në Jugosllavi është ngritur i tëri në luftën e tij të drejt për bukë, liri dhe të drejta demokratike. Ai e pa të arsyeshme të kërkojë me këmbëngulje Republikën e federuar të shqiptarëve në Jugosllavi. Në themelet e kësaj kërkese të shtruar në rrugë paqësore, me fajin e qeverisë shoviniste të Beogradit, u vu gjaku i derdhur, plagët e shumta dhe torturat çnjerëzore që po i bëhen burgjeve e gjyqeve një rinie të tërë shqiptare. Sot për këtë kërkesë është hedhur në gjyqin e tërbuar fashist i tërë populli ynë liridashës, të cilin, në prezencën dhe nën kërcënimin e milicisë dhe të ushtrisë serbe, po e detyrojnë të "diferencohet" nga kërkesat e veta më vitale, të shtruara në pranverë nga ana e djalërisë patriotike, komuniste e revolucionare të Kosovës.

Aktet barbare, me të cilat udhëheqja serbomadhe po përpiqet ta shtypë me çdo kusht e me çdo mjet vullnetin dhe të drejtat e patjetërsueshme të popullit tonë heroik, rrezikojnë në mënyrën më flagrante çdo arsyeshmëri dhe çdo cak të bashkëjetesës normale të popullit tonë me popujt e Jugosllavisë në kushtet ekzistuese, i hedhin helm plagës së madhe të popullit tonë martir dhe nxisin – me përmasa të papara deri më tash – urrejtjen ndërnacionale mes shqiptarëve dhe popujve të Jugosllavisë.

Prandaj, në mbrojtje të vullnetit sa e sa herë të ndrydhur e të nëpërkëmbur të popullit shqiptar në Jugosllavi, ne - një pjesë e pararojës patriotike e komuniste të shqiptarëve të robëruar, që jemi organizuar në gji të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi – dalim para popullit tonë, para opinionit jugosllav dhe atij botëror me këto kërkesa minimale të parevokueshme:

1) Pa iu njohur Kosovës statusi i Republikës në kuadër të federatës jugosllave;

2) Pa iu njohur shqiptarëve në Jugosllavi statusi i kombit dhe, rrjedhimisht, e drejta demokratike e leniniste për vetëvendosje deri në shkëputje;

3) Pa u marrë masat konkrete të të gjithë bashkësisë jugosllave që ritmi i zhvillimit të Kosovës të shpejtohet së paku në shkallën e parashikuar dhe të premtuar nga federata – do të thotë 60 për qind mbi mesataren jugosllave;

4) Pa u marrë masa të menjëhershme kundër papunësisë katastrofike në viset shqiptare, që në afatin sa më të shpejt të inkuadrohet krahu i lirë (ekzistues) i punës dhe të tërhiqen punonjësit tanë të shkapërderdhur në Perëndim dhe nëpër Republikat e zhvilluara të Jugosllavisë;

5) Pa shpalljen e amnistisë së përgjithshme, me të cilën do të liroheshin menjëherë dhe pa kusht të gjithë të burgosurit politikë shqiptarë, që vuajnë dënime të rënda nëpër kazamatet jugosllave;

6) Pa marrë nga populli dënimin e merituar të gjithë ata udhëheqës politiko-shoqërorë, publicistë e njerëz të tjerë, qofshin nga Kosova ose republikat e Jugosllavisë, që janë implikuar në një mënyrë a në një tjetër në tragjedinë më të re të Kosovës, në fushatën e tërbuar antishqiptare të serbomëdhenjve, duke i shkaktuar popullit tonë plagë të reja dhe duke ndërsyer kundër tij popujt jugosllavë, të nxitur nga propaganda;

7) Pa formimin e një komisioni të posaçëm, që do të studiojë me themel dhe në hollësi aksionet shtetërore jugosllave për shpërnguljen e shqiptarëve, para e pas lufte, gjë që presupozon edhe publikimin e dokumenteve të fshehta shtetërore (të vjetra e të reja), që kanë të bëjnë me aksionin në fjalë; pa marrë dënimin e merituar të gjithë aktorët e gjallë (Çubrilloviçi me shokë) dhe të vdekur (Andriç, Vukotiçi etj.) të këtij akti barbar të gjenocidit; pa iu marrë e drejta qytetare publike të gjitha atyre veprave letrare (Duçiçi, Laliçi, Çosiçi, Bulatoviçi), kuazishkencore (Gjorgjeviçi, Cvijiçi etj.) e publicistike, në të cilat pasqyrohet përçmimi kombëtar e synimet antishqiptare, dhe mbi to të vihet embargo e përhershme jo vetëm në Kosovë po në mbarë Jugosllavinë;

8) Pa u rivendosur e pa u zhvilluar më tej marrëdhëniet e filluara kohë më parë mes popullit shqiptar (dhe popujve tjerë) në Jugosllavi me shtetin dhe me popullin shqiptar në RPS të Shqipërisë, të ndërprera në mënyrë të njëanshme arbitrare e me qëllime thellësisht antishqiptare –

– Pa këto masa të menjëhershme, rigorozisht të plota, populli shqiptar i martirizuar nuk do ta ketë as satisfaksionin më të vogël për krimet e vazhdueshme 70-vjeçare të gjenocidit nën regjimet e egra jugosllave, sidomos nën regjimin e vetëquajtur socialist dhe vetadministrues të klikës titiste-rankoviçiste, rrjedhimisht, nuk do të qetësohet deri në ngadhënjimin e plotë të të drejtave dhe të lirisë së tij.

Në qoftë se përkundrazi, udhëheqja jugosllave nuk merr qëndrim të matur, gjakftohtë e të drejtë përballë kërkesave tona krejt të ligjshme, por edhe më tutje vazhdon të godasë padrejtësisht popullin tonë, duke nxitur por të tjerash kundër tij edhe popujt e pafajshëm të Jugosllavisë, përgjegjësinë për këtë do ta marrin mbi vete ekskluzivisht udhëheqja e Serbisë dhe ajo e federatës.

Asnjë kërcënim e shantazh për gjoja implikacionet e brendshme dhe ndërkombëtare, që – siç duan të thonë për demagogji serbomëdhenjtë – mund të dalin nga këmbëngulja e shqiptarëve për kërkesat aktuale, nuk mund të jenë kurrë pasojë e luftës së popullit tonë për bukë e liri. Çdo implikacion eventual, konkludojmë ne me ndërgjegje të plotë e të pastër, do të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë i politikës që na i mohon këto të drejta të ligjshme, rrjedhim i politikës së egër aktuale antishqiptare, që ndjek udhëheqja jugosllave, e cila, me dashje ose me pahir, është kapur në vallen fashiste të serbomëdhenjve.

Prandaj, asnjë pengesë, e vogël a e madhe qoftë, nuk do të na ndalë në luftën tonë të drejtë, e cila patjetër do të kurorëzohet me fitore, pa marrë parasysh disponimin, propagandën dhe masat e egra antishqiptare, që ia grisën krejtësisht maskën regjimit titist.

VDEKJE FSHIZMIT – LIRI POPULLIT!

Komiteti Qendror i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare nën Jugosllavi

(Zëri i Kosovës, Nr.1, nëntor 1981, faqe 2-3)

61. TË DASHUR LEXUES,

Kemi nderin, detyrën dhe përgjegjësinë e madhe të dalim para jush me revistën periodike "Zëri i Kosovës"* pikërisht në një çast historik, kur në ndërgjegjen e popullit

tonë dhe të rinisë sonë heroike po trokasin fuqishëm pulset e lirisë që po agon. Sot për sot, në trupin e këtij populli dhe të kësaj rinia po vizatohen qartë projeksionet e plagëve të reja që do të merren, por njëherazi po hidhen edhe themelet e çelikta të ardhmërisë së sigurtë e të ndritshme.

E sëmura e Ballkanit, Jugosllavia, këmba këmbës po i afrohet shtratit të një vdekjeje të turpshme. Ekonomia e saj, e bazuar në pjesën më të madhe mbi ndihmat dhe mbi kapitalin e huaj, po gremiset nga minuta në minutë. Standardi jetësor ka rënë aq poshtë, sa vetëm që s'kanë kumbuar kambanat e falimentimit të plotë. Dinari është zhvlerësuar dhe është bërë si një paçavure qerepi, kurse inflacioni s'di të ndalur. Dhe sa më shumë që thellohet kriza, aq më shumë vete e nxiton hapin anarkia në treg, e të mos flasim për çmimet; qeveria e Beogradit nuk po gjen dot frenj për t'ia ndalur turrin kalit të hazdisur të çmimeve, i cili po e ha dizginin si i flamosur.

Titistët, siç është e natyrshme për ta, po bëjnë çmos për t'i mbuluar shkaqet e vërteta të gjendjes kaq të mjeruar. Përpjekjet më të dëshpëruara ata i bëjnë sidomos për të mbuluar domethënien dhe shkallën e vërtetë të krizës, që s'është tjetër pos nisma e zëshme e bankrutit të turpshëm e të plotë të "vetadministrimit" jugosllav.

Kompensimi për fatkeqësitë, shkaktarë të të cilave janë vetë me hegjemonizmin e tyre, serbomëdhenjtë kanë ndarë mendjen ta nxjerrin në shtypjen e përgjakshme të kërkesave të ligjshme të popullit shqiptar në Jugosllavi. Pas demonstratave të rinisë dhe të popullit tonë u tregua sa eterike e të paqëndrueshme ishin demagogjitë 40-vjeçare të titistëve për barazinë e vëllazërim-bashkimin e popujve, ato nxorën në pah fytyrën e gjithmonshme të shovinizmit serbomadh, i cili ndër shekuj s'ka lënë gjë pa bërë dhe aleat pa shfrytëzuar vetëm e vetëm për ta mbytur që në zanafillë çdo përpjekje të shqiptarëve për autonomi, mvetësi e pavarësi. Dolën sheshit inkonsideratat e njohura të shovinizmit serbomadh ndaj jetës së njerëzve, ndaj historisë, kulturës, traditës së popujve të tjerë, veçmas të shqiptarëve.

Ata pandehin se me një goditje të rrufeshme policore e ushtarake, me "diferencimet" e tyre të dhunshme, do ta gjunjëzojnë popullin dhe rininë tonë trime, ta shtyjnë atë që të heq dorë jo vetëm nga kërkesat e shtruara në mars e prill, por edhe nga ato pak të drejta formale të mëparshme, të fituara me gjakun e derdhur. Ata do të kishin dashur të na katandisnin edhe një herë në greminën rankoviqiane e më zi. Por, përgjigjen për këtë po e marrin dita më ditë nga pasardhësit e Skënderit e të Abdylit, të Buletinit e Idriz Seferit, të Shotës e Azemit, që kanë vendosur të mos përulen jo vetëm përpara torturave çnjerëzore të burgut, por as para terrorit më të egër shtetëror e tankeve dhe bajonetave serbe.

Bota përreth po e shikon me simpati gjithnjë më të madhe luftën e drejtë të popullit tonë dhe qysh tash mund të thuhet se çështja shqiptare doli në pah në arenën ndërkombëtare si asnjëherë më parë. Vërtet që, duke qenë radiotelevizioni dhe shtypi kosovar zëdhënës të politikës shoviniste që ndjek qeveria e Beogradit, Kosova ishte pa gojë. Por matanë kufirit, në Shqipërinë mëmë, vigjëlon Partia e Punës, e cila e ngriti lart zërin e saj të fuqishëm në mbrojtje të popullit tonë të shumëvuajtur. Dhe zërin e saj populli ynë i robëruar përkëtej kufirit, e mori si zë të vetin dhe u bë me një gojë që flet shtruar e me argumente të ngjeshura, sepse për bazë ka drejtësinë.

Ndërkaq, me ato që bëri e po bën në fushën e betejës populli shqiptar në Jugosllavi, me vendosmërinë e tij për të mos kursyer sakrificat në realizimin e aspiratave të ligjshme, me trimërinë e tij të trashëguar përballë armiqve të egër e shumë më të mëdhenj, jo vetëm që mahniti botën, por u dha forca të pashtershme edhe revolucionarëve, komunistëve e patriotëve të tij pararojë.

Me një popull që ka tradita si ky yni dhe me një shkallë të ndërgjegjes së tillë shoqërore e kombëtare që ka sot populli dhe rinia jonë, forcat patriotike dhe revolucionare nuk kanë si të vënë fare në peshojë mundin dhe sakrificat nga ana e tyre**. Në ballë të këtij populli dhe te këmbët e këtij populli, flijimi dhe vdekja për realizimin e aspiratave të tij, do të na vijnë si përjetimi më i bukur e më fisnik në gjithë jetën. Dhe s'do të ketë forcë që të na ndalë në rrugën tonë të ndritshme.**

---

* Deri më tash "Zëri i Kosovës" ka dalë në trajtë buletini dhe ka botuar materiale të përdorimit të brendshëm për anëtaret e LNÇKVSH (Zëri i Kosovës, nëntori 1981, f. 3)

62. DËNIMET E RËNDA NUK E MPOSHTIN POPULLIN AS RININË TONË

Arrestimet, torturat e dënimet e rënda nuk janë të panjohura për popullin tonë. Klika serbe në pushtet, 40 vjet me radhë, ka zbatuar terrorin më të egër e më gjakatar në Kosovë. Gjymtimet e terrori fizik mbi shqiptarët e pushtuar kanë qenë e mbesin metodat më të preferuara të shovinistëve e të çetnikëve serb. Kazamatet e shumta fashiste jugosllave kanë qenë gjithmonë plot e përplot me patriotë shqiptarë. Njerëzit tanë kanë marrë dënimet më të rënda, me 10 e 15 vjet burg, pse kanë përdorur flamurin kombëtar, pse kanë mbajtur një distinktiv a një shenjë kombëtare, pse kanë lexuar një libër, kanë dëgjuar radion shqiptare, pse kanë diskutuar shqip ose kanë folur për Skënderbeun. Nuk janë të rralla rastet kur shovinistët kanë organizuar veprime provokative, me qëllim të zhdukjes masive të shqiptarëve. Të tilla janë edhe kasaphanat e përgjakshme që kurdisin titistët në burgje, ku pastaj policia shoviniste jugosllave grin me plumba qindra shqiptarë të burgosur. Pra, veprimet e tilla terroriste e të gjenocidit, nuk janë gjë e re, por kryqëzata serbe që ka shpërthyer tani në Kosovë është e papresedan e ua kalon edhe veprimeve më të egra të fashistëve hitlerianë.

Pas demonstratave popullore të marsit e të prillit, në Kosovë sundon shtetrrethimi e ligjet e luftës. Këtu kanë zbritur dhjetëra mijëra forca policore e ushtarake, të pajisura me mjetet më moderne të represionit. Ditë e natë patrullohet çdo rrugë, çdo fashat e mal. Kontrollimet e shtëpive dhe të njerëzve janë bërë të zakonshme. Njerëzit arrestohen pa kurrfarë vendimi: në rrugë, në shkollë e në punë. Të tjerëve u rrethohet shtëpia në pikë të natës, arrestohen njerëz, rrahen e poshtërohen anëtarët e familjes e tmerrohen fëmijët.

Vetëm gjatë katër pesë muajve të fundit janë përplasur nëpër burgje e qeli me mijëra të rinj e të reja shqiptare dhe torturohen në mënyrat më çnjerëzore e më barbare. Tani kanë dalë nga skutat më të errëta hienat e fantazmat shoviniste dhe, me kërbaç në dorë, shfryjnë mbi vëllezërit dhe motrat tona duarlidhura.

U bën muaj e muaj qëkur shtypi titist zuri të njoftonte për të ashtuquajturat procese gjyqësore, në të cilat dënohen rëndë, me 15 e 20 vjet burg, djem e vajza shqiptare. Procedura që ndiqet si gjatë hetimeve ashtu edhe në gjykime, është e pashembullt, jo vetëm në praktikën bashkëkohore ndërkombëtare juridike e morale, por edhe me të drejtën pozitive jugosllave. Deri më tani është njoftuar se dënime kanë marrë mbi 200 veta dhe masa e dënimeve të tyre, marrë së bashku, i kalon të 2000 vjetët. Këto njoftime qeveritarët serb i patën bërë jo se ndienin ndonjë obligim ligjor e moral, por që të kënaqin ndjenjat shoviniste dhe antishqiptare, që kanë gufuar kudo nëpër Jugosllavi. Për mijëra të tjerë që janë arrestuar e mbajtur nën hetime për muaj të tërë, pa kurrfarë vendimi gjyqësor, nuk di kush gjë. Nuk dihet sa janë ata, kur do të dalin para gjyqit, sa do të dënohen e pse akuzohen.

Sa ia kanë frikën popullit tonë titistët, tregon edhe fakti se të gjitha gjykimet u zhvilluan në fshehtësi të plotë e me dyer të mbyllura. Në to jo vetëm që nuk mori pjesë

populli, por në shumë prej tyre nuk ishin të pranishëm as pjesëtarët më të afërm të familjeve të të akuzuarve. Pjesa dërmuese e atyre që do të dënohen janë të rinj, bile shumë prej tyre nën moshën madhore. Nuk u njoftuan as emrat e gjykatësve e të prokurorëve, pa le të avokatëve, që nuk ishin kurrku. Kjo tregon se dënimet i caktoi Beogradi dhe i shqiptuan gjykatat ushtarake, dhe shovinistët e patën vështirë të gjejnë ndonjë gjyqtar shqiptar për të luajtur këto drama rrëqethëse.

Çetnikëve serbë ua ka errur aq shumë sytë shovinizmi serbomadh sa të mos i kursejnë nga torturat, poshtërimet e dënimet e rënda, as fëmijët e mitur, vajzat e thjeshta punëtore e shkollare, bile as gratë shtatzëna. Kur bota përparimtare indinjohet e pyet për këto veprime çnjerëzore e të pashpirt, shovinistët, që nga më i madhi e deri te më i vogli, përgjigjen me një gojë: "Ne po shtypim kundërrevolucionin që shpërtheu në Kosovë", pasi shqiptarët kërkojnë që "Kosova të bëhet republikë", ata kërkojnë të jenë të barabartë me popujt e tjerë të Jugosllavisë, dhe kjo është "nacionaliste", "irredentiste". Dhe akoma pa mbaruar këtë, shkumëzojnë ata, "parulla 'Kosova - Republikë" është reaksionare e shumë e rrezikshme, prandaj ajo duhet demaskuar rrënjësisht". Këtij avazi i bien pa pushim Nikeziçët e Brajeviçët dhe pas tyre mbajnë iso edhe këlyshët e tyre në Kosovë, si Fadilët, Vllasët e fundërrina të tjera shqiptare të farës së tyre. Por deri më tash nuk është gjetur ndonjë "kokë e madhe" që t'ua plotësojë dëshirën, pra, ta demaskojë plotësisht e shkencërisht këtë parullë "armiqësore".

Akuza për të gjithë të dënuarit është e njëjtë dhe standarde: "pjesëmarrja në demonstratat e marsit e të prillit". Se çfarë fshihet prapa këtyre masave të tipit mesjetar, është e qartë. Klika serbe në pushtet kërkon që të shtypë fort popullin tonë, të mbysë kërkesat e tij të drejta e të realizojë planet e paraardhësve të saj monarkistë e rankoviçistë. Ata përpiqen që me këto veprime fashiste të demoralizojnë popullin tonë, të thyejnë qëndresën e tij e të krijojnë panik ndër shqiptarët. Shumica e të dënuarve po akuzohen edhe si organizatorë të demonstratave, por në fakt edhe vetë titistët e dinë se demonstratat i organizoi e i bëri gjithë populli, se kërkesat po ashtu i shtroi vetë populli. Se kjo është një manovër mashtruese, u detyrua ta pranojë para disa kohësh edhe vetë udbashi e kryeshovinisti serb në Kosovë, Dushan Ristiqi. Ai, duke vlerësuar punën e LKJ e të UDB-së në Kosovë, shprehi shqetësimin e tij dhe tha: "Ne ende nuk kemi mundur t'i zbulojmë organizuesit e vërtetë të këtyre demonstratave, ende nuk po mund të arrijmë te organizuesit e vërtetë kur është fjala për këtë aksion armiqësor… Shtrohet pyetja se për ç'arsye nuk po mund t'i zbulojmë disa organizues, pse nuk po mund t'i zbulojmë ata që po shkruajnë parulla, pse nuk po mund t'i zbulojmë ata që po veprojnë, pse nuk po mund të zbulojmë atë që sulmoi njeriun në rrugë dhe nuk po mund ta dimë se kush është…"

Vendosmëria e popullit tonë në kërkesat e tij të drejta dhe masat e represionet që po ndërmarrin shovinistët serb në Kosovë, jo vetëm që e kanë diskreditуar Jugosllavinë në sytë e botës, por kanë futur përçarje e mosbesim edhe në mes vetë titistëve. Pasojë e kësaj janë edhe gjithë ato spastrime e shkarkime në udhëheqësinë më të lartë të Krahinës. Kanë filluar të hidhen si limon i shtrydhur e të sikterisen dhjetëra tradhtarë shqiptarë, që u kanë shërbyer me besnikëri vite e dekada të tëra titistëve e shovinistëve serbë. Mosbesimi e grindja ka hyrë edhe në radhët e LKJ, të UDB-së e të organeve të tjera shtypëse. Këtë e kanë shprehur tërthorazi shumë funksionarë të lartë, por më troç e pohoi Ristiqi. Ai, duke bërë fjalë për rezistencën e popullit e për masat që duhet ndërmarrë, me plot nervozitet shtroi pyetjen para Komitetit Krahinor: "A është e mundshme që në ato mjedise, ata njerëz të mos e dinë, a është e mundshme që anëtarët e LK disa mos t'i dinë, a është e mundshme që organet e pushtetit atë nuk mund ta gjejnë. Unë jam i bindur se akoma nuk kemi krijuar atmosferë të tillë në organet e pushtetit, unë jam i bindur se akoma nuk kemi krijuar atmosferë të tillë në Parti – te masa, që të gjithë të veprojmë

kundër veprimeve të tilla dhe që të gjejmë atë që vepron kështu. Gjërat po ndodhin publikisht dhe gjysmëpublikisht".

Pas ngjarjeve të Kosovës, përçarja e mospajtimet janë ashpërsuar edhe në mes klaneve nacionaliste në udhëheqjen më të lartë të Federatës. Kjo u duk qartë edhe nga fjala e Andrej Marincit, të cilin klani kroato-sllloven e kishte dërguar si përfaqësues të vet në mbledhjen e 6 gushtit të Komitetit Krahinor. Ai u dërgua për të nuhatur situatën politike në Kosovë, për ta parë nga afër se deri ku kanë arritur fërkimet mes shqiptarëve e borgjezisë serbe, por edhe për të paralajmëruar klanin serbo-malazez se nuk është ai i vetmi që bën ligjin në Jugosllavi e për t'u vënë fre ambicieve të tij për një pushtet despotik.

Ai përgëzoi kolegët e tij serbë për masat e rrepta që kanë ndërmarrë kundër shqiptarëve, por nga ana tjetër nuk harroi t'i qortonte ata për masat e nxituara e të pamatura, që dëmtojnë Jugosllavinë në planin ndërkombëtar e mund të rrezikojnë edhe sigurinë e saj. Ai, duke bërë fjalë për rolin e ushtrisë në ngjarjet e Kosovës, rikujtoi se udhëheqja më e lartë e Federatës ka dërguar armatën në Kosovë "para së gjithash për të zënë pozitat", e jo me fjalë tjera, të gjuhet me gurë rrugëve me pionierë e nxënës të shkollave të mesme. Tërthorazi ai bëri edhe vërejtje të tjera rreth politikës së terrorit, që zbaton udhëheqja serbe në Kosovë (këtë jo se ai është më dashamirës i shqiptarëve sesa kolegët e tij serbë, por për hir të interesave konjukturale të borgjezisë së vet, të cilën e përfaqëson). Dhe më vonë ai filloi të profetizojë për mënyrën se si mund të dilet nga kjo gjendje e nderë në Kosovë, se si duhet të dalë regjimi titist nga qorrsokaku ku është futur. "Shokë, – thërret Marinci, – ne jemi në situatën kur para së gjithash është thelbore lufta politike, pra, me mjetet e punës e të aktivitetit me qytetarë përmes punës politike. Në praktikën tonë politike ne kemi ikur gjithmonë nga aktivitetet që kanë si mjet detyrimin, mjetet e shtetit etj." Kjo të bie te konkluzioni se, si pasojë e interesave egoiste, nacionaliste në rivalitetin e grupeve të ndryshme borgjeze në udhëheqjen e Partisë dhe të shtetit jugosllav, ka mospajtime e kundërshtime edhe ndaj dënimeve të ashpra që po shqiptojnë gjyqet serbe në Kosovë.

Qeveritarët e lartë jugosllavë edhe "ideologët" e "vetadministrimit" janë të shqetësuar seriozisht, pasi veprimet e tyre antinjerëzore e antishqiptare e demaskuan keq para botës dhe e zbuluan hapur regjimin e tyre fashistë e gjakatar. Ata gjithashtu po e shohin se megjithë mizoritë që kryen, nuk arritën ta mposhtin e ta gjunjëzojnë popullin tonë. Ata e mbytën në gjak Kosovën tonë martire, por edhe planet e tyre të mbrapshta nuk arritën t'i realizojnë. Populli ynë po e vazhdon pa u trembur rezistencën dhe nuk ka forcë në botë ta frikësojë e ta largojë nga rruga e tij e drejtë, nga rruga për t'u çliruar prej tutelës e shtypjes së shovinistëve serbë.

Dënimet e rënda që po u jepen, e do t'u jepen edhe në të ardhmen bijve e bijave të Kosovës sonë trime, nuk e trembin popullin e rininë tonë të kuqe, por i forcojnë e i bëjnë edhe më të ndërgjegjshëm për drejtësinë e kërkesave e të luftës së tyre. (Zëri i Kosovës, nëntor 1981, faqe 4-5)

63. S'e ka të gjatë robëria

Shembullit të ndritur të nënës, motrës dhe bijës së lavdishme të Kosovës trime, që sot u hodh e tëra në vallen e madhe të luftës për liri

Në shekuj të kam parë me trupin të fishkur dergje e me lotët faqeve. Të shkelmuar nga njerëzit e shtëpisë dhe nga "Fati" yt i hidhur, i emëruar burrë. Në dasmën tënde të kam gjetur më të heshturën e kësaj bote dhe kam pirë nga lotët e tu të valë, të derdhur kot për vashërinë e hidhur me prindërit dhe për nusërinë edhe më të hidhur me burrin e

njerëzit e tij, që për ty s'gjetën emër tjetër pos robinë, kafshë për rëngët e mëdha në shtëpinë që kurrë su bë e jotja.

Me shekuj përfytyrimi ngërthente këto kontura të tua: gruaja e përkulur mbi djepin e plleshmërisë, të cilës i duhet ta flakë anash edhe djepin, për t'ia arrirë burrit qershitë nga dega që atij i bën hije duke iu varur mu përmbi kokë. Të kam parë me këmishën e grisur në shpatull nga skamja dhe rëngët dhe kam dëgjuar burrin tënd tek i thotë së ëmës, vjehrrës sate, sesi ja "nusja e rreh veten", ndërsa ti ke pritur grerëzat e thneglat helmuese, që të janë vardisur me djersët e punës së rëndë në fushë.

Sa e sa herë të kam parë si merr djepin e hidhesh tatëpjetë greminave bashkë me suliotet e tjera, për të mos i rënë e gjallë në dorë turkut. Dhe sesi me djepin në krah, me tmerrin në shpirt e me lotin në sy arratisesh gërxheve të Arzhanicës e Nokshiqit, djerrinave të Nishit e të Vranjës, për të mos i rënë në dorë shkjaut, që vinte putrat në tokat e të parëve të tu.

Njëherë të pagëzova Teutë. Atëherë u ngrite mbretëreshë madhështore, u vure në ballë të ilirëve të lavdishëm dhe i kalle datën romakut. Kur të thirra: Marigo!, ti ishe përkulur dhe po qëndisje përmbys me duart e tua të arta shkabën dykrenare mbi fushën e gjakut, për të mbajtur të gjallë ndër shekuj kujtimin e trimave të rënë me prijës Skënderin dhe për ta ngritur flamur fitimtar në Vlorën e Ismail Qemalit. Por ky përfytyrim sakaq përpihej nga vetvetja dhe ti më dilje prapë në porte e stacione, në Durrës e në Ferizaj, ku përcillje burrin ushtar, nizam në ushtrinë pushtuese, përcillje burrin në kurbetin e hidhur.

Pastaj thash të të quaj Polikseni Luarasi ose Parashqevi Qiriazi. Dhe më dole në Korçën e ndritur. Sa hije të kishin syzet e holla dhe vendi përballë nxënësve rreckamanë! Por, plasi lufta në Shkodër dhe ty t'u desh të vishje tirqit. "Prite Norën e Kelmendit!" – sokëllite dhe tmerrova shkjaun. Pastaj u bëre tebdil e më dole – Shotë me çetat e Azemit, krah për krah me luanin, burrin tënd. Me tirq e me gërshetin e flokut nën plis, që shpesh t'u desh ta këpusje e t'ia lidhje gjalm pushkës kur t'i kalbej rripi në shi e në borë, maleve të Kosovës. Ta këndova këngën e të quajta heroinë dhe nënë jetimash të Kukësit.

Të kam parë në Llap, nuse në shtëpinë e Demë Ahmetit. Shkjau ta gjeti çastin kur burrat nuk ishin në shtëpi e të çnjerëzoi, të verboi e të sakatoi. Fëmijën ta shkoi në bajonetë. Dhe, në Strellc, të kam parë lidhur për mullarin e sanës, dorë për dorë me njerëzit e shtëpisë e me fqinjët, kur shkjau i vuri zjarrin mullarit dhe ju të gjithë u bëtë shkrumb e hi.

Të kam parë me bark sa koshi, në vapën e verës, me buzën të çarë për një pikë uji, në arë e në fushë, se agjëroje për hatër të engjujve e të djajve të huaj. Në këtë ditë të gjeti italiani, që erdhi të të merrte nderin. Po ti e mashtrove me një pulë nga koteci, se aq e kishte ngrënësi i bretkosave.

Dhe erdhi një ditë që të pashë më në fund, edhe në bankën e shkollës. Zemra m'u bë mal. Por isha gëzuar para kohe. Dora jote e brishtë s'i shkruante dot shenjat e pakuptimta cirilike dhe emrat e huaj të trilluar e të urryer, Marko Kraleviq e Musa Kesexhija. Instinktet e tua kërkonin brenda qenies sate nëpër kujtesën e trashëguar cicërimën e bilbilit të "Bagëti bujqësisë", flakën e kandilit që digjej për të parë ti dritë. Kam parë kur fshehurazi, në tarçukun e librave, ta futnin flamurin tënd të ndaluar, po aq të dashur, dhe pastaj vinin e të merrnin në shtëpi, të rrehnin e poshtëronin për një punë që s'e kishe bërë.

Kur, pas njëqind mundimesh, të pash me ditarin e mësueses në dorë, në Podujevë e Vushtrri, në Kamenicë e Ferizaj, në Shkup e në Strugë, seç m'u ngjallën shpresat. Konturat e tua po e braktisnin përfundimisht gëzhojën e ngurtë e të errët shekullore dhe ti hyje pa ndruajtje e hirplote në tempujt e dritës, në Institutin Albanologjik e në Fakultetin Filozofik… Seç më ngjave atëherë me atë shoqen dhe motrën tënde ministre në Tiranën e Kuqe. Dhe sërish zemra m'u bë mal.

Pastaj të takova në demonstratën e 1968-ës në Prishtinë e Tetovë. Kur turma, pa e marrë mirë veten, u step në fillim nga zjarri që hapi armiku, ti sokëllite: "Përpara vëllezër, nuk na tremb dot serbi!" Atëherë e dita se lufta jonë po merrte rrugë për së mbari. Dhe atë ditë e tutje të thirra në të gjitha aksionet, në të gjitha mbledhjet ilegale, dhe kënaqesha kur na e rrëfeje rrugën e dritës e të lirisë.

Të kam parë… e si s'të kam parë!

Por kur të pashë kësaj pranvere duke u sjellë bukë e ujë trimave, duke u afruar gurë, këtë armë të shtrenjtë të studentëve heroikë; kur të pash në ballë të popullit që kërkonte bukë e liri: Në Prishtinë e Podujevë, Mitrovicë e Vuçiternë, në Ferizaj e Drenicë, m'u bë se kobi plasi nga vetvetja dhe armikun e kafshoi mordja. Kur sulmove në Prizren, duke çarë rrethimin me emrin e Shotë Galicës në gojë, u shembën si kulla rëre të gjitha shpresat e kota të serbomadhit për serbizimin e Kosovës sonë martire.

Dhe gjithmonë të desha. Të desha si nënë, që më mëkove e më urove rritë me ninullat e tua fisnike. Të desha si motër që ndave me mua skamjen e mjerimin në robëri. Të desha si shoqe lufte, kur më dole përkrah dhe më mbushje armën e vjetër. Po tash të dua edhe më shumë, se më dole në ballë të luftëtarëve të lirisë, si një yll i pashuar priatar. Zemra më pikon gjak për krahun që të këputi, për gjirin që të sakatosi, për prangat që po të vë në duar mizori. Por, më së shumti po të dua kështu si je bërë sot: e sharë nga armiku dhe e bekuar nga populli, e çnjerëzuar nga halldupi e gjakësori por me nderin të shumëfishuar nga vëllezërit e etërit, në prangat e armikut e pëllumb lirie në shpirtin e gufuar hakmarrës, në hakmarrjen e madhe që po përgatitin motrat, vëllezërit, baballarët dhe nënat e tua.

Se nuk e ka të gjatë robëria. Çdo hallkë e zinxhirit të saj po këputet tash që në vallen e ndritshme të lirisë u kape ti me gjithë qenien tënde, motër dhe bijë e lavdishme e Kosovës trime! (Zëri i Kosovës, nëntor 1981, faqe 5-6)

64. Luftëtar deri në vdekje

48 vjet nga dita e rënies së birit besnik të Kosovës trime, Hasan Prishtinës

Gjithë jeta e këtij patrioti është e lidhur ngushtë me luftërat e popullit shqiptar për liri, pavarësi e demokraci. Ai u lind në Vuçiternë, në vitin 1873, në një familje patriote. Mësimet e para i kreu në qytetin e lindjes e studimet e larta në fakultetin e drejtësisë, në Stamboll.

Qëkur ishte nxënës, dhe më vonë si student, ai u bë një propagandist i shquar në popullin dhe rininë e Kosovës, duke zgjuar te ata ndërgjegjen kombëtare dhe ngulte këmbë t'i jepej më tepër liri vendit. Më vonë, veprimtaria e tij vjen e rritet. Si deputet i Prishtinës në parlamentin turk, më 1908-1912, përkrah Ismail Qemalit, ai u bë mbrojtës i flaktë i të drejtave të kombit shqiptar kundër sundimit të egër osman. Me pjekurinë e tij politike, me forcën e fjalës e të veprimit të tij të pashoq, ai u afrimua si një nga udhëheqësit kryesor të lëvizjes sonë kombëtare.

Hasan Prishtina, deputet e kryengritës, ishte nga të parët që demaskoi demagogjinë e xhonturqve pa u frikësuar nga egërsia e tyre. Në këtë kohë ai zhvilloi një aktivitet të gjerë për krijimin e klubeve e të shkollave shqipe dhe në caktimin e një alfabeti të vetëm shqip dhe frymëzon e përkrah kryengritjet e armatosura të Kosovës më 1910 dhe të Mbishkodrës më 1911. Duke demaskuar barbarizmat e osmanlinjve, ai deklaroi në parlament: "Jemi të mendjes që pushteti turk, po të mos mbroj politikën shtatanike të tij, kryengritja do të përhapet në të gjitha anët e Shqipërisë, dhe pas pak kohe do t'i bini kokës pas murit, por do të jetë shumë vonë". Dhe u largua nga parlamenti në shenjë proteste.

Zhvillimi i ngjarjeve çoi në organizimin e kryengritjes së përgjithshme të armatosur në të gjithë Shqipërinë, në vitin 1912. Bashkë me Ismail Qemalin e patriotë të

tjerë, Hasan Prishtina është një nga udhëheqësit kryesor të saj. Ai ishte iniciatori dhe personi që luajti rolin kryesor në mbledhjen historike të Junikut, ku u vendos shpërthimi i kryengritjes së armatosur në Kosovë, e cila do të shtrihej në të gjitha viset shqiptare për shpalljen e autonomisë, si hap i ndërmejtëm drejt pavarësisë. Bashkë me kryengritësit, të udhëhequr nga Isa Buletini, Bajram Curri, Idriz Seferi etj., Hasan Prishtina hyri triumfalisht në Shkup, i cili ishte qendra e Vilajetit të Kosovës.

Por, pa u ftohur grykat e pushkëve, filloi Lufta Ballkanike dhe shovinistët serbomalazez u derdhën nëpër Kosovë, duke shprehur sheshazi qëllimet e tyre aneksionuese. Në këtë situatë kritike, Hasan Prishtina u vu në ballë të qëndresës për të mbrojtur trojet shqiptare në Kosovë nga pushtuesit e rinj serbë e malazez. Pas shumë peripetish ai shkoi në Vlorë, për të vazhduar luftën për çështjen kombëtare. Qeveria e Vlorës e caktoi ministër të bujqësisë.

Hasan Prishtina nuk i njohu vendimet e Konferencës së Londrës, që i lejoi monarkisë serbe ta aneksojë Kosovën heroike, duke ndarë më dysh Shqipërinë, luftoi kundër tyre dhe nuk u pajtua kurrë me këtë padrejtësi të madhe historike që iu bë kombit shqiptar. Që nga kjo kohë e deri në fund të jetës së tij prej patrioti të flaktë, ai punoi dhe luftoi me penë e me armë për mbrojtjen dhe zhvillimin demokratik të Shqipërisë së pavarur, por edhe për shpëtimin e Kosovës e bashkimin e saj me Shqipërinë.

Në Vlorë, në Durrës, në Kosovë, në Vjenë, në Romë, në Paris e gjetkë, më 1913, 1914, 1918 dhe 1919 e 1920, si diplomat në kancelaritë e huaja dhe si luftëtar në malet e Kosovës, ai i shkriu të gjitha energjitë e aftësitë e tij për çështjen shqiptare. Edhe kur konferenca e Paqes në Paris i vë në fuqi vendimet e Konferencës së Londrës të vitit 1913, Hasan Prishtina nuk u step nga lufta e tij. Me energji të shumëfishuara, në muajt e parë të vitit 1921 ai ishte në Evropë dhe përpiqej të çonte zërin për mbrojtjen e Kosovës në Lidhjen e Kombeve dhe të bashkërendiste luftën e tij me luftën çlirimtare të popujve të tjerë të Ballkanit, që luftonin kundër shovinistëve serbë.

Në prill të vitit 1921, kur u hap parlamenti i parë shqiptar, Hasan Prishtina u zgjodh deputet i Dibrës. Koha e qëndrimit të tij në parlament ishte e shkurtër, por, për aq sa qëndroi, ai u rreshtua me forcat demokratike të vendit, të cilat kishin nisur luftën kundër forcave çifligare reaksionare dhe satrapit të ri Ahmet Zogu, i cili sapo kishte filluar të tregonte kthetrat e tij.

Viti 1921 është viti që shovinistët serbë intensifikojnë luftën e bëjnë masakra të egra kundër popullsisë shqiptare në Kosovë, praktikojnë gjenocidin, përpiqen të thyejnë rezistencën shqiptare, Lëvizjen kaçake, që ishte një lëvizje nacionalçlirimtare e popullit shqiptar të Kosovës për t'u çliruar nga zgjedha serbe. Hasan Prishtina, ashtu si edhe të tjerë patriotë në zë, luftën për demokratizimin e vendit, në Shqipëri, dhe luftën çlirimtare në Kosovë i shikonte të lidhura ngushtë njëra me tjetrën. Ai përsëriti shpesh se Kosova e lëvizja e saj "kanë qenë e kanë me qenë në çdo kohë, në çdo kohë rreziku, aleati më i afërt besnik e i sigurt për atdheun e tyre, Shqipninë".

Gjatë viteve 1921-1924, Hasan Prishtina është i pranishëm në të gjitha ngjarjet kryesore politike në Shqipëri e Kosovë. Në dhjetorin e vitit 1921, me vendim të Këshillit të Lartë, ai formoi një nga qeveritë më demokratike të vendit, ku bënin pjesë Luigj Gurakuqi, Bajram Curri, Fan Noli, Hoxhë Kadri Prishtina, Zija Dibra etj. Pas rrëzimit të saj nga Ahmet Zogu me klikën e tij, Hasan Prishtina bashkë me Bajram Currin ngritën flamurin e luftës për demokraci në malet e Shqipërisë së veriut dhe udhëhoqën luftën që bënin çetat e Azem Galicës në Kosovë për çlirimin kombëtar. Së bashku me Bajram Currin, Aqif Elbasanin etj., ai orgnizoi Lëvizjen e marsit më 1922 dhe me çetat kosovare kontribuoi në fitoren e Revolucionit Demokratik të Qershorit, më 1924. Në shtator të atij

viti, ai shkoi me Bajram Currin në Gjenevë, për të protestuar në Lidhjen e Kombeve kundër barbarizmave të qarqeve shoviniste serbe.

Pas rrëzimit të qeverisë së Nolit nga forcat zogiste e të Pashiqit, Hasan Prishtina, i brengosur por pa iu thyer vullneti për të vazhduar luftën kundër armiqve të Shqipërisë e të Kosovës, mori rrugën e mërgimit. Ai vazhdoi veprimtarinë e tij patriotike në mërgim gjatë viteve 1924-1933. Dy vjet para se të vdiste, më 10 janar 1931, ai protestoi edhe një herë pranë Lidhjes së Kombeve për shtypjen nacionale që i bëhej popullsisë shqiptare. Në fillim Stambolli, pastaj agjentët e Beogradit e të Zogut, e kishin dënuar disa herë Hasan Prishtinën, dhe pasi nuk e kishin shtruar dot me kolltuk e me armë. Ata e kërkonin me këmbëngulje "kryet e gjarpërit", siç e quante Pashiqi atë, sepse ishte tribun i popullit shqiptar e bir besnik i Kosovës trime. Me pesë plumba e vranë tradhtisht pas krahëve, më 14 gusht të vitit 1933 në Selanik, ashtu sikurse kishin bërë me Bajram Currin e Luigj Gurakuqin.

Por kujtimi dhe vepra e tij nuk u zhdukën kurrë. Populli ynë i kujton dhe nuk i harron ata që sakrifikuan gjithçka për mëmëdhenë. Emri i Hasan Prishtinës është një shembull frymëzues për të bërë çdo therrori për çështjen e atdheut e të popullit. (Zëri i Kosovës, nëntor 1981, faqe 6-7)

65. Turpi i mizorit dhe lavdia e heronjve

babë e bir Nebih dhe Tahir Mehaj një ditë të tërë kundër qindra milicëve të mbështetur edhe nga tanket e avionët

Më 13 maj të këtij viti, në Prekazin e Poshtëm u zhvillua një luftë, e cila mund të hedhë në harresë legjendën e simbolit të luftës së pabarabartë, luftën me Davidit e Goliatit.

Babë e bir Nebih dhe Tahir Mehaj, të rrethuar në kullë të vet nga njësite të shumta të milicisë speciale serbe, të cilat shoqëroheshin edhe nga tanket e helikopterët, luftuan një ditë të tërë dhe ranë heroikisht, duke e këmbyer shumëfish jetën e tyre.

Atë ditë të turpshme për të, milicia speciale serbe, e ardhur në Kosovë për ta bërë zap popullsinë shqiptare të revoltuar, kishte marrë urdhër të prerë: të kapej, i gjallë a i vdekur, bujku i ri Tahir Mehaj nga Prekazi. Një vit më parë, Tahiri kishte refuzuar t'u dorëzohej organeve të Skënderajt dhe, për më tepër, në arratisje e sipër ishte mbrojtur edhe me armë zjarri, duke lënë të plagosur me atë rast një milic.

Së pari për kapjen e Tahirit u ngarkua postkomanda e Skënderajt, por nuk ia doli dot kësaj pune. Tahiri, i përkrahur nga i ati dhe i vendosur deri në fund për të qëndruar, jo vetëm që nuk e braktisi shtëpinë, por dërgoi policët shqiptarë t'i çonin fjalë milicisë së Beogradit që ajo të vinte e ta merrte vetë, po t'i duhej gjë.

Pas kësaj, Prekazi u vërshua nga milicia fashiste serbe. Rreth fshatit u vunë tre breza milicësh, e u rrethua edhe çdo lagje e shtëpi e fshatit veç e veç. Dy të ngujuarve në kullë s'mund t'u vinte kështu asgjëkundi as ndihma më e vogël.

*

Gjëmuan tanket dhe oshtëtinë helikopterët mbi fshat. Breshërimat e mitralozit njëra pa mbaruar tjetra. Mbi muret e oborrit e nëpër dyert e jashtme të shtëpisë së Mehajve, mëkot përpiqej ndonjë milic të përvidhej për ta pushtuar kalanë së brendi. Nebihu dhe Tahiri ishin burra të çarkut, syshqiponjë e zemër drenicake. Kështu lufta po ashpërsohej gjithnjë më shumë e u zgjat aq sa s'e kishte menduar njeri. Përveç epërsisë numerike disa qindra herë më të madhe, armatimeve të rënda dhe teknikës bashkëkohore të armikut, luftën e bëri edhe më të ashpër një pabarazi përrallore: syri dhe gishti i luftëtarëve të rrethuar mund ta gjenin e ta goditnin armikun vetëm e vetëm po t'ia kërkonin me plumb lulen e ballit! Vend tjetër të pambrojtur nuk kishte në trupin e milicëve serb, të veshur me jelekë çeliku e të mbrojtur me mburoja qelqi që s'e shpon plumbi. Në kushte të një lufte të tillë çnjerëzore ishte e logjikshme dhe e parashikuar që të rrethuarit të mos mund të bënin rezistencë as disaminutëshe. Po shpirti luftarak, fryma e lartë e sakrificës, këmbëngulja dhe syri e gishti i sigurt i Nebih dhe Tahir Mehajt, bënë që lufta të zgjatej një ditë të tërë. Në fund të asaj dite milicia serbe, e dërmuar dhe e sakatosur (ç'ironi e turp!), megjithatë korri edhe një "fitore", vrau Tahirin dhe Nebihun dhe ua rrafshoi me tanke muret e oborrit dhe kullën stërgjyshore. Ky akti i fundit paraqet një nga hakmarrjet më të egra e më të turpshme të forcave që janë zhgënjyer ndonjëherë me vetveten.

Fundi i luftës së 13 majit solli turp e panik të paparë për fashistët e tërbuar serbë përballë armës shqiptare dhe lavdi të pashoqe për Mehajt, Prekazin e Kosovën. Me dhjetëra milicë kishin mbetur të vrarë, me plumbin në lule të ballit ose në dritë të syrit. Qindra të plagosur barti ndihma e shpejtë dhe i shtriu spitaleve. Nga pala tjetër ranë heroikisht të gjithë luftëtarët, gjithsej dy trima të papërkulur shqiptar, Nebihu e Tahiri, që u shpaguan shumëfish. Lajmi i përfundimit të kësaj lufte popullin tonë e la me një ndjenjë të topitur keqardhjeje për jetën e shuar të luftëtarëve dhe me një admirim të pafund për lavdinë e zemrës dhe të armës së tyre. Me shpresën dhe këmbënguljen për vazhdimin, në shembullin e Prekazit, të luftës së ashpër e të pabarabart, por të lavdishme e ngadhënjimtare.

Shpërblim më të mirë për heroizmin e Prekazit nuk mund të ketë. Ndërkaq, armiku mbeti duke fajësuar të tjerët për turpin e vet. Për gjoja mosvigjilencë e mashtrim, u burgosën komandiri, zëvendëskomandiri dhe një milic i postkomandës së Skenderajt, që të tre shqiptarë. Pastaj serbomëdhenjtë u dhanë të vajtonin si qyqe trupin dhe turpin e milicëve të rënë dhe të hanin si gjarpri dhjamin e vet egërsinë dhe helmin që i kaploi përballë trimërisë tradicionale të shqiptarëve.

Sepse, në qoftë se në luftën e tyre çnjerëzore antishqiptare, të egër e të pabarabartë, kanë mundur të sigurojnë epërsi në numër dhe në teknikën ushtarake (një shtet përballë dy individëve, ose përballë një popullsie të vogël duarthatë), serbomëdhenjtë e tërbuar nuk mund ta sigurojnë edhe shpirtin luftarak, frymën e sakrificës së lartë dhe këmbënguljen, të cilat janë virtyte vetëm të atij që bën luftë të drejtë, mbrojtëse.

Nebih dhe Tahir Mehaj mbesin për popullin tonë kujtimi e shkuar kujtimit të Ahmet Delisë e Mursel Ahmetit, të cilët kohë më parë patën luftuar heroikisht po për Prekazin, Kosovën dhe për gjithë Shqipërinë. (Zëri i Kosovës, nëntori 1981, faqe 8)

66. Më shumë se fashistë

Në fillim të prillit zezakët e Anglisë ngritën në demonstrata. Po në fillim të prillit, në demonstrata qenë ngritur edhe shqiptarët e Kosovës. Edhe demonstratat e zezakëve

edhe ato të shqiptarëve bënë që të flitej me të madhe për to në radiot dhe televizionet e gjithë botës dhe të mbusheshin shtyllat në të gjitha gjuhët dhe shtetet.

Mund të shihje zezakët e Anglisë si kallin e rrokullisin autobusa e automjete të tjera. Kallin ndërtesa të tëra, hedhin gurë mbi policinë e, sipas informatave të shtypit, plagosin mbi 140 policë anglezë. Qeveria antipopullore e zonjës M. Thëçer nuk i jep dot urdhër policisë e ushtrisë së vet për të grirë me mitraloza e për të shkelur me tanke zezakët, e as për të shtënë nga helikopterët mbi grumbuj fëmijësh të ngjyrosur. As reaksionarët anglezë nuk shtinë nga dritaret e shtëpive të tyre për të vrarë kalimtarë zezak. Policët anglezë, të përgjakur nga gurët e zezakëve, nuk i shkelën në bark vajzat zezake që këto të mos mund të bëjnë kurrë më fëmijë, nuk ua copëtojnë gjinjtë nënave zezake që të mos mund t'i ushqejnë voglushët e tyre zezakë.

Këso masakrash e shëmtirash nuk bëri policia as ushtria angleze kundër zezakëve, shumë prej të cilëve Anglinë nuk e kanë as vendlindje, e lëre më atdhe mijëravjeçar. Masakra të tilla të turpshme shtazarake bëri mbi shqiptarët policia dhe ushtria jugosllave, e ardhur nga qytete të ndryshme të Serbisë, me urdhrin e qeverisë "humane" të Beogradit.

Në demonstratat e zezakëve në Angli u plagosën shumë policë anglezë, por nuk u vra – për hakmarrje – asnjë zezak. Shumica e organizatorëve të demonstratave as që u mor në pyetje nga policia. Edhe ata organizatorë që ranë në dorë të policisë, u mbajtën vetëm nga disa ditë në burg. Nuk u rrahën as u torturuan. Demonstratat e tyre u zhvilluan në praninë e gazetarëve dhe të fotoreporterëve, ato u xhiruan me kamera filmike dhe mjetet e informimit njoftuan lidhur me to gjerë e gjatë opinionin vendës dhe atë botëror. Në gazeta, në emisionet e radiotelevizionit, kurrë s'u dëgjua t'i quante kush zezakët "të egër" as "primitiv". Në vend të kësaj u treguan haptazi kërkesat e tyre, bile në shumë raste ato kërkesa u quajtën të drejta.

Nuk është këtu vendi të merremi me fakte se ai se, a e çan fare kokën Anglia apo kushdo tjetër për realizimin e të drejtave të zezakëve. Aq më pa prirje e dëshirë kemi të flasim në "humanizmin" e "demokracinë" e mirënjohur angleze. Por, nga ana tjetër, do të vëmë patjetër në dukje se gjatë demonstratave të tyre, zezakët në Angli gëzonin shumë më tepër të drejta dhe trajtoheshin në mënyrë shumë më të njerëzishme sesa shqiptarët në demonstratat e tyre në Kosovë. Përveç të tjerash, zezakët gëzonin, në krahasim me shqiptarët, një të drejtë të rëndësishme: të drejtën për informim të saktë lidhur me kërkesat e demonstratave të tyre dhe me vet rrjedhën e furishme të atyre demonstratave.

Në demonstratat e shqiptarëve në Kosovën e tyre (ku autoktoninë më se 3000-vjeçare e vërteton e gjithë shkenca, shqiptare e botërore), u vranë e u plagosën me qindra shqiptarë dhe u burgosën e po torturohen me mijëra të tjerë. U hodhën në burgje profesorë të shkollave fillore e të mesme, profesorë universitarë, nxënës, studentë, punëtorë e fshatarë. U nxorën nga puna mijëra e mijëra punonjës dhe u morën nga shtëpitë e tyre të burgosurit e dikurshëm politikë, ndonëse UDB-ja e dinte se ata nuk kishin gisht në demonstrata, pasi qëmoti janë të izoluar e të ndjekur në hap nga policia.

Gjatë ngjarjeve të përgjakshme të Kosovës e deri më sot, Krahina është e mbyllur për të gjithë gazetarët dhe qytetarët e huaj e jugosllavë. Në Kosovë nuk mund të hynte njeri i jashtëm deri sa të kryheshin masakrat, derisa të vriteshin studentët e nxënësit, profesorët, gratë e fëmijët; derisa t'u humbeshin gjurmët kufomave (pa iu dorëzuar prindërve për varrim), deri sa të pastroheshin rrugët nga gjaku i atyre që ishin copëtuar nën tanke. Në këtë kohë, radiotelevizioni dhe shtypi jugosllav bënin punën e tyre të rregullt, thua se nuk po ndodhte gjë, thua se në atë kohë nuk kishin ndodhur gjërat më të tmerrshme e më të paturpshme në Evropën e pasluftës. Mjetet jugosllave të informimit heshtën për ngjarjet e përgjakshme të Kosovës. Po këto mjete, po në atë kohë çonin pluhur të madh rreth demonstratave të zezakëve në Angli! Jugosllavët donin të thoshin se janë gjoja kundër brutalitetit të policisë angleze dhe se gjoja solidarizoheshin me

demonstruesit zezakë. Pse nuk ndaleshin pak më afër – të solidarizoheshin me "zezakët" shqiptarë, por e bënin gjëmën pikërisht mbi rininë shqiptare?!

Mbi të gjitha, qeveria e Beogradit, ka një gjysmë viti që të vrarët, të plagosurit, të burgosurit e të pushuarit nga puna në Kosovë i akuzon edhe për "shovinizëm". Duke tërhequr këtë paralele mes demonstratave të zezakëve në Angli dhe atyre të shqiptarëve në Jugosllavi, deshëm të vizatojmë në vija të shkurtra portretin e një qeverie që akuzon të tjerët për krime e shovinizëm pikërisht në kohën që vetë, me veprimet e egra e çnjerëzore, ia shkon çdo shovinisti dhe kalon në një fashizëm të hapët. (Zëri i Kosovës, nëntor 1981, faqe 9)

67. Letër e hapur popujve të Jugosllavisë

SOLIDARIZIMI ME POPULLIN SHQIPTAR JU BËN NDER DHE JU FORCON

Bashkështetas jugosllavë!

Kur të parët tuaj u vendosën në Gadishullin ilirik, këtu gjetën disa popullsi të lashta vendëse, e në mesin e tyre edhe shqiptarët. Që atëherë kanë kaluar shumë shekuj fqinjësie të shqiptarëve me popujt tuaj. Po fati historik e deshi që fqinjit tuaj të parë, shqiptarit, duke qenë ky një popull i vogël, kurrë nuk i qeshi buza, sepse i ra hise të shijojë jo lirinë e pavarësinë, por të ndërrojë shumë zgjedha të huaja, secila më e ligë se tjetra.

Një nga fatkeqësitë e shumta që i ranë mbi kokë shqiptarit që në shekujt e hershëm të mesjetës së errët, ishte edhe pushtimi i tokave të tij nga ana e perandorisë serbe të Nemanjiqëve. Kujtimi i këtij pushtimi, edhe atëherë kur shqiptarë e serb së bashku ndodheshin nën zgjedhë të huaj, te disa shtresa shoviniste serbe la gjurmë të pashlyeshme, që shpreheshin me anë aspiratash pushtuese ndaj tokave shqiptare e në emër të një "Serbie të vjetër" fikse. Kjo ëndërr e ligë që ka për shtrat plleshmërie të fëlliqur hilet ndaj tokave dhe popullit shqiptar, ndër shekuj ka bërë që marrëdhëniet shqiptaro-serbe të jenë vazhdimisht të tendosura e armiqësore. Ajo ka bërë që ndërkohë të madhërishme e tragjike kur shqiptarët – me ndjenjën e mrekullueshme të trimërisë dhe të flijimit suprem për atdhenë e shtrenjtë – kanë rrokur armët e lirisë dhe janë përgjakur me armiqtë shekullorë si me Turqinë, pikërisht atëherë kur serbët të na bien më qafë dhe të na gllabërojnë pa mëshirë tokat tona.

Mund të sillni ndërmend ngjarjet tragjike të para një shekulli. Mu në kohën e Lidhjes së lavdishme Shqiptare të Prizrenit, kur populli ynë martir ishte ngritur i tëri në këmbë kundër pushtuesit pesëshekullor turk, serbët dhe malazezët gjetën rastin e volitshëm të na shkëputin (me ndihmën e Rusisë cariste) tokat shqiptare poshtë Nishit, ato në Mal të Zi dhe në Maqedoninë e sotme. Dokumentet e kohës, të cilat aktualisht i fsheh prej jush me ngulmin më të madh qeveria shoviniste e Beogradit, tregojnë për tmerre të papara që përjetoi popullsia shqiptare e territoreve poshtë Nishit, para egërsimit të madh të shovinizmit serb (pas vendimeve të Shën Stefanit dhe atyre të Kongresit të Berlinit, që dhanë dorë për copëtimin e madh të tokave shqiptare).

Në mos tjetër ju duhet të keni parasysh ngjarjet tragjike të fillimit të këtij shekulli. Populli shqiptar ishte ngritur në luftë për ekzistencën kombëtare e shtetërore. Ai i dha atëherë grushtin vendimtar të Sëmurit të Bosforit, grusht pas të cilit perandoria anadollake nuk u mëkëmb më kurrë. Po ushtritë e atëhershme serbo-malazeze, duke gëzuar përkrahjen pansllave të Rusisë, në vend që t'i gëzoheshin luftës dhe fitores sonë, e panë të udhës të na bien me thikë pas shpine dhe t'i shkëpusin shtetit shqiptar me së gjysmën e tokave dhe të popullsisë: Kosovën e Rrafshin e Dukagjinit, tokat shqiptare në Maqedoninë e sotme dhe ato në Mal të Zi. Zgjerimet më të mëdha territoriale të shteteve

shoviniste serbo-malazeze gjatë luftërave ballkanike dhe gjatë Luftës I Botërore janë bërë në kurriz të shqiptarëve. Për popullsinë shqiptare që mbeti kështu jashtë kufijve të shtetit shqiptar, zgjedha e vjetër turke u zëvendësua atëherë me në zgjedhë të re, edhe më të egër, me atë serbo-malazeze.

Gjeni dhe shikoni elaboratet e Çubrilloviqëve, Vukotiqëve, Andriqëve me kompani, dhe do të shihni se sa të "njerëzishme" e të "drejta" ishin ndaj shqiptarëve qeveritë serbo-malazeze dhe më vonë ato jugosllave. Do të shihni se barbarizmi i ushtruar ndaj shqiptarëve deri në përpjekjet për një gjenocid të plotë mbi popullin tonë martir, nuk u bëjnë nder pushteteve shoviniste jugosllave as historisë, e aq më pak popujve të përfshirë brenda kufijve administrativo-politikë të Jugosllavisë. Përkundrazi, ato janë turpi dhe ligësia më e madhe dhe ia mihin tokën nën këmbë pikërisht prosperitetit dhe perspektivës së mbarë të zhvillimit të popujve serbë e malazez.

E njëjta politikë shoviniste po ndiqet edhe nga ana e klikës shoviniste në pushtet, nga ana e titizmit, që është burg dhe varr jo vetëm për të drejtat dhe liritë e shqiptarëve, po edhe për zhvillimin e pavarur e të mbarë të të gjithë popujve në Jugosllavi. Vetë ju, fqinjë të dashur, jeni dëshmitarë të aspiratave të vazhdueshme të serbomëdhenjve për hegjemoni, dëshmitarë të shfrytëzimit ekonomik e shoqëror që ju bëhet edhe juve nga ana e borgjezisë së re jugosllave, sidomos serbomadhe. Klika titiste-rankoviqiste, e cila është betuar të përmbysë frytet e revolucionit të lavdishëm popullor në Jugosllavi, pas Luftës II Botërore tradhtoi gjakun e derdhur të partizanëve jugosllavë, të atyre bijve të shtrenjtë të Sllovenisë, Bosnjë-Hercegovinës, Vojvodinës, Kroacisë, Serbisë, Malit të Zi, të Maqedonisë, të mos flasim pastaj për masakrat që bëri qysh gjatë luftës e pas saj mbi popullsinë shqiptare. Në vend që të realizonte të drejtat e barabarta ekonomike, shoqërore e kombëtare, të premtuara në çastet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, në vend që të përgatitej për ndërtimin e rendit të ri socialist, klika titiste hyri në shërbim besnik te kapitalizmi dhe revizionizmi modern, u bë shërbëtore e aspiratave shoviniste serbe për hegjemoni e dominim mbi popujt e tjerë të përfshirë brenda kufijve jugosllavë dhe jashtë tyre. Në mënyrën më të egër u shkel e drejta e trumbetuar deri atëherë për vetëvendosjen e popujve deri në shkëputje, me të cilën vetë Titoja dhe Partia Komuniste Jugosllave i kishte ftuar popujt e Jugosllavisë të ngriheshin si një grusht i vetëm në luftë kundër pushtuesve nazi-fashistë dhe kundër rendit të kalbur antipopullor të Jugosllavisë së vjetër. Në vend që popujt e Jugosllavisë, posaçërisht shqiptarët si popullsi josllave, të gëzonin frytet e kësaj të drejte demokratike e leniniste, ata u shkelën edhe më shumë nga thundra e re titiste, që ua rrëmbente edhe më egër se kushdo tjetër të gjitha të drejtat.

Në kohën që 50 mijë partizanë shqiptarë nga Jugosllavia iu përgjigjën thirrjes së PKJ dhe të PKSH për luftën e rreptë antifashiste nacionalçlirimtare, dhe pikërisht pasi, bashkë me Ushtrinë Nacionalçlirimtare Shqiptare, çliruan tokat e veta dhe u erdhën në ndihmë, deri në Srem e Sllloveni, popujve fqinjë të Jugosllavisë, Partia Komuniste Jugosllave shpalli në Kosovë gjendjen ushtarake, griu e preu mbi 40 mijë shqiptarë, me qëllim të fundit pengimin e realizimit të së drejtës së ligjshme të shqiptarëve për vetëvendosje, të proklamuar gjatë luftës e të vendosur në Mbledhjen e Bujanit, më 1943. Pastaj PKJ ndaloi përdorimin e flamurit kombëtar të shqiptarëve, shpalli "otkupin", burgosi e zhduku masivisht të ashtuquajturit informbyroistë shqiptarë, rrahu, vrau e poshtëroi shqiptarët në aksionin famëkeq të armëve, shpërnguli me dhunë në Turqi mbi 350 mijë shqiptarë, për të arritur kështu në vitin 1968, kur e shuajti me gjak kërkesën e kosovarëve për republikë dhe për të dalë sidomos në pranverën e përgjakshme të këtij viti, kur Kosovën e viset e tjera shqiptare në Maqedoni e Mal të Zi i mbuloi me tanke, bajoneta e helikopterë, me kërbaçë e mitralozë.

Aktualisht, duke mos gjetur argumente për ta bërë vërtet reaksionare, kundërrevolucionare e armiqësore, kërkesën e dy milionë shqiptarëve në Jugosllavi për republikën e tyre të federuar; duke mos gjetur fakte për ta argumentuar se kjo kërkesë është vërtet kundër mirëqenies dhe integritetit territorial të Jugosllavisë, e sidomos kundër popujve jugosllavë, qeveria shoviniste e Beogradit ka parapëlqyer të derdhë mbi shqiptarët plumb, çelik e tym, aeroplan e milici speciale, të mbjellë vdekje e ta kthejë Kosovën e viset e tjera shqiptare në krematorium e burg të paparë.

Pasi vrau dhe la pa varre qindra shqiptarë, djem, gra, pleq e fëmijë, pasi plagosi me mijëra të tjerë dhe të tërë Kosovën e shndërroi në një burg kolektiv, qeveria shoviniste e Beogradit ka zënë e po vjell vrer, duke përdorur gënjeshtrat më absurde, dhe po kërcënohet t'ua marrë shqiptarëve edhe ato pak të drejta formale që kishin ata në Jugosllavinë e Titos. Ajo quan të parealizueshme kërkesën e shqiptarëve për republikë në kohën që përnga numri shqiptarët kanë vendin e tretë në Jugosllavi (pas serbëve e kroatëve) dhe në kohën që republikat e federatës jugosllave përbëjnë territore kombëtarisht kompakte. Dy popuj të tjerë të Jugosllavisë, malazeztë dhe maqedonasit, që kanë republikat e veta, nuk bëjnë së bashku 2 milion e 200 mijë banorë, sa janë shqiptarët, që s'e kanë republikën e tyre! Qeveria e Beogradit mendon se duke u çjerrë për gjoja "reaksionarët", "kundërrevolucionarët" e "armiqtë" shqiptarë, ka shprehur kështu edhe mendimet, dëshirat dhe aspiratat e popujve të Jugosllavisë, të cilët i mban gjithashtu nën thundër.

Por, kështu ajo s'bën gjë tjetër pos që rrit edhe më shumë hendekun mes shqiptarëve dhe pushtetit jugosllav shovinist. Ajo ka marrë rrugën që me shovinizmin e vet të lig t'ju helmojë edhe juve, fqinjë jugosllavë, vetëm e vetëm për t'jua larguar vëmendjen nga problemet katastrofike ekonomiko-shoqërore e për t'ju vënë përballë shqiptarëve, që ju t'i qëroni hesapet me ta, duke jua mbushur mendjen se shqiptarët janë fajtorë për katastrofën e pashmangshme, në të cilën e ka çuar vendin politika antipopullore e Beogradit. Por, në këtë mënyrë, ajo kërkon t'ju bëjë mish për top dhe të realizojë me ndihmën tuaj aspiratat e veta të liga, të cilat s'kanë për t'ju shpënë gjëkundi, pos në një kasaphanë të re ballkanike, mbase edhe evropiane.

Ajo vazhdimisht ju nxit kundër nesh, duke ju treguar me gisht se ja shqiptarët qenkan shkaktarët e të gjitha fatkeqësive që ju kanë rënë juve përmbi kokë nën këtë regjim. Natyrisht, ajo ka nevojë jashtëzakonisht të madhe të fshehë shkaktarin e vërtetë, që është ajo vetë. Por, ne jemi të bindur se ajo flet kot në emrin tuaj, pa ju pyetur fare dhe kundër bindjeve e vullnetit tuaj. Sepse, ndryshe nga qeveritë, me të cilat nuk kanë si të identifikohen kurdoherë popujt e botës e kanë ditur gjithmonë se perspektiva dhe prosperiteti e zhvillimi i mbarë i tyre nuk kanë qëndruar, e aq më pak mund të qëndrojnë sot në shtypjen dhe shfrytëzimin e popujve të tjerë.

Shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi, të shtypur e të shfrytëzuar si mos më keq qe 40 vjet të zeza, kanë vendosur të luftojnë pa kompromis për realizimin e të drejtave të veta. Ata kanë vendosur të mos durojnë më që, duke shkelur përmbi ta, titistët të ndërtojnë "vëllazërim-bashkimin" e tyre të rremë. Një vëllazërim-bashkim të vërtetë me popujt e tjerë, kudo që të ndodhen këta, shqiptarët mund ta kultivojnë vetëm në kushte të barabarta të jetesës, të mirëkuptimit e të respektimit reciprok. Shqiptarët mund të bashkëjetojnë normalisht me ju vetëm pasi ju ta keni marrë në duart tuaja fatin tuaj, e jo në kushte të atilla kur, në emrin tuaj dhe pa ju pyetur fare, vret e pret shqiptarë shovinizmi beogradas. Shqiptarët kanë vendosur që të mos lejojnë më që, duke shkelur përmbi ta, të ruhet "integriteti territorial" i Jugosllavisë. Nuk është humanitet, drejtësi, as perspektivë e mbarë ajo që provon në heshtje apo me zhurmë që, duke shkelur mbi trupat e djalërisë, burrërisë, grarisë, fëmijërisë dhe pleqërisë shqiptare,

Jugosllavia ta ruaj "integritetin" e saj territorial dhe, ç'është edhe më keq, të çirret në anën tjetër për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të popujve. Për "parajsën" e "vetadministrimit" dhe për politikën e "drejtë" të "mosinkuadrimit". Vallë, duke shkelur mbi shqiptarët mendon kjo qeveri t'i largojë të gjitha rreziqet që u turren pareshtur popujve të Jugosllavisë nën prangat e klikës shoviniste titiste?! Duke shkelur mbi shqiptarët, vallë, do të aprovoni edhe ju, popuj fqinjë të Jugosllavisë, të sigurohet mirëqenia për borgjezinë jugosllave e sidomos atë serbomadhe?! Duke shkelur mbi shqiptarët të ripërtyp qeveria jugosllave në kotjen e saj sllavomadhe ëndrrat e errëta për "Stara Serbinë" e Dushanit dhe për dominimin e hegjemonizmit serb jo vetëm në Jugosllavi po edhe në Ballkan?! Dhe, më në fund, duke shkelur mbi shqiptarët të sigurojnë "paqen" në Jugosllavi dhe në Ballkan e Evropë?!

Kjo nuk do të ndodhë kurrë, pa u shkrirë gjithë populli ynë martir, i cili ka qenë me shekuj i pushtuar e i shtypur, por asnjëherë i përkulur!

Aspiratat e tilla mund të jenë në interesin e një qeverie antipopullore e shoviniste, siç është ajo e Beogradit. Por, ne jemi të bindur, fqinj të dashur jugosllavë, se kjo nuk mund të jetë njëherazi edhe në interesin tuaj. Nuk është fatbardhe ndjenja eventuale që mund ta përjetoni ju në realizimin e dëshirave dhe të aspiratave të tilla ndërsa shkelni mbi kufomat e fqinjit tuaj të parë, që s'ju ka bërë asnjë të keqe, historikisht as aktualisht, pos që sot ka vendosur të ngritet e të luftojë deri në fund për të drejtat e veta të shkelura ndër shekuj në mënyrën më mizore, përveç tjerash, edhe nga ana e qeverisë suaj të sotme.

Përkundrazi, po të rrëmbeheni nga ndjenja e identifikimit të aspiratave tuaja popullore me ato të klikës shoviniste serbomadhe, ç'e mirë mund të dalë nga kjo?! Të përplasur për vendosmërinë e pashembullt shqiptare në luftë për realizimin e të drejtave të shkelura, ju nuk do të arrini asgjë tjetër pos të përgjakeni me shqiptarët për llogaritë e armikut të përbashkët, të klikës antipopullore në pushtet. Dhe veç kësaj, duke urryer (në vend që të simpatizoni) lëvizjen aktuale të shqiptarëve kundër robërisë, shtypjes e mjerimit, ju do ta shtyni për shumë e shumë kohë luftën tuaj të ardhshme të pashmangshme për çlirimin tuaj kombëtar e shoqëror nga e njejta zgjedhë.

Në fakt, populli shqiptar, në një mënyrë a në një tjetër, në shekuj e ka ndarë me ju të mirën dhe të keqen. Në emër të kësaj, ky popull e quan sot të drejtë ftesën që jua drejton huve për solidarizim me luftën e tij të ligjshme. Vetëm gënjeshtra e ligë dhe mashtrimi i armikut tonë të përbashkët qeverisë shoviniste të Beogradit, mund t'ju bëjë të ngurroni, të mos solidarizoheni me luftën e drejtë të shqiptarëve. Duke mos u bërë pengesë në rrugën e drejtë të luftës së shqiptarëve, po përkundrazi duke u solidarizuar me këtë luftë, ju do të konsolidoni në fakt radhët tuaja dhe, në mos sot, do ta keni më lehtë nesër të luftoni armikun, i cili e ka vënë gojën e vet prej katallani dhe thith pa mëshirë nga burimi i të drejtave e lirive, nga burimi i mirëqenies dhe prosperitetit të Jugosllavisë, pa ju lënë juve thuaja asgjë nga këto. (Zëri i Kosovës, nëntor 1981, faqe 10-11)

68. MASA PËR PARALIZIMIN E ARSIMIT NË KOSOVË

Psikologjia fashiste është e dukshme edhe atëherë kur mbi kapelën e bartësve të saj nuk qëndron kryqi i thyer nazifashist po ylli i tradhtuar e i përdhosur proletar

Qeveria e Beogradit, në euforinë e saj të pashembullt fashiste, ka marrë në dorë skalpelin e kirurgut maniak dhe i ka hyrë operacionit të Kosovës. Ajo po do që popullsisë shqiptare në Jugosllavi t'ia presë gjithë ata rremba e ata damarë, pa të cilët kjo popullsi do të mbetej e lidhur për shtratin e dergjjes – nga paraliza e sigurt.

Një nga masat më drakonike që kanë ndërmarrë shovinistët serbomëdhenj në Kosovë është aplikimi i të ashtuquajturit provim politik për studentët ekzistues dhe zvogëlimi drastik i numrit të studentëve të rinj, që do të regjistrohen tash e tutje në Universitetin Kosova.

Në Kosovë ka "superprodhim të intelektualëve", thonë ata. Krahina nuk është në gjendje të absorbojë me kapacitete e veta gjithë atë numër (!) punëtorësh të kualifikuar, të rinjsh me diplomën e shkollës së mesme dhe të diplomuarish në fakultete. Prandaj e vetmja zgjidhje e drejtë, sipas mendimit patologjik serbomadh, mbetet zvogëlimi i numrit të studentëve që nga ky vit universitar! Dhe, për ilustrim, gjendjen te ne e krahasojnë me shkallën e "prodhimtarisë së intelektualëve" në Slloveni. Atje, thonë, në krahasim me Kosovën, intelektualë "prodhohen" fare pak, por ata që "prodhohen" e kanë të gatshëm vendin në prodhimtari.

Me gjendjen në Slloveni, qoftë edhe kur është fjala për "prodhimtarinë" normale të intelektualëve atje, s'na kanë thënë gjë të re. I ri është vetëm fakti se kur te ne në kërkesat tona bëjmë çfarëdo krahasimi të gjendjes së Kosovës me atë të Sllovenisë, shovinistët serbomëdhenj i quajnë absurde e tendencioze pretendimet tona dhe nuk e quajnë absurd e tendencioz pretendimin e tyre për arsyeshmërinë e bashkëjetesës së kosovarit me sllovenin; kurse vetë, kur ua do puna, e bëjnë një krahasim të tillë. Universiteti ynë u mbyll me dhunë, para kohe. Megjithatë, disa sesione të provimeve u mbajtën në pranverë. Po mënyra se si u mbajtën ato, do të mbetet e paharrueshme në kujtesën e kandidatëve që iu shtruan provimeve në ato sesione. Ne kemi dëgjuar rrëfime nga baballarët, kemi lexuar libra e kemi parë filma mbi luftërat. As në rrëfimet e njerëzve, as në libra e dokumente të kohës dhe as në filma, nuk kemi njohur skena si kjo:

Je nisur për në provim. Në derën e fakultetit të pret treshi karakteristik – milici dhe ushtari pushtues të armatosur deri në dhëmbë, dhe ta profesori "kujdestar". Me një egërsi arrogante, që merr kuqi te epërsia e armës, milici e ushtari të legjitimojnë e të marrin në pyetje. Pasi të kesh hyrë në fakultet, korridoreve përsëritet po ajo skenë. Mbi të gjitha, në sallën e provimeve, përveç profesorit të lëndës, përveç pyetjeve nga lënda, ti duhet t'i përgjigjesh edhe "profesorit" të dytë, për çështje që kanë të bëjnë me lëndën e – UDB-së.

Këtë psikozë e këtë presion serbomëdhenjtë po e duan për më tepër ta kthejnë në sistem. Për t'u regjistruar në shkollë të mesme e fakultet, tash e tutje kandidati duhet të sigurojë edhe disa "dokumente" (primare: se suksesi në mësime është i "parëndësishëm"): garancinë e prindërve se do të rrijë urtë e butë, garancinë e këshillit të lagjes e të fshatit dhe karakteristikat, të cilat do t'ia përshkruajë shkolla paraprake. Dhe pas të gjitha këtyre, në shkollë, në klasë, në sallën e ligjëratave, të të përcjellë spiuni ose të të presë inspektori i UDB-së, i autorizuar për të të marrë në pyetje!…

Për superprodhim intelektualësh bëhet fjala?!

Shtypi e radiotelevizioni çirren përditë për mësuesit dhe profesorët shqiptarë "të ngarkuar me ndjenja nacionaliste", ose pjesëmarrës në demonstratat dhe në turbullirat e marsit e të prillit dhe pas tyre. Numri i mësuesve të tillë, që janë hedhur burgjeve, duke marrë dënime të rënda deri në 15 vjet burgim, ose janë larguar nga puna, përditë po ngjitet më lart. Zyrtarisht përmenden disa qindra të tillë, po e vërteta është se janë burgosur ose larguar nga puna të gjithë mësuesit dhe profesorët e ndërgjegjshëm, për t'u zëvendësuar me njerëz të besueshëm të pushtetit, për të cilët nuk është me rëndësi të ketë përgatitje e aftësi përkatëse edukativo-mësimore, sepse është pikërisht ndërgjegjja e lartë e këtyre mësuesve që po u prish punë serbomëdhenjve.

Përveç kësaj, nën thikën e mprehtë e të ndohtë të serbomëdhenjve janë futur për operacion të gjitha tekstet shkollore e universitare, sidomos ato që kanë të bëjnë me historinë dhe letërsinë shqipe. Tani, ekipe reçensentësh obskurantë mblidhen kokë më

kokë, vënë syze e llupa dhe qërojnë nga këto tekste çdo fjalë e mendim që ka të bëjë me ndjenjën kombëtare, me krenarinë e dinjitetin njerëzor të shqiptarëve, me historinë tonë, që është historia e popullit më të vuajtur në Ballkan dhe ndër më të vuajturit në botë, po njëherit edhe historia e një populli që s'u mposht kurrë nga asnjë rrebesh, sado i egër që të ketë qenë ky.

Mëkot komisioni i autorëve dhe redaktorëve të teksteve shkollore e universitare konkludon në mbledhjen e vet se tekstet janë në rregull dhe s'ka çka t'u hiqet. Serbomëdhenjtë e pandreqshëm dhe disa mercenarë të UDB-së, me provokacione, vërejtje e kërcënime e hedhin poshtë punën e ndershme të komisionit të përmendur. Sepse, fashistët serbë kanë thënë njëherë botërisht që një pjesë të "fajit" për demonstratat e Kosovës e kishin tekstet, prandaj në to duhet të gjenden patjetër elementet "kontestuese" dhe të qërohen nga komisioni, në mënyrë që të shkojnë në vend me çdo kusht insinuatat obskurantiste të serbomëdhenjve.

Për rininë dhe popullin tonë është e qartë loja makabre që po luhet nën rrogoz e mbi rrogoz, kjo është loja e obskurantizmit të pashembullt serbomadh, që ka për qëllim ta zhdukë gjithë atë që është shqiptare në popullsinë shqiptare në Jugosllavi, pra, të hedhë një hap të madh e të papritur në pacifizimin e në asimilimin e popullit tonë. Kjo gjë nuk është aspak e vështirë të kuptohet. Populli e rinia jonë kanë përvojë të gjatë me armiqtë. Veç kësaj, psikologjia fashiste është e dukshme edhe atëherë kur mbi kapelën e bartësve të saj nuk qëndron kryqi i thyer nazifashist, por ylli i tradhtuar e i përdhosur proletar. Bile populli ynë tashmë e ka lehtë të bindet se nazifashizmi i dikurshëm nuk ka me çka të mburret për egërsi përpara shovinizmit të tërbuar serbomadh.

Serbomëdhenjtë mund të kenë iluzionin se kanë për t'u dalë mbanë me shqiptarët e përvuajtur e të etur për dritë, duke zbatuar mbi ta me përpikmërinë më të madhe masat e tilla drakonike. Pse pra në deklaratat e zyrtarëve jugosllavë e kosovarë nuk mungon kurrë të shprehet frika për shpërthimin e turbullirave të reja?

Por, iluzioni i tyre do të mbetet vetëm iluzion. Rinia dhe populli ynë, ndonëse të dërmuar nga vrasjet, plagët, burgjet, torturat dhe maltretimet politike gjatë "diferencimeve", mbesin po ajo rini dhe po ai popull që ishin në mars e në prill, por tash me bindje e këmbëngulje edhe më të madhe, pasi u hodh përfundimisht në baltë maska e propagandës dhe e demagogjisë fashiste titiste.

Në një situatë të shqetësuar si kjo jona, shpëtimi i të robëruarit nuk varet nga një nxënës, student, arsimtar e tekst shkollor më shumë ose më pak. Përballë llogarive të armikut, kemi edhe ne llogaritë tona. Sipas llogarisë sonë të qartë, një student ose një profesor më pak në fakultet, don të thotë – qind për qind – një i papunë më shumë në rrugë. Aq sa do t'i marrësh armatës së studentëve, do t'i shtosh patjetër armatës së të papunëve kosovarë. A do të jetë për shtetin e falimentuar jugosllav më i rrezikshëm një student (i papunë në perspektivë) apo një student i hedhur në rrugë, pra i papunë (aktualisht), kjo le të mbetet preokupim për qeverinë fashiste të Beogradit.

Neve s'do të na bëhet vonë. Nga kërkesat tona, të ujitura me gjakun e rinisë sonë revolucionare, të fuqizuara me plagë e tortura burgjesh, nuk heqim kurrë dorë. E kemi thënë njëherë fjalën tonë, e do ta themi përsëri, kurdo që ta kërkoj puna. Mos të habitet armiku nëse herën tjetër ia themi ndryshe me një hov e me një forcë tjetër.

Lufta e drejtë e popullit dhe e rinisë sonë, shovinizmin serbomadh e ka vënë përpara një alterantive të madhe: t'i hapë apo t'i mbajë mbyllur fakultetet tona. Në rast se i hap ato, neve do të na ketë të bashkuar dhe më këmbëngulës për kërkesat tona të shtruara në pranverë. Në rast se i mban mbyllur, ne do të bashkohemi sërish, po tani me një kërkesë të re: që të na hapen përdhunë shkollat dhe fakultetet e mbyllura.

Se s'ka lezet, në një vend "socialist" shumëkombësh, një kombi – të tretit përnga madhësia – t'i shkelen të gjitha të drejtat, madje edhe e drejta elementare e shkollimit. Dhe sa më shumë të përpiqen serbomëdhenjtë të na e gjymtojnë sistemin e arsimit dhe ta zvogëlojnë vëllimisht atë, duke hedhur në rrugë nxënës, studentë e arsimtarë dhe duke hequr nga përdorimi tekste e pjesë tekstesh shkollore e universitare, aq më shumë do të shtohet këmbëngulja jonë dhe aq më pak do të pajtohemi ne me politikën e tillë arsimore, e cila popullit tonë nuk i jep mundësi të plotë për zhvillim kryekëput në bazë të nevojave të veta ekonomike, politike, sociale, nacionale e kulturore. (Zëri i Kosovës, nëntor 1981, faqe 12-13)

69. S'na frikësojnë inskenimet

Për ta kënaqur sedrën e vet fashiste e kapitulluese, e cila vjen duke u bërë më e prekshme sa më shumë që po rriten kotësia dhe disfatat e masave të egra antishqiptare, qeveria e Beogradit ka futur në përdorim një mjet të ri, si provë për të shtrembëruar në sytë e opinionit jugosllav dhe botëror luftën e drejtë të popullit tonë. Ajo gjithnjë më shpesh po çirret për njëfarë të ashtuquajtur "terrorizëm shqiptar". Për pikënisje ka marrë "hedhjen e bombës" në ambasadën jugosllave në Tiranë, rrahjen e dy gazetarëve serbë në Gjenevë nga demonstruesit tanë – punëtorë në botën e jashtme, kalljen e disa përfaqësive dhe objekteve tregtare jugosllave në Belgjikë si dhe ty "atentate" mbi njerëzit e ambasadës jugosllave në Belgjikë.

Sa i përket "bombës" së hedhur në Tiranë, ajo iu kthye Beogradit si bumerang. Bota është bindur tashmë që Jugosllavia ishte vetë ai gishti që edhe ha edhe kallëzon, pra që ajo vetë kreu aksionin dhe u çua vetë kundër tij, duke akuzuar për këtë qeverinë shqiptare. Pastaj u hodh të sulmonte qeverinë e Zvicrës dhe atë të Belgjikës, që gjoja nuk po ndërmerrnin asgjë për mbrojtjen e përfaqësuesve jugosllavë në vendet përkatëse.

Por këto protesta prej një të dëshpëruari të qeverisë së Beogradit po shkojnë huq. Punës së inskenuar mund t'i hedhës spec me të dy duart, e ajo prapë të mos djegë e të mos lëvizë nga pika e vdekur, pasi nuk e ka për bazë brengën e vërtetë dhe seriozitetin, po pezmin falso të aktorit të dobët. Kështu e tërë jehona e këtyre protestave nuk po i kalon dot kufijtë e Jugosllavisë. Këtu brenda po ndalet dhe këtu po e helmon me një helm të fortë antishqiptar një pjesë të popujve të Jugosllavisë, gjë që është një nga qëllimet kryesore të serbomëdhenjve. Sa u përket vendeve të Perëndimit ato kanë tashmë një përvojë të begatshme me terrorizmin "antijugosllav", autor dhe aktor i të cilit është pikërisht dhe vetëm UDB-ja me mercenarët e saj, që vrasin njërin pas tjetrit jugosllavët e mërguar. (Pikërisht në kohën që Beogradi protestonte pranë qeverisë belge, përpara një gjyqi gjermanoperëndimor përgjigjeshin dhe morën dënime të rënda – 13, 11 dhe 8 vjet burg – tre udbashë e mercenarë të UDB-së, që kishin bërë atentat mbi një emigrant kroat.)

Nga ana tjetër, krerët serbomëdhenj të Beogradit deklarojnë botërisht se janë në gjendje "të jetojnë me një terrorizëm të vazhdueshëm shqiptar, si Anglia me çështjen e Irlandës"! (Me një vend të bukur po aq falimentues, e ka krahasuar veten regjimi titist!) Prandaj nuk është gjë e rastit kur flitet kaq shumë për terrorizmin fiktiv shqiptar. Serbomëdhenjtë kapardisen se si do ta lënë pezull e të pazgjidhur çështjen e republikës së shqiptarëve dhe pretendojnë se kështu do të mund ta nxisin një terrorizëm të vërtetë të shqiptarëve. Është e qartë se qeverisë shoviniste të Beogradit i leverdis një gjë e tillë. Madje, ajo është në gjendje të humbë shumë njerëz e objekte përfaqësish, duke inskenuar "terror shqiptar". Pse?

Edhe teoria edhe praktika e luftës çlirimtare dhe e revolucionit qëmoti e kanë hedhur poshtë terrorizmin si mjet jo vetëm të kotë po edhe shumë të rrezikshëm. Duke i dhënë luftës së drejtë të popullit tonë ngjyrën e terrorizmit, Jugosllavia synon të fitojë një

avantazh për ta kompensuar sado pak prestigjin e humbur në sytë e opinionit ndërkombëtar. Përveç kësaj, ajo llogaritë ta largojë shqiptarin nga rruga e vërtetë e luftës, duke e joshur dhe duke e pezmatuar për ndonjë terrorizëm të vërtetë.

Por, në vend të kësaj, Beogradi po ballafaqohet me diçka krejt të kundërt. Është një grusht i fortë për këtë qeveri fashiste fakti se populli ynë po tregohet i matur dhe politikisht i pjekur. Kërkesa për t'iu njohur Kosovës statusi i republikës, serbomëdhenjtë i bëri të shkumëzojnë e të shkelmojnë si të fantaksur. Nuk gjejnë dot asnjë fakt të logjikshëm për të argumentuar tezën e tyre sesi kjo kërkesë e popullit tonë na qenka nacionaliste, shoviniste, reaksionare, kundërrevolucionare dhe armiqësore. Kjo i huton dhe egërson ata, se gjithnjë kanë konsideruar që populli shqiptar i ka të tepërta edhe ato pak të drejta formale në letër, lëre më që atij t'i jepet edhe republika. Për të joshur në rrugën e vet edhe popujt e Jugosllavisë (e vetëdijshme, sadopak, se pa ta nuk mund t'i dalë mbanë asnjë lufte), qeveria e Beogradit hap fjalën e "terrorit shqiptar" dhe kështu duke zgjuar mërinë e urrejtjen ndërnacionale, ajo shikon t'i mishërojë këta popuj, që edhe ata të vihen pas saj.

Mbi të gjitha, duke sulmuar për "terrorizëm", ajo llogaritë ta hedh popullin tonë në defansivë, që ky të harrojë terrorin shtetëror jugosllav dhe të mos kërkoj llogari për krimet e një gjenocidi në kuptimin e plotë të fjalës, që ushtroi qe dyzet vjet mbi popullin tonë klika gjakatare titiste-rankoviqiste. Këto janë disa nga arsyet pse i tërë aparati propagandistik i Beogradit është vënë në lëvizje të paparë dhe fryn e zmadhon në përpjesëtime çnjerëzore "terrorizmin shqiptar". Me këtë, qeveria e Beogradit synon t'i hap rrugë terrorit të vet shtetëror, duke marrë si pretekst se gjoja është e "detyruar" të vrasë, të plagosë, të burgosë, të çnderojë e të bastisë shqiptarët, siç bëri gjatë demonstratave të fundit dhe siç po vazhdon deri në këtë moment.

Por fryma e lartë luftarake dhe revolucionare e lëvizjes sonë, karakteri i drejtë i luftës sonë për të drejta e liri përballë një armiku të tërbuar që na i shkel e mohon ato vazhdimisht; qëllimet e shenjta e idealet e larta të rinisë dhe të popullit tonë të shumëvuajtur, bëjnë që ne as të mos e vëmë në buzë çorbën djallëzore që po zien Jugosllavia titiste dhe të mos biem në grackat e saj perfide, ashtu siç nuk kemi rënë as deri më sot. Përkundrazi, asnjë propagandë për të ashtuquajturin "terrorizëm shqiptar", të inskenuar e të "sulmuar" nga qeveria shoviniste e Beogradit, nuk do të na frikësojë e të na ndalë në kërkesat tona të drejta për bukë, të drejta e liri demokratike. Ato do t'i kërkojmë në mënyrën që do ta shohim të arsyeshme, pa e vënë në peshojë as jetën, derisa t'i realizojmë që të gjitha! (Zëri i Kosovës, nëntor 1981, faqe 14)

70. Gjuha shqipe dhe flamuri shqiptar në shënjestër

Shtypi jugosllav, veç të tjerash, "merakoset" edhe për gjuhën tonë të njësuar letrare. Pse, – thonë letërnxirësit e gazetave të shumta, – kur u bë unisimi i shqipes, nuk u mor për bazë gegërishtja po toskërishtja gjirokastrite, – shtojnë ata, – "e folmja e vendlindjes së Enver Hoxhës" (sic!)…

Që kjo është një çështje serioze dhe – siç do ta pranonin edhe vetë kalemxhinjtë jugosllavë – shumë e ngatërruar për njohuritë e tyre më pak se modeste në lëmin e shqipes, kjo s'do mend. Çështja e një gjuhe përket në thelbin e çështjes së një kombi. Trajtimi i saj presupozon njohuri përkatëse shkencore të nivelit më të lartë.

Mbi të gjitha, problemi i një gjuhe është problem i brendshëm i kombit që e flet dhe në këtë drejtim shtypi jugosllav pretendon të bëjë një punë e cila përjashtohet

vetvetiu. Letërnxirësit nuk tregojnë prej çfarë konsideratash janë nisur kur e shtruan këtë çështje kaq të huaj për ta.

Nga ana tjetër, vetë akti i unisimit të letrarishtes shqipe është një akt i kryer. Serbët ishin këtu ku janë edhe në kohën që u krye ky akt, më 1969. Dhe nuk e thanë një fjalë të vetme. Tash e thonë, por me përpjekje të mundimshme për ta fshehur dhembjen e vërtetë.

KONSIDERATA E PARIMIT SHKENCOR

A është gjuha letrare shqipe thjeshtë një toskërishte apo gegërishte ose bashkim dhe shkrirje e të dy dialekteve tona, që ka marrë për bazë elemente të qëndrueshme edhe nga të folmet e veçanta lokale të shqipes – kjo është një punë që nuk ua kap kalemi letërnxirësve jugosllavë. Ose, që të përkufizohemi më saktësisht, kalemxhinjve serbomëdhenj.

Ç'është e vërteta, fusha e interesimeve serbe në lëmin e gjuhësisë e të etnologjisë, nuk është gjithaq e ngushtë. Por, është gjithashtu e vërtetë se interesimi i shkencës serbe për studimin e gjuhësisë shqiptare ka qenë fare i kufizuar, për të mos thënë se ka munguar krejtësisht. (As M. Shuflaj as H. Bariç njohës të gjuhësisë, historisë dhe të kulturës materiale të shqiptarëve, nuk ishin serbë, po kroatë.)

Për kulturën serbe, shqipja ka qenë tradicionalisht një gjuhë të kolonizuarish të përbuzur, që nuk paraqet interes shkencor. Së këndejmi ka vend për një dyshim: mungesa shekullore e studimeve në këtë drejtim nga ana e shkencës serbe, a ka mundur të kompensohet brenda një nate, për nevoja të ngutshme politike, dhe tash të na dalë me konkluzione të gatshme?! Përgjigja logjike që del, nuk lë vend të supozohet për konsideratën e parimit shkencor nga ana e artikullshkruesve serbë në trajtimin e çështjes së letrarishtes shqipe.

KONSIDERATA E DASHAMIRËSISË NDAJ FQINJIT TË AFËRM

Një konsideratë tjetër e natyrës joshkencore, prandaj më e ulët, do të kish qenë konsiderata e letërnxirësve serbë ndaj shqiptarëve gegë si ndaj fqinjit më të afërm nga të gjithë shqiptarët. Kur shprehen kundër "dominimit" të toskërishtes në shqipen letrare, është logjikshme të pritet se atyre u mbetet hatri për gegërishten, së cilës ia paska ngrënë hisen toskërishtja dhe gjirokastritët e Enver Hoxhës!!!

Po të kundrohej çështja nga këndvështrimi i ndonjë krijese prej planetesh të tjera, që s'dinë për urrejtjet fqinjësore, do të mund të supozohej se pushteti serb merakoset, pse jo, për "fatin" e fqinjëve shqiptarë (gegë) dhe "mosmarrjen" pjesë të dialektit të tyre në gjuhën letrare shqipe. Por, pasi është puna për njerëz të vdekshëm të planetit tonë, konkretisht për shqiptarët veçanërisht të vdekshëm nga tanket dhe mitralozat e milicisë speciale serbe, supozimet e tilla nuk hanë bukë.

Fërkimet shqiptaro-serbe shtrihen në shekuj. Nga ana e serbëve, ato nuk kanë paraqitur kurrë kujdesin e një fqinji për fatin e zi të fqinjit tjetër. Përkundrazi, historikisht dhe aktualisht, siç e di edhe fëmija në djep, aspiratat serbe ndaj fqinjit shqiptar, qoftë ky edhe gegë, ose veçanërisht gegë, kanë qenë kurdoherë aspirata në radhë të parë pushtuese dhe shfarosëse.

Kështu dali te konsideratat e vërteta të serbomëdhenjve.

NJË SULM FRONTAL ANTISHQIPTAR

Prekja e çështjes së letrarishtes shqipe nga shovinistët serbomëdhenj është bërë në kuadër të sulmit frontal antishqiptar të qeverisë së Beogradit pas demonstratave të marsit e prillit. Udhëheqja e Beogradit është bërë pikë e helm mes tjerash edhe për një arsye: Pse u lejua (!) unifikimi i shqipes, përkatësisht pse u lejuan shqiptarët në Jugosllavi të zbatonin gjuhën letrare gjithëshqiptare. Duke qenë gjuha e njësuar një nga elementet më të rëndësishme të unitetit të kombit, serbomëdhenjtë s'ka si të mos ndihen të dëmtuar pse populli shqiptar në Jugosllavi nuk mbeti me dialektin e vet, kryesisht gegë, por përqafoi letrarishten dhe kështu unitetin kombëtar me vëllezërit shqiptarë në RPS të Shqipërisë.

Shqipja, qoftë edhe gegërishte, e veçanërisht gegërishte, ua vret veshin këtyre shovinistëve të tërbuar. Ajo ka qenë e përbuzur prej tyre me shekuj, e përbuzet edhe sot. Por, po të ngelte ajo në suazat e dialektit të vet (gegë), për serbomëdhenjtë do të kish pasur shpresa më të mëdha që një ditë ky dialekt, duke u bërë gjithnjë me anemik nën dorën e kujdesshme të serbomëdhenjve, do ta braktiste fare trevën e vet dhe do të katandisej në një të folme të gjymtë, dhe kështu do të jepte mundësi shumë më të mëdha për asimilim më të madh të shqipfolësve të tillë. Ky ishte fillimisht qëllimi i Garashaninit, Pashiqit, Stojadinoviqit, Çublilloviqit, Vukotiqit, Andriqit. Ky është sot qëllimi i Stamboliqit, Miniqit, Vidiqit…

Në një tubim të LSPP të Kosovës, ku mbi punëtorët shqiptarë bëhej presioni i zakonshëm për diferencim nga vullneti i popullit i shprehur qartë në demonstrata e greva, një punëtor e pyeti sa vijon Azem Vllasin: "A është nacionalizëm të flasësh shqip?!" "Jo, nuk është nacionalizëm", u përgjegj Vllasi pa një pa dy dhe vazhdoi atje ku e kish lënë muhabetin, pa e diktuar ironinë e mprehtë të punëtorit. Kjo tregon sa keq e kanë humbur Vllasët, rrugën në oborr të vet. Tregon gjithashtu se kjo trullosje është infektim i drejtpërdrejtë nga dehja fashiste që ka përfshirë sot qarqet sunduese serbe në sulmet e tyre antishqiptare.

CËNIMI I FLAMURIT SHQIPTAR

Kuadri i gjerë i këtyre sulmeve nuk la pa përfshirë edhe një element tjetër vital të qenies kombëtare shqiptare: flamurin kombëtar!

Me këtë flamur, – çirren sahanlëpirësit skllevër maqedonas, – me këtë flamur sulmoi armiku! (Krahaso: Këtë gjuhë fliste armiku që sulmoi!) Dhe s'ngurrojnë të shpifin e të trillojnë si çiliminj sesi qenka ngritur një shqiptar në Strugë (pa shih, pa shih: një shqiptar dhe në Strugë, – të dhëna të forta!), qenka ngritur ky *shqiptar në Strugë* dhe paska deklaruar se flamuri shqiptar, qëkur ka "dalë", paska shkaktuar vetëm ngatërresa (sic!), dhe prandaj është më mirë të hiqet fare. Se vetëm kështu hiqen edhe ngatërresat – shtojmë ne.

I inkurajuar nga ky gjest i madh kalorësiak i atij *shqiptarit në Strugë*, çohet në kryesinë e LSPP të Kosovës, njëfarë zoti serbomadh, Laziç. Ç'është e vërteta në krahasim me kërkesën e atij shqiptarit në Strugë, kërkesa e këtij z. Laziçit paraqet njëfarë konçesioni ndaj shqiptarëve: Flamuri shqiptar s'ka nevojë të hiqet krejtësisht (tash për tash), por atij duhet t'i ndërrohet forma, që të mos jetë identik me flamurin kombëtar në RPS të Shqipërisë (sepse Shqipëria u përzie keq në punët e brendshme të Jugosllavisë dhe të atij *shqiptarit në Strugë*)!

Që tragjikomedia të fitojë sa më shumë në gradacionin e vet dramatik, ngehet A. Vllasi dhe e hedhë poshtë "propozimin" e Laziçit si të pabazë, së paku tash për tash! As

këtu Vllasi nuk ka vesh për ironinë. Ata që akuzojnë pareshtur për nacionalizëm e shovinizëm, Laziçët, prekin me shovinizmin më të tërbuar në gjërat e paprekshme të një kombi.

PËRFUNDIM

Serbomëdhenjtë nuk do të kishin qenë ata që janë sikur të mos e kishin pasur të gatshme edhe alternativën për zgjidhjen e problemit. Dhe alternativa e tyre është kjo:

Ju shqiptarët s'keni nevojë as të luani veshin. Mund të rrini e të këqyrni seri, për ju mendon udhëheqja e Beogradit.

Nëse jua ndalojmë përdorimin e letrarishtes suaj, s'krisi kiameti; e keni dialektin tuaj, gegë. Dhe kur t'na teket t'jua ndalojmë edhe këtë dialekt, se mos sosen të gjitha gjuhët që keni në dispozicion të flisni?! Ja ku e keni – serbishten, bie fjala. Ç'i mungon asaj?!

Ose, flamuri ta zëmë. Shqiptarët e Maqedonisë dhe të Malit të Zi mund ta heqin qysh sot. S'mbeten pa flamur, megjithatë, e kanë ata atë maqedonas dhe malazias! Shqiptarët e Kosovës mund të pajtoheshin sot për sot me ndërrimin e formës së shkabës dykrenare. Mund t'u mjaftojë një kokë e shqiponjës mbi flamur. Po të mos u pëlqejë, ja ku e kanë flamurin serb!

Me rëndësi është që ju shqiptarët nuk bën të prekeni. Ne mund ta ofendojmë në shtypin tonë figurën e ndritshme të heroit kombëtar shqiptar me përmasa ballkanike e evropiane, figurën e Skënderbeut. Mund edhe t'jua ndalojmë kujtimin e tij. Por, ç'ju prishë punë? Ju do të mund ta adhuroni sa të keni qejf Marko Kraleviqin, Pashiqin, Karagjorgjeviqin, Buriqin pasi nuk mund të jetoni pa adhurimin e figurave historike.

Vërtetë, ç'ju prish punë e gjithë kjo? Kryesorja është që të mos ju lëmë fare pa gjuhë, pa flamur e pa figura historike!

Ngjashëm patën thënë këta maniakë të serbizmit (s'është larg mendsh që në të ardhmen shprehja "serbizëm" do të përdoret në kuptimin e një fashizmi në katror), kur doli në shesh kërkesa për republikën e shqiptarëve: "Kosovarët s'janë pa republikë. E kanë republikën e – Serbisë!!!"

Logjikë e shkëlqyeshme! E pjekur për t'i dalë përballë jo me fjalë e kopalla, por me pushkën plot, si logjikës më të mykur fashiste. (Zëri i Kosovës, nëntor 1981, faqe 17)

71. T'I JAPIM SHTYTJE TË RE LUFTËS

Duke hyrë me polici e ushtri në Kosovë, qeveria shoviniste e Beogradit erdhi këtu për të marrë brirët, por la edhe veshët. Pa vënë në peshojë viktimat, pa zgjedhur mjetet, pa u kujdesur për autoritetin e vet, që rrezikohej t'i binte në baltë, ajo deshi ta shuante me çdo kusht, me furinë e tankeve dhe të avionëve, revoltën shqiptare. Por nuk ia doli. Për dhjetë muaj të ripushtimit të Kosovës, revolta shqiptare jo vetëm nuk u shua, por u shumëfishua dhe u fuqizua. Sulmi, në vend që të arrinte objektivat e planifikuara, qetësimin e menjëhershëm të situatës në Kosovë, i përzjeu të gjitha përmasat. Ai ndihmoi që, te shtresat e popullsisë sonë, atje ku qe dukur apatia dhe tërheqja në vete, të nxirrte kokë trimëria dhe iniciativa, ku qe kursyer edhe fjala e gojës, tani të dilte në dritë gatishmëria për të dhënë jetën pa pyetur për kusur. Sulmi i policisë mbi demonstruesit u spraps nga masat me gur e me dru. Tankeve ua vuri gjoksin përpara djalëria heroike kosovare, kurse punëtorët bënë kërdinë mbi to, duke i sprapsur me vegla e mjete të ndryshme pune. Fluturimi i ulët i aeroplanëve të luftës përmbi qytetet dhe fshatrat e Kosovës, që kishte për qëllim të mbillte panik te popullsia jonë, mbeti pezull si kërramëz vdekjeje e një përbindëshi anakronik të dëshpëruar deri në kulm. Të arrestuarit u mbajtën heroikisht gjatë hetimeve, kurse në gjyqe hynë me grushta të ngritur lart luftarakisht,

brohoritën parullat revolucionare që kishin thirrur edhe gjatë demonstratave, e para gjyqtarëve deklaruan haptazi e me guxim se nuk e pranojnë këtë gjyq, se ata i binden vetëm gjyqit të popullit shqiptar.

Fshatarët, punëtorët dhe mbarë punonjësit kosovarë morrën qëndrim të patundur gjatë diferencimeve politike, të cilat ose i bojkotuan, ose i shfrytëzuan si skena për të deklaruar haptazi se kërkesat e demonstruesve ishin të drejta dhe se gjyqet ushtarake jugosllave po vepronin në mënyrë të paligjshme e të dënueshme, duke dënuar të rinjtë dhe popullin shqiptar me burgime jashtëzakonisht të rënda për kërkesa që më në fund i parashikon edhe vetë kushtetuta jugosllave.

Gjatë gjithë kohës, pas demonstratave e këtej, asnjë çast nuk pushoi shkrimi i parullave mbi mure, rrugë e kodra, as aksionet e ndryshme në organizimin e grevave, në çarmatosjen dhe likuidimin e patrullave policore, në prishjen e mbledhjeve diferencuese nëpër bashkësitë lokale të fshatrave e të lagjeve, të qyteteve. Sa më i egër që bëhet sulmi frontal antishqiptar i serbomëdhenjve me masa politike e shtetërore, aq më e vetëdijshme po bëhet popullsia jonë për rrezikun më të ri nga zhdukja fizike e asimilimi, aq më shumë rinia e populli ynë po i shtrëngojnë radhët e veta, aq më shumë forcat tona të organizuara revolucionare e patriotike po e marrin veten dhe po përgatiten që lufta e ardhme të mos i zërë ngushtë për asgjë.

As që mund të ndodhë ndryshe.

Siç e ka thënë qëmoti shoku Enver Hoxha, edhe në Jugosllavi vepron ligji i revolucionit, edhe këtu ekziston situata revolucionare. Kriza e rëndë ekonomike që e ka mbërthyer vendin, lufta e serbomëdhenjve për hegjemoni mbi popujt e tjerë të federatës jugosllave, në një anë dhe rezistenca e klanit kroato - slloven ndaj këtij hegjemonizmi në anën tjetër, kanë bërë që, sidomos pas vdekjes së satrapit Tito, të dalë dita me ditë në sipërfaqe pakënaqësia e disa popujve dhe e disa shtresave shoqërore, e cila e ka dobësuar në masë të madhe aftësinë e udhëheqjes kolektive të Beogradit për ta qeverisur vendin. Demonstratat e Kosovës ishin pasojë e "acarimit përtej acarimit të zakonshëm të varfërisë dhe mjerimeve të klasave të shtypura", pasojë e diskriminimit të gjithanshëm të popullit shqiptar në Jugosllavi. Këto demonstrata e mprehën edhe më situatën revolucionare. Klasat sunduese, siç doli sheshit tani, nuk janë më në gjendje ta mbajnë në duar situatën me mjete të rëndomta politike. Për më tepër, këtë gjë ato nuk po mund ta bëjnë as me masat më rigoroze shtetërore,- me ushtri e polici. Pas 11 marsit u shtua shumë "aktiviteti i masave, të cilat në kohë "paqeje" lejojnë t'i grabisin me qetësi, por të cilat në kohë stuhie tërhiqen, si nga atmosfera e krizës, ashtu edhe nga vetë "shtresat e larta" në veprime historike të pavarura "

Mësimi i parë që duhet të nxjerrim ne nga situata e krijuar është se qeveria e Beogradit s'para heq dorë nga aspiratat pushtuese e kolonializuese, nga mjetet për asimilimin dhe shfarosjen e popullit shqiptar në Jugosllavi. Dhe jo vetëm kaq, por ajo nuk ka reshtur së menduari edhe për shkatërrimin e Shqipërisë së pavarur. Për të përmbushur këto qëllime, ajo nuk heziton të hyjë në marrëveshje të fshehta ushtarake me përkrahësen e saj të vjetër pansllave, Rusinë e carëve të rinj Qeveria e Beogradit do të përdorë edhe në të ardhmen diskursione për mashtrimin dhe përvetësimin e popujve të tjerë të Ballkanit, siç provoi me grekët pas shpërthimit të demonstratave tona. Në situatën e ndërlikuar ndërkombëtare, nga e cila mund të shpërthejë herët a vonë edhe një luftë e tretë botërore me përmasa shkatërruese duhet të jemi vigjilentë tej mase dhe të vetëdijshëm për detyrën historike të popullit shqiptar në Jugosllavi, i cilit duhet të bëhet mur i pakapërcyeshëm për jugosllavët në drejtim të sulmit të tyre eventual mbi Shqipërinë socialiste.

Kërkesa për t'iu njohur shqiptarëve në Jugosllavi e drejta që të kenë republikën e tyre kombëtare, po zhagitet tej mase nga ana e qeverisë shoviniste të Beogradit. Kjo qeveri e ka njëmij herë të qartë se këtë kërkesë nuk e ka shtruar një "grusht armiqsh" siç i kanda asaj ta thotë, por një popull i tërë dymilionësh. Për sa mund të gjykohet tash për tash, dy mund të jenë arsyet e zhagitjes së kësaj kërkese; shqyrtimi, nga ana e Beogradit, i mundësive për të hyrë në marrëveshje të fshehta ushtarake me fuqitë e mëdha dhe me shtetet fqinje ballkanike (sipas traditës së vjetër të dhelprës Serbi), me anën e të cilave do të bëhej e mundshme jo vetëm sakatosja e zhvillimit të mëtejshëm të popullit shqiptar në Jugosllavi, por edhe sulmi eventual mbi Shqipërinë; dhe, e dyta, përfitimi në kohë e përgatitje që, edhe kur të shtrëngohet t'ua njohë shqiptarëve të drejtën e Republikës, këtë gjë ta bëjë me cungime territoriale dhe me reduktimin e të drejtave kushtetuese që sjell me vete statusi i Republikës. Një arsye e tretë mund të jetë edhe iluzioni i serbomëdhenjve se do ta bëjnë zap me ushtri e polici popullin shqiptar dhe do ta detyrojnë atë të heqë dorë jo vetëm nga kërkesa për republikë, por edhe nga disa të drejta formale, që gëzonte ai para shpërthimit të demonstratave.

Sa do t'u shkojë kjo përdorësh serbomëdhenjve, u pa që dhjetë muaj.

Karshi zhvillimit të tillë të ngjarjeve, për forcat tona të organizuara patriotike e revolucionare, për rininë dhe popullin tonë dalin detyra serioze, të barasvlershme me përpjekjet historike shekullore për ekzistimin e kombit shqiptar në tërësi dhe për këmbënguljen në realizimin e të drejtave të ligjshme të pjesës së robëruar të popullit tonë nga shovinistët jugosllavë, në veçanti.

Po të kihet parasysh pesha historike e situatës aktuale, një detyrë prioritare del bashkimi optimal i organizatave e grupeve komuniste, patriotike e revolucionare, të cilat luftën kombëtare dhe shoqërore të popullit tonë të shumëvuajtur e marrin në tërë seriozitetin e saj. Ato grupe e organizata, që bëjnë lojën e "politikës së madhe", lojën e arrivizmit revolucionar, të udhëhequra prej karrieristësh megalomanë, dhe ato që janë organizuar prej elementësh të dyshimtë e tani mbjellin në radhët e njerëzve tanë anarki dhe sjellin dezinformime në fitim të qeverisë së Beogradit, i ftojmë të heqin dorë nga rruga e tyre e gabuar. Gjaku i derdhur, burgu i zi dhe terrori çnjerëzor që po ushtrohet mbi bijat dhe bijtë e Kosovës, na obligon që Atdheut tonë t'i dalim hakut me një dashuri që bëhet, - siç thotë Kadareja, - me ngut, me alarm, me përpjekjet mbinjerëzore të luftëtarëve të vërtetë të lirisë.

Në momentin e tanishëm është e domosdoshme të bëhet rishqyrtimi i të metave të shfaqura deri më tash në punën revolucionare; përmirësimi i teknikës së konspiracionit, arritja e një cilësie më të lartë të punës agjitative e propagandistike, në zgjerimin e radhëve me forca të reja, siç implikojnë kushtet e luftës, iniciativa revolucionare për aksione të guximshme luftarake, që e dobësojnë armikun dhe sjellin besim të ri te rinia dhe populli ynë heroik.

Nga ana tjetër rinia me hovin e saj revolucionar, që doli në dritë sidomos gjatë demonstratave dhe pas tyre duhet ta intensifikojë edhe më tej iniciativën revolucionare për aksione që armikut s'i lenë mundësi e kohë të mendojë e të planifikojë në mënyrë komode. Rinia, ky burim i pashtershëm i forcave revolucionare, ka detyrën serioze që ta hutojë armikun hap pas hapi, t'ia humbë atij orientimin me aksione të menduara e të zhdërvjellëta, t'ia shuajë armikut zërin e propagandës, duke propaganduar e agjituar vetë në mënyrë energjike e në shkallë sa më të gjerë te popullsia jonë dhe kështu të përgatisë terren e të hapë shtigje për aksione të rëndësishme luftarake të forcave tona të organizuara patriotike e revolucionare.

Tashmë ka ardhur koha që punëtorët tanë trima, të cilët iu bashkuan me aq vendosmëri rinisë revolucionare në demonstrata dhe u përleshën heroikisht me milicinë fashiste serbe, të mendojnë me seriozitet për ngritjen e vetes së tyre në një shkallë më të organizuar. Si shtyllë e luftës së ardhme, ata duhet të marrin masa përgatitore që lufta të mos i zëri ngushtë. Për këtë arsye është e nevojshme që proletarët dhe gjysmë proletarët tanë, si në qytet ashtu edhe në fshat, të tregohen më të hapur ndaj agjitacionit dhe propagandës së forcave tona të organizuara revolucionare dhe më të mbyllët për propagandën e armikut. Punëtorëve u bie barra e rëndë që armikut t'ia japin grushtin më të madh, në fillim në planin ekonomik, - me bojkotime e greva, e më vonë edhe në frontin e luftës. Ne jemi të mendimit se tashmë ka ardhur koha si për punëtorin ashtu edhe për fshatarin tonë, që ata të nxjerrin në rend të ditës dhe t'i përmbahen parullës:

Ç'KE BERE SOT KUNDER ARMIKUT?

Asnjë ditë nuk duhet të na kalojë pa i sjellë një dëm sado të vogël armikut të egër serbomadh, deri sa të mos ngritemi në një shkallë të tillë që të mund të organizojmë edhe aksione të tipit më të lartë të organizimit revolucionar, siç janë grevat e përgjithshme në shkallë kombëtare. Në drejtim të grevave, megjithatë, qysh tash mund të marrim mësim nga punëtorët e kombinatit ndërtimor "Ramiz Sadiku" në Prishtinë dhe nga ata të xeherores "Trepça"

Një aktivitet i dukshëm revolucionar u zhvillua muajve të fundit edhe mes punëtorëve kosovarë në mërgim. Ata organizuan demonstrata të fuqishme në shenjë proteste për intervenimin ushtarako – policor të serbomëdhenjve në Kosovë dhe në shenjë solidariteti me kërkesat e rinisë e të popullit tonë, pjesë e pandashme e së cilës janë edhe vetë, në kulmin e revoltës, ata morrën në duart e veta të ashtuquajturat klube shqiptare dhe përzunë prej tyre përfaqësuesit diplomatikë jugosllavë, që këto klube i përdornin si çerdhe agjenturore për denigrimin e punëtorëve shqiptarë në botën e jashtme. Tani punëtorët tanë mërgimtarë po bojkotojnë thuaja çdo tubim dhe çdo manifestim, me të cilat jugosllavët përpiqen ende t'u hedhin atyre hi syve dhe t'i përçajnë me prindërit, vëllezërit dhe me motrat e tyre në Atdhe. Punëtori ynë i ndershëm, që me fajin e robërisë u detyrua jo vetëm të shesë në Perëndim krahun e punës, por, edhe të bjerë për shumëçka viktimë e propagandës denigruese, çnjerëzore të titistëve, duhet ta kuptojë edhe më shumë se vetëm duke u bashkuar, duke u mbështetur njëri te tjetri, si vëllau te vëllau e duke u përgjigjur një për një thirrjeve që atij i vijnë nga Atdheu i robëruar, vetëm kështu ai do të kryejë me nder detyrat serioze që shtron edhe para tij momenti aktual historik dhe gjaku i derdhur i motrave dhe vëllezërve tanë

Të bashkuar si një grusht i vetëm, me një ide të qartë për detyrat dhe me përkushtimin serioz për realizimin e tyre, duke kërkuar në çdo çast dhe në çdo pore të jetës hallkat e dobëta të makinerisë së egër të armikut e duke i goditur ato atje ku shovinistët serbomëdhenj e presin e nuk e presin, ne do t'i japim një shtytje të re luftës sonë të drejtë, e cila po e shpejton hapin nga dita në ditë dhe nga çasti në çast. (Zëri i Kosovës, janar 1982, faqe 1-2)

72. Komiteti Qendror i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare

Abusus not tollit usum

Nga pikëpamja jonë e luftëtarëve të lirisë përjashtohet si gjë absurde çdo polemikë me atë demagogji titiste e serbomadhe të qeverisë së Beogradit, e cila i ka të gjitha tiparet e rrenës së kulluar edhe për mendjen më të mjegulluar njerëzore. Ne s'kemi pse ta pranojmë, nga ky aspekt, sfidën për t'iu përgjigjur një për një të ashtuquajtur Platformë politike e LKJ për çështjen e Kosovës, e cila u aprovua në Mbledhjen e 22-të të LKJ. Ne hedhim poshtë si të paligjshme të gjitha tezat e kësaj platforme dhe, nga ana jonë, dalim me këtë:

KUNDËRPLATFORMË TË LUFTËTARËVE TË LIRISË

Platforma jonë ngërthen dy momente kyçe: programin minimum të luftëtarëve të lirisë – luftën për Republikën Socialiste të Kosovës, që s'është gjë tjetër pos lufta për autonominë e popullit shqiptar në Jugosllavi; dhe programin tonë maksimum – luftën për realizimin e të drejtës demokratike e leniniste për vetëvendosjen e popullit tonë deri në shkëputje, që është lufta për pavarësinë e plotë kombëtare e shoqërore të shqiptarëve në Jugosllavi.

I

E drejta e popujve për vetëvendosje deri në shkëputje është parim i të drejtës ndërkombëtare dhe i politikës ndërkombëtare, sipas të cilit çdo popull ka të drejtë të vetëvendosë lirisht në cilin shtet donë të jetojë, duke përfshirë këtu edhe të drejtën për formimin e shtetit të vet dhe të përcaktoj vetë formën dhe rregullimin e tij (Mala Enciklopedija "Prosveta", Beograd, botimi i dytë).

Për rrjedhim, çdo shkelje e kësaj të drejte – qoftë fjala për popuj të vegjël apo të mëdhenj – nga ana e shteteve dhe popujve të tjerë, është në kundërshtim flagrant me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe (në parim) tërheq me vete pasoja të rënda për shkelësin.

Jashtë këtij kuadri, siç është fare e logjikshme, nuk ka si të shikohet as çështja e shqiptarëve në Jugosllavi, të cilët përbëjnë një popull e një komb, me gjuhë, histori, kulturë e tradita të lashta. Shqiptarët në Jugosllavi, historikisht, kurrë nuk e kanë pasur mundësinë që ta shfaqin lirisht vullnetin e tyre për të jetuar në shtetin e tyre kombëtar. Paqja e Shën Stefanit dhe po atë vit Kongresi i Berlinit, kanë prerë si me shpatë krahina të tëra nga trungu shqiptar dhe ia kanë aneksuar Serbisë dhe Malit të Zi. Po kështu kanë vepruar fuqitë e mëdha të kohës edhe në Konferencën e Ambasadorëve në Londër më 1913, në Paqen e Versajës më 1919 dhe në Konferencën e Paqes të Parisit më 1946. Për rezultat, më shumë se gjysma e trojeve shqiptare dhe gati gjysma e popullsisë shqiptare, për vullnetin e lirë të së cilës s'ka pyetur njeri, kanë mbetur jashtë kufijve shtetërorë e kombëtarë shqiptarë.

Vetëm një herë shqiptarët në Jugosllavi janë ndodhur afër rrethanave për ta shfaqur vullnetin e lirë për bashkim me shtetin amë, Shqipërinë. Kjo pat ndodhur në Mbledhjen e Bujanit, dhjetor 1943-janar 1944. Rezoluta e kësaj mbledhjeje i çoi peshë shqiptarët në Jugosllavi që të ngriheshin si petrita dhe të skuqnin tokën stërgjyshore me gjakun e tyre në luftë kundër okupatorëve nazi-fashistë italo-gjermanë. Kjo gjë, sipas Rezolutës së Bujanit, shqiptarëve në Jugosllavi ua bënte të mundshëm bashkimin me

Shqipërinë. Por, siç u vendos në AVNOJ dhe siç doli në realitet gjatë këtyre dyzet vjet robërie nën Jugosllavinë titiste, duke u shkelur vendimet e Mbledhjes së Bujanit, u provokuan ligësisht aspiratat e ligjshme shekullore të shqiptarëve në Jugosllavi. AVNOJ-i vendosi që tokat shqiptare të "trashëguara" nga kralët e vjetër të Serbisë e të Malit të Zi jo vetëm të mbaheshin sërish nën thundrën jugosllave, po edhe të copëtoheshin më tej mes tri republikave sllave.

Duke u mbështetur në rrethanat historike krejtësisht brutale e të disfavorshme për popullin tonë, serbët, gjatë sundimit të tyre afro 70 vjeçar mbi tokat shqiptare, janë përpjekur me kohë ta ngrisin në tezë shkencore pretendimin mbi të drejtat historike dhe etnike (!) të tyre mbi këto toka.

Si përgjigje për këtë pretendim, ne shtrojmë pyetjen që shtronte në fillim të këtij shekulli Lenini: A i zotëron në mënyrë të ligjshme paratë një batakçi, që i ka shtënë në dorë me kambial fals? Dhe, të gatshëm për ta çuar në vend të drejtën, e cila, siç thotë populli ynë, vonon por nuk harron, ja ku përgjigjemi vetë se për ne sot ka dalë "Ma mirë flakë e kuqe se futë e zezë."

II

Një premtim tjetër i "komunistëve" jugosllavë pasqyrohet në disa deklarata të shtypit komunist dhe të vetë satrapit Tito para e gjatë Luftës II Botërore: se shqiptarëve, në qoftë se nuk deklarohen për bashkim me vendin e tyre amë, duhet t'u takoj gjithsesi republika kombëtare brenda federatës jugosllave. Ky premtim, i përmendur disa herë në dialogun mes "Zërit të popullit" dhe Tanjugut, asnjëherë nuk u demantua nga jugosllavët dhe nuk ekziston as më i vogli dyshim për vërtetësinë e tij. Dhe duke qenë kërkesa e shqiptarëve për republikën e tyre kombëtare brenda federatës një kërkesë sa e ligjshme aq edhe e logjikshme, ajo u shtrua nga studentët në Demonstratat e vitit 1968 dhe u shua me gjak; së dyti u shtrua më 1974 nga intelektualët e Kosovës dhe u refuzua me demagogji, e demagogjia titiste u pranua pa zhurmë nga renegatët shqiptarë. Dhe sërish kjo kërkesë po shtrohet sot me këmbënguljen më të madhe, të ujitur edhe me gjak, nga mbarë populli shqiptar në Jugosllavi, dhe sërish po shtypet nga serbomëdhenjtë, po tani me tanke e bajoneta, me pushtetin ushtarak që është vendosur në Kosovë.

III

Serbomëdhenjtë duan të thonë se shqiptarët e paskan konsumuar të drejtën e tyre për vetëvendosje deri në shkëputje, se ata paskan zgjedhur vetë të jetojnë në kuadrin e Jugosllavisë titiste. Kur, ku e si? Këtë s'kanë si ta thonë, se kjo është një gënjeshtër e ligë. Ata duan të thonë se shqiptarët e kanë konsumuar edhe kërkesën për republikën e tyre kombëtare brenda Jugosllavisë dhe kanë zgjedhur që të ngelin nën Republikën e Serbisë, të Malit të Zi e të Maqedonisë! Po kur dhe si?...

Ne u themi atyre:

1) Se kjo nuk është e vërtetë. Po të kenë argumente, le t'i nxjerrin, ç'po presin më!

2) Se, edhe sikur kjo të kishte qenë e vërtetë, vullneti i lirë i një populli nuk është artikull i konsumit të gjerë që mund të konsumohet njëherë e përgjithmonë. Në botë nuk ka ligje absolute, ecuria njerëzore shkon duke shkelur, në bazë të dialektikës, gjithë ato ligje që deri më dje janë dukur të mira, kurse sot bëhen pengesë për progresin e shoqërisë përgjithësisht dhe të popujve në veçanti. Prandaj shqiptarët e kanë kurdoherë të drejtën të shprehin vullnetin e tyre të lirë, qoftë për të kërkuar status republike për Kosovës, qoftë për t'u bashkuar me Shqipërinë.

Kërkesa e shqiptarëve për Republikën e Kosovës, siç tha Arbër Korabi, edhe në mos qoftë në germën, është në frymën e Kushtetutës jugosllave. Përnga numri, shqiptarët përbëjnë popullin e tretë me radhë në Jugosllavi. Konstitucioni i republikës në federatën

jugosllave nënkupton një territor kompakt etnik. Shqiptarët janë kompakt në të gjitha tokat shqiptare nën Jugosllavi. Pastaj, në Jugosllavi kanë republika edhe popuj më të vegjël, siç janë maqedonasit dhe malaziasit, që së bashku edhe me hungarezët nuk bëjnë vetëm sa ka shqiptarë në Jugosllavi.

Qeveria jugosllave e ka të qartë se shqiptarët kanë vendosur ta kundërshtojnë me luftë këtë padrejtësi. Ata edhe po të duan të jetojnë ende në bashkësinë federative, kurrsesi nuk duan më të jetojnë nën sqetullën e Serbisë.

Kjo e tmerron qeverinë e Beogradit, të cilën e mbajnë në këmbë shovinistët serbomëdhenj. Egërsia dhe paturpësia e tyre u ngjit në kulm në Mbledhjen e 22-të të LKJ, kur qeveria doli me parullën se, sa i përket LKJ-së, "Kosova – Republikë" brenda Federatës dhe Kosova – Republikë jashtë Federatës jugosllave janë njësoj"! Dhe ne këtë e kemi pritur, sepse jemi të vetëdijshëm se kështu e ka logjika e shovinistëve serbë.

Por, në emër të kujt flasin kështu serbomëdhenjtë?

Në mbledhjen e përmendur nuk na ra të dëgjojmë duke sulmuar kërkesën e kosovarëve për Republikë thuaja asnjë përfaqësues nga republikat e Sllovenisë, Kroacisë dhe B e H. Për më tepër, ka indikacione të qarta dhe mendime në shtypin e vendit e atë të huajin, që thonë se ky nuk është fare mendimi as i udhëheqjes e as i popujve në Slloveni, Kroaci dhe B e H. Çka do të thotë LKJ për protestat e studentëve kroatë e sllovenë kundër represalieve të egra të serbomëdhenjve mbi popullin dhe rininë shqiptare? E marrim me mend sa janë tmerruar serbomëdhenjtë kur qeverisë iu paraqit protesta e nënshkruar nga 119 studentë të Universitetit të Beogradit kundër dënimeve drakoniane të rinisë kosovare, që vlerësohet si protesta më e madhe në Jugosllavinë e pasluftës!

Kjo s'do të thotë gjë tjetër veçse dalje në shesh të abuzimeve të rënda ndaj Kushtetutës jugosllave nga ana e LKJ. Por, abusus not tollit usum (Keqpërdorimi nuk e suprimon përdorimin e drejtë). Herët a vonë, njerëzit që kanë mbetur ende esëll në Jugosllavinë e dehur, e cila në krizën e saj më të madhe ka ndarë mendjen të sillet si karasevdaliu i fundit i kësaj bote, këta njerëz do t'u japin fund abuzimeve të shumta, sidomos abuzimit të vetë Kushtetutës jugosllave nga ana e serbomëdhenjve, po deshën të shpëtojnë atë që mund të shpëtohet akoma në Jugosllavi.

Sa për popullin shqiptar, "qeveria do të arrijë, ndoshta, ta shtyjë orën e dhënies së llogarisë, por kjo shtyrje e afatit vetëm se do ta bëjë më madhështor hapin e mëtejshëm të sulmit revolucionar dhe asgjë tjetër" (Lenini, Vepra, vëll. 8 botimi shqip, Tiranë 1954, faqe 99).

Populli shqiptar, përveç intuitës për veprimet e drejta e të ligjshme, sot ka nxënë edhe pak dije sa të mund të lexojë e ta interpretojë edhe atë të shkretë Kushtetutë jugosllave. Mbi të gjitha, njeriu ynë po bëhet përditë e më i vetëdijshëm se nuk është populli a që ekziston për kushtetutën, por është kushtetuta që ekziston për popullin dhe që formalisht edhe ka dalë prej popullit. Veç kësaj, shovinizmi i tërbuar serbomadh na ka prurë në atë situatë që, edhe po të avullohen brenda nate të gjitha nenet e të gjitha paragrafet e Kushtetutës jugosllave që kanë mundur të përmbajnë eventualisht ndonjë të mirë edhe për popullin shqiptar në Jugosllavi, ne nuk kemi humbur asgjë nga kjo.

Populli shqiptar në Jugosllavi e ka ngritur sot parullën e fuqishme se:

ASNJË LIGJ, ASNJË KUSHTETUTË NUK PARAQESIN ASGJË PËRPARA VULLNETIT TË LIRË TË NJË POPULLI!

Komiteti Qendror i LNÇKVSH (në Shtutgart)

(Zëri i Kosovës, Janar 1982, faqe 3-4)

73. TË DASHUR LEXUES

Serbomëdhenjtë e kanë pisk me ne. Ata ranë copë duke gënjyer njëri-tjetrin dhe gjithë botën sesi puna me shqiptarët – ja, veç sa nuk është rregulluar krejtësisht. Po kanë fytyrë të thonë ende se nuk qe e gjithë rinis shkollore e studenteske, punëtore e fshatare, se nuk ishin punëtoria e fshatarët ata që dolën në pranverën e shkuar në demonstrata dhe, rrjedhimisht, sesi nuk janë këta, të gjithë së bashku ata që, tok me bllokun e çeliktë të intelektualëve popullorë dhe me forcat tona të organizuara patriotike e revolucionare, ngulën këmbë dhe nuk lëshojnë pe, për asnjë çmim në botë, nga kërkesat e veta të ligjshme, të shtruara me zë të lartë e të spërkatura me gjak. Nga ana tjetër, si kafsha me teke, e cila e ka zënë gishtin e të zot në ije, qeveria e Beogradit ka mbetur duke mbajtur vesh se kush po e thotë në botë një fjalë për të (për realitetin e vërtetë të Jugosllavisë, e jo si do ajo vetë ta paraqesë), në mënyrë që pastaj të klithë me një qyqari nevrike: "Kjo është përzierje në punët e brendshme të Jugosllavisë"!

Tani së fundi, nga alergjia e padurueshme ndaj zërit të Shqipërisë, që është zëri i së vërtetës, qeveria jugosllave la mënjanë mjerimin e saj ekonomik dhe bleu një aparaturë jashtëzakonisht të shtrenjtë, me të cilën po e pengon emitimin e programeve të Radiotelevizionit Shqiptar (një shembull unik në botë, që s'ka provuar ta bëjë asnjë qeveri fashiste deri më sot).

Po mirë, Beogradi thotë se zëri i Shqipërisë flet "në kundërshtim me interesat e shqiptarëve në Jugosllavi"! Ta zëmë se i kemi besuar. Por, ai shton se populli në Kosovë nuk mund të mashtrohet – e për këtë i besojmë qind për qind. Pse, pra, ai nuk lë që populli ynë ta peshojë vetë fjalën e Shqipërisë dhe të mos "mashtrohet" prej saj? Aq më parë, pasi Beogradi na ndihmon të mësojmë aq shumë për "realitetin" në Shqipërinë socialiste. Pse s'lejon që propaganda të shtyhet me propagandë? Beogradit i mbetet një mjet më tepër në luftën e tij të egër antishqiptare – terrori ushtarak e policor mbi rininë dhe popullin shqiptar në Jugosllavi. S'i mjafton ky avantazh!

Kopalla. Por, kopalla që e dëmtojnë pak aktualisht dhe e ndihmojnë shumë në perspektivën e afërme luftën tonë të drejtë.

Tani, sa për aparaturën me të cilën po pengohet programi i Radiotelevizionit shqiptar, ç'të themi? T'ju themi se populli e di vetë ç'bën me pengesat që atij i dalin në rrugë. Kemi frikë se Beogradi do të ngrihet e të na akuzojë se po nxisim "vandalizëm". Mirëpo, o'burrani, në qoftë se pas leximit të kësaj letre, ti popull shqiptar, del dhe e heq pengesën nga rruga, në mënyrë që të mund të dëgjosh zërin e së vërtetës, Beogradi le të çirret sa të dojë. Ai me propagandën shtetërore, me të gjitha forcat e pushtetit të tij të egër, po përpiqet të ndikojë mbi ty – me qëllim që të vrasë ty. Po ne, pse ne, bijtë e tu, me një propagandë kaq modeste, të mos ndikojmë mbi ty – me qëllim që të shpëtosh?!! (Zëri i Kosovës, faqe 3)

74. Vive le son du canon!

Nga artikulli i V.I. Leninit: Parathënie për broshurën 'Promemoria e drejtorit të departamentit të policisë, Lopuhin'

Një i burgosur politik kosovar paska deklaruar para do kohësh se është marksist-leninist i bindur; kur e pyesin më gjatë në hetuesi, ai gjoja qenka përgjigjur se nuk e ka lexua asnjë vepër të Leninit.

Kështu thotë Tanjugu dhe kjo mund të jetë e vërtetë, dhe, edhe po të jetë e vërtetë, s'ka krisur kiameti. Të burgosur politikë shqiptarë - vetëm pas ngjarjeve të përgjakshme të marsit dhe prillit - ka me mijëra, e të paktën janë 232 sish, të shpallur zyrtarisht, që

kanë marrë dënime drakoniane. Dhe në mos të gjithë, në pjesën dërmuese po se po, në mos marksistë-leninistë të ngritur, këta të burgosur janë së paku ithtarë e dashamirës të marksizëm-leninizmit. Dhe kjo mjafton për fillimin e çdo lufte çlirimtare dhe të çdo revolucioni.

Nga ana tjetër, ky është një grusht i rëndë për sistemin e arbitrarizmit policor jugosllav, sado që qeveria e Beogradit, me maskën e "marksizëm-leninizmit" mbi surrat, ushtron një pushtet thellësisht antimarksist, antipopullor e antikombëtar. Prandaj i pëlqen aq shumë Tanjugut ta ngrejë në dukuri çështjen e atij luftëtarit tonë të lirisë, i cili s'e paska lexuar Leninin. Por kjo nuk na brengosë fare, ne jemi të vetëdijshëm që Tanjugu, sikur të kish pasur në dorë shënime qoftë vetëm edhe për një tjetër të burgosur politik shqiptar, "që të mos e ketë lexuar Leninin", nuk do të lente kurrë pa e propaganduar gjerë e gjatë në shtyp me një vetëkënaqësi edhe më të madhe kreteneske. Por, tukse s'e përdori, do të thotë se nuk e gjeti.

Konkluzioni është i qartë. Policia e fshehtë jugosllave, ose në mënyrë më të popullarizuar UDB-ja, përpiqet ta kompromentojë me cinizëm figurën e luftëtarëve tanë të lirisë. Prandaj, me gojën e Tanjugut, ajo bien në 'rezignacion' pse këta nuk e paskan lexuar Leninin! E ç'të mirë mund të pres arbitrarizmi policor jugosllav nëse kundërshtari i tij i lexon veprat e viganit të revolucionit socialist. Ato, a ishin në anën e arbitrarizmit policor, apo pikërisht në anën e kundërshtarëve të tij? Mos, duke lexuar Leninin, luftëtarit tonë do t'i bjerë hovi revolucionarë? Apo do të ngjasë e kundërta.

Megjithatë, pasi i 'pëlqeka' UDB-së, ne që s'e kemi lexuar dhe që e kemi lexuar pak Leninin, tash e tutje do ta lexojmë edhe më me zell.

Ja ç'thotë Lenini për një situatë në Rusinë cariste të vitit 1905. Sa është ajo e ngjashme me situatën e sotme në Kosovë e në viset tjera shqiptare në Jugosllavi, le të konkludojë vetë lexuesi ynë i ndershëm. Tanjugu le të qesë fall me letra, le të shikoj në filxhan të kafesë ose në shpatull të pulës se si do të zhvillohen fatet e mëtejme të shovinizmit serbomadh..."

Ia lëmë fjalën Leninit:

Pak e sak! - duket sikur thotë zoti Lopuhin në promemorien e tij. Një gjë e mirë për policinë është Ligji "i përkohshëm" mbi rojën e përforcuar, që qysh prej vitit 1881 është bërë një nga ligjet themelore më të qëndrueshme të Perandorisë ruse. Policia merr të gjitha të drejtat dhe fuqitë e plota "për t'i mbajtur ndër duar qytetarët", sipas shprehjes së qëlluar të promemories, shprehje që të bie aq më shumë në sy, sa më shpesh ngec duke e lexuar atë ngaqë është shkruar në mënyrat më të rënda, të mbrapshta, burokratike të të folurit. (Për krahasim, lexoni Platformën politike të LKJ për çështjen e Kosovës - red. e "Zërit të Kosovës").

Po policia ra rehat me këtë "Ligj", por vetit e tij "të mira" e llastuan policinë. Kjo nga njëra anë. Kurse nga ana tjetër, masat e jashtëzakonshme të shtypjes, të cilat mund të dukeshin të jashtëzakonshme këtu e njëzet e pesë vjet përpara, janë bërë aq të zakonshme, sa që, nëse mund të shprehemi kështu, edhe popullsia u mësua me to. Vlera represive e këtyre masave të jashtëzakonshme është dobësuar, siç dobësohet një sustë e re nga përdorimi i saj i gjatë dhe jashtë masës. Nuk ia vlen barra qeranë, - thotë drejtori i Departamentit të policisë z. Lopuhin, me tërë promemorien e tij, që bashkohet nga një ton melankolie dhe dëshpërimi.

Një përshtypje jashtëzakonisht të kënaqshme i bën socialdemokratit ky ton dëshpërimi, kjo kritikë konkrete, e thatë dhe megjithatë e pamëshirshme, e një njeriu të policisë, kritik që drejtohet kundër ligjit themeltar të Rusisë. Perënduan ditët e mira të mbarëvajtjes së policisë! Perënduan vjetët 1860-1870, kur as që mendonte njeri se kishte

një parti revolucionare. Perëndoi dhjetëvjetëshi i tetë, kur forcat e një partie të tillë, që padyshim ekzistonte dhe kallte tmerr, ishin "të mjaftueshme vetëm për atentate të veçanta, por jo edhe për një revolucion politik". Në ato kohëra, kur "agjitacioni ilegal gjente mbështetje në persona e rrethe të veçuara", kjo sustë e shpikur rishtas mund të bënte njëfarë efekti. Po sa shumë është shthurur kjo sustë tani, "në gjendjen e sotme të shoqërisë, kur në Rusi po zhvillohet në shkallë të gjerë edhe pakënaqësia kundrejt gjendjes ekzistuese të punëve edhe një lëvizje e fortë opozitare". Sa absurde dhe sa pa kuptim dhe pa kuptim dolën masat e jashtëzakonshme të rojës së përforcuar, kur u bë e nevojshme pikërisht: *u bë e nevojshme* që ato të përdoren me mijëra "kundër punëtorëve për grevat që kishin karakter paqësor dhe synonin në objektiva vetëm e vetëm ekonomike", kur edhe gurët filluan të konsiderohen si armë të rrezikshme nga pikëpamja politike!

I gjori Lopuhin nga dëshpërimi vë dy pikëçuditëse, duke i ftuar zotërinjtë ministra të qeshin bashkë me të me pasojat absurde, në të cilat çoi ligji mbi rojën e përforcuar. U pa se asgjë s'vlen në këtë ligj që kur lëvizja revolucionare depërtoi si duhet në popull dhe u lidh pazgjidhshmërisht me lëvizjen klasore të masave punëtore, - asgjë, duke filluar që nga regjistrimi i pasaportave dhe duke mbaruar me gjyqet ushtarake. Edhe "instituti i portierëve", instituti i mrekullueshëm shpëtimtar i portierëve i nënshtrohet një kritike asgjësuese nga ministri i policisë, që e akuzon këtë institut pse ka ushtruar një influencë dobësuese mbi aktivitetin preventiv të policisë.

Me të vërtetë, një falimentim i plotë i rendit policor!

Dhe ky falimentim vërtetohet, përveç deklaratave të një personi aq kompetent, si shumë i nderuari z. Lopuhin, nga gjithë procesi i zhvillimit të politikës cariste. Atëherë, kur akoma nuk kishte një lëvizje revolucionare me të vërtetë popullore, kur lufta politike akoma nuk përbënte një të tërë të pandarë me luftën e klasës, atëherë ishin të vlefshme vetëm masat policore kundër personave dhe rretheve të veçanta. Kur u drejtuan kundër klasave, këto masa u bënë tepër të pafuqishme dhe qesharake dhe duke qenë kaq të tepërta, ato filluan të bëhen një pengesë për punën e policisë. U pa se paragrafet dikur të tmerrshme të Ligjit mbi rojën e përforcuar s'ishin veçse disa kleçka mezerabël, meskine, të cilat më tepër ndezin pakënaqësinë e "qytetarëve" që nuk bëjnë pjesë në radhët e revolucionarëve, se sa prekin seriozisht revolucionarët. Kundër revolucionit popullor, kundër luftës së klasës, nuk mund të mbështetesh te policia; prapë duhet të mbështetesh te populli, prapë duhet të mbështetesh te klasat. I tillë është morali që del nga promemoria e z. Lopuhin. Dhe i tillë është edhe morali, në të cilën arrin në praktikë qeveria autokratike. U dobësuan sustat e mekanizmave policore. Nuk mjaftojnë më vetëm forcat ushtarake, duhet ndërsyer armiqësia nacionale, raciale, duhet organizuar "qindëshe të zeza" nga shtresat më pak të zhvilluara të borgjezisë së vogël qytetare *(dhe më vonë, natyrisht edhe të borgjezisë fshatare),* duhen bërë përpjekje që të bashkohen për mbrojtjen e frontit të gjithë elementët reaksionarë të popullsisë, duhet shndërruar lufta e policisë kundër rretheve në një luftë të një pjese të popullit kundër pjesës tjetër të tij.

Pikërisht kështu vepron tani qeveria, duke ndërsyer tatarët kundër armenëve në Baku, duke u përpjekur të provokoj pogrome të reja kundër çifutëve, duke organizuar qindëshet e zeza kundër zemistëve, studentëve dhe gjimnazistëve rebelë, duke u bërë apel fisnikëve besnik dhe elementëve konservatorë të fshatarësisë. Ç't'i bësh? Ne, socialdemokratët, nuk çuditemi nga kjo taktikë e absolutizmit dhe nuk trembemi prej saj. Ne e dimë se qeveria nuk do të arrijë të shfrytëzoj ndezjen e armiqësisë raciale tani, kur punëtorët kanë filluar të organizojnë rezistencën e armatosur kundër pogromistëve; ndërsa duke u mbështetur në shtresat shfrytëzuese të borgjezisë së vogël, qeveria do të

bëjë që kundër saj të ngrihen masa edhe më të gjëra me të vërtetë proletare. Ne nuk kemi pritur kurrë dhe nuk presim që revolucionet politike dhe sociale të vijnë nga "bindja" e atyre që kanë fuqinë në dorë ose nga kalimi i njerëzve të kulturuar në anën e "virtytit". Ne kemi thënë dhe themi gjithmonë se lufta e klasave, lufta e pjesës së shfrytëzuar të popullit kundër pjesës shfrytëzuese të tij përbën bazën e transformimeve politike dhe *në fund të fundit* vendos fatin e të gjitha transformimeve të këtij lloji. Duke pranuar dështimin e plotë të metodave policore meskine dhe duke kaluar në organizimin e drejtpërdrejtë të luftës civile, qeveria provon me këtë se dita *e llogarisë së fundit* po afrohet. Aq më mirë. Qeveria po fillon luftën civile. Aq më mirë. Edhe ne jemi për luftën civile. Në qoftë se ne e ndiejmë gjëkundi veten veçanërisht të sigurt, është pikërisht në këtë fushë, në luftën e masës kolosale të popullit të shtypur dhe pa të drejta, të popullit shumëmilionësh, që punon dhe mban të gjithë shoqërinë kundër një grupi parazitësh të privilegjuar. Sigurisht, duke ndezur armiqësinë raciale dhe urrejtjen midis kombësive, qeveria mund ta ndalojë përkohësisht zhvillimin e luftës së klasave, por kjo vetëm për një kohë të shkurtër dhe me çmimin e një zgjerimi akoma më të madh të fushës së luftës së re, me çmimin e zemërimit akoma më të madh të popullit kundër absolutizmit. Prova: pasojat e pogromit të Bakusë, i cili bëri që shpirti revolucionar i të gjitha shtresave të popullsisë kundër carizmit të dhjetëfishohet. Qeveria mendonte ta frikësonte popullin me derdhjen e gjakut dhe me viktimat e panumërta të përleshjeve nëpër rrugë - po në të vërtetë ajo *po ia nxjerrë popullit frikën* nga gjakderdhja, nga përpjekjet e armatosura të drejtpërdrejta. Në të vërtetë ajo po vepron në favorin tonë me një agjitacion aq të gjerë dhe aq bindës, sa që ne as që e kemi ëndërruar. Vive le son du canon! themi ne, duke përdorur fjalët e këngës së revolucionarëve francezë - "Rroftë gjëmimi i topave!", Rroftë revolucioni, Rroftë lufta e hapur e popullit kundër qeverisë cariste dhe përkrahësve të saj.

Artikulli është marrë nga vëllimi i 8 i veprave të Leninit, botimi shqip, Tiranë, 1954

(Zëri i Kosovës, janar 1982, faqe 10-11)

75. NË DIJENI VËLLEZËRVE QË NDODHEN NË SHËRBIMIN USHTARAK

Ti, vëlla, që ndodhesh me shërbim ushtarak; në Postojnë, në Dërvar, në Sisak, në Suboticë e në Gjevgjeli, a e di ti se nuk është punë e rastit që nuk je me shërbim në Pejë, Gjakovë Prizren, Prishtinë, Gjilan, Kaçanik e gjetkë nëpër viset shqiptare?

Të parët e tu kanë qenë me shërbime ushtarake në Edrene, në Çanak – Kala e deri në Jemen. Atje i lanë kockat, ose u kthyen me tabute në trojet e veta. Edhe kur ndodhte të ktheheshin gjallë në shtëpi, atje gjenin babanë të vdekur, nënën të verbuar nga lotët gruan duke u martuar me burrë tjetër; shtëpinë të rrezbitur, atin duke u shitur në treg.

Ju, vërtet, të shumtën as i leni kockat atje ku jeni, as ktheheni mbi tabute, se Jugosllavia nuk është Turqia e dikurshme, që të hapë fronte. Por, ju keni lënë familjet në banesat me qira, pa asnjë rrogë e kompensim tjetër. Si do ta gjeni kur të ktheheni . Edhe sot në shtëpitë tuaja hynë pa trokitur njerëzit e UDB-së, vjen milicia me automatik, bastis dhe arreston vëllezërit, baballarët e motrat tuaja; vjen këshilli i lagjes a i fshatit dhe i kërkon nënës suaj plakë që të garantojë për vëllanë tuaj të vogël – se nuk do të bëjë demonstrata dhe “marrëzira” të tjera!!! Me se dhe nga kush do të paguhen 15 muajt e zez nën rrobën e përhimtë, të urryer, të ushtrisë fashiste jugosllave?!

Dhe, po të hapë nesër front kjo qeveri kokëshkretë, a e dini, vëllezër, me kë e ka mendjen ajo të hapë luftë? Mos me të mëdhenjtë? Jo. Me të vegjëlit ka punë ajo. Me shqiptarët në Jugosllavi, të dërmuar prej saj me robëri e vuajtje dyzetvjeçare, dhe me shqiptarët në Shqipërinë socialiste. Ika hyrë mendja se e gjen shqiptarin siç e pat gjetur dikur, të dërmuar luftërash kundër fuqive të mëdha të kohës! A e keni marrë vesh se perspektiva e luftës, që serbomëdhenjtë po e nxisin me të katrat, nuk është fort larg? Dhe, kur të çelet ky front, vëllezër, a jeni ju ata që do të shtien kundër prindërve dhe motrave tuaja? E pra, për këtë llogari ju merr ju në ushtri Jugosllavia, këta ujë vak ajo në zjarr!

Po tash që lufta ende s'ka plasur haptazi, kur të ktheheni nga shërbimi ushtarak, a ju pret këtu puna? A do të mund të regjistroheni në fakultet apo t'i vazhdoni studimet? Ti, vëlla student, që ndodhesh në shërbimin ushtarak, s'dëgjove si tha Beogradi? Studentët kosovarë po i zvarrisin studimet vetëm për t'iu shmangur shërbimit ushtarak! Ky ishte preteksti i Beogradit për t'ju larguar ju masivisht nga Universiteti, domethënë për t'ju larguar masivisht nga demonstratat, nga lufta për liri.

Tani atje ju thërresin në mbledhje, ju flasin zi e më zi për motrat e vëllezërit tuaj në Kosovë, ju flasin zi e më zi për nënën Shqipëri dhe përpiqen t'ju ushtrojnë (ç'ironi) e t'ju ushtrojnë që nesër asaj t'ia drejtoni grykën e pushkës.

Në orët politike ju bëjnë pyetje provokative, ju fyejnë e ju poshtërojnë me fjalë. Pastaj vijnë eprorët e ju lusin të bëheni anëtar të LKJ. Pse? Së paku sot duhet ta keni fare të qartë këtë.. Për asgjë tjetër, veçse për t'ju ndërsyer kundër njëri tjetrit, të kallëzoni gjithçka për shoku-shokun, që pastaj të kthehen e t'ju hanë vetë, më leht, veç e veç. Ju s'duhet të harroni për asnjë moment se – deri sa përpiqen t'ju denigrojnë ju në ushtri, qoftë me lajka e fjalë të buta (tashmë po duket sheshit se sherbeti i tyre është më i zi se helmi), qoftë me sharje, fyerje e provokacione – në trojet tuaja të dashura po shkretojnë tanku e bajoneta, ushtari e milici fashist serb.

Ju e dini si e keni lënë situatën në Kosovë dhe si është ajo tani. Bëni krahasime me situatën që përshkruhet në revistën ushtarake "Front" A e dini pse kanë rënë aq ngushtë serbomëdhenjtë sidomos ata në ushtri për ta fshehur realitetin në Kosovë? Pse u ka hyrë atyre lepuri në bark? Sepse, s'ka armë më të fuqishme se pezmi i popullit, që ka vendosur të marrë në dorë fatet e veta. A ju kanë treguar ndonjëherë në orët politike se cilët janë faktorët vendimtarë të një lufte? Faktori vendimtar është njeriu, vëllezër, pra unë e ti dhe shoku që ke pranë.

A ju kanë treguar ndonjëherë sa është përqindja e shqiptarëve në ushtrinë jugosllave? Sekret ushtarak? Natyrisht. Madje, shumë dëshpërues për serbomëdhenjtë. Që më 1974, sipas informatave sekrete, çdo i katërti ushtar në APJ ishte shqiptar. Po sot?. Shumë më tepër, merret vesh.

Ti vëlla duhesh të nxjerrësh konkluzione. Të takojnë së paku katër ushtarë për t'i bërë zap në rastin më kritik. Ne mund të themi se detyra jote – në rastin më kritik – do të dalë më e lehtë. Beogradi thirret në çdo ushtar me uniformë dhe në çdo banor të Jugosllavisë dhe don të thotë se ata janë të shastisur për ta mbrojtur atë – në rastin kritik. Por, ti e di se shumica e ushtarëve dhe sidomos popullsia s'e bëjnë asnjë hap për këtë qeveri të fëlliqur. Gjithçka që bëhet në Jugosllavi, bëhet të shumtën nga zori.

E dhuna e përjashton idealin. Kurse pa ideal s'ka fitore në asnjë luftë. Ata kanë thënë ndonjëherë këtë në orën politike?

A të ka shkuar ndonjëherë mendja pse ty, si shqiptar që je, nuk të mësojnë në ushtri thuaja asgjë tjetër pos për pjesët dhe përdorimin e pushkës. Ne nuk e përbuzim atë, shqiptarët gjithmonë, në momente kritike, i ka mjaftuar një pushkë – e vjetër. Asgjë pos pastrimit të oborrit, të korridorit, të nevojtoreve, pos rregullimit të krevateve?

E vetmja arsye është se armiku ta di fuqinë dhe i frikësohet shumë fuqisë sate, syrit tënd shqiponjë, që ia kall tmerrin serbomadhit në të gjitha qitjet ushtarake. Ai nganjëherë, për syrin dhe gishtin tënd të sigurtë, edhe të lavdëron e të gradon, por këtë e bën nga frika që ka ai në perspektivë prej teje dhe me qëllim që të të blejë.

Por a do të shitesh ti sot te serbomadhi? A do ta shesësh te ai vëllanë a shokun që ke pranë? Do të kish qenë një mallkim i tmerrshëm . Do të të mallkonin toka dhe populli yt. Ata ta kanë nevojën, jo serbomadhi. Atyre duhet t'u dalësh zot, jo serbomadhit. Edhe po i dole zot atij, ta dish se serbomadhi, posa ta fitojë luftën – në qoftë se ende ka luftë të cilën mund ta fitojë ai – për ty ai s'do të ketë gjë tjetër pos një thike pas shpine. Serbomadhi s'pranon tjetërkë në "fisin" e tij pos serbomëdhenjve. A dëgjon se si ty dhe popullin tënd ai sot po i quan haptazi racë e ulët?!

Këtë desha të ta them. Ti ende nuk ka mundësi të vendosësh vetë për çkadoqoftë. Ty të ka lidhur si rob uniforma që mban. Por, ti ke dalë nga gjiri i atij populli, i cili ka vendosur ta marrë në dorë fatin. Dhe kjo është pasuria më e madhe. Pasuria do ruajtur dhe ajo ruhet duke u kujdesur për të gjitha pjesët e saj, më të imtat deri në më të mëdhatë. Ruaje, pra, shokun dhe vëllanë që ke pranë dhe kështu do të ruash popullin tënd. Lidhu me të dhe mos lejo të të hyjë ndërmjet serbomadhi.

Asnjëherë mos harro që armikut s'duhet t'i shitësh asgjë. Blej sa më shumë prej tij; studioja fuqinë, teknikën, taktikën. Kurrë nuk mund të jesh i sigurt se kur do të hyjë në punë dija që ke nxënë.

Në qoftë se jemi marrë vesh për këto që thamë, për të tjerat nuk do ta kesh vështirë as vetë. Ti je po ai që në mars e prill të vitit të kaluar bëre me demonstrata, me shokët e tu, kërdinë mbi armikun. Mos harro se ti je ai që ke qenë. (Zëri i Kosovës, janar 1982, faqe 13 dhe 16)

76. Yje të pashuar në qiellin e Kosovës
NJËRI NGA ATA

Kryengritja popullore, që përfshiu mbarë Kosovën dhe që tronditi nga themelet pushtetin jugosllav, është një ngjarje e shënuar në historinë e popullit shqiptar. Bijtë e bijat e popullit tonë, në mars e prill të vitit të kaluar, u ngritën në demonstrata, duke shprehur me to kërkesat e ligjshme e të drejta të popullit tonë dhe duke ia bërë me dije të gjithë botës se në ç'gjendje të mjeruar e ka lënë qeveria e Beogradit popullin shqiptar në Jugosllavi.

Pasi u sulmuan të rinjtë nga ushtria jugosllave dhe milicia speciale serbe e sjellë nga të gjitha anët e Serbisë, populli i revoltuar u prek edhe më tepër dhe, nga demonstrimi i qetë në fillim, gjithë ngjarjen u shtrëngua ta kthejë në një kryengritje popullore. Sulmeve të ushtrisë e të milicisë me pushkë automatike, me autoblinda, tanke e helikopterë, populli ynë heroik iu përgjegj me gurë, me shkopinj e me çka i erdhi përdore. Në ballë të betejave qëndronin bijat dhe bijtë më të mirë të Kosovës kreshnike dhe të viseve të tjera shqiptare të pushtuara nga Jugosllavia.

Njëri nga ata që nuk e braktisi për asnjë çast kreun e turmës së kryengritësve, qe edhe Xhelal Maliqi, punëtor nga Prishtina.

Xhelal Maliqi u lind më 11 janar 1957 në Prishtinë. Ai ishte djali i pestë i Abdylit dhe i nënë Myhybes. Duke qenë fëmija më i vogël, ai ishte më i përkëdheluri në familje, si nga prindërit, ashtu edhe nga të katër vëllezërit e mëdhenj.

Familja Maliqi mbahej me rrogën e vogël të babë Abdylit, shërbëtor në Spitalin e Prishtinës. Prandaj Xhelali nuk arriti të shkollohej si shokët e tij. Qysh fëmijë i vogël, ai u detyrua të punonte çirak në dyqanin e një qebaptori. I zoti i dyqanit dhe punëtorët tjerë e donin dhe ia kishin hatrin, se Xhelali ishte i shkathët, i vyer e i ndershëm. Ato pak para që merrte me djersën e tij djaloshare, të derdhur që nga orët e hershme të mëngjesit e deri në mbrëmje vonë, rregullisht ia dorëzonte nënë Myhybes.

Xhelali u lind në një kohë kur populli shqiptar po përjetonte një nga çastet më të vështira në historinë e tij, aksionin famëkeq të armëve, të ushtruar nga këlyshët çetnikë të Rankoviqit. Më vonë, duke u rritur, ai mësoi për shumë fatkeqësi që i kishin rënë mbi kokë familjes dhe popullit të tij. Ai sa vinte e mbushej urrejtje ndaj shkaktarëve të këtyre fatkeqësive dhe dashuri të pamatë ndaj atyre që luftonin kundër padrejtësive e terrorit shtetëror jugosllav që ushtrohej mbi shqiptarët.

Gjatë punës, ai nuk dinte për hile. Duke qenë vetë i varfër, i donte të varfrit, kurse ata që luftonin për të varfrit i adhuronte dhe përpiqej t'i ndihmonte me çka kishte mundësi. Shpesh kishte ngjarë që, rastësisht, në dyqanin ku punonte ai të hynte edhe ndonjë patriot, për të cilin Xhelali kishte kuptuar se është i papunë dhe i ndjekur nga UDB-ja. Prandaj, sa herë që njerëz të tillë vinin në dyqan, ai nuk u merrte para për bukën varfanjake që hanin aty, kurse të zotit të dyqanit ia kompensonte nga xhepi i vet.

Erdhi një ditë që disa punonjës të Radiotelevizionit të Prishtinës, në afërsi të të cilit ndodhej edhe qebaptorja ku punonte Xhelali, duke parë sjelljen e tij shembullore dhe karakterin e një njeriu të vyer, i gjetën një vend pune në RTP.

Një prilli e gjeti në këmbë mbarë Kosovën. Kërkesa "Kosova–Republikë" i theu të gjitha rrethimet e hekurit dhe zjarrit. Ushtria, milicia, tanket, helikopterët, heshtja e vdekur e të gjitha mjeteve të informimit, nuk ia dolën ta ndalnin depërtimin e kërkesave të ligjshme të shqiptarëve deri te opinioni i mbarë botës.

Më 2 e 3 prill Krahina ishte në kryengritje të vërtetë. Populli ishte zemëruar në kulm nga sulmi i egër i ushtrisë dhe milicisë fashiste serbe. E tërë Kosova u mbulua në tym. Shumë shqiptare e shqiptarë u vranë ose u plagosën. Por, edhe ushtria, e sidomos milicia serbe, e paguan shtrenjtë këtë sulm të pamëshirshëm e të pabesë.

Edhe Xhelal Maliqi luftoi me milicinë serbe ashtu si luftoi rinia e mbarë Prishtinës dhe e tërë Kosovës. Natyra i kishte dhuruar trup të qëndrueshëm e fuqi të pashtershme, ndërsa jeta në robëri ia kishte mbushur zemrën me urrejtje ndaj shtypësve dhe me dashuri ndaj tokës e popullit të vet, të shtypur egërsisht. Parulla "Kosova–Republikë" në gojën e turmave ishte e barasvlershme me fjalët: "Duam të jetojmë", "Edhe ne duam të ekzistojmë". Dhe zëri i Xhelalit, gjatë tri ditëve që populli u përlesh me ushtrinë dhe milicinë, i dha zemër e forca të mëdha. Për tri ditë rresht, xhaketa e Xhelalit u mbush me gurë dhe u zbraz mbi kokën e mizorit. Shumë milicë gjakatarë u rrëzuan nga goditjet e fuqishme të Xhelalit.

Për herë të fundit e mbushi me gurë xhaketën e tij Xhelal Maliqi ditën e tre prillit. Dhe nuk arriti t'i hedhë të gjithë gurët, që qenë arma e vetme e tij dhe e popullit gjatë kësaj lufte çnjerëzore të pabarabartë. Forcat policore vinin duke u shtuar si thneglat. Kur i binin nga plumbat e milicisë xhakatare shokët e shoqet, Xhelali nuk trembej, por i shtohej urrejtja, e me të edhe forca për të qëndruar sa më burrërisht. Mirëpo, një plumb automatiku, që e godit mu në zemër, ia ndërpreu luftën Xhelal Maliqit. Në çastet e fundit të jetës ai u bërtiti shokëve përreth: "Mua më goditën, ju vazhdoni… Rroftë populli shqiptar…" Dhe pasi eci ashtu edhe disa metra, ia dha në dorëzim shpirtin e ri përjetësisë.

Shokët dhe vëllezërit e tij nuk lejuan që policia t'ia merrte e t'ia zhdukte kufomën Xhelalit, si bëri me shumë kufoma të dëshmorëve tanë të orëve të para, që ranë gjatë kryengritjes.

Të nesërmen, ndonëse i tërë qyteti ishte bllokuar e të gjitha rrugët e tij ishin mbushur me tanke e autoblinda, prapëseprapë, një numër shumë i madh qytetarësh u mblodhën për ta përcjellë Xhelalin në rrugën e tij të fundit.

Xhelal Maliqi vdiq njëherë për të jetuar gjithmonë në zemrën e popullit të vet, si të gjithë ata bij të tij të shtrenjtë, të cilët dhanë jetën e tyre që të tjerëve t'u sigurohet një jetë më e mirë e më e lumtur. (Zëri i Kosovës, janar 1982, faqe 18)

77. HARAÇI PËR MILICINË SERBE

Deri kur populli shqiptar duhet të paguaj haraç për ata që e shtypin!

Renegatët shqiptarë dhe padronët e tyre serbomëdhenj menduan se, me një goditje të rrufeshme dhe me një çirrje shtazarake të tyre, do të mbyllnin njëherë e mirë çështjen shqiptare. Bënë rrethimin e Krahinës me tanke, sollën ushtrinë dhe milicinë e tyre fashiste, shpallën gjendjen e shtetrrethimit me orën policore, hapën burgjet dhe ngujuan në to bijat dhe bijtë më të mirë të popullit tonë… ç'mund të bënin ata më shumë?!

Por, kaluan javët e muajt dhe po bëhet viti që kur në Kosovë u sollën kopukët dhe kopilat e Serbisë, për ta mbytur kërkesën e ligjshme të popullit shqiptar për formimin e Republikës së Kosovës, kurse këtë s'po e arrijnë dot. Kështu qëndrimi i tyre në Kosovë po bëhet i "domosdoshëm" për një kohë jashtëzakonisht të gjatë. Dhe kjo mizëri kopukësh do racion dy-tre fish. Shqiptarët të nxjerrin telashe, duhet vrapuar pas aksioneve të tyre, e vrapimi t'i shtjer energjitë, të cilat, natyrisht, duhet të kompensohen me kafshatë të majme, me kalori, siç po i thonë milicët. Por, a ishte thënë që bukën e këtyre kopukëve duhej ta siguronte pikërisht populli shqiptar! A s'kishte dalë si vetë në mars e në prill rrugëve për të kërkuar bukë për vete?!

Tani zotërinjtë e Beogradit vendosën: Forcat e reja policore që janë sjellë në Kosovë le t'i mbajë në bukë populli i Kosovës! Urdhri: Çdo të inkuadruari në Kosovë t'i hiqet nga një mëditje për këtë qëllim!

Mirë zotërinj të Beogradit. Ju e keni ditur gjendjen shumë të ligë ekonomike e sociale të Kosovës para demonstratave dhe po e dini gjendjen e saj të tanishme të mjerueshme. Dhe s'po ju mjafton. Keni ndarë mendjen të na mbytni edhe me uri. Por, llogarinë e keni bërë gabim, krejtësisht, si të gjitha llogaritë që bëtë qyshse hytë me ushtri e polici në Kosovë. Ne kemi përballuar dhembjen njerëzore kur na i vratë bijtë dhe bijat më të mira, jo s'po e përballojmë haraçin që na e ngarkoni tash për të mbajtur në bukë vrasësit tanë. Ja ku ju themi se ne jemi të gatshëm të paguajmë, përveç haraçit në gjak, edhe çdo haraç tjetër. Kemi marrë rrugën e lirisë, a s'po e shihni, o të verbër, e në këtë rrugë nuk pyesim për çmime.

Dakord? (Zëri i Kosovës, janar 1982, faqe 18)

78. ARMIKUN TA GRISHIM NË LOGUN QË DUAM VET

Përpara ngjarjeve të Kosovës për udhëheqjen shoviniste serbomadhe ende bënte mot i bukur. Si në planin e brendshëm, ashtu edhe në politikën e saj të jashtme ajo ende mund ta trumbetonte " vetadministrimin " si një " parajsë" të kësaj bote, revizionizmin si " rrugë specifike" dhe "fytyrë humane" të socializmit. Ajo ende mund të përzihej dhelpërisht në punët e brendshme të shtetit tonë amë, Shqipërisë socialiste, e në anën

tjetër të ngrinte lart zërin e mos përzierjes, të shitej kampione e kufijve të hapur, e në anën tjetër të vendoste darët policore fashiste në hyrje – daljen e kufirit me Shqipërinë; të fliste për " mosinkuadrimin", e këndej të përçonte në Ballkan pikërisht interesat e superfuqive dhe , përveç kësaj, të zjente edhe marrëveshje të fshehta me socialimperialistët rusë, që kanë për qëllim t'ua bëjnë varrin pikërisht popujve të Ballkanit.

Atëhere revolucionarët tanë të organizuar, të mbledhur rreth ndonjë organi të tyre ilegal, ose lexuesit e zellshëm, të shtypit tonë revolucionar, do të kenë hetuar në fjalimet dhe në shkrimet e shovinistëve serbë e të sahanlëpirësve të tyre në Kosovë edhe dromca të polemikës së tyre me lëvizjen tonë patriotike e revolucionare. Duke qenë të regjur në tradhti e në përunjësi pakurrizore ndaj pushtuesve dhe shtypësve, renegatët shqiptarë rropateshin ta bënin me mjeshtëri këtë polemikë. Në" oratoriumet" e tyre mediokër ata goditnin në të majtë e në të djathtë, por me kujdesin më të madh që të mos vërehej me kë e kanë konkretisht luftën. Ata llomotitnin në shtyp e radiotelevizion, goditnin vazhdimisht në mbledhjet e të gjitha forumeve dhe institucioneve. Populli nuk e kishte vështirë të kuptonte se ata dikë dhe diçka godasin, por jo kurdoherë mund t'ia qëllonte se për kë dhe për çka është fjala. Por me rëndësi ishte që populli shihte dhe dëgjonte...Dhe qeshte. Renegati i ngjante me të devijuarin psikik, të cilit i ka rënë sëmundja e tokës dhe zhgërryhet nëpër baltë, duke u matur me shenjtëritë e me djajtë e kësaj bote.

Me kalimin e kohës, sa më të shpeshta bëheshin pamjet e tilla halucinante të pushtuesit dhe renegatit, aq më shumë populli e gjente drejtimin nga suleshin grushtet e armikut të popullit dhe aq më shpejt zbulonte se kush qenkan bijtë e vërtetë të popullit. Ishte hedhur ndonjë trakt a pamflet nga forcat tona patriotike revolucionare, ose ishte zënë ndonjë grup a organizatë patriotike revolucionare. Pushtuesit serbomëdhenj dhe sahanlëpirësit e tyre shqiptarë jepeshin me të gjitha forcat për ta shuar zërin e luftës dhe të revolucionit, për ta shuar zërin e së vërtetës. Por, ata sikur nuk pandehnin fare se dita me ditë veç sa do na e forconin këtë zë. Kureshtjen për fjalën dhe për veprën tonë revolucionare ata e zgjonin domosdo edhe në ato shtresa të popullsisë sonë e në ato mjedise, ku kjo fjalë e kjo vepër, për arsye objektive, nuk kishin depërtuar ende. Dalëngadalë, edhe atje ku ende nuk kishte arritur mendimi ynë revolucionar e patriotik, arrinte përshtypja se dikush u paska përcjellë masave popullore një porosi aq të rëndësishme, sa që armiqtë e popullit tonë nuk përmbahen dot pa sulmuar.

Por erdhi dita që të gjitha trumbetimet e bëra me gënjeshtra trashamane dhe të gjitha demagogjitë e serbomëdhenjve dhe të renegatëve shqiptarë u ndeshën me nofulla në shkëmb. Shpërthyen demonstratat e Kosovës, kërkesave të studentëve për bukë dhe republikë iu bashkua i tërë populli shqiptar në Jugosllavi dhe armiku ynë u detyrua ta flakë tutje si të pavlefshme maskën e tij dyzetvjeçare. Doli sheshit etja e madhe e serbomëdhenjve për gjak shqiptari. Renegatët shqiptarë, me veprimtarinë e tyre krejtësisht të dënueshme, që ka në themel shitjen e interesave të popullit tonë, mbetën si peshku në zall; i humbën kreditë tek pushtuesit serbomëdhenj dhe dolën lakuriq para popullit me tradhtinë e tyre të hapët, duke u treguar të gatshëm të thërrasin për ndihmë edhe tanket e armikut vetëm e vetëm për të shpëtuar kolltukun e vet.

Udhëheqja e Beogradit e humbi, të thuash brenda nate, edhe luftën në planin e jashtëm. Opinioni ndërkombëtar, i cili deri dje kishte ruajtur përshtypjen e rreme për" humanitetin", "demokracinë", e "socializmin" jugosllav, tani e kuptoi qartë se këtu ekzistoka para së gjithash një rend i kalbëzuar shoqëror, me një aparat policor shtypës, i cili nuk mund të jetë më garanci as për investimet e kapitalit të huaj, i cili më parë ishte derdhur këtu pa kursim si nga Perëndimi ashtu edhe nga Lindja. Më në fund ky opinion, që të shumtën nuk dinte as për ekzistimin e shqiptarëve në shtetin e sllavëve të jugut, tash

e kuptoi se 2 milion shqiptarë, që përbëjnë kombin e tretë për nga numri në mozaikun artificial jugosllav, u mohoheshkan të drejtat elementare kombëtare e njerëzore.

Tani, pas grushtit të fuqishëm që iu dha shovinistëve nga forcat tona revolucionare e patriotike, nga rinia dhe populli ynë; me parulla e pamflete, me demonstrata e greva dhe aksione nga më të ndryshmet, armik ynë ka zënë të trajtojë dendur dhe haptazi ato tema dhe të popullarizojë në shtyp e radiotelevizion ato çështje vitale të popullit tonë, të cilat ne nuk kemi mundësi t'i trajtojmë kaq masivisht, sepse nuk kemi në dorë mediume kaq masive.

S ndodhi kështu?

Në organet tona ilegale, në agjitacionet gojore, në traktet dhe pamfletet e patriotëve revolucionarë qe folur për gjakun e derdhur, - që ishte derdhur shumë gjak, ishte një fakt i dëshmuar, - për burgjet e mbushura ding me bijat dhe bijtë e Kosovës, madje edhe e të mitur e fëmijë. Ne kishim folur dendur për disa akte revolucionare të popullit dhe të rinisë sonë, që jo vetëm s'u stepën përpara dhunës policore e ushtarake, përpara tankeve dhe automatikëve, po përkundrazi u hodhën në aksione e veprime të cilat e kapërcejnë cakun e çdo demonstrate dhe hyjnë në suaza veprimesh karakteristike për kryengritjet popullore. Mirëpo ishin të shpeshta rastet që jo vetëm dëgjuesit e lexuesit, por edhe vetë agjitatorët e propaganduesit revolucionarë, i merrnin me një farë mosbesimi të gjitha ato që thuheshin. Në kohën që Kosova ishte mbërthyer në darët e shtetrrethimit, në kohën që ora policore i jep në dorë milicisë dhe ushtrisë të korrnin me plumba, në kohën që UDB – ja kishte aktivizuar zagarët e saj me parulla, gënjeshtra e dezinformime për të mjegulluar situatën dhe për të denigruar luftën e rinisë e të popullit tonë; gjëja më e lehtë për t'u bërë naiv, tendencioz, e madje edhe qesharak në sytë e njerëzve, ishte që të thoshe në një kohë të tillë sesi Podujeva, ta zëmë, e kishte marrë situatën krejtësisht në duart e veta, sesi popullsia e këtushme kishte ngritur mbi qytet një barrikadë të pakapërcyeshme për automjetet që vinin nga Serbia, kurse fëmijët dhe të rinjtë kishin përjetuar kënaqësinë e rrallë që të kontrollonin dhe t'u kërkonin pasaportë të gjithë udhëtarëve që hynin në Kosovë. Pakkush besonte në fillim kur flitej për bllokimin e rrugëve të tjera automobilistike dhe të hekurudhave anembanë Kosovës. Për agjitatorët dhe propaganduesit tanë ishte gjë e vështirë kur ngarkoheshin të flisnin, fjala jen në Shkup, për regjionin e Llapit, ku një grup i vogël të rinjsh, me një çifte të vetme, kishte arritur të çarmatoste një njësit të tërë milicësh dhe të merrte në dorëzim sasi të mëdha armësh. Lexuesit e dëgjuesit pohonin me kokë, në heshtje, se nuk mund të thoshin se ishte ndryshe. Po fjalëve tona nuk ju besohej. Më pas ata që nuk kishin marrë vetë pjesë në demonstrata e kishin vështirë të besonin për pjesëmarrjen e gjerë në demonstratat e prillit të punëtorëve të kombinatit " Ramiz Sadiku", të "Trepçës". Obiliqit, Amortizatorëve etj., pa le pastaj të besonin për përleshjen e tyre heroike me forcat e armatosura jugosllave.

Kur ne shkruanim e flisnim për tendosjen në rritje të situatës në Kosovë, për gjakun e derdhur rrëke dhe për burgosjet masive, Tanjugu ushqente shtypin jugosllav – si ujkonja këlyshët – me lajme mbi gjoja normalizimin e jetës, mbi furnizimin e mirë të qytetarëve në Kosovë, mbi gjoja suksesin që po arrihej në diferencimet politike dhe sidomos mbi vetë "faktin" se vetë populli shqiptar në Kosovë " po i dënonte rreptësishtë demonstratat" (Kështu, me nder lexuesit, Tanjugu s'ka turp të raportojë edhe sot kohë pas kohe)

Po edhe ne vetë, ndonëse kishim dalë masivisht në demonstrata, ndonëse nuk po reshtim me hedhjen e parullave dhe me aksionet e shumta, do ta kishim pasur të vështirë të mësonim për përmasat e vërteta të ngjarjeve, të kuptonim sa thellë – në të gjithë poret e shoqërisë sonë – ka depërtuar ndjenja liridashëse e popullit tonë, po të mos kishin marrë papritmas një kthesë të re organet jugosllave të informimit. Duke parë se hovi

revolucionar i rinisë dhe i popullit tonë ishte në rritje të shpejtë, duke ndarë mendjen që, pas gjakderdhjeve të mëdha, të mbushnin përditë burgjet me shqiptarë kryengritës , t'u jepnin atyre dënime drakoniane dhe të përpiqen ta frikësojnë kështu mbarë popullin tonë të revoltuar; duke qenë, në anën tjetër, në shtim të vazhdueshëm etja e serbomëdhenjve për ta nënshtruar me terror e për ta skuqur me gjak popullin tonë dhe gjithë aspiratat e tij, në UDB vendosën të zgjedhin rrugën e represioneve të jashtëzakonshme. Për këtë qëllim duheshin gjetur edhe pretekste të jashtëzakonshme. Kështu mbulimi dhe fshehja e akteve revolucionare dhe e aspiratave të rinisë e të popullit tonë, papritmas u treguan pengesë e madhe në këtë drejtim.

Me qëllim që të përligjen masat represive fashiste mbi popullsinë shqiptare në Jugosllavi, Tanjugu më vonë hodhi vetë dritë mbi përmasat e vërteta të ngjarjeve të përgjakshme të Kosovës, mbi "platformën e kërkesave shoqërore e kombëtare të shqiptarëve të revoltuar. Shtypi dhe radiotelevizioni jugosllav, duke përfshirë edhe "Rilindjen" e Radiotelevizionin e Prishtinës, si dhe të gjitha organizatat politiko – shoqërore në të gjitha forumet dhe nivelet e tyre me muaj të tërë nuk bënë gjë tjetër veçse mbetën duke pohuar me gojën e tyre të gjitha ato akte e ngjarje, të cilat më herët ishin përpjekur t'i mbulonin me çdo kusht. Dhe informimi i tyre mbi këto akte e ngjarje sa vinte e bëhej më pedant. Ato folën mbi përmasat e luftës në Llap e Drenicë, në Prishtinë e Ferizaj, mbi qëndrimin heroik të të burgosurve tanë para gjyqeve ushtarakë jugosllavë dhe mbi dështimet e diferencimit politik. Më në fund serbomëdhenjtë u detyruan ta prekin edhe një temë tabu – aspiratat shekullore të shqiptarëve për bashkim me vendin e tyre amë, të drejtën demokratike e leniniste për vetëvendosjen e popujve deri në shkëputje.

Natyrisht, faktet ata i vënë me kokë poshtë. Por kjo tashmë nuk i prish punë popullit tonë, i cili në kushtet e sotme revolucionare është mësuar ta lexojë edhe së prapthi gazetën e serbomëdhenjve. Kjo nuk i prishi punë as opinionit botëror. Në këtë moment sikur jemi përkulur mbi një enë të madhe me solucion kimik, ku është hedhur fotografia, nga e cila po bëhen gjithnjë më të qarta tiparet dalluese të politikës së egër antishqiptare të serbomëdhenjve. Po qe se gjymtyrët e kësaj politike janë hedhur kuturu në letrën e fotografisë; gjuha në zverk, nofullat në thembra, shpatullat në bërryla dhe koka mbi gjunjë, bota sot ka aq njohuri mbi anatominë sa të mund t'i vendosë ato gjymtyrë secilën në vendin e vet, në mënyrë që të përfitohet pamja e vërtetë e pushtuesve dhe kolonizuesve, në një anë, dhe ajo e aspiratave të ligjshme të një populli liridashës dhe e luftës së tij këmbëngulëse për të drejta e liri, në anën tjetër.

Ç'po ndodh aktualisht, për forcat tona patriotike e revolucionare është një sfidë e shkëlqyeshme që, krahas organizimit e zgjerimit të radhëve të tyre, ta intensifikojnë veprimtarinë në shumë drejtime.

Për mendimin tonë, një punë me rëndësi shumë të madhe është shtypi revolucionar në ilegalitet. Ne duhet të bëjmë të gjitha përpjekjet që ta shpeshtojmë daljen e këtij shtypi. Për këtë punë është e domosdoshme të zgjerohet në mënyrë rapide numri i bashkëpunëtorëve të këtij shtypi, të cilët të jenë të kujdesshëm në mbledhjen e informatave të sakta e të rëndësishme dhe sa më ekspeditivë në përcjelljen e tyre drejt redaksive përkatëse. Situata e gjallë revolucionare që mbretëron te ne nga shpërthimi i demonstratave, e bën shumë të nevojshëm edhe shtimin e tirazhit të shtypit tonë ilegal dhe formimin e një rrjeti sa më të gjerë e më ekspeditiv të njerëzve që do ta shpërndajnë këtë shtyp si dhe literaturën revolucionare e patriotike në përgjithësi. Kjo detyrë bëhet aq më e ngutshme kur të kemi parasysh mbylljen arbitrare të kufirit me vendin tonë amë dhe kontrollin rigoroz në kufijtë e Jugosllavisë, në të gjitha ato pika ku është i mundshëm depërtimi i literaturës revolucionare, kur të kemi parasysh edhe tentativat e ethshme të

serbomëdhenjve për të penguar edhe emitimin e programeve të Radiotelevizionit Shqiptar.

Sepse siç na porosit udhëheqësi i madh i revolucionit të parë socialist në botë, Lenini: sa më shumë e më seriozisht ta zbatojmë teorinë marksiste të revolucionit dhe të luftës çlirimtare, aq më seriozisht dhe në mënyrë më të thelluar do ta kryejmë detyrën tonë revolucionare në të demaskuar të armikut në baza të shëndosha teorike e praktike të revolucionit, aq më me sukses do t'ia dalim t'i këpusim hallkat e hekurta të censurës që ushtrohet mbi shtypin legal (shtetëror), kurse përfaqësuesit e regjimit do t'i detyrojmë kështu të dalin para popullit me përgjigjet e tyre pikërisht lidhur me ato pyetje vitale, të cilat ne do t'i kemi shtruar paraprakisht në shtypin tonë ilegal dhe në gjithë veprimtarinë tonë të organizuar revolucionare.

Duke u ngritur në shkallë sa më të lartë të aktivitetit të organizuar revolucionar që ka për bazë shkencën ngadhënjimtare të çlirimit shoqëror e kombëtar, ne do të jemi në gjendje të trajtojmë në mënyrë sa më të thelluar e të gjithanshme shfaqjet e skllavërisë shoqërore e kombëtare të popullit tonë nën thundrën e pushtuesve jugosllavë. Kështu do t'ia dalim ta informojmë e ta sqarojmë drejt dhe me kohë popullin tonë liridashës, po dhe armikun do ta nxjerrim në ato shtigje, ku ai s'ka dëshirë të dalë dhe ku e pret vetëm disfata e turpshme. (Zëri i Kosovës, janar 1982, faqe 4-5)

79. NË VEND TË URIMIT

Në pjesën e viseve shqiptare nën Jugosllavi, në Kosovë, sllavët edhe sot e kësaj dite angazhojnë aparate të tëra shkencore, të cilat kanë për detyrë t'ia gjejnë ilaçin asimilimit apo zhdukjes së popullit shqiptar. Por nuk zhduket aq leht populli më i lashtë i Ballkanit. Këtë nuk e lejon as populli shqiptar prej më të madhit deri te më i vogli, se lejon dot gruaja, e cila sot ka zënë të hyrë në shoqërinë e babait, burrit dhe të djalit. Mirëpo, duhet mjerisht të konstatojmë se gruaja shqiptare e kësaj pjese të Atdheut ende është larg përparimit të motrës së saj në Shqipërinë Socialiste, që ka arritur suksese të mëdha në të gjitha nivelet shoqërore dhe politike, të bëhet punëtore, deputete, ministreshë...

Megjithëse që nga viti 1968 e këndej ajo veproi mjaft, është e domosdoshme të ceket se politika armiqësore e shovinistëve serb ishte dhe është pengesë e madhe e përparimit të gruas dhe të mbarë popullit

Si në çdo fushë tjetër, hegjemonizmi serb po orvatet me të gjitha mjetet e veta t'a degjenerojë edhe gruan shqiptare. Duke e përhapur me të madhe demagogjinë e saj në njërën anë, se femra shqiptare duhet shkolluar me të madhe, ajo, qeveria, në anën tjetër nuk ua siguron kushtet e vërteta të një shkollimi të drejtë.

Duke patur parasysh të kaluarën e shqiptarit, botëkuptimet e tij dhe sidomos frymën patriarkale të tij, është dashur, siç ka ndodhur në Shqipërinë socialiste, që këto rrethana të studiohen mirë dhe pastaj të vihen në punë, por armiku e bëri të kundërtën, sepse atij nuk i konvenon të krijojë një shoqëri të shëndoshë e të përparuar në Kosovë dhe viset e tjera shqiptare në Jugosllavi, atij i dolën mjaft kokëçarje me burrat intelektual kosovarë.

Armiku, teorikisht ja dha edhe femrës shqiptare mundësinë të shkollohet, por në anën tjetër ai i bëri asaj aq dredhi, gjë kjo që shumë vajza kosovare përkundër vullnetit të fortë për shkollim, hoqën dorë, sepse panë se me shkollimin e tyre po prekin thellë ndjenjat patriarkale të prindërve të vetë. Dhe vërtet sot e kësaj dite jemi dëshmitarë të sjelljes së paskrupullt të anëtarëve të LKJ –së, të cilët nuk i japin pesë pare për moralin e gruas e le më të vetin. Le të na përkujtohet vetëm era e Rankoviçit, të cilit i siguronin femrat e zgjedhura shqiptare për të " kaluar kohën më të bukur gjatë punës së tij" rreth asimilimit të shqiptarëve. Por nuk ishte vetëm Rankoviçi ai, i cili luante me moralin e femrës shqiptare, sot e kësaj dite, nëpër zyrat e ndryshme të Kosovës ndodhin shembuj të tillë. Armiku e di fort mirë se çfarë roli luan morali në jetën e përditshme, prandaj armiku pikërisht këtë e ka shfrytëzuar dhe përkrahur, në mënyrë që shqiptarët të mos lejojnë shkollimin e vajzave të veta dhe armiku pastaj të ketë shtegun e çelur për ta sulmuar " prapambetjen e popullit shqiptar"

Por, ky sabotazh, nuk i pati sukses, sepse femra shqiptare qëlloi me një moral të fortë dhe me të gjitha vështirësitë që ia hodhën para këmbësh, ajo arriti të shkollohet në mënyra të ndryshme. Të pakta janë asosh që ranë në grackën e armikut.

Kohëve të fundit, femra shqiptare e vërtetoi eksperiencën dhe syçeltësinë e vet sidomos kur është fjala për ndjenjën patriotike dhe për aspiratat shqiptare shekullore. Ajo përkundrazi në të gjitha orvatjet e armikut arriti të studiojë mirë e mirë historinë e kombit të vet dhe asaj nuk i mjaftoi të ndalet me kaq, por ajo hyri në luftë drejtpërdrejt për realizimin e këtyre aspiratave krahas shokut, bashkëshortit, babait apo të birit. Femra shqiptare vërtetoi se është anëtare e denjë e shoqërisë shqiptare revolucionare. Edhe këtë fakt s'mund t'ia mohojë askush. Ajo nuk u step as para burgosjes dhe kështu ndodh se në burgjet e Kosovës qindra e qindra femra po e "paguajnë " dënimin për veprimtari politike; dhe kjo ato vetëm i forcon. Jemi shumë krenarë për këtë gjë, edhe kjo na jep fuqi më të madhe të marshojmë drejt lirisë sonë përfundimtare. Armiku me këtë po e dëshmon ligësinë dhe orët e ngjehuna të vetat, prandaj rroftë, rroftë, rroftë FEMRA KOSOVARE! (Zëri i Kosovës, mars 1982, faqe 6-7)

80. BOTA PROGNOZON TË VËRTETËN SE SHEH (THOTË)!

Mjetet e informimit në mbarë botën gjithnjë më shpesh bëjnë fjalë për situatën në Jugosllavi, prognozojnë se çka do të ndodhë pas Titos me këtë shtet shumëkombësh të Ballkanit, bëjnë gjithfarë supozimesh nga ato se do të marshojë ushtria ruse në të, si në Çekosllovaki, në Afganistan dhe vende të tjera, deri te marrja e kalasë nga brenda përmes oficerëve serbë të shitur te Rusia.

Si duket prognozojnë e prognozojnë, po të vërtetën nuk e shohin ose nuk duan ta thonë botërisht. Vdekja e Titos rusëve u dukej situata më e përshtatshme për realizimin e qëllimeve të veta. Por edhe sa ishte gjallë Titoja, rusët ishin kujdesur ta shpejtonin vdekjen e tij. Kjo kishte ndodhur para vitit 1966, kur u munduan t'ia bënin çaren përmes Rankoviçit. Apo dhe më vonë, nëpërmes Mileta Popoviçit, duke formuar në Jugosllavi një parti të re "komuniste" krejtësisht pro ruse, e cila e pat mbajtur kongresin e pestë të partisë në Tivar, duke i hedhur poshtë të gjitha kongreset e tjera zyrtare jugosllave, të mbajtura nën udhëheqjen e Titos, pas prishjes së marrëdhënieve me BS.

Po rusët nuk ndenjën duarkryq edhe pas dështimit të këtyre planeve. Planet e tyre të reja parashikonin likuidimin dhe mënjanimin e udhëheqësve joserbë në Jugosllavi,

duke sjellë në vend të tyre udhëheqës serbë ose proserbë të vërtetuar. Kështu pat ndodhur kur u likuidua kryetari i qeverisë federative, Xhemal Bijediçi, që ishte boshnjak dhe në vend të tij qe sjellë malazezi Gjuranoviç. Në të njëjtën kohë u zu me presh në dorë edhe bashkëshortja e Titos, Jovanka, e cila në bashkëpunim me gjeneralët serbë, punonte në realizimin e planeve ruse, duke shkarkuar nga detyra kuadro të larta ushtarake kroate, sllovene etj. Dhe duke emëruar në vend të tyre oficerë serbomalazezë.

Bashkëpunimi me rusët është traditë e vjetër e serbëve. Ai i ka bazat në qëllimet e rusëve për ta shtënë në dorë Ballkanin, në mënyrë që të sigurojë dalje të lirë në Adriatik dhe në Mesdhe dhe së këndejmi të dominojnë në këtë pjesë të botës.. Me qëllim që t'i realizojnë këto plane, carët rusë nxitën serbomalazeztë së pari kundër perandorisë Turke dhe i ndihmuan në formimin e shteteve të pavarura, që, me ndihmën e rusëve, u zgjeruan me toka të begatshme shqiptare.

Qëllimet e vjetra të rusëve për shtrirjen e tyre nga Vlladivostoku deri në Adriatik, janë njëkohësisht edhe qëllime të carëve të rinj të Kremlinit. Konjukturat politike të kohës nuk dhanë dorë që Jugosllavia të dominohej krejtësisht nga rusët. Në konferencën e Jaltës, Jugosllavia u nda në dy sfera të interesit, mes Lindjes dhe Perëndimit, më vonë u shpall shtet "neutral" dhe Titua u caktua përjetësisht në krye të tij. Kishte shpresa që gjatë sundimit të tij do të krijoheshin forca të mjaftueshme që Jugosllavia të mos rrëshqasë në anën e rusëve, por të bëhet një shtet properëndimor, ose së paku të mos bëhet një satelit besnik i rusëve.

Po shpresat e Perëndimit dalëngadalë dështuan. Rusët i arritën thuaja plotësisht qëllimet e tyre. Ata gjithnjë u mbështetën te serbët, dhe nuk u mashtruan. Ata e dinin se njerëzit më besnikë të rusizmit dhe të pansllavizmit jo vetëm në Ballkan, po në mbarë botën, janë serbët. Sa e sa herë e kanë dëgjuar ata nga goja e serbëve fjalën "Majka Srbija, pramajka Rusija"(Nëna Serbi, Stërnëna Rusi).

Rusët i ndihmuan serbët në çdo pikëpamje, që këta të krijojnë kushte për t'i marrë në dorë frenjtë e Jugosllavisë në momentin e duhur. Politika që kanë luajtur dhe luajnë rusët në Jugosllavi është një politikë shumë perfide dhe dinake. Qysh për gjallë të Titos, ata i koordinonin shumë mirë planet me serbët. Titos i dhanë mundësi të çojë një jetë përrallore, që nuk e kanë bërë as perandorët më të mëdhenj, e mbuluan me dekorata që nga Beogradi (ku u shpall tre herë hero) e deri në Moskë, ku ia dhanë Dekoratën e Leninit. Nuk u prishte punë carëve të rinj rusë fakti që Titua qe një nga kundërshtarët më të mëdhenj të mësimeve të Leninit. Sllovenëve, që janë në kufi me shtetet perëndimore, u dhanë mundësi të zhvillojnë industrinë (por jo atë ushtarake) dhe të arrijnë standard të lartë, thuaja të barabartë me shtetet perëndimore dhe shumë më të lartë se vetë Serbia dhe mbarë Jugosllavia. Sllovenët sipas planeve serbo – ruse, duhej të mos ua merrnin lakmi fqinjëve evropianë, që të mos kenë mundësi t'i akuzojnë serbët për ndonjë padrejtësi.

As kroatët nuk u lejuan që të ndërtonin industri ushtarake. Nga njëra anë, ata kishin mundësi të zhvillonin industrinë e lehtë, sidomos turizmin, kurse nga ana tjetër Serbia i mbante vazhdimisht nën presionin rus, gjoja se e tërë Jugosllavia është e rrezikuar nga Bullgaria, e cila gjoja ndihmohet nga Rusia për ta marrë Maqedoninë, kërcënime krejtësisht të montuara nga serbët dhe rusët, me qëllim që të mbytet zëri i çdo kroati që ka guxim të ngritet kundër hegjemonizmit serbomadh.

Shqiptarët në një kohë u shtypën me mjete gjenocidi. Më vonë nën presionin e forcave patriotike dhe revolucionare, serbomëdhenjtë u detyruan të bënin disa lëshime. Edhe këto lëshime, serbët e rusët u përpoqën t'i shfrytëzonin për qëllimet e tyre djallëzore. Qëllimi ishte të tërhiqej edhe Shqipëria në taborin rus, kurse shqiptarët në Jugosllavi, në mënyrë të pavetëdijshme, të punonin pikërisht në realizimin e planeve djallëzore serboruse.

Boshnjakët dhe popujt e tjerë mbaheshin nën presion dhe mashtroheshin me gjithfarë demagogjish. Ndërsa Sllovenia dhe deri diku Kroacia e rritnin standardin, Serbia me viset që mbante nën kontroll dhe që kishte bindjen, se do t'i ketë nën kontroll të përhershëm, ndërtonte industrinë ushtarake, përgatiste kuadro të larta ushtarake e policore. Në momentin e duhur këto forca duhej ta merrnin situatën në duar të veta.

Posa vdiq Titua, serbët filluan t'i venë në jetë planet e tyre djallëzore me një mjeshtri shumë të madhe. Rusët, të bindur se planet e tyre në Jugosllavi po sendërtoheshin sipas parashikimeve, e acaruan gjendjen në Poloni, me qëllimin e vetëm që t'ia largojnë opinionit botëror vëmendjen nga ngjarjet në Ballkan, të cilat po zhvillohen krejtësisht në favor të tyre. Dëshira e kahmotshme e rusëve për të dalë në Adriatik e Mesdhe, do të realizoheshin sipas parashikimeve. Vetëm shqiptarët paraqesin një pengesë, e cila nuk mund të kapërcehet lehtë.

Këtë realitet e sheh, ose duhet ta shohë, Evropa, duhet ta shohin të gjithë. Kuçedra ruse i ka zgjatur kthetrat në të gjitha anë e botës. A është fjala për ndonjë mpirje të përgjithshme para forcës rrënuese të Rusisë, apo për nënvlerësime, që do të hakmerren me pasoja tragjike? Pse bota merret me prognozime, thua se është fjala për ndonjë ndeshje sportive? Çkado që të ngjajë, do të jetë një shputë mamuthi.

Duke gëzuar përkrahjen e rusëve, serbët së pari i kanë hyrë nënshtrimit të shqiptarëve. Gjendja e rëndë e shqiptarëve, pas vdekjes së Titos, u vështirësua dhe më tepër. Kjo gjendje u krijua nga vetë serbët, sipas udhëzimeve të Moskës. Para ngjarjeve të marsit e të prillit, përveç shumë vështirësive të tjera, si papunësia, shtrenjtimi, mungesa e lirive më elementare, filloi të ndjehet mungesa e të gjithë artikujve elementarë të jetesës, siç janë sheqeri, sapuni, deterxhenti, mielli, kafja, vaji etj. Ndonëse sheqeri e vaji prodhoheshin me shumicë në Kosovë, kamionat bartnin për në Serbi, kurse Kosova vargonte rreshtat e gjatë të njerëzve që pritnin të blenin një kilogram sheqer apo një litër vaj dhe më së shpeshti kthehesin në shtëpi pa to. Kjo gjendje e rëndë e revoltoi popullin dhe ai doli në rrugë për të kërkuar të drejtat e veta, ngriti zërin aq lart sa e dëgjoi bota. Populli shqiptar në Jugosllavi, i bindur se pa dalë nga tutela e Serbisë nuk do të ketë kurrfarë përparimi, doli me parullën " Kosova – Republikë"

Këtë kërkesë të ligjshme të dy milion shqiptarëve, serbomëdhenjtë e hodhën poshtë me kapadaillëk dhe e mbytën në gjak me ushtri e milici, me tanke e bajoneta, se po të bëhej Kosova republikë do të prisheshin planet ruso – serbe në Jugosllavi e Ballkan. Shpallja e Kosovës republikë nënkupton edhe formimin e republikës së Vojvodinës. Me tetë republika , federata jugosllave do të forcohej dhe më shumë dhe kështu do të zvogëloheshin mundësitë e cilësdo republikë të veçantë për dominim mbi republikat e tjera. Është ky fuqizim i federatës që do t'i prishte shumë planet ruso – serbe, do ta plagoste për vdekje mundësinë e Serbisë për hegjemonizëm në Jugosllavi.

Serbët e shtypën kryengritjen shqiptare me brutalitet barbar. Për sjelljet e ushtrisë dhe të milicisë serbe ndaj shqiptarëve në ngjarjet e përgjakshme të Kosovës, ndjeu bota, e cila i gjykoi ato. Vetëm rusët, duke e ndier grushtin e shqiptarëve si goditje po aq sa edhe serbët, heshtën. Por as kjo nuk zgjati shumë dhe ata dolën me surratin e tyre të vërtetë, duke u identifikuar në lidhje me Kosovën me mendimet e serbomëdhenjve

Brutaliteti në shuarjen e ngjarjeve të Kosovës ka dy qëllime : të mbytet zëri i shqiptarëve dhe të frikësohen të gjithë popujt joserbë në Jugosllavi. , po qe se marrin guxim të reagojnë kundër planeve ruso – serbe.

Hiq pengesën shqiptare, rusët janë të kënaqur me ngjarjet në Jugosllavi. Ata kanë bërë përherë përpjekje ta fusin në grusht ose së paku ta lidhin pas qerres së tyre Shqipërinë socialiste. Por, të gjitha tentativat në këtë drejtim ju kanë shkuar huq. Dalja në Mesdhe bëhet për rusët aq më e vështirë, sa më shumë të fuqizohet pengesa shqiptare. Shqipëria

ka nën kontroll një pjesë të mirë të detit Adriatik dhe të detit Jon, nëpër të cilat duhet kaluar domosdo për të dalë në Mesdhe. Pjesën tjetër e ka nën kontroll Italia, e cila bën pjesë në paktin kundërshtar të Rusisë, NATO.

Edhe për një arsye tjetër shqiptarët janë halë në sy për ruso – serbët. Radio Tirana tashmë në pjesën më të madhe të botës cilësohet si i vetmi zë i së vërtetës, i cili ua nxjerr sheshit të palarat të gjithë mizorëve, ku e kanë pjesën e vet sidomos rusët dhe serbët.

Një kohë synimet e tyre për daljen në Mesdhe, rusët u përpoqën t'i realizonin nëpërmjet Turqisë. Disa forca turke, që e quanin veten revolucionare, s'ishin asgjë tjetër pos vegla të verbëta në realizimin e planeve të errëta ruse. Është punë që dihet aktiviteti i jashtëzakonshëm i rusëve në Turqi, me parulla të shumta demagogjike, gjoja për shpëtimin e Turqisë, po që kishin qëllim të fundit shndërrimin e Turqisë në një Afganistan të dytë. Pasojat që do të delnin nga një sukses eventual i rusëve në këtë drejtim, mund të merren me mend. Pas dështimit të këtyre planeve, Rusia iu kthye me shpresë e angazhime më të mëdha Jugosllavisë, si mundësi e përhershme.

Në shikim të parë, Shqipëria, e cila është kundërshtari më i madh i planeve të tilla, duket drejtësisht e vetmuar në këtë luftë të Davidit me Goliadin. Por nuk është kështu. Populli shqiptar ka përkrahjen e forcave më përparimtare në mbarë botën. Kurrë popujve të tjerë të botës nuk u ka ardhur asnjë e ligë nga populli shqiptar. Përkundrazi, gjatë historisë së tij shumëshekullore, pikërisht populli i vogël shqiptar është bërë prag i pakapërcyeshëm për aspiratat e pushtuesve të mëdhenj të kohës. Edhe kësaj radhe, me gjasë, shqiptarët gjenden para një detyre të ngjashme. Por kësaj radhe ka shumë gjasa që kthetrat e carëve të rinj dhe veglave të tyre do të përcëllohen në zjarrin shqiptar. (Zëri i Kosovës, mars 1982, faqe 10-11)

81. Lëvizja e organizuar dhe spontaniteti

Po ta pyetësh të sëmurin që ka bërë dergjë të rëndë: A ke dëshirë të të çojmë te i pari mjek që do ta gjejmë, apo të të kërkojmë ilaç duke ndjekur një rrugë më të gjatë, deri sa të gjejmë specialistin e vërtetë për sëmundjen tënde? – ai të përgjigjet se do të presë deri sa të gjendet specialisti. Dhe kur specialisti ta pyesë atë të sëmurë: A do t'i shtrihesh një mjekimi të përciptë e të përkohshëm, mjekim që do ta jap vetëm iluzionin se je shëruar, apo dëshiron një mjekim të themeltë – me kohë zgjatjeje e me mundime më të mëdha? – i sëmuri, pa dyshim, do ta zgjedhë mjekimin e themeltë, megjithë kohën më të madhe të zgjatjes dhe me gjithë mundimet më të mëdha që do të duhet të përjetojë kështu. Dhe, sa më të rëndë ta ketë sëmundjen, aq më i gatshëm do të jetë ai për t'i duruar kohën e gjatë dhe mundimet e mëdha që vijnë me mjekimin serioz.

Për një shoqëri dhe për një komb, nuk ka plagë më të madhe se robëria nën zgjedhën e huaj apo shtypja e shfrytëzimi i egër nën rendin e kalbëzuar shoqëror. Prandaj nuk është vështirë të përfundojmë se kur të shtrohet çështja e lëvizjes revolucionare do të zgjedhë patjetër mjekimin e themeltë.

Së këndejmi, del se ato forca revolucionare, që parapëlqejnë mjekimin e përkohshëm, të shpejtë e pa mundime, pa u organizuar me themel dhe pa program të hollësishëm që të ketë bazën në një teori të shëndoshë marksiste-leniniste, zgjedhën e huaj dhe kalbëzimin e rendit shoqëror nuk e marrin si plagë të vetën. Kjo është, për ta, plagë e një të sëmuri tjetër, jashtë tyre, i cili u është mërzitur me kujdesin e madh që kërkon dergja e tij e rëndë, prandaj duan ta heqin qafe shpejt e shpejt, qoftë duke e çuar edhe në vdekje.

Rendi i kalbëzuar shoqëror dhe pushteti antipopullor e spontaniteti antikombëtar kanë për pasojë të logjikshme pakënaqësinë e punonjësve dhe të masave popullore. Me thellimin e shfrytëzimit e të shtypjes kombëtare e klasore, kjo pakënaqësi vjen duke u

shndërruar në mllef gjithnjë më të madh, që e rrezikon rendin ekzistues shoqëror ose zgjedhën e huaj. Njëkohësisht, kjo pakënaqësi dhe ky mllef i popujve dhe klasave të shtypura, është një bazë e fortë, mbi të cilën ngrihen lëvizjet revolucionare dhe vetë luftërat çlirimtare e revolucionet. Varësisht nga drejtimi që merr pakënaqësia e masave, ajo i shkakton armikut të kombit dhe të klasës dëme dhe e dobëson atë e ia lëkundë fuqinë dhe besimin në vetvete.

Mirëpo, përnga natyra e vet, kjo forcë e masave nuk përbën ndonjë grusht me goditje të koncentruar. Ai (spontaniteti), paraqet thërrime të shpërndara të pakënaqësisë dhe mllefit. Punonjësit e një profesioni janë të pakënaqur nga shfrytëzimi karakteristik prej padronëve. Po kështu edhe punonjësit e profesioneve të tjera. Me luftën e tyre spontane, ata arrijnë njëfarë bashkimi dhe i shkëpusin padronit ndonjë koncesion lidhur me pagat apo me kushtet e vështira të punës. Por, nëse është arritur solidariteti mes minatorëve të një apo dy minierave, ky ende është një hap shumë i vogël për lëvizjen e përgjithshme punëtore. Sepse ai nuk garanton që këta minatorë do të solidarizohen me punëtorët grafikë, ta zëmë, ose me ata të shkritoreve, ndonëse edhe këta punojnë në kushte jashtëzakonisht të vështira. Po kështu, shtypjen dhe shfrytëzimin e ndiejnë në mënyrë të ndryshme fshatarët (bile ndryshe bujku nga blegtori) ndryshe intelektualët dhe ndryshe punëtorët e niveleve të ulëta të administratës. Dhe, duke zbrazur secili në fushën e vet pezmin dhe mllefin e tyre të grumbulluar, kurrë nuk do ta bëjnë pushtetin e egër të heqë dorë nga administrimi i një vendi.

Ngjan që punëtorët e një profesioni të bashkohen në atë masë sa t'i japin aq zjarr luftës së tyre, sa padronët shtrëngohen të bëjnë koncesione të rëndësishme, kurse te forcat e ndryshme revolucionare krijohet iluzioni i revolucionit të vërtetë. Por, lëvizjen e tillë profesionale të punëtorëve, sado shkallë të lartë që të ketë arritur e bën të tërhiqet e të zmbrapset ofensiva e parë e fuqishme e pushtetit, kur ky vendos ta përdorë brutalitetin e vet me anën e milicisë dhe ushtrisë. Përveç kësaj, "Historia e të gjitha vendeve tregon se vetëm me forcat e veta klasa punëtore mund të fitojë vetëm ndërgjegje tredunioniste, d.m.th. të bindet se duhet të bashkohet në organizata profesionale, të luftojë kundër padronëve, të kërkojë nga qeveria këto ose ato ligje që u nevojiten punëtorëve etj." (V. I. Lenin, Vepra, vëll. 5, Tiranë, 1978, f. 435-436). Dhe këto kërkesa, nuk janë kërkesa të revolucionit, po përkundrazi kërkesa antirevolucionare për reforma në kuadër të asaj që ekziston. Ndërkohë që organizata e vërtetë revolucionare lufton për shembjen e plotë të rendit ekzistues shoqëror apo për dëbimin e plotë të pushtetit të huaj. "Politika tredunioniste e klasës punëtore është pikërisht politika borgjeze e klasës punëtore. Dhe formulimi i detyrave të klasës punëtore që na jep kjo "pararojë" është pikërisht një formulim i politikës tredunioniste" (Lenin, po aty, f. 498).

Një shembull tipik të luftës së tillë sindikaliste kemi sot te "Solidarnoshci" polak. Grevat e punonjësve polakë të disa profesioneve, të lidhura fortë pas organizatës së tyre, arritën shkallën e një organizmi aq të lartë, sa ta lëkundin edhe kryesinë partiake revizioniste të Polonisë edhe vet shtetin revizionist polak ta detyrojnë të bëjë lëshime të mëdha, duke prekur madje edhe vetë kushtetutën. Në fillim në vende të ndryshme të botës ku ekzistojnë situata revolucionare, u nxenë gjakrat dhe sikur u ndez një shkëndijë shprese që edhe në zemër të Evropës po merr hov revolucioni i vërtetë proletar. Mirëpo, kur punës i doli boja, u pa se prapa grevave të punonjësve polakë nuk qëndronte ndonjë organizatë a parti e vërtetë revolucionare, po ato bëheshin me kërkesa për reforma lidhur me pagat dhe kushtet e punës, u bë fare e qartë se nga revolucioni polak "Solidanrnoshci" as që merr erë. Përkundrazi ai çon ujë në mullirin e një kundërrevolucioni të dytë në Poloni, në mullirin e Vatikanit... (Zëri i Kosovës, mars 1982, faqe 11-13)

82. MBROJTJA E KISHAVE DHE SHENJTORËVE SERBË NGA SHQIPTARËT NË SHEKUJ

Historia vërtet nuk përsëritet, kjo është një e vërtetë, por në mes periudhave të ndryshme historike ka sa të duash paralelizma.

Ç' na hyn kjo çështje në punë, në një kohë që populli shqiptar në Jugosllavi po përjeton çaste nga më të vështirat në historinë e tij? Ata që u turrën ta shtrojnë me tanke e bajoneta popullin tonë, në kohën që ky kishte ngritur zërin e fuqishëm për bukë dhe të drejta demokratike, serbomëdhenjtë, në shtypin e tyre të qelbur dhe në të gjitha instancat politiko – shoqërore, pasi vranë e prenë, pasi burgosën një rini të tërë shqiptare, e panë të udhës ta shtrojnë edhe problemin e kishave dhe të varrezave serbomalazeze në Kosovë, duke thënë se shqiptarët dogjën Patrikanën e Pejës (sado që ish djegur jo monumenti, po konaku i popave) dhe u përpoqën të prishin varrezat e serbomalazezëve, Në këtë mënyrë ata nuk thanë gjë të re, por vetëm se nxorën nga naftalina historike pikëpamjet karagjorgjeviçjane për "barbarizmin" dhe "vandalizmin" e shqiptarëve, pikëpamje sipas së cilës shqiptarët nuk kanë trashëgimi të vetën kulturore dhe aq pak respekt ndaj trashëgimisë së huaj të kulturës materiale. Qëllimi i kësaj fushate të ethshme, ishte i dyfishtë : në një anë duhej të hidhej baltë mbi luftën e ligjshme fisnike të shqiptarëve, në mënyrë që luftëtarët tanë të cilësohen si "nacionalistë të tërbuar nga ndjenja e nacionalizmit", në anën tjetër, që me nxitje, me shpifje e demagogji, të bëheshin përpjekje edhe më të ethshme për ta bërë për vete opinionin jugosllav dhe për ta ndërsyer atë kundër shqiptarëve.

Parimisht fjala ra kështu për respektin, përkatësisht mosrespektimin e monumenteve historike, që serbomëdhenjtë u përpoqën ta ngrisin në shkallën e një vije të karakterit të popullit tonë në shkallë të përgjithshme kombëtare. Tani ne e kemi radhën t'u themi atyre se jo trashëgimia kulturore serbe ka qenë e rrezikuar nga shqiptarët, po pikërisht kultura materiale e shqiptarëve ka qenë kurdoherë nën shënjestrën e shkelësve, shkatërraqëve e plaçkitësve, të cilët kanë shkretuar me shekuj mbi trojet tona, Dhe, ndër këta shkelës, shkatërraq e plaçkitës, një vend të rëndësishëm zënë pikërisht serbomalazeztë. Në periudha kritike historike, që kanë qenë të shumta e të shpeshta në fërkimet shqiptaro – serbe, ata jo vetëm që janë përpjekur t'ia humbin çdo gjurmë kulturës sonë materiale, por edhe kanë marrë guximin të na quajnë ne barbarë , duke menduar te "mungesa" e monumenteve të kulturës sonë, dhe vandalistë, duke pasur ndër mend "prirjen" e popullit tonë për shkatërrimin e kulturave të huaja. Mirëpo, kjo gjë ka qenë e mundshme të bëhet vetëm me insinuata politike, me gënjeshtra e shpifje nga më të poshtrat në shërbim të aspiratave politike të ditës. Gjuha e dokumenteve dhe e kërkimeve shkencore ka folur kurdoherë ndryshe, në të mirë të shqiptarëve, si kur ka qenë fjala për pasurinë e kulturës materiale të shqiptarëve, një nga popujt më të lashtë të Evropës, ashtu edhe për respektin ndaj kulturave të huaja.

Ka së paku tre shekuj që familja e Zhuj Rugovës nga Rugova, e Salih Rrustës nga Deçani dhe e Behram Vojvodës nga Drenica, janë mbrojtëse tradicionale të tri monumenteve të rëndësishme serbe në Kosovë – Patrikanës së Pejës, Kishës së Deçanit dhe Kishës së Deviçit. Sipas dokumenteve, shpesh ka qenë e domosdoshme që në mbrojtje të këtyre monumenteve të vihen jo vetëm familjet e përmendura, por edhe vëllazëritë, fiset dhe fshatrat e tyre, duke lënë edhe shumë të vrarë. Vetëm nga familja e Zhuj Rugovës, në mbrojtje të Patrikanës së Pejës, janë vrarë meshkujt e katër brezave : Muq Elezi, i biri i Muqës, Veseli, i biri i Veselit, Zhuji dhe tre djemtë e tij: Beka, Asllani e Kapllani, pa folur këtu për meshkuj të shumtë të fisit të Kelmendit, të cilët angazhimin e familjes së Zhujit e kanë marrë njëherit edhe si obligim fisnor për mbrojtjen e kishës.

Nga familja e Behram Vojvodës nga Llausha, në mbrojtje të kishës së Deviçit janë vrarë vojvodët Sejdija e Delija dhe është plagosur kushëriri i tyre Ajeti.

Një kapitull më vete është familja e Salih Rrustës së Deçanit. Njëri nga të parët e kësaj familje, me lutjen e murgjve të Kishës së Deçanit, të cilët ai i kishte shpëtuar na vdekja e sigurt, merr përsipër mbrojtjen e këtij monumenti. Dhe kisha mbrohet nga kjo familje kurdo që kishte rrezik për cënimin e saj. Mirëpo në periudha të favorshme për të, ia kthen shpinën familjes së Salih Rrustës. Pas Luftës së Parë Botërore, që shënon aneksimin e Kosovës nga Serbia, gjandarmëria serbe e vret Bilall Rrustën, i cili përkrahte në atë kohë një parti opozitare politike dhe duke qenë njeri me autoritet në popull, kishte fituar për vete shumë vota. Arshimandriti i kishës ka qenë propagandues për listën e qeverisë, pra kundërshtar i Bilallit. (M.K.f. 137)

Një zell të madh kanë treguar shqiptarët në periudha të ndryshme historike edhe për ruajtjen e klerit serb dhe të thesarit të kishave. Karakteristik është rasti i igumanit të Patrikanës së Pejës, Sofronije, të cilin selia e Prizrenit e largon nga kisha, kurse, me insistimin e rugovasve dhe me intervenimin e tyre te Begollët e Pejës (familje në pushtet) Sofronije kthehet prapë në kishë. Igumani Haxhi Danillo (kisha e Deçanit), nga ana tjetër kishte ditur ta shfrytëzonte si duhet besën e shqiptarëve. Kur kish plasur kryengritja në Serbi (më 1804), Haxhi Danilloja, pasi kishte shpërndarë ndër shqiptarë thesarin e kishës, kishte shkuar në Bullgari e Palestinë për të kërkuar ndihma materiale për kishën, të cilën ua la të tërën në besë shqiptarëve. Udhëtimi i tij zgjati një vit të plotë dhe kur u kthye gjeti çdo gjë në rregull e iu falënderua shqiptarëve (Arhimandrit deçanski Serafim Ristiq. Dçanski spomenici. Beograd.1846, 49,52; shih edhe M.K. f. 137)

“ Deri sa turqit në viset tona të tjera, që sigurisht kanë pasur kulturë më të lartë se shqiptarët, e pasardhësit e të cilëve edhe sot i konsiderojnë shqiptarët si njerëz gjysmë të egër, - i kanë rrënuar shenjtoret tona dhe monumentet e tjera, ndërkaq shqiptarët i kanë ruajtur e kryesore është se kanë ndihmuar që të ruhet monumenti ynë më i bukur – kisha e Deçanit”. Këto janë fjalët e arhimandritit serb Leontije Ninkoviç, që i citon dr. Mark Krasniqi në studimet e tij etnografike “Gjurmë e gjurmime”.

Më tej këto monumente historike e kulturore kanë mbetur të parrënuara gjatë shekujve e të ruajtura të paprekura fare, vetëm në sajë të popullsisë shqiptare në fshatrat përreth tyre “ shton dr. Mark Krasniqi. Dhe ky nuk është një mendim i njëanshëm i një shqiptari, që do të kishte për qëllim ngritjen e virtyteve të popullit të vet. M. Krasniqi, lidhur me këtë, mbështetet pikërisht te konkluzioni i studiuesit serb Radomir Ivanoviç (Istoriskij casopis, knj 4, Beograd, 954, 173)se, po të mos kish qenë mbrojtja e vëllazërive dhe fshatrave të forta shqiptare, kisha e Deçanit do të ishte e rrënuar.

Derisa në një anë kemi mbrojtjen e suksesshme të kishave nga ana e shqiptarëve – në baza individuale, familjare e fisnore, në anën tjetër kemi gjithashtu asgjësimin e suksesshëm të shenjtorëve të shqiptarëve mysliman nga ana e serbëve në baza të organizuara shtetërore.

Sjellja gjatë shekujve e serbëve ndaj monumenteve shqiptare dhe ndaj të vetave na bënë të vimë deri te konkluzioni në të cilin kanë ardhur edhe serb se : dinastitë e ndryshme serbe kanë ndërtuar manastire edhe larg kufijve shtetëror me qëllim afirmimi, e sidomos në viset e pushtuara ato më tepër janë përdorur për të treguar kufirin se sa që kanë shërbyer si shenjtore.

A kanë pasur farë dobie shqiptarët nga ruajtja e kishave serbe me shekuj? Dhe për këtë ruajtje, këtë shpërblim të marrin sot jo vetëm nga shtypi, por dhe nga forumet politike e shoqërore jugosllave!?

Serbomëdhenjtë sot mund të bëjnë çdo gjë. Si duket në disa vende me udhëzime të Çubrilloviçit ata po i thejnë varrezat e tyre që për vandalizmin e vet t'i akuzojnë shqiptarët. Thonë se i humburi nuk di çka bën. Pse të mos besojmë. (Zëri i Kosovës, mars 1982, faqe 16-17)

83. ÇËSHTJE TË LUFTËS NACIONALÇLIRIMTARE DHE TË REVOLUCIONIT

Luftë të dëshpëruarish, apo lëvizje të ndërgjegjshme?

Pakënaqësia e masave popullore dhe punonjëse është pasqyrim i natyrshëm e i logjikshëm i rendit të kalbëzuar shoqëror dhe pushtetit antipopullor e antikombëtar. Me thellimin e shtypjes kombëtare dhe klasore, kjo pakënaqësi vjen duke u shndërruar në mllef me fuqi të madhe goditëse mbi armikun e kombit dhe të klasës. Forca goditëse e grushtit të masës së pezmatuar varet nga orientimi i duhur dhe koncentrimi i këtij grushti. Që goditja të arrij efekt sa më të madh, pra, është i domosdoshëm bashkimi optimal i mllefit të shpërndarë.

Në periudhat kohore dhe në vendet ku ka pasur arsye e rrethana për përgatitjen e luftës çlirimtare dhe të revolucionit, gjithmonë është paraqitur nevoja që luftëtari i lirisë dhe revolucionari të përcaktohen në mënyrë të qartë lidhur me qëndrimin që do të mbajnë ndaj pakënaqësisë dhe pezmit të masave popullore e punonjëse. Pra a duhet ta pranoj revolucionari si të tillë shpërthimin e pezmit; madje duke hyrë krejtësisht në shërbim të tij; apo, me një punë të vazhdueshme në përpunimin e teorisë, strategjisë dhe të taktikës revolucionare – çlirimit kombëtar dhe klasor të plotë.

Rruga e rezistencës së vogël

Historia e luftërave çlirimtare dhe e revolucioneve ka treguar se lidhur me këtë çështje, në periudha të ndryshme, kanë dalë divergjenca në lëvizjet revolucionare, që kanë çuar edhe në përçarje të plotë dhe në tradhtinë e teorisë marksiste-leniniste, si teoria më e përsosur e revolucionit, nga ana e revolucionarëve, që kanë qenë të prirur të ndjekin rrugën e rezistencës më të vogël, duke u përpjekur që pjesëzat e tërësisë t'i imponojnë si tërësi dhe qëllime të fundit.

Po ta pyesësh të sëmurin që ka bërë dergj të rëndë a ka dëshirë t'i shtrohet një mjekimi të përciptë e të përkohshëm, sa për sy e faqe, mjekim që atij do t'i japë vetëm iluzionin se është shëruar, apo dëshiron një mjekim të themeltë, me kohë zgjatjeje më të madhe e me mundime më të mëdha – ai do të zgjidhte padyshim, të dytin: mjekimin e themeltë. Dhe, sa më të rëndë që ta ketë sëmundjen, aq më i gatshëm do të jetë ai ta durojë kohën e gjatë dhe mundimet e mëdha, që vijnë me një mjekim serioz.

Për një komb a një shoqëri, plagë më të madhe se robëria nën zgjedhën e huaj apo shtypja e egër në rendin e kalbëzuar shoqëror – nuk ka. Prandaj nuk është vështirë të përfundojmë se lëvizja revolucionare do ta zgjedhë logjikisht mjekimin e themeltë. Së këndejmi del se ata militantë të lirisë e të revolucionit, që parapëlqejnë mjekimin e përkohshëm, të shpejtë e pa mundime, pa u organizuar me themel dhe pa program të hollësishëm – robërinë dhe kalbëzimin rendit shoqëror nuk i marrin si plagë të vetat, por si plagë të një sëmuri tjetër, jashtë tyre, i cili u është mërzitur me kujdesin e madh që kërkon dergja e tij e rëndë, prandaj duan ta heqin qafe shpejt e shpejt, qoftë duke e çuar edhe në vdekje.

Çështjen e luftës dhe të revolucionit, militantët e tillë e thjeshtësojnë në mënyrë të palejueshme. Të prirë nga qëllimi (më së shpeshti fisnik) që të hyjnë me gjithë çka kanë në shërbim të masave, ata hyjnë në shërbim të spontanitetit të masave. Duke qenë vetë të pangritur në pikëpamje të teorisë së revolucionit, e hedhin poshtë rolin e teorisë dhe të luftës së ndërgjegjshme dhe pulsin e tyre e kurdisin sipas pulsit të imponuar nga spontaniteti i masave. Me një fjalë, siç shprehet udhëheqësi i madh i revolucionit të parë socialist, Lenini, "ata gjunjëzohen para spontanitetit të masave", dhe kështu në vend që ta orientojnë atje ku duhet këtë spontanitet dhe ta realizojnë koncentrimin e forcës së tij goditëse në të mirë të çështjes së përgjithshme revolucionare, ata s'bëjnë tjetër veçse shkrihen edhe vetë në spontanitetin.

Po t'i pyesësh ata shokë: Në qoftë se edhe keni arritur ndonjë sukses me gjunjëzimin tuaj para forcës spontane të masës, ç'do të bëni ju kur t'ju dalë pengesa e parë në rrugë, do të thotë kur armiku ta përdorë forcën e vet brutale dhe masa të zmbrapset? (Gjëja më e natyrshme është që masa, e paorganizuar dhe e pangritur në shkallën e lëvizjes me program serioz ashtu si është vërsulur furishëm mbi armikun, gjithashtu edhe të tërhiqet shpejt para brutalitetit të armikut.) Ata rrudhin krahët, ose thonë "shohim e bëjmë", ose "populli ynë heroik nuk zmbrapset" etj. Natyrisht, populli ynë e ka dëshmuar me shekuj heroizmin si vijë të theksuar kombëtare, por as ky popull nuk përjashtohet nga ligjet e përgjithshme që vlejnë edhe për popuj të tjerë. Çështja qëndron tjetër ku: këta njerëz nuk dinë ose nuk duan të dinë se kur të kesh vepruar me kufizime (me dëshirë të madhe po me angazhim të vogël, në mënyrë spontane e jo të ndërgjegjshme), me kërkesa të kufizuara për realizimin e aspiratave, pra kur të kesh ndjekur rrugën e rezistencës së vogël; do të ballafaqohesh patjetër me pengesa, mbase edhe me disfata. Kur të kesh ndjekur rrugën që të çon vetëm deri te një pikë e caktuar (prapa së cilës për ty është çdo gjë, thuaja çdo gjë e panjohur), kush do të gjendet – pas kësaj pike – që do ta marrë fatin tënd në dorë? Armiku – natyrisht. Dhe faji është yti, sepse, vetë ke zgjedhur që armikun ta luftosh deri në pikën e caktuar, dhe jo në të gjitha pikat.

Ndërgjegjja dhe spontaniteti

Lenini u kishte shpallur një luftë të pakompromis të ashtuquajturve ekonomistë në lëvizjen socialdemokrate ruse, të cilët luftën e punëtorëve të industrisë (peticionet, grevat, presionin mbi industrialistët për reforma e lëshime ekonomike) apo luftën e ashtuquajtur profesionale të proletariatit, përpiqeshin ta imponoin si orientim kryesor të gjithë lëvizjes socialdemokrate. Me këtë ekonomistët lëvizjen komuniste për revolucion të plotë socialist, donin ta zbritnin në shkallën e tredunionizmit apo në revizionizmin bernshtajnist të teorisë marksite mbi revolucionin. Fraksione të tjera të socialdemokracisë kapeshin edhe ato për ndonjë pjesë përbërëse të revolucionit dhe qëllimet e tyre parciale i imponoin si qëllime të përgjithshme të revolucionit. Karakteristikë e përbashkët e këtyre fraksioneve ishte gjunjëzimi i tyre përpara spontanitetit dhe tendenca këmbëngulëse për mohimin e diferencës mes luftës spontane dhe luftës së ndërgjegjshme revolucionare.

Mund të duket e panevojshme të flitet, kur është çështja për realitetin shqiptar në viset e robëruara nga Jugosllavia, por gjithë këto çështje, pasi ato, as kanë ekzistuar deri më tash dhe as ekzistojnë tash në lëvizjen tonë. Mirëpo, gjithmonë ekziston një rrezik objektiv: nëse lëvizja revolucionare ka për qëllim të bëhet ingranazh, që do të jap mundësi për aktivitet të gjallë në çfarëdo rrethanash edhe nga më të vështirat, edhe përvjedhja e gabimeve që ka mundësi të bëhen në faza fillestare të lëvizjes mund të bëhen ingranazh, që shkon duke i vënë gjithnjë më dendur gurë nën rrota revolucionit. Në mos paçim industri, e kështu as luftë qoftë edhe tredunioniste të punëtorëve industrialë (pos disa

grevash dhe disa protestash të punëtorëve të KNI "Ramiz Sadiku" dhe atyre të "Amortizatorëve" në Prishtinë), kemi çështje të tjera, në të cilat disa njerëz të lëvizjes sonë kanë mund të rrëmbehen pas spontanitetit.

Te ne, prej kohësh kemi një situatë të këtillë. Hera-herës, masa e pakënaqur elektrizohet deri në një shkallë revolte të vërtetë. Ky revolt i saj paraqitet aq i "tejngopur" me "kopalla", sa njerëzia të shtinë në dhé me shikimin e egër e serioz kur ia ofron literaturën revolucionare, aq më shumë kur e ngarkon me detyrë që të shpërndajë një trakt apo një afishe. "Na mbytët më me këto parulla, – thotë njeriu i mllefosur deri në kulm nga mosdurimi, – më jep pushkën dhe dalim në mal! Për këtë më ke me vete, jo për letra!" Thua se pushka të ka mbirë në bahçe! Kur i kërkon kontribut për sigurimin e armëve, ai ta kthen shpinën. Edhe ky është për të cikërrim, dhe për cikërrime atë "s'e ke me vete". Ose sikur malin e ke ja aty në oborr. Po t'i drejtohesh të njëjtit njeri që të ta strehojë një revolucionar të rrezikuar nga pushteti, i gjen treqind arsye për të treguar se, një punë e tillë jo vetëm që nuk i takon atij, por ai as ka mundësi ta bëjë dhe, "more vëlla, nuk është kohë kaçakësh sot", të frushkullon me "seriozitetin" e tij. E kur ti, pas gjithë kësaj përshpirtjeje, ia tërheqë vëmendjen që së paku ta ruaj fshehtësinë për sa keni biseduar me të, si të shikon me përbuzje, sikur të kishe pikur nga qielli dhe s'ditke gjë ç'po ndodh në këtë botë madhështore: "Ku ke parë ore të dyshosh në shqiptarin! Kush ka besë si shqiptari!" Dhe pastaj çuditesh kur, në gjykim, po atë njeri ta nxjerrin si dëshmitar, pikërisht për ato që keni biseduar me të. S'ka mundur, i shkreti, t'i durojë torturat e policisë!

Pësimi-mësim: ndikimi që je përpjekur ti ta ushtrosh te ai njeri, për të mirën e çështjes së përgjithshme, të del i barabartë me zero, madje, bilanci është edhe negativ, sepse ai të bëhet dëshmitar në gjyq. Kurse ndikimi që ai ka ushtruar te ti – është vendimtar. Ai, me njerëz si veten, ta kanë dhënë iluzionin se janë të gatshëm për të dalë në Mal. Dhe ti, i rrëmbyer kështu nga hija e spontanitetit (sepse kjo gjë nuk është as spontanitet: cili njeri nga ata që ty të bënë për vete, ka dalë vetë a me shokë si veten në mal deri më sot?!), e ke lënë rrugën e organizmit të lëvizjes çlirimtare dhe i ke mprehur veshët se ja, tash-tash, do të dëgjohet kushtrimi!

Lëvizja spontane është shprehje e pakënaqësisë dhe e pezmit të masave, që është i prirur të shpërthejë kohë pas kohe – po edhe të tërhiqet para brutalitetit të armikut – pa bazë të caktuar teorike, pa program të qartë që ndjek një strategji e taktikë të qartë e largpamëse. Grushti spontan i masës, ndonëse ka forcë rrënuese, nuk paraqet goditje të koncentruar mbi armikun, i cili, në rastin tonë konkret, i ka forcat e organizuara: milicinë dhe ushtrinë.

Këtë kapitull, kuazirevolucionarët do të mund ta kuptojnë si një blasfemi ndaj masave popullore e punonjëse. Dhe, mund të shkojnë edhe më larg, duke bërë pyetjen, e me kë, pra, mendokeni ju t'i realizoni aspiratat shekullore të popullit tonë dhe ta bëni njëherazi edhe çlirimin e tij klasor? Me gurët e sukës?! Apo pikërisht me këtë popull dhe me këta punonjës? Dhe kjo është pyetja më me vend që kanë bërë ndonjëherë. Dhe neve na takon të përgjigjemi: Pikërisht dhe vetëm me këtë popull dhe me këta punonjës! Por, u rekomandojmë të konsultojnë pakëz edhe shkencën marksiste-leniniste. Historia e të gjitha vendeve tregon se vetëm me forcat e veta klasa punëtore mund të fitojë vetëm një ndërgjegje tredunioniste d.m.th. të bindet se duhet të bashkohet në organizata profesionale, të luftojë kundër padronëve, të kërkojë nga qeveria këto ose ato ligje që u nevojiten punëtorëve etj. Kurse doktrina e socializmit… lindi në mënyrë krejt të pavarur nga zhvillimi spontan i lëvizjes punëtore, lindi si rezultat i natyrshëm dhe i pashmangshëm i zhvillimit të mendimit të inteligjencës socialiste revolucionare" (V. I. Lenin, Vepra, vëll. 5, Tiranë 1978, f. 435-436). Ose të shkojmë edhe pak më tej: "…çdo

gjunjëzim përpara spontanitetit të lëvizjes punëtore, çdo zvogëlim i rolit të "elementit të ndërgjegjshëm" … do të thotë njëkohësisht, – në mënyrë krejt të pavarur nga dëshira e atij që e zvogëlon këtë rol, – forcim i ndikimit të ideologjisë borgjeze mbi punëtorët." (Lenini, po aty, f.444– nënvizimi është i tij)

Lëvizja revolucionare marksiste-leniniste synon dhe realizon krijimin e forcave të rregullta revolucionare, teorikisht të përgatitura dhe të lidhura në trajtë ingranazhi, që mund të sigurojnë vazhdimësinë e veprimtarisë revolucionare, ta përcaktojnë orientimin dhe ta koncentrojnë forcën goditëse të masave popullore e punonjëse dhe, duke mos u zmbrapsur e hutuar as në kohën e vlimeve të masës e as në kohën e tërheqjes së saj para brutalitetit të armikut – t'ia bëjnë armikut varrin e vërtetë.

Cila rrugë, duhet të zgjedhet me këtë rast? Dhe a kemi ende paqartësi në këtë mes. Po nëse nuk jemi marrë vesh për kryesoren: a jemi duke ndjekur vërtetë rrugën e luftës nacionalçlirimtare dhe të revolucionit socialist, apo këtë parullë e trumbetojnë për të mashtruar të tjerët, e në radhë të parë vetveten.

Shpirtngushtësia dhe egoizmi i lëvizjes spontane

Përkrahësit e lëvizjes spontane nuk e kanë përgjegjësinë e duhur revolucionare dhe patriotike. Përfitimi më i madh që mund të nxjerrin nga gjunjëzimi para spontanitetit është nofka sedërtare "njeri i popullit" dhe, pas shkrirjes së prirjeve e veprimeve të veta me ato të masës dhe nën diktatin e spontanitetit, edhe njëfarë autoriteti te masa. Për çfarë autoriteti! Sa t'ia dalë që masën ta shtyjë në ndonjë "sherr", por jo edhe ta nxjerrë prej atij "sherri" kur rreziku dhe vështirësitë të kenë dalë më të mëdha nga ç'janë parashikuar.

Përveç kësaj, këta njerëz janë edhe shpirtngushtë dhe egoistë. (Fjalë e rëndë si realiteti.) Jo në kuptimin se nuk janë në gjendje të japin shumëçka për çështjen e përgjithshme, nganjëherë edhe jetën. Por në kuptimin se ata janë shpirtngushtë dhe nuk mund "ta presin ardhjen e lirisë pasi të kenë shkuar ata vetë". Pra, liria, sipas tyre, patjetër duhet të arrijë sot. Për hatër të tyre dhe të fëmijëve të tyre. Në qoftë se ajo pret e nuk vjen më herët, në qoftë se, ta zëmë liria u mbetet për ta gëzuar nipave të tyre, për këta njerëz liria e tillë nuk vlen as pesë para.

Do të thotë se atyre u mungon një nga gjërat më të rëndësishme për punën revolucionare: vullneti i pathyeshëm dhe vetëdija historike. "Vullneti, – na mëson shoku Enver, – nuk ekziston ose thyhet te të plogëtit, te dembelët, te ata që i tremben jetës, te ata që e mendojnë jetën shesh me lule, pa përpjekje e pa mundime, te ata që duan të rrojnë dhe të përfitojnë pa mundime me punën e shfrytëzimin e të tjerëve" (E. Hoxha, Raporte e fjalime, f.18)

Lidhur me vetëdijen historike, që nuk e kanë spontanistët, po marrim shembull një moment nga historia jonë, që ka pasur ndikim vendimtar. Sikur Skënderbeu të kish mbetur një oficer i lartë turk – dhe ka pasur mundësi të mbetet i tillë, si qindra e mijëra bijë të tjerë të gjakut shqiptar, të shkolluar në institucionet ushtarake të Turqisë, ndër ta edhe asish si Ballabani, që luftoi kundër popullit të vet pikërisht në kohën e Kastriotit – sikur Skënderbeu, pra, të mos mendonte për brezat e ardhshëm, a do t'ia vlente atij barra qeranë t'i çojë 25 vjet të plota jetë në luftëra të pakëputura e të egra kundër forcës më të madhe ushtarake të asaj kohe? A do të ekzistonte në rast të tillë shtytje e fuqishme për Lekë Dukagjinin, që ta mbaj edhe për 10 vjet të tjera tempon e luftave të nisura nga Kastrioti? Dhe, më tej, sikur të hiqej fare nga historia jonë kombëtare epoka e Skënderbeut, a do të kishim qenë edhe ne këta që jemi sot? E, pra, vullneti i udhëheqësit

të madh diti ta mbledhë grusht pezmin e shpërndarë të popullit dhe strategjia skenderbejane ia kalli datën perandorisë anadollake dhe bëri kërdinë në përmasa që i kapërcenin përmasat e rëndomta shqiptare dhe ballkanike. Dhe të flasësh kështu kurrë s'do të thotë t'ia zvogëlosh, po përkundrazi ia shton, vlerën dhe meritën popullit që luftoi nën udhëheqjen e Kastriotit.

Përvoja e gatshme dhe "origjinaliteti" me çdo kusht

Kafshimi i gjarprit është vdekjeprurës. Këtë e di edhe ai që s'e ka kafshuar gjarpri. Duket absurd, po disa njerëz te ne duan me çdo kusht ta provojnë në trup të vet atë kafshim, në mënyrë që të nxjerrin përvojë "origjinale". Megjithëqë, rreziku nga ky "origjinalitet" është aq i madh sa, menjëherë pas përvojës, duke mbetur pa frymë, ti do të mbetesh edhe pa përvojën e dëshiruar e edhe pa "origjinalitetin" absurd.

Shkenca dhe historia e përgjithshme njerëzore, për shumëçka e kanë thënë fjalën e tyre të fundit. Sidomos dija marksiste-leniniste. Ndonëse kjo dije u shkel brutalisht nga revizionizmi modern hrushoviano-titist dhe nga eurokomunizmi, ajo, duke gjetur një kështjellë të fortë te Atdheu i shqiptarëve dhe te Partia e Punës e Shqipërisë, përditë po e hedhë shkëndijën e luftërave çlirimtare dhe revolucioneve anembanë botës, kudo ku ka shtypje e shfrytëzim. Prandaj, nuk jemi me ata "revolucionarë popullorë", që duke pasur trashëgimin e madhe të teorisë e të praktikës revolucionare marksiste-leniniste, nuk e quajnë detyrë e nder t'i rreken me gjithë mend veprave të Marksit, Engelsit, Leninit, Stalinit dhe të Enverit, ku e kanë sheshuar si rreze drite gjithë atë që lypset për luftën çlirimtare dhe revolucionin, po jepen pas shpikjesh naive e primitive të "teorive" dhe të "rrugëve" "origjinale" që na shpien te çlirimi.

Na bëhet se ka ardhur koha e fundit t'i rrekemi lëvizjes së ndërgjegjshme revolucionare. T'i flakim hutesën dhe rrugët e parrugë, përgjumjen e amullinë; ndryshkun e kalbëzimin, kotjen e ngathtësinë. Dhe, në vend të këtyre të zgjedhim zgjimin dhe lëvizjen, shkëlqimin e shëndetshëm, shkathtësinë e punën. Ta hedhim vdekjen, të marrim gjalljen. Dhe jo vetëm të një fshati, të një lagjeje qyteti apo të një krahu të vogël të tokave shqiptare të robëruara, po një gjallje e shkathtësi në shkallë të përgjithshme kombëtare e klasore. Dhe t'i ruajmë shëndet, e punë, e gjallëri edhe në rastet e ofensivave më të egra të armikut e edhe në zmbrapsjen më të madhe të masave popullore para brutalitetit të armikut. Të kapemi dorë për dore në ato hallka të sigurta, që e kanë çuar përpara revolucionin botëror dhe luftërat çlirimtare të popujve të robëruar si dhe gjithë shoqërinë njerëzore. Duke ruajtur dhe duke kultivuar cilësinë fisnike të lëvizjes, ne do ta ruajmë dhe do ta kultivojmë në shkallë të lartë prirjen elementare të shoqërisë njerëzore – ecjen përpara, të cilës i bëhen prag me qëllime shtypëse e shfrytëzuese forcat e errëta të planetit, kapitalizmi, imperializmi dhe revizionizmi. Dhe këtë natyrë fisnike t'ua lëmë trashëgim brezave të ardhshëm!

LAVDI MARKSISËM – LENINIZMIT!
RROFTË PPSH ME SHOKUN ENVER HOXHA NË KRYE!
RROFTË POPULLI SHQIPTAR I LIRË E I BASHKUAR!
POSHTË IMPERIALIZMI DHE REVIZIONIZMI MODERN!

LETRAT

1. Letër për Ibrahim Kelmendin, nga pranvera 1980

Ludwigsburg, RFGJ
(fillimviti 1980)

I dashur shok*,

Letra me materialet që të pata dërguar m'u kthye prapa, për shkak se e kisha pasur adresën gabim. Dhe, u bë më mirë, sepse m'u dha rasti që njërin prej atyre materialeve, të fundmin, atë lidhur me "Zërin e popullit", ta marr edhe një herë në dorë dhe ta përpunoj më mirë. Tash, prej tij i bëra dy materiale (i dyti është ai që lidhet me deklaratat e Brezhnjevit), të cilat kur të vijë puna të botohen, të lutem t'i vësh pranë njëri tjetrit, për shkak të tematikës së tyre.

Jam mirënjohës që të bie ndër mend edhe të më shkruash letër. Unë sa për letra jam shumë dembel. Mirëpo, në letrën e fundit ti kërkon ndonjë mendim prej meje lidhur me vargjet që ke shkruar. Prandaj, më duhet të të përgjigjem patjetër.

S'ka dyshim se, sikur të mos kisha diktuar tek ti një shpirt që energjinë e vet mund ta zbrazë përsë mbari duke shkruar vargje (kjo është një nga mënyrat më fisnike të shfrytëzimit të energjisë së njeriut në përgjithësi), do t'i bija shkurt dhe të të thosha të mos lodhesh më. Po realiteti, fatbardhësisht, po flet ndryshe: me një përkushtim më të madh dhe me konsultim pak më të ngulmët edhe të teorisë së artit, për sa kam arritur unë të vërej, ti mund të na dhurosh vjersha shumë të qëlluara.

Ja se, pse i zura ngoje angazhimin më të madh dhe konsultimin e teorisë.

Së pari, në art, gjatë procesit të krijimit, është e domosdoshme që, pos të tjerash, të kemi një besim të madh në vete dhe një bindje të fortë, një sugjestion se jemi duke bërë punë shumë fisnike. Më duket se te ti kemi diçka tjetër: një provë që, krahas punëve të tjera, të merresh edhe me diçka joserioze! Ky është një mëkat ndaj artit dhe deri sa të mbash qëndrim të tillë ndaj tij, edhe ai do të mbajë qëndrim adekuat ndaj teje, do të të përbuzë, dhe kështu mendimi i vërtetë artistik kurrë nuk do të zhveshet i tëri përpara teje në gjithë bukurinë e vet të fuqishme.

E dyta: mbi çdo varg tëndin vërehet influenca e madhe e poetëve tendenciozë revolucionarë, sidomos e atyre gjermanë, (shpresoj se tendencën artistike në këtë rast nuk e identifikon me tendencën e thjeshtë praktike.) Thjeshtësia dhe fuqia e vargut të poetëve si Brehti me shokë, do ta pranojnë edhe teoricienët më të përçudnuar, ka një funksion fisnik në jetë. Mirëpo, i pajisur me një subtilitet, ta zëmë agollian, dhe me një subtilitet e refleks kadarean, vargu i tillë, duhet ta pranojmë unë dhe ti, bëhet varg i vërtetë letrar dhe nuk humb asgjë nga tendenca për t'i shërbyer një populli a një epoke. Përkundrazi, ashtu mishërohet edhe më shumë me njeriun, me indet e tij më të fshehta e më vitale, me asociaconet e tij më të pambërrijshme, dhe bëhet njëherë e përgjithmonë pasuri e njeriut.

Konsultimin e teorisë së artit letrar ta sugjeroj edhe për një arsye të fortë: në vargun më subtil në botë mund të bëjë vend fjala më e vrazhdë në botë, pa i marrë gjë butësisë, veçse duke e shquar atë. Mirëpo, për ta arritur këtë gjë, duhet t'i kemi të qarta ligjet e kontekstit artistik, e me këto ligje nuk lindim por i mësojmë nga leximi dhe i absorbojmë bashkë me invencën jetësore e artistike.

Më në fund, meqë nuk më doli kohë të prek gjësend konkretisht në vjershat që më dërgove ti, këtë punë po e lëmë për herën tjetër.

Të fala të përzemërta,

Jusufi

P.S.

Ne të gjithë jemi mirë, dëshirojmë që edhe ti të jesh mirë, bashkë me shokët dhe dashamirët.

*) Letër dërguar I. Kelmendit, nga J. G., shënim i Faridin Tafallarit

(Botuar për herë të parë nga Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 280-281)

2. Letër e Jusuf Gërvallës - Nazmi Selmanajt prill 1980

I dashur shok Nazmi !

Është hera e dytë që po më gëzon me një letër të mirë. Gatishmëria jote për t'iu kushtuar me gjithë qenien, ashtu si i ka hije një burri shqiptar dhe një intelektuali përparimtar, çështjes së atdheut, s'ka si mos të çmohet. Natyrisht, ky është një obligim për përmbushjen e të cilit duhet të jetë i gatshëm çdo shqiptar. Por, ne jemi të vetëdijshëm se vitet 70 – vjeçare të Jugosllavisë për shkatërrimin e popullit shqiptar, duke mos ia dalë ta arrijnë efektin e plotë, megjithatë e kanë ushtruar një efekt të padëshirueshëm për ne – apatinë dhe topitjen e një pjese të madhe të njerëzve tanë. Prandaj, gatishmëria jote dhe e shokëve të ngjashëm duhet çmuar si virtyt dhe jo të shikohet vetëm si gatishmëri për ta çuar në vend obligimin.

Por, lufta që na mbetet ne në fazën e tashme për çlirim nacional e social nga Jugosllavia, pa dyshim, duhet të jetë luftë që klasën punëtore dhe fshatarësinë shqiptare t'i zgjojmë nga apatia e përmendur dhe t'i bëjmë të vetëdijshme për obligimin e shenjtë që kanë ndaj atdheut. Më duket se, në thjeshtësinë e vet të madhe, kjo çështje për ne është bërë gjëja më e ndërlikuar. Populli ynë, siç dëshmon historia, është një popull trim, që atdheut i ka dalë borxhit kurdoherë, duke luftuar me armiq shumë herë më të fortë. Ky popull sot nuk po lëviz. Arsye? Të jetë frika arsye? Ne e dimë se populli ynë është ndeshur edhe më herët me të njëjtin armik. Gjithmonë, me armë më të dobëta, kundër forcave çetnike, e në fund edhe kundër të ashtuquajturave forca „komuniste" të PKJ-së, populli ynë, i ka dalë të sigurojë superioritete lufte. Cila të jetë, pra, arsyeja e vërtetë? Njeriu mund të thotë: Në mos qoftë frika, atëherë duhet të jetë ndonjë ftohje si rezultat i ftohjes së motivit për dashurinë ndaj atdheut. Mua më duket se as kjo nuk është arsyeja. Motivi i dashurisë ndaj atdheut është i rrënjosur tek të gjithë popujt, madje edhe te ata më të civilizuarit, sado që, siç e dimë, sa më e lartë të jetë shkalla e civilizimit, aq më shumë dobësohet intensiteti i motivit të dashurisë. Këtë mendim ma përkrahin luftërat e sotme në të gjitha frontet, luftëra në të cilat popujt e shumtë, sidomos të civilizuarit, janë kapur fort për motivin atdhedashës dhe nuk lëshojnë pe, edhe me kusht që të shkaktohet lufta e madhe, e Treta, në të cilën ka mundësi të shkatërrohet një pjesë e madhe e njerëzimit.

Armiku ynë ka përdorur mjete tinëzare: postin dhe paranë. Te popujt e shtruar në një mënyrë a në një tjetër, këto mjete kurdoherë e kanë bërë efektin e vet shkatërrues. Të kombinuara me terrorin politik dhe me zhvendosjen e vlerave të vërteta e zëvendësimin e tyre me kuazi vlera, posti dhe paraja, në dekorin e errësirës, të skamjes e të analfabetizmit të deridjeshëm, kanë shkaktuar apatinë dhe topitjen, të përmendura më lart. Më duket se ky mund të jetë një lloj emëruesi për gjendjen tonë.

Mirëpo, ne jemi të vetëdijshëm, në anën tjetër, se populli ynë, shumica dërmuese e tij, nuk është i kënaqur. Historikisht, lëvizja e popujve përgatitet ngadalë. Deri në momentin që në mendjen kolektive të popullit të mos jetë kristalizuar ideja e interesit të përgjithshëm, populli paraqet një masë në dukje amorfe, po me një mundësi të brendshme shpërthimi, siç është ajo e vullkanit. Ç'na mbetet neve: T'ia kristalizojmë atij idenë e interesit.

Një fjalë goje! Por, kjo është thjeshtësia e madhe, e cila është ndërlikuar deri në absurditet. Ne, mendoj unë, duhet ta kemi durimin e vektares së mirë. I janë lidhur nyje ind e tymën; nuk tmerrohet, nuk rrëmbehet nga nervozizmi, që duket i arsyeshëm në atë situatë, por, dalëngadalë, nyjë pas nyje, e bie vekun në gjendje të rregullt pune. Pastaj, meqë është mjeshtër, drugëza e saj do të punojë me rregullsim dhe me shpejtësinë e saj karakteristike. Edhe ne i kemi me vek, me ind e tymën, me shpatëza e drugëza e me bosht. Jemi bij të një populli të shkelur e të shumëvuajtur, i cili, pikërisht në çastet kur është dukur se do të japë shpirt, ka gjetur burime, që ia kanë shumëfishuar fuqinë dhe është vënë në lëvizje?!

S'do mend se, po punuam me ndërgjegje për zgjimin e plotë të shqiptarit të robëruar, kur të bjerë ora e revolucionit, habia jonë më e madhe do të jetë se me çfarë pasioni, me çfarë dashurie, me çfarë trimërie dhe me çfarë mjeshtërie do të punojë vetë populli ynë në luftën me armikun shekullor.

Dhe, kur të bëhemi vetë të gatshëm për flijime sa më të mëdha e për punë të palodhshme e të ndërgjegjshme, do të na dalë përpara me përshëndetje një fakt gazmor: Puna jonë nuk është në fillim. Pjesa më e madhe e nyjave të vekut është zgjidhur. Garancia më e madhe për realizimin e një revolucioni është pakënaqësia e përgjithshme. Kurse unë e ti me shokë kemi pasur pa numër raste të bindemi për pakënaqësinë e madhe të popullit tonë me gjendjen ekzistuese.

Të uroj, pra, durim sa më të madh dhe punë të palodhshme!

Të fala vëllazërore

Jusuf Gërvalla

(Hasan Ukëhaxhaj, Komiteti i Deçanit LNÇKVSHJ, Prishtinë 2022, f.187-189)

3. Letër Enver Hoxhës, prill 1980

I dashur shoku Enver!

Djali im i vogël, dy vjeç e gjysmë, po llafosej me të motrën, tetë vjeçe, ndaj të gdhirë, "Dua", i thoshte asaj, të vij me ty në shkollë! "Kur të rritesh edhe pak" , ia ktheu ajo dhe shtoi me një dlirësi të dhembshur fëmijënore: "Kur t`i bëhesh ti motrës për shkollë, ne do të jemi në Shqipërinë tonë të dashur!"

Cicërrimë më të ëmbël, po edhe më prekëse, për të më nxjerrë gjumin e një mëngjesi të gdhirë me përtesë në dhe të huaj-thuaja se nuk kish.

Isha i lumtur që fëmija im s`e hiqte mendjeje mundësinë për të jetuar në Shqipërinë tonë të dashur. Por fjalët e saj më prekën shumë se sendërtimin e dëshirës së fëmijëve të mi dhe gjakimin tim, nuk e kisha unë në dorë.

Më 14 dhjetor të vitit të kaluar, UDB-ja e Pejës e arrestoi në shtëpinë e lindjes, në katundin Dubovik (afër Deçanit), vëllaun tim të madh, Hysen Gërvalla. Po këtë ditë, UDB-ja e Prishtinës mua ma kishte bastisur banesën në Prishtinë, pa prezencën time. Lajmin e hidhur ma solli në punë (në gazetën "Rilindja") shoqja ime, menjëherë pas bastisjes dhe pas largimit të inspektorëve të UDB-së nga banesa. Lidhur me arrestimin e vëllaut tim të madh dhe me materialet ilegale që kishin shtënë në dorë organet e Pejës, atë, gruan time, e kishte informuar një kushëriri im i parë. Materialet propagandistike të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës si dhe makina ilegale e shkrimit, në rast dorëzimi, do të më ngarkonin me shumë vjet burgim të rëndë. Pos kësaj, në sajë të mjeteve moderne që përdor UDB-ja gjatë hetimeve, nuk ishte e përjashtuar mundësia që, pa marrë parasysh këmbënguljen time, UDB-ja mund të zbulonte edhe ndonjë sekret lidhur me Lëvizjen.

Prandaj, duke marrë pëlqimin e shokut të parë të Lëvizjes, anëtar i Komitetit Qendror, unë u arratisa aty për aty. Më datë 21 dhjetor arrita në Ludvigsburg të RF

Gjermane dhe u strehova te vëllau im i vogël Bardhosh Gërvalla, i cili këtu punon që nga viti 1974.

Në vendlindje, Dubovik, mbetën nëna plakë, vëllai më i ri me grua dhe një fëmijë dhe familja e vëllait të arrestuar, gruaja me shtatë fëmijë; kurse në Prishtinë, gruaja ime dhe tre fëmijët të cilët do të vijnë tek unë një muaj më vonë.

Unë, me të arritur në Ludvigsburg, i bëra telefon Ambasadës Shqiptare në Vjenë dhe prej shokëve të atjeshëm kërkova ndonjë këshillë se si mund të ruhem nga gabimet në një botë ku nuk kisha qenë kurrë më parë dhe ku, pasi kisha ardhur pa pasaport e më duhej të kërkoja azil politik, kishte mundësi edhe për ndonjë gabim. Pak ditë më vonë, këtë gjë si dhe kërkesën për shqyrtimin e mundësive që të më jepet mundësia e strehimit në RPS të Shqipërisë, ia komunikova edhe me gojë njërit prej shokëve të Ambasadës së përmendur.

Nga ajo kohë u bënë afro katër muaj dhe lidhur me kërkesën time nuk mora ndonjë përgjigje.

Ndërkohë, me iniciativën time, në të përjavshmen gjermane "Der Spiegel", u botua një artikull i gjatë për situatën aktuale në Kosovë, pas arrestimeve masive të shqiptarëve, të cilët duhet të përgjigjen para gjyqit jugosllav për vepra "kundër popullit dhe shtetit". Pos kësaj, gazetës së këtushme majtiste "Tageszeitung" i dhash edhe një intervistë po për gjendjen e përmendur. Shkrova edhe një numër artikujsh për gazetën ilegale shqiptare "Bashkimi", e cila qarkullon në radhët e punëtorëve shqiptarë me punë në Gjermani dhe në Kosovë.

Nga shokët e Kosovës më vinin kohë pas kohe porosi që të ruhesha, sepse UDB-ja, e cila është mësuar t`i qërojë me likuidime fizike hesapet me disa ustashë kroatë, kinse nuk qenka larg vendimit që një praktikë të tillë ta aplikojë edhe me shqiptarët në botën e jashtme. Nuk mund të them se s`më kanë bërë ndonjë përshtypje këto sugjerime të shokëve, por as njerëzve të UDB-së këtu, megjithë marrëveshjet dhe bashkëpunimin jugosllavo-gjerman, nuk ua kam aq shumë frikën. Mjafton që këtu nuk ka si të më kërcënojë uniforma e policisë jugosllave, pa për të tjerat bëhet disi, rroftë arma.

Por, që nga çasti i parë i arratisjes, unë e kam pasur mendjen të strehohem në Shqipëri. Prandaj, shoku Enver, mora kurajon të Ju drejtohem Ju personalisht. Kam njoftime për marrëveshjen shqiptaro-jugosllave lidhur me ekstradimin reciprok të personave të vënë jashtë ligjit në të dy vendet. Por, sipas Nenit 65 të Kushtetutës së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, ku thuhet: "Në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë u jepet e drejta e strehimit shtetasve të huaj që ndiqen për shkak të veprimtarisë së tyre në dobi të revolucionit e të socializmit, të demokracisë e të çlirimit kombëtar si edhe të përparimit të shkencës e të kulturës", konsideroj se mua më takon kjo e drejtë. Nuk dua të them se ma mohon kush, por, procedura e rëndomë e realizimit të saj po më dëmton fizikisht e shpirtërisht, shoku Enver. Po e pësojnë fëmijët, të cilët e humbën nga një vit shkollor, dhe sidomos shoqja që është shumë e dobët nga shëndeti, kurse qëndrimi këtu i ka shkaktuar edhe një depresion të rëndë që po mjekohet me vështirësi të mëdha. Përveç kësaj edhe vëllai, te i cili jam strehuar, ka vështirësi të mëdha. Brenda dy viteve të fundit ai është bërë dy herë operacion nga një tumor i lig në kokë, kurse këto ditë do të operohet edhe për herën e tretë. Ndoshta ky mund të jetë një çast ligështimi, por sido që të jetë, çdo ditë e kaluar në këtë vend të huaj sikur po ma gërryen truallin nën këmbë.

Nuk ishte punë e lehtë për mua të vendos që të Ju drejtohem Ju, shoku Enver, për një çështje që ndoshta nuk është e denjë te merreni me të. Në krahasim me të ligat që kanë rënë mbi kokë familjes sime para dhe pas lufte, me të ligat që kam përjetuar vetë dhe me situatën e përgjithshme shumë të vështirë në Kosovë, gjendja ime është, siç i themi ne

nga Kosova, lule e dritë. Por, edhe deveja ka rënë më gjunjë për një lëkurë lepuri që i është shtuar barrës së saj të rëndë.

Kur i marr parasysh çështjet në gjithë gjerësinë e tyre, kërkesa për të m`u dhënë e drejta e strehimit në atdheun tim, më duket si një luks, dhe atëherë më rrëmben një ndjenjë turpi. Por i vetëdijshëm se në Kosovë, përderisa gjendja të mos ndërrojë rrënjësisht, këmba ime s`ka si shkel më sa të jem gjallë, e në anën tjetër, me këtë botë të huaj s`më lidh asnjë cikërrim dhe këtu nuk shoh kurrfarë perspektive, e vetmja rrugë e drejtë dhe e njerëzishme më duket jeta në Shqipëri.

Jam i vetëdijshëm edhe për disa probleme të pahijshme, që kanë shkaktuar disa kosovarë, duke dalë me qëllime të ulëta në territorin e RPS të Shqipërisë. Për fat, makinacionet e UDB-së, që në Kosovë e viset e tjera shqiptare brenda kufijve politikë të Jugosllavisë kanë bërë kërdinë në dëm të popullit tonë, në shtetin shqiptar s`kanë gjetur shesh për të bërë përshesh. Mirëpo, duke qenë njeri i përvuajtur, i thjeshtë dhe i vetëdijshëm për dashurinë që kam ndaj nënës Shqipëri, jam i sigurtë se unë s`do të merrja në asnjë mënyrë rrugën e atyre djemve bastardë të Kosovës, që janë vënë në shërbim të armikut, por do të ndiqja shembullin e ca të tjerëve, si Ajet Haxhiu, Agim Gjakova e ndonjë tjetër të cilët kurdoherë kanë mbetur burra të ndershëm.

(Kjo letër përfundon pa emër, të shkruar nga Jusufi, por është letër e Jusuf Gërvallës - shënimi im- F.Tafallari)

(U botua për herë të në www.albaniapress.com, 2 tetor 2011 së bashku me shkrimin e Faridin Tafallarit, *Kur shkruante Jusuf Gërvalla*)

4. Letër Enver Hoxhës, 19 gusht 1980

I dashur shoku Enver!

Ne - shqiptarët e shkëputur nga atdheu i lirë dhe të mbërthyer me dhunë mbrenda kufijve politikë të Jugosllavisë - ndjekim me krenari çdo hap të Shqipërisë mëmë në përforcimin dhe përparimin e atdheut dhe të socializmit. I gëzohemi prej së largu çdo prove të suksesshme të unitetit të pathyeshëm parti – popull dhe kjo na bën më të fortë edhe ne. Mburrja dhe entuziazmi ynë s'kanë kufi kur kujtohemi që Shqipëria, nga një vend i varfër dhe i prapambetur feudalo – borgjez, u kthye në një vend të përparuar e të zhvilluar, pa analfabetizëm e papunësi në një vend të socializmit të mirëfilltë, që jo vetëm po ja del ta ruajë në gji të shoqërisë së vet të paprekur kështjellën e marksizëm-leninizmit, por edhe t'i ndezë shkëndijat revolucionare te pjesa dërmuese e popujve të Planetit. Pa frikë se po biem në ndonjë eufori, nesër, kur këto shkëndija të kthehen në zjarre të vërteta revolucionesh socialiste, ne jemi të bindur që bota do t'ia njohë një pjesë të madhe të meritave pikërisht atdheut tonë, Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

E qartë, duhej një punë e mundimshme jashtë mase për të arritur në shkallën e sotme. Jemi në dijeni për një pjesë të madhe problemesh, me të cilat u ballafaquan Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli shqiptar në rrugën e tyre të ndritshme. Ajo që na mburr dhe na jep shpresë më së shumti, është fakti se në gjithë këtë punë, prej titani PPSH dhe populli shqiptar i lirë, në udhëkryqin e njërës nga sprovat më të mëdha historike, ka zgjedhur rrugën e sinqeritetit dhe të guximit të pashembullt, me të cilat është mëkuar ndër shekuj populli ynë i shumëvuajtur;, rrugën që i jep dorë të bëhet zëdhënës i ideve më përparimtare të njerëzimit, duke ndarë si me thikë të mirën nga e keqja në botë.

Epoka e lavdishme shqiptare e Gjergj Kastriotit nxorri në pah një përmasë të rëndësishme të shpirtit të popullit tonë: gatishmërinë e flijimit në shkallën më të lartë dhe të frymëzimit të papërsëritshëm të njeriut të kohës për mbrojtjen e atdheut. Dhe hyri me të drejtë në histori si epokë e Prometheut kundër të gjithë perëndive. Epoka e sotme

shqiptare, me Partinë e Punës dhe me Ty në krye, shoku Enver, nxori në shesh edhe një dimension tjetër: etjen e madhe të shqiptarit për punë dhe për ndriçimin e plotë të mendjes. Doli në shesh njeriu i ri, vërtet nga gjiri i njërit nga popujt më të vegjël në botë, por i aftë për t'u bërë shembull për të mirë në mbarë botën. Skena e dramës së sotme shqiptare është po ajo e Prometheut të pesëqind vjetëve. Bota e krishterë ishte ajo që pat nisur luftën kundër kuçedrës anadollake. Dhe sa u duk që ajo botë po i gëzohej titanit Skënderbe, që po i çonte në vend tek e fundit dhe interesat e Evropës, u prapsën një pas një fuqitë e kohës. Kishte një cikërrimë që nuk durohej në personin e Gjergjit dhe të popullit shqiptar: seriozitetin dhe këmbënguljen mbinjerëzore, që çështjen e shtrenjtë të lirisë e bënte të kuptohej në gjithë njëmendësinë e saj. Kështu u sprapsën dalëngadalë edhe forcat që kishin hyrë përpara Shqipërisë "së vogël" në lojën e madhe të dramës komuniste. Shqipëria e "vogël", me seriozitetin dhe njëmendësinë e saj, atyre ua nxorri gjithë merakun në kushte të një temperature të lartë të "lojës" së nisur prej tyre. Marrëveshjet paqësore dhe krushqitë e Venedikut, Raguzës, Serbisë me kuçedrën anadollake, në një kohë që Shqipëria po e lante në gjak çdo pëllëmbë të tokave të veta, nuk ndryshojnë aspak nga tradhtia sovjetike, jugosllave, kineze...që ia kthyen shpinën marksizëm-leninizmit, duke mos qenë të gatshëm t'i bëjnë ballë frymëzimit të lartë komunist dhe duke parapëlqyer rrugën e rezistencës së ulët ndaj armikut të egër të epokës - imperializmit dhe kapitalizmit. Ne ndjekim me indinjatë bllokadën e egër ndaj Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, që e nisën imperializmi e kapitalizmi, për ta vazhduar revizionistët tradhtarë. Por zemra na bëhet mal kur shohim që atdheu ynë marshon sypatrembur, duke çarë një pas një rrethimet dhe bllokadat mizore dhe duke ndjekur me frymëzim e besnikëri të pashembullt rrugën e sigurt të socializmit, që është e ardhmja e afërt e gjithë njerëzimit.

Në saje të ekzistimit të kësaj Shqipërie të mbarë, të fortë e vigjilente dhe në saje të traditave revolucionare të popullit tonë, përgjithësisht, edhe ne, shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare të përfshira me dhunën e me padrejtësinë e pashembullt historike brenda kufijve të Jugosllavisë - ndonëse jemi dëmtuar në masë të madhe nga shtrëngimi i vazhdueshëm i darëve të shovinizmit serbo-malazezo-maqedonas - ia kemi dalë të ruhemi bukur mirë nga ujërat e zeza ideologjike të revizionizmit titist- rankoviçist. Larg ndenjës revanshiste, nacionaliste e shoviniste, te ne është ndezur shkëndija e luftës së pashmangshme nacionalçlirimtare, konturet e së cilës po duken në horizont. Të nxiret pjesa e robëruar e tokave dhe e popullit shqiptar nga kthetrat e përgjakshme të socialshovinistëve titistë dhe të çohet në vend vullneti i ndryshuar i popullit tonë: bashkimi me vendin amë, Shqipërinë socialiste, është një e drejtë historike, që iu mohua por nuk iu çrrënjos kurrë popullit tonë të vënë me shekuj përballë padrejtësive të mëdha historike po të papërkulur kurrë.

Në dëshmi të përpjekjeve dhe të luftës sonë flasin vetë kampet jugosllave të përqëndrimit, me barkun e tyre të akullt, që s'po resht së gëlltituri qe tridhjetë e pesë vjet me mijëra e mijëra patriotë dhe revolucionarë shqiptarë; në dëshmi të tyre flet vetëdija e zgjuar kombëtare dhe klasore e shqiptarëve me banim në Jugosllavi. Na bën të lumtur fakti se Partia e Punës e Shqipërisë dhe Ti, shoku Enver, jo vetëm që keni ndjekur në hap të gjitha konjugacionet e gjenocidit sllavomadh të ushtruar mbi ne, por keni qenë edhe të vetmit denoncues të denjë të këtij gjenocidi në sy të botës. Deri sa ne kemi duruar urie; deri sa ne kemi shikuar me sedër të vrarë kombëtare si zbret dhe si ndalohet flamuri shqiptar; deri sa nga vatrat tona na kanë dëbuar me dajak, me presione e shantazhe dhe deri sa na kanë vënë në tortura të pashembullta; gjithë kohën që ne kemi shijuar mjetet të gjenocidit nga ana e socialshovinistëve serbo-malazezo-maqedonas, i vetmi sadisfaksion për ne ka qenë forcimi dhe zhvillimi i mbarë i Shqipërisë mëmë dhe denoncimi i hapët nga ana e PPSH i të zezave të zbrazura me rrebesh mbi kokën tonë. Dhe, në vend të ndonjë

ndjenjeje të braktisjes nga Shqipëria mëmë (këtë ndjenjë provoi një kohë të gjatë të injektonte në qenien tonë kombëtare gënjeshtra e ligë titiste), qenien tonë e mbushi ndjenja e fuqishme se ka kush na del zot dhe kush e davarit mjegullën historike, me të cilën titistët donin të mbështillnin historinë tonë të vërtetë dhe planet e tyre shtetërore për shfarosjen e shqiptarëve.

Të shtypur në pikëpamje ekonomike, sociale, nacionale e kulturore me breza të tërë intelektualësh e revolucionarësh të asgjësuar fizikisht nga pushtuesit serbo-malazezo-maqedonas; pa institucione dhe literaturë të përshtatshme, nga do të rridhnin informata e njohuri, në bazë të të cilave do të mund të hetohej aktualiteti politik ndërkombëtar dhe çështja jonë jetike, aktivitetin e djalërisë patriotike shqiptare në këtë pjesë të robëruar të atdheut tonë e karakterizonte një kohë të gjatë vetëm instinkti kombëtar dhe entuziazmi i pashuar. U desh një kohë relativisht e gjatë që ne të kuptonim një fakt fare të thjeshtë; se kufijtë e Shqipërisë dhe të Jugosllavisë, në kushtet e sotme dhe në shkallë ndërkombëtare, janë të pacenueshëm dhe se çdo intervenim i hapët i Shqipërisë në çështjet e shqiptarëve të robëruar mund të konsiderohet përzierje në punët e brendshme të Jugosllavisë e kështu edhe të sjellë pasoja të rënda intervecioniste edhe për vetë atdheun tonë, pavarësia e të cilit ka kushtuar çdo pëllëmbë e gjak. Po tani që vetëdija jonë politike po begatohet gjithnjë e më shumë, rrezikun e Shqipërisë mund ta hetojmë më lehtë dhe më lehtë t'i bëhemi prag atij. Sidomos atë të madhin, rrezikun e intervenimit ndërkombëtar në Shqipërinë socialiste, nuk e aprovojmë në asnjë mënyrë, dhe jam i bindur se djalëria jonë përparimtare dhe përgjithësisht populli shqiptar brenda kufijve politikë të Jugosllavisë, më parë do të duronte asgjësimin e vet sesa zhbërjen e Shqipërisë. Për këtë arsye dhe për arsyen se çështja e luftës dhe e revolucionit tonë na përket në radhë të parë neve, shqiptarëve të kolonizuar, ne gjithnjë më shpejt po pajtohemi me faktin se ndihmën e RPS të Shqipërisë duhet ta presim vetëm në çastin vendimtar të luftës sonë, kur lufta të kalojë në konflikt të armatosur. (Por, gjithashtu ne prekemi thellë në sedër sa herë që, nga mosbesimi në ne apo nga konspiracioni i thellë, ndonjë shtetas i RPS të Shqipërisë ngul këmbë sesi në Jugosllavi nuk jemi "gjithaq keq" dhe se "Shqipëria nuk ka fare të bëjë me çështjen tonë!" Fjalë të tilla edhe pse nuk kanë fare të bëjnë me të vërtetën sa i përket qëndrimit të Shqipërisë socialiste ndaj tokave të veta të pushtuara, sjellin dekurajim dhe pakënaqësi në mesin e popullit tonë të shumëvuajtur.)

Nga ana tjetër, ne aprovojmë pa rezervë parimin marksist-leninist të PPSH, lidhur me rivendikimin e kufijve. Mirëpo, nga përvoja 35 – vjeçare me titizmin, a mund të priten rrethana të rivendikimit në rrethana marksiste-leniniste? Te ne nuk do të lëkundet kurrë besimi në revolucionaritetin e popujve. Kjo vlen edhe për popujt jugosllavë. Ti, i dashuri shoku Enver, ke konstatuar vetë se klima politike në Jugosllavi është e atillë që në të mund të pritet shpërthimi i revolucionit socialist. Dhe kushtet ekonomiko-shoqërore për një shpërthim të tillë ekzistojnë qëmoti në këtë vend revizionist, sidomos sot, në kohën e krizës më të madhe në të cilën është katandisur ky vend. Aparati fashist jugosllav ia ka dalë t'i shuajë grevat e shumta të punëtorëve, që janë zhvilluar kohëve te fundit, po edhe ta minimizojë jehonën e tyre, duke i ruajtur ato në fshehtësinë më rigoroze.. Këto greva vërtet mund të merren si shkëndijë e një revolucioni të ardhshëm, sado që ato, përsa mund të hetohet, nuk dalin me ndonjë program të qartë marksist-leninist. Sa i përket opozitës së regjimit të sotëm titist, sidomos kur është fjala për pjesëtarë të kombit kroat nga Kroacia dhe Bosnja, veprimtaria e saj propagandistike dhe agjitatore i ka rrënjët në emigracionin e orientuar thuajse kryekëput nga imperializmi dhe kapitalizmi perëndimor. Kjo opozitë, me një bazë fare të dobët në vend, po bën presion të vazhdueshëm që populli kroat, krahas luftës për pavarësi të plotë nga Jugosllavia, të orientohet nga "demokracia" perëndimore, që do të thotë nga regresi i shkelur para dyzet vjetësh, kundër të cilit është

derdhur gjaku i popullit kroat.. Pos kësaj, regjimi social – shovinist i Beogradit ia ka dalë të helmojë me ndjenjë shoviniste dhe të ndërsejë kundër popullit shqiptar një pjesë të madhe të popullsisë serbe, malazeze e maqedonase, sidomos brenda tokave shqiptare dhe në regjionet që kufizohen me viset tona. Prandaj, ne jemi skeptikë se për realizimin e aspiratave tona shekullore, të drejta, për bashkimin e tokave dhe të popullit tonë, mund të priten rrethana të rivendikimit në baza marksiste-leniniste. Ose, së paku, deri sa të arrijë një kohë e tillë, ka rrezik për dëmtime të mëdha të popullsisë shqiptare që lëngon nën regjimin e egër titist.

Aktualisht, siç e di edhe Ti, shoku Enver, te ne vazhdon eksploatimi i paskrupullt ekonomik i viseve shqiptare nga ana e qeverisë së Beogradit. Vazhdon me të madhe papunësia dhe shitja e krahut të lirë të punës te kapitalistët perëndimorë. (Kohët e fundit, qeveria "shqiptare" e Kosovës deklaroi me mburrje në shtyp sesi janë duke u bërë përpjekje për t'u siguruar punë edhe së paku dhjetëmijë kosovarëve - në Libi, pastaj në RDGJ etj.) Krahas zbrasjes së mëtejshme të Kosovës nga krahu vital i punës (dhe i pushkës), titistët po i shërbejnë, kështu të thuash, pa pengesa edhe një qëllimi sa të lashtë aq edhe aktual sllavomadh: duke sjellë kolonistë të rinj në vend të shqiptarëve të mënjanuar në një mënyrë a në një tjetër, t'u ndërrohet fizionomia etnike tokave të mirëfillta shqiptare.

Në kushte të papunësisë, të pagave të ngurtësuara në një anë dhe çmimeve që po ngrihen në mënyrë përditë më të shfrenuar në anën tjetër, populli shqiptar nën Jugosllavi po çon jetë të mjeruar prej skllavi. Ndërsa rezervat e mëdha ekonomike të viseve tona merren nëpër këmbë dhe me to ushqehet makineria e egër e sistemit revizionist jugosllav dhe ngrihen qendrat e çetnikëve dhe administratorëve serbo-malazezo-maqedonas. Kështu, pakënaqësia e popullit shqiptar, që gjithmonë ka qenë i pakënaqur nga regjimet jugosllave, po rritet dita me ditë.

Për djalërinë patriotike e revolucionare shqiptare, pakënaqësia e popullit tonë ka qenë shlagfort i qartë, për të cilin ata janë kapur rregullisht për ta thënë replikën e tyre luftarake. Pakënaqësia në rritje e popullit tonë, njëherazi, është edhe pasqyrë e luftës politike ndërmjet titizmit dhe popullit shqiptar. Dhe kjo pakënaqësi sot ka arritur në atë shkallë, sa mund të thuhet që lufta jonë politike kundër këtij pushtuesi të egër revizionist është fituar gati në mënyrë përfundimtare. Ky është një faktor i fuqishëm shtytës i revolucionit tonë.

Ndonëse të zbuluara e të ndëshkuara, në luftën tonë të përgjithshme kanë kontribuar shumë grupet dhe organizatat patriotike e revolucionare të shqiptarëve në Jugosllavi, që nga Lufta e Dytë Botërore e këtej. Është mbarësi e posaçme që pjesa e tyre dërmuese ka pasur platformë të shëndoshë ideopolitike. Ato mund të mburren, se kanë ndjekur rrugën e luftës nacionalçlirimtare dhe revolucionit socialist, duke synuar në mënyrë permanente bashkimin e tokave dhe të popullit e me vullnetin e popullit, me vendin amë, Shqipërinë socialiste të Partisë së Punës dhe të shokut Enver. Në këtë mënyrë ato janë bërë pararojë dhe shprehje e qartë e vullnetit të popullit shqiptar, të ndrydhur nga tradhtia e madhe e P"K"J dhe nga interesat e fuqive të mëdha. Por, megjithëse numerikisht kanë aktivizuar në gjirin e tyre një pjesë bukur të mirë të patriotëve dhe revolucionarëve shqiptarë, këto grupe e organizata nuk mund të mburren për konsolidimin e mjaftueshëm të forcave tona përparimtare dhe për punën me efekte të larta në goditjen e armikut. Thuajse rregullisht, veprimtaria e tyre është zbuluar dhe është ndëshkuar që në gjysmë të rrugës. Atyre u ka munguar konspiracioni i thellë, i domosdoshëm në veprimtarinë ilegale. Organizimi i tyre është bërë shpesh në suaza regjionesh të caktuara, të ngushta dhe vetëm në ndonjë rast të rrallë ato (si bie fjala më

1964) janë përhapur në ndonjë trevë më të madhe të tokave tona. Përjashtim bën Lëvizja nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare nën Jugosllavi, për të cilën mendoj se jeni në dijeni dhe anëtar i së cilës jam dhe unë. Kjo Lëvizje vazhdimisht ka pasur parasysh si një nga qëllimet kryesore përfshirjen në gji të vet të patriotëve dhe revolucionarëve nga të gjitha viset shqiptare. Pos kësaj, edhe anëtarët e saj kanë qenë nga të gjitha strukturat shoqërore, gjë që organizatës i ka dhënë një karakter të përgjithshëm popullor. Megjithë të metat që janë përcjellë në aktivitetin e grupeve dhe të organizatave patriotike revolucionare të shqiptarëve në Jugosllavi, ne, para se t'i sulmojmë me kritikën tonë lidhur me ndonjë aspekt të posaçëm të tyre, ndihemi krenar dhe mirënjohës. Mendomë se aktiviteti i tyre më në fund, siç është fare e natyrshme, ka qenë në përputhmëri me mundësitë që ofrojnë kushtet e përgjithshme shoqërore ndër ne.

Po tash, meqë lufta jonë politike ka hyrë në fazën e vet përfundimtare, e cila po zhvillohet në favorin tonë, janë të domosdoshme edhe forma më të larta organizimi të aktivitetit revolucionar. Edhe nga kjo pikëpamje ne, me një vonesë të konsiderueshme, kemi arritur në përfundimin se luftës sonë i duhet një emërues i përbashkët dhe i fuqishëm. E ky emërues mund të jetë vetëm kufta në baza rigoroze të marksizëm-leninizmit dhe në gji të një partie marksiste-leniniste.

Për themelimin dhe mirëvajtjen e një partie komuniste marksiste-leniniste të shqiptarëve me banim në Jugosllavi është e domosdoshme një ndihmë konkrete nga ana e Partisë së Punës të Shqipërisë. Një ndihmë e tillë, konsiderojmë ne, është e drejtë e patjetërsueshme si për PPSH – në, ashtu edhe për djalërinë patriotike e revolucionare shqiptare në pjesën e robëruar të atdheut tonë të përbashkët. Kështu do të përligjej dhe do të fuqizohej edhe lufta jonë e drejtë, po edhe përkrahja që do të merrnim nga PPSH.

Ndihma, natyrisht nuk ka munguar as deri më tash. Literatura revolucionare dhe patriotike, që ka depërtuar në masë të madhe edhe te populli ynë këndej, ka rëndësi të madhe dhe ka ushtruar ndikim të madh. Një rol të rëndësishëm ka luajtur deri më tash sidomos Radio Tirana me emisionet e saj. Dhe një nga masat më të qëlluara për afrimin dhe për ngritjen e vetëdijes kombëtare, shoqërore, politike e ideologjike të popullit tonë në pjesën e robëruar të Shqipërisë, konsiderojmë ne, ka qenë ajo e 28 Nëntorit të kaluar, qëkur shqiptarët në Jugosllavi mund ta ndjekin edhe programin e Televizionit Shqiptar. Mirëpo për t'ia dalë në mënyrë sa më të denjë dhe sa më efektive qëllimit tonë të lartë, mendojmë se në mesin tonë duhet të punojë një dorë e rysur komuniste, që do të na i trasmetonte drejtpërsëdrejti bazat e shëndosha të veprimtarisë së një partie komuniste marksiste-leniniste në kushtet e ilegalitetit të thellë.

Nga ana jonë mund të themi se një gjë është fare e sigurt: njerëz përparimtarë nga të gjitha strukturat shoqërore te ne janë të gatshëm të punojnë pa kursyer asgjë për atdhe dhe për idetë e larta komuniste. Pos kësaj, në mesin tonë dita ditës po nxjerr kokë një mendim i përgjithshëm: brezi ynë i sotëm e ndjen veten të thirrur ta bëjë një hap të madh përpara në luftën për liri dhe bashkim me vendin amë, në mos edhe ta realizojë përfundimisht revolucionin e pashmangshëm.

Prandaj, të sigurt se kjo çështje është e denjë për kujdesin Tënd, të Partisë së Punës dhe të mbarë popullit shqiptar, ne presim që kërkesa e mbarështruar këtu për ndihmën e përmendur nga ana e PPSH-së, të hasë në mirëkuptim dhe të shqyrtohet në nivelin për të cilin do të konsideroni ju se është adekuat.

Duke çmuar lart kohën Tënde të shtrenjtë, shoku Enver, shpresoj se do të kesh mirësinë t'i propozosh ndonjërit nga shokët e afërm të Partisë së Punës të më përgjegjet në këtë letër. Çdo fjalë, çdo mendim a porosi do të jetë shumë efektive dhe jo vetëm për mua.

Në përfundim të kësaj letre, kam nderin e jashtëzakonshëm të Të uroj punë të mbarë në ndriçimin e idesë së lartë komuniste dhe shëndet të çeliktë në udhëheqjen e popullit të lirë shqiptar dhe të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Untergruppenbach 19 gusht 1980

JUSUF GËRVALLA
Habichthöhe 40
7101 Untergruppenbach
RF e Gjermanisë

(Botuar për herë të parë në librin e Faridin Tafallarit, Dhimbje krenare, Tiranë 1998, faqe 94-99, e ribotuar në librin me Tre Yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 32-38)

***

5. Letër Nënës në Dubovik, shtator 1980

Nanë e dashtun!
Rruga e jetës na pruni deri këtu. Zor sa të duesh. Po kollaj, s'ka qysh bahet ma kollaj. Ti vetë sa e sa herë, në prag të gjumit, kur ishim fëmijë e kur kishim dalë prej lojnave të fëminisë, na ke kallxue përralla që kanë të njëjtin përfundim: rruga e nderës asht ma e zorshmja, po ma e mira dhe e vetmja rrugë e vërtetë për njerin. Dhe, kush u mundue për nder, nder ka gjetë!
Sot, në vjeshtën e kësaj rruge, kur s'po kemi qysh me i dhanë gjevap bereqetit kaq të pasun, farën e të cilit e kemi mbjellë vetë, kush lodhet i pari mundet me thonë: a vyen me luftue për nder, tuj i ngarkue vetit kaq të liga në shpindë?!
Unë, besoj, nanë, se ti nuk je ajo që thotë kështu. Ti gjithmonë u ke përballue burrnisht rrebesheve të mëdha. Unë besoj se ti nuk je lodhë. Rruga jonë, mendja e shpirti ynë kanë pasur strofull fjalën tande, dashuninë e kujdesin tand të pashoq. Kur i kujtoj këto, më del se ti, në vend se të mërzitesh, duhet të gëzohesh e të përtërihesh. Ma në fund, veç tuj mos u dorëzue në këtë kohë të vështirë, ti nanë, do ta qitësh edhe hapin tand të fundit burrnor, që të bon si të gjitha ato nana trimnesha e fisnike shqiptare, të cilat, kur e ka lypë puna e vatanit, s'e kanë kursye e s'e kanë kajtë me lot jetën e djemve të tyne dhe kanë këndue kur kanë kukatë qyqet.
Jam shumë i lumtun që për këtë pikë, pra, për mërzinë tande, shpirtin e kam të fjetun. Ti je nji lis, që nuk don me ditë për fërfllazat e forta. Bile, nji lis, madhështia e të cilit del në pah bash kur merr mot me fërfllazë. As bora as ngricat e mëdha nuk të kanë ba kurrë shejë.
Pse, pra, dridhesh aq fort prej lagshte e prej bryme?
Në përfytyrimet e mia të gjalla, këtu në tretdhe, të shoh tuj ecë me atë krejninë tande të pashoqe, sa herë që nisesh me e pa djalin tand në burg, e rrugës të bjen me u shpërndrrue me anmiq të mëdhenj e të vegjël të pjellës sate. Le të pëlcasë anmiku, gjithë ai që e ka ba synin qorr e veshin shurdh kur e do puna me luftue për nderën, për ato që ti jau ke kushtue jetën e shëndetën. Dhe dije se krejnia jote përballë fërfllazës së sotme, asht helmi ma i fortë për anmikun.
Të përqafojmë me mall prej së largu, djemtë, rejat e nipat. (pashtriku.org)

***

6. Letër për Ibrahim Kelmendin, nëntor 1980

Po ashtu, „përkundrazi“, i nderuar shok Ibrahim!

Kështu duket titulli-pasthirrmë i letrës sime, që i përgjigjet besnikërisht tëndes. Edhe sa e sa gjëra të tjera të çuditshme do të kishin dalë, sikur unë t‘i përgjigjesha pikë për pikë gjithë përmbajtjes së letrës sate. Ndoshta edhe s‘do të kish pasur gjë të keqe, por do të na çuditej bota për rasat nëpër të cilat ditka të lakohet mendimi i sotëm i revolucionarit shqiptar.

Megjithatë, për mua që më drejtohet ai titull dhe ajo letër, ka fare pak paqartësi, sepse ne u takuam dhe u njohëm dhe është punë e kotë dhe ndoshta absurde ta injorojmë këtë njohje.

E marr me mend (e kjo spikat edhe në letrën tënde) ç‘mundime ke pasur të më shkruash në “nivelin” tim. Thua se vetëm në “nivelin” tim të shkrimit paska për mua afrim, respekt e dashuri për njerëzit! E çka do të kish qenë “niveli” im, sikur t‘u jepej flirteve absurde narcisoide me vetveten dhe të injoronte faktin se ka pa numër virtyte të tjera, që mund ta marrin vizën e njerëzisë para se një aftësi mesatare e të shkruarit?! **Ky është ofendimi më i madh, që më ke bërë ndonjëherë: të më zhveshësh nga gjithçka njerëzore dhe të më identifikosh me një aftësi gati-gati mediokër të shkrimit! (Ti këtë se thua konkretisht, po del nga qëndrimi yt.)**

Por, t,i biem pak më konkretisht.

S’do mend se ndërmjet mënyrës sate dhe mënyrës sime të veprimit ka një dallim thelbësor, sado i njëjtë të jetë caku. Dhe kurrë mos do të shkojë mendja, vëlla të paça, shok të paça, apo kushdo qofsh ti, mos të shkojë mendja se jam i bindur që mënyra ime është më e drejtë dhe më e mirë. Pikërisht duke çmuar mënyrën tënde, megjithë vërejtjet e shumta që kam pasur për të, unë asnjëherë s’kam provuar të dal para teje me kërkesa të prera që ajo ti nënshtrohet mënyrës sime. Dhe kështu, për kaq kohë sa njihemi- e nuk është pak po më se dhjetë muaj-ne të shumtën i kemi rënë kush thumbit e kush patkoit.

Mendoj se kjo e ka arsyen e vet objektive. Ti ke njerëzit e tu, me të cilët, sipas mendjes sime, ke vështërsi në realizimin e kontakteve për shkak të largësisë. Kam përshtypjen se, pos kësaj, edhe me ta ke mospajtime dhe sygjerime e urdhrave të tyre s’të fle në hatër tu përmbahesh gjithmonë. Unë, nga ana tjetër, i kam humbur të gjitha lidhjet me njerëzit e mi dhe për çdo hap që bëj kam stërngarkime, sepse nuk e di në mos bej gjësend, që nuk përputhet me luftën aktuale, që bëjnë ata në vendlindje. Kjo është një tragjedi vetvetiu. Kurse tragjedia tjetër është se edhe unë edhe ti, në këto kushte, ndiejmë pasiguri në një pikë: kë përfaqësojmë dhe a mund të flasim në emër të një populli dhe sa mund të flasim në këtë drejtim.

E keqja është se ti, në mënyrë këmbëngulëse, shkakun kryesor për pengesat në marrëdhëniet në mes nesh e kërkon atje ku s’duhet. Ti je energjik në kuptimin e asaj se brenda ditës arrin në shumë pika. Kjo është pozitive. Sepse në këtë mënyrë mund të supozohet se ia del t’i mbash frenjtë e njerëzve me të cilët punon. Mirëpo, këtë gjë ti e bën me këmbana. Dhe kjo, sipas mendjes sime, është e keqja. Sepse, siç ta kam thënë edhe më parë (e ti s’ia ke vënë veshin), edhe këtu konspiracioni duhet të jetë i plotë, dhe sidomos këtu.

E dyta, ti se ke për gjë të kërkosh ndihma në të holla (dhe në armë!) te emigracioni, i cili ka një cak të kundërt me atë të punës sate, e pastaj të biesh në rezignacion aq të panevojshëm, kur po ky emigracion u bie kambanave të shpifjeve, të cilave ua ka anën. Ky është një gabim shumë i madh, dhe kur unë ta them se është gabim e t’i marr shembull pasojat që ke pasur, ti ma zë për të madhe pse unë po ti mbaj te hunda disa cikërrime që t’u kanë përvjedhur pahiri. Vërejtjet e mia ti i merr si atak rivaliteti mbi personalitetin

tënd, që do të thotë se nuk je i gatshëm për të nxjerrë mësime nga pësimet dhe për autokritikë (sa do që rolin e autokritikës nuk e mohon).

(Botuar për herë të parë në www.albaniapress.com, më 5 qershor 2009 nga Faridin Tafallari, së bashku me shkrimin "IBRAHIM KELMENDI KA NDIKIM NË VRASJEN E JUSUF DHE BARDHOSH GËRVALLËS E KADRI ZEKËS!!!???", e ribotuar nga Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 281-283)

7. Letër për Nuhi Sylejmanin, janar 1981

I dashur shok, Nuhi!

Herën e kaluar nuk patëm si të ishim të kënaqur nga takimi. Unë e kisha marrë me mend krejt ndryshe. Por, ne edhe më tej, në këto kushte, do të ballafaqohemi me vështirësi pasi kemi pak gjë në dorë.

Tani, me keqardhje, ju bëj me dije se kësaj jave nuk mund të takohemi fare. Bardhi, qysh të hënën në mëngjes, ndodhet në Bon, në një seminar, ku i duhej të merrte pjesë patjetër. Natyrisht, ne do të mund të takohemi, nëse ju do të vendosni të vini këndej nga unë.

Ndërkohë, e kam përgatitur edhe një material. Por, nuk kam si t'jua dërgoj, sepse më parë do të duhej ta fotokopjoja, e për këtë nuk kam mundësi pa qenë këtu Bardhi. Deri në takimin e ardhshëm do të kish qenë mirë që ju t'i jepni zor pak më konkretisht e më energjikisht në mbledhjen e ndihmave për shokun H. Nuk është mirë ta vonojmë këtë punë. Dhe sa më shpejt duhet ta gjejmë një shok të përshtatshëm, i cili do t'i dorëzojë në vend. Besoj se nuk e keni harruar dhe nuk e keni bërë "nazgjë" këtë punë.

Ju porosis të shikoni ndonjë shok me bibliotekë të pasur dhe të merrni prej tij e ta lexoni librin e V. I. Leninit: "Ç'të bëjmë?". E gjeni në vëllimin 5 të kompletit të veprave të Leninit, nga faqja 401 deri në fund. Unë besoj se do ta gjeni, po të përpiqeni. Kurse leximi i kësaj vepre është i domosdoshëm.

Ju porosis, mbi të gjitha, që ta ruani sekretin, si jemi marrë vesh, për ato që kemi biseduar. Ne ndonjëherë mund të mos punojmë si duhet, si tash që i kemi rralluar takimet, gjë që dëmton vullnetin dhe moralin tonë. Por, të mos harrojmë se çështja kryesore mbetet ajo që është, dhe ajo asnjëherë nuk humbet asgjë nga shenjtëria e vet. Këto t'i keni parasysh, dhe jo ndonjë qëndrim të ndonjë shoku, se kështu mund të bëjmë gabime të pafalshme, duke e barazuar rëndësinë e vet çështjes me qëndrimet e përshtatshme a të papërshtatshme të shokëve.

Me përshëndetje të ngrohta vëllazërore,

"Lajmëtari"

P. S. Nuk e di a e keni adresën time: Habichthöhe 40, - 7101 Untergruppenbach.

Në qoftë se vini, atëherë më shkruani ndonjë letër. Mundësisht me makinë shkrimi, për arsye që dihen. Dhe, në letër, të shtroni pyetjet lidhur me materialet e përpunuara deri më tash, apo për gjëra të tjera që na interesojnë. (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, f. 28-30) (Janar 1981-shën i Xhafert Durmishit)

8. Letër për Nuhi Sylejmanin, kah fundi i janarit 1981

I dashur shok, Nuhi!

Më vjen keq që një nga bisedat tona të para serioze u bë duke kritikuar punën e të tjerëve, madje pa qenë ata prezentë. Ka mundësi të dalin keqkuptime dhe gjithë puna të

merret si përgojim, por këtë gjë do ta bëjmë edhe ndërsy njerëzve që do t'i marrim në thumb, kurdo që të na ipet rasti. Aq më parë është e rëndësishme ta sheshojmë mënyrën e punës së "Frontit...", sepse është në kundërshtim të rreptë me veprimtarinë revolucionare marksiste – leniniste, pa marrë parasysh që vetë ka si pikënisje idenë marksiste – leniniste. Por, vetëm formalisht...

Por, këtë gjë, tash e tutje do ta bëjmë më me themel.

Takimin e parë po e mbajmë të dielën (më 1 shkurt) në ora 18:00, në Ludwigsburg. Takohemi te zyra e B., aty ku i mbanim provat e dramës. Takimi do të jetë i shkurtër. (Duhet të kujdesemi që takimet tona të mos shndërrohen në "ndeja të pasdarkes dimërore".)

Mendoj unë se duhesh t'i marrësh me vete nja 400 DM nga ato të fondit të krijuar deri më tash. Me I. dhe H. kemi pasur një marrëveshje konkrete, që unë të shkruaj për "Bashkimin", t'i përpunoj materialet e shkruara prej të tjerësh dhe ta shtyp gjithë materialin në makinën time të shkrimit. Unë i jam përmbajtur marrëveshjes, ata jo. Deri më tash, ata më kanë dhënë vetëm 200 DM për shtypjen në shtypshkronjë të "Lajmëtarit të Lirisë", kurse marrëveshja ka qenë që të hollat për shtyp t'i sigurojnë ata, meqë unë nuk jam në gjendje të paguaj nga xhepi im. (Deri më tash, dy numrat e revistës i kam paguar me të hollat e mia, sikurse edhe makinën e shtypit, gjithsejtë mbi 9.000 DM, kurse kontribute nga shokët kam marrë gjithsejtë 1.300 DM.) Për këtë arsye, numri i parë (për këtë vit) më ka ndenjur qe më se dy javë i gatshëm, sepse nuk kisha të holla ta dërgoja në shtyp.

Merri me vete, nëse mundesh, edhe ato disqet e gramafonit me recitime, të cilat i përmendi Mejdiu. Është mirë t'i incizojmë dhe t'i shpërndajmë sa më parë.

Në takim të vish në formacionin për të cilin jemi marrë vesh herën e kaluar.

Mirupafshim, të dielën!

(nënshkrimi origjinal i Jusuf Gërvallës)

"Lajmëtari"

Të fala të përzemërta edhe shokëve, që s'po ua përmend emrin!

P. S. Po të dërgoj edhe numrin më të ri të "Bashkimit", nëse nuk e keni marrë ende. Por, ju lutem të ma ruani, sepse është e vetmja kopje që e kam.

(Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 30-32)

9. Letër për Nuhi Sylejmanin, 10 shkurt 1981

I nderuar shok, Nuhi!

Druaj mos jam vonuar në këtë letër, për arsye të caktuara.

Në qoftë se e merr brenda ditës së sotme (e martë, 10 shkurt 1981), atëherë, të lutem që në përbërjen e herës së kaluar, të dalësh po në atë kohë dhe po në vendin e përparshëm në takim. Shpresoj se e keni lexuar me shokë materialin që more herën e fundit, se do të keni marrë edhe ndonjë qëndrim të caktuar lidhur me të, dhe se kësaj radhe do të mund të kalojmë konkretisht në sqarimin e gjërave të panjohura lidhur me materialin e parë dhe në punën e mundimshme po të shenjtë që na pret në të ardhmen. Unë jam duke punuar në një material të ri me rëndësi dhe besoj se do të jetë i gatshëm për këtë takim. Po kështu, ka qenë e parashikuar që brenda ditës së sotme të dalë edhe numri i ri i "Lajmëtarit", kështu që, nëse del, do ta marrim me vete edhe atë.

Nëse është kthyer M., merrja ato pllakat e gramafonit dhe pyete a ka marrë gjë vesh lidhur me shokun H., pasi, me gjasë, M. ka qenë në shtëpi dhe, sipas informatave, është dashur të kthehej pardje.

Besoj të kesh biseduar me shokët për ndihma që patëm thënë t'i mblidhnim për H. Po kështu, qysh tash ne duhet të mendojmë hollë e hollë se kush do të jetë njeriu i përshtatshëm, që do t'i dërgojë në vend ato, kur të mblidhen. Kjo ka rëndësi të madhe.

Me shpresë se letra arrin me kohë, ju përcjellim të fala vëllazërore, ty dhe shokëve!

"Lajmëtari"

(Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 32)

10. Letër për Nuhi Sylejmanin, mesi i marsit 1981

I dashur shoku Vullnet, dhe të tjerë,

E mora letrën tuaj dhe listën e fjalëve të panjohura që duan shpjegim. Pikërisht për ta kryer këtë punë, ndenja në shtëpi dhe nuk dola sot të takohem me ju, sado që e dija se do të dilnit në Ludwigsburg. Prandaj e porosita Bardhin të merreni vesh. Ai sapo u kthye nga puna dhe më tregoi se jeni takuar. Edhe për të tjerët më tregoi. Natyrisht, do të bëhet shumë mirë nëse do të keni rast të shkoni për ndonjë ditë për në shtëpi. Edhe do të çmalleni edhe do të kryeni ndonjë punë.

Merret vesh se nuk do të shkoni pa më treguar dhe pa u takuar. Duhet të merremi vesh për ndonjë send, helbete. Pos kësaj, meqë njeriu i pritur nga Kosova nuk erdhi ende, s'është keq të mendoni pakëz si ta organizojmë edhe nxjerrjen përtej kufirit të këtyre revistave të grumbulluara. Pos kësaj, mendoj që ka ardhur koha të caktojmë një njeri i cili do të realizojë kontaktin me krahun e Lëvizjes në Kosovë. Pra, kemi shumëçka për t'u marrë vesh.

Më njoftuat për demonstratat. Uashingtoni thotë se kanë qenë 500 demonstrues.

„Frankfurter Allgemeine Zeitung" (data 12.03.1981) thotë se demonstrata ka qenë e fuqishme, kurse pjesëmarrës kanë qenë 2000, disa shokë që gjoja e paskan dëgjuar me vëmendje Radio-Këlnin, thonë se Këlni paska thënë se kanë marrë pjesë 32 mijë demonstrues. Ndërkaq, me valën e parë të informatave, disa shokë nga Kosova na kanë dhënë njoftime jo të plota. Ata thonë se kanë qenë së paku 4000 demonstrues. Një polic është plagosur rëndë (gazeta gjermane thotë se ai ka vdekur), kurse prej djelmoshave tanë 13 janë të plagosur. Demonstratat kanë filluar të mërkurën më 11 mars 1981 në ora 17:00, dhe kanë vazhduar deri ditën e nesërme në ora 4. Së shpejti do të na arrijnë informata të hollësishme.

Sido që të jetë, demonstratat nuk i mohon as "Rilindja", as „Borba" (13 ose 14 mars), sado që e zvogëlojnë përmasën dhe numrin e pjesëmarrësve, në një mënyrë aq të mjerë, e cila është karakteristike vetëm për fashizmin jugosllav.

Lidhur me efektin e tyre do të flasim posaçërisht pasi të marrim informata të plota. Po një gjë dihet me siguri: ato kanë rëndësi shumë të madhe. E vërtetojnë edhe njëherë vitalitetin e popullit tonë dhe faktin se mes nesh dhe fashizmit jugosllav nuk do të ketë kurrë pajtim, deri te liria e plotë dhe bashkimi me vendin amë.

Përshëndetje shqiptare e komuniste

„Lajmëtari"

(Mesi i marsit 1981) (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 34-36)

11. Letër e Bardhoshit për Nijazi Strajën, 4 prill 1981)

Herrn
Nijazi Saracoglu,
Mahmut Pasa Çadesi 82
TR-ISTAMBUL
Türkei

I dashuri Shoku Nijazi,

dje, pasi e mora lidhjen telefonike me ju, isha shumë i gëzuar, sepse kan kaluar me se 15 muaj qe po e presim ndonje lajme nga shoku Bashkim Prishtina, për të cilin ju mund te dini rastesisht se ku po qendron. Jusufi, vëllai im para dy ditesh ka shkuar ne veri të Gjermanise tek nje nip i yni, keshtu qe ai nuk mund t'ju shkruan edhe 6 dite deri sa te kthehet prap kendej.

Ju thate se e njihni vellaun tim, dhe se keni qene se bashku ne burg, por, vellau im nuk ka qene ne burg, keshtu qe ju duhet ta njihni Zeqir Gervallen, kusheririn tane. Jusufi u arratis diten kur u burgos vellau yne me i madhi, Hyseni, me 14. 12. 79 dhe ka kerkuar strehim politik ne Gjermanine Perendimore. Me Shabanin u njohem para dy javesh ne panairin e artizanatit, ku bente pjese edhe Shqiperia. Ai edhe na dha adresen dhe telefonin tuaj.

Pasi harrova te iu pys a mos keni pengesa lidhur me letra, sepse mund tbehet qe ua kontrollojne, tani per tani nuk po ju shkruaj me gjeresisht. Per sa i perket qeshtjes sone te madhe, ne jemi shume optimist, sidomos pas ngjarjeve te fundit ne Prishtine, Prizren, Gjakove, Peje, dhe ne Zagreb (sipas gazetes Gjermane studentet shqiptar ne Zagreb bene demonstrata solidarizuese me ato te Kosoves), ku u pa haptazi vullneti dhe gateshmeria e popullit te drejte shqiptar.

Kishte me qene mire sikur edhe Bashkimi te na shkruaje sa me pare. Ne fund po iu pershendes ju me gjithe familjen dhe dashamiret tuaj.
Bardhosh Gervalla

(U botua për herë të parë nga Faridin Tafallari si pjesë e shkrimit "Kur Jusuf Gërvalla shkruante" në www.albaniapress.com, 2 tetor 2011)

12. Letër për Sabri Novosellën, 14 prill 1981

Untergruppenbach, RFGJ
14 prill 1981

I dashuri shok, Bashkim!

Letrën tënde (një fjalë apo një shenjë sado të vogël) e kam pritur si qorri sytë. Siç do të shohish pak më poshtë, ajo ka për mua një rëndësi jashtëzakonisht të madhe, bile rëndësi jetësore.

Muajt e parë të arratisë sime u merakosa për efikasitetin e Organizatës sonë. Unë, në bazë të bisedave në takimet tona, e dija që Organizata ka për detyrë dhe është e zoja të marrë kontakt me anëtarët e vet edhe në rrethanat më të vështira, siç është burgu. Nga ana

tjetër, megjithëqë vështirësitë për të marrë kontakt me mua, duke u nisur nga karakteri i hapët i kufirit jugosllav ndaj Perëndimit, i konsideroja vështirësi relative, për disa muaj rresht s'më vinte fjalë as zë. Dhe gjendja e tillë, e cila me jepte dorë ta gjykoja Organizatën, do të vazhdonte deri më sot, sikur ndërkohë unë vetë të mos e bëja një ligësi të kobshme. Ti mund të mos e dish, por shkaktari i arratisjes sate jam pikërisht unë! Mbase natën që do të jesh arratisur ti, mua më morën me telefon nga UDB-ja e Pejës dhe më bënë presion të çuditshëm, gjithsesi monstruoz, që të tregoja se kush është Bashkim Prishtina. As që më ka shkuar mendja se e kisha humbur aq shumë truallin nën këmbë. I përgjumur dhe me gjasë fare i humbur siç isha, në kthetrat e një ligësie të pashembullt dhe fare të huaj për mua deri në atë çast, unë rashë në provimin e rëndësishëm: kallëzova shokun! Për të „shpëtuar" fëmijët e vëllait, pra mora në qafë fëmijët e shokut, fëmijët e vëllait por që nuk ma kishte bërë nëna. Dhe në këmbim të kësaj fitova: faqen e zezë dhe barrën e rëndë të ndërgjegjes së ligur si kurrë ndonjëherë në jetë. At çast e tutje, jeta edhe ashtu e errët, me strumbullar të vetëm luftën modeste dhe gatshmërinë për flijim në emër të idealit të lartë të lirisë, m'u errësua edhe më. Brerja e rëndë e ndërgjegjes dhe ndjenja e thellë e shkatërrimtare e fajit ndoqën pa mëshirë dhe në çdo hap të gjitha netët dhe ditët e arratisë sime të hidhur, e cila, pas gjestit tim qyqar, e humbi gjithë qëllimin e vet dhe m'u shndërrua në gurë të rëndë në zemër.

Menjëherë pas aktit tim të lig, unë, tashmë i „shpërgjumur", i bëra telefon një shokut tim në Podujevë (është fjala për z. Skënder Hyseni, K. R.) që të vinte e të të lajmëronte për rrezikun. Por, sigurisht ka qenë vonë për gjithçka. Atëherë m'u shfaq një motiv i fuqishëm që për gjestin tim qyqar t'i rrëfehesha shokut tim të parë që do ta takoja. Po shokë nuk kisha. Gjithë natën e gjatë u detyrova t'i shtrohem gjykimit të vëllait të vogël këtu, të shoqes sime dhe, bile, gjykimit të heshtur të djalit tim 12-vjeçar, i cili ishte prezent kur ngjau biseda. Më pastaj prisja t'i rrëfehem ndonjërit nga shokët e Organizatës, kur të merrja eventualisht kontaktin e pritur. Ndërkohë dëgjova për arratisjen tënde dhe vendosa që së pari të të rrëfehem ty e pastaj kujt do që e kërkon puna.

Unë pra, shok i dashur, u korita keq. Me „meritën" time, ti tani do të mund të ishe në duart e UDB-së xhelate në ndonjë kamp jugosllav të përqendrimit, ndoshta edhe i vdekur nga dora e UDB-së, me po këtë „meritë", ti u detyrove të dalësh në kurbet, peshën e të cilit e di unë mirë. Të mos flasim për dëmet që i kam shkaktuar Organizatës, e kështu edhe idealit të lartë të popullit tonë të shumëvuajtur. Prandaj s'më bën zemra të kapem pas fjalës së urtë të popullit, që thotë se duhet të jetë „i lumtur ai që u korit një herë" për t¨mos u koritur më kurrë. Sado që jam i sigurt se ligësia e turpi i tillë nuk do të përsëriten kurrë më tek unë pa e ngrënë së pari mishin tim e të fëmijëve të mi.

Tani, fatin tim të mëtejshëm e keni plotësisht në dorë ti dhe shokët. Nëse mund ta merrni mundimin e ta analizoni rastin tim më hollësisht, nëse pastaj gjendet shteg që gjesti im të cilësohet akt qyqar i kryer në rrethana ligështimi, dhe jo tradhti e hapët, atëherë më keni ndihmuar të ngjitem edhe një herë në shkallën e njeriut, e për këtë do ta keni përjetë mirënjohjen time dhe punën time të palodhshme. Nëse nuk i peshoni punët kështu dhe e quani tradhti të hapët qyqarinë time, atëherë jam i gatshëm ta duroj edhe dënimin më të rëndë nga ana jote, e shokëve e kështu edhe e pjesës përparimtare e liridashëse të popullit tonë: përjashtimin jo vetëm nga radhët e Organizatë (s) sonë, po edhe shpalljen e tradhtisë sime me daulle, te të gjithë ata njerëz që ia duan të mirën popullit shqiptar. Ndoshta e meritoj që, si gjarpri dhjamin e vet, ta ha dalngadalë këtë tepricë të jetës që më ka mbetur – në mërgim dhe pa shokë e njerëz që të më konsiderojnë të barabartë me vetveten. Me një fjalë, ju mund të më bëni një njeri të rilindur apo një njeri të humbur fre në vorbullën e këtij planeti. Se vetëm mendimi juaj mund të bëhet shpatë, që do ta këpusë këtë nyje të ngatërruar të jetës sime.

Natyrisht, kurrë nuk do t'i lejoja vetes që të kërkoj prej jush as mirëkuptimin më të vogël ndaj meje, po qe se jeni të bindur se, duke më falur, mund t'i bëni ndonjë dëm çështjes sonë të shenjtë. Në rrethana tjera, unë kam mundur të bie hero a dëshmor në gjysmën e rrugës të revolucionit tonë. Në rrethanat e tashme, nëse nuk më falet gabimi, do të bie tradhtar. Një më shumë a më pak, nuk mund ta dëmtojë luftën tonë, e cila s'ka të ndalur dhe e cila do të ngadhënjejë patjetër.

I dashuri shok, Bashkim,

Tani më lejo të të bëj një raport të shkurtër për punën time nga dita e arratisjes sime e këndej.

Puna e parë që bëra, u bëra një telefon shokëve të ambasadës shqiptare në Vjenë. I njoftova për çështjen time dhe i luta të më ndihmojnë me ndonjë këshillë për të mos bërë ndonjë gabim ideologjik a taktik gjatë strehimit në këtë vend kapitalist. Ata, si zakonisht, u treguan të kursyer, po megjithatë patën njëfarë mirëkuptimi. Pastaj sipas marrëveshjes që kishim së bashku me ty, unë i informova Organizatën e Amnestisë Ndërkombëtare dhe Radio Londrën për gjendjen e vështirë në Kosovë dhe për burgosjet masive politike të shqiptarëve. Me sa di, Radio Londra s'ka marrë gjë para syshë, kurse Amnestia I. e dërgoi menjëherë tek unë përfaqësuesen e vet nga Londra dhe mori përsipër përkujdesjen për të gjithë ata të burgosur politikë shqiptarë, për të cilët unë ia dola ndërkohë të mbledh ndonjë shënim.

Në të njëjtën kohë shkrova një artikull të gjatë, të cilin ia dërgova magazinës së përjavshme gjermane „Der Spiegel". Ajo, siç mund të pritej, nuk e botoj artikullin në fjalë, por një artikull të një redaktori të vet, me disa të dhëna nga artikulli im po edhe me disa poshtërsi karakteristike për shtypin e këtushëm.

Në fillim të qëndrimit këtu, më ofroi bashkëpunim me gazetën „Bashkimi", organ i Frontit të Kuq Popullor, njëri nga bashkëpunëtorët e saj. Meqë gazeta edhe më parë shkonte në popull, madje në një gjendje të keqe, unë e pashë të udhës dhe të lejueshme dhe bashkëpunova me të në disa numra (të cilët po t'i dërgoj menjëherë – te artikujt e shkruar prej meje po e vë nga një shenjë).

Pastaj, nga Kosova më erdhi një student për vizitë dhe më solli një letër nga një i njohuri im i mëparshëm. Ky më njoftonte në letër se ishte pjesëtar i një organizate të vogël patriotike (unë atë person e dija për atdhetar) dhe, duke shprehur gatshmërinë e vet dhe të shokëve të vet për luftë të pakompromis për atdhe, me lutej që të merrnim kontakt dhe t'u delja në ndihmë me ndonjë këshillë a udhëzim. Unë, edhe lidhur me këtë e pashë të udhës të përgjigjem pozitivisht. Madje nga njoftimet që zunë të me arrijnë pastaj për riorganizimin e kujdesshëm të atij grupi, mora impulse edhe për ta nxjerrë vetë (me përballime të mëdha materiale e pa bashkëpunëtorë) edhe revistën e përdymuajshme „Lajmëtari i lirisë", tre numrat e parë të së cilës po t'i dërgoj me këtë udhë. (Lidhur me atë krah të ri, që pranoi Statutin dhe programin e Organizatës e riorganizimin, përditë po më arrijnë fjalë gjithnjë e më të mira.)

Qëkur ndodhem këtu, kam qenë mjaft aktiv në propagandë dhe agjitacion. Në Shtutgard dhe në rrethin e këtij qyteti ka shqiptarë të ndershëm, që e presin me padurim fjalën patriotike dhe revolucionare. Përveç kësaj, kam udhëtuar edhe në shumë qendra të tjera të RFGJ. Kam kontakte (sado të pakta) edhe me njerëz jashtë këtij vendi, por deri më tash nuk kam mundur të udhëtoj, sepse nuk kam pasur dokumente. (Dje, bashkë me letrën tënde, më arriti edhe njoftimi se më është dhënë strehimi politik në RFGJ, në bazë të kërkesës së paraqitur para 16 muajsh.)

Konkretisht, në rrethin e Shtutgartit janë nja 7 – 8 shokë të gatshëm e të përshtatshëm për punë patriotike-revolucionare. Ata presin ndonjë orientim nga unë. Po unë duke qenë edhe vetë në mjegull për gjendjen time, nuk kam dashur t'i ngashnjej e pastaj t'i lë në gjysmë të rrugës. Prandaj u kam folur për gjëra të përgjithshme në çështje të organizimit, të propagandës dhe të agjitacionit si dhe kam bërë përpjekje për t'ua dhënë elementet e domosdoshme shkencore të historisë kombëtare dhe të lëvizjes komuniste shqiptare e ndërkombëtare. Janë punëtorë dhe ma ka marrë mendja se në radhë të parë u duhet një ngritje ideore, politike e shkencore.

Tani së fundi jam në kontakt edhe me një shok të grupit të Marksistë-leninistëve të Kosovës, të tubuar rreth organit të tyre „Liria". Personalisht, për organin e tyre kam mendim shumë të mirë, po edhe shoku me të cilin kam kontaktuar duket shumë i ngritur dhe i pjekur. Ka një mirëkuptim mes nesh dhe kemi rënë në ujdi që t'i bashkërenditim veprimet. Lidhur me këtë, për fillim, kemi zënë të organizojmë një varg demonstratash, nëpër qendra të ndryshme evropiane, që kanë për qëllim të bëhen përpjekje të zëshme e ngjarjeve aktuale në Kosovën tonë trime. Demonstrata e parë, shumë e suksesshme, është bërë para ambasadës jugosllave në Bern të Zvicrës, më 11 prill, në të cilën kanë marrë pjesë edhe shqiptarë nga RFGJ. Demonstrata e dytë do të mbahet po në Zvicër, në qytetin Cyrih, më 18 prill, kurse të tretën e kemi parashikuar në Stutgart, aty nga 26 prilli. Parullat e demonstratave kanë një përmbajtje thellësisht marksiste-leniniste dhe përkrahin deri në fund kërkesat e rinisë heroike të Kosovës për republikë (që nënkupton edhe përfshirjen e tokave të popullsisë shqiptare në Maqedoni, Mal të Zi e në Serbi). Përveç kësaj, demonstratave u prin automobili me megafon, i cili i koordinon veprimet, kontrollon disiplinën dhe shprehjen unike. Me megafon lexohet në shqipe dhe në gjuhë të huaja trakti përkatës, me elemente informative e sqaruese lidhur me gjendjen e krijuar në Kosovë nga kryengritja e këtej.

Kur e mora letrën tënde të çmuar, unë isha duke përgatitur një trakt të gjatë për opinionin gjerman e zvicëran, kurse shoku i „Lirisë" e përgatit traktin për shqiptarët e mërguar „ekonomik".

Hapi i ardhshëm do të jetë përgatitja e materialeve sa më të bollshme për informimin e opinionit, të qeverive evropiane dhe të Kombeve të Bashkuara lidhur me gjendjen në Kosovë. (Më vonë, suksesivisht, do të t'i dërgoj kopjet e materialeve të shkruara për këtë qëllim.)

Kam pasur nderin të njihem edhe me sekretarin e parë të Partisë Komuniste Gjermane, njëkohësisht edhe kryetar i Shoqatës së Miqësisë Gjermani-Shqipëri dhe i kam dërguar një letër me lutjen që edhe ai me partinë e tij të shikojë ndonjë formë të përshtatshme ndihme për përkrahjen morale të popullit shqiptar të Kosovës. Ende s'kam marrë përgjigje prej tij, por shpresoj se megjithatë do të na ndihmojnë patjetër, sepse për këtë i obligon drejtpërdrejt edhe artikulli i „Zërit të popullit" i datës 8 prill, se siç dihet, kjo parti e komunistëve gjermanë ka për busollë të vetme PPSH-në.

Sa për situatën në Kosovë, megjithë krimet e pashembullta fashiste që ushtron armiku ynë mizor e që prekin thellë në zemër çdo shqiptar dhe jo vetëm shqiptarët, unë jam shumë optimist. Arsyet i mendoj kësisoji: 1) Doli sheshazi mospajtimi i shqiptarëve me armikun e egër, qeverinë shoviniste të Beogradit; bota, që sot po e bën veshin shurdh e syrin qorr për çështjen shqiptare, në mos sot, nesër do të detyrohet patjetër të ballafaqohet në mënyrën më serioze për këtë çështje, deri në fitoren tonë përfundimtare. 2) Popullsia e Kosovës, e ballafaquar me tanket, aeroplanët, helikopterët e me gjithë pancirin tjetër të ushtrisë dhe policisë serbe, nuk u frikësua dot, po qëndroi pa iu trembur syri; kjo popullsi tregoi se është e zoja të çohet në kryengritje dhe ta bëjë edhe luftën përfundimtare për çlirimin nga armiku mizor dhe bashkimin me vendin amë. 3) Vetë armiku, që kohë më parë e dinim edhe për politikan të regjur, me këtë intervenim ushtarak e policor mbi

shqiptarët bëri pa dyshim gabimin më të madh në historinë e vet shtetërore-politike; ky gabim do t'i kushtojë shtrenjtë, sepse gjithë situata, edhe në mos vazhdoftë menjëherë lufta definitive për bashkim me Shqipërinë tonë, pra gjithë situata do të ndjekë në të ardhmen e afërme atë drejtim, i cili do ta sjellë shqiptarin në potez për të zgjedhur se ç'dëshiron brenda kuadrit të Jugosllavisë, madje duke na lejuar të bëhemi edhe mjaft nazeqarë…

Ja, pra, këto ishin disa nga punët dhe mendimet e mia në këtë situatë të vështirë.

Tani, me shpresë se edhe për mua personalisht, në saje të mirëkuptimit të shokëve, do të ketë ndonjë ditë më të bardhë, po e përfundoj këtë letër dhe po të përcjell të fala shqiptare e revolucionare.

Sokoli

POPULLI YNË ËSHTË I PAMPOSHTUR DHE DO TË FITOJË!

(Botuar për herë të parë në librin e Faridin Tafallarit, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 256-261)

13. Letër për Sabri Novosellën, 13 maj 1981

13 maj 1981, RFGJ

I dashur vëlla, Mërgim!

Diku thellë në ndërgjegje e dija se do të ma falje gabimin më të madh në jetën time. Kjo shpirtbardhësi e zemërgjerësi jotja mua më shpëtoi me fytyrë. Prandaj, do të të jem mirënjohës për tërë jetën. Dhe kurrë nuk do të harroj se kjo gjë, në vend që ta zvogëlojë, do do ta rritë edhe më shumë gabimin tim të pafalshëm. Por, meqë ti u bërë burrë dhe meqë situata në Atdheun tonë e do që të punojmë me një vrull të madh, atëherë çështjen time, siç ke propozuar edhe vetë, e lëmë për ta shqyrtuar hollësisht kur të na paraqitet rasti, kurse tash po u jepemi punëve me gjithë fuqinë që kemi.

Letrat e tua dhe materialet e shkruara i mora me kohë. Por, i lejova vetes të ta vonoja pak përgjigjen, për arsye se isha i zënë me disa punë të nisura, shumë të ngutshme. Me një shok të „Lirisë" organizuam në Zvicër dhe në Gjermani katër demonstrata të punëtorëve kosovarë në botën e jashtme, dhe jemi në prag të organizimit të demonstratës së pestë. Duheshin shkrime, trakte dhe fjalime, pastaj duhej një vrap i madh për tubimin e njerëzve. Demonstrata e parë u mbajt më 11 prill në Bernë të Zvicrës, e dyta më 18 prill në Cyrih të Zvicrës, kurse treta dhe e katërta në Shtutgart e Dyseldorf të RF Gjermane, më 25 prill, përkatësisht më 9 maj. Në demonstrata u hodhën po ato parulla që ishin hedhur në demonstratat në Kosovë. Para ambasadave u mbajtën kudo mitingje protestuese, me fjalime të rëndësishme, që demaskonin qëllimet dhe veprimet fashiste të jugosllavëve dhe tregonin qëllimin e vërtetë të kryengritjes në Kosovë si dhe shkaqet e saj të vërteta. Thuaja në të gjitha demonstratat e organizuara ishin bashkë me ne edhe komunistët dhe demokratët gjermanë dhe shumë komunistë nga radhët e punëtorëve turq, qoftë fizikisht, qoftë me trakte e fjalime në të cilat paraqitej gjendja reale në Kosovë dhe dënohej rëndë veprimi fashist i policisë dhe i ushtrisë jugosllave mbi popullsinë e pafajshme dhe duarthatë të Kosovës. Demonstrata e ardhshme do të bëhet në Mynih të RF Gjermane, të shtunën, më 16 maj.

Në të gjitha demonstratat ka dominuar rendi dhe disiplina e shkallës më të lartë si dhe shprehja e indinjatës më të thellë të punëtorëve tanë e të qytetarëve të këtushëm për ato që po ndodhin në Kosovë. Vetëm në Shtutgart ndodhi një incident, por, edhe ky në fitoren tonë: njerëz të Konsulatës jugosllave fotografonin dhe xhironin demonstrantët, me qëllim

që t'i frikësojnë për pjesëmarrjen e tyre në demonstratë. Disa punëtorë nga radhët e demonstrantëve u ndanë me një rast dhe hynë në një shkollë jugosllave, nga na xhironin me kamerë filmike. Ua morën filmin dhe e rrahën xhiruesin, i cili s'donte ta jepte atë në asnjë mënyrë. Aktorët e kësaj përleshjeje jo vetëm që dolën faqebardhë, pa gërvishjen më të vogël, por edhe policia gjermane i mbajti vetëm dy orë dhe i lëshoi nga burgu, kurse shtypi gjerman, sipas deklaratës së vet policisë së Shtutgartit, fajtor për incidentin i cilësoi jugosllavët dhe jo demonstrantët tanë.

Një hap tjetër revolucionar që u bë këto ditë në Gjermani, qe pushtimi nga punëtorët tanë i dy klubeve kosovare, të cilat deri më tash ishin bërë çerdhe spiunazhi e propagande të njerëzve të konsullatave jugosllave. Punëtorët revolucionarë i morën në dorë ato klube, hoqën flamurin jugosllav dhe fotografitë e xhelatit Tito, ndoqën së andejmi njerëzit e konsullatave, përderisa ngjarjet në Kosovë të vazhdojnë të trajtohen kështu nga ana e qeverisë jugosllave. Klubet e pushtuara ndodhen në Dyseldorf dhe në Bilefeld. Policia gjermane jo vetëm që nuk ka ndërmarrë asgjë lidhur me këtë aksion, por e konsideron edhe shumë të drejtë, meqë sipas statusit të tyre, klubet duhej edhe më parë të ishin të pavarura nga ndikimi i konsullatave. Tani kemi shpresë se ky shembull do të ndiqet në të gjitha ato qendra ku kanë ekzistuar deri me tsh klube që veç emrin e kanë pasur kosovar. Dhe kjo gjë ka rëndësi mjaft të madhe.

Vëlla, Mërgim! Kohë më parë, unë i kisha nisur një letër njërit nga anëtarët e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Gjermane, të cilin e kam njohur personalisht. Iu drejtova me

kërkesën që ta përdorë autoritetin e Partisë së tij dhe të na dalë në ndihmë në një mënyrë apo në një tjetër. Ato ditë Radio Tirana transmetoi edhe artikullin e parë të „Zërit të popullit" lidhur me ngjarjet në Kosovë, kështu që komunistët e këtushëm morën qëndrim zyrtar që të solidarizohen me Kosovën dhe ta ndihmojnë luftën e popullit tonë me të gjitha mjetet që kanë në dorë. Në fillim të fillimit ata botuan gjermanisht në organin e tyre „Roter Morgen" artikullin e „Zërit të popullit" dhe neve na nxorën lejet zyrtare te policia gjermane për mbajtjen e demonstratave. Po kështu, me luftën tonë janë solidarizuar edhe komunistët zvicëranë dhe ata turq në botën e jashtme.

Tani, në bashkëpunim me komunistët gjermanë e zvicëranë, unë dhe një shok i „Lirisë" jemi duke punuar në formimin e disa komiteteve për Kosovën. Këto komitete do të përbëhen prej autoritetesh të njohura gjermane e zvicërane, si politikanë, shkrimtarë e artistë të njohur demokratë. Konkretisht, në komitetin që do të formohet në Gjermaninë Federale, kemi rënë dakord që nga pala shqiptare të hy unë, kurse në atë në Zvicër, një shoku i „Lirisë". Komitet kanë për qëllim ta sheshojnë të vërtetën mbi Kosovën dhe të organizojnë ndihma të ndryshme për popullin tonë të shumëvuajtur. Komitetet do të bëjnë demarshe pranë qeverive dhe ndoshta edhe pranë Kombeve të Bashkuara, si dhe do të përpiqen të ndikojnë sa më shumë në shtypin evropian e botëror, duke e ushqyer këtë shtyp me të dhëna faktografike mbi Kosovë, në mënyrë që demagogjia jugosllave të demaskohet në përmasa të gjera. Po kështu, komitetet do të hapin edhe xhiro-llogaritë për ndihma materiale dhe do të caktojnë qendra me adresa ku të arrijnë të dhëna konkrete lidhur me numrin e të vrarëve, të plagosurve dhe të të burgosurve në ngjarjet e fundit në Kosovë. (Prandaj, është mirë që qysh tash tani, shokët të mbledhin sa më shumë informata dhe, kur të formohen komitetet, t'i ushqejmë ato me të vërteta në shkallë sa më të gjerë.)

Tani, vëlla Mërgim, lejomë t'u përgjigjem disave nga pyetjet që shtron ti në letër.

„Lajmëtarin e lirisë", siç të pata shkruar edhe më parë, e kam nxjerrë kryekëput vet, bile, 80 për qind të shpenzimeve rreth botimit të tij i kam paguar vetë nga të ardhurat e mia dhe të vëllaut. Duke qenë puna kështu, është e natyrshme që niveli të mos ketë qenë në nivel dhe të jetë përvjedhur edhe ndonjë gabim. (Aq më parë, kur për shkrime kam qenë i angazhuar edhe në gazetën „Bashkimi".)

Gjëja më e rëndësishme lidhur me „Lajmëtarin“ është se, duke qenë krejt i vetmuar, nuk e mora dot guximin ta emëroja atë si organ të LNÇKVSH. Kjo është e vetmja arsye pse në të nuk flitet e brohoritet në emër të Lëvizjes sonë.. Mjafton ta përmend faktin se dy materialet e Lëvizjes, që i botova në numrin 3, i lëshova me njëqind druajtje, ngase nuk isha në gjendje të gjykoja vetë dhe të fitoj bindjen e plotë se a bëja mirë apo keq.

Tirazhi i „Lajmëtarit“ ka qenë i vogël, nga 600 kopje. Por, kaq ka pasur aftësi të shpërndajë rrjeti i krahut të ri të Lëvizjes, që u formua në Kosovë pas ardhjes sime këtu. Por me rëndësi është fakti se atë e ka shpërndarë pikërisht ai krah.

Unë, që në fillim, e kam pas ditur se organ i Lëvizjes është „Zëri i Kosovës“, se kjo shihet nga vetë Statuti. Dhe, me kënaqësinë më të madhe, në vend që të dilte „Lajmëtari i lirisë“, kam mundur të bëja që të dilte „Zëri i Kosovës“. Nuk e bëra për dy arsye. Së pari nuk isha i autorizuar nga Lëvizja. Së dyti, këtu kishte vepruar qysh më herët një i ashtuquajtur Grupi Komunist „Zëri i Kosovës“, për punën e errët të të cilit me ndonjë rast tjetër mund të bëj para Lëvizjes ndonjë raport të gjerë. Tash për tash po theksoj se udhëheqësi i këtij grupi (Rizah Salihu, nga Mushtishti, një provokator ose njeri shumë naiv dhe i rrezikshëm), provoi të organizonte me shokë likuidimin tim dhe të vëllaut tim, duke na quajtur „të dërguar specialë të UDB-së“, pikërisht për arsyen se i pata thënë që „Zëri i Kosovës“ është organ i LNÇKVSH, kurse ai e kishte marrë për emër të grupit të vet. Po për këtë arsye, para se t'i hyjmë botimit të këtij organi, duhet të marr nga Ti dhe Lëvizja edhe fjalën e fundit, sepse ka mundësi që titulli „Zëri i Kosovës“ si organ i LNÇ, të përzihet në mendjen e naivëve me Grupin Komunist „Zëri i Kosovës“.

Më ke pyetur si qëndrojmë me çështjen financiare lidhur me nxjerrjen e gazetës. Numri i parë, i cili është radhitur dhe shtypur krejtësisht në një shtypshkronjë, e që është e natyrshme se ka dalë teknikisht më së miri, ka kushtuar 2540 mark. Ky ishte një çmim shumë i lartë sa të mund ta përballoja, madje edhe me pjesëmarrjen modeste të disa njerëzve që u treguan të gatshëm të ndihmojnë (pa ditur për çka është fjala). Prandaj, bashkë me vëllaun, vendosëm ta marrim me kredi një makinë shkrimi të përshtatshme (është kjo me të cilën po ta shkruaj letrën dhe me të cilën janë radhitur dy numrat e fundit të „Lajmëtarit të lirisë“). Makina kushtonte relativisht pak (5080 mark) dhe, me disa funksione elektronike që kryente, jepte mundësi të nxirrej disi revista, sado që mua më ngarkonte shumë, sepse, pos që i shkruaja të gjithë artikujt, më duhej edhe t'i radhitja e t'i përgatisja teknikisht të gjitha faqet. Por, shpenzimet që mbeteshin për t'iu paguar shtypshkronjës në procesin e mëtejshëm të shtypjes e të shumëzimit të revistës, ishin shumë të vogla, vetëm 600 mark.

Por, kur është fjala për botimin e „Zërit të Kosovës“, mendoj se del edhe një problem. Sipas të gjitha gjasave, tashmë është identifikuar se kush qëndron prapa „lajmëtarit“ dhe kështu edhe mënyra se si radhitet ai. Pra, kjo makinë shkrimi, sipas mendjes sime, nuk do të duhej të përdorej dhe në radhitjen e „Zërit të Kosovës“. Kurse radhitja në shtypshkronjë kushton shtrenjtë, siç u pa. Mbesin dy mundësi: ose të shitet kjo makinë (po tash me çmim shumë më të ulët, se kështu ngjan këtu) dhe të blehet një lloj tjetër makine, duke shtuar edhe para të tjera, ose të merret kohë pas kohe me qira ndonjë makinë tjetër për radhitjen e gazetës. Se sa do të shpenzoheshin me variantin e parë dhe sa me të dytin, të informoj këto ditë me telefon, por e di se, për një punë më të rregullt në nxjerrjen e gazetës, do të duhej një ndihmë bukur e madhe financiare. Dhe unë nuk e di se sa keni mundësi, Ti me shokët, të ndihmoni së andejmi. Për shembull, një makinë për radhitje, me të gjitha llojet e germave ë përdoren në gazeta e libra e që prandaj s'ka si të identifikohet, e re kushton mbi 20 mijë mark, po e përdorur ka mundësi të gjendet edhe me 10 mijë. E këto janë para të mëdha. Ndryshe, po të zgjidhet çështja e makinës, shpenzimet e shumëzimit të revistës do t'i përballoja vetë, me disa shokë këtu, pa kurrfarë problemi. Këtu kam një propozim. Ai shoku në Munhen, përmes të cilit e mora lidhjen

me Ty, Shabani, është një milioner. Nëse shokët që ke ti atje kanë ndikim në të, atëherë ai do të mund të na ndihmonte në blerjen e një makine të tillë, bile nuk do t'i ndiente shpenzimet. Por, kjo është çështje që duhet ta vendosni ju.

Sido që të jetë, para se t'ia nis punës në nxjerrjen e „Zërit të Kosovës", duhet të dija se deri në çfarë shkalle mund të më ndihmoni së andejmi materialisht.

Kur është fjala për materialet që mora, përveç atyre me tituj „Në Kosovë dy njerëz u ngjallën" dhe „Adem Demaçi-Demaçi, simbol i rezistencës shqiptare", mendoj se të tjerët nuk kanë elemente të mjaftuara për një revistë çfarë e mendoj unë „Zërin e Kosovës". Në ta gjenden të meta ideopolitike dhe janë shkruar jo në nivel. Përveç kësaj, sidomos tash na duhen materiale me elementin e aktualitetit kosovar. Mendoj se në revistë duhet t'u përgjigjemi një për një sulmeve jugosllave dhe demagogjisë së vrullshme titiste. Dhe për këtë kemi se ku kapemi. Dhe, një pjesë të mirë të përgjigjeve të tilla, që do të bënin një punë sqaruese si për popullsinë tonë, ashtu edhe për të tjerët, e marr përsipër ta shkruaj unë vetë po të autorizohem për këtë nga Lëvizja. Një gjë është fare e sigurt: tash e tutje, i forcuar moralisht, nuk do të kursehem për punë ditë as natë dhe besoj se puna nuk do të mbetet pa rezultate.

Po dalim te një çështje tjetër me rëndësi. Kur është fjala te bashkimi i organizatave revolucionare patriotike që veprojnë në Kosovë, unë pata bërë një propozim konkret, po druaj se nuk jemi marrë vesh si duhet. Është i ashtuquajturi Grupi Komunist „Zëri i Kosovës" një grup që predikon krijimin e një Kosove „të lirë" dhe jo bashkimin me vendin amë. Me këtë grup as kam marrëdhënie, as do të doja të kem, sepse, edhe nëse ekziston akoma (se pjesa më e madhe e anëtarëve të tij në atdhe janë të burgosur, për shkak të mënyrës së organizimit shumë të gabuar e të rrezikshëm: me lista konkrete, ku anëtarët shënojnë elementet e tyre biografike, bëjnë me shkrim betimin dhe e firmojnë me dorën e vet; kështu listat komplete të anëtarëve kanë rënë në dorë të UDB-së dhe ata janë burgosur masivisht e pa mundime nga ana e policisë), pra, edhe nëse grupi ekziston akoma, ai punon keq e fëlliqtë. I tillë nuk është as në shkrime as në pikëpamje të organizimit grupi i Marksistë-leninistëve të Kosovës, të bashkuar rreth organit të tyre „Liria". Përkundrazi, ata, jo vetëm që luftojnë si ne për bashkim të domosdoshëm me vendin amë, por, sa kam mundur të konkludoj nga kontaktet e mia me njeriun e tyre, janë edhe shumë të pjekur dhe organizatorë të zotët. Më vonë do të marrim vesh se ata, me sa duket, kanë qenë ndër organizatorët kryesorë të ngjarjeve të fundit në Kosovë, jo fillimisht, por duke intervenuar pas ngjarjeve të 11 marsit. Por, kjo gjë duhet të studiohet edhe më tej me seriozitetin më të madh dhe, po u pa e arsyeshme, edhe të merret kontakti me ta e të vazhdohet puna e përbashkët.

Sa për organizatën e bashkuar rreth organit „Bashkimi", më duket se pak dobi mund të kemi nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. Së paku për sa shihet te udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, nuk ekziston përshtypja për organizim të mirëfilltë dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t'u jepet lidhja me përfaqësuesin e „Bashkimit" në Kosovë. Megjithqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë, njëfarë Blakaj (Islam Blakaj-shën. i red.), që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë një herë për një herë, pas numrit të fundit të „Bashkimit", të cilin ta kam dërguar, të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë. Kështilla për ndërprerjen e marrëdhënieve me të kam pasur edhe nga ana e diplomatëve shqiptarë në Vjenë.

Në fund, po të njoftoj se, si unë me familje, ashtu edhe vëllau që është këtu edhe ai me familje, jemi që të gjithë mirë. Deri më tash edhe Luani ka qenë mirë në burg, si dhe familja e tij në fshat. Si janë punët tash, nuk dimë gjë prej shumë kohësh.

U bëra helm që vëllaun ta paskan mbyllur prapë. Por, ju jeni mësuar, e edhe ne po mësohemi pak nga pak me këto gjëra. Armiku ynë tash u tërbua fare dhe e ka ndër mend të vazhdojë gjithnjë e më egër. Por, jam më se i bindur se kjo vërtet do të na dëmtojë neve në një shkallë të gjerë, por atë do ta dëmtojë shumë më tepër, atë do ta shkatërrojë plotësisht.

Të fala vëllazërore, Sokoli me familje!

POSHTË TITIZMI GJAKATAR!
RROFTË POPULLI SHQIPTAR I LIRË E I BASHKUAR!

(Botuar për herë të parë në librin e Faridin Tafallarit, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 261-266)

(Një pjesë e kësaj letre është botuar në librin *Dhimbje Krenare*, Tiranë 1998, faqe 115-116)

14. Letër për Faridin Tafallarin, verë 1981

I dashur shok Faredin!

Më fal që materialin e premtuar po jua dërgoj me vonesë. Por ashtu u bënë punët.

Besoj se tani do ta merrni e ta shqyrtoni, bashkë me D.... Dhe pasi ta keni analizuar, të më përgjigjeni për sa qemë marrë vesh atë natë në mes vete. Ato që do t'i keni të paqarta, shënojini si dhe fjalët e pakuptueshme, e pastaj do t'i sqarojmë së bashku.

Mirë u pafshim në takimin e
ardhshëm
" Lajmëtari..."

(Kjo letër, dërguar Faridin Tafallarit nga Jusufi, në verë të vitit 1981, është botuar për herë të parë në librin e Faridin Tafallarit " Dhimbje Krenare", Tiranë 1998, faqe 239)

15. Letër për Faridin Tafallarin, verë 1981

I dashur shok, Dini*!

Ja dhe materialet që të premtova se do të t'i çoj. Në të parin " Armiku na ka në dorë vetëm aq sa e lejojmë ne vetë", janë udhëzimet për disa çështje revolucionare në kushtet e punës ilegale. Ndërkaq, në materialin me titull " Si do të na përgjigjet armiku në pyetjet që do të shtrojmë ne, revolucionarët" , bën fjalë për rëndësinë e njërës nga fushëbetejat kryesore të organizatës revolucionare, pra për rëndësinë e shtypit revolucionar.

Materialet e tilla siç thamë edhe mbrëmë, nuk bën vetëm të lexohen si artikuj gazete a si roman. Ato duhet të përvetësohen, në mos në tërësi, atëhere së paku pikat kryesore duhet të zotërohen patjetër.

Ndoshta, në bisedën që bëmë mbrëmë, unë isha pak tepër këmbëngulës dhe energjik. Por, kam shpresë të madhe se, sa më parë t'i kapemi kësaj rruge të organizimit, aq më shumë efekte do të arrijmë në drejtimin në të cilin jemi të gatshëm të luftojmë pa kursyer asgjë.

Po e përsërisim edhe një herë mënyrën se si duhet të lidhen anëtarët e celulës. Ti si anëtar celule ke të drejtë dhe detyrë të krijosh dy hallka – A dhe B. Hallka A dhe B të njohin ty, por jo edhe njëra tjetrën. Po kështu, pasi të jenë futur në celulë këto dy hallka dhe pasi të kenë dhënë ndonjë shenjë të sigurt se janë të pjekura për punë revolucionare në kushtet e caktuara prej nesh, secila prej tyre do të ketë të njëjta të drejta dhe detyra. U morrëm vesh edhe lidhur me atë se çfarë kushtesh kërkohen për angazhimin e një shoku etj. (Për çdo gjë të paqartë, drejtomu me letër ose bëjmë takim, sepse nuk duhet të ecim me gjëra të pasigurta në asnjë mënyrë.)

Kur të kesh zgjidhur hallkat tuaja, kujdesu që njëri shok yti të jetë patjetër në vendlindje. Sepse, ne bëjmë pak, në qoftë se mbështetemi vetëm në shokët tanë që punojnë në botën e jashtme. Me rëndësi është që organizimi të marrë hov në vendlindje. Natyrisht, çështjen e takimeve me shokët e angazhuar në vendlindje, do ta shqyrtojmë bashkarisht dhe në hollësi. Përgjithësisht, edhe po të na duken gjëra të vështira disa hollësi që imponohen në shikim të parë, s'ka nevojë të bëhemi merak. Kjo mënyrë e organizimit është studjuar hollësisht dhe ne do ta zotërojmë dalëngadalë po me siguri. Mjafton që të kemi vullnet dhe të angazhohemi seriozisht

Më shkruaj, pra, për gjithçka. Unë do të të përgjigjem me kënaqësi.

VDEKJE TITIZMIT, LIRI POPULLIT SHQIPTAR

"Lajmëtari**..."

*) Shkurtimi i emrit Faridin, shënim i Faridin Tafallarit
**) Pseud. i J. Gërvallës, shënim i F.T.

(Kjo letër, dërguar Faridin Tafallarit nga Jusufi, në verë të vitit 1981, është botuar për herë të parë në librin e Faridin Tafallarit, "Terror, Dhimbje, Qëndresë", Tiranë 1997, faqe 401)

16. Letër për Faridin Tafallarin, verë 1981

I dashuri shoku Faredin!

Me pak vonesë po t'i dërgoi thirrjet për demonstrata, që do të mbahen këtë të shtunë në Dyzeldorf në ora 10,30 para stacionit hekurudhor. Njoftoi shokët aty përreth, por kishte me qenë mirë, sikur do të mundeshe t'i njoftosh edhe do shokë nga Tubingeni.

Sa i përket udhëtimit me autobusa, duhet të dihet përafërsisht numri i udhëtarëve dhe më lajmëro menjëherë, në mënyrë që kjo gjë të organizohet me kohë.

Në qoftë se të kanë ardhur edhe thirrje tjera nga "larg", kjo gjë mos të habit, dhe përmbaju këtyre thirrjeve këtu.

Sa i përket gjendjes në Kosovë, kemi informata se atje populli është i pamposhtur, dhe se lufta po vazhdon. Shokët na bëjnë me dije se demonstratat që po organizohen në botën e jashtme i kanë dhënë popullit shqiptar në " Kosovë" një frymëzim dhe një hov të madh...

Prandaj kjo gjë edhe neve na frymëzon edhe më tepër edhe na forcon vullnetin tonë, që të marrim pjesë sa më shumë në këto demonstrata.

Të fala vëllazërore nga Semani*

FITORJA ESHTE E JONA !

*) Pseud. i J. Gërvallës, shënim i Faridin Tafallarit
(Kjo letër, dërguar Faridin Tafallarit nga Jusufi, në verë të vitit 1981, është botuar për herë të parë në librin e Faridin Tafallarit, " Terror, Dhimbje, Qëndresë", Tiranë 1997, faqe 402)

17. Letër Sabri Novosellës, 16 qershor 1981

Untergrupenbach, RFGJ
16 qershor 1981

I dashur vëlla Mërgim!

Po të vë në dijeni se vonesa e letrave nga ana ime nuk është, as çështje harrese e as çështje e neglizhencës. Po prirem nga dëshira që kur të Të shkruaj, të kem së paku diçka të rëndësishme për të të thënë.

Përmes shtypit jugosllav ke mundur të informohesh për një demonstratë të fuqishme të punëtorëve tanë në Gjenevë, në të cilën qenë mbledhur më 30 maj më se 1000 punëtorë nga Zvicra e Gjermania dhe, të penguar për t'iu afruar ambasadës jugosllave, shkuan dhe demonstruan para selisë së Kombeve të Bashkuara. Kjo demonstratë i tërboi jugosllavët, të cilët këmbyen edhe replika bukur të ashpra të nivelit shtetëror me organet zvicërane, që kishin dhënë leje për mbajtjen e demonstratës. Pastaj, kur panë se s'ka gjë prej asaj pune, u kthyen në të shara e britma të egra kundër demonstrantëve gjoja se këta ishin gjysma ekstremistë (lexo: komunistë) dhe gjysma tjetër, ata të ardhur nga RFGJ, fashistë etj. Por, sido që të jetë, gjithë atë që kanë thënë deri më sot jugosllavët lidhur me demonstratat e punëtorëve kosovarë në mërgim, s'janë gjë tjetër pos klithma e përçarje të të dëshpëruarve.

Një demonstratë tjetër e rëndësishme u mbajt në 13 qershor në Bruksel të Belgjikës. E rëndësishme për këto arsye: e para, pas demonstratës në Gjenevë, jugosllavët kishin mundësi të ndërmerrnin ndonjë masë konkrete qoftë duke intervenuar te organet e Belgjikës, qoftë duke organizuar vetë ndonjë antidemonstratë, siç ishin kërcënuar më parë përmes Radio Beogradit (por s'e bënë dot njërën as tjetrën); e dyta, në Bruksel është çerdhja e emigracionit reaksionar shqiptar, i cili u përpoq, gjatë tërë kohës sa bëheshin përgatitjet për demonstratën, të ushtronte presione e shantazhe, duke kërkuar të merrnin edhe vetë pjesë në manifestimin tonë. Megjithatë, të gjitha u shkuan kot dhe demonstrata u zhvillua si është më mirë dhe në rrugën më të mbarë, edhe e treta, më e rëndësishmja, kjo demonstratë ndihmoi në bashkimin e mërgimtarëve të dyfishtë kosovarë, të ardhur këtu së fundi nga Turqia, të cilët më parë jetonin keq në kërcënime e shantazhe nga emigracioni i vjetër i Shqipërisë dhe me presione, që këta shqiptarë të ndershëm e patriotë të rreshtoheshin në radhët e armiqve të Shqipërisë socialiste. Jemi të bindur se të tria këto qëllime demonstrata i realizoi në një shkallë të caktuar.

Teksti për traktin më pëlqeu dhe e përshkrova e po ta dërgoj. Tjetër herë për trakte të tilla më trego a është më mirë t'i shumëzoj unë këtu, sepse i fotokopjojmë mirë dhe kushton relativisht pak, apo të duket më mirë t'i fotokopjosh atje. Kësaj radhe po i shumëzoj këtu. Nëse të duken pak kopje, trego sa kërkohen dhe i bëjmë kopjet e tjera dhe sipas nevojës i shumëzojmë edhe traktet e ardhshme.

Me shokun Sh. në Mynih nuk kemi biseduar gojarisht, po vetëm në telefon. Ai tha se do të më përgjigjet brenda një kohe të shkurtër, por ende nuk është përgjigjur. Ndërkaq te shoku I. në Visloh ishim. Na priti mirë. Por kohën e bisedës e kishim të kufizuar, se i erdhën mysafirë të tjerë. Paske marrë vesh për një bisedë të nxehtë, që u zhvillua në banesën e tij me atë rast me disa kopukë projugosllavë. E di që nuk kam bërë aq mirë që kam folur, por, unë e pata paralajmëruar shokun I. të mos më ndalte, sepse nuk mund të durohen kur fliten muhalife.. Pos kësaj, ja lëshova frenin vetes pak më shlirshëm, duke ditur se shoku I. nuk është aspak i varur nga Jugosllavia. Përveç kësaj, unë mendoj se kjo gjë duhet të ketë pasur një efekt të mirë te shoku I. Ai e pati rastin të njihet me disa pikëpamje dhe me shkallën time të informimit; lidhur me realitetin kosovar.

Po të bëj me dije se këto ditë arriti prej tij edhe shuma e të hollave që kërkoheshin prej tij.

Ke bërë shumë mirë që më dërgove emrat e të burgosurve, ata të veteranëve të luftës sonë. Do t'ua bëjmë vendin në ndonjë material adekuat. Skënder Blakaj, për të cilin shtypi shkruan se e kanë larguar nga puna, është në burg që nga data 12 maj. Kjo duhet të na japë të kuptojmë se në mos të gjithë, atëhere shumica e atyre për të cilët flitet se janë larguar nga puna, në realitet janë të burgosur.

Tani më lejo të dalim te një nga çështjet më të rëndësishme për momentin aktual, pra, te çështja e bashkimit të vërtetë të të gjitha forcave të mbara revolucionare. Unë, kohën e fundit, me qëllim të mirë, i kam dhënë vetes të drejtë të të dekonspiroj ty tek një person, te ai shoku* i "Lirisë", me të cilin kemi bashkëpunuar qe disa kohë. Ai, duke nxjerrë konkludime nga puna e Organizatës së tij dhe nga ajo e LNÇK, sidomos nga organi ynë "Zëri i Kosovës", ka ardhur në këtë përfundim: sipas të gjitha gjasëve, edhe LNÇKVSH edhe Marksistë-leninistët e Kosovës janë dy degë të të njëjtit trung. Një patriot revolucionar, i cili prej kohësh qenka në burg (ai thotë se nuk është fjala për Ademin, por për dikë tjetër), qenka përgjegjës për ndërprerjen e kontakteve mes anëtarëve të vjetër të organizatës së hershme me anëtarët e krahut të ri të kësaj organizate. Kështu që, pjesa e vjetër e asaj organizate (të përbashkët) ka ndjekur një rrugë të caktuar dhe sot ka arritur deri te emri Marksistë-leninistët e Kosovës, kurse krahu i ri, duke mos marrë kontakt me kohë me anëtarët e vjetër, qenka zhvilluar në Lëvizjen e sotme Nacionalçlirimtare të Kosovës. Për këto konkludime ai merr për bazë pikërisht organin "Zëri i Kosovës", të cilin Marksistë-leninistët e paskan pasur gjithashtu organ të vetin për një kohë të gjatë (sidomos që nga viti 1974, thotë ai, paskan dalë disa numra të këtij organi). Në rast të tillë, sipas mendimit të tij, bashkimi i organizatave tona jo vetëm që nuk është i vështirë, por është puna më e natyrshme. Lidhur me këtë, ai ka një propozim konkret, të cilin ia kam aprovuar edhe unë, nëse pranon ti: të vijmë së bashku ai e unë te ti dhe ta ndriçojmë po qe e mundur këtë çështje. Fitimi, besoj, do të kish qenë i madh. Ai* është një shok i mirë dhe mjaft i pjekur. Por, në qoftë se ti ngul këmbë që nuk duhet t'i hymë fare kësaj pune, atëhere ashtu edhe do të bëhet.

Edhe një çështje tjetër me shumë rëndësi. Po ky shoku* i "Lirisë", i cili lidhjet me shokët në Kosovë i mban rregullisht, tash së fundi na njofton sesi nga Kosova i paska ardhur porosia që tash e tutje të mos ngulim më këmbë në kërkesën për përfshirjen e tokave shqiptare në Maqedoni e Mal të Zi brenda republikës së Kosovës, por të kufizohemi vetëm me statusin e republikës për territorin e sotëm të Krahinës Autonome të Kosovës, sepse gjoja, po të paraqitet kështu çështja, paska njëfarë mangësie për realizimin e kësaj kërkese. Ai* shton se gjoja sugjerime të tilla u paskan arritur nga instanca të rëndësishme të atdheut. Unë paraqita kundërshtimin tim kategorik. Në mos qentë tradhti e hapët, një lëshim i tillë, thashë unë, atëhere është një politikë e ligë konjukturale, të cilën vështirë se do të na e falte populli i pezmatuar, sidomos shqiptarët e viseve jashtë Krahinës, që janë në rrezik edhe nga asimilimi i madh.

Tani prej teje pres përgjigje të prerë për sa vijon:

1) A e aprovon ardhjen time bashkë me atë shokun*, lidhur me sqarimin e çështjes së përmendur, apo se lejon.

2) Pas "pështjellimeve" rreth titullit të organit "Zëri i Kosovës", a të duket e udhës që organit tonë të ardhshëm t'i vëmë një titull tjetër? Unë mendoj se titulli duhet ndërruar.

3) A duhet të pranojmë edhe ne, sikundër ata të "Lirisë", solucionin e republikës vetëm për territorin e sotëm të Krahinës së Kosovës?

4) A mendon se duhet edhe më tutje, pas këtyre njoftimeve, ta vazhdoj bashkëpunimin me shokun* në fjalë, apo të punoj vetëm, duke iu kushtuar kryekëput punëve të LNÇKVSH dhe të organit të saj të ardhshëm?

Të lutem t'i analizoni hollësisht këto çështje me shokë dhe të më përgjigjeni sa më parë që të jetë e mundshme.

Të fala vëllazërore Sokoli

*) Kadri Zeka, shënim i Faridin Tafallarit
(Botuar për herë të parë në librin e Faridin Tafallarit, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 269-271).

18. Letër për Sabri Novosellën, 21 korrik 1981

Untregr. RFGJ,
21 korrik 1981

I dashur vëlla, Mërgim!

Qortimet e tua janë me vend. I entusiazmuar nga pritja e takimit tonë dhe (eventualisht) e bashkimit të dy forcave të rëndësishme revolucionare të Kosovës, unë rashë në një pasivitet të palejueshëm dhe lashë pas dore shumë punë. Letra jote e fundit më zgjoi nga kjo „kllapi" dhe të jesh i bindur se që tani do të përpiqem t'i çoj në vend si duhet e me kohë të gjitha porositë dhe t'i kryej me kohë ato që kërkohen prej meje.

Më lejo tani të informoj për disa çështje tash për tash të rëndësishme.

Lidhur me takimin tonë doli një pengesë tash për tash e pakapërcyeshme: ambasada turke nuk më jep kurrsesi vizë hyrjeje në Turqi. Me gjasë nuk i japin as atij shokut tjetër, se edhe ai e ka punën si unë. Ne do të provojmë ndonjë lloj intervenimi, por sa duket është e kotë. Prandaj, nga ju andej presim ndonjë propozim se si dhe përmes kujt të organizohet ndonjë kontakt, që do të shpiente kah bashkimi.

Shoku Shpend ka ardhur dhe është vendosur te ne. Sot kanë dalë me B. për të kërkuar punë. Jam i kënaqur nga takimi me të.

Shokut A. Mërturi i kam dërguar letër, por ende nuk është përgjigjur. A është rregulluar puna si do të dijë ai se ku të drejtohet kur të vijë?

Deklarata e KQ dedikuar shtypit të Perëndimit është shtypur shqip, gjermanisht e serbokroatisht. Të parët që e kanë botuar në organet e tyre janë kroatët e mërguar. Kështu ka ndodhur një e pa mirë që nuk e parashikonim. Por, shpresojmë se do ta publikojnë edhe të tjerë.

Shumë keq që nuk të kanë arritur traktet e dërguara. Ne kemi intervenuar në postë, po përgjigje nuk kemi marrë. Tani ku dihet në dorë të kujt kanë rënë? Unë po të dërgoj një kopje që e pata ndalur për vete. Herën tjetër t'i dërgoj ashtu si më porosit ti në letër.

Sa i përket maqinës për shtypjen e „Z.K.", të njoftoj se shoku I. B. e ka kryer atë që lypsej prej tij. Shoku Sh. Është përgjigjur pozitivisht, por ende s'e ka kryer punën. Ai thotë se pak më vonë do të na përgjigjet me një shumë 4-5 herë më të madhe.

Me këtë letër po ju dërgojmë edhe ca trakte që kemi shpërndarë ne këndej. Ja edhe ca letra të bardha me zmalt, që të mbuloni me to, para se t'i fotokopjoni traktet, ato pjesë që nuk ju përgjigjen për atje. Tekstin e traktit të ardhshëm, që me erdhi me letër, do ta shtyp dhe të ta dërgoj menjëherë.

Tani po kalojmë te numri i ardhshëm i „Zërit të Kosovës". Në letrën e ardhshme besoj do të mund të më udhëzosh si t'ia bëj me këto çështje:

Formati, a duhet zgjedhur ai i „Lajmëtarit…" apo ai i „Bashkimit"?

Unë kam menduar që titulli i gazetës të jetë me shkronja të kuqe, përafërsisht si ai i numrit 3 të „Lirisë“. Në vend të flamurit me pushkë, që ndodhet te „Liria“, kam menduar të vëmë ose flamurin shqiptar, ose një simbol të pushkës dhe penës. Si mendoni ju për këto dhe çka më porositni?

A pajtoheni që tirazhi i gazetës të jetë 3000 ose 5000 kopje, apo mendoni se duhet të jetë më i vogël a më i madh?

Mendoj se ky numër duhet të përmbajë një fjalë hyrëse të redaksisë. Që të mos na përvidhet ndonjë lëshim, mendoj se këtë fjalë, së paku në pika të shkurta, duhet ta përpilosh ti me shokët dhe pastaj të më tregoni edhe autorizimet e mia lidhur me të, përkatësisht në ç'shkallë mund të intervenoj unë në të.

Tash për tash, unë kam parashikuar, globalisht, këto tema:

1) kryeartikulli. Në pika të shkurtra të përfshihen kushtet objektive që u paraprinë ngjarjeve të Kosovës. Vetë ngjarjet e Kosovës nga aspekte të ndryshme.

2) Dëshmorëve të rënë në demonstrata

3) Lavdia e femrës shqiptare ndër shekuj dhe në ngjarjet e sivjetme

4) Renegatët e vjetër dhe renegatët e rinj

5) „Preokupimi“ i jugosllavëve për realitetin në RPS të Shqipërisë

6) Botimi (me komentin tonë) i një vjershe të shkëlqyeshme mbi Shqipërinë, shkruar nga një poete e vjetër greke. Kjo vjershë demanton insinuatat jugosllave lidhur me opinionin grek sa i përket çështjes së minoritetit grek në Shqipëri.

7) „Preokupimi“ jugosllav për dominimin e toskërishtes në letrarishten tonë përzierje flagrante në punët dhe në kulturën materiale të shqiptarëve dhe përpjekje për shuarjen e kulturës kombëtare te shqiptarët e Kosovës në veçanti.

8) Figura e punëtorit dhe e fshatarit në ngjarjet e Kosovës

9) Heshtja e bllokut të pathyeshëm të intelektualëve kosovarë, që po e vret armikun

10) Zvogëlimi i numrit të studentëve në Universitet – shtim i armatës se të papunëve në Kosovë dhe tmerr edhe më i madh për armikun

11) Jeta e mjeruar e shqiptarëve në Maqedoni dhe Mal të Zi

12) Rreth shpërnguljes së serbo-malazezëve nga Kosova

13) Letër e hapur popullit serb, malazez e maqedonas (për nxitjen e ndjenjës antishqiptare që mbjell te ta propaganda revizioniste jugosllave dhe rrezikun që ata, nesër, të bëhen mish për top në realizimin e aspiratave shoviniste e pushtuese të kësaj qeverie

14) Marrëdhëniet shqiptaro-serbe ndër shekuj (përfolje e studimit omonim të historianit tonë të ndjerë Sadulla Brestovci, botuar në „Gjurmime albanologjike“

15) Nga shtypi shqiptar lidhur me ngjarjet e Kosovës

16) Nga shtypi i huaj lidhur me ngjarjet e Kosovës

Përveç këtyre, edhe ndonjë nga temat e gatshme që më keni dërguar ju dhe që ju duken të arsyeshme për këtë moment.

Nuk mund të them gjë prerazi lidhur me afatin kur mund të kryhet nga ana ime puna e daljes së gazetës, por shpresoj se nuk do të më marrë më shumë se 20 ditë.

Të fala vëllazërore e revolucionare – Sokoli

(Shënim i Xhafer Durmishit: Këtë letër ma dërgoi Kadri Rexha, më 31 gusht 2013)
(U botua për herë të parë nga Faridin Tafallari në www.albaniapress.com, më 30 shtator 2013)

19. Letër për Sabri Novosellën, 31 korrik 1981

Untergruppenbach, RFGJ
31 korrik 1981

I dashur vëlla, Mërgim!

Dje mora dy letra në një zarf ë mbante datën e nisjes 23. 07. Njëra ishte për mua, e tjetra e përbashkët, për mua, Shpendin e Bardhin.

Menjëherë pas dite me Bardhin shkuam te Shpendi dhe i lexuam bashkë të dy letrat.

Nga përmbajtja dhe toni i letrave të tua, kuptova që ende s'e ke marrë letrën time të fundit, në të cilën të kam njoftuar për punën konkrete që është duke u bërë rreth nxjerrjes së numrit të ardhshëm të „Zërit të Kosovës".

Ka një keqkuptim mes meje dhe teje. Kur është fjala për titullin „Zëri i Kosovës", te unë s'ka pasur as nuk ka „hutesë" as „trullosje". E kam në dorë Statutin e LNÇKVSH, ku shkruan qartë se ai është organ i Lëvizjes sonë. Por, kam pasur në dorë edhe disa trakte të të ashtuquajturit Grupi komunist „Zëri i Kosovës" dhe më kanë dalë kokëçarje pikërisht me udhëheqësin e këtij grupi dhe pikërisht lidhur me këtë titull. Prandaj kam supozuar se mund të ketë hutesë te lexuesi. Vetëm kaq.

Të falem nderit për autorizimet që më jep në shumë drejtime. Kjo më detyron të rritem e të piqem dita me ditë përtej aftësive dhe mundësive të mia. Mendoj se autorizime më të mëdha (por edhe ato me kufij të theksuar) mund të me jepen vetëm sa i përket nxjerrjes së gazetës. Për të tjerat, sidomos për punë organizative, kujtoj se më mungon përvoja, e sidomos takti. Prandaj është e nevojshme të më jepen këshilla të vazhdueshme, fare mos nguro që këshillat të përmbajnë edhe hollësira.

Kësaj radhe e kam fjalën konkretisht te autorizimi që më ke dhënë për punë me shokun e „Lirisë", e veçanërisht të bisedohet me të lidhur me bashkimin e dy organizatave tona. Siç e di, përvoja ime në punë të organizuar ishte e shkurtër dhe unë nuk i di ato hollësi për organizatën tonë, lidhur me të cilat kërkon të informohet shoku i „Lirisë". Me një fjalë unë shoh një disponim të tij (besoj edhe të shokëve të tij) që kjo punë të mos bëhet përmes meje. Dhe u jap të drejtë. Nga ana tjetër, ata ende nuk i kanë shtruar hollësisht e me shkrim ato që duan të dinë e që kërkojnë. Mendimi i tyre, për sa e shoh unë, është se do të duhej të takoheshe ti, ose ndonjë shok tjetër nga më të rëndësishmit e Lëvizjes në atdhe, me ndonjë shok të njëjtit nivel, po në atdhe, nga ata të „Lirisë". Kjo më duket edhe mua e drejtë. Dhe ndoshta vetëm në këtë drejtim do të mund të kontribuonim në këtë moment unë dhe ai shoku i „Lirisë". Sa për udhëtim deri te ti (se kështu me korrespondencë është e rrezikshme të thuhen hollësitë) do të gjendej ndonjë njeri i përshtatshëm, bie fjala Shpendi a Bardhi.

Ndërkohë, puna do të vazhdojë me të vetën, deri sa të bëhet bashkimi, ashtu si porosit edhe ti me shokët.

Leximi i letrave të tua nga unë, Shpendi e Bardhi, u shndërrua në një takim të mbarë, ku shqyrtuam në hollësi çështjet e shtruara prej teje, sqaruam Shpendin për disa hollësi të punëve (këtu) në të kaluarën, dhe morëm disa vendime.

Që të tre jemi të mendimit se „Zëri i Kosovës" duhet të dalë sa më parë e sa më mirë dhe për këtë jemi duke punuar sa po mundemi.

Ne konstatuam së bashku që, ndonëse deri më tash nuk është formuar këtu dega konkrete e Lëvizjes, me komitetin e vet, veprimtaria është bërë si të kish qenë kjo degë. Por, tani do ta formojmë sa më shpejt edhe komitetin edhe degën, ashtu si na porositni ju, se mundësi dhe forca kemi.

Deri më tash, nga punëtorët kosovarë në mërgim, përmes meje kanë hyrë në Lëvizje 7 shokë. Secili prej tyre ka rrethin e vet, në të cilin ushtron ndikim dhe zhvillon veprimtari agjitative e të cilin e furnizon me materiale. Ata janë aktivë dhe me ndihma materiale të nevojshme, por kam pasur kujdes që të mos ngarkohen tepër. Këta njerëz kanë qenë aktiv, pos të tjerash, edhe në tubimin sa më të madh të punëtorëve për demonstratat tona në botën e jashtme.

Nga ana tjetër, në Lëvizje ka hyrë, që më se një vit, një grup që më parë aktiv, por gjysmë i organizuar, në atdhe. Ata janë aktivizuar shumë sidomos pas kontaktit të një përfaqësuesi të tyre me mua. Kanë pranuar Statutin, materialet e Lëvizjes dhe mënyrën e organizimit tonë e kanë përqafuar me entusiazëm të madh. (Me këtë letër po ta nis edhe një „qarkore“, të cilën ia kam pas drejtuar këtij krahu disa muaj para se të shpërthenin demonstratat e Kosovës. Po kështu po ta dërgoj materialin e „Parathënies“, siç e kam nxjerrë dhe shpërndarë unë këtu e në atdhe.) Fatkeqësisht, tash më arrijnë lajme se është burgosur një numër i konsiderueshëm nga aktivistët e këtij krahu.

Formimi i një komiteti për Kosovën ishte ide jona dhe e disa miqve gjerman, si kryetari i Shoqatës Gjermani-Shqipëri dhe anëtar i KQ të PK të Gjermanisë, Peter Platzman, pastaj shoku Hans Röm etj. (Për ta duhet të ketë informata të hollësishme Profesori. Sipas mendimit të tyre, në komitet do të bënin pjesë disa personalitete të shquara të jetës politike, shoqërore e artistike në Gjermani (kështu praktikoheshka këtu në raste të tilla), kurse nga pala e shqiptarëve të Kosovës ata ishin të mendimit që ne komitet të hyja unë, për dy arsye konkrete: si njeri që do të siguroja materiale për punën e komitetit dhe si person publik në vendin tonë – gazetar dhe poet. Këto bisedime qenë zhvilluar së bashku edhe me shokun e „Lirisë“ dhe ashtu qe vendosur. Por, më vonë atij i erdhi nga shokët porosia se s'duhet të kemi të bëjmë fare me të huajt. Dhe, qe atëherë, si punë e përbashkët çështja e këtij komiteti ra poshtë dhe në këtë drejtim s'u ndërmor gjë tjetër.

Në takimin e mbrëmshëm konkluduam se, po të jeni ju andaj të mendimit se kjo punë duhet të vazhdojë, atëherë ne do ta vazhdojmë. Mundësitë janë ato që kanë qenë.

Edhe çështja e letrave protestuese drejtuar qeverive të ndryshme dhe kombeve të bashkuara ka qenë e planifikuar të bëhej në bashkëpunim me shokët e „Lirisë“. Por, edhe ajo s'dha rezultat deri më tash. Ne do ta bënim edhe vetë, por ngurronim për një arsye – se, me punë të pavarur, prishnim punë në drejtimin e bashkimit të nevojshëm të organizatave tona. Edhe kjo punë mund të vazhdojë, po e patë ju të arsyeshme, por mendoj se, kur të merrni vendime për çështje të tilla, duhet ta mbani parasysh edhe rrethanën e nevojës së madhe të bashkimit, duke u prirë nga mendimi leninist se me bashkim nënkuptohet bashkimi i mendimeve, i pikëpamjeve dhe i punëve të përafërta a identike të dy a më shumë organizatave. Atje ku duket se ka pasur pasivitet ose harresë te unë, atje kryesisht ka qenë vendimtar ky parim dhe më pak harresa ose pasivizimi.

Numrin 3. të „Lirisë“ ta kam pas dërguar bashkë me traktet e shumëzuara, si dhe diçka nga artikujt e „Zërit të popullit“ dhe nga shtypi i huaj. Tani po ta dërgoj sërish, bashkë me një trakt të „Lirisë“, të hartuar prej meje në kuadër të bashkëpunimit që kemi me ta.

Numra të tjerë të „Lajmëtarit të lirisë“ dhe të „Bashkimit“, përveç atyre që të kam dërguar, nuk kanë dalë. „Bashkimi“ vështirë të dalë më, sepse unë kam vendosur të mos bashkëpunoj më me të, për arsyet e përmendura në Raportin që po ta dërgoj veçan. „Lajmëtari i lirisë“, ashtu si propozoni ju, mund të dalë si organ i Rinisë së LNÇKVSHJ, po do të jetë ngarkesë për forcat tona njëherë për një herë të pakta krijuese këndej. Por, edhe lidhur me këtë, ne do të punojmë ashtu si e do puna, dmth. si na porositni ju.

Ne patëm një vërejtje konkrete: autorizimi i çdo dege të Lëvizjes për të nxjerrë nga një organ të vetin me titull „Zëri i Kosovës“ na duket jo i dobishëm, por i dëmshëm.

Ai nuk do të flasë për unitetin, por për copëzimin e Lëvizjes, jo për forcën po për anarkinë brenda për brenda Lëvizjes. Nuk është çudi, pos të tjerash, që në këtë rast nga organi i një dege të dalin në shesh pikëpamje e mendime të kundërta me ato të degës tjetër, skajore. Të mos flasim për nivelet në realizimin e tyre. Nevoja për nxjerrjen e tyre bëhet, sipas mendimit tonë, aq më e përjashtueshme, pasi tash po del një organ qendror publik, me tirazh të madh, me materiale të bollshme e me përgatitje përkatëse teknike. Ka qenë e udhës që forcat krijuese dhe mjetet materiale të nevojshme për nxjerrjen e organeve nga ana e çdo dege, të centralizohen dhe t'ia japin krahun e tyre organit qendror.

Tani, pasi u shkruan disa materiale për numrin e pritshëm të „Zërit të Kosovës", po t'i dërgoj kopjet e tyre. I lexoni dhe m'i dërgoni sa më shpejt vërejtjet tuaja eventuale. Do t'u përmbahem temave të caktuara, për të cilat ju kam folur në letrën e fundit, e gazeta do të begatohet edhe me materiale të tjera (në mes të të cilave edhe disa tema të gatshme që më keni pas dërguar ju më herët).

E përfundoj këtë letër, duke ju përcjellë të fala vëllazërore e revolucionare ty e shokëve – nga Sokoli, Shpendi, Bardhi e shokët e tjerë këndej.

SOKOLI

(Shënim i Xhafer Durmishit: Këtë letër ma dërgoi Kadri Rexha, më 31 gusht 2013)
(U botua për herë të parë nga Faridin Tafallari në www.albaniapress.com, më 30 shtator 2013)

20. Raport për degën Hasan Prishtina, 31 korrik 1981

(31 korrik 1981)
Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare
-Komitetit të Degës „Hasan Prishtina"

R A P O R T

Mbi disa çështje rreth punës së organizatave
Grupi komunist „Zëri i Kosovës" dhe Fronti i Kuq Popullor

Nga dita e arritjes sime në RF të Gjermanisë, më 14 dhjetor 1979, këtu kam pasur kontakte me përfaqësues të Grupit komunist „Zëri i Kosovës" dhe pastaj të organizatës Fronti i Kuq Popullor. Le të më lejohet të shënoj këtu disa përshtypje dhe disa vrojtime lidhur me punën e tyre, aq më parë lidhur me punën e Frontit të Kuq, pasi Dega „Hasan Prishtina" mendon se është e arsyeshme të thërritën edhe përfaqësuesit e tij për bashkimin e organizatave dhe të veprimtarisë sonë.

Me udhëheqësin kryesor të Grupit komunist „Zëri i Kosovës" jam njohur, pra, në fund të dhjetorit 1979. Quhet Riza Salihu, nga fshati Mushtisht. Ra fjala për organin e LNÇK „Zëri i Kosovës" dhe ai, me një ton të ashpër, shprehu dyshimin jo vetëm në ekzistencën e këtij organi dhe të LNÇKVSH, por edhe në besnikërinë time. Arsyeja ishte se ai qëndronte vetë në krye të Grupit me të njëjtin emër dhe, siç del logjikisht, nuk dinte për ekzistimin e LNÇKVSH dhe kishte edhe vetë një logjikë të kufizuar, kurrsesi nuk ia kapte rradakja të bëjë dallimin mes një organizate me emrin „Zëri i Kosovës" dhe një organi me titull „Zëri i Kosovës" që i takonte koinçidentalisht një organizate krejt tjetër. Po atë natë, ai më njohu mua dhe vëllaun tim me dy shokë tij, Hysen Gega (tani i burgosur në burgun e Prishtinës) dhe Maksut Saramati, me punë të përkohshme në RFGJ. Që në fillim më ra në sy kapadaillëku në rigorozitetin prej një shefi bande i Riza Salihut dhe natyrshmëria e zgjuarësia e dy shokëve të tij (anëtarë të KQ të „Z.K.").

Me Hysenin e Maksutin u pamë dhe ndenjëm disa herë me radhë dhe e pritëm bashkë Vitin e Ri 1980. Hyseni lente të kuptohej se kishte diku në Gjermani një shok më të mirë se Rizanë, një student. Ai fliste dendur për të dhe vëllaut tim, Bardhit, që kishte njohur kohë më parë një person të tillë, i shkoi mendja mos ishte për njëfarë Ibrahim Kelmendin. Por, Hyseni e fshehte, prandaj nuk ngulëm këmbë për t'u njohur. Pak ditë më vonë vijnë te ne Hyseni e Maksuti dhe na tregojnë sesi Rizai kishte ardhur, që në takimin e parë me mua, në përfundim se unë jam „i dërguar special i UDB-së" dhe se u kishte propozuar haptazi Hysenit e Maksutit të më likuidonin bashkë me vëllaun, Bardhin. Ata u hapën në „muhabet" për dy arsye, sipas pohimit të tyre: e para, lidhur me Rizanë kishin pasur disa dyshime më përpara, dhe e dyta, tashmë ishin takuar me Ibrahimin dhe ai i kishte këshilluar të më afroheshin se gjoja ai e ditka kush jam dhe sa jam „i mirë".

Këto ishin dyshimet e shokëve më të ngushtë të Rizasë lidhur me veprimtarinë dhe me personalitetin e tij:

-Riza jetonte me vite në Gjermani, por as punonte as kishte zënë banesë të përhershme. Me se mbahej, pos me paratë e punëtorëve tanë?

-Rizai kishte theksuar vazhdimisht domosdoshmërinë e moralitetit, te çdo patriot e revolucionar. Vetë jetonte me një serbe dhe kishte me të një djalë me emër sllav. Këtë e kishin zbuluar shokët, e nuk ua kishte thënë ai vetë.

-Ç'është me rëndësi, mënyra e organizimit të Grupit „Z.K." ishte bërë e dyshimtë edhe për bashkëpunëtorët më të ngushtë të Rizasë. Sipas kësaj mënyre, në organizatë mund të hynte çdo shqiptar që „do të luftojë për atdhe". Çdonjëri që hyn në organizatë, duhej të jepte shënimet e sakta biografike (emri e mbiemri, vendlindja, ditëlindja, vendi i punës) dhe, mbi të gjitha, këto shënime si dhe betimin ta bënte me shkrim, me dorë të vet. Nga listat me të dhëna të tilla të hollësishme, një mbahej nga shokët e tyre në atdhe dhe një tjetër nga Rizai në RFGJ. Para se të arrija unë këtu, pothuaj të gjithë njerëzit e organizuar prej Rizait (kryesisht në Ferizaj e në Prizren) ishin burgosur pa mundimin më të vogël nga policia, sepse arrestimet ishin bërë në bazë të listave të përmendura. (Mërgimi mund të dijë për çfarë të burgosurish është fjala: kur ishim në atdhe, ne gjatë takimeve kemi pas biseduar me të disa herë lidhur me një grup të rinjsh ferizajas, që vepronin demonstrativisht nëpër qytet nën hundët e policisë. Unë këtu, kur kuptova hollësitë lidhur me organizimin e „Z. K.", supozova se ishin pikërisht ata të arrestuar.) Edhe Rizai, më vonë, e H. dhe M. që në fillim, i thoshin edhe me emra shokët e tyre të burgosur, kryesisht në dy qytetet e përmendura. Tre nga katër prej tyre përmenden në artikullin e parë të „Lajmëtari" Nr.1.

Nga bisedat që kam pasur me H. e M. kam kuptuar se puna e Grupit komunist të tyre konsistonte në radhë të parë në botimin e disa trakteve (nëse më bie në dorë ndonjë prej tyre do t'jua dërgoj) dhe në shfaqjen e disa filmave të huajtur nga shokët gjerman, miq të RPSSH. (Kur unë vetë mora kontakt me këta shokë gjermanë, më thanë se pas një kohe janë detyruar ta largojnë Rizanë nga lokalet e partisë së tyre, për shkak të arrogancës së tij.)

Përafërsisht katër muaj pas takimit të parë me Rizanë, u takuam edhe një herë, në banesën e H. Ishim prezent unë e vëllau, pastaj Ibrahim Kelmendi (ishim njohur me të ndërkohë), Hyseni, Maksuti dhe Rizai. Ne u fjalosëm keq më të, sepse patëm rastin të hetonim që të gjithë se ai kishte prirje të gënjejë dhe t'i shmanget bisedës parimore. Këto ishin pikat që rrahëm: Pse ai, pa verifikuar dyshimet e veta, që në takimin e parë kish kërkuar nga shokët e vet të më likuidonin mua dhe vëllaun; pse, pastaj, me muaj të tërë, në stacionin hekurudhor të Shtutgartit, ku dalin e rrinë punëtorët tanë, kishte agjituar kundër meje (pa i vërtetuar akoma dyshimet) me fjalët: „Ruajuni se këndejpari vepron filan fisteku, i dërguar special i UDB-së"; Pse ai vetë (edhe pasi ia kisha tërhequr unë vërejtjen që në takimin e parë), vazhdonte kontaktet me njëfarë Adem Povataj nga

Strellci, i cili, pasi kishte marrë në qafë disa punëtorë stinorë në Titograd, më 1978, duke i ngashnjyer së pari për punë patriotike e pastaj duke ua dorëzuar komplet UDB-së (që Rizai kishte kontaktuar dhe vazhdonte të kontaktonte me këtë njeri, ia thoshin ndërsy shokët H. e M.); pse ai, si komunist që i thoshte vetes, edhe pasi kishte parë rezultatet e hidhura të mënyrës së organizimit me lista të anëtarëve të organizatës, vazhdonte punën me të vjetrën dhe merrte njerëzit në qafë.

Gjatë gjithë bisedës ai mbajti një qëndrim qyqar, që s'kishte aspak të bënte me qëndrimin e një komunisti shqiptar. Në fund ai pranoi se kishte gabuar sa u përket shpifjeve të pabazuara rreth meje e vëllaut dhe premtoi se nuk do ta përsëriste. Por, që të nesërmen ai e përsëriti, në stacionin e Shtutgartit.

Nga gjysma e gushtit të vjemë, te unë erdhi në banesë policia kriminalistike gjermane (po në atë orë Bardhi ndodhej në qendrën e kësaj policie, në Shtutgart, ku e kishin marrë nga puna. Ata na morën në pyetje veç e veç. Çështja kishte të bënte me Riza Salihun. Ai kishte hapur në postën e Shtutgardit 14 fah-postale në emër të 14 njerëzve të ndryshëm, ku ndalte letrat e këtyre dhe i lexonte për nevojat e veta. Mes të 14, kishin qenë unë e vëllau, Hysen Gega, Ibrahim Kelmendi etj. Policia e kishte zënë, e kish hedhur në burg dhe dyshonte se është agjent i UDB-së. Ndërkohë që Rizai kishte shpallur ndër punëtorë sesi ka kërkuar azil politik në Gjermani, ai kishte qenë pesë herë, në prag të burgimit, në konsullatën jugosllave në Shtutgart. Këto i kishte të shënuara në bllokun e shënimeve. Për mua e vëllaun dhe për Ibrahim Kelmendin kishte dhënë te policia deklarata shumë të liga me shkrim, me plot gënjeshtra edhe për dy takimet që kishim pasur e ku kishim shumë dëshmitarë. Policia një fjalë kërkonte prej nesh: të thoshim edhe ne se Rizai është spiun jugosllav. Natyrisht, ne s'e bënim dot një gjë të tillë pa qenë të sigurt, dhe insistimet e policisë, të bazuara nga ana e saj në disa fakte që ne s'na e mbushnin mendjen, i kthenim mbrapshtë me arsyetimin se UDB-ja ka mundësi të mëdha të kurdisë gracka, e kështu ka mundur të veprojë edhe me R. S.

Pastaj, tërë vjeshtën dhe tërë dimrin s'dëgjuam gjë për të. Të tretën herë u takuam me të në demonstratat e punëtorëve tanë në Shtutgart. Ishte vënë në bisht të kolonës, me duar në xhepe dhe pa asnjë shok me vete. Pas demonstratës m'u afrua. Përshëndeste punët e mia, lavdëronte (ishim më këmbë dhe s'pata si ta pyesja për çfarë punësh e kishte fjalën) dhe thoshte se do të kish qenë mirë të bisedonim. Aty për aty ishin zënë me Ibrahim Kelmendin dhe Ibrahimi ia kishte ndaluar pjesëmarrjen në demonstratat e ardhshme. Unë e qortova Ibrahimin, se s'bënte ashtu, dhe Rizait, ndërsy Ibrahimit, i thashë që e kish derën hapur për ta thënë mendimin e vet. Ai tha se më ka diçka borxh dhe se do të bënte një autokritikë. Unë i shpreha gatshmërinë se do ta dëgjoja kur të ketë qejf, por atë ditë e sot as më kërkoi më dhe as e kërkova unë. Tani po dëgjoj se paska ndërruar mendje lidhur me mua dhe nëpër njerëz nuk flitka më keq.

Lidhur me këtë person ka edhe një të dhënë me rëndësi. Diku nga viti 1976, Rizain e ka plagosur me thikë një kroat. Kroati i afron një hartë dhe Rizai e rrefuzon me fjalët „Nuk e pranoj një Jugosllavi të tillë, e cila s'e ka edhe Kroacinë brenda". Në spitalin e Shtutgartit pastaj e kanë vizituar njerëzit e konsullatës jugosllave dhe e kanë mburrur për patriotizëm jugosllav. Edhe Bardhi ka qenë prezent, si përkthyes dhe punëtor social. Disi pas këtij rasti fillon edhe veprimtaria patriotike (?) e Rizait.

Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980. Më ka sjellë për t'ia korrigjuar disa artikuj të përgatitur për gazetën „Bashkimi" dhe më ka propozuar që të shkruaj edhe unë për këtë fletushkë. Pasi e kisha lexuar numrin e saj të parë qysh në vendlindje dhe e dija se gazeta bie në duar të popullit, bile në një gjendje jo të lakmueshme, e pashë të arsyeshme t'i përgjigjem pozitivisht për propozimin dhe konkretisht fillova me bashkëpunimin. (Bashkëpunimi im fillon me atë

numrin, që ia kam dërguar Mërgimit, ku në faqen e parë është një vizatim që paraqet grushtet e të burgosurve tanë që shpërthejnë grilat e dritares së burgut.)

Më vonë, Ibrahimi ka ardhur bashkë me Hysen Gegën e Maksut Saramatin dhe kanë kërkuar prej meje që të vihem në krye të tyre e t'i udhëheq (tashmë Hyseni e Maksuti e paskëshin braktisur Rizain dhe kishin kaluar në anën e Ibrahimit). Unë e refuzova kërkesën e tyre, se s'bënte të jem njëkohësisht në dy organizata. Përveç kësaj, ua kisha tërhequr që më vërejtjen se konspiracioni duhej mbajtur i pacenuar edhe këtu ashtu si në vendlindje. Kërkesa e tyre e dytë ishte që së paku t'i këshilloja, si „njeri me përvojë", dhe unë tërë kohën atë punë bëja. Por, ndërsa kërkonin këshilla dhe i aprovonin ato, në punën e tyre ishin mësuar të vepronin krejt ndryshe dhe s'hiqnin dot dorë nga mënyra që i kishte rrëmbyer dhe ua diktonte çdo hap. Përveç të tjerash, me gjithë sqarimet e shumta nga ana ime, ata konspiracionin e konsideronin si frikë, zhburrërim dhe jopatriotizëm.

Që të mos zgjatem në detaje, ja vrojtimet e mia në pika të shkurtra lidhur me veprimtarinë dhe personalitetin e I. Kelmendit.

Kurdoherë ka anuar nga aksione të natyrës terroriste dhe në këtë drejtim i ka nxitur edhe shokët e vet. Unë ia kam tërhequr vërejtjen se kjo gjë është e dënueshme edhe nga pikëpamja e PPSH. Më vonë kam vërejtur, në librin që ma ka dhënë hua për lexim, se i ka pasur të nënvizuara pikërisht mendimet e Leninit lidhur me kotësinë dhe rrezikshmërinë e terrorizmit në lëvizjen revolucionare. Kam ardhur kështu në përfundim se ai ka një prirje të natyrshme kah terrorizmi dhe e bën me vetëdije.

Pikërisht në kohën që jam njohur unë me të, ai ka pasur kontakte, madje edhe negociata me emigracionin reaksionar shqiptar për një veprimtari të përbashkët në mbledhje armësh dhe mjetesh materiale. Madje, në atë kohë, kërkonte një njeri „të ndershëm e trim", që, për një kundërshpërblim prej nja 50 mijë markash gjermane, do të kryente në Kosovë një aksion sipas porosisë së reaksionit shqiptar antikomunist. (Lidhur me këto çështje kemi pasur një dialog të përbashkët dhe bukur të rreptë në praninë e tij unë dhe dy shokë nga Vjena, lidhur më këtë është dashur të jetë i informuar patjetër Profesori, në qoftë se është informuar për çkado lidhur me I. Kelmendin.)

Ka pasur vërejtje rreth Kushtetutës së RPSSH dhe rreth përgatitjes „luksoze" të librave të shokut Enver, në „dëm" të botimeve letrare në RPSSH! Vërejtjen e parë na e ka thënë hapurazi mua dhe shokëve të Vjenës, të dytën vetëm mua. Arsyetohet se ka të drejtë të bëjë vërejtje gjithfare dhe se këto dilema të tij nuk i paraqet te masat, por i diskuton vetëm me shokë. Unë s'mund ta di a është e saktë kjo.

Ka dyshuar me këmbëngulje në drejtësinë e artikullit të „Zërit të popullit", ku shprehej gatishmëria e RPSSH për t'u ardhur në ndihmë popujve jugosllavë po të kërcënohen këta nga BRSS, dhe dyshimet e tij kanë qenë edhe të shokëve të tij. Përkundër bindjeve të mia se është e panevojshme dhe e pamirë një gjë e tillë, jam detyruar të udhëtoj me qindra kilometra për ta „arsyetuar" te shokët e tij artikullin e përmendur. Ai më ka propozuar pastaj me këmbëngulje që këtë gjë ta përsëris edhe me shkrim në artikullin e „Bashkimit" me titull „Zëri i popullit – zë i të gjithë shqiptarëve" (këtë numër s'e keni pasur, prandaj po jua dërgoj). (Pas kësaj, kam vendosur të mos bashkëpunoj më me të dhe kam vendosur ta nxjerr „Lajmëtarin e lirisë". Kështu kam vepruar nga gushti 1980, deri në fillim të vitit 1981, kur më ka ardhur në derë me disa materiale të çoroditura për numrin e ri të „Bashkimit". Ndërsa ishim duke punuar në këtë numër (që Mërgimi e ka veçuar si më të mirin), ai ndërkohë e kishte „lejuar" Hysen Gegën të shkonte për kryerjen e një aksioni në Kosovë. Gjoja Hyseni e paska përberë që të mos më tregojë mua për këtë gjë, se unë s'e lë të shkojë. Vërtetë nuk do ta lija, se ai kishte respekt ndaj meje dhe, meqë aksioni ishte i natyrës terroriste, e dinte edhe mendimin tim. Pas disa ditë qëndrimi ilegal në Kosovë, bashkë me njeriun me të cilin ishin nisur prej këndej – një njeri i dyshimtë edhe

për mendimet e Ibrahimit e të Hysenit, Sadik Blakaj, për të cilin Mërgimit i kam shkruar më herët – Hyseni bie në burg, kurse Sadiku kthehet në Gjermani shëndosh e mirë. Fajin për burgosjen e Hysenit unë ia vë Ibrahimit.

Nëpër të ashtuquajturat klube kosovare në mërgim, që ishin dhe shumica vazhdojnë të jenë çerdhe agjenturore të përfaqësive diplomatike jugosllave në Perëndim, I. K. është ekspozuar në masën më të madhe të mundshme edhe para përfaqësuesve diplomatikë jugosllavë. Ua ka thënë hapurazi të gjitha të palarat e Jugosllavisë titiste. Pasoja pozitive ka qenë inkurajimi i punëtorëve kosovarë, pasoja negative – dëmtimi i disa punëtorëve që kanë marrë pjesë në klubet ku është paraqitur I. K. Këta punëtorë ndodhën në burgje jugosllave.

Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. I biri i këtij Ramës ndodhet me punë në Mynhen dhe ka qenë aktivist i dalluar, madje edhe kryetar klubi në Mynhen. Ibrahimi kritikon hapurazi si agjent dajën, por ka kontakte të vazhdueshme me djalin e dajës dhe, për sa mund të vërehet, edhe simpati ndaj tij. Ka provuar t'ia plotësojë këtij daje të vogël (Gani Ibërdemajt – edhe lidhur me këtë njeri është dashur të jetë i informuar Profesori) dëshirën për t'u njohur me mua. Më vonë, kur ka qenë puna që të formojmë këndej një shoqëri kulturo-artistike të punëtorëve të mërguar, me shokun e „Lirisë" e kemi provuar Ibrahimin lidhur me dajën e tij të vogël: meqë ky Ganiu qenka këngëtar dhe instrumentist i mirë në vegla muzikore folklorike, Ibrahimi propozoi që edhe ai të hynte në atë shoqëri. Po kur erdhi puna te aktiviteti konkret, Ibrahimi tha se Ganiu donte pak „lutje". Në anën tjetër, më 25 maj, në festën jugosllave të rinisë, Ganiun e gjejmë në ballë të një orkestrine dhe të ca valltarëve shqiptarë e jugosllavë, bashkë me të shoqen, në Stadiumin e Munhenit. E kemi konsideruar të panevojshme të kërkojmë ndonjë sqarim nga Ibrahimi, dhe ky vetë s'e ka marrë mundimin të na sqarojë, as lidhur me këtë rast dhe, përgjithësisht, as për raste të tjera. Tash i gjithë Mynheni flet çmos pikërisht për këtë farë Ganiun.

Në kufirin gjermano-zvicëran, Brahimit dhe Hysenit u ka zënë policia e huaj disa qindra ekzemplarë të „Bashkimit" dhe ua ka marrë. Me këtë rast, Ibrahimi nuk është treguar i gatshëm për të pranuar kritikat. Përgjithësisht, nëse ia numëron gjestet dhe punët e kritikueshme, ai thotë: „Mos m'u kap vetëm për disa gabime, të vogla". Menjëherë pas kësaj, bashkë me shokët, kanë vazhduar rrugën për në Çekosllovaki, në gjurmim të armëve (ndoshta profesori mund të ketë ndonjë informim nga ana e shokëve të Pragës lidhur me sjelljen e tyre në atë vend, sepse e di që shokët e Pragës kanë pasur kontakte dhe bile disa mosmarrëveshje me ta, sipas fjalëve të I. dhe H.).

Vetë më ka treguar gjoja për disa sugjerime, që i kanë bërë shokët e organizatës së tij në vendlindje, dhe të cilave ai nuk u është përmbajtur fare. Të imponohet përshtypja se as që ka shokë të tillë në Kosovë. Përshtypja e parë dhe e fundit lidhur me këtë çështje është se ai, përveç disa punëtorëve të tubuar rreth tij në botën e jashtme, të paorganizuar po vetëm të furnizuar me literaturë revolucionare dhe të inkurajuar, tjetërkë as që ka prapa vetes. Kjo, në një mënyrë edhe mund të provohet bindshëm. Më vjen një ditë, (vitin e kaluar), në derë me disa shkresurina që vetëm titullin e kishin të qartë: Programi dhe Statuti i Frontit të Kuq Popullor, dhe më lutet t'ia korrigjoj në pikëpamje drejtshkrimore. Më pastaj më autorizon që të preki, po e pashë unë të arsyeshme, „si njeri me përvojë", edhe në anën materiale të pikave të përfshira në program e statut. Mirë, them, dhe meqë përmbajtja e shkresurinave ishte pa kokë pa bisht, i hy unë punës me gjithë seriozitetin dhe ato pak njohuri që kisha. Gjithmonë kisha parasysh, pas punës sime, ai do t'ua kthente shokëve për diskutim Programin dhe Statutin e Organizatës së tyre. Por, doli ndryshe. Doli se I. K. i ishte tekur të bënte një natë pa gjumë dhe të hartonte këmbadoras një

program dhe statut të një organizate revolucionare, të cilin e botoi dhe e shpërndau si „literaturë revolucionare“ menjëherë pas „korrigjimeve“ që i bëra unë. E puna që kisha bërë unë më atë rast, s'ishte punë korrigjimi.

Shokët e Vjenës e mbajnë larg. Bile, kur njërit prej këtyre shokëve, i cili më qortoi pse rrija me I. K., i thashë se është njeri që imponohet me këmbëngulje dhe unë, si shqiptar, nuk mund ta përzë nga shtëpia ime, ky m'u përgjigj fjalë për fjalë kështu: „Ia paske frikën, prandaj s'e përzen, si qenin!“

Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht, flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi. Bashkëpunimi me të gjatë demonstratave të mbajtura në Perëndim ka shkuar përmes shokut të „Lirisë“.

Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare të I.K., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella.

Përndryshe, një meritë e tij, mendoj, nuk mund ta përbuzë askush: që nga viti 1977 e këtej, i vetëm, po me një vitalitet të pashoq, ka bërë shumë në shpërndarjen e literaturës revolucionare, si ka mundur e ka ditur, dhe në njëfarë politizimi spontan të një pjese të mirë të punëtorëve tanë në botën e jashtme. Është njeri komunikativ dhe i popullarizuar te punëtorët. Udhëton shumë, vlon prej idesh, shpesh naive e të papërpunuara, ndonjëherë edhe të qëlluara.

SOKOLI

(U botua për herë të parë në www.albaniapress.com, 2 tetor 2011 nga Faridin Tafallari, së bashku me punimin *Kur Jusuf Gërvalla shkruante*)

21. Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981

RFGJ 20 gusht 1981

I dashur vëlla Mërgim!

Për mua, personalisht mendimet e tua kanë një domethënie të madhe. U mësova disi me to dhe se si më vjen keq kur i bie në fund së lexuari letrës sate, më vjen keq që s'ka më shumë fjalë. Ndërkaq, për të gjithë ne, mendimet dhe këshillat e tua të urta janë bërë një impuls i mirë, që po na e shkund ndryshkun, në çastet që ky po kaplon punën tonë në këto kushte të vështira mërgimi dhe sidomos në një mjedis bashkatdhetarësh, me të cilët është punë tejet e vështirë të punohet (vështirësinë e kushtëzon natyrisht, edhe paaftësia jonë për komunikim të qëlluar.)

Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I. K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij, në qoftë se ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari, atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të. Të shpresojmë se ai e meriton. Sot për sot nuk po zgjatem më shumë lidhur

me këtë çështje, sepse vetë kjo letër, për shkak të kohës së kufizuar, është vetëm njëfarë kapari për një përgjigje më të gjatë e më të thelluar.

Materialet e numrit të ardhshëm të "Z.K." janë pothuaj të gjitha të gatshme. Për pjesën e tyre më të madhe, unë, Shpendi e Besniku jemi të kënaqur. Morëm zemër edhe nga fakti se ju kishin pëlqyer edhe juve ato punime që ua dërguam edhe juve për t'i shikuar. Përveç kësaj, unë personalisht tani jam në pozitë shumë më të lehtë, për shkak të mendimeve, porosive e sugjerimeve nga ana juaj dhe për shkak të një ndihme, sado të vogël në fillim, nga ana e Shpendit, e Besnikut dhe e shokut të "Lirisë", që këta më dhanë me disa artikuj të mirë. Edhe Shpendi edhe Besniku, për sa duket kanë afinitet për shkrim, i cili do të rritet bashkë me punën tonë e me ne.

Tani pas hartimit të dy artikujve që kanë mbetur pa u kryer, menjëherë po i hyjmë shtypjes së revistës. Maqinë për të blerë nuk kemi gjetur ende, por shpresojmë se do të na bjerë në dorë diçka e mirë. Tani për tani duhet të marrim, për këtë numër, një maqinë të tillë me qira. Këtu praktikohet kjo gjë.

Mbrëmë ishim me Besnikun te ai personi në Visloh, që na i patë dhënë 3 mijë markat. Sa më shumë që po njihemi me të, aq më i matur, i pjekur dhe i mirë po na duket ai neve dhe me gjasë, edhe ai po fiton gjithnjë simpati më të mëdha për punën tonë. Unë, Shpendi e Besniku, duke analizuar anët e mira dhe virtytet e këtij njeriu, kemi vendosur se do të kish qenë mirë ta bënim menjëherë anëtarë të Komitetit të degës së këtushme. Na nevojitet mendimi juaj i prerë për të se ju keni ku e merrni këtë mendim.

Me këtë letër po të nis edhe Programin e Statutin e Frontit të Kuq Popullor dhe një material (mbase program) të Organizatës së Marksistë-leninistëve të Kosovës.

Të fala të ngrohta vëllazërore

Sokoli (Jusuf Gërvalla)

(Botuar për herë të parë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 451-452)

22. Letër për Sabri Novosellën, 5 nëntor 1981

Untergrupenbach, RFGJ
5 nëntor 1981

Vëlla i dashur Mërgim!

Pas një kohe prej afro dy vjetësh, dje sërish ta ndjeva zërin. U gëzova si fëmijë. Më erdhi mirë që të paskan ardhur shoqja e fëmijët. Vërtet, kështu një nga një, po na bie të arratisemi nga atdheu ynë i shumëvuajtur. Por, sipas bindjes sime të plotë, robëria tani po numëron tik-taket e veta të fundme dhe ne së shpejti do t'i kthehemi tokës e popullit tonë, kush duke ia falur gjakun, të tjerët duke mbetur për t'ia falur djersën dhe për të gëzuar jetën në liri e fatbardhësi. Po bien kambanat e luftës, pas të cilës do të vijë fitorja, kësaj radhe e plotë për popullin tonë.

Tani disa fjalë rreth takimit të Stambollit.

Ka disa muaj që unë po fluturoja nga gëzimi, në pritje të bashkimit të forcave tona revolucionare, që isha bërë gati ta quaja bashkim historik. Më herët të kisha dërguar një letër dhe të kisha thënë se këtë bashkim unë vetë nuk e shoh çështje aq të thjeshtë. Ka probleme parimore për të cilat duhen marrëveshje serioze, siç është ai se a duhet të kemi fare parti k. m.-l., apo ajo parti është e domosdoshme për t'i dalë në ballë popullit tonë në drejtim të luftës dhe të fitores. Ky ishte për mendimin tim problemi kyç. Meqë me Organizatën e shokëve të „Lirisë" kishim të përbashkët ideologjinë e qëllimin dhe ndonjë ndryshim të vogël në pikëpamje të taktikës revolucionare e të organizimit, kujtoja se pas disa bisedimesh mund të rregullohej shumëçka. Për veten time, në shërbim të kësaj

çështjeje, nuk kurseva gjumë as punë, shëndet as djersë, e besa as shpenzime materiale. Aq më pak e kam kursyer sinqeritetin e shokut me shokun, e revolucionarit me revolucionarin. Si të kursehem në një kohë që populli ynë, i cili sot po martirizohet si rrallëherë në historinë e tij shumëshekullore, pret nga djalëria e tij patriotike e revolucionare që ajo të çajë rrugë drejt luftës dhe fitores, e lidhur fort me besa-besë dhe me grushtin e bashkuar.

Nga e gjithë kjo, tash mbeti vetëm dëshira. A ka vend të ndruhemi se s'paska ardhur ende çasti i pritur i bashkimit? Ende po dua të shpresoj që qëndrimi i shokut Z. ndaj kësaj çështjeje të rëndësishme nuk është edhe qëndrimi i shokëve të tij, aq më pak vija e tyre dhe përfytyrimi i tyre për bashkimin.

Pasi kuptova si është shtruar kjo çështje në takimin tuaj (e këtë e kuptova në çastin e fundit në bisedë me shokun Z.), ishte e vetëkuptueshme të pajtohesha plotësisht me qëndrimin që ke marrë ti atje. Të njoftoj se, që kur mbaj kontakte me atë person, asnjëherë, as rastësisht, nuk ka rënë fjala për një „bashkim" të tillë të çoroditur, siç e kishte shtruar çështjen shoku Z. Po e panë ata të udhës, le të përpiqen të arrijnë „bashkime" me hope e boshllëqe, duke pasur cak të fundit jo grumbullimin optimal të forcave tona revolucionare në frontin e rreptë të luftës, por megalomaninë e arrivistëve të revolucionit, ndjenjën e epërsisë boshe mbi të tjerët dhe tendencën për dominim me çdo kusht mbi të tjerët. Kam dëshirë të madhe të më dalin gabim përshtypjet e këqija që formova për ta pas atij takimi dhe pasi mësova për qëndrimin e tyre.

Në këtë mes, më duhet të pranoj se, nga ana e atyre shokëve, qenka bërë një lojë e pahijshme me personin tim. Nuk di me se e kam merituar një gjë të tillë. Por tani, pas hidhërimit të parë, nuk ndiej kurrfarë nevoje të kërkoj ndonjë shpjegim a satisfaksion prej tyre. Sedra s'ka vend në këtë mes. Nuk do të pendohem për angazhimin tim (të kotë) në këtë drejtim, as për sinqeritetin që ua kam falur atyre pa rezervë. Mjafton ndërgjegjja e pastër dhe qëllimet e mira, që më kanë udhëhequr gjithë kohën. Veçse, një mësim duhet nxjerrë: sinqeriteti – për shokët e sinqertë. (Po kush dyshonte në mossinqeritetin e tyre, kur nuk dhanë asnjë shenjë! Kjo më brengos edhe më shumë për rrugën e tyre.)

Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër. Kjo nuk do të ndodhë kurrë. Përkatësisht, deri në çastin që të bindem plotësisht se Lëvizja e ka lënë rrugën e drejtë dhe, në vend që të luftojë si duhet për popullin, i sjell dëme pikërisht kësaj lufte. Shenjat për këtë, fatbardhësisht, nuk janë dukur gjëkundi deri në këtë çast. Bashkëluftëtarët tanë, në paçin sado pak nga veçoritë dhe virtytet e tua luftarake e patriotike, Mërgim, mund të mburren se janë duke u shkrirë si qiriu, që populli të shohë dritë.

Është e tepërt të thuhet se do t'i çojmë në vend këshillat, sugjerimet dhe urdhrat që do të na vijnë nga ana juaj. Këtë mendim e kanë plotësisht edhe Shpendi e Besniku.

Më lejo të kalojmë te disa çështje mbi përgatitjen sa më të mirë të „Zërit të Kosovës" në të ardhmen.

Materialet që mendohet të sigurohen nga shokë të brendshëm, e do puna të na arrijnë gjithmonë me kohë, në mënyrë që të dalim me to me kohë para lexuesve, pa u humbur aktualiteti.

Kemi mungesë thuaja totale të shënimeve në vendin e ngjarjes, pra shënime për ato që po ndodhin dita-ditës në atdhe. Një mungesë e tillë s'ka si të mos e godasë keq revistën tonë revolucionare.

Kemi nevojë të madhe për materiale të nivelit profesionist, sidomos nga lëmi i historisë, i drejtësisë etj.

Për këtë qëllim, po shtroj këtu këto propozime:

1) Ne këndej, dhe shokë të tjerë në botën e jashtme, do të mund të siguronim një numër të caktuar adresash të vendësve. Këto adresa do t'u jepeshin në atdheun tonë njerëzve të penës. Ata do të na dërgonin në to shënime për ato që kanë ndodhur e po ndodhin në Kosovë: numrin, emrat dhe shënime përcjellëse, sa më të plota, për të vrarët, të plagosurit, të arratisurit, të pushuarit nga puna, të burgosurit etj. Materialet do t'i lëshonin në posta jashtë trojeve shqiptare, është e dëshirueshme që ato të lëshohen në Slloveni, ku kontrolli policor duhet të jetë më i vogël.

2) Mendoj se në revistën tonë duhet të bëjë vend sa më shpejt një artikull mbi marrëdhëniet shqiptaro-serbe në periudha të ndryshme. Qëllimi është që të shihet kontinuiteti i i aspiratave pushtuese, kolonizuese serbe dhe shovinizmi i tyre, që shkon deri në dëshirën për shfarosjen e plotë të popullit shqiptar. Si literaturë bazë mund të shërbejnë disa punime të Sadulla Brestovcit në „Gjurmime albanologjike", librat e Shukri Rrahimit „Vilajeti i Kosovës" dhe „Lufta e shqiptarëve për autonomi 1897-1912", libri i Z. Canës „Lëvizja kombëtare shqiptare 1908-1912", ai i D. Tucoviçit „Serbia dhe Shqipëria", i Kosta Novakoviçit „Politika e Serbisë në pushtimin dhe serbizimin e Kosovës" (për titullin e këtij të fundit nuk jam krejtësisht i sigurt në është i saktë), libri i Shaban Brahës „Idriz Seferi" etj. Tema duhet të shtjellohet nga një historian i rryer, së pari për nevojat e revistës e pastaj, nëse zgjerohet, mund ta nxjerrim edhe si broshurë a libër. Unë do të përpiqem nga ana ime të gjej njeri të tillë, por edhe më shumë të përpiqeni ju andej. Ideale do të kish qenë sikur përmes Plakut, materiale të tilla me peshë të mund të siguroheshin në rrugën nëpër të cilën më kanë arritur këtu paratë e mbledhura për makinë.

3) Një temë me shumë rëndësi më duket edhe kjo: Inkompetencat e gjyqeve aktuale jugosllave në dënimin e rinisë dhe të popullit shqiptar. Një jurist i zoti, po ta vështronte problemin nga aspekti i së drejtës abstrakte, jo vetëm që do t'i nxirrte këto gjyqe inkompetente, po edhe ta paraqiste gjithë pushtetin jugosllav si një pushtet jolegal, që ushtrohet mbi popujt e Jugosllavisë, e veçanërisht mbi popullin shqiptar në mënyrë jashtëzakonisht të egër e të dënueshme, pa përfillur vullnetin e lirë të popullit tonë.

4) Ngjarjet po zhvillohen shpejt, fluturim. Ne që jemi jashtë, ndodhemi në bisht të të informuarve. Vërtet arrijnë lajme gojë pas goje, për shumëçka. Por, me to nuk mund të shërbehemi në revistë. Aq më pak lidhur me gjendjen e mjeruar ekonomike të Kosovës dhe me diskriminimin që i bëhet krahinës në këtë drejtim. Siç dihet, pa një trajtim serioz të problemeve ekonomike, revista jonë nuk ka si të përmbushë misionin e vet. Të dhënat që kemi pasur deri më tash, janë sigurisht të vjetëruara, se ekonomia jugosllave, veçmas ajo kosovare, po rrokulliset nga çasti në çast.

Ka edhe shumë probleme të tjera, që nuk mund t'i trajtojmë seriozisht pa bashkëpunëtorë profesionalë të niveleve të përmendura.

Nga temat e ngjashme, që propozova më lart, unë kam ndarë për vete të shkruaj për numrin 2 një artikull mbi mbrojtjen e kishave dhe të manastireve serbe nëpër Kosovë nga shqiptarët në të gjitha furtunat e deri tashme. Do të shërbehem me disa të dhëna që jep Dr. Mark Krasniqi në librin e tij „Gjurmë e gjurmime". Qëllimi është të sheshohet respekti i kosovarëve ndaj monumenteve të huaja të kulturës dhe mosprirja e tyre për vandalizëm, në një anë; në anën tjetër, „shpërblimi" i pushteteve serbe për këtë mbrojtje dhe shovinizmi i tyre në gjithçka që ka të bëjë me shqiptarët si „racë më e ulët", në krahasim me ta.

Pres propozime e sugjerime edhe për tema të tjera, me realizimin e të cilave do të rrekeshim unë, Shpendi e Besniku.

Të fala vëllazërore e revolucionare,
Sokoli

P.S.
Adresën e B. Krasniqit do ta sigurojmë dhe të ta dërgojmë sa më shpejt të jetë e mundshme. Me K. Mërturin do të bisedojmë për ato që u morëm vesh. Djelmoshave të tjerë në Romë, Besniku u kishte lënë 200 dollarë, këtu e kemi një shok të njërit prej tyre dhe prandaj shpresojmë se do ta fitojmë besimin e tyre dhe t'i bëjmë shokë edhe ata. Kemi rënë në kontakt edhe me një djalosh të tillë, në një kamp afro 250 km. nga vendbanimi ynë këtu, duket djalë i mirë dhe revolucionar i ngritur. Do të provojmë ta marrim në rrugën tonë. Ai kishte tubuar rreth vetes shumë punëtorë të vyer nga Kosova në qytetin ku është kampi. Ai ka mundësi të na e sqarojë më mirë edhe çështjen e Muharremit, meqë e kishte shok të mirë vëllaun e tij.

(Botuar për herë të parë nga Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 273-276)

23. Letër për Sabri Novosellën, 14 nëntor 1981

14 nëntor 1981

I dashur vëlla Mërgim,

Revista na u vonua ca ditë në shtypshkronjë. Posa e mora, po t'i dërgoj disa kopje me zarfa, sipas porosisë sate, dhe një pako me njëqind e ca kopje, në adresën e caktuar, që ma dërgove me letrën e fundit.

Ne gjetëm një vend ku na kushtonte diçka më lirë për ta shtypur, por na doli rrotull. Edhe na e vonoi shumë, edhe nuk e ka punuar mirë.

Mes të tjerash, janë përzier dy tituj të dy materialeve. Qe bërë shumë vonë për përmirësim. Korrigjimin e japim në numrin tjetër.

Të lutem që të na i dërgosh sa më parë materialet eventuale që do të vijnë nga shokët për numrin tjetër.

Telegramin e urimit për Kongresin e 8-të e pata dërguar pikërisht ditën që biseduam me telefon. Përmbajtja është përafërsisht kjo:

„Me entusiazëm të madh e dashuri të pamatë po ndjekim punimet e Kongresit të 8-të të PPSH dhe po e dëgjojmë zërin e së vërtetës. Na dha krahë raporti i shokut Enver për gjendjen në Kosovë, të cilin populli ynë liridashës e akcepton në tërësi si fjalën më të ligjshme në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të tij. Nga Kosova e robëruar ju përcjellim urime të përzemërta dhe urojmë që pushka t'iu bëhet top!"

Më falë që po shkruaj shkurt, por është ditë e shtunë dhe po nxitoj ta zë të hapur postën, e cila këtë ditë punon vetëm para dite. Menjëherë, nesër a pasnesër, ta nisi një letër tjetër, normale.

Të fala vëllazërore,
Sokoli

(Shënim i Xhafer Durmishit: Këtë letër ma dërgoi Kadri Rexha, më 31 gusht 2013)
(U botua për herë të parë nga Faridin Tafallari në www.albaniapress.com, më 1 tetor 2013)

24. Letër për Sabri Novosellën, 16 nëntor 1981

16 nëntor 1981

I dashur vëlla Mërgim!

Para tri ditësh t'i nisa një pako dhe tri zarfa me revistën. Po letrën që ta dërgova me to, e shkrova shkurtimisht, se prisja të përfundojë një ngjarje dhe të të shkruaj më gjerësisht.

Të shtunën, më 14 nëntor, në Shtutgart erdhi për të dhënë koncert Orkestrina e Radiotelevizionit të Prishtinës me tetë këngëtarë. Meqë në Shtutgart ende nuk ka klub të shqiptarëve dhe punëtorët e këtushëm, pos me një demonstratë, nuk kanë pasur si ta shfaqin revoltën dhe mendimin e vet lidhur me ngjarjet e Kosovës, ne patëm vendosur ta bojkotojmë koncertin e tyre. Ishte parashikuar nga ana e tyre që, para koncertit, ndonjë politikan të thoshte ndonjë fjalë lidhur me 29 nëntorin (jugosllav). Kurse ne planifikuam që, mes fjalës së tyre dhe koncertit, t'i thërresim punëtorët për dy minuta heshtje në nderim të luftëtarëve të rënë në pranverën e përgjakshme të Kosovës, të lexojmë një tekst të shkurtër (1,5 faqe të shtypura në makinë), të thërresim parullat „Jashtë nga vatrat tona ushtria dhe milicia fashiste jugosllave", „Rroftë populli shqiptar" dhe „Kosova - Republikë", me ç'rast kjo e fundit „Kosova – Republikë" do të vazhdonte pandërprerë deri në ndërprerjen e programit të „mysafirëve".

Por, ngjarjet u zhvilluan shumë më mirë sesa e kishim parashikuar ne. Në këtë drejtim na ndihmuan vetë armiqtë, me nervozën dhe druajtjen e tyre, siç po na ndihmojnë për të na vajtur punët mbarë që nga pranvera.

Konsullata jugosllave kishte organizuar si kujdestarë nja dyzet shqiptarë të mashtruar e serbë, me shirita kujdestarie në duar. Ata duhej të mbanin rend gjatë koncertit. Pas hyrjes në sallë të publikut (nja 5 – 600 veta) dhe të trimave tanë, të organizuar, nja 30 veta, një përfaqësues i ambasadës jugosllave, me emrin Bashkim Hisari (ish punëtor i TV Prishtinës) i afrohen Besnikut dhe një punëtori shqiptar e i nxjerrin nga salla si persona të padëshirueshëm. Meqë Besniku, për shkak të profesionit që ushtron, është i njohur pothuaj për të gjithë shqiptarët e këtushëm, , publiku ngritet i tëri në këmbë dhe reagon për largimin e tij. Atëherë, një shok yni, i LNÇKVSH, e shfrytëzon mirë rastin, hipën energjikisht mbi tavolinë, thërret të madhe parullën „Kosova – Republikë", duke vendosur kështu ta shkurtojë krejt procedurën e planifikuar. Publiku përnjëherë ngrihet i tëri në këmbë dhe i përgjigjet njëzëri parullës. Kujdestarët e neveritshëm dhe personeli i konsullatës jugosllave, me këlyeshët e tyre mercenarë, zënë të tolloviten dhe përpiqen të marrin masa. Por, si vetëtimë u lëshohen në shpinë djelmoshat tanë dhe publiku bashkë me ta. Përfundimi: tragjik dhe komik për armiqtë tanë. Përfaqësuesit të konsullatës i çahet koka me karrige (këtë njeri, Bashkim Hisarin, e kanë rrahur njerëzit tanë edhe në demonstratën e Shtutgartit, se qe treguar shumë i zellshëm dhe dinak e këmbëngulës në realizimin e qëllimeve të poshtra të armikut), e përgjaken të gjithë ata që kanë pranuar të hynë në vallën e tyre. Prej njerëzve tanë e punëtorëve, asnjë i plagosur, as i gërvishur, bile. Në taborin e tyre, disa të plagosur rëndë (ka qenë rrezik që të mbetet edhe ndonjë i vdekur). Fotografia e satrapit Tito dhe flamuri jugosllav grisen e shkilen nga publiku, instrumentat e Orkestrinës fluturojnë, thyhen e shkilen nëpër sallë. Gjatë gjithë kohës, shqiptarët, në përleshje e sipër, nuk e ndalin parullën „Kosova-Republikë". Përleshjet bëhen të rrëmbimshme, të rrufeshme, shumë energjike. Prej salle, i tërë publiku del përjashta dhe, për më se një gjysmë ore rresht, nuk shpërndahet por thërret parulla me zë të lartë, kështu që manifestimi shndërrohet në një demonstratë të shkëlqyeshme.

Autobusi i jugosllavëve mbushet me parulla të ndryshme, pëllëmbë për pëllëmbë, me sprej për ngjyrosjen e automobilave. Më në fund, shpërndahen pa therrë në këmbë.

Është interesant të shtohet se policia gjermane, prezente gjatë tërë kohës së përleshjeve, nuk intervenon asnjëherë, por e ndjek ngjarjen me gjakftohtësinë më të madhe. Asnjë punëtor nuk merret nga policia, as shfaqet fare ndonjë tentim i tillë nga ana e policisë. Disa nga policët gjermanë u bashkohen thirrjeve të parullës „Kosova – Republikë“ dhe u thonë hapurazi njerëzve tanë se kanë të drejtë të veprojnë kështu, sidomos pas nxjerrjes përjashta nga salla të dy njerëzve tanë.

Si e përshkruajnë shokët, ky ishte një manifestim i shkëlqyeshëm i vendosmërisë së punëtorëve tanë dhe i solidarizimit të tyre me bashkatdhetarët në Kosovë. Jugosllavët e pranishëm kanë se çka u tregojnë eprorëve të tyre.

Një shfaqje të ngjashme atyre u kanë organizuar, një javë më parë, edhe punëtorët tanë në Cyrih të Zvicrës. Por, atje, sipas mendimit tim, kanë bërë një gabim të vogël: punën e kanë nisur si kundërshtim ndaj një kënge popullore serbe, të kënduar nga nga një këngëtare serbe. Ndryshe, edhe atje u kanë dhënë mend aq, sa trupa menjëherë e ka ndërprerë turnenë nëpër Zvicër dhe ka kaluar në Gjermani. Në Mynih nuk ka pasur manifestim nga shqiptarët, por ka pasur një lloj bojkotimi. Nga afro 10 mijë shqiptarë që punojnë në atë qytet, në koncert kanë shkuar gjithsej 70 – 80 veta.

Këta rreshta t'i shkrova nën përshtypjen e kësaj ngjarjeje, që neve po na duket me rëndësi.

Tani të njoftoj se bashkë me shokun e „Bashkimit“ dhe të „Lirisë“ kemi vendosur të organizojmë një manifestim qendror për kremtimin e festës kombëtare të 28 dhe 29 Nëntorit në Shtutgart. Do të mblidhemi nja 300-400 veta nga Gjermania, Zvicra e Belgjika. Një pjesë e shokëve do të shkojnë për festë në Vjenë.

Të fala vëllazërore e revolucionare
Sokoli

Ja më në fund adresa e kërkuar e atij shokut në Australi:
B. Kr.
Penington Hostell
Penington SA 5013
Adelaide
Australia

(Adresën e kemi marrë nga „Lisi“, që duhet ta njohë shoku B. Kr. Kurse „Lisi“, që ka qenë këtu në Gjermani, te i ati, i ka marrë njoftimet nga „Bungu“ ose „Guri“, në mos qoftë njëri prej këtyre vetë shoku B. Kr. Besniku e di mirë, por nuk është këtu në këtë çast.)

(Shënim i Xhafer Durmishit: Këtë letër ma dërgoi Kadri Rexha, më 31 gusht 2013)
(U botua për herë të parë nga Faridin Tafallari në www.albaniapress.com, më 1 tetor 2013)

25. Letër për Kadri Zekën, (rreth 7 dhjetorit 1981)

Untergruppenbach, RFGJ
Dhjetor 1981

Mirëdita, shoku Z*!

Thirrjen për bashkim me Frontin po ta kthej ashtu si ma dërgove. Ato që thuhen në të për bashkimin e të gjitha organizatave komuniste, patriotike e revolucionare, dhe që, sipas meje, përbëjnë themelin e kësaj thirrjeje, janë në kundërshtim me informatat më të reja që kam marrë nga shokët e Lëvizjes. Si janë sjellë punët këto kohët e fundit, në gjithë çështjen ka gjëra të mjegullta (dëshiroj të gabohem nëse them se mjegullimi ka ardhur nga mënyra e veprimit të shokëve të Organizatës m-l).

Për mua konkretisht, dhe shokët e Lëvizjes me të cilët kam kontakt, thënia në "Thirrje", ku thuhet se është bërë bashkimi i organizatave, nuk është e vërtetë, së paku deri në këtë çast, ndërsa thirrja është shkruar shumë më herët.

Ju po deshët, mund të delni me atë thirrje. Por, duhet të jeni të vetëdijshëm se çfarë mund të jenë sukseset dhe konseguencat e një pune, në dokumentin e parë të së cilës themeli është vënë me të pavërteta.

Në lidhje të ngushtë me këtë, po dolët me Thirrjen pa u kristalizuar mirë të gjitha çështjet e bashkimit, ne do ta konsiderojmë se keni bërë përpjekje për t'i vënë disa forca të caktuara patriotike e revolucionare para një akti të kryer, në mos e teprofsha,. me manovrime nga ana juaj.

Prandaj, mos u habitni nëse pas hapit tuaj ne do të dalim publikisht me sheshimin e të pavërtetave.

Me përshëndetje revolucionare
Drini**

*) Zeqa, Kadri Zeka, shënim i Faridin Tafallarit
**) Pseudonim i Jusuf Gërvallës, shënim i Faridin tafallarit
(Botuar për herë të parë në www.albaniapress.com, më 5 qershor 2009, nga Faridin Tafallari, së bashku me shkrimin "IBRAHIM KELMENDI KA NDIKIM NË VRASJEN E JUSUF DHE BARDHOSH GËRVALLËS E KADRI ZEKËS", e ribotuar nga Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 277)

26. Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982

14 janar 1982

I dashur vëlla Mërgim,
Letrën për KQ të PPSH e vonuam shumë. Unë e shkrova në disa variante, por me asnjërin prej tyre nuk mbeta i kënaqur. Nuk jam mësuar të komunikoj me një nivel të tillë. Më së fundi e lashë variantin që mora prej teje.

Hapi si hap më pëlqeu shumë dhe më duket shumë i dobishëm. Por, nuk di a duhet të jemi të kënaqur si e kemi realizuar.

Në letrat e fundit na kanë arritur disa këshilla nga ana juaj. Ta them të drejtën se mua personalisht me kanë lënë me një ndjenjë të ftohtë. Thelbi i tyre konsiston, sipas përshtypjes sime, në një tërheqje në vete, që u dashka të aplikohet prej nesh. Ose nuk kam qenë në gjendje ta kuptoj qartë. Se cilësia duhet të ketë përparësi ndaj sasisë, kjo dihet dhe për këtë kam pas shkruar edhe vetë, nëse të kujtohet, në atë Qarkoren drejtuar atyre

shokëve në D., që ti e ke pas pëlqyer. Por, që atëherë kushtet kanë ndryshuar shumë. Tash ka dalë sheshit pezmi i madh i popullit, gatishmëria e madhe për flijime të larta, ideja e luftës për liri është materializuar më shumë se kurrë. Sipas njohurive të mia të pakta teorike, më duket se tash, në vend të reduktimeve e të përkufizimeve, duhet ta aplikojmë zgjerimin e furishëm të radhëve, ashtu si thotë Lenini me një rast, madje në atë mënyrë që rekrutët e rinj të zënë vendin e luftëtarëve të rëndomtë, kurse ushtari i vjetër të zërë vendin e oficerit të ulët. Kështu e pata kuptuar më në fund edhe zgjedhjen e Shpendit dhe timen në KQ. Rinia jonë revolucionare po kërkon radhët e revolucionarëve të organizuar. Ajo do të kapet në ato hallka që do t'i gjejë me leht. Po u mbyllëm ne, ajo do të kapet në radhët e të tjerëve. Më duket se Lëvizja duhet të mblidhet, t'i trajtojë me seriozitetin më të madh disa çështje vitale që dalin nga momenti aktual e që i kanë rrënjët në kushtet e ndryshuara shumë pas demonstratave të pranverës së shkuar. Mendoj se Lëvizja duhet të përfshihet prej impulsesh të reja. Se cilat do të jenë këto impulse, unë nuk jam në gjendje ta them. Por, po të përpiqen shokët, do ta gjejnë medoemos.

Unë kërkoj falje për guximin që po marr të flas kështu, sado që, siç e di edhe ti, njohuritë i kam të mangëta si për mënyrën e organizimit të brendshëm, ashtu edhe për gjendjen reale të punëve në veprimtarinë e sotme të organizatës sonë. Mirëpo, disa vërejtje, më parë se t'i mbaj në vete, parapëlqeva t'i them shtruar.

Shtypi revolucionar zë një vend me rëndësi në veprimtarinë e çdo organizate revolucionare. Ne tani mund të themi se kemi shtypin tonë. Por, pa u siguruar mënyra e sigurt e transportit dhe e shpërndarjes së tij, shtypi mbetet gjysmë i vdekur. Kurse ne nuk mund të krenohemi se kemi krijuar kushtet as për transport, e mbase as për përhapjen e tij të suksesshme. Kjo gjë po ushtron ndikim negativ edhe në punën e vetë redaksisë së „Z. K.". Është një ndjenjë e ligë kur mendon se je duke shkruar diçka që e ka shumë vështirë të bjerë në dorën e lexuesit.

Siç e di, ne kemi pas bërë që këndej njëfarë transporti të shtypit. E kemi futur atë në Atdhe, por atje s'i kemi pasur njerëzit që do ta shpërndanin si duhet. Tani, në drejtimin e transportit, kemi pësuar më në fund edhe një disfatë. Me numrin 1 të „Z. K." dërguam për në Atdhe dy punëtorë. Rruga e futjes së materialit ishte po ajo që kishim ndjekur në tri raste të suksesshme të transportit. Por, kësaj radhe puna dështoi dhe ata dy punëtorët ndodhen në duart e UDB-së. Pas kësaj e kemi shumë vështirë të ndjekim të njëjtën rrugë. Tani a të qajmë materialin që nuk ra në duart e lexuesit, apo të qajmë njerëzit që na u dëmtuan. Aktualisht numri i dytë (bashkë me shumë kopje të numrit 1) na kanë mbetur këtu dhe s'po bëjmë ballë dot t'u japim rrugë. Është disfata e parë kësodore që dy vjet e këtej dhe na ka demoralizuar shumë. Sa patëm zënë të kënaqemi e të marrim krah nga materialet që po na arrinin për revistën, tash u desh të na dilte edhe ky problem.

Nga ana tjetër, mënyra se si është vepruar nga ana juaj atje me futjen e materialit brenda, jo vetëm që nuk i plotëson nevojat për shtypin tonë revolucionar në Atdhe, por është e pasigurt dhe e rrezikshme po aq sa mënyra jonë. Si me një kopje të „Z. K." si me një mij, njeriu rrezikohet njësoj.

Si t'ia bëjmë këtij halli të madh? Marku s'na erdhi. Edhe po të kish ardhur, më duket (sipas fjalëve të Kolës) se edhe ai tashmë nuk është i pakompromet uar në sytë e UDB-së.

Ne kemi vrarë mendjen se rruga më e sigurtë për futjen e shtypit në Atdhe është shfrytëzimi i ndonjë transportuesi në relacionet evropiane. Juve ndoshta mund t'iu vijë përdoresh të gjeni ndonjë shofer shqiptar nga Turqia që bart mall me kamion të madh në shtetet evropiane, e që kalon nëpër Jugosllavi. Ne do t'ia jepnim që këtej materialin, kurse shokët brenda duhet ta gjejnë mënyrën se si ta marrin prej tij në dorëzim atë material. Në

rast të tillë neve do të na zvogëlohej problemi edhe sa i përket shtimit të tirazhit të revistës edhe shpeshtimit të daljes së saj, gjë që ka rëndësi të madhe.

Është keq që këtë punë s'e kemi bërë dert para disfatës sonë të parë, por tash kjo duhet të na bëhet një preokupim shumë serioz. Ndryshe, spontaniteti do të na kushtojë shtrenjtë dhe do të bëjë që të zhagitemi si zvarranikë e jo të veprojmë furishëm si revolucionarë.

Edhe një lajm jo fort të mirë kam për ju. Me insistimin e Shpendit, për të mos thënë me presionin e tij, Shpendi shkoi në Kosovë për një qëndrim të shkurtër, disa kohë para vitit të ri. Së andejmi u paraqit disa herë me telefon, e së fundi disa ditë para vitit të ri, kur tha se do të kthehej menjëherë pas vitit të ri. Mirëpo, sot jemi më 14 janar, e ai as na thirri më, as erdhi. Ne nuk kemi si t'i drejtohemi, sepse ai nuk është në shtëpi, por në ilegalitet. Por, jemi të brengosur shumë se mos i ka ndodhur gjë. Ndonjë lajm a shenjë për të keq nuk kemi, veçse vonesa e tij na brengos. Nëse ka fat dhe kthehet, ai do të na sjellë materiale me vlerë, sepse për atë qëllim edhe pat shkuar.

Tani po kthehem edhe njëherë në fillim të letrës. Mendimi im është se disa çështje parimore, siç është themelimi i partisë si domosdoshmëri apo rrezikshmëri në perspektivë, pastaj mënyra e organizimit të Lëvizjes në kushtet e reja të luftës, duhet të diskutohen e të pleqërohen më dendur me shokët, sidomos me Plakun. Jo vetëm gabimet e mëdha parimore, por edhe të voglat ka mundësi të evitohen shumë më mirë në këtë mënyrë. Ju atje jeni të lumtur që e keni Plakun. Në këtë pikëpamje ne jua kemi lakmi, se këndej punët në relacione të tilla nuk janë aq të thelluara, jo për fajin tonë.

Në fund, duke ju dërguar të fala vëllazërore e revolucionare, kërkoj falje për helmin e derdhur në këtë letër, por na helmuan ca problemet e përmendura dhe është e udhës t'i ndajmë bashkë.

Sokoli

P.S.
Vehbi Ibrahimi, i vrarë në Belgjikë, ishte sekretari personal i Emin Fazliut (Emil Kastriotit). Ky farë Emili, kryetar i së ashtuquajturës „Besëlidhja shqiptare", është një nga reaksionarët më të mykur shqiptarë në Perëndim. Enver Hadri, për sa jam i informuar, i takon gjoja një partie komuniste, por me orientim prorus. Edhe Martin Camaj, për sa dimë, është kundër Shqipërisë. Për emrat e tjerë, adresat e të cilëve na janë dërguar me nga një pikëpyetje pranë, nuk dimë gjë. Ne s'po u dërgojmë tash për tash asgjë, deri sa të mos vërtetohet puna e tyre. Në qofshin si këta që përmendëm më lart, s'kemi pse ua dërgojmë as helmin, lëre më shtypin tonë. (Fjala është për Hasan Beyn në Amerikë, Hysen Çamin në Suedi, Vincenzo Golletttin në Frankfurt.)

Ja një adresë ku të më shkruash për disa kohë:
Shaban Klaiqi
Postfach 1566
7030 Böblingen
W. Germany
Së shpejti të dërgoj edhe ndonjë tjetër.

(Marrë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f.452-454)

27. Letër Imer Baqajt në kampin Latina në Itali, 14 janar 1982

I dashur shok, Imer! 14 janar 1982

Sapo morëm një letër nga ana jote. Po të përgjigjemi edhe në letrën e parë.

Më vjen shumë mirë që dukesh pak më i stabilizuar sa i përket gjendjes në kamp. Aq më mirë që së shpejti bëheshke edhe me dokumente udhëtimi. Shpresoj se nuk do të ikësh gjëkundi pa u parë me ne. Ne me gjithë qejf do të vinim të shiheshim edhe atje, por edhe ne jemi të zënë me punë, edhe rruga është shumë e largët dhe po bëhen shumë shpenzime.

Unë po vërej se je një njeri që nuk lëshohesh verbër në marrëdhënie me njerëz. Por, megjithatë mosha jote s'ka pasur si të pajisë edhe me përvojën e duhur për njohjen e plotë të njerëzve në situata të vështira si kjo jona. Konkretisht, personi, për të cilin më njoftoje ne letrën e fundit e i cili thotë se është i lindur në Shqipëri, ose dredhon për arsye të cilat për ty e ne janë të panjohura, ose është provokator dhe agjent i rrezikshëm. Nga Duboviku s'kemi kurrfarë të dhënash për ndonjë familje a njeri që të ketë dalë në Shqipëri, herët as vonë. Përveç kësaj nga të gjithë emrat që përmend ai person duke thënë që janë nga Duboviku vetëm një është real, ai i Emrush Berishës, i shpërngulur në Pejë. Duke u nisur nga shumë arsye, ne e diskutuam me shokë dhe vendosëm të të njoftojmë që prej atij njeriu, ndonëse personalisht nuk e njohim, ti duhet të ruhesh sa prej gjarprit. Asnjë e mirë s'mund të dalë prej tij, vetëm të këqija. Ai që ka dalë nga Shqipëria për t'i ndihmuar kosovarët, e të tillë sot nuk ka, të jesh i bindur, këtë sekret kaq të rëndësishëm nuk do ta thoshte ty, as të tjerëve.

Prandaj, sytë në ballë. Mos u largo në mënyrë të prerë prej tij dhe shtiru sikur nuk je informuar gjë për të. Largimi të bëhet dalëngadalë dhe në mënyrë të padiktueshme. Ndryshe, ai mund të bëhet i rrezikshëm aty për aty dhe të të dëmtojë menjëherë, në qoftë se ka menduar të të dëmtojë më ngadalë. Ne nuk dimë ku e ka ai forcën, por duhet ta ketë te armiku ynë, nuk ia dimë "misionin", por mund të jetë "mision" shumë i rrezikshëm. Aq më parë, pasi ti thua se ai është shumë i ngritur në pikëpamje ideopolitike. Do të thotë se ka mundësi të jetë ndonjë kuadër i lartë e i rëndësishëm i UDB-së.

Më në fund, duke të përcjellë të fala vëllazërore e revolucionare, të urojmë stabilizim edhe më të madh të gjendjes dhe syçeltësi edhe më të madhe.

J. Gërvalla (Shënim i Xh. D.: Këtë letër në vitin 2012 ma përcolli Imer Baqaj përmes Asllan Muharremit. Kjo letër u botua për herë të parë nga Xhafer Durmishi në librin "Fjalori i Lëvizjes së Jusuf Gërvallës", 2013)

28. Letër për Ibrahim Kelmendin, 15 janar 1982

I dashur shok Ibrahim! 15 janar 1982

Me bisedën që patëm në dasmë, unë në njëfarë mënyre u tregova i padrejtë ndaj teje. Por, duhet ta kesh kuptuar që gjaknxehtësinë time mund ta zbrazja vetëm mbi një shok me të cilin nuk kemi pasur kufij. Arsye për të qenë aq gjaknxehtë, mbase nuk kam pasur. Puna e Organizatës në të cilën bëjë pjesë nuk shkon aspak keq. Por, nga takti më kanë nxjerrë disa gjeste e veprime të një shoku, që, të kundruara nga distanca e të sotmes,

më dalin një lojë e pamirë, së pari me personin tim, e pastaj edhe me një organizatë, çka, më shumë organizata revolucionare, madje në një çast madhështor të historisë sonë, që implikon dashurinë, afrimin dhe sinqeritetin më të madh mes luftëtarëve të lirisë.

Ti mund dhe besoj se je i painformuar lidhur me ato që kanë ndodhur në përçapjet për bashkimin e dy organizatave. Por, unë kam edhe më pak leje të të informoj për to, tani që e di se ku bënë ti pjesë. Edukata ime s'më lejon të veprojë në mënyrë të tillë. Shokët e tu të rinj e kanë me borxh ta bëjnë këtë punë. Unë e di se ata e kanë vështirë ta bëjnë, sepse, po ta bënin, do të duhej të flisnin hapurazi kundër punëve të tyre të pahijshme. Tash për tash mund të të them se kjo gjë nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar. Do të dalë në shesh se kush është duke bërë zhurmë për bashkimin, duke u çjerrë për të e duke luftuar kundër tij.

Një punë, megjithatë të ngarkon edhe ty. S'ka pasur hije pa marrë edhe mendimin tim, ta shpallje ndër njerëz se si një nga njerëzit e rëndësishëm të Lëvizjes na qenkësh, në mos antikomunist, atëherë së paku kundërshtar i partisë (iluzioniste) që do të formoheshka ndër ne. E vërteta është krejt ndryshe. Shoku Z. i ka procesverbalet e takimit me të. Po deshtët të ngulni këmbë edhe më tej në qëndrimin "antikomunist" të atij shokut të Lëvizjes, urdhëroni e bëjeni këtë punë në baza më të shëndosha e më të ndershme, merrini përbazë procesverbalet e takimit. Atje shihet se ku qëndron e vërteta për bashkimin e paarritur, e megjithatë të shpallur si akt të kryer në thirrjen e famshme "Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!", të cilën ndoshta nuk e ke pasur në dorë, ngase botimi i saj u spostua pas letrës sime dërguar shokut Z.

Tani po e kupton se unë hyra shumë thellë në punë që s'janë të miat, në punë tuaja të brendshme. Prandaj, nuk shkoj dot më tej. Dëshiroj që ana jonë këndej të jetë e gabuar dhe juve t'ju shkojë puna për së mbari deri në arritjen e fitores. Ne s'ndiejmë frikë as kemi dëm nga cilado forcë me të vërtetë patriotike e revolucionare e popullit tonë. Përkundrazi, atë kërkojmë si qorri sytë dhe ajo na bënë të mburremi. Por kemi një çikë ndruajtje se punës i është zënë jo fort mirë peta.

Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot shpresën e bashkimit. Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të nevojshëm e aq të shenjtë për ne, do ta bëjnë kur të vijë koha, njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta.

Tani po të njoftoj se këto ditë na arriti në videokasetë me pesë filma shqiptarë. Filmat janë të shkëlqyeshëm dhe shumë inspirues. Ne ende s'ia kemi dalë ta shumëzojmë videokasetën, se për këtë punë po na duhet edhe një videofon i dytë, që s'e kemi, dhe një shtojcë speciale për riinçizim, që s'e kemi poashtu. Po të nxorri rruga këndej ndonjë ditë dhe po pate mundësi, merr videofonin tuaj e eja t'i riinçizojmë. Me këtë rrugë, për të njejtën çështje po e njoftoj edhe shokun Z., megjithqë më duket se ata nuk kanë ende as videofon.

Të fala vëllazërore e revolucionare

J.G.

(Botuar për herë të parë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 411-412)

29. Letër Kadri Zekës, 15 janar 1982

Untregruppenbach, RFGJ

15 janar 1982

I dashur shoku Z*.!

Para disa ditësh e mora videokasetën e pritur. Në të janë pesë filma e drama shqiptare të shkëlqyeshme. Shfaqjet e tyre të para ndër punëtorët tanë, treguan se janë shumë frymëzues. Ne ende nuk arritëm t'i shumëzojmë e t'jua dërgojmë edhe juve, sepse po na mungon edhe një videofon i dytë. Sa më shpejt që të mundemi ta bëjmë inçzimin e tyre, ne do t'jua dërgojmë videokasetën. Ndoshta Ibrahimi ka mundësi më të mira, prandaj i thashë të vijë me videofonin e klubit, e po të vijë e bëjmë një kopje edhe për ju në Zvicër.

Po kështu kam marrë edhe disa shirita me radiodrama (për kasetofon). Ato do të përpiqemi të gjejmë mënyrën t'i shumëzojmë në më shumë, e mbase t'i shesim për të mbuluar shpenzimet e tyre. Në to janë përfshirë radiodramat: "Epoka para gjyqit"; "Besa e madhe"; " Toka jonë"; " Prijësja e komitëve"; "Tokë e ndezur".

Njëherazi shfrytëzoj rastin t'ju përgëzoj edhe njëherë për martesën dhe t'ju uroj trashëgim të frutshëm shqiptar.

Me përshëndetje revolucionare
Drini**

*) Kadri Zeka, shënim i Faridin Tafallarit
**) Pseud. i J. Gërvallës, shënim i Faridin Tafallarit
(Botuar për herë të parë në www.albaniapress.com, më 5 qershor 2009 nga Faridin Tafallari, së bashku me shkrimin "IBRAHIM KELMENDI KA NDIKIM NË VRASJEN E JUSUF DHE BARDHOSH GËRVALLËS E KADRI ZEKËS!!!???", e ribotuar nga Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 284-285)

==========

BETOHEM SE DO TA THEM TË VËRTETËN, KREJT TË VËRTETËN DHE ASGJË POS TË VËRTETËS

1. U VRANË TRE EMIGRANTË
2. KOSOVËS PO I VRITEN DJEMTË NGA SERBOMËDHENJTË
3. BETOHEM SE DO TA THEM TË VËRTETËN, KREJT TË VËRTETËN DHE ASGJË POS TË VËRTETËS

1. U VRANË TRE EMIGRANTË

Sipas kumtesës së policisë këta janë Bardhosh e Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zeka

Bon, 18 janar - (TANJUG)

Policia e Shtutgardit kumtoi se gjatë natës së kaluar në vendin Untergrupenbah, afër Hajlbronit, në Krahinën Baden-Virtenberg u vranë tre emigrantë me prejardhje jugosllave. Këta janë Bardhosh Gërvalla (31), Jusuf Gërvalla (36) dhe Kadri Zeka (28).

Policia ende po i gjurmon dorasit, por mund të supozohet se është fjala për qërim tipik hesapesh midis emigrantëve të nëntokës së RFGJ, të cilëve, siç mendon policia i kanë takuar edhe viktimat e kësaj përleshjeje. Ky supozim jipet nga rezultati i parë i hetimeve të policisë, i cili nuk është definuar në mënyrë plotësisht të qartë, por që është mjaft indikativ. Konsiderohet në të vërtetë se "fjala është për krim me prapavijë politike", sepse ndërmjet emigrantëve të këtij lloji të orientuar armiqësisht ndaj Jugosllavisë, ka më shumë "rryma" dhe "grupacione".

Bardhosh e Jusuf Gërvalla, siç merret vesh, janë vëllezër. Ata tash, sipas të gjitha gjasave, janë bërë viktima të mesit, të cilit i kanë takuar. Viktima e tretë, Kadri Zeka, siç pohon policia, para kësaj, ka jetuar në Zvicër, ku ka pasë marrë azil. Nuk ka dyshim se të vrarët tash një kohë të gjatë kanë jetuar në RFGJ.

Policia e Shtutgardit kumtoi se ka organizuar ndjekje përmasash të gjera për zënien e vrasësve të mundshëm.

Qeveria e Bonit, siç deklaroi përfaqësuesi i saj për shtyp, e dënon rrept vrasjen e tre personave. Ky përfaqësues shtoi në konferencën për shtyp se "qeveria shpreh keqardhje për shkak të përleshjeve të tilla. (RILINDJA)

2. KOSOVËS PO I VRITEN DJEMTË NGA SERBOMËDHENJTË

TIRANE, 19 janar 1982 ATSH, - Sikurse njofton agjensia gjermanoperëndimore e lajmeve, DPA, të dielën më 17 janar, natën vonë, në fshatin Untergrupenbah, në afërsi të qytetit të Shtutgart të Gjermanisë Perëndimore, u vranë kosovarët Bardhosh Gërvalla, Jusuf Gërvalla e Kadri Zeka. Sipas burimeve zyrtare gjermanoperëndimore, sulmi u krye të dielën natën, pak kohë pasi të tre kosovarët dolën me makinë nga një garazh. Vrasësit e armatosur hapën zjarr kundër makinës dhe vranë në vend Kadri Zekën (28 vjeç) dhe Bardhosh Gërvallën (31 vjeç). Jusuf Gërvalla (36 vjeç), i plagosur rëndë vdiq më pas në spital.

Agjencia gjermanoperëndimore e lajmeve, DPA, agjencia franceze e lajmeve, AFP, dhe agjencia amerikane e lajmeve, ASPRESS, duke dhënë lajmin e vrasjes së tre shqiptarëve, theksojnë se, sipas deklaratave të zyrtarëve të sigurimit gjermanoperëndimor të Shtutgartit dhe sipas shërbimit lokal të hetimeve kriminale, Jusuf Gërvalla duke dhënë shpirt në spital, akuzoi policinë sekrete jugosllave se qëndronte pas këtyre tri vrasjeve.

Ndërsa agjencia jugosllave e lajmeve TANJUG, lajmin që dha për vrasjen e tre djemve kosovarë e cilëson si "larje hesapesh" midis emigrantëve, shprehje kjo që e kemi dëgjuar shpesh nga udhëheqësit kryesorë jugosllavë dhe ata të Kosovës, kur është fjala për masa shtypëse e terroriste kundër shqiptarëve në Jugosllavi." (Zëri i Popullit, 20 janar 1982)

3. BETOHEM SE DO TA THEM TË VËRTETËN, KREJT TË VËRTETËN DHE ASGJË POS TË VËRTETËS

THE WITNESS (K6): [Interpretation] **I solemnly declare that I will speak the truth, the whole truth, and nothing but the truth.**

International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia (ICTY) 10 June 2002

"Më 24 maj 1999, Tribunali paraqet aktakuzë kundër Presidentit jugosllav Sllobodan Millosheviq për krime në Kosovë. Është e hera e parë që një gjykatë ndërkombëtare ngre aktakuzë kundër kryetarit në detyrë të një shteti. Më vonë akuzat kundër tij u zgjeruan edhe në lidhje me krimet e kryera kundër joserbëve në Kroaci, Bosnjë-Hercegovinë dhe Kosovë prej vitit 1991 deri në 1999.

Më 12 shkurt 2002 fillon procesi gjyqësor kundër Sllobodan Millosheviqit.

Më 14 mars 2006 mbyllet procesi kundër Sllobodan Millosheviqit pas vdekjes së tij natyrale në Njësinë e Paraburgimit të Tribunalit më 11 mars 2006."

(http://www.icty.org/action/timeline/254)

UDB'a E PRANON SE I KA VRA: JUSUF E BARDHOSH GËRVALLËN

Në procesin gjyqësor kundër kryekriminelit Millosheviç në Hagë, ka dëshmuar edhe një shqiptar (ish'udbash) i mbrojtur me Kodin K6. Në seancën gjyqësore të datës 10 qershor 2002 dëshmitari K6, pasi e ka dhënë betimin me fjalët: **Betohem se se do ta them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe asgjë pos të vërtetës**, ka pranuar se vëllezërit Jusuf e Bardhosh Gërvalla i ka vrarë Sigurimi Sekret serb. Për të argumentuar këtë fakt, po i referohemi dokumenteve zyrtare nga procesi gjyqësor kundër Sllobodan Millosheviçit.

10. 06. 2002 – Millosheviçi dhe Haga

PROKURORI NAJS: Sektori në të cilët është ndarë Shërbimi i Sigurimit Shtetëror, a janë këta sektor nën numrin tetë apo vetë Shërbimi i ka tetë sektore, nuk jam i sigurt. Në cilin numër keni qenë ju? Në cilin sektor keni punuar ju?

DËSHMITARI K-6: Në të tetin.

* * *

I AKUZUARI MILOSHEVIÇ: Kur jeni duke folur për bazat e forta në botën e jashtme, a është e vërtetë se UÇK'ja ka pasur baza të forta në Gjermani, Zvicër dhe Belgjikë? A është e vërtetë kjo apo jo?

DËSHMITARI K-6: Ashtu është.

I AKUZUARI MILOSHEVIÇ: Sipas njohurive tuaja, themeluesit e UÇK'së qysh në vitin e largët 1975, në mes tjerësh kanë qenë vëllezërit Gërvalla, a është kjo e vërtetë?

DËSHMITARI K-6: Kjo nuk është e vërtetë.

I AKUZUARI MILOSHEVIÇ: Nuk është e vërtetë a?

DËSHMITARI K-6: Jo.

I AKUZUARI MILOSHEVIÇ: Mirë. Ju thoni, vetëm një moment, shumë e gjatë është kjo deklaratë, ja në faqen 19: "**Themeluesit kanë qenë vëllezërit Gërvalla, Jusuf e Bardhosh, të cilët e kanë themeluar në Gjermani. Ata kanë jetuar në Ludwigsburg."** Dhe a është e vërtetë kjo që thoni se njerëzit të cilët i kanë vra këta të dy kanë qenë Lutfi Ajazi (përmendje në vazhdim), Selim Broshi dhe Jusuf Karakushi, gjithashtu të gjithë shqiptarë. A është e vërtetë kjo? E vërtetë apo e pavërtetë?

DËSHMITARI K-6: **Është e vërtetë se ata njerëz i ka vra policia, sigurimi sekret.**

I AKUZUARI MILOSHEVIÇ: Ju thoni në deklaratën tuaj se këtë e kanë bërë Lutfi Ajazi, Selim Broshi e Jusuf Karakushi, a është e vërtetë kjo apo nuk është?

DËSHMITARI K-6: Është e vërtetë. Ata kanë qenë të punësuar në sigurim.

* * *

IT IS TRUE THAT THESE PEOPLE HAVE BEEN KILLED BY THE POLICE, BY THE SECRET SECURITY

http://www.icty.org/x/cases/slobodan_milosevic/trans/en/020610ED.htm

Page 6569

Monday, 10 June 2002

[Open session]

[The accused entered court]

--- Upon commencing at 9.02 a.m.

JUDGE MAY: Yes, Mr. Nice.

MR. NICE: Before **K6** comes to give evidence, there are just a few matters that I must deal with in private session, with your leave, and one or two in public session, but they really won't take very long.

Private session, yes, please, if the Court approves.

Page 6570

==========

Page 6580

JUDGE MAY: Yes. Let us now turn to that witness. Mr. Nice, we have the summary, for which we're grateful. Given the time constraints and given that much of his evidence deals with the time with which we're normally concerned, perhaps that can be taken fairly quickly.

MR. NICE: May the blinds come down for his arrival.

The witness entered court]

JUDGE MAY: **Yes. Let the witness take the declaration.**

THE WITNESS: [Interpretation] **I solemnly declare that I will speak the truth, the whole truth, and nothing but the truth.**

JUDGE MAY: Yes. If you'd like to take a seat.

WITNESS: **WITNESS K6**

Witness answered through interpreter]

MR. NICE: May this witness be shown a piece of paper with a name on it, which I think has already been provided. I thought it had already been provided. There may be some misunderstanding.

Examined by Mr. Nice:

Page 6581

Q. Just look at this piece of paper, please. Don't read out the name on it. Just tell us if that is your correct name. Yes or no.

A. Yes.

MR. NICE: May that piece of paper be exhibited? It's not a very satisfactory piece of paper. I may get another one and substitute for it,but may it be exhibited?

THE REGISTRAR: Prosecution Exhibit 218.

MR. NICE: Your Honour, this witness is giving evidence with protection of distortion and a pseudonym, but for matters that would reveal his identity, I would seek private session, which will, of course, always be as short as possible. But for the first paragraph on the summary of the background, may we have private session, and after that - which should only take a couple of minutes - move into open session again.

JUDGE MAY: Before we move into private session, let me make it plain to those in the public gallery and elsewhere that any publication of this witness's proper name will be a contempt and will be treated as such.

Yes, Mr. Nice.

Private session]

Page 6582

==========

Page 6585

MR. NICE: Thank you very much.

Can we place one of them on the overhead projector, please. Can we place this one on the overhead projector. That one on the overhead projector, please. Thank you. This will be --?

THE REGISTRAR: This will be Exhibit 219.

MR. NICE: Thank you very much.

Q. K6, does this adequately set out the overall structure of the state security Kosovo detachments in early 1998?

A. Yes.

Q. We see at the head of the security a box with three names in it, headed by David Gajic.

A. Yes.

Q. Within the box, we see the various detachments for Pristina, Pec, Prizren, and then Kosovska Mitrovica, Gnjilane, and Urosevac. But just looking at Pristina, we see that that was itself broken down into five other detachments: Podujevo, Glogovac, Obilic, Kosovo Polje, and Lipljan, and was under the control of Lutfi Ajazi; correct?

A. Yes.

Q. If we go to the next exhibit, please, 220. Does this set out the subdivisions of state security in early 1998?

A. Yes.

Q. The sectors by which the state security was divided we can see are 8 by number, or whether they're 8 in number, I'm not sure. Which number were you in? Which sector did you work in?

A. In the eighth one, number 8.

Page 6586

==========

Page 6634

Q. And when you speak about strongholds abroad, is it true that the KLA had strongholds in Germany, Switzerland, and Belgium? Is that true?

A. True.

Q. Based on your information, the founders of the KLA were the **brothers Gervalla**, back in 1995, among others; is that right?

A. It is not right.

Q. Not right?

A. [In Serbian] No.

Q. Let me just find this. Your statement is much too long. Here, on page 19, there is a subheading that says "the KLA." And then you go on to say: "**The founders were the Gervalla brothers, Isuf and Bardhec,** and **they established it in the KLA. They lived in Ludwigsburg**." **And then you go on to say that they were killed there by the SUP in 1982. Is that true? And also, is it true what you go on to claim,** that the people **who killed these brothers** were Lutfi Ajazi, Selim Broshi, and Jusuf Karakushi, all of them Albanians? **Is this true or not? True or not?**

A. It is true that these people have been killed by the police, by the secret security.

Q. You say in your statement that this was done by Lutfi Ajazi, Selim Broshi, and Jusuf Karakushi. So is it true or not?

A. It is true. They have been employees of the security.

Page 6635-6636

==========

http://www.icty.org/x/cases/slobodan_milosevic/trans/en/020610ED.htm
International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia

==========

Libra nga Xhafer Durmishi – Skenderi i Shtutgartit, për Rilindasit e Shtutgartit
01. Protesta e Aspirata – Tetor 2006
02. Lëvizja e Jusuf Gërvallës- Tetor 2011
03. Zëri i popullit dhe Zëri i Jusuf Gërvallës-Nëntor 2011
04. Të fala s'po na çojnë asnjëherë-Dhjetor 2011
05. Nuk pyesin për çmimin e lirisë-Mars 2012
06. Pa taktizime-Prill 2012
07. Në rrethin e Shtutgartit-Shtator 2012
08. Fakte për Lëvizjen e Jusuf Gërvallës-Tetor 2012
09. Luga dhe Lugina-Dhjetor 2012
10. Filharmonia e Jusuf Gërvallës-Janar 2013
11. Shokët dhe Jusuf Gërvalla-Shkurt 2013
12. Fjalori i Lëvizjes së Jusuf Gërvallës-Maj 2013
13. Argatët agresiv-Maj 2013
14. Pa trazime-Qershor 2013
15. Skena-Qershor 2013
16. Emër që u bë traditë-Qershor 2013
17. Jusuf Gërvalla dhe Liria-Korrik 2013

18. Testamenti-Gusht 2013
19. Ilustrime-Janar 2014
20. Vepra e Jusuf Gërvallës-Janar 2014
21. Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit-Korrik 2019
22. Qendra Jusuf Gërvalla-Janar 2023
23. Lufta për liri në letrat e Jusuf Gërvallës, Mars 2024
24. Dëshmi e Dëshmorë, Janar 2025
25. HAPËSIRA, KOHA dhe Drita e Jusuf Gërvallës, Shkurt 2025
26. Referenca – Burime I-1979-1983
27. Referenca – Burime II-1982-1985

Jusuf Gërvalla: "*Kështu e pata kuptuar më në fund edhe zgjedhjen e Shpendit (Skenderit-shën im) dhe timen në Komitetin Qendror.*" (14 janar 1981)

Shaban Muharremi: "*Xhafer Durmishi është vlerë dhe krenari kombëtare e veçantë, është yll që do t'u shndris brezave! Edhe 25 veprat e tij për ngjarjet në Shtutgart dhe më gjerë, janë dëshmi e pakontestuar dhe e pastër si loti që ai po ia le historisë tonë. Personaliteti i tij kalon baladën për Gjergj Elez Alinë, ndërsa pena e tij, është penë e Marin Barletit të kohës moderne.*"

Xhafer Durmishi-Skenderi

Shënime për autorin

Xhafer Durmishi-Skenderi ka lindur në maj 1958 në fshatin Stanoc të poshtëm të komunës së Vushtrrisë. Nga arsimtarët e vetë të shkollës fillore angazhohet në organizatën "Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi". Në vitet 1977-1981 ka studiuar në Fakultetin Xehtaro-Metalurgjik në Mitrovicë, në degën e Teknologjisë. Nga korriku 1981 gjendet pranë Vëllezërve Gërvalla në Shtutgart. Pas atentatit të 17 Janarit 1982, në mars 1982, falë dhuntive të natyrës, diturive dhe cilësive të ndërgjegjes e tij, me kërkesën e rrethit të Jusuf Gërvallës vazhdon redaktimin e asaj gazete që më parë e kishte redaktuar Jusuf Gërvalla. Fillimisht në redaktimin e plotë dhe në përgatitjen teknike të gazetës kryesore të Lëvizjes për Republikë punon gjer në mars 1983. Pas një qëndrimi prej 100 ditësh në Paris, në korrik 1984 vendoset në Suedi. Në korrik 1985 shërbimet e tij për çështjen apo në emër të çështjes shqiptare, nga rrethi që i kishte qëndruar afër, nuk konsiderohen të nevojshme dhe lirohet nga detyrimet e obligimet e organizuara politike. Vepra e tij pas vitit 1985 e ka bazën në detyrimet e ndërgjegjes. Është përkthyesi i parë i autorizuar për përkthime në mes suedishtes e shqipes. Merret me përkthime. Është njohës i mbi njëzet e pesë gjuhëve të huaja.

==========

XHAFER DURMISHI-SKENDERI Janar 2014-Shkurt 2026